



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
MEKANIZMI KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS**

**AKTIVITETI I AVOKATIT TË POPULLIT TË SHQIPËRISË
NË ROLIN E
MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS**

RAPORTI I VEÇANTË VJETOR

2019

Tiranë 2020

TABELA E PËRMBAJTJES

Table of Contents

1. Kuadri ligjor i funksionimit të MKPT-së	6
2. Metodologjia e përdorur gjatë inspektimeve nga MKPT-ja	19
3. Struktura organizative e MKPT-së, përfaqësimi institucional dhe bashkëpunimet	20
3.1 Aktivitetet e institucionit të Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit për Parandalimin e Torturës.....	21
4. Vizitat monitoruese, gjetjet dhe rekomandimet	24
4.1 Niveli i respektimit të drejtave të të dënuarve dhe paraburgosurve në Institucionet Penitenciare	25
4.2 Niveli i respektimit të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar, arrestuar në njësitë policore	26
4.3 Niveli i respektimit të drejtave të të dënuarve dhe të paraburgosurve në Institucionet Penitenciare	27
4.4 Rastet e torturës, keqtrajtimit dhe ushtrimit të dhunës në njësitë policore dhe në institucionet penitenciare ndjekur hetuar nga ana e MKPT-së gjatë vitit 2019	30
4.5 Niveli i respektimit të drejtave të personave në Spitalet Psikiatrike dhe IEVP Krujë ...	31
4.5.1 Niveli i respektimit të drejtave të personave në Spitalet Psikiatrike dhe IEVP Krujë	31
4.6 Niveli i respektimit të drejtave të personave në Qendra	33
4.6.1 Qendra e Mbyllur për të Huajt, Karreç	33
4.6.2 Vizitat monitoruese në Shërbimin e Shëndetit Mendor me Shtretër në Shkodër	39
4.7 Monitorimi i pavarur i të drejtave të emigrantëve të huaj dhe kthimeve të detyruara të qytetarëve shqiptarë	42
5. Rekomandimet e dërguara në bazë të Inspektimeve të kryera gjatë vitit 2019 në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale	44
5.1 IEVP Berat	44
5.2 IEVP Elbasan	46

5.3 IEVP “MINE PEZA” Tiranë	52
5.4 IEVP Fier	58
5.5 IEVP Kavajë	62
5.6 IEVP Korçë	66
5.7 IEVP Krujë	72
5.8 IEVP Kukës	76
5.9 IEVP Lushnje	80
5.10 IEVP Peqin	86
5.11 IEVP Tepelenë	93
5.12 IEVP “JORDAN MISJA” Tiranë.....	98
5.13 IEVP Durrës	107
5.14 Spitali Psikiatrik Shkodër	116
5.15 Spitali Psikiatrik Elbasan	120
5.16 Spitali Psikiatrik Vlorë	124
5.17 QENDRA KOMBËTARE PRITËSE E AZILKËRKUESVE Babrru	127
5.18 QENDRA PRITËSE E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT Linzë	131
5.19 Q.S.U.T Spitali Psikiatrik “XHAVIT XHARRA” Tiranë.....	134
6. Rekomandimet e dërguara në bazë të Inspektimeve të kryera gjatë vitit 2018 në Drejtoritë e Policisë së Vendore dhe në Komisaritet e varësisë e DPV- ve	139
6.1 Komisariati i Policisë Lushnje	139
6.2 Komisariati i Drejtorisë Vlorë	142
6.3 Komisariati i Policisë Mat.....	145
6.4 Komisariati i Policisë Devoll	150
6.5 Komisariati i Policisë Berat	153

<i>6.6 Komisariati i Policisë Elbasan</i>	159
<i>6.7 Komisariati i Policisë Fier</i>	164
<i>6.8 Komisariati i Policisë Gjirokastrë</i>	169
<i>6.9 Komisariati i Policisë Gramsh</i>	174
<i>6.10 Komisariati i Policisë Has</i>	176
<i>6.11 Komisariati i Policisë Kapshticë Korçë</i>	179
<i>6.12 Komisariati i Policisë Krujë</i>	182
<i>6.13 Komisariati i Policisë Kuçovë</i>	184
<i>6.14 Komisariati i Policisë Kufitare Dibër</i>	187
<i>6.15 Komisariati i Policisë Kukës</i>	189
<i>6.16 Komisariati i Policisë Librazhd</i>	195
<i>6.17 Komisariati i Policisë Nr.3 Tiranë</i>	197
<i>6.18 Komisariati i Policisë Nr.4 Tiranë</i>	202
<i>6.19 Komisariati i Policisë Shijak</i>	206
<i>6.20 Komisariati i Policisë Peqin</i>	208
<i>6.21 Komisariati i Policisë Përmet</i>	210
<i>6.22 Komisariati i Policisë Pogradec</i>	213
<i>6.23 Komisariati i Policisë Shijak</i>	216
<i>6.24 Komisariati i Policisë Skrapar</i>	218
<i>6.25 Komisariati i Policisë Tepelenë</i>	222
<i>6.26 Komisariati i Policisë Vahu i Dejës Shkodër</i>	225
<i>6.27 Komisariati i Policisë së Kufirit dhe Migracionit, Muriqan</i>	227
<i>6.28 Reparti Ushtarak nr. 6620</i>	230

6.29 Stacioni i Policisë Kufitare Porti Durrës dhe në Drejtorinë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Durrës232

6.30 Komisariati i Policisë Kuçovë234

AKTIVITETI I AVOKATIT TË POPULLIT TË SHQIPËRISË NË ROLIN E MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS

RAPORTI VJETOR 2019

Veprimtaria e Institucionit të Avokatit të Popullit si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës gjatë vitit 2019

1. Kuadri, mandati ligjor dhe veprimtaria monitoruese e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës

Gjatë vitit 2019 Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) është përbushur si një detyrë funksionale e konsoliduar duke u mbështetur në prioritetet të veçanta.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, zbaton një sërë aktesh kombëtare dhe ndërkombëtare që normojnë dhe mandatojnë veprimtarinë e përditshme. Konkretisht, sipas pikës 1 të nenit 60 të Kushtetutës së Shqipërisë, Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike. Nisur nga nevoja për të përbushur një monitorim më të madh të institucioneve ku liria e personave është e kufizuar, ku dhe probabiliteti për shkelje është më i lartë, janë paraparë të rëndësishme për zbatim edhe dispozitat e Protokollit Opsional të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT)” miratuar me Ligjin Nr. 9094, dt. 03.07.2003.

Këto dispozita parashikojnë parimet bazë të inspektimeve në institucionet e mësipërme dhe garantojnë një aktivitet konform standardeve kombëtare në këtë drejtim.

Gjithashtu, neni 19/1, i Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, autorizon një veprimtari monitoruese dhe hetimore të pavarur, të gjithanshme dhe të plotë për çdo rast torture, trajtimi çnjerëzor dhe degradues, duke garantuar akses të madh në çdo ambient apo zyrë, ndaj çdo zyrtari pa imunitet dhe mbi çdo dokumentacion, qofte dhe të klasifikuar të organeve të administratës publike.

Gjatë vitit 2019, Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar kundër Torturës ka kryer **79** vizita inspektuese. Këto vizita janë kryer në bazë të planit të miratuar të inspektimeve në institucionet ku privohet apo mund të privohet liria e individit, përfshirë këtu institucionet penitenciare, njësitë policore, spitalet psikiatrike, qendrat ku trajtohen shtetasit e huaj, azilkërkuesit dhe viktimat e trafikut si dhe pikat e kalimit kufitar dhe mjediset ku parashikoheshin të ndërtoheshin kampet e trajtimit të përkohshëm të migrantëve. Përveçse sa më sipër MKPT-ja ka zhvilluar dhe aktivitete të tjera monitoruese që do të trajtohen më poshtë.

Rekomandimet dhe ndërhyrjet e mësipërme janë prezantuar kryesisht për respektimin e të drejtave të të dënuarve dhe paraburgosurve, në plotësimin e nevojave të tyre jetësore, shëndetësore dhe arsimore edhe një sërë masash të tjera për kryerjen e investimeve të brendshme infrastrukturore, në plotësimin e efektivit punonjës me qëllimin mbulimin e plotë të shërbimeve të kërkuara nga këto institucione. Përveç kësaj është mbajtur në konsideratë veprimtaria promovuese e të drejtave të njeriut në bashkëpunim me administratën e burgjeve dhe Drejtorinë e Policisë së Shtetit. Avokati i Popullit si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës, ka vijuar të kryejë veprimtarinë e tij në inspektimin e ambienteve të Policisë së Shtetit, duke u ndalur dhe kontrolluar veçanërisht ligjshmërinë dhe rregullsinë e shoqërimit, ndalimit apo arrestimit të individëve, kushtet dhe trajtimin e tyre brenda komisariateve, problematikat infrastrukturore dhe materiale të tyre etj. Gjatë vitit 2019, janë kryer sondazhe në shërbimet policore, mbi mënyrën e trajtimit të rasteve të shoqërimit të shtetasve, për mbajtjen e objekteve të dyshimta në zyrat e hetimit që mund të provokojnë dhunë psikologjike tek individët, si dhe për rolin e psikologut të policisë në trajtimin e personave të mitur dhe të efektivave që mund të shfaqin probleme psikologjike gjatë shërbimit. Për të gjitha rastet e konstatuara janë prezantuar edhe vërejtjet përkatëse në rekomandimet që u janë dërguar organeve eprore të Policisë së Shtetit.

Një tjetër fushë ku është fokusuar gjatë vitit 2019 aktiviteti i Avokati i Popullit si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës, ka qenë monitorimi i operacioneve të përbashkëta të kthimit të detyruar të emigrantëve të paligjshëm nga zona Shengen të koordinuara nga Frontex. Gjatë periudhës Janar 2019- Dhjetor 2019, Avokati i Popullit në rolin e MKPT-së, në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë Kufitare dhe të Migracionit dhe Frontex, ka monitoruar në mënyrë konstante operacionet e riadhesimit vullnetar e të detyruar të shtetasve shqiptarë nga vendet e BE-së dhe shteteve të zonës Shengen, me qëllimi transferimin sipas rregullave të shtetasve shqiptarë me vendim riadhesimi nga territoret e vendeve anëtare të BE-së. MKPT, ishte pjesë e grupit monitorues të 25 operacioneve të riadhesimit, duke u bashkërenduar dhe me Mekanizmat e vendeve të tjera, duke ushtuar në këtë mënyrë rolin e vet ligjor si garant, e njëkohësisht duke përmbushur Direktivën 2008/115/EC të Parlamentit Evropian për standardet e përbashkëta midis vendeve të BE-së dhe vendeve të treta, në monitorim e pavarur nga ana e MKPT-ve të operacioneve të kthimit të shtetasve nga BE në vendet e origjinës.

Avokati i Popullit është përfaqësuar rregullisht dhe aktivisht në të gjitha aktivitetet e përvitshme të organizuara nga organizmat ndërkombëtare dhe shoqatat ne mbrojtje të të drejtave të njeriut me qëllim shkëmbim informacionesh dhe përvojash më të mira dhe është pjesë e rrjeteve të MKPT-ve në nivel ndërkombëtar.

Roli parandalues i Avokatit të Popullit në mbrojtje të shkeljes së të drejtave të personave te privuar nga liria për vitin 2019

Institucioni i Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) është parashikuar në ligjin Nr. 9094, datë 03.07.2003 “Për ratifikimin e Protokollit Opsional

të Konventës kundër Torturës dhe Dënimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT)”, ndërkohë që njohja ligjore e saj, si strukturë e veçantë pranë Avokatit të Popullit në Shqipëri, u bë efektive me hyrjen në fuqi të ligjit Nr. 9888, datë 10.03.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosurve”. Gjatë vitit 2016, shtesat dhe ndryshimet ligjore të bëra me anë të Ligjit Nr. 155/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8454, datë 4.2.1999, ‘Për Avokatin e Popullit’”, i ndryshuar e kanë kaluar strukturën e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT), në nivel Seksioni duke parashikuar zgjedhjen nga ana e Kuvendit të Shqipërisë të Komisionerit drejtues të këtij seksioni.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) në ushtrimin e detyrave të tij të njohura nga legjislativi vendas, udhëhiqet edhe nga parime e instrumente të sanksionuara në legjislativin ndërkombëtar si: Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, si edhe protokollat e saj shtesë¹; Konventa kundër Torturës dhe Vuajtjeve të tjera ose Trajtimin Mizor, Çnjerëzor e Degradues,²; Protokollin Opsional i Konventës kundër Torturës dhe Ndëshkimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT),³; Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve apo Ndëshkimeve Çnjerëzore dhe Poshtëruese,⁴. Lista e instrumentave që udhëheqin punën e Mekanizmit nuk është shteruese, pasi ka një sërë rekomandimesh, veçanërisht të Këshillit të Evropës dhe vendimesh të Gjykatës së të Drejtave të Njeriut të Këshillit të Evropës të cilët janë të rëndësishëm dhe përbejnë standarde në garantimin e të drejtave të personave të privuar nga liria. MKPT funksionon dhe vepron në përputhje me legjislativin vendas, si Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë; Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë; Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë; Ligjin Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”; Ligjin Nr. 44/2012, datë 08.05.2012 “Për Shëndetin Mendor”; Ligjin Nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar; Ligjin Nr. 10032, datë 11.12.2008 “Për Policinë e Burgjeve”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 437, datë 20.5.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”; Ligjin Nr. 13/2015 “Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”; Ligjin Nr. 121/2014 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”; Ligjin Nr. 108/2013 “Për të huajt”; VKM-në nr. 589, datë 28.08.2003 “Për ngritjen dhe vënien në funksionim të Qendrës Pritëse të Viktimave të Trafikut”. Sërish, kjo nuk është një listë shteruese, pasi ka një sërë Vendimesh të Këshillit të Ministrave, si edhe manuale dhe dokumente të tjera pune, zbatimi i të cilave është një garanci për gëzimin e të drejtave.

I gjithë aktiviteti i mësipërm është shoqëruar me përcjelljen e **79** raporteve të inspektimit dhe rekomandimeve ndaj institucioneve përgjegjëse mbi problematikat dhe fenomenet e konstatuara. Nga përgjigjet e deritanishme të marra mbi rekomandimet, ato rezultojnë të jenë pranuar e të kenë vënë në lëvizje institucionet për të përmbushur detyrimet e tyre. Mbetet për t’u ndjekur në vazhdim plotësimi i masave të tjera për përmirësimin e kushteve të trajtimit të individëve që mbahen në këto institucione.

¹ ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin Nr. 8137, datë 31.7.1996.

² ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin Nr. 7727, datë 30.06.1993.

³ ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin Nr. 9094, datë 03.07.2003.

⁴ ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin Nr. 8135, datë 31.07.1996.

Gjatë kryerjes së vizitave monitoruese, MKPT-ja kishte për objekt të punës mbledhjen e informacionit mbi:

- Trajtimin e personave në institucione dhe identifikimin e rasteve të përdorimit të presionit psikologjik, trajtimit degradues e diskriminues, torturës apo forcës fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative.
- Nivelin e zbatimit të masave mbrojtëse, duke krahasuar përputhshmërinë e tyre me kuadrin normativ vendas dhe standardet ndërkombëtare.
- Cilësinë e kujdesit shëndetësor.
- Kushtet materiale për trajtimin e personave që qëndrojnë në ambientet e këtyre institucioneve, duke u përqendruar kryesisht në aspekte të tilla si ushqimi dhe shërbimi në kohë i vakteve, ndriçimi natyral e artificial, ventilimi-aspirimi e sistemi ngrohës, respektimi i mundësisë për higjienën personale, kushtet sanitare, mbipopullimi, kushtet e banimit etj.
- Vlerësimin e respektimit të të drejtave të personave të trajtuar, sipas zërave të parashikuara në rregulloret institucionale dhe specifike të tyre (për të pasur kontakte me këshilltarët ligjorë e familjarët për të kryer telefonata për t'u informuar mbi të drejtat e tyre në një gjuhë që e kuptonin për t'u informuar nëpërmjet medias elektronike dhe asaj të shkruar për procedurat e punësimit dhe shpërblimet për punën e kryer për të drejtën për aktivitete në ajër të pastër të drejtën e ushtrimit të riteve fetare, të drejtën për të përfituar ndihmë financiare etj.).
- Zhvillimin e arsimit të detyrueshëm, kurseve profesionale dhe të aktiviteteve rekreative e rehabilituese, sipas specifikave të institucioneve, etj.

Në inspektimet e bëra gjatë vitit 2019 u vunë re një sërë problematikash të cilat paraqesin nevojë të ngutshme për shqyrtim e përmirësim.

Përmbledhtazi gjetjet pasqyrohen në vijim:

- Kushte materiale tejet degraduese e pa mundësi rikonstruktimi të mjediseve në regjimet e brendshme të I EVP Zahari Krujë, I EVP Tepelenë, I EVP Kukës, I EVP Lezhë të cilat e bëjnë të pamundur garantimin e të drejtave të të paraburgosurve dhe të dënuarve të sanksionuara në aktet ndërkombëtare dhe legjisllacionin kombëtar në fuqi. Meqenëse këto gjetje vazhdojnë të konstatohen në mënyrë të përsëritur, madje me kushte edhe më të degraduara si rrjedhojë e mbipopullimit të vazhdueshëm, mungesës së investimeve dhe amortizimit, Avokati i Popullit ka rekomanduar mbylljen e menjëhershme të këtyre institucioneve dhe transferimin e personave në institucione të tjera penitenciare.
- Infrastruktura në pjesën më të madhe të I EVP-ve paraqiste probleme të amortizimit, lagështirës, furnizimit me ndërprerje me energji elektrike e ujë, sigurimit të ndriçimit natyral dhe të ajrosjes së plotë të qelive, pranisë së insekteve, kushteve jashtë standardeve të tualeteve, kuzhinave, dusheve, ambienteve të ajrimit, dhomave të izolimit, etj. I EVP-të me

problematika emergjente infrastrukturore paraqiteshin I EVP Zahari-Krujë, Lushnje, Rrogozhinë, Sarandë, Lezhë, Tepelenë. Përrjashtim bënin I EVP-të e reja dhe ato të rikonstruara të cilat praktikisht kanë krijuar një sistem me dy standarde në sistemin penitenciar shqiptar.

- Mbipopullimi, megjithëse ka pësuar një rënie vitet e fundit në disa nga I EVP-të si në I EVP 302, Tepelenë, Jordan Misja, I EVP Durrës, vazhdon të jetë prezent. Gjatë vizitave në jo pak mjaft raste grupet e inspektimit kanë gjetur 4 (katër) deri në 6 (gjashtë) persona të akomodohen në një qeli, duke mos respektuar standardin 4m² hapësirë jetike për çdo të burgosur. *(Për më shumë referojuni tabelës nr. 1 më poshtë).*
- Moszbatim i marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë për ngritjen e një Institucioni të Posaçëm Mjekësor të parashikuar në ligjin Nr. 44/2012, datë 08.05.2012 “Për Shëndetin Mendor”, me qëllim strehimin dhe trajtimin e personave që kanë marrë nga gjykata masën “mjekim i detyruar” dhe “shtrim i përkohshëm”. Investimi i filluar gjatë vitit 2019 në përshtatjen e dy ndërtesave të I EVP Lezhë, ende nuk ka përfunduar, duke shkelur afatin e përcaktuar në kontratë dhe për më tepër nuk dihen arsyet e ndërprerjes të punimeve. Trajtimi i kësaj kategorie vazhdon të kryhet në I EVP Zahari-Krujë, i cili është në kushte materiale degraduese, me mungesa në organikë të personelit mjekësor dhe ku aksesit për konsulta psikiatrike pranë spitaleve psikiatrike rajonale paraqet vështirësi. Gjithashtu, trajtimi në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve për rastet me episode akute, vijon të mbetet i paligjshëm, gjë e cila vazhdon të reflektohet në raportet kombëtare, ndërkombëtare dhe në konferencat rajonale. Gjendja gjatë vitit 2019 u rëndua dhe më shumë në këtë institucion për shkak të mbipopullimit të theksuar.
- Mungesa e Mjekëve në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale mbetet një problematikë shqetësuese e sistemit tone penitenciar. Avokati i Popullit gjatë vitit 2019 për rreth 12 I EVP në rang vendi ka rekomanduar marrjen e masave për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të plotë sipas parashikimeve në organikën e institucionit. Më problematike paraqitet situata në I EVP 302, I EVP Tepelenë, I EVP Fushë Krujë, I EVP Kukës, I EVP Korçë, I EVP Berat, I EVP Durrës, I EVP Fier, I EVP Peqin, I EVP Lushnje. *(Për më shumë referojuni tabelës 2 më poshtë).*
- Ambientet e kujdesit shëndetësor në burgje, përjashtuar I EVP-të e reja si në Vlorë, Berat, Fier, Durrës, Elbasan dhe Shkodër, ishin përgjithësisht të papërshtatshme për vizita mjekësore si dhe janë të pa pajisura me materiale ndihmëse.
- Probleme me ofrimin e mundësisë për arsim. Në I EVP Kukës, I EVP Jordan Misja 313, I EVP Rrogozhinë, I EVP Fier, I EVP Tropojë, I EVP Fushë-Krujë, I EVP Sarandë, I EVP Shën Koll-Lezhë, I EVP Elbasan, I EVP Peqin, I EVP 302, mungonin kurset profesionale dhe nuk ofrohej arsimit detyrueshëm në përputhje me marrëveshjen ekzistuese ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për arsimin 9-vjeçar. Theksojmë se në asnjë prej institucioneve penitenciare nuk ofrohej arsimit mesëm. Ndërsa në mbi 17 (shtatëmbëdhjetë) I EVP, mungojnë kurset e formimit profesional në bashkëpunim me drejtoritë rajonale.

- Shpërblimi për punën e kryer në të gjitha institucionet, vazhdon të kryhet me ditë ulje nga dënimi, gjë që nënkupton paragjykim të fajësisë për kategorinë e të paraburgosurve. Po në këtë kuadër për punën që kryenin të paraburgosurit në këto institucione nuk paguhej vlera përkatëse e sigurimeve shoqërore, gjë që sjell mos vlerësimin e kohës së punës në institucion si kohë vjetërsie në punë si dhe mohimin e një të drejte, atë të përfitimit të pensionit të pleqërisë. Të dënuarit nuk ishin të pajisur me librezë pune dhe as me atë të kontributeve shoqërore. Kjo problematikë është trajtuar më gjerësisht dhe pikën 4.1 “Të drejtat e personave të privuar nga liria”.
- Ambientet e përbashkëta për zhvillimin e aktiviteteve rehabilituese mungonin në një pjesë të IEVP-ve si rezultat i kthimit të ambienteve të edukimit apo ushtrimit të rriteve fetare e veprimtarive sportive në dhoma banimi apo mungesës së fondeve për pajisjen e tyre me materiale didaktike. Po ashtu sipërfaqet e vogla për ajrim të jashtëm kushtëzonin llojin e aktiviteteve sportive që mund të zhvilloheshin në to. Për rrjedhojë në thuajse të gjitha IEVP-të, u konstatuan probleme sa i përket aktiviteteve në grup apo individuale dhe pamundësi nga sektori psiko-social të cilat ndonëse mundohen t’i realizojnë realisht nuk arrijnë t’i kryejnë për mungesë të ambienteve të përshtatshme, bazës materiale apo dhe organikës së paplotësuar.
- Vonesa dhe mangësi paraqiten në pajisjen e të dënuarve/paraburgosurve me libreza shëndetësore apo me të dhënat elektronike në sistemin e sigurimeve shëndetësore në shumicën e IEVP-ve që sillnin si pasojë moszbatimin e skemës së rimbursimit të ilaçeve dhe probleme në furnizimin me medikamente.
- Vështirësi në realizimin e konsultave, ekzaminimeve dhe analizave laboratorike specifike si dhe ndërhyrjeve kirurgjikale, vëreheshin ende në disa prej IEVP-ve për arsye të lidhura me mungesën e mjekëve me kohë të plotë në organikë apo mungesën e autoambulancave, me rezistencën e spitaleve rajonale për të trajtuar personat për shkak të mungesës së kushteve të sigurisë në to, etj.
- Probleme të ofrimit të shërbimit stomatologjik në IEVP që vinin si rrjedhojë e mungesave në aparatura dhe materiale ndihmëse. Shërbimet dentare, përveç ekstraksioneve, kryheshin me vështirësi në poliambulancat publike apo në klinikat private me shpenzimet e vetë të dënuarve.
- Sistemet qendrore të ngrohjes, pothuajse në të gjitha IEVP-të, ku ishin të instaluar nuk funksiononin si rezultat i defekteve teknike ose të mungesës së karburantit. Në shumicën e rasteve të dënuarit/paraburgosurit nuk i sigurohet ngrohja sipas parashikimeve ligjore.
- Mungesat në furnizimin me produktet bazë të higjienës personale (pastë dhëmbësh, furçë dhëmbësh, shampo, etj.) dhe të detergjenteve të nevojshme për të pastruar qelitë si dhe mungesat në uniforma dhe doreza gjatë shpërndarjes së ushqimit, u konstatuan në shumicën e IEVP-ve.
- Mungesat në dollapë e rafte të rrobave bënin që ato të mbaheshin nga të dënuarit/paraburgosurit në qese plastike ose në thasë, kryesisht poshtë shtretërve. Kjo

problematikë ndeshej kryesisht në I EVP Lezhë, Tepelenë, Korçë, Durrës, Tiranë (“Jordan Misja”), Sarandë, Kukës, Rrogozhinë e Tropojë.

- Problem i hasur në të gjitha institucionet e inspektuara, ishte konstatimi i çmimeve të larta të produkteve të dyqaneve të I EVP-ve.
- Mbetej shqetësuese thujse në të gjitha I EVP-të, cilësia dhe larmia e ushqimit.

Problematikat e vërejtura nevojitet të adresohen me vendimmarrje nga organet e larta shtetërore, pasi në shumicën e rasteve ato janë rezultat i ashpërsimit të politikës penale, mungesës së fondeve dhe mungesës së nxjerrjes së akteve nënligjore për të bërë përmirësime të nevojshme të sistemit si në formë ashtu dhe në përmbajtje.

Tabela 1– Rekomandimet e inspektiveve të MKPT-së për 2019, me të dhëna mbi mbipopullimin ose jo në I EVP

Nr.	I EVP	Data e inspektimit	Kapaciteti zyrtar i Institucionit	Numri i të burgosurve në ditën e inspektimit	Mbi kapacitet
1	I EVP Tepelenë	11.12.2019	75 persona	90 persona	15 persona
2	I EVP Elbasan	12.03.2019	140 persona	145 persona	5 persona
3	I EVP Peqin	05.04.2019	560 persona	548 persona	-
4	I EVP Durrës	02.07.2019	300 persona	261 persona	-
5	I EVP Kukës	22.07.2019	36 persona	13 persona	-
6	I EVP Tropojë	23.07.2019	26 persona	19 persona	-
7	I EVP 302	11.12.2019	170 persona	90 persona	-
8	I EVP Fushë-Krujë	16.10.2019	312 persona	384 persona	72
9	Instituti i të Miturve Kavajë	21.03.2019	40 persona	32 persona	-
10	I EVP Korçë	23.09.2019	312 persona	375 persona	63
11	I EVP Berat	02.07.2019	112 persona	108 persona	-
12	I EVP Lushnjë	10.04.2019	198 persona	179 persona	-
13	I EVP Fier	11.04.2019	870 persona	813 persona	-
14	I EVP Reç	27.05.2019	857 persona	405 persona	-
15	I EVP Rrogozhinë	08.07.2019	343 persona	309 persona	-
16	I EVP Krujë	20.06.2019	190 persona	288 persona	98
		17.12.2019		290 persona	100
17	I EVP Jordan Misja	04.09.2019	482 persona	486 persona	4

Tabela 2 – Rekomandimet e inspektimeve të MKPT-së për 2019, mbi mungesën e mjekëve dhe stafit mjekësor në IEVP

Nr	Institucioni	Data e Inspektimit	Numri i të dënuarve në ditën e inspektimit	Gjendja aktuale e stafit mjekësor	Rekomandimet e MKPTsë
1.	EVP 302	26.12.2019	170 të burgosur	1 mjek me kohë të pjesshme	Marrjen e masave për plotësimin e organikës me 1 mjek me kohë të plotë
2.	IEVP Fushë Krujë	16.10.2019	384 të burgosur	1 mjek me kohë të pjesshme	Të merren masa të menjëhershme për sigurimin e mjekut me kohë të plotë.
3.	IEVP Tepelenë	11.12.2019	90 të burgosur	1 mjek me kohë të pjesshme	Marrjen e masave për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të plotë sipas parashikimeve në organikën e institucionit.
4.	Instituti i të Miturve Kavajë	21.03.2019	32 të burgosur	1 mjek me kohë të pjesshme	Marrjen e masave për sigurimin e mjekut me kohë të plotë.
5.	IEVP Korçë	23.09.2019	375 të burgosur	2 mjekë me kohë të pjesshme	Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të plotë sipas parashikimeve të organikës.
6.	IEVP Berat	02.07.2019	108 të burgosur	1 mjek me kohë të pjesshme	Marrjen e masave të menjëhershme për punësimin me kohë të plotë të 1mjeku, 1 stomatolog dhe 1 farmacisti
7.	IEVP Durrës	30 maj 2019	261 të burgosur	1 mjek të përgjithshëm dhe 1 infermier me kohë të pjesshme	Marrjen e masave për plotësimin e organikës të stafit mjekësor me 1 mjek të përgjithshëm dhe 1 infermier.

8.	IEVP Peqin	05.04.2019	548 të burgosur	Mungonin 3 mjekë dhe 1 stomatolog	Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e organikës të institucionit me 3 mjekë të përgjithshëm dhe stomatologu me kohë të plotë, për t'ju përgjigjur nevojave dhe kërkesave të të dënuarve/paraburgosurve për vizita mjekësore dhe ofrimin e një shërbimi shëndetësor sa më cilësor
9.	IEVP Fier	11.04.2019	813 të burgosur	Organika përbëhej nga 2 mjekë, ku njëri prej tyre punonte me kohë të pjesshme	Marrjen e masave për plotësimin e pozicionit të mjekut të dytë me kohë të plotë
10.	IEVP Lushnjë	10.04.2019	179 të burgosur	1 mjek me kohë të pjesshme, si dhe nuk kishte farmacist	Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të plotë sipas parashikimeve në organikën e I.E.V.P, Kosovë, Lushnjë ose në mënyrë alternative me dy mjekë me kohë të pjesshme
11.	IEVP Kukës	22.07.2019	13 të burgosur	1 mjek me kohë të pjesshme dhe 3 ndihmësmjekë	Marrjen e masave për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të plotë
12.	IEVP Kukës	23.07.2019	19 të burgosur	1 mjek me kohë të pjesshme dhe 3 ndihmësmjekë	Marrjen e masave për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të plotë

Për vitin 2019 kemi rekomanduar për 12 (IEVP) plotësimin e organikës me mjek të përgjithshëm.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2019, Avokati i Popullit në rolin e MKPT-së në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë Kufitare dhe të Migracionit dhe FRONTEX ka vazhduar të monitorojë në mënyrë konstante operacionet e riadhesimit vullnetar e të detyruar të shtetasve shqiptarë nga vendet e BE-së dhe shteteve të zonës Shengen, me qëllim transferimin sipas rregullave të shtetasve shqiptarë me vendim riadhesimi nga territoret e vendeve anëtare të BE-së. MKPT ka

qenë pjesë e grupit e rreth 26 operacioneve të riatdhimit, duke u bashkërenduar dhe me Mekanizmat e vendeve të tjera, duke ushtuar në këtë mënyrë rolin e vet ligjor si garant, e njëkohësisht duke përmbushur Direktivën 2008/115/EC26 të Parlamentit Europian për standardet e përbashkëta midis vendeve të BE-së dhe vendeve të treta në monitorimin e pavarur nga ana e MKPT-ve të operacioneve të kthimit të shtetasve nga BE në vendet e origjinës. Pjesëmarrja jonë në këto operacione është realizuar duke përdorur kapacitetet e kufizuara të institucionit pasi, ndonëse kemi kërkuar që të na vihen në dispozicion kapacitete shtesë në nivel ndihmëskomisioneri, Kuvendi nuk e ka mundur një gjë të tillë. Si rezultat nga 44 operacione në të cilat është kërkuar prania e përfaqësuesit të institucionit tonë, ne kemi mundur të marrim pjesë në vetëm rreth 26 prej tyre për mungesë burimesh njerëzore.

Në përfundim të proceseve të monitorimit, Avokati i Popullit në rolin e MKPT-së në takimet e zhvilluara me përfaqësues të FRONTEx dhe të Drejtorisë së Policisë Kufitare dhe të Migracionit ka sugjeruar marrjen e masave për të garantuar kthimin në mënyrë njerëzore duke respektuar plotësisht të drejtat themelore të emigrantëve shqiptarë, respektimin rigoroz të standardeve të BE-së si dhe respektimin rigoroz të ligjit shqiptar.

Bashkëpunimi në kuadër të OPCAT-it

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës gjatë vitit 2019 ka bashkëpunuar ngushtësisht me Komitetin për Parandalimin e Torturës (CPT), Nënkomitetin e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Torturës (SPT), Shoqatën për Parandalimin e Torturës (APT) për të siguruar një sistem cilësor mbikëqyrje e raportimi. Bashkëpunimi me këto struktura është kryer në kuadër të takimeve të përbashkëta e kontakteve të drejtpërdrejta dhe kanë pasur për qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe vlerësimin e nevojave e mjeteve të nevojshme në luftën për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria në përmbushje të OPCAT-it.

Me ftesë të Avokatit të Popullit në datat 27-31 Maj 2019, një delegacion i Observatorit të Pavarur të NPM-së (NPM Obs) shoqëroi NPM-në shqiptare (MKPT) në vizitat inspektuese në vendet e privimit të lirisë si:

- IEVP Reç, Shkodër
- Pika e kalimit kufitar të Muriqanit
- Drejtoria e Policisë Kufitare Shkodër
- Komisariati i Policisë Bushat
- Shërbimi psikiatrik i Shkodrës
- Burgu Shën Koll i Lezhës, dy ndërtesa që përkohësisht do të shërbejnë për të dënuarit me mjekim të detyruar

- Spitali psikiatrik i Elbasanit
- Qendra pritëse e mbyllur për emigrantët e Kareçit
- Instituti i të miturve në Kavajë - IEVP Durrës

Delegacioni i NPM Obs kryesohej nga z.Patrizio Gonella, ekspert i njohur ndërkombëtar në fushën e jurisprudencës dhe parandalimit të torturës dhe në përbërje të tij ishin z.Petur Hauksson, mjek psikiatër me shumë përvojë në fushën e tij, ish anëtar i CPT-së si dhe z. Markus Jaegger, drejtues i Seksionit për të Drejtat e Njeriut dhe Migracionin, pranë Këshillit të Europës, një nga personalitetet më të shquara ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut të parandalimit të torturës dhe sjelljeve degraduese e çnjerëzore, i cili mori pjesë si përfaqësues i Këshillit të Europës, nën statusin e vëzhguesit të NPM Obs në kuadrin e një projekti të përbashkët midis Këshillit të Europës dhe Bashkimit Europian të quajtur "Forumi Europian i NPM".

Të gjitha vizitat ishin të paparalajmëruara. Delegacioni i NPM Obs/Këshilli i Europës mundi të hyjë në të gjitha institucionet e sipër përmendura, së bashku me MKPT-në shqiptare, bazuar në legjislacionin kombëtar dhe parimet e OPCAT që lejon NPM-në të shoqërohet nga çdo ekspert që zgjedh, duke përfshirë të huajt.

Në përmbyllje të këtyre takimeve nga të dyja palët u hartuan konkluzionet paraprake në të cilat, grupi i NPM Obs shprehu mirënjohjen për eksperiencën e kaluar gjatë gjithë javës së monitorimit në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale si dhe në qendrat e tjera ku privohet liria e individëve në Republikën e Shqipërisë dhe u ndal në mënyrë të veçantë në punën dhe procedurat e ndjekura nga grupi i ekspertëve të MKPT-së të cilët sipas grupit të ekspertëve të observatorit njëzëri dëshmuuan nivel të lartë profesionalizmi në zbatimin e detyrave të tyre si dhe paralelisht një organizim të mirëfilltë që tregonte funksionimin e këtij seksioni në përputhje me standardet e kërkuara nga OPCAT, CPT dhe legjislacioni shqiptar. Rekomandimet e grupit të OBS do të shërbejnë në vijimësi për përmirësimin e punës së MKPT-së.

Mbi vizitat e kryera është hartuar një raport i përbashkët, i cili është në fazën e diskutimit dhe do të bëhet publik në momentin e finalizimit.

Monitorimi i pavarur i të drejtave të emigrantëve të huaj

Institucioni i Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës vijoi të zbatojë, gjatë vitit 2019, Marrëveshjen e bashkëpunimit të nënshkruar me UNHCR në kuadër të projektit të përbashkët "Refugjatët dhe Azilkërkuesit në vendet e Europës Juglindore". Krahas zonës kufitare të Gjirokastrës, Sarandës dhe Përmetit, aktiviteti i Avokatit

të Popullit përmes ekspertëve u shtri përgjatë vitit 2019 edhe në zonën e Shkodrës, Kukësit, Korçës dhe Bilishtit.

Ekspertët, sipas orientimeve të institucionit të Avokatit të Popullit dhe në bashkëpunim me UNHCR, përgjatë gjithë vitit realizuan kontakte në këto tre zona ndërkufitare me qindra të huaj të parregullt duke i informuar për të drejtat, duke i intervistuar dhe duke monitoruar procesin e evidentimit të tyre që kryhet nga punonjësit e sektorit të emigracionit, duke parë dhe bashkëpunuar për nevojat në asistimin e tyre për trajtim me ushqime dhe veshmbathje, duke kryer koordinimin e bashkëpunimit me strukturat përgjegjëse në raste të asistencës mjekësore kur ka qenë e nevojshme, përfshirë komunikimin me urgjencën spitalore, ndjekjen e rasteve në spital, komunikime për mbarëvajtjen e mjekimeve për raste të thjeshta, etj.

Ekspertët u përfshinë në monitorimin sistematik të kufijve, raportimin periodik pranë institucionit të Avokatit të Popullit të gjetjeve, trajtimin e zgjidhjen e problematikave të hasura duke bashkëpunuar me Drejtoritë Rajonale të Kufirit në nivel vendor, autoritetet qendrore të kufirit dhe migracionit si dhe në bashkëveprim me UNHCR-në.

Shqipëria u përball gjatë vitit 2019 me shtim të hyrjes së të huajve të parregullt kryesisht përmes kufirit jugor dhe juglindor me Greqinë për të vijuar më tej drejt Malit të Zi, me destinacion përfundimtar vendet e Bashkimit Europian. Rritja e prurjes së të huajve të parregullt u shoqërua me shtim të kërkesave për azil në territorin shqiptar dhe me adresimin e nevojave prioritare për mbrojtje, ndihmë dhe shërbime sidomos për grupet më të rriskuara, siç janë gratë dhe fëmijët, personat me nevoja të veçanta apo personat me probleme shëndetësore.

Përfaqësuesit e Avokatit të Popullit janë prirur nga mendimi kritik gjatë kontakteve për të përmirësuar cilësisht elementë të ndryshëm në mekanizmin e mbrojtjes së migrantëve mbi bazë të identifikimit të boshllëqeve në sistemin e azilit. Një nga sfidat me të cilat përballlet sistemi është mungesa e përkthyesve për gjuhë të rralla (pasi një person nga grupi i emigrantëve shërben vetëm me anglishte të dobët si përkthyes për pjesën tjetër të grupit) dhe pengesa të tilla gjuhësore ndikojnë në procesin e identifikimit dhe përzgjedhjes.

Tabela 3. Aktiviteti i përmbledhur i Ekspertëve në Gjirokastrë, Korçë dhe Shkodër

Proceset e ndjekura	Rajonet	Treguesit vjetorë
Vëzhgimi në procesin e evidentimit të të huajve të parregullt dhe Intervistat e Përzgjedhjes	Gjirokastrë	1.510 persona
	Saranda	18 persona
	Korça	110 persona
	Bilisht	680 persona
	Shkodra	1180 persona
	Kukës	17 persona

Monitorime kufiri dhe vizita në terren në zonat kufitare	Gjirokastrë	146 vis.
	Saranda	15 vis.
	Korça	16 vis.
	Bilisht	38vis. 135 vis
	Shkodra Kukës	9 vis.
Intervista të thelluara me të huaj të parregullt	Gjirokastrë	330 persona
	Saranda	14
	Korça	15persona
	Bilisht	46persona
	Shkodra Kukës	181 9
Raporte Analitike për gjetjet gjatë vëzhgimeve	Gjirokastrë	10
	Saranda	
	Korça	1
	Bilisht	
	Shkodra Kukës	2
Raporte rekomanduese mbi gjetjet gjatë vëzhgimeve	Gjirokastrë	7
	Saranda	2
	Korça	1
	Bilisht	
	Shkodra Kukës	3

Tabela 4: Të huajt e parregullt të trajtuar nga ekspertët në 3 zonat Gjirokastrë, Korçë dhe Shkodër

Moshat	Meshkuj		Femra		Total	
	Në numër	në %	në numër	ne %	në numër	në %
0-17	212	7,1	160	26,8	372	10,6
18-59	2400	82,5	380	63,8	2780	79,1
60 >	305	10,4	55	9.4	360	10,3
Total:	2917	100%	595	100%	3512	100%
Rajonet	Korçë, Shkodër, Gjirokastrë					

Gjejmë me vend të theksojmë se ky aktivitet nuk do mund të kryhej pa bashkëpunimin dhe mbështetjen e UNHCR-së pasi kapacitetet aktuale të MKPT-së nuk mund ta kryejnë këtë mandat.

Rastet e torturës, keqtrajtimit dhe ushtrimit të dhunës në njësitë policore dhe në institucionet penitenciar

Pranimi dhe shqyrtimi me përparësi dhe me rigorozitet i ankesave të qytetarëve ndaj organeve të Policisë së Shtetit për dhunimin fizik të tyre në njësitë policore si dhe ndaj Policisë së Burgjeve për dhunimin fizik të të paraburgosurve dhe të dënuarve në institucionet penitenciare ka qenë dhe do të vazhdojë të mbetet një nga prioritetet e institucionit të Avokatit të Popullit.

Duhet theksuar se pavarësisht hapave të rëndësishëm përpara kjo problematikë mbetet shqetësuese, pasi përbën një nga shkeljet më të rënda të të drejtave themelore të njeriut. E drejta për të mos ju nënshtruar torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues, e cila garantohet dhe mbrohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (neni 25), Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (neni 3), Konventa e OKB-së, Kundër Torturës dhe Ndëshkimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese, “Protokolli Opsional i Konventës Kundër Torturës dhe ndëshkimeve të tjera çnjerëzore dhe degraduese (OPCAT)”, Kodi Penal (nenet 86 dhe 250) është një e drejtë absolute.

Dhuna e ushtruar nga punonjës policie që në disa raste përbën torturë ose veprime arbitrare, cenon rëndë integritetin fizik e psikologjik të personit dhe lë pasojë në shëndetin dhe në raste të veçanta edhe në jetën e të dhunuarit, deri në humbjen e saj. Ky veprim është i dënueshëm penalisht për personin që e kryen atë. Ndërkohë ai cenon rëndë imazhin e Policisë së Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve si dhe dëmton e trondit besimin e publikut tek këto organe. Gjithashtu, ky tregues negativ i Policisë është i papranueshëm në një shtet të së drejtës dhe në një shoqëri demokratike.

Rastet e tejkallimit të forcës nga punonjësit e policisë ndaj qytetarëve janë të vështira për t’u provuar si edhe vërtetuar. Kjo lidhet me shumë arsye e shkaqe, sepse ato kryhen në vende të mbyllura, brenda ambienteve të policisë në zyra, pa dëshmitarë të jashtëm okulare por edhe në rastet kur ka të tillë është e vështirë që të dhunuarit të dalin kundër punonjësve të policisë. Ekziston edhe frika e hakmarrjes tek qytetarët për ti denoncuar rastet e dhunës si dhe pasiguri e mosbesim në ndjekjen e tyre nga organet e drejtësisë. Që të mundësohet vërtetimi i dhunës policore është e nevojshme që, ankesa të bëhet sa më shpejtë, kur pasojat e saj janë ende të dukshme dhe ndërkohë, duhet bërë hetimi administrativ në vend. Mekanizmi për Parandalimin e Torturës ka hetuar për vitin 2019, 4 (katër) raste me iniciativë dhe 5 (pesë) ankesa me pretendim ushtrim dhune. Për më shumë shikoni rekomandimet përkatëse në faqen e Avokatit të Popullit.

2. Metodologjia e përdorur gjatë inspektimeve nga MKPT-ja

Metodologjia e ndjekur nga MKPT-ja gjatë vizitave inspektuese konsiston në: përgatitjen e vizitës, ndarja në grupe, takimi dhe bashkëbisedimi me drejtuesin/drejtuesit e institucionit, grupi monitorues

viziton të gjitha hapësirat e institucionit, kryen intervista me personat e privuar nga liria, zhvillon takime me punonjësit e burgjeve (përfshirë personelin me uniformë si dhe ata civilë), me punonjësit e policisë në raste e inspektimit në komisariatet e policisë, zhvillon takime me personelin shëndetësor, kontrollojnë regjistrat, dhomat ku merren në pyetje të ndaluarit/shoqëruarit, kuzhinat në rastet e inspektimeve në burgje, spitale psikiatrike, apo qendrat e ndryshme të azilit apo të antitrafikut, në përfundim të inspektimit zhvillon takimin ndërmjet anëtarëve të grupit monitorues, përpara takimit final me drejtuesin e institucionit dhe më tej, biseda finale me drejtuesin ku i parashtrihen gjetjet dhe i lihen paraprakisht rekomandimet për përmirësimin e problematikave të evidentuara.

Faza e përgatitjes së vizitës nënkupton mbledhjen e informacionit të rëndësishme për institucionin i cili do të vizitohet, objektivi i vizitës, përcaktimin e numrit të anëtarëve të MKPT-së, të cilët do të marrin pjesë në grupin inspektues, ndarjen konkrete të detyrave, si dhe diskutimi me Seksionin e Veçantë lidhur me rastet e ankesave, që mund të kenë ndjekur ata, për institucionin që do të inspektohet. MKPT-ja i kryen vizita në vendet ku privohet liria, kryesisht pa paralajmërim.

Gjatë bisedës paraprake me drejtuesin e institucionit, i cili inspektohet nënkupton prezantimin e mandatit të MKPT-së në mënyrë efektive dhe profesionale, prezantimin e anëtarëve të ekipit monitorues, objektivi i vizitës, kontrolli nëse janë zbatuar apo jo rekomandimet e lëna nga Avokati i Popullit në inspektimin e mëparshëm etj. Pas bisedës fillestare me drejtorin, ekipi monitorues bën inspektimin në të gjitha hapësirat e institucionit.

Vlen të theksohet se në intervistat me personat e privuar nga liria dhe zyrtarët e institucionit, ekipi monitorues i siguron të të intervistuarit se biseda do të jetë konfidenciale, pa prezencë të zyrtarëve të institucionit.

Në përfundim të gjithë procedurave grupi inspektues harton raportin dhe lë rekomandimet përkatëse të cilat ua dërgon institucioneve të inspektuara.

3. Struktura organizative e MKPT-së, përfaqësimi institucional dhe bashkëpunimet.

Gjatë vitit 2019, MKPT ka funksionuar si një seksion me strukturë multidisiplinare të përbërë nga 4 (katër) ndihmës komisionerë, pjesë e shërbimit civil të Republikës së Shqipërisë, prej të cilëve tre ekspertë ligjorë dhe një psikologe dhe është drejtuar nga Komisioneri i zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë. Për herë të parë në 15 mars 2018, sipas ndryshimeve të bëra në ligjin për Avokatin e Popullit, Kuvendi i Shqipërisë zgjodhi znj. Ermonela Xhafa, si komisionere e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës.

Gjatë vitit 2019, Avokati i Popullit në rolin e MKPT-së mori pjesë në aktivitetet e Rrjetit të MKPT-ve të Evropës Juglindore, rrjet ky i jetësuar në vitin 2013 bazuar në Deklaratën e Bashkëpunimit të nënshkruar nga Institucionet e Ombudsmanëve/Avokatëve të Popullit të Shqipërisë, Austrisë, Bullgarisë, Kroacisë, Maqedonisë, Malit të Zi, Sllovenisë, Serbisë, Bosnjës dhe Hercegovinës,

Hungarisë, Greqisë dhe Rumanisë. Në përmbushje të qëllimit të këtij rrjeti të specifikuar edhe në OPCAT për rritjen e bashkëpunimit, shkëmbimin e eksperiencave dhe organizimin e aktiviteteve të tjera të përbashkëta për një realizim sa më të qenësishëm të mandatit të MKPT-ve në rajon, MKPT-ja shqiptare mori pjesë dhe kontribuoi në disa seminare dhe konferenca.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës gjatë vitit 2019, ka bashkëpunuar ngushtësisht me Komitetin për Parandalimin e Torturës (CPT), Nënkomitetin e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Torturës (SPT), Shoqatën për Parandalimin e Torturës (APT) për të siguruar një sistem cilësor mbikëqyrje e raportimi. Bashkëpunimet me këto struktura janë kryer në kuadër të takimeve të përbashkëta, kontakteve të drejtpërdrejta dhe kanë pasur për qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe vlerësimin e nevojave, mjeteve të nevojshme në luftën për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria në përmbushje të OPCAT-it.

Gjatë vitit 2019, Avokati i Popullit në rolin e MKPT-së, në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë Kufitare dhe të Migracionit dhe Frontex, ka monitoruar në mënyrë konstante operacionet e riadhesimit vullnetar e të detyruar të shtetasve shqiptarë nga vendet e BE-së dhe shteteve të zonës Shengen, me qëllimi transferimin sipas rregullave të shtetasve shqiptarë me vendim riadhesimi nga territoret e vendeve anëtare të BE-së. MKPT, ishte pjesë e grupit monitorues të **25** operacioneve të riadhesimit, duke u bashkërenduar dhe me Mekanizmat e vendeve të tjera, duke ushtuar në këtë mënyrë rolin e vet ligjor si garant, e njëkohësisht duke përmbushur Direktivën 2008/115/EC të Parlamentit Evropian për standardet e përbashkëta midis vendeve të BE-së dhe vendeve të treta, në monitorim e pavarur nga ana e MKPT-ve të operacioneve të kthimit të shtetasve nga BE në vendet e origjinës.

3.1 Aktivitetet e institucionit të Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit për Parandalimin e Torturës

Në kuadrin e bashkëpunimit Ndërkombëtar, janë realizuar aktivitetet si më poshtë:

- Konferenca “National Preventive Mechanism Policy On Reprisals” - Shkup, Maqedoni.
- Konferenca “ Multilateralizmi Efektiv Në Luftën Kundër Torturës: Trendet Në Rajonin e Osbe Si Dhe Rruga Përpara” - Vjenë, Austri.
- Konferenca “ European Final Conference: Children’S Rights Behind Bars” – Bruksel.
- Vizitë Studimore, Kosovë.
- Në ditën Kombëtare të Jetimëve date 20.20.2019, një ditë kur shoqëria dhe institucionet reflektojnë më shumë për të gjetur rrugët dhe mënyrat që t’i ndihmojnë më shumë ata. Problemet që po kalon sot shoqëria shqiptare kanë viktimizuar, së pari këtë pjesë të pambrojtur të popullatës.
- Institucioni i Avokatit të Popullit mori pjesë në organizimin e aktivitet bamirës të organizuar nga Qendra e Kujdesit të Fëmijëve Jetim “Zemër nëne”. Aktiviteti kishte një emër kaq kuptimplotë “Bëhu arsye e buzëqeshjes”.

- Të pranishëm në këtë aktivitet ishin deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, përfaqësues të pushtetit lokal të qarkut Gjirokastrë, fëmijë të cilët festuan së bashku, si një familje e madhe. Në emër të institucionit të Avokatit të Popullit këtë aktivitet e përshëndeti Komisionerja e Avokatit të Popullit znj. Ermonela Xhafa. Ndër të tjera ajo tha: “Avokati i Popullit është i përkushtuar në punën e tij, për të dëgjuar cilindo që ndjehet i nëpërkëmbur apo i shkelen të drejtat e tyre. Dyert tona janë të hapura për jetimët dhe kauza e tyre është kauza jonë. Prania jonë sot këtu në këtë aktivitet të organizuar me kaq dashuri është për të dëshmuar pikërisht angazhimin se ata nuk janë vetëm”. Ky organizim mbështetej nga Qendra e kujdesit të fëmijëve.
- Avokati i Popullit dhe Qendra “Tirana Art” kanë një bashkëpunim shumë të mirë, ne i kemi ndjekur në punën e tyre të lavdërueshme dhe në fushatën e tyre të parë “Handle with Care” dhe kemi dhënë kontributin tonë.
- Avokati i Popullit, si një institucion kushtetues, një ndër prioritetet e punës së tij, ka dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe sidomos të grupeve më të dobëta dhe më të varfëra që kryesisht janë viktimat të trafikimit. Qendra “Tirana Art” çeli më datë 22.10.2019 në orën 11.00, në sheshin kryesor të qytetit të laçit “Gjin Pjetri”, ekspozitën “Care and Dare” Kjo ekspozitë ishte realizuar nga nxënësit e këtij qyteti kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Care and Dare mbështetet nga Ambasada e Mbretërisë së Vëndeve të Ulta në Tiranë, dhe i financuar nga Ambasada Hollandeze.
- Avokati i Popullit në datën 27.10.2019 mbështet Iniciativën e Sensibilizimit mbi Çështjet e Trafikimit të Femrave edhe në Shkodër. Në ditën e dytë të aktivitetit “Handle with Care”, në Shkodër, mori pjesë komisionerja e Avokatit të Popullit, Ermonela Xhafa. E emocionur ajo përshkroi, jo vetëm anën ligjore, para nxënësve dhe studentëve, por edhe ndjesitë njerëzore duke u shprehur: “Më mirë do doja t’ju flisja me fjalë zemre se sa të futesha në detaje juridike. Të japim shembuj të nënave dhe motrave model”. Për t’u ardhur në ndihmë viktimave të trafikimit e qenieve njerëzore është vënë në dispozicion një numër telefoni i cili mund të përdoret nga çdokush që ka për të raportuar një situatë, kjo telefonatë është pa pagesë. Studentët pranuan se nuk ishin të informuar rreth këtij fenomeni. Midis historive të shumta që u treguan nga pjesëmarrësit, një prej nxënësve, rrëfeu eksperiencën e tij më një mikeshën e tij, vetëm 13-vjeçare, të cilën e trafikoje e ëma. Nxënësi kërkoi ndihmë për të shpëtuar shoqen e tij! Pjesëmarrja e nxënësve dhe studentëve që u bënë pjesë e diskutimeve ishte intensive deri në përfundim të aktivitetit. Ky aktivitet financohej nga Ambasada Hollandeze.
- Në kuadër të mbylljes së fushatës "16 Ditët e Aktivizimit", në datë 16.12.2019 me Mekanizmin Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit, dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues përfaqësuar nga Komisionerja znj Ermonela Xhafa dhe në bashkëpunim me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi z. Robert Gajda, zhvilluan një bashkëpunim me të dënuarat dhe të paraburgosurat e I EVP 325 “ Ali Demi”. Fokusi i këtij takimi ishte respektimit të të drejtave dhe trajtimit të paraburgosurve dhe të dënuarve, sidomos për grupet vunerabël, siç janë gratë dhe vajzat. Takimi u zhvillua në frymën e bashkëpunimit. Nga ana e MKPT-së u dhuruan disa libra artistikë dhe juridik për bibliotekën e I EVP-së 325. Këto libra u mundësuan nga stafi i Avokatit të Popullit dhe kjo nismë do të vijojë dhe për disa I EVP të tjera. Ky aktivitet nuk përmban kosto financiare.

- Në datën 18.12.2019 në vijim të aktiviteteve të tjera në kuadër të fushatës për ndërgjegjësim kundra trafikimit “Care and Dare”. Projekti “Care and Dare” Aktivitet në shkollën e Mesme të Bashkuar “Bahri Nela” në Zall Bastar me të rinjtë e kësaj shkolle. Avokati i Popullit, si një institucion kushtetues, ndër prioritetet e punës së tij, ka respektimin e të drejtave të njeriut dhe sidomos të grupeve më të dobëta dhe më të varfëra që kryesisht janë viktimat e trafikimit. Trafikimi i qenieve njerëzore sot përbën shkeljen më të rëndë dhe më të egër të të drejtave të njeriut. Është shqetësuese që Shqipëria ende mbetet një vend burimi dhe destinacioni të trafikimit për qëllime të shfrytëzimit seksual apo dhe punës së detyruar. Për t’u ardhur në ndihmë viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore është vënë në dispozicion një numër telefoni pa pagesë 08001111, numër i cili mund të përdoret nga çdokush, që ka për të raportuar një situatë ose kërkon ndihmë brenda fushave që mbulon Avokati i Popullit. Projekt I financiar nga Ambasada Hollandeze.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, në realizim të funksioneve të tij ligjore, edhe gjatë vitit 2019 ka bashkëpunuar ngushtësisht me Organizatat e Shoqërisë Civile aktive dhe të specializuara të fushës në vend, si me Komitetin Shqiptar të Helsinkit etj. Falë këtij bashkëpunimi, është arritur që të realizohen inspektime të përbashkëta, me karakter multidisiplinar dhe të thelluar si dhe janë zhvilluar auditoriume, konferenca e seminare me qëllim nxjerrjen në pah të problematikave të konstatuara në burgje e komisariate si dhe diskutimin e gjetjen e zgjidhjeve për to.

Në funksion të promovimit të të drejtave të njeriut në vend, si dhe parandalimit të shkeljeve, ekspertët e MKPT-së gjatë vitit 2019 kanë qenë aktivë në median e shkruar dhe atë elektronike shqiptare, përmes konferencave për shtyp, takimeve të përbashkëta me gazetarët, intervistave, si dhe pjesëmarrjes në emisione televizive, me qëllim ndërgjegjësimin mbi problematikat dhe arritjet në fushën e të drejtave të njeriut për personat e privuar nga liria.

MKPT në rolin e Monitoruesit të Protestave përgjatë vitit 2019:

1. Monitorimin e protestës së datës 28/03/2019 përpara Parlamentit.
2. Monitorimin e protestës, inspektimin e datës 14.04.2019.
3. Monitorimi i protestës së datës 02.06.2019.
4. Monitorimi i procesit zgjedhor 30.06.2019.
5. Monitorimi i protestës së datës 08.07.2019.
6. Monitorimi i protestës së datës 21.06.2019.
7. Monitorimi i protestës së datës 08.06.2019.
8. Monitorimi i komisariateve (Në të gjitha Komisarariatet Tiranë dhe DVP në përfundim të protestave të zhvilluara).

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, në realizim të funksioneve të tij ligjore, edhe gjatë vitit 2019 ka bashkëpunuar ngushtësisht me Organizatat e Shoqërisë Civile aktive dhe të specializuara të fushës në vend, si me Komitetin Shqiptar të Helsinkit etj. Falë këtij bashkëpunimi, është arritur që të realizohen inspektime të përbashkëta, me karakter multidisiplinar dhe të thelluar si dhe janë

zhvilluar auditoriume, konferenca e seminare me qëllim nxjerrjen në pah të problematikave të konstatuara në burgje e komisarate si dhe diskutimin e gjetjen e zgjidhjeve për to.

Në funksion të promovimit të të drejtave të njeriut në vend, si dhe parandalimit të shkeljeve, ekspertët e MKPT-së gjatë vitit 2019 kanë qenë aktivë në median e shkruar dhe atë elektronike shqiptare, përmes konferencave për shtyp, takimeve të përbashkëta me gazetarët, intervistave, si dhe pjesëmarrjes në emisione televizive, me qëllim ndërgjegjësimin mbi problematikat dhe arritjet në fushën e të drejtave të njeriut për personat e privuar nga liria.

4. Vizitat monitoruese, gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë vitit 2019, Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit, ka kryer **79** vizita të kryera në bazë të planit të miratuar të inspektimeve për vitin 2019 në të gjitha institucionet ku privohet apo mund të privohet liria e individit, përfshirë këtu institucionet penitenciare, njësitë policore, spitalet psikiatrike, qendrat ku trajtohen shtetasit e huaj, azilkërkuesit dhe viktimat e trafikut, si dhe pika të kalimit kufitar dhe mjediset ku parashikoheshin të ndërtoheshin kampet e trajtimit të përkohshëm të migrantëve.

I gjithë aktiviteti i mësipërm, është shoqëruar me përcjelljen e **79** raporteve të inspektimit dhe rekomandimeve ndaj institucioneve përgjegjëse mbi problematikat dhe fenomenet e konstatuara.

Nga përgjigjet e deritanishme të marra mbi rekomandimet, ato rezultojnë të jenë pranuar e të kenë vënë në lëvizje institucionet për të përmbushur detyrimet e tyre. Mbetet për t'u ndjekur në vazhdim plotësimi i masave të tjera për përmirësimin e kushteve të trajtimit të individëve që mbahen në këto institucione.

Aktiviteti i mësipërm, është shoqëruar me përcjelljen e 79 raporteve të inspektimit dhe rekomandimeve ndaj institucioneve përgjegjëse mbi problematikat dhe fenomenet e konstatuara. (rekomandimet mund ti gjeni ne faqen e Avokatit te Popullit si vijon <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles/mechanisms-against-torture/jails/rekomandime-drejtuar-sistemit-t-burgjeve-2019-296/> rekomandimet e 2019.

<https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles/mechanisms-against-torture/police/rekomandime-drejtuar-policis-2019-301/> rekomandimet e komisarateve për vitin 2019.

Nga përgjigjet e institucioneve përgjegjëse mbi rekomandimet, rezultojnë të jenë pranuar e të kenë vënë në lëvizje institucionet për të përmbushur detyrimet e tyre. Mbetet për t'u ndjekur në vazhdim plotësimi i masave të tjera për përmirësimin e kushteve të trajtimit të individëve që mbahen në këto institucione. Gjatë kryerjes së vizitave monitoruese, MKPT kishte për objekt të punës mbledhjen e informacionit mbi:

- Trajtimin e personave në institucione dhe identifikimin e rasteve të përdorimit të presionit psikologjik, trajtimit degradues e diskriminues, torturës apo forcës fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative.

- Nivelin e zbatimit të masave mbrojtëse, duke krahasuar përputhshmërinë e tyre me aktet ligjore vendase dhe standardet ndërkombëtare.
- Kushtet materiale të personave të trajtuar në institucione, duke u përqendruar kryesisht në aspekte të tilla si ushqimi dhe shërbimi në kohë i vakteve, ndriçimi natyral e artificial, ventilimi-aspirimi e sistemi ngrohës, respektimi i mundësisë për higjienë personale, kushtet sanitare, mbipopullimi, kushtet e banimit, etj.
- Vlerësimin e respektimit të të drejtave të personave të trajtuar, sipas zërave të parashikuara në rregulloret institucionale dhe specifikave të tyre (për të pasur kontakte me këshilltarët ligjorë e familjarët, për të kryer telefonata, për t'u informuar mbi të drejtat e tyre në një gjuhë që e kuptonin, për t'u informuar nëpërmjet medias elektronike dhe asaj të shkruar, për procedurat e punësimit dhe shpërblimet për punën e kryer, për të drejtën për aktivitete në ajër të pastër, të drejtën e ushtrimit të riteve fetare, të drejtën për të përfituar ndihmë financiare, etj.)
- Zhvillimin e arsimit të detyrueshëm, e kurseve profesionale dhe të aktiviteteve rekreative e rehabilituese sipas specifikave të institucioneve.
- Cilësinë e kujdesit shëndetësor, etj.

Për rastet e pretendimeve për tejkalim të forcës apo ushtrim dhunë ndaj personave të privuar nga liria nga ankesat e marra përmes postës e telefonit apo ankesave nga familjarët, MKPT bashkëpunoi në kryerjen e hetimeve *ad hoc* me Seksionin e Veçantë pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, në përmbushje të funksioneve përkatësisht parandaluese e reaktive të dy strukturave.

4.1 Niveli i respektimit të drejtave të të dënuarve dhe të paraburgosurve në Institucionet Penitenciare

Inspektimet në Institucionet Penitenciare kishin si qëllim vlerësimin e nivelit të respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria, të parashikuara në ligjin Nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore përkatëse. Përgjithësisht, vizitat e ekspertëve të Avokatit të Popullit në këto institucione për vitin 2019 janë kryer në përputhje me procedurën e monitorimit të MKPT-së, e në një frymë të mirë bashkëpunimi. Në inspektimet e bëra gjatë vitit 2019 u vunë re një sërë problematikash, të cilat paraqesin nevojë të ngutshme për shqyrtim e përmirësim. Përmbledhtazi gjetjet pasqyrohen në vijim:

- Vazhdimin e konstatimit lidhur me kushtet materiale tejet degraduese e pa mundësi rikonstruktimi të mjediseve në regjimet e brendshme të I EVP Zahari Krujë, të cilat e bëjnë të pamundur garantimin e të drejtave të të paraburgosurve dhe të dënuarve të sanksionuara në aktet ndërkombëtare dhe legjislacionin kombëtar në fuqi. Meqenëse këto gjetje vazhdojnë të konstatohen në mënyrë të përsëritur, madje me kushte edhe më të degraduara si rrjedhojë e mbipopullimit të vazhdueshëm, mungesës së investimeve dhe amortizimit, Avokati i Popullit rekomandoi Mbylljen e Menjëhershme të I EVP Krujë, pasi kushtet e trajtimit në këtë institucion të personave të privuar nga liria janë tejet degraduese, jo humane, dhe në kundërshtim me standardet ndërkombëtare dhe kuadrin ligjor në fuqi.

- Mungesa e Mjekëve në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale mbetet një problematikë e sistemit tonë penitenciar, për vitin 2019 për rreth 12 IEVP në rang vendi ka rekomanduar: Marrjen e masave për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të plotë sipas parashikimeve në organikën e institucionit
- Mbipopullimi mbetet problematikë në Institucionin e Ekzekutimeve Penale Zahari mbipopullim me mbi 100 persona mbi kapacitet.
- Moszbatim i marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë për ngritjen e një Institucioni të Posaçëm Mjekësor, të parashikuar në ligjin Nr. 44/2012, datë 08.05.2012 “Për Shëndetin Mendor”, me qëllim strehimin dhe trajtimin e personave që kanë marrë nga gjykata masën “mjekim i detyruar” dhe “shtrim i përkohshëm”. Trajtimi i kësaj kategorie në IEVP Krujë etj., në kushte materiale degraduese dhe kur në organikat e tyre mungon mjeku psikiatër dhe kur aksesin për konsulta psikiatrike pranë spitaleve psikiatrike rajonale paraqet vështirësi, ose në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve për rastet me episode akute, vijon të mbetet i paligjshëm, duke u reflektuar edhe raportet kombëtare, ndërkombëtare dhe në konferencat rajonale.
- Probleme me ofrimin e mundësisë për arsim. Në IEVP Lezhë, Lushnje, Tepelenë, Sarandë dhe Rrogozhinë etj. nuk ofrohet arsimi i detyrueshëm në përputhje me Marrëveshjen ekzistuese ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për arsimin 9-vjeçar. Në asnjë prej institucioneve penitenciare, nuk ofrohet arsimi i mesëm.
- Mungesa e kurseve të formimit profesional në mbi 17 (Shtatëmbëdhjetë) IEVP

4.2 Niveli i respektimit të të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar në njësitë policore.

Inspektimet e kryera në njësitë policore gjatë vitit 2019 kishin si qëllim, vëzhgimin e objekteve si dhe mbledhjen dhe vlerësimin e të dhënave mbi veprimet dhe praktikën e ndjekura nga Policia e Shtetit në përmbushje të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, Aktin e procedurës standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr.925, datë 18.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, si dhe Aktin e procedurës standarde “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin Nr.1102, datë 07.11.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit si dhe verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, të dhëna gjatë vitit 2018.

Nga inspektimet e kryera në strukturat e policisë, u konstatua sa më poshtë vijon:

- Mbipopullim i konsiderueshëm në DPV Tiranë, si dhe në komisariatet ku gjenden ambiente sigurie në varësi të saj. Në këto struktura punohej në pjesën më të madhe të kohës mbi kapacitetin zyrtar. Mbipopullimi ishte krijuar kryesisht si pasojë e arrestimeve e ndalimeve të

shumta të bëra gjatë vitit nga policia, për vepra penale të përfshira rishtazi në Kodin Penal por edhe për shkak se personat e dënuar me vendim të formës së prerë, në mungesë, vononin të pranoheshin nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

- Pretendime për raste të ushtrimit të torturës dhe keqtrajtimit fizik e psikologjik të shtetasve nga punonjësit e policisë ka patur, në disa komisariate. Ankesat e gjetura të bazuara janë ndjekur kryesisht nga grupe të përbashkëta me Seksionin e Veçantë janë pasuar nga rekomandimet konkrete për marrjen e masave lidhur me personat përgjegjës.
- Mbjajtje dhe trajtim i personave të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, me burgim në mungesë, për një periudhë 5-30 ditore, në disa prej ambienteve të sigurisë në strukturat e Policisë së Shtetit.
- Mospërmbushje e detyrimeve ligjore për ndërtimin apo përshtatjen e ambienteve të shoqërimit sipas standardit të kërkuar (3 dhoma shoqërimi, 1 për të rritur, 1 për femra dhe 1 për të mitur). Dhomat e shoqërimit në pjesën më të madhe të komisariateve nuk i plotësonin standardet për trajtim dinjitoz të personave, pasi rezultonin të pakta në numër dhe nuk krijonin ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, të rritur dhe të mitur.
- Mospërmbushje e detyrimeve ligjore për ndërtimin apo përshtatjen e ambienteve të sigurisë, sipas standardeve të kërkuara e të miratuara nga Konventat Ndërkombëtare dhe “Aktit të Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar, në Njësitë Policore”. Përfundimisht bënë ambientet e sigurisë në DPV Tiranë, Gjirokastrë, Kukës, Korçë dhe Fier. Komisarariatet e varësisë të DPV Tiranë ku gjenden dhoma sigurie, po ashtu ishin në shkelje të dukshme të standardeve. Në komisarariatet nr. 1 dhe 3 nga inspektimi rezultoi se janë mbyllur 2 dhoma sigurie, dhe janë nxjerrë jashtë funksionit, me dyllosje e procesverbal. Përgjithësisht, këto dhoma u gjetën të mbajtura me çelës ose dry.
- Probleme në ofrimin e një shërbimi shëndetësor nga disa DPV, sa i përket plotësimit korrekt të regjistrave e kartelave mjekësore, si dhe ambienteve të papërshtatshme për ofrimin e konsultave, në disa drejtori mjeku mungon. Në disa prej këtyre institucioneve, vizitat mjekësore kryheshin përtej afatit 12 orësh, të përcaktuar në Manualin e Policisë së Shtetit.
- Probleme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi në korridoret e dhomave të shoqërimit, sigurisë dhe ambientet e marrjes në pyetje të shtetasve në disa komisariate.

4.3 Niveli i respektimit të drejtave të të dënuarve dhe të paraburgosurve në Institucionet Penitenciare

Inspektimet në Institucionet Penitenciare kishin si qëllim vlerësimin e nivelit të respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria, të parashikuara në ligjin Nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore përkatëse. Përgjithësisht, vizitat e ekspertëve të Avokatit të Popullit në këto institucione për vitin 2016 janë kryer në përputhje me procedurën e monitorimit të MKPT-së, e në një frymë të mirë bashkëpunimi. Përmbledhtazi gjetjet pasqyrohen në vijim:

- Vazhdimin e konstatimeve lidhur me kushtet materiale tejet degraduese e pa mundësi rikonstruktimi të mjediseve në regjimet e brendshme të IEVP Zahari Krujë, IEVP Sarandë, IEVP Tepelenë, IEVP Kukës, të cilat e bëjnë të pamundur garantimin e të drejtave të të paraburgosurve dhe të dënuarve të sanksionuara në aktet ndërkombëtare dhe legjislacionin kombëtar në fuqi. Meqenëse këto gjetje vazhdojnë të konstatohen në mënyrë të përsëritur, madje me kushte edhe më të degraduara si rrjedhojë e mbipopullimit të vazhdueshëm, mungesës së investimeve dhe amortizimit, Avokati i Popullit rekomandoi mbylljen e menjëhershme të këtyre institucioneve dhe transferimin e personave në institucione të tjera penitenciare.
- Mbiipopullimi në disa IEVP në rang vendi si: IEVP 302, Tepelenë, Jordan Misja, Durrës ka bërë që 4 (katër) persona të akomodohen në një qeli duke mos respektuar standardin **4m²** për çdo të burgosur.
- Moszbatim i marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë për ngritjen e një Institucioni të Posaçëm Mjekësor, të parashikuar në ligjin Nr. 44/2012, datë 08.05.2012 “Për Shëndetin Mendor”, me qëllim strehimin dhe trajtimin e personave që kanë marrë nga gjykata masën “mjekim i detyruar” dhe “shtrim i përkohshëm”. Trajtimi i kësaj kategorie në IEVP Krujë etj., në kushte materiale degraduese dhe kur në organikat e tyre mungon mjeku psikiatër dhe kur aksesimi për konsulta psikiatrike pranë spitaleve psikiatrike rajonale paraqet vështirësi, ose në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve për rastet me episode akute, vijon të mbetet i paligjshëm, duke u reflektuar edhe raportet kombëtare, ndërkombëtare dhe në konferencat rajonale.
- Probleme me ofrimin e mundësisë për arsim. Në IEVP Kukës IEVP Jordan Misja 313 IEVP Rrogozhinë IEVP Fier IEVP Tropoje IEVP Fushe-Krujë, IEV Sarandë, Shën Koll Lezhe IEVP Elbasan IEVP Peqin, IEVP 302, IEVP Tepelene IEVP 302 IEVP Tepelene, mungonin kurset profesionale dhe nuk ofrohej arsimit detyrueshëm në përputhje me Marrëveshjen ekzistuese ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për arsimin 9-vjeçar. Theksojmë se në asnjë prej institucioneve penitenciare, nuk ofrohej arsimit i mesëm.
- Shpërblimet për punën e kryer në të gjitha institucionet, bëheshin me ditë ulje nga dënimi, gjë që nënkupton paragjykim të fajësisë për kategorinë e të paraburgosurve. Po në këtë kuadër, për punën që kryenin të paraburgosurit në këto institucione, nuk paguhej vlera përkatëse e sigurimeve shoqërore, gjë që sjell mos vlerësimin e kohës së punës në institucion si kohë vjetërsie në punë, si dhe mohimin e një të drejte, atë të përfitimit të pensionit të pleqërisë. Të dënuarit nuk ishin të pajisur me librezë pune dhe as me atë të kontributeve shoqërore.

- Infrastruktura në pjesën më të madhe të I EVP-ve paraqiste probleme të amortizimit, lagështirës, furnizimit me ndërprerje me energji elektrike e ujë, sigurimit të ndriçimit natyral dhe të ajrosjes së plotë të qelive, pranisë së insekteve, kushteve jashtë standardeve të tualeteve, kuzhinave, dusheve, ambienteve të ajrimit, dhomave të izolimit, etj. I EVP-të me problematika emergjente infrastrukturore paraqiteshin I EVP Zahari-Krujë, Lushnje, Rrogozhinë, Sarandë, Lezhë, Tepelenë. Përgjithësisht në I EVP-të e reja dhe ato të ri konstruara të cilat praktikisht kanë krijuar një sistem me dy standarde në sistemin penitenciar Shqiptarë.
- Ambientet e përbashkëta për zhvillimin e aktiviteteve rehabilituese mungonin në një pjesë të I EVP-ve si rezultat i kthimit të ambienteve të edukimit, apo ushtrimit të rriteve fetare e veprimtarive sportive në dhoma banimi, apo mungesës së fondeve për pajisjen e tyre me materiale didaktike. Po ashtu sipërfaqet e vogla për ajrim të jashtëm kushtëzonin llojin e aktiviteteve sportive që mund të zhvilloheshin në to. Për rrjedhojë, në thuajse të gjitha I EVP-të, u konstatua probleme sa i përket aktiviteteve në grup apo individuale dhe pamundësi nga sektori psiko-social të cilat ndonëse mundohen t'i realizojnë realisht nuk arrijnë t'i kryejnë për mungesë të ambienteve të përshtatshme, bazës materiale apo dhe organikës së paplotësuar.
- Ambientet e kujdesit shëndetësor në burgje, përjashtuar I EVP-të e reja si Vlorë, Berat, Fier, Durrës, Elbasan dhe Shkodër, ishin përgjithësisht të papërshtatshme për vizita apo manipulime mjekësore, e të pa pajisura me materiale ndihmëse.
- Vonesa dhe mangësi paraqiten në pajisjen e të dënuarve/paraburgosurve me librezë shëndetësore apo me të dhënat elektronike në sistemin e sigurimeve shëndetësore në shumicën e I EVP-ve, që sillnin si pasojë moszbatimin e skemës së rimbursimit të ilaçeve dhe probleme në furnizimin me medikamente.
- Mungesa e Mjekëve konstatohet në I EVP-të si : I EVP 302, I EVP Tepelenë, I EVP Fushë Krujë, I EVP Kukës, I EVP Korçë, I EVP Berat, I EVP Durrës, I EVP Fier, I EVP Peqin, I EVP Lushnje.
- Vështirësi në realizimin e konsultave, ekzaminimeve dhe analizave laboratorike specifike si dhe ndërhyrjeve kirurgjikale, vëreheshin ende në disa prej I EVP-ve, për arsye të lidhura me mungesën e mjekëve me kohë të plotë në organikë apo mungesën e autoambulancave, me rezistencën e spitaleve rajonale për të trajtuar personat për shkak të mungesës së kushteve të sigurisë në to, etj.
- Probleme të ofrimit të shërbimit stomatologjik në I EVP që vinin si rrjedhojë e mungesave në aparatura dhe materiale ndihmëse. Shërbimet dentare, përveç ekstraksioneve, kryheshin me vështirësi në poliambulancat publike apo në klinikat private me shpenzimet e vetë të dënuarve.
- Sistemet qendrore të ngrohjes, pothuajse në të gjitha I EVP-të, ku ishin të instaluar nuk funksiononin si rezultat i defekteve teknike ose të mungesës së karburantit. Në shumicën e rasteve të dënuarit/paraburgosurit nuk i sigurohet ngrohja sipas parashikimeve ligjore.
- Mungesat në furnizimin me produktet bazë të higjienës personale (pastë dhëmbësh, furçë dhëmbësh, shampo, etj.) dhe të detergjenteve të nevojshme për të pastruar qelitë, si dhe mungesat në uniforma dhe doreza gjatë shpërndarjes së ushqimit u konstatuan në shumicën e I EVP-ve.
- Mungesat në dollapë e rafte të rrobave bënë që ato të mbaheshin nga të dënuarit/paraburgosurit në qese plastike ose në thasë, kryesisht poshtë shtretërve. Kjo problematikë ndeshet kryesisht

në I EVP Lezhë, Tepelenë, Korçë, Durrës, “Jordan Misja”, Sarandë, Kukës, Rrogozhinë e Tropojë.

- Problem i hasur në të gjitha institucionet e inspektuara, ishte konstatimi i çmimeve të larta të produkteve të dyqaneve të I EVP-ve.
- Mbetej shqetësuese thujse në të gjitha I EVP-të, cilësia dhe larmia e ushqimit.

Problematikat e vërejtura nevojitet të adresohen me vendimmarrje nga organet e larta shtetërore, pasi në shumicën e rasteve ato janë rezultat i ashpërsimit të politikës penale, mungesës së fondeve, dhe mungesës së nxjerrjes së akteve nënligjore për të gjeneruar përmirësime të dukshme të sistemit, si në formë ashtu dhe në përmbajtje.

4.4 Rastet e torturës, keqtrajtimin dhe ushtrimin të dhunës në njësitë policore dhe në institucionet penitenciare ndjekur hetuar nga ana e MKPT-së gjatë vitit 2019

Për rastet e tejkallimit të forcës të evidentuara gjatë inspektimeve apo nga ankesat e marra përmes postës e telefonit, ankesave nga familjarët apo nga mediat MKPT ka bashkëpunuar në kryerjen e hetimeve *ad hoc* me Seksionin e Veçantë pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, në përmbushje të funksioneve përkatësisht parandaluese e reaktive të dy strukturave.

Pranimi dhe shqyrtimi me përparësi dhe me rigorozitet i ankesave të qytetarëve ndaj organeve të Policisë së Shtetit për dhunimin fizik të tyre në njësitë policore, si dhe ndaj Policisë së Burgjeve për dhunimin fizik të të paraburgosurve dhe të dënuarve në institucionet penitenciare ka qenë dhe do të vazhdojë të mbetet një nga prioritetet e Institucionit të Avokatit të Popullit. Duhet theksuar se kjo problematikë mbetet shqetësuese, pasi përbën një nga shkeljet më të rënda të të drejtave themelore të njeriut, për të mos ju nënshtuar torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues, e cila garantohet dhe mbrohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (neni 25), Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (neni 3), Konventa e OKB-së, Kundër Torturës dhe Ndëshkimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese, “Protokolli Opsional i Konventës Kundër Torturës dhe ndëshkimeve të tjera çnjerëzore dhe degraduese (OPCAT)”, Kodi Penal (nenet 86 dhe 250).

Dhuna e ushtruar nga punonjës policie, që në disa raste përbën torturë ose veprime arbitrare, cenon rëndë integritetin fizik e psikologjik të personit dhe lë pasoja në shëndetin dhe në raste të veçanta edhe në jetën e të dhunuarit, deri në humbjen e saj. Ky veprim është i dënueshëm penalisht për personin që e kryen atë. Ndërkohë ai cenon rëndë imazhin e Policisë së Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, si dhe dëmton e trondit besimin e publikut tek këto organe. Gjithashtu ky tregues negativ i Policisë është i papranueshëm në një shtet të së drejtës dhe në një shoqëri demokratike.

Rastet e përdorimit të dhunës nga punonjësit e policisë ndaj qytetarëve janë të vështira për t’u provuar si edhe vërtetuar. Kjo lidhet me shumë arsye e shkaqe, sepse ato kryhen në vende të mbyllura, brenda ambienteve të policisë, në zyra, pa dëshmitarë të jashtëm okulare, por edhe në rastet kur ka të tillë, është e vështirë që të dhunuarit të dalin kundër punonjësve të policisë. Ekziston edhe frike hakmarrjeje tek qytetaret për ti denoncuar rastet e dhunës, si dhe pasiguri e mosbesim në ndjekjen e tyre nga organet e drejtësisë. Që të mundësohet vërtetimi i dhunës policore është e nevojshme që, ankesa të bëhet sa

më shpejtë, kur pasojat e saj janë ende të dukshme dhe ndërkohë, duhet bërë hetimi administrativ në vend. Mekanizmi për Parandalimin e Torturës ka hetuar për vitin “2019” 4 (katër) raste me iniciativë dhe 5(pesë) ankesa me pretendim ushtrim dhune.

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit për Parandalimin e Torturës njofton opinionin publik se ka rekomanduar fillimin e hetimeve penale në ngarkim të një punonjësi të Policisë së shtetit, për veprën penale të “Torturës”.

4.5 Niveli i respektimit të drejtave të personave në Spitalet Psikiatrike dhe IEVP Krujë.⁵

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar,⁶ ka tërhequr në mënyrë të përsëritur vëmendjen për kushtet e trajtimit në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale ku janë vendosur personat me çrregullime të shëndetit mendor që kanë kryer vepra penale.

4.5.1 Vizitat monitoruese në IEVP Krujë

Moszbatimi i ligjit nr. 44/2012, datë 08.05.2012 “Për Shëndetin Mendor”, për ngritjen e një Institucioni të Posaçëm Mjekësor me qëllim trajtimin e kësaj kategorie personash, ka sjellë problematikën e trajtimit të tyre në institucione të ekzekutimit të vendimeve penale, të cilat për më tepër gjenden në kushte mjaft të rënduara amortizimi e mbipopullimi. Institucioni i Avokatit të Popullit në mënyrë të përsëritur u ka rekomanduar institucioneve përgjegjëse mbylljen e IEVP Zahari, Krujë ku ata trajtohen më së shumti, dhe ka bërë thirrje për ngritjen e institucionit të veçantë të parashikuar me ligj. Deri në ngritjen e këtij institucioni, Avokatit të Popullit ka kërkuar përmbushjen e standardeve të kushteve materiale të këtyre mjediseve të lidhura drejtpërsëdrejti me investimet e pamjaftueshme, si dhe ofrimin e një shërbimi cilësor që mundësohet pikësepari me rritjen e numrit të punonjësve të stafeve mjekësore dhe atyre mbështetëse.

Ministri i Drejtësisë, me Urdhrin Nr.8927 datë 27.09.2018 “Për Klasifikimin e Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale” e ka klasifikuar Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Krujë, si “Institut i Veçantë” me seksion të posaçëm për të moshuar mbi 65 vjeç, me siguri të lartë dhe të zakonshme, një sektor të veçantë për të dënuarit me shqetësime psikike dhe të sëmurë të pamundur, me siguri të zakonshme, dhe ka urdhëruar kalimin e tij në konservim (mbyllje e përkohshme). Iniciativa e Ministria e Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për rikonstruktimin dhe përshtatjen e dy godinave 4,5 brenda IEVP-së Shën Koll, Lezhë, të cilat do të shërbejnë për akomodimin provizor⁷ të personave të trajtuar në IEVP Zahari, deri në ngritjen e institucionit të posaçëm të parashikuar me ligj, Avokatja e Popullit po të njëjtën ditë vizitoi IEVP Shën Koll Lezhë,

⁵ Mbi inspektimet e MKPT-së në Spitalet Psikiatrike janë hartuar 4 rekomandime.

⁶ Neni 74/1 i ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar.

⁷ Urdhrin Nr.8927 datë 27.09.2018 “Për Klasifikimin e Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale”

për të vlerësuar nga afër situatën. Pas takimit me drejtuesin e institucionit dhe inspektimit në vend, u konstatua se punimet infrastrukturore të godinave ishin larg përmbushjes së afateve dhe përmbylljes, e për rrjedhojë të papërshtatshme për të filluar funksionimin.

Konstatimet I EVP Krujë:

- I EVP Krujë jo vetëm që nuk mund të garantojë lëvizjet e pacientëve drejt spitaleve, apo të të paraburgosurve/dënuarve drejt gjykatave etj., por as transportin e sigurt të stafit, duke vështirësuar tej mase edhe kontaktet e familjarëve me personat që mbahen e trajtohen në të. Rruga në shpat mali që lidh I EVP Krujë me qytetin, është tejet e amortizuar dhe nuk mundëson as shkëmbimin e makinave në pjesën më të madhe të saj, duke u bërë vështirësisht e kalueshme në raste moti të rënduar.
- Infrastruktura e amortizuar krahas amortizimit të pajisjeve të mangëta në dhoma, lagështia si rrjedhojë e problemeve me hidroizolim, mungesa e sistemit të ngrohjes dhe e sistemit të ajrosjes, e bëjnë tepër të vështirë jetesën në këtë institucion. Shumë problematike paraqitej situata në pjesët lidhëse midis godinës së administratës dhe regjimit të brendshëm, si dhe ndërmjet sektorit A dhe sektorit B, pasi në këto pjesë, uji dhe lagështia kanë depërtuar në ambientet e poshtme të banimit në ndërtesë. Ajo çka është dhe më shqetësuese është mbajtja në të tilla kushte çnjerëzore e degraduese e të miturve dhe personave me probleme të shëndetit mendor.
- Mungesa e investimeve në riparime dhe materiale mbështetëse ishte e dukshme në të gjitha ambientet e regjimit të brendshëm. Brenda dhomave vërehej prani e theksuar e lagështirës dhe e mykut, mure të plasaritura dhe të palyera, papastërti e theksuar dhe prani e dukshme e insekteve, brejtësve dhe zvarranikëve. Të dënuarit gjendeshin kryesisht të shtrirë, të mbuluar me batanije të grisura dhe të palara pa çarçafë, të veshur keqas, të parruar e të paqethur. Personat paraplegjikë hasin vështirësi në përmbushjen e nevojave të higjienës veçanërisht në tualete e dushe, si pasojë e pamjaftueshmërisë së kujdestarëve si dhe e pamjaftueshmërisë së rampeve. Në përgjithësi përmbushja e kushteve për higjienë personale ishte e vështirë për t'u realizuar për shkak të numrit të madh të personave në raport me katër tualetet në sektor si dhe defekteve në dushe, problemeve me tubacionet dhe pajisjet e dëmtuara hidrosanitare.
- Në të dy ditët e vizitave monitoruese, problematika e përhershme e mbipopullimit u rikonstatua me përkatësisht 100 dhe 96 persona mbi kapacitetin zyrtar të institucionit. Për të përmbushur nevojat, institucioni ka mundësuar shtimin e shtretërve në dhoma (tip marinar), ndonëse dhomat që përpara kësaj përshtatjeje nuk i përmbushnin standardet ndërkombëtare të hapësirës së nevojshme për person. Në dhoma me sipërfaqe 12 metra katrorë strehohen 8 deri në 10 persona me mjekim të detyruar apo të dënuar, në kundërshtim me standardet minimale të pranuar nga Këshilli i Evropës që thotë se çdo i dënuar duhet të ketë 4-6 metra katrorë hapësirë në dhomë.
- Në mungesë të dyqanit dhe të arkës në institucion, nevojat për blerje të artikujve të ndryshëm nga ana e personave të privuar nga liria mbeten të pa plotësuara.

- Mungesa e pajisjeve dhe orendive vihej re edhe në kuzhinën e institucionit ku u konstatua se pajisjet e gatimit ishin të vendosura në dysheme, në mosrespektim të rregullave bazë të higjienës.
- Ambulanca e institucionit dhe krevati i fiksimit vazhdojnë të jenë tejet të amortizuar, ndërkohë që janë të pamjaftueshme mjetet e përshtatshme të kufizimit fizik (rripa lëkure, këmisha force) të domosdoshme për realizimin e imobilizimit sipas nenit 27 të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”. Nga ana tjetër në korridorët e sektorit të shëndetësisë si dhe në korridorët ndarëse në institucion mungonin kamerat e monitorimit.
- Organizimi i aktiviteteve të nevojshme rehabilituese është i vështirë në mos i pamundur, si pasojë e mungesës së ambienteve të përshtatshme për mundësimin e tyre. Aktiviteti i këtyre punonjësve të Sektorit të Kujdesit Social kufizohet vetëm në këshillime individuale apo biseda për tema të lira në ambientet e ajrosjes.

4.6 Niveli i respektimit të drejtave të personave në Qendra

4.6.1. Qendra e Mbyllur për të Huajt, Karreç

Gjatë vizitës së MKPT-së në Qendrën e Mbyllur për të Huajt në Karreç në datën 29 maj 2019, në përbërje të grupit inspektues ishin si vëzhgues dhe përfaqësuesit e Këshillit të Europës në kuadër të Observatorit të Mekanizmave Kombëtarë për Parandalimin e Torturës (NPM OBS). Qendra e Mbyllur për të Huajt, Karreç, është ngritur me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.1083, datë 28.10.2009 “Për ngritjen e Qendrës së Mbyllur dhe për miratimin e Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të saj” me qëllim strehimin e të huajve të parregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë, ndaj të cilëve është marrë një masë ndalimi në përputhje me legjislacionin në fuqi, individë të ndaluar për kalim të paligjshëm kufiri, si edhe azilkërkues potencialë.

Kapaciteti zyrtar i kësaj qendre është për 100 persona. Qendra e mbyllur kishte 25 dhoma për të mundësuar akomodimin e 4 (katër) personave për çdo dhomë. Në mjediset e institucionit në kohën e inspektimit ndodheshin 17 persona, nga të cilat 16 meshkuj dhe 1 femër. Koha e qëndrimit të tyre në këtë qendër ishte 1-12 muaj. Rekomandimet e Avokatit të Popullit të parashtruara në vijim të inspektimit të realizuar në vitin 2018, ishin fokusuar kryesisht në mënyrën e trajtimit të shtetasve të huaj dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së tyre me qëllim shmangien e rasteve të shkeljes të të drejtave të njeriut.

Sipas të dhënave që u morën gjatë kësaj vizite, evidentimit të gjendjes së zbatimit të rekomandimeve të bëra më parë nga institucioni i Avokatit të Popullit, informacioneve të marra nëpërmjet intervistave konfidenciale me personat e privuar nga liria, si dhe bisedat me stafin e institucionit, rezultoi se ishte plotësuar rekomandimi për marrjen e masave që procedurat e sigurisë në qendër të bazohen në respektimin e të drejtave themelore të njeriut si në fazën e identifikimit dhe regjistrimit ashtu dhe gjatë zhvendosjes dhe riatdhesimit të të huajve. Ishte plotësuar rekomandimi për marrjen e masave për vënien në funksionim të sistemimit të monitorimit me kamerave të perimetrit të brendshëm, duke

shtuar kamera funksionale në hollet dhe korridoret e godinës, si dhe në korridoret e ambienteve të veçimit. Gjithashtu ishte plotësuar pjesërisht rekomandimi për pajisjen me televizorë të ambienteve të përbashkëta të brendshme, por nuk ishte realizuar lidhja e tyre me antenë satelitore për të mundësuar informimin e të huajve me ngjarjet që ndodhin në vendet e tyre dhe në botë në gjuhët që ata kuptojnë, si dhe ishte plotësuar rekomandimi për marrjen e masave për pajisjen e kuzhinës së institucionit me mjete gatimi, aspirimi dhe larje industriale dhe pajisje të tjera të domosdoshme.

Ndërkohë që një pjesë e rekomandimeve të paraqitura nga Avokati i Popullit të një viti më parë nuk kishin gjetur zbatim dhe nuk ishin plotësuar nuk ishte plotësuar rekomandimi për marrjen e masave të nevojshme për shtimin e stafit të kësaj qendre me një punonjës social, një psikolog, një jurist, dhe një punonjës sanitar, me qëllim respektimin e të drejtave të të huajve të parregullt në Republikën e Shqipërisë në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi. Nuk ishte plotësuar rekomandimi për marrjen e masave për të krijuar ambientet rekreative të brendshme e të jashtme të qendrës me pajisjet e nevojshme për aktivitete sportive dhe për ndërtimin e një këndi lojërash për fëmijët për të mundësuar trajtimin dinjitoz të tyre. Nuk ishte plotësuar rekomandimi për marrjen e masave për vënien në funksionim të sistemimit të njoftimit me zilet e emergjencës në dhomat e fjetjes të të huajve dhe instalimin e këtij sistemi në dhomat e veçimit. Nuk ishte plotësuar rekomandimi për marrjen e masave për të pajisur ambientet e kësaj qendre me aparate kartofonike, sikurse është parashikuar në rregulloren e institucionit. Nuk ishte plotësuar rekomandimi për marrjen e masave për sigurimin e një lavatriçeje shtesë në shërbimin e lavandrisë. Nuk ishte plotësuar rekomandimi për marrjen e masave për pasurimin e bibliotekës me literaturë dhe akte juridike në gjuhë të huaj. Nuk ishte plotësuar rekomandimi për marrjen e masave për vendosjen në ambientet e korridoreve të qendrës të posterave, me të drejtat ligjore të shtetasve të huaj të ndaluar aty por u konstatua se këto materiale ishin vendosur në tavolina pranë këtyre ambienteve pasi sipas autoriteteve ato griseshin nga personat e privuar nga liria.

Gjatë vizitës monitoruese, grupi inspektues pati si objekt të punës së tij mbledhjen e informacionit lidhur me trajtimin e të huajve të strehuar në këtë qendër, si dhe identifikimin e rasteve të përdorimit të presionit psikologjik, të dhunës fizike, apo të ushtrimit të forcës tej kufijve të parashikuar nga aktet normative në fuqi ndaj kësaj kategorie. Grupi inspektues u takua me personat e huaj që ndodheshin në këtë qendër dhe bisedoi me ta në mënyrë konfidenciale. Gjithashtu mbi këtë çështje u verifikuan edhe regjistrat përkatës të institucionit ku u konstatua se nuk figuronte e regjistruar ndonjë ngjarje, ankesë apo pretendim dhune lidhur me këtë rast.

Disa ankesa u morën për cilësinë e jetesës në institucion. Ankesa pati edhe për orarin e ajrimit për 2 orë të parashikuara, të cilësuar prej tyre si të pamjaftueshëm si edhe mungesën e aktiviteteve rekreative.

Komunikimi me botën e jashtme i tyre përmes aparateve kartofonike ende nuk ishte mundësuar dhe personave që ishin akomoduar në këtë qendër të mbyllur u lejohej të përdornin telefonin celular personal vetëm gjatë orarit të daljes në ajrim gjatë dy orëve të lejuara. Ankesa pati në disa raste edhe për trajtimin ushqimor, si jo i shumëllojshëm dhe i pamjaftueshëm. Të ndaluarit paraqitën ankesa

lidhur me pamundësinë për t'u informuar me ngjarjet që ndodhin nga vendet e tyre dhe në botë në gjuhët që ata kuptojnë, sepse televizorët nuk ishin të lidhur me pajisje satelitore.

Gjithashtu ankesa u paraqitën edhe përsa i takon kohës së qëndrimit në këtë institucion pasi nga autoritetet nuk u është dhënë informacion se sa do të jetë kjo e fundit si dhe për arsyet që mbahen të privuar nga liria. Disa persona paraqitën pretendimin se edhe pyetja e tyre nga autoritetet shqiptare (nga prokurorë ose oficerë të policisë gjyqësore) në disa raste bëhet pa praninë e përkthyesve të gjuhës arabe dhe duke përdoruar ato pak njohuri gjuhësore të gjuhës angleze.

Po ashtu, u administruan edhe ankesa dhe pretendime lidhur me shërbimin shëndetësor që ofrohet në këtë qendër si dhe mungesën e stafit psiko-social pasi vijonte të mungonte specialisti psikolog. Gjithashtu u konstatua se shërbimi stomatologjik mungonte tërësisht në këtë qendër. Është për tu theksuar se individët që shprehin dëshirën e tyre për të aplikuar për azil duhet t'u jepej trajtim i veçantë në procedurën e paraidentifikimit, duke marrë parasysh nacionalitetin e tyre, grupin e gjuhës dhe asistencën dhe trajtimin e diferencuar për grupe të tilla. Gjithashtu masat shtrënguese, duke përfshirë përdorimin e forcës dhe veçimin e zgjatur, nuk duhet të përdoren në rastin e migrantëve që refuzojnë të identifikohen.

Nga inspektimi u konstatua se shërbimi shëndetësor, psiko-social dhe ligjor kishin mangësi dhe për rrjedhojë cenoheshin standardet e trajtimit të kësaj kategorie. Nga inspektimi u konstatua se në korridoret e qendrës nuk kishte të afishuara postera me të drejtat e personave të huaj të ndaluar në këtë qendër. Sipas punonjësve të policisë, ishin vendosur postera, por ato ishin grisur nga të ndaluarit. Ndërkohë u konstatua se materialet informuese në disa gjuhë të huaja me të drejtat e personave të huaj të ndaluar, mbaheshin në tavolina jashtë këtyre ambienteve. Personat e huaj të ndaluar mund ti aksesonin këto materiale gjatë kohës që dilnin për ajrim.

Theksojmë se autoritetet duhet të vënë në dispozicion, dokumentacionin gjithëpërfshirës për aksesin në të drejtat dhe rregullat e jetës në këtë qendër në një gjuhë të kuptueshme për të gjithë, gjithashtu dhe të përmirësohet shpërndarja e informacionit për azilkërkuessit dhe grupet vulnerabël.

Sistemi i pritjes dhe i kontrollit fizik për pritjen dhe intervistim e të huajve kryej konform rregullores së përgjithshme dhe asaj të brendshme. Në Qendër ishin hapur dosjet personale të të huajve të ndaluar, regjistri i pranimeve, regjistri i takimeve, regjistri i hyrje/daljeve, regjistri i marrjes-dorëzimit të shërbimit, si dhe procesverbalet për marrjen në dorëzim të sendeve personale dhe të vlerave monetare.

Ambienti ku depozitoheshin vlerat monetare dhe sendet personale funksiononte sipas Rregullores. Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacionit nuk u konstatuan parregullsi. Të gjitha veprimet që kryheshin me të huajt lidhur me sendet personale dhe vlerat monetare regjistroheshin në regjistrin përkatës.

Lidhur me çështjen e sigurisë, Qendra e Mbyllur për të Huajt, Kareç, ishte e pajisur me kamera vëzhgimi si në mjediset e jashtme ashtu dhe në ambientet e brendshme. Nga informacioni i marrë nga

Drejtuesi i kësaj qendre rezultoi se sistemi i monitorimit funksiononte. U konstatua se zilet e emergjencës në dhomat e fjetjes të të huajve nuk funksiononin.

Në këtë qendër kishte katër ambiente veçimi, të cilat ishin me kubaturë dhe hapësirë të mjaftueshme, dritare me përmasa të cilat lejojnë ajrosjen dhe futjen e dritës natyrale. Ato kishin tualete dhe pajisje hidrosanitare por u konstatua se këto ambiente kishin nevojë për investime pasi pajisjet përgjithësisht ishin të dëmtuara dhe nuk funksiononin.

U evidentua se masat e sigurisë me izolim jepeshin nga Drejtori i Qendrës. Zakonisht masat e sigurisë ishin dhënë në pak raste dhe jo më tepër se një ditë.

Dyert e dhomave të izolimit ishin prej hekuri dhe të një formati burgu dhe jo të një qendre pritëse. Dhomat e izolimit nuk ishin të pajisura me sistem alarmi që i jep mundësi personit të izoluar të thërrasë një anëtar të personelit sipas rregullores “Masat e Sigurisë” Kreu IV, neni 7.

Për të huajt femra dhe të miturit, kishte një sektor të veçantë, i cili ishte i ndarë nga sektori i meshkujve. Aktualisht në të gjithë këtë sektor ndodhej vetëm një person i huaj femër. Nga drejtuesi i institucionit na u sqarua se në rastet kur të huajt e strehuar ishin me familjet, ata akomodoeshin së bashku në ambiente të veçanta. Megjithatë u konstatua se çifti që kishte pësuar situatën e abortit vijonte të ishte i ndarë në mjedise më vete për gruan dhe gjithashtu për bashkëshortin e saj.

Lidhur me funksionimin e sistemit të kërkesë/ankesave, kjo qendër dispononte një regjistër ku pasqyroheshin kërkesat dhe ankesat e të huajve. Regjistri përmbante rubrika të specifikuar mbi ankesën dhe zgjidhjen e saj dhe i referoheshin punonjësës sociale apo punonjësit të sigurisë, të cilët merrnin masa për të njoftuar drejtorin e institucionit dhe zgjidhjen e menjëhershme të ankesës.

Vizitat nga familjarët, avokatët, përfaqësuesit diplomatikë etj., kryheshin sipas parashikimeve në Rregullore dhe regjistroheshin në regjistrin përkatës.

Kjo qendër përbëhej nga një godinë dy katëshe, me një pjesë të parashikuar për zyra administrative dhe pjesa tjetër për regjim me 25 dhoma akomodimi, 4 dhoma veçimi, bibliotekë, lavanteri, dushe, ambient rekreacioni, magazina dhe ambiente ajrosje të jashtme. Kushtet e strehimit në këtë Qendër ishin brenda normave të parashikuara. Gjithsesi, sektori i katit të parë paraqiste probleme të kushteve sanitare dhe materiale. Grupi i inspektimit vizitoi dhomat e banimit të cilat ishin të pajisura me materiale bazë e tualete për secilën prej tyre. Ambientet e dhomave kishin nevojë që të lyheshin.

Pajisjet brenda në dhomë përbëheshin nga krevatë e dollapë. Dhomat ishin të parashikuara për 2, 4 dhe 8 persona. Ato kishin dritare me përmasa të tilla që lejonin ajrosjen dhe futjen dritës natyrale. Gjithashtu dhomat ishin të pajisura edhe me ndriçim artificial. Nuk u konstatua prania e insekteve apo brejtësve. Në rastet e mungesës së energjisë elektrike nga rrjeti, ndriçimi artificial sigurohej nga një gjenerator. Problem shqetësues përbënte ngrohja e ambienteve të Qendrës, sepse ndonëse ishte instaluar sistemi i ngrohjes me kaldajë, ai nuk ishte vënë në funksionim gjatë gjithë periudhave të

ftohta të motit pasi shpenzonte shumë karburant dhe nuk kishte fonde për përballimin e këtij shpenzimi. Të huajve, për ruajtjen e higjienës personale iu jepeshin detergjente, si sapun, shampo, ilaç rrobash, furça dhe pastë dhëmbësh. Pati ankesa lidhur me furnizimin me materiale higjienike në ambientet e Qendrës pasi disa banues i kishin përdorur këto materiale në një formë vetëlëndimi si një mënyrë pakënaqësie ndaj mbajtjes së tyre në një qendër të mbyllur. Gjithashtu ankesa kishte edhe për furnizimin e personave të huaj të ndaluar me veshje të cilat ishin të pamjaftueshme. Larjet e trupit bëheshin me grafik në 2 dushet e përbashkëta të cilat ishin të pajisura me bojlerë për të mundësuar ujin e ngrohtë. Lavanteria kishte një lavatriçe që shërbenin për të huajt e ndaluar. Kishte një mjedis ambulator (dhoma e kryeinfermierit), e cila ishte e pastër dhe e pajisur me orenditë e nevojshme, si krevat, tavolinë dhe karrige. Sipas stafit, ambienti i ajrimit përdorej edhe për lojëra sportive, por fusha ishte e papërshtatshme për zhvillimin e lojërave me top. Nga punonjësit e qendrës u konfirmua se po punohej për krijimin e një fushe sporti. Ndërkohë u konstatua se nuk kishte një kënd lodrash për fëmijët në pjesën e jashtme por ishte përshtatur një ambient i tillë në pjesën e brendshme. Qendra e mbyllur kishte një bibliotekë, e cila kishte literaturë fetare, por nuk ishte pasuruar me botime në gjuhën arabe, si dhe në literaturë juridike. Në qendër kishte një ambient kulti, si dhe ishte krijuar edhe një ambient faljeje për praktikantët e besimit mysliman. Grupi i inspektimit konstatoi se kuzhina e qendrës dhe mensa ishin të pastra dhe orenditë e sistemuara. Mensa kishte tavolina dhe karrige të mjaftueshme për kapacitetin e qendrës, ndërsa në kuzhinë ishin realizuar disa investime në pajisje dhe materiale të tjera lehtësuese me ndihmën e Caritas. Në këtë qendër nuk kishte njësi tregtare për të mundësuar blerje të artikujve të ndryshëm nga personat e strehuar në këtë qendër. Në rast nevoje, artikujt e nevojshëm siguroheshin nga punonjësit e institucionit, të cilat i blinin jashtë institucionit. Nga stafi, grupi inspektues u informua që aktiviteti sportiv ishte i pamundur si rrjedhojë e pamundësisë financiare për të realizuar terrenet e nevojshme në ambientet e jashtme të qendrës por po punohej në këtë drejtim. Sipas organikës së miratuar, qendra kishte vetëm specialistë për praninë dhe intervistim, por nuk kishte specialitete të tilla tepër të rëndësishme për natyrën e funksionimit të saj, si psikologë, edukatorë dhe juristë.

Duke marrë në konsideratë faktin se në këtë qendër vijnë persona me trauma të tipeve të ndryshme, familje të shpërngulura nga vende në gjendje lufte etj., grupi i inspektimit konkludoi se stafi psiko-social duhet të jetë konform parashikimeve ligjore në Rregulloren për Qendrën e Mbyllur për të Huajt, respektivisht në Pjesën e Pestë, Kreu III “Asistenca sociale, koha e lirë dhe zhvillimi i përgjithshëm”, nenet 1 dhe 2, për të plotësuar të gjitha nevojat e shtetasve të huaj në aspektin psiko-social dhe përmirësimit të gjendjes së tyre psikologjike gjatë qëndrimit të tyre në këtë qendër. Lidhur me paraqitjen e ankesave dhe rrugën që ndiqet për zgjidhjen e tyre, grupi inspektues u informua se kishte kanale komunikime me UNHCR ku personat e strehuar në qendër mund të drejtoheshin dhe referonin problemet e tyre. Në organikën e qendrës së mbyllur nuk kishte mjek, por ndihmësmjek. Gjithashtu nuk kishte as stomatolog. Në rast nevoje, të huajt dërgoheshin tek stomatologu privat. Ndihmësmjeku kryente vizitat e të gjithë personave që në momentet e para sapo ata ndaloheshin në këtë qendër dhe në mënyrë periodike në vijimësi. Në rastet kur kërkoheshin ekzaminime të specializuara apo të sëmundjeve infektive, të huajt dërgoheshin në Spitalin Rajonal Durrës, apo trajtoheshin nga Sektori i Higjienës, pranë Drejtorisë së Shëndetit Publik Durrës. Institucioni nuk kishte një autoambulancë. Në

rastet emergjente përdoreshin makinat e qendrës për transportimin e të huajve pranë qendrave spitalore.

Përmes raportit me rekomandime pas vizitës në këtë Qendër, MKPT-ja i ka rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë dhe Drejtorit të Departamentit Kufirit dhe Migracionit që: të merren masat e nevojshme për shtimin e stafit të kësaj qendre me një mjek, një punonjës social, një jurist, dhe një punonjës sanitar, me qëllim respektimin e të drejtave të të huajve të parregullt në Republikën e Shqipërisë në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi. Marrjen e masave për plotësimin e vendit vakant të psikologut në institucionin e Qendrës së Mbyllur për të Huajt në Kareç. Marrjen e masave nga ana e stafit të institucionit për parandalimin dhe evidentimin e rasteve të mundshëm të dhunës fizike apo psikologjike ndaj personave të huaj të ndaluar, identifikimin dhe zbatimin e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës si dhe pasqyrimin e saktë dhe të menjëhershëm të ngjarjeve të dhunës në regjistrat përkatës. Marrjen e masave për zgjatjen e orarin e ajrimit gjatë stinës së verës për të huajt e parregullt të ndaluar, për shkak të zgjatjes së ditës dhe mungesës së aktiviteteve rekreative që duhet të ofronte Qendra e Mbyllur për të Huajt në Kareç.

Marrjen e masave të menjëhershme për të ofruar shërbimin stomatologjik nga institucioni i Qendrës së Mbyllur për të Huajt në Kareç. Marrjen e masave të menjëherëshme lidhur me furnizimin në kohë të institucionit me medikamentet mjekësore të nevojshme sipas nevojave të personave të huaj të ndaluar. Marrjen e masave për të krijuar ambientet rekreative të brendshme e të jashtme të qendrës me pajisjet e nevojshme për aktivitete sportive dhe për ndërtimin e një këndi lojërash për fëmijët për të mundësuar trajtim dinjitoz të tyre. Marrjen e masave për vënien në funksionim të sistemimit të njoftimit me zilet e emergjencës në dhomat e fjetjes të të huajve dhe instalimin e këtij sistemi në dhomat e veçimit. Marrjen e masave për të realizuar investime në sistemet hidrosanitare dhe ato elektrike në dhomat e izolimit. Marrjen e masave për të realizuar lyerjen e dhomave të personave të ndaluar në mjediset e Qendrës së Mbyllur për të Huajt në Kareç. Marrjen e masave për të pajisur ambientet e kësaj qendre me aparate kartofonike, sikurse është parashikuar në rregulloren e institucionit. Marrjen e masave të domosdoshme për trajtimin e diferencuar sipas standardeve ndërkombëtare për rastet kur anëtarët e një familjeje ndodhen në të njëjtin institucion për të bërë të mundur zgjatjen e takimeve mes tyre. Marrjen e masave për të garantuar sistemin e ngrohjes të ambienteve të Qendrës së Mbyllur për të Huajt në Kareç. Marrjen e masave për furnizimin me materiale higjienike në shërbim të nevojave të personave të huaj të ndaluar në ambientet e Qendrës së Mbyllur për të Huajt në Kareç. Marrjen e masave për furnizimin e personave të huaj të ndaluar me veshjet e nevojshme në përputhje me stinët e vitit. Marrjen e masave për pajisjen e institucionit me autoambulancë për transportimin e personave të privuar nga liria pranë qendrave spitalore të specializuara sipas nevojave. Marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e cilësisë dhe shumëllojshmërisë të ushqimit për të huajt e ndaluar që janë akomoduar në Qendrën e Mbyllur për të Huajt në Kareç. Marrjen e masave të menjëhershme për të vënë në dispozicion të personave të privuar nga liria të dokumentacionit gjithëpërfshirës, për aksesin në të drejtat dhe rregullat e jetës në këtë qendër në një gjuhë të kuptueshme për të gjithë, gjithashtu dhe të përmirësohet shpërndarja e informacionit për azilkërkuesit dhe grupet vulnerabël. Marrjen e masave për të siguruar lidhjen e televizorëve në ambientet e përbashkëta me pajisje satelitore për të mundësuar informimin e të huajve të parregullt të ndaluar, me ngjarjet që ndodhin nga vendet e tyre dhe në botë në gjuhët që ata kuptojnë.

Marrjen e masave për vendosjen në ambientet e korridoreve të qendrës, të posterave, me të drejtat ligjore të shtetasve të huaj të parregullt të ndaluar. Marrjen e masave të menjëhershme për të siguruar pyetjen e personave të privuar nga liria nga autoritetet përkatëse me praninë e një përkthyesi në gjuhën amtare të tyre për të garantuar të drejtat themelore. Marrjen e masave për pasurimin e bibliotekës me literaturë dhe akte juridike në gjuhë të huaj.

4.6.2 Vizitat monitoruese në Shërbimin e Shëndetit Mendor me Shtretër në Shkodër

MKPT në datën 28 maj 2019 kreu inspektim në Shërbimin e Shëndetit Mendor me Shtretër Shkodër. Në përfundim të inspektimit Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës doli me rekomandimin si më poshtë vijon: Në ditën e inspektimit në këtë shërbim me shtretër me kapacitet zyrtar prej 35 personash, respektohej hapësira jetike, kusht ky i domosdoshëm për trajtimin njerëzor të pacientëve në institucione psikiatrike. Në ditën e vizitës monitoruese trajtoheshin 34(tridhjetë e katër) pacientë. Nga të cilët 9 (nëntë) persona janë me mjekim të detyruar.

Diktuar nga një numër në rritje i sëmundjeve/çrregullimeve mendore, i tipologjive, i grup moshave, i shtrirjes gjeografike, çrregullimeve për shkak të përdorimit të substancave narkotike, etj., lind domosdoshmëri ndryshimi dhe përmirësimi i mbrojtjes dhe kujdesit të pacientëve në kushte të tilla komplekse, të vështira. U evidentuan mangësi në lidhje me nevojën për mbështetje me investime, kushte me të mira materiale për një shërbim cilësor, nevojë për një numër në rritje të stafëve mjekësore dhe mbështetëse, adresimin e psikiatrisë ligjore ambulare apo trajtimin dhe monitorimin e kushteve për personat me çrregullime mendore që kanë kryer vepra penale (personat që vuajnë dënimin me burg apo që janë me masa mjekësore, mjekim i detyruar). Nga inspektimi në vend, u konstatua se vështirësi paraqiste mirëmbajtja e institucionit, si pasojë e amortizimit është e nevojshme, ndërhyrja për rregullimin për shkak të kategorisë së personave që trajtohen aty, ambientet kanë nevojë për investime si: Lagështira ishte problem i përgjithshëm, por në mensën e grave ishte shqetësues, riparime në banjën e grave (riparime hidraulike e suvatime), magazina e infermierisë kërkon zgjerim e ambient me të përshtatshëm. Pajisja e lavanderisë me pajisje te reja, pasi ekzistueset ishin të amortizuara (dhurata nga kisha ose persona të ndryshëm).

Në kundërshtim me nenin 28 të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, vazhdonin të silleshin në këtë institucion në bazë të vendimeve gjyqësore, persona me çrregullime të shëndetit mendor që kanë kryer vepra penale për të cilat gjykatat kanë marrë vendim “mjekim të detyruar në një institucion mjekësor”. Theksojmë se Shërbimi i Shëndetit Mendor me shtretër, Shkodër, nuk është një institucion i posaçëm mjekësor për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor që kanë kryer vepra penale për të cilat gjykatat kanë marrë vendim për “mjekim të detyruar në një institucion mjekësor”. Sjellim në vëmendje se në ligjin nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, në nenin 28, pika 1 përcaktohet se: *“Institucionet mjekësore të posaçme janë institucione që shërbejnë për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor që kanë kryer vepra penale për të cilat gjykata kompetente ka vendosur mjekimin e detyruar në një institucion mjekësor, të të paraburgosurve apo të dënuarve që shfaqin çrregullime të shëndetit mendor gjatë vuajtjes së dënimit, si dhe për trajtimin e personave për të cilët gjykata ka vendosur shtrimin e përkohshëm në një institucion të posaçëm në bazë të nenit 239*

të Kodit Procedurës Penale". Theksojmë se ligji nr. 44/2012 "Për Shëndetin Mendor", i cili ka hyrë në fuqi në datën 01.06.2012, nuk e kushtëzon zbatimin e dispozitave të tij me ndërtimin apo krijimin e institucioneve mjekësore të posaçme nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale. Për këta persona nga ana e shefes së këtij shërbimi ishin bërë kërkesa të vazhdueshme, jo vetëm për të sqaruar situatën e shtrimeve në institucion, por edhe për rivlerësim e masave nga ana e gjykatave. Personat me "mjekim të detyruar", bëhen pengesë për shtrimet e reja, është e nevojshme ndërhyrja e menjëhershme për transferimin urgjent të këtyre personave. Këta pacient duhet të trajtohen me një institucion të posaçëm. (shkresa me nr. prot.38 me datë 07.05.2019, e cila i drejtohet Njesisë vendore të kujdesit shëndetësor Shkodër. E megjithatë, për shkak të vonesave në përgjigje, ata vazhdonin të trajtoheshin për një kohë relativisht të gjatë në institucion, çka jo vetëm që e vështirësonte punën e stafit, por edhe nuk ofronte kushtet e përshtatshme të sigurisë. Grupi inspektues bëri takime private, pa praninë e personelit të shërbimit me personat me masë mjekësore "mjekim i detyruar". Ata për momentin ishin nën kujdesin intensiv të stafit mjekësor, nga biseda private me të sëmuret ata shprehën pozitivitet dhe nuk kishin ankesa për keqtrajtim fizik apo ushtrim dhune nga personeli i këtij shërbimi. Problematika e dërgimit të personave abuzues me substancat narkotike dhe alkoolin pranë këtij shërbimi, ashtu si dhe në të gjithë institucionet e tjera psikiatrike në vend, mbetej e pazgjidhur dhe shqetësuese për stafin e institucionit, pasi ky i fundit nuk ka kapacitetet infrastrukturore dhe as burimet njerëzore për hospitalizimin apo ofrimin e një shërbimi të specializuar për personat abuzues me substancat të cilët si rregull duhet të trajtohen në repart toksikologjie. Institucioni nuk ishte pajisur ende me aparat EKG, si dhe me aparat për matjen e glicemisë. Këto aparate ishin në plan për t'u siguruar nga shoqata humanitare dhe OJF, pasi nuk kishte fonde të akorduara për këtë qëllim nga organet kompetente. Vazhdonte të mungonte dhoma e izolimit, si dhe mjetet e parashikuara të kufizimit fizik (rripat e këmishat e forcës), ndaj dhe mënyra e vetme për të realizuar atë ishte nëpërmjet kufizimit kimik. Shërbimi mjekësor mbetet me mungesa dhe nevojë të përhershme për kushte më të mira materiale, mbështetje me staf sigurie, për shkak të kushteve minimale të sigurisë, mjekët dhe stafi mbështetës janë gjithmonë të rrezikuar. Ndërkohë furnizimi me komplete të përshtatshme fjetjeje, veshmbathje, produkte higjieno-sanitare, dhe pajisje të tjera individuale ishte në sasi të mjaftueshme, në saje të mbështetjes së vazhdueshme që institucioni kishte siguruar nga shoqatat humanitare. Furnizimi me ujë të rrjedhshëm ishte siguruar pa ndërprerje, duke u mundësuar personave nën trajtim plotësimin normal të nevojave të tyre. Institucioni kishte një sistem qendror ngrohje, i cili siguronte ngrohje në periudhën e dimrit dhe ajër të kondicionuar gjatë verës. Tualetet dhe dushet ishin të amortizuara, me lagështirë dhe në kushte jo të mira higjieno-sanitare. Pacientët zakonisht bënin dush 2 herë në javë. Përsa i përket ushqimit, sigurohej nga kuzhina e vetë këtij institucioni. Kuzhina ishte e pastër. Sistemi i aspirimit ishte funksional. Kuzhinierët dhe punonjësit që shpërndanin ushqimin, ishin të pajisur me librezën shëndetësore të higjienës. Kampionet ushqimore ruheshin rregullisht në kushte frigoriferike. Ushqimi ishte i mjaftueshëm. Ushqimi shërbehej 5 pesë herë në ditë (3 vaktet kryesore dhe 2 të ndërmjetme), mëngjesi, vakti para dreke, dreka, vakti i mbas ditës, darka. Vetëm një prej pacienteve E.V i cili vuante nga çrregullimi i përndjekjes dhe ishte i hospitalizuar me vendim gjykatë, mjekim i detyruar shfaqti ankesë ndaj ushqimit të ofruar në spital për një cilësi më të mirë të ushqimit. Furnizimi me medikamente nuk kishte paraqitur probleme për këtë institucion, farmacia ishte e kompletuar me larmishmëri antipsikotikësh,

antidepresivësh, ansiolitikësh, hipnosedativësh, si dhe stabilizues të humorit. Nuk kishte mangësi në medikamente edhe për sëmundjet e tjera kronike, kardiake, endokrinologjie, neurologjike, dermatologjike, etj. kjo e ndihmuar edhe nga shoqatat humanitare. Shtrimet e pavullneshme kryheshin në përputhje me nenin 20 të ligjit Nr. 44/ 2012, “Për Shëndetin Mendor”, procedurat ndiqeshin në mënyrë rigoroze, dhe plotësimi i dokumentacionit përkatës nga stafi i mjekëve të këtij spitali kryhej me rregull në të gjitha hallkat e tij. Organika e këtij institucioni ishte e plotësuar me mjekë, infermierë dhe kujdestarë, prej të cilëve 16 infermier, 15 kujdestarë. Roli i infermierëve në spital ishte mese i rëndësishëm pasi ofronin dhe promovonin kujdes me qasje ndaj shërimit të sëmundjeve mendore, vlerësonin situatën dhe bisedonin me pacientët rreth problemeve që ata kanë dhe diskuton me ta për planin individual të trajtimit dhe mënyrën më të mirë që ky trajtim mund të jepet. Organika e shërbimit psiko-social ishte e plotësuar, e përbërë nga 4 (katër) psikologë dhe 1 (një) punonjëse sociale. Puna e tyre ndahej sipas pavijoneve, në planet individuale të trajtimit për çdo pacient, si të atyre që shtroheshin në pavijonin e pranimit, ashtu edhe për ata të cilët trajtoheshin në dy pavijonet e tjera. Psikologu kryente vlerësimin e funksionimit psikologjik dhe mendor, si pjesë e vlerësimit multidisiplinar që i bëhet pacientit pas kontaktit të parë në shërbim. Vlerësimi mund të bëhet në bazë të intervistës së strukturuar klinike, ose duke përdorur teste të standardizuara të aftësive mendore dhe ose psikologjikë. Stafi psiko-social pasi bënte një vlerësim psikologjik fillestar, të cilin e pasqyronte në kartelën mjekësore të pacientit bënte ndjekjen e ecurisë së tij paralelisht me trajtimin terapeutik okupacional. Ky i fundit dokumentohej dhe i bashkëlidhej kartelës mjekësore të patienti. Raportet për pacientët e shtruar në spital i përcillehin sektorit psiko-social të Drejtorisë Rajonale Shëndetësore Shkodër, i cili mbikëqyrte mbarëvajtjen e punës në këtë spital. Nga ana e stafit psiko-social, pacientët në këtë institucion trajtoheshin me seanca këshillimore individuale apo në grup, psiko-edukim dhe mbështetje emocionale. Punonjësi social ofronte menaxhimin e rastit që përfshin krijimin dhe nxitjen e bashkëpunimit midis profesionisteve të ekipit multidisiplinar të një shërbimi dhe midis shërbimeve të ndryshme në funksion të përmirësimit të situatës psiko-sociale apo zgjidhjes së problematikave të një patienti ose grupi patientësh, gjetjen dhe vënien në lëvizje të burimeve të nevojshme për realizimin e planit të kujdesit për patientin ose grupin e patienteve. Nga bisedat me pacientët në përgjithësi kushtet dhe trajtimi vlerësoheshin pozitivisht nga ta. Stafi zhvillonte aktivitete të ndryshme në sallën e ergoterapisë si lojëra tavoline, punime dore me grep për gratë, si dhe ndonjë herë dhe lojëra me top për burrat, në oborrin e këtij institucioni. Kishte një tip biblioteke të vogël. Ambientet e përbashkëta, për zhvillimin e aktiviteteve apo terapive në grup nga ana e stafit psiko-social, ishin të bollshme, të rregullta dhe të mirëmbajtura. Pacientët mund të lëviznin nëpër ambientet e spitalit dhe brenda rrethimit të tij. Ata kishin uniforma dhe higjienë të pranueshme. Lejoheshin takimet e herë pas hershme me familjarët. Shefja e Shërbimit luante një rol shumë aktiv për përmirësimin e marrëdhënieve mes patientëve dhe familjarëve, në disa nga rastet që ne konstatuam. Regjistrat e të gjithë pavijoneve dhe procedurave të shtrimeve që kryhen në spital ishin të sekretuar dhe të mbajtur me rregull. Të mbajtura me rregull dhe të pasqyruara saktë ishin regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve. Sistemi i kërkesë-ankesave funksiononte normalisht, në institucion ndodhej një kuti e veçantë ku mblidheshin të gjitha ankesat e të sëmurëve dhe të familjarëve. Nuk kishin patur asnjë ankesë për 2018-2019.

Sistemi monitorues i kamerave të vëzhgimi në të gjithë ambientet e këtij institucioni ishin funksionale, si një ndër aspektet më të rëndësishme të parandalimit të veprave të dhunshme apo sjelljeve degraduese/çnjerezore. **Në përfundim të inspektimit u zhvillua sërish një takim me shefen e shërbimit, ku në mënyrë të përmbledhur iu bënë me dije gjetjet dhe problematikat e evidentuara. Nga ky inspektim MKPT ka bërë rekomandimin si më poshtë:** Marrjen e masave të menjëhershme për vënien në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor” nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për ngritjen e institucioneve të posaçme mjekësore dhe për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor, që kanë kryer një vepër penale, për të cilët gjykata kompetente ka vendosur mjekimin e detyruar në një institucion mjekësor, të të paraburgosurve apo të të dënuarve që shfaqin çrregullime të shëndetit mendor gjatë vuajtjes së dënimit, si dhe për trajtimin e personave, për të cilët gjykata ka vendosur shtrimin e përkohshëm në një institucion mjekësor të posaçëm, sipas nenit 239 të Kodit të Procedurës Penale, i ndryshuar. Marrjen e masave të menjëhershme nga Ministria e Drejtësisë për gjetjen e një zgjidhjeje të shpejtë, efektive dhe të qëndrueshme, për shqyrtimin kryesisht brenda afateve ligjore nga gjykatat të të gjitha vendimeve të dhëna për “mjekim të detyruar në një institucion mjekësor”, si dhe për dërgimin e vendimeve në institucionet ku trajtohen personat përkatës. Në kushtet aktuale kjo mund të realizohet përmes dërgimit të një letër - porosie të gjitha gjykatave në shkallë vendi, ku t’u silltet në vëmendje detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 46, paragrafi i parafundit i Kodit Penal. Në perspektivë të vlerësohet mundësia e ngritjes së një sistemi elektronik qendror që t’u sjellë në kujtesë gjykatave shqyrtimin brenda afateve ligjore të vendimeve gjyqësore të dhëna për këtë kategori personash. Marrjen e masave për ofrimin e shërbimit të specializuar me hospitalizim pranë spitaleve rajonale të personave abuzues me substancat narkotike apo/dhe alkoolin. Kjo do të zgjidhte problemin e trajtimit të papërshtatshëm të këtyre personave jo vetëm në Shërbimin e Shëndetit Mendor me Shtretër Shkodër, por edhe në spitalet psikiatrike të Elbasanit dhe Vlorës. Marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e një dhome të izolimit në Shërbimin e Shëndetit Mendor me shtretër Shkodër në përputhje me nenin 27 të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”. Marrjen e masave për furnizimin e Shërbimit të Shëndetit Mendor me Shtretër Shkodër me mjete të kufizimit fizik konform standardeve evropiane, ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor” dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë dhe për zbatim të tij. Marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen me aparatën e EKG-së dhe aparat për matjen e glicemisë.

4.7. Monitorimi i pavarur i të drejtave të emigrantëve të huaj dhe kthimeve të detyruara të qytetarëve shqiptarë

Institucioni i Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës vijoi të zbatojë, gjatë vitit 2019, Marrëveshjen e bashkëpunimit të nënshkruar me UNHCR në kuadër të projektit të përbashkët “Refugjatët dhe Azilkërkuesit në vendet e Evropës Juglindore”. Krahas zonës kufitare të Gjirokastrës, Sarandës dhe Përmetit, aktiviteti i Avokatit të Popullit përmes ekspertëve u shtri përgjatë vitit 2019 edhe në zonën e Shkodrës, Kukësit, Korçës dhe Bilishtit. Ekspertët, sipas orientimeve të institucionit të Avokatit të Popullit dhe në bashkëpunim me UNHCR, përgjatë gjithë vitit realizuan kontakte në këto tre zona ndërkufitare me qindra të huaj të parregullt duke i informuar

për të drejtat, duke i intervistuar dhe duke monitoruar procesin e evidentimit të tyre që kryhet nga punonjësit e sektorit të emigracionit, duke parë dhe bashkëpunuar për nevojat në asistimin e tyre për trajtim me ushqime dhe veshmbathje, duke kryer koordinimin e bashkëpunimit me strukturat përgjegjëse në raste të asistencës mjekësore kur ka qenë e nevojshme, përfshirë komunikimin me urgjencën spitalore, ndjekjen e rasteve në spital, komunikime për mbarëvajtjen e mjekimeve për raste të thjeshta, etj.

Ekspertët u përfshinë në monitorimin sistematik të kufijve, raportimin periodik pranë institucionit të Avokatit të Popullit të gjetjeve, trajtimin e zgjidhjen e problematikave të hasura duke bashkëpunuar me Drejtorinë Rajonale të Kufirit në nivel vendor, autoritetet qendrore të kufirit dhe migracionit si dhe në bashkëveprim me UNHCR-në. Shqipëria u përball gjatë vitit 2019 me shtim të hyrjes së të huajve të parregullt kryesisht përmes kufirit jugor dhe juglindor me Greqinë për të vijuar më tej drejt Malit të Zi, me destinacion përfundimtar vendet e Bashkimit Evropian. Rritja e prurjes së të huajve të parregullt u shoqërua me shtim të kërkesave për azil në territorin shqiptar dhe me adresimin e nevojave prioritare për mbrojtje, ndihmë dhe shërbime sidomos për grupet më të rriskuara, siç janë gratë dhe fëmijët, personat me nevoja të veçanta apo personat me probleme shëndetësore. Prurjet e rritura ndikuan edhe në aktivitetin e rrjeteve të trafikut të qenieve njerëzore ndaj të cilëve pati një forcë goditëse të policisë shqiptare në bashkëpunim me Rojën Europiane të Kufijve “Frontex”. Në maj të vitit 2019 hyri në fuqi

Marrëveshja për menaxhimin e përbashkët të kufirit mes Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian dhe 50 oficerë të parë të Frontex u vendosën në zonën e kufirit të Shqipërisë me Greqinë (25 në Qarkun e Gjirokastrës dhe 25 në Qarkun e Korçës) duke punuar së bashku me oficerët shqiptarë të Kufirit dhe Migracionit dhe me aktorët që bashkëpunojnë në trajtimin e problematikave të të huajve të parregullt dhe kufirit. Ekspertët kanë pasur akses nga sektori i migracionit për të qenë të pranishëm fizikisht në intervistat e përzgjedhjes për qindra të huaj të parregullt që hynë në harkun e një viti nga territori grek duke vëzhguar respektimin e udhëzimit përkatës dhe realizimin e standardeve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare në këtë fushë. Në shumë raste përfaqësuesit e Avokatit të Popullit në terren dhe MKPT në bashkëveprim me Zyrën e UNHCR-së Gjirokastrë apo Zyrën qendrore të UNHCR-së referuan tek autoritetet kufitare problematikave e paraqitura nga të huajt e parregullt dhe trajtimin dhe zgjidhjen e tyre. Përfaqësuesit e Avokatit të Popullit janë prirur nga mendimi kritik gjatë kontakteve për të përmirësuar cilësisht elementë të ndryshëm në mekanizmin e mbrojtjes së emigranteve mbi bazë të identifikimit të boshllëqeve në sistemin e azilit. Një nga sfidat me të cilat përballlet sistemi është mungesa e përkthyesve për gjuhë të rralla (pasi një person nga grupi i emigranteve shërben vetëm me anglishte të dobët si përkthyes për pjesën tjetër të grupit) dhe pengesa të tilla gjuhësore ndikojnë në procesin e identifikimit dhe përzgjedhjes.

5. Rekomandimet e dërguara në bazë të Inspektimeve të kryera gjatë vitit 2019 në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale

5.1 IEVP BERAT

Gjatë vizitës, në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale IEVP Berat- Datë 02.07.2019.

MKPT-ja kishte si qëllim vlerësimi i kushteve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Sarandë, për garantimin e respektimit të të drejtave dhe trajtimit të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim të përcaktuara në ligjin nr.8328 datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar dhe në dokumentet ndërkombëtare, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra në inspektimin e mëparshëm.

Në ditën e inspektimit, në mjediset e institucionit ishin 108 persona, nga të cilët 65 të paraburgosur dhe 43 të dënuar. Nga këta të dënuar janë: 34 persona të sëmurë kronik, 13 persona me sëmundje të shëndetit mendor dhe 2 persona me diabet. Të dënuar të punësuar në institucion janë 22 persona, të cilët punonin si pastrues, berber, shërbim luanterie etj. Aktualisht organika e IEVP, Berat ishte e përbërë nga sektori i burimeve njerëzore, sektori juridik, sektori financiar, sektori i logjistikës dhe sektori shëndetësor. **Sektori shëndetësor** përbëhej nga (1) një mjek i përgjithshëm dhe (5) pesë ndihmës mjekë, ndërkohë që në institucion mungonte stomatologu dhe farmacisti. **Sektori psiko - social** përbëhej nga (2) dy psikologë, (1) një specialiste edukimi, (1) një punonjës social, 1 përgjegjës për çështjet shoqërore. Grupi i inspektimit, inspektoi dhe plotësimin e kushteve materiale dhe të jetesës të të dënuarve/paraburgosurve në këtë institucion, duke u përqendruar kryesisht te kushtet e banimit, veshjen, mbipopullimin në dhoma, higjienën personale, kushtet sanitare, cilësinë e përgatitjes dhe shpërndarjes në kohë të ushqimit, ndriçimi, ventilimi, ngrohja, ambientet e takimit me familjarët, komunikimi telefonik, dhe monitorimi me kamera i ambienteve të përcaktuara sipas skemës së sigurisë. Nga inspektimi i ambienteve rezultoi se :Dezinfektimi i ambienteve të IEVP ishte bërë në muajin maj të 2019. Sistemi i monitorimit me kamera funksiononte në të gjitha ambientet. Dhomat ishin të lyera dhe në kushte të mira. Dhomat ishin me nga 2- 4 persona, fakt që tregon se respektohej hapësira jetike për pëson. Dushet ishin funksionale, në një sektor me 35 persona ishin 2 poste. Dy dhoma në institucion shërbenin për zhvillimin e riteve fetare. Te gjitha dhomat e dënimit ishin të pajisura me tualet. Kuzhina ndodhej në katin e parë të ndërtesës dhe përgjithësisht ishte në kushte të mira por u konstatua se kampionet e ushqimit nuk ishin të etiketuara. Lavanderia ishte e pajisur me 5(pesë) lavatriçe dhe 1(një) tharrëse rrobash, të gjitha ishin në gjendje pune. Ambientet e ajrimit ishin (5) pesë dhe një fushë sportive për zhvillimin e aktiviteteve dhe lojërave të ndryshme.

Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacioneve lidhur me sistemin e kërkesë/ankesave rezultoi se çdo ankesë regjistrohej në regjistrin përkatës dhe protokollohej, regjistrat mbaheshin nga sekretaria e institucionit. Sa i takon objektit të këtyre kërkesave na rezultoi se ato konsistonin në kërkimin për leje shpërblyese, takime me familjarë, kërkesë për dinamikën e vuajtjes së dënimit, kërkesë për takim me avokatë, vizitë në spital, transferim, punësim ose kërkesë për blerjen e pajisjeve si TV ose frigorifer.

Sistemi i monitorimit me kamera vëzhgimi ishte funksional. Në institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Berat kamerat monitoronin pjesën më të madhe të mjedisëve për 24 orë, ndërkohë që të dhënat ruheshin në server për një periudhë dy javore. Observimi si sektor i rëndësishëm për mbajtjen, kujdesin e veçantë të paraburgosurve të cilët akomodohen rishtazi në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Berat funksiononte me 2 dhoma (me nga 2 krevate secila) dhe

pajisur me orenditë e nevojshme. Dhomat e observim/veçimit ndodheshin në regjim, 4 dhoma veçimi me nga një shtrat të vendosur brenda këtyre ambienteve dhe një dhomë observimi, e cila ishte e pajisur me 4 shtretër. Në momentin e inspektimit në këtë ambient nuk gjendej asnjë person. Telefonat punonin në çdo kohë dhe të paraburgosurit e intervistuar, pohuan se flisnin dy herë në javë me të afërmit e tyre nëpërmjet kabinave telefon të cilat funksiononin me kartë me impulse, këto kabina ndodheshin në korridoret e regjimit të brendshëm. Nga ana e të paraburgosurve kishte kërkesa për komunikime më të shpeshta me familjarët e tyre dhe ngritën si shqetësim kufizimin e numrit të telefonatave. Ata kërkonin që tu jepej mundësia e komunikimit më shpesh brenda mundësive të institucionit dhe sipas kushteve familjare që kishte secili prej tyre. Në ambientin e takimeve ishte krijuar një mjedis i veçantë për të paraburgosur që kishin fëmijë të vegjël lidhur me ushtrimin e të drejtës së prindërimit në distancë. Ata mund të takoheshin në këtë ambient pa barriera apo kufizime fizike, por dhoma kishte nevojë për investime dhe pajisje me orendi për të qenë e përshtatshëm për këtë qëllim. IEVP Berat kishte në organikë me 34 të dënuar dhe paraburgosur të punësuar të cilët punonin kryesisht si pastrues, sanitarë, shpërndarës ushqimi etj. Të paraburgosurit që punonin përfitonin nga ulja e dënimit me 3.9 ditë në muaj. Ndërkohë, u konstatua se mungonin kontratat e punës të lidhura midis të punësuarve me institucionin. Kjo procedure ndiqej nga ana e stafit të institucionit, pasi vazhdon të mos jenë miratuar aktet nënligjore të nevojshme për të bërë efektive të drejtën e punësimit dhe për shpërblimin për të paraburgosurit/dënuarit, që garantohej nga ligji dhe standardet ndërkombëtare. Dhomat e banimit akomodonin nga 2, deri në 4 persona. Gjithashtu, u konstatua se dhomat ishin të pajisura me tavolina, karrige, apo pajisje elektro-shtëpiake. Dhomat kishin tualete të brendshme, në korridoret e regjimit të brendshëm kishte stola të cilët përdoreshin për raste festash apo aktivitetesh nga të paraburgosurit. Gjithashtu këto korridore ishin të pajisur me kabina telefoni të cilat mund të përdoreshin nga të paraburgosurit. Në regjimin e brendshëm të çdo godine kishte dhoma këshillimi të cilat ishin funksionale. Gjatë inspektimit të ambienteve të brendshme të regjimit, në IEVP Berat, nga grupi inspektues u vërejt se kishte një (1) dhomë observimi dhe katër (4) veçimi si dhe një dhomë, e cila përdorej për prindërimin në distancë. Gjithashtu në ambientet midis dy godinave gjendej dhe dhoma për takimin me avokatët dhe për marrjen në pyetje të shtetasve nga organi i akuzës. Në dy godinat e IEVP Berat kishte (5) pesë ndarje ajrimi, një (1) fushë futbollit dhe (1) një fushë voleybollit. Grupi i inspektimit konstatoi se në mjediset e jashtme, që përdoreshin për ajrim të dënuarit dilnin me orare e cila vajonte nga 2 ore deri në 3 orë. Nga intervistat brenda në regjim u konstatua se të paraburgosurit dhe të dënuarit lejoheshin të dilnin në ajrim të ndarë dhe në orare të ndryshme dhe se nuk kishin pasur probleme në këtë drejtim. Gjithashtu kishte ambiente për aktivitete këshilluese, fetare, kulturore, sportive etj. Biblioteka konsistonte në një dhomë me disa rafta të vendosura në mur dhe një tavolinë të madhe plotësuar me karrige. Në bibliotekë kishte më tepër se 100 tituj librash, ambientet e kultit ishin të ndara sipas përkatësisë fetare mysliman dhe të krishterë. Kuzhina, ishte në katin e parë të hapësirës së ndërmjetme midis dy godinave. Ambienti ishte brenda standardeve, në kushte shumë të mira higjieno-sanitare. Pajisjet në të ishin të reja dhe kampionët ushqimorë mbaheshin në frigorifer të mbyllur me dry, por konstatuam se kampionët ushqimorë nuk ishin etiketuar dhe cilësuar sipas vakteve ushqimore. Në kuzhinë punonin katër kuzhinierë dhe një punonjës mirëmbajtje. Menyja e përditshme ishte e afishuar. Nga bisedat me të paraburgosurit, grupi i inspektimit mori informacionin se ajrimi ishte një aktivitet që kryej sipas parashikimeve ligjore. Në IEVP Berat në periudhën e verës ishte

mundësia e realizimit të aktiviteteteve sportive, ndërsa aktivitetet edukative zhvilloheshin në bibliotekë. Nga takimi me punonjësin e sektorit të kujdesit social, si edhe nga intervistat e kryera me të paraburgosurit, grupi i inspektimit vuri re një komunikim dhe ndërveprim shumë të mirë të ndërsjelltë mes tij dhe të paraburgosurve. Aktivitetet e zhvilluara së fundmi: Organika e stafit mjekësor në këtë institucion përbëhej nga një mjek dhe stomatolog me kohë të pjesshme dhe pesë ndihmës mjekë, dhe një farmacist. Grupi i inspektimit konstatoi përgjithësisht se vizitat dhe ndërhyrjet mjekësore nga ana e stafit mjekësor ishin realizuar në kohë.

Nga biseda me të dënuarit/paraburgosurit, u konstatuan se kishte ankesa të shumta për shërbimin stomatologjik, i cili ishte jofunksional për arsye se në institucion nuk kishte mjek stomatolog. Gjatë inspektimit u vërejt se institucioni kishte marrë masa për kompletimin e dhomës së stomatologut dhe ishte e pajisur me të gjitha pajisjet e nevojshme, kishte dhomë mjeku, farmacisti dhe infermierie të pajisura me orendi sipas standardeve. Dhoma e vizitave ishte e pajisur me një shtrat vizitash si dhe një tavolinë dhe një karrige, dhoma shtrimi ishin tre, të pajisura me nga (2) dy shtretër, por kishte mungesa në pajisje si një aparat për ekzaminimin e shqetësimeve në veshë, aparat oksigjeni etj.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës, nenit 21, germa “b” të ligjit Nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, si dhe nenit 12, nenit 74/1 pika “b” të ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar

Rekomanduar: Marrjen e masave të menjëhershme për punësimin me kohë të plotë të një mjeku stomatolog dhe një farmacisti; marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen me orenditë përkatëse të sallës së TV dhe palestrës së IEVP-së; marrjen e masave për pajisjen e dhomave të këshillimit me orenditë e nevojshme me qëllim krijimin e kushteve normale të funksionimit të tyre; marrjen e masave për etiketimin e kampionëve të ushqimit sipas vakteve ushqimore të përcaktuar në menynë e afishuar në kuzhinë; pajisjen e institucionit me Ambulancë si pjesë e domosdoshme jetike.

5.2 IEVP ELBASAN

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim Mekanizmi Kombëtar⁸, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, kreu një inspektim në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Elbasan më datë 12.03.2019, sipas një Plani Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Vizita në këtë institucion u zhvillua në një frymë të mirë bashkëpunimi. Organika e IEVP Elbasan përbëhej nga 140 punonjës, nga të cilët 30 punonjës organika civile dhe 110 ishin punonjës të sektorit të policisë së burgjeve.

Në bazë të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë Nr. 8927/1, datë 27.09.2018, “Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”, i ndryshuar, IEVP Elbasan është kategorizuar si institucion paraburgimi. Grupi i monitorimit pati për objektiv të punës së tij mbledhjen e informacionit

⁸ Neni 74/1 i ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar.

lidhur me trajtimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve, me identifikimin e rasteve të përdorimit të forcës fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative apo të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie, si edhe të rasteve të marrjes së masave disiplinore. Nga informacioni i marrë gjatë vizitës inspektuese dhe intervistimit të të paraburgosurve, grupi monitorues nuk evidentoi raste apo pretendime të këtyre personave, për tejkalim të forcës fizike nga ana e punonjësve të policisë së burgjeve. Por, pavarësisht situatës të përgjithshme, drejtuesi i institucionit informoi mbi rastin e vetvarjes me pasojë vdekjen e të paraburgosurit Bledar Doda, godina A, kati i 3-të, dhoma nr.16, më datë 22.03.2019. Lidhur me këtë rast, Institucioni i Avokatit të Popullit ka filluar kryerjen e një hetimi të pavarur administrativ. Nga korrespondenca zyrtare e zhvilluar midis institucionit tonë dhe organeve shtetërore të përfshira për hetimin e këtij rasti, rezulton se, mbi bazën e materialit referues të dërguar nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan, Prokuroria pranë Gjykatës të Shkallës së Parë Elbasan, ka regjistruar procedimin penal nr.403 të vitit 2019 për veprën penale të “Shkaktimit të vetëvrasjes” parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal. Nga analiza paraprake e këtij rasti, ky procedim bën fjalë për vetëvrasjen (nëpërmjet vetëvarjes me litar) të shtetasit Bledar Doda. Nga policia gjyqësore është vendosur kryerja e ekspertimit mjeko-ligjor për viktimën, por sipas organit të prokurorisë, akti i ekspertimit mjeko-ligjor ende nuk është administruar. Ndërkohë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nisur nga rasti i lartpërmendur me qëllim marrjen e masave parandaluese lidhur me vetëvrasjet në të gjitha institucionet penitenciare, me urdhrin nr.2406, datë 11.03.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm⁹ ka parashikuar detyrimin e stafit që gjatë pranimit të të dënuarve dhe të paraburgosurve, të merret informacion brenda afatit të observimit mbi rekordet që i dënuari/paraburgosuri mund të ketë patur në institucionet e tjera, si dhe të ushtrohen kontrole periodike për pastrimin e dhomave dhe ambienteve nga çdo mjet, litar, rrip, tel që mund të shërbejë si mjet për vetvarje. Grupi i inspektimit, nga intervistat me të paraburgosurit evidentoi një numër ankesash që ishin të lidhura kryesisht me punën që duhej bërë nga sektori psiko-social për larminë e aktiviteteve të përbashkëta kulturore dhe sportive, si dhe ndaj sektorit shëndetësor për disa vonesa në kryerjen e vizitave mjekësore. Sipas intervistave të paraburgosurve, shërbimi mjekësor në këtë institucion nuk ishte i rregullt në kryerjen periodike të vizitave mjekësore. Ai nuk ofrohej në kohën kur ishin paraqitur nga të paraburgosurit raste emergjente të sëmundjeve, si dhe ky shërbim nuk ishte në cilësinë e duhur. Një numër i konsiderueshëm ankesash, kishin të bënin me mungesën e një sistemi qendror për ngrohje/ftohje të ambienteve të brendshme të godinës së banimit, që ti përshtatet kushteve klimaterike. Në mungesë të tij, ngrohja në dhoma për periudhën e dimrit realizohej me pajisje të siguruara nga vetë të paraburgosurit. Sipas informacionit të drejtuesit të institucionit, godina e banimit nuk ka sistem qendror ngrohje/ftohje me kaldajë, pasi ky sistem nuk ka qene i parashikuar në projektin e godinës që kur është ndërtuar. Ankesa të tjera u paraqitën dhe për kushtet në ambientet e dhomave të banimit, të cilat konsistonin në mungesën e orendive kryesisht dollapë për vendosjen e rrobave, sendeve personale dhe të ushqimeve. Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacioneve lidhur me sistemin e kërkesë/ankesave rezultoi se çdo ankesë regjistrohej në regjistrin përkatës dhe protokollohej¹⁰. Regjistrat mbaheshin nga sekretaria

⁹ Urdhër nr.2406, datë 11.03.2019 “Për masat parandaluese të vetvrasjeve në burgje dhe paraburgime”.

¹⁰ Neni 49 i ligjit Nr. 8328 dt. 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar.

e institucionit. Të paraburgosurit plotësonin një formular kërkesë/ankese dhe ia dorëzonin më pas punonjësit të sektorit psiko-social. Punonjësi i dërgonte në sekretarinë e institucionit ku protokolloheshin dhe pastaj i kalonin drejtorit të institucionit, i cili kthente përgjigje me shkrim apo takonte vetë të dënuarit. Sa i takon objektit të këtyre kërkesave na rezultoi se ato konsistonin në kërkimin për leje shpërblyese, takime me familjarë, kërkesë për dinamikën e vuajtjes së dënimit, kërkesë për takim me avokatë, vizitë në spital, transferim, punësim ose kërkesë për blerjen e pajisjeve si TV ose frigorifer. Sistemi i monitorimit me kamera vëzhgimi ishte funksional. Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Elbasan kamerat monitoronin pjesën më të madhe të mjediseve për 24 orë, ndërkohë që të dhënat ruheshin në server për një periudhë rreth dy javore. Observimi si sektor i rëndësishëm për mbajtjen, kujdesin e veçante të paraburgosurve të cilët akomodohen rishtazi në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Elbasan funksiononte me 2 dhoma (me nga 2 krevate secila) dhe pajisur me orenditë e nevojshme. Në momentin e inspektimit në këtë ambient nuk gjendej asnjë person. Telefonat punonin në çdo kohë dhe të paraburgosurit e intervistuar, pohuan se flisnin dy herë në javë me të afërmit e tyre nëpërmjet telefonave me kartë që ndodheshin në mjedisin e regjimit të brendshëm. Nga ana e të paraburgosurve kishte kërkesa për komunikime më të shpeshta me familjarët e tyre dhe ngritën si shqetësim kufizimin e numrit të telefonatave. Ata kërkonin që tu jepej mundësia e komunikimit më shpesh brenda mundësive të institucionit dhe sipas kushteve familjare që kishte secili prej tyre. Nga intervistat me të paraburgosurit nuk pati ankesa për mosrespektim të numrit të takimeve me familjet. Takimet me familjarët zhvilloheshin në një ambient të veçantë ku ndodheshin 8 poste takimesh, sipas kërkesave të të paraburgosurve dhe me miratim të Drejtorit të institucionit. Në ambientin e takimeve ishte krijuar një mjedis i veçantë për të paraburgosur që kishin fëmijë të vegjël lidhur me ushtrimin e të drejtës së prindërimit në distancë. Ata mund të takoheshin në këtë ambient pa barriera apo kufizime fizike, por dhoma kishte nevojë për investime dhe pajisje me orendi për të qenë e përshtatshme për këtë qëllim. IEVP Elbasan kishte në organikë 10 të paraburgosur të punësuar të cilët punonin kryesisht si pastrues, sanitarë, shpërndarës ushqimi etj. Të paraburgosurit që punonin përfitonin nga ulja e dënimit me 3.9 ditë në muaj. Ndërkohë, u konstatua se mungonin kontratat e punës të lidhura midis të punësuarve me institucionin.

Kjo procedure ndiqej nga ana e stafit të institucionit, pasi vazhdon të mos jenë miratuar aktet nënligjore të nevojshme për të bërë efektive të drejtën e punësimit dhe për shpërblyimin për të paraburgosurit/dënuarit, që garantohen nga ligji dhe standardet ndërkombëtare.

IEVP Elbasan kishte 4 sektorë të vendosur në një godinë. Nisur nga infrastruktura e godinës, në katin e parë ishin të vendosura ambientet e përbashkëta për takime, guzhina, lavanderia, dhomat e observim/veçimit etj. Ndërsa, dy katet e tjerë ishin të planifikuara për akomodimin e të paraburgosurve. Në çdo kat kishte nga dy sektorë të ndarë më vete. Në ambientin e jashtëm të godinës së banimit, ndodheshin 2 bokse për ajrimin e të paraburgosurve. Çdo sektor kishte në përbërje nga 10 dhoma me kapacitet 2 dhe 6 persona për çdo dhomë. Kushtet e dhomave, sipërfaqet dhe hapësirat ishin të përshtatura duke respektuar hapësirën jetike për person. Pothuajse të gjitha dhomat kishin tualete brenda, të cilat ishin në kushte të pastra higjieno-sanitare. Dhomat ishin të pajisura me orenditë e nevojshme për mbajtjen e sendeve personale dhe ruajtjen e ushqimit të të paraburgosurve, por sikurse rezultoi në shumicën e rasteve këto orendi e pajisje ishin siguruar nga familjarët e tyre. Madje, në disa

dhoma u konstatuan mungesë të pajisjeve dhe orendive duke detyruar të paraburgosurit të mbanin sendet e tyre personale dhe ushqimet në kushte jo të përshtatshme. Materialet për fjetje si dyshekët, batanijet dhe çarçafët ishin në gjendje të mirë dhe të mirëmbajtura. Tharja e rrobave personale vazhdonte të kryhej në ambientet e brendshme të dhomave. Kjo përbënte një shqetësim për të paraburgosurit, por dhe stafin e sigurisë të institucionit, pasi nuk kishte një vend të posaçëm për këtë qëllim. Pavarësisht urdhrin nr.2406, datë 11.03.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, në disa dhoma u konstatuan rripa apo mjete të tjera të varur në mure për tharjen e rrobave. Kjo praktikë, për arsye sigurie nuk duhet lejuar nga punonjësit e shërbimit të policisë, por të gjendet mundësia e krijimit të ambienteve të veçanta në çdo sektor për tharjen e rrobave. Në fund të korridorit të çdo kati ndodhej ambienti i dusheve i cili ishte i përbashkët për secilin sektor. Në këtë ambient, ndodheshin nga dy poste për dushe që plotësonin nevojat për larjen e trupit të të paraburgosurve. Orari i dushit ishte planifikuar për mesatarisht dy herë në javë dhe zbatohet sipas grafikut të miratuar nga drejtuesit e institucionit. Kushtet e mirëmbajtjes të dusheve dhe ato higjieno sanitare nuk ishin të mira. Grupi i inspektimit, konstatoi se disa nga kokat e dusheve ishin të dëmtuara, sikurse kishte amortizim të pllakave dhe tubacioneve. Këto ambiente gjithashtu, kishin nevojë për mirëmbajtje, lyerje me bojë dhe dezinfektimin periodik të tyre, pasi konstatohej që ato nuk ishin të pastra nga ana higjieno sanitare. Ajrimi për të paraburgosurit kryhej sipas sektorëve në 2 bokse ajrimi të ndara nga njëra-tjetra. Njëri prej këtyre ambienteve të ajrimit përdorej sipas grafikut të miratuar për personat me probleme të shëndetit mendor, izolim/veçimin, si edhe për 18-21 vjeçarët (aktualisht në këtë institucion ndodheshin 11 të paraburgosur të moshës 18-21 vjeçare). Ky ambient përdorej gjithashtu për kryerjen e ajrimit edhe për personat e tjerë kur konstatohej se ata kishin konflikte dhe mosmarrëveshje me njëri-tjetrin. Ambientet e përbashkëta si klasat, biblioteka dhe dhoma e palestrës ishin funksionale për çdo sektorë. Aty zhvilloheshin rregullisht aktivitete në grup dhe individuale me të paraburgosurit, sipas programit të miratuar nga drejtuesi i institucionit për punonjësit e sektorit psiko-social. Këto ambiente ishin me hapësire të bollshme, të pajisura me orenditë e nevojshme, por mungonte larmia e materialeve dhe mjeteve në funksion të qëllimit që ato kanë, për riedukimin e personave të privuar nga liria. Për sa i takon aktivitetet kulturore dhe sportive, që kërkonte pjesëmarrje më të gjerë të të paraburgosurve, ato organizoheshin në bokset e ajrimit, sipas programit vjetor të aktiviteteve.

Ambientet e takimit me familjarët gjendeshin në katin e parë të godinës. Ambienti ishte funksional me 8 poste për takimet e planifikuara mujore. Në këtë ambient ndodhej dhoma e takimeve me avokatët, dhoma e takimeve nga prokurorët, si dhe një dhomë me sipërfaqe prej gati 3x4 m², e cila përdorej si ambient për prindërimin në distancë. Kjo dhomë ishte e vogël dhe nuk ishte e plotësuar me pajisje dhe orenditë e duhura për t'u konsideruar si një ambient takimi i të paraburgosurve me fëmijët e tyre. Infrastruktura e godinës jepte mundësinë e krijimit të një ambienti tjetër me hapësirë më të madhe se ambienti ekzistues, i cili gjithashtu duhet të jetë i pajisur me materiale shlodhëse dhe lodra për fëmijët, që të paraburgosurit të ndjehen sa më miqësor me fëmijët dhe familjet e tyre. Në këtë ambient kishte një dhomë për takime speciale ndërmjet bashkëshortëve, e cila ishte e pajisur me materialet dhe orenditë e nevojshme. Gjendja higjieno sanitare e dhomave që ndodheshin në ambientin e takimeve ishte e pastër. Shërbimi i furnizimit me ujë të rrjedhshëm kryhej nga Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizimeve Elbasan dhe nga pusi që ndodhej brenda territorit të këtij institucioni. Cilësia e ujit ishte e mirë, por furnizimi me ujë në dhoma dhe ambientin e dusheve kryhej me orar, 3 herë në ditë, sipas

grafikut të miratuar. Gjatë intervistave, disa të paraburgosur shfaqën ankesa që shpeshherë ky shërbim kishte probleme dhe nuk plotësonte nevojat e tyre për mbajtjen e pastërtisë së ambienteve dhe të higjienës personale.

Për përse i përket larjes së rrobave të veshjes dhe atyre të fjetjes ato laheshin në lavanderin e këtij institucioni, nga vetë të paraburgosurit brenda në ambientet e dhomave, si dhe nga familjarët e tyre. Furnizimi me detergjente, kryhej sipas normativave mujore për çdo të paraburgosur, të cilat ishin të evidentuara në regjistër të veçantë. Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Elbasan nuk kishte një njësi tregtare për ofrimin e produkteve të ndryshme për të paraburgosurit. Kuzhina funksiononte në kushte shumë të mira dhe ishte e plotësuar me pajisjet e gatimit dhe sistemit të aspirimit. Ato ishin të standardeve industriale duke qenë se ishin vendosur së fundmi. Ambienti ku ndodhej kuzhina ishte i pastër dhe i lyster. Sipas organikës, në këtë institucion punonin 4 (katër) kuzhinierë dhe 2 (dy) ndihmës kuzhinier të paraburgosur nga lista e të punësuarve. Në kuzhinë ndodhej regjistri i normativave ushqimore dhe menyuja ditore ishte e afishuar. Regjistrat e kontrollit të ushqimit dhe të menisë së gatimit ishin të sekretuar dhe të protokolluar. Kampionët e ushqimeve mbaheshin në kushte frigoriferike dhe të etiketuar sipas vakteve përkatëse. Gjithashtu u konstatuan edhe racionet përkatëse për të sëmurët diabetikë në këtë institucion. Kushtet e përgatitjes së ushqimit në ambientet e kuzhinës së institucionit, rezultuan në gjendje të mirë dhe ushqimi konsumohej nga të paraburgosurit. Orari i veprimeve në regjimin e brendshëm ishte i afishuar, në të cilin pasqyrohej mbarëvajtja e rregullave ditore si zgjimi, rregullimi e pastrimi i dhomave, pastrimi i ambienteve të përbashkëta, ora e punës edukative e profesionale, ajrimi, aktivitetet kulturore dhe sportive, etj.

Nga intervistat e realizuara me të paraburgosurit në lidhje me aktivitetet apo programet që zhvillohen në këtë institucion, ata theksonin se organizoheshin aktivitete të përbashkëta edukative dhe sportive. Por, ata kishin kërkesa për larminë e aktiviteteve kulturore dhe mungesën e kurseve profesionale. Në dosjet e punës të punonjësve të sektorit psiko-social kishte programe individuale të trajtimit, si dhe pasqyrimi i organizimit të aktiviteteve të përbashkëta kryesisht diskutime në grup për tema sociale, këshillime në ambientet e ajrimit ose në klasat e edukimit dhe aktiviteteve sportive

E drejta për të mbajtur kontakte me familjarët dhe të afërmit zbatohet në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve. Takimet realizoheshin mesatarisht 4 herë në muaj. Takimi me familjarët zgjaste rreth 20 minuta. Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Elbasan, funksiononte biblioteka e cila ishte e pasur me libra, në dispozicion të të paraburgosurve për lexim sipas kërkesave. Në këtë institucion, mungonin trajnimet profesionale, pasi Qendra Rajonale e Formimit Profesional Elbasan apo dhe organizatat e ndryshme të qytetit, nuk kishin ofruar shërbime të tilla kohët e fundit. Gjate vizitës në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Elbasan, grupi i inspektimit konstatoi se ky shërbim funksiononte rregullisht. Personeli mjekësor përbëhej nga 7 punonjës dhe ishte i plotësuar sipas organikës me 1(një) mjek, 1(një) stomatolog dhe 5 (pesë) infermierë. Farmacistë nuk kishte në organikë, por detyrën e tij e kryente një nga infermierët, i cili ishte i miratuar nga shërbimi shëndetësor në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe Drejtori i këtij institucioni. Personeli mjekësor punonte i gjithi me kohë të plotë. Ambienti ku zhvilloheshin vizitat mjekësore ishte i pastër nga ana higjieno sanitare. Në këtë ambient ndodheshin 3 (tre) dhoma për shtrimin e të

paraburgosurve, dhoma e mjekut, dhoma e stomatologut, farmacia, dhoma e infermierëve dhe një dhomë me 3(tre) krevate në rast urgjence. Dhoma e mjekut ishte e plotësuar me krevatin, tavolinën, dollapin për mbajtjen e mjeteve të punës të mjekut dhe ishte e lyster. Gjithashtu, kabineti stomatologjik ishte i plotësuar me të gjitha pajisjet e nevojshme të punës, duke përfshirë dhe poltronin i cili ishte i ri. Furnizimi me ilaçe kryhej rregullisht sipas skemës treshe, me ribursim për të sëmurët kronikë, me fonde në dispozicion nga vetë institucioni për të sëmurët akutë, si dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bazë të një plan-shpërndarje, sipas kërkesave dhe nevojave vjetore të shërbimit shëndetësor të këtij institucioni. Pavarësisht kësaj situatë, nga intervistat me të paraburgosurit, grupi inspektimit konstatoi dhe disa problematika lidhur me shërbimin shëndetësor, të cilat konsistojnë në vonesa të vizitave mjekësore pranë mjekëve specialistë të Spitalit Rajonal Elbasan, si dhe për mungesa të medikamenteve, që shpesh mbuloheshin me kontributet e sjelljes nga familja.

Prezenca e mjekut edhe pas orarit të punës duhet të jetë me kohë të plotë, pasi kjo ka një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë dhe mbulimin e shërbimit shëndetësor, me qëllim për të shmangur situatat që mund të paraqiten në rastet urgjente, të cilat personeli infermierëve nuk mund t'i përballojë dhe pasojat mund të jenë të rënda për të paraburgosurit e sëmurë. Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Elbasan kishte një Sektor të Kujdesit të Veçantë (SKV), në të cilin ndodheshin 7(shatë) persona të sëmurë me probleme të shëndetit mendor. Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor, e në veçanti atij të mjekut, u konstatua se kartelat klinike mbaheshin në dollap të mbyllura me çelës në dhomën e mjekut. Gjithashtu u këqyrën regjistri i vizitave të mjekut, regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve, të cilat ishin mbajtur me rregull. Gjithashtu, regjistri i evidentimit të rasteve të dhunës fizike, si dhe formatet e kontrollit mjekësor ishin plotësuar sipas Protokollit të Stambollit lidhur me evidentimin dhe raportimin e rasteve të dhunës.

Gjatë vizitës inspektuese dhe intervistave me të paraburgosurit, u konstatua se një pjesë e tyre ishin të pajisur me librezë shëndetësore. Ndërkohë, personeli mjekësor ishte duke punuar për plotësimin e librezë shëndetësore për të gjithë të paraburgosurit. Lidhur me disa mungesa për sigurimin e ilaçeve, duhet të theksojmë se Institucioni i Avokatit të Popullit në mënyrë të përsëritur ka rekomanduar marrjen e masave për vënien në funksion të skemës së furnizimit me ilaçe për të gjitha institucionet penitenciare, ndaj në vijim do të kërkohet informacion i vazhdueshëm për hapat e marra nga ana juaj në këtë drejtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës, nenit 21, germa “b” të ligjit Nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, si dhe nenit 12, nenit 74/1 pika “b” të ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar

Rekomanduar: Marrjen e masave të menjëhershme nga ana e personelit të shërbimit shëndetësor të institucionit për furnizimin e farmacisë me ilaçe, si për rastet akute, ashtu dhe ato kronike duke vënë në zbatim efektiv skemën e ribursimit të ilaçeve; marrjen e masave të menjëhershme për rritjen e efikasitetit dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimit shëndetësor në kohë dhe pa vonesa nga ana e stafit mjekësor ndaj të të paraburgosurve; marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e dhomave të të paraburgosurve me materialet dhe orenditë e nevojshme për mbajtjen e sendeve personale dhe ushqimeve; marrjen e masave për gjetjen e mundësive financiare për investime, me qëllim instalimin

e një sistemi qendror ngrohës-ftohës për të paraburgosurit që strehohen në këtë godinë; marrjen e masave për krijimin dhe pajisjen e ambienteve ekzistues me mjetet e duhura për konkretizimin e aktiviteteve psiko-sociale, si dhe aktiviteteve kulturore e sportive për rritjen e larmisë së aktiviteteve social-kulturore në këtë institucion; marrjen e masave të menjëhershme për riparimin e dusheve, dezinfektimin dhe lyerjen e ambienteve të përbashkëta të tyre; marrjen e masave të menjëhershme për krijimin e ambienteve të veçanta në çdo sektor për tharjen e rrobave të të paraburgosurve dhe heqjen për arsye sigurie të litarëve, rripave dhe mjeteve të tjera në dhoma, për tharjen e rrobave; marrjen e masave për plotësimin e institucionit me autoambulancë, me qëllim shoqërimin e të sëmurëve në rastet urgjente, si dhe atyre me probleme të shëndetit mendor, për në Spitalin Rajonal Elbasan dhe spitalet e tjera të vendit; marrjen e masave të nevojshme në bashkëpunim me Qendrën e Formimit Profesional Elbasan për ofrimin e kurseve profesionale të të paraburgosurve në institucion si dhe bashkëpunim me zyrën rajonale për të bërë aktivitete të formimit profesional.

5.3. IEVP “MINE PEZA”

Gjatë vizitës në IEVP Mine Peza Tiranë MKPT zhvilloi vizitë inspektuese më datë 26.12.2019, sipas planit të inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Ky institucion ka një kapacitet maksimal të miratuar prej 170 personash. Në ditën e inspektimit, në mjediset e institucionit ishin 170 persona, nga të cilët 169 të paraburgosur dhe 1 i dënuar, prej të cilëve 3 (tre) të paraburgosur ndodheshin në spitalin e burgut. Nga këta të paraburgosur janë: 36 persona të sëmurë kronik, 16 persona të sëmurë me probleme të shëndetit mendor, 8 persona me diabet dhe përdorues të lëndëve narkotike që trajtohen me metadone. Te paraburgosur të punësuar në institucion janë 15 persona, të cilët punonin si pastrues, berber, shërbim luanterie etj. Aktualisht organika e IEVP, Mine Peza ishte e përbërë nga sektori i burimeve njerëzore me 9 punonjës, sektori juridik 2 punonjës, sektori financiar me 2 punonjës, sektori i logjistikës me 5 punonjës si dhe sektori shëndetësor dhe psiko- social të cilat përbëhen nga: Sektori shëndetësor (1) një mjek i përgjithshëm i cili ishte në mungesë, (4) katër ndihmës mjekë, (1) një stomatolog dhe (1) farmacist. Sektori psiko - social (1) një psikologe e cila është përgjegjëse për çështjet shoqërore, (4) katër specialiste edukimi. Problematika të rëndësishme ngelen: Lagështia është e pranishme kudo, ambientet e dusheve të përbashkëta ishin në kushte emergjente për tu riparuar në IEVP “Mine Peza”. Pjesa më e madhe e problematikave të evidentuara më herët përgjatë inspektimeve, në këtë institucion të tilla si ventilimi dhe ndriçimi natyral dhe drita e pamjaftueshme natyrale vazhdonin të ishin ekzistuese. Mbipopullimi në dhoma nisur nga standardet kombëtare për respektimin e hapësirës jetike për person, ishte prezent pothuajse në të gjitha dhomat e vuajtjes të dënimit. CPT kërkon konfirmim se norma e akomodimit në qeli në burgun “Mine Peza” është ulur, për të siguruar së paku 4m² hapësirë jetese për person në pjesën më të madhe të qelive (pa përfshirë hapësirën e tualetit). Pjesa më e madhe e 11 qelive në katin e parë të godinës ishin më pak se 3m² sip. për person. Mjeku në institucion mungon, një nga rekomandimet përsëritëse nga CPT (Komitetit për Parandalimin e Torturës, Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues) për “Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale” është rritja e burimeve për personelin mjekësor. Në institucion nuk kishte një ambulancë, kjo mungesë krijonte jo pak vështirësi në përbalimin e situatave emergjente me të sëmurët. Kurset Profesionale në institucion mungonin. Është shqetësues fakti që të paraburgosurit nuk merrnin pjesë në kurse

profesionale, edhe pse disa prej tyre janë të punësuar. Me përjashtim të një numri të vogël të paraburgosurish të cilët punojnë, shumica e personave, rrinë të mbyllur në qeli 22 orë në ditë dhe e kalojnë kohën duke parë televizor Grupi i inspektimit në vijim të punës, vizitoi mjediset e regjimit të brendshëm të institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve “Penale Mine Peza”, ku u njoh me regjistrat dhe dokumentacionin e disa praktikave, që kanë të bëjnë me të drejtat e të paraburgosurve, si dhe zhvilloi intervista në mënyrë konfidenciale me ta në dhomat e tyre. Nga informacioni dhe në intervistat konfidenciale të zhvilluara me të paraburgosurit, rezultoi se nuk kishte raste torture, të dhunimit fizik ose psikologjik apo përdorimit të tepruar të forcës fizike ndaj këtyre personave nga personeli i sigurisë të shërbimit të policisë apo punonjësit e stafit civil, që shërbejnë në këtë institucion. Gjatë vizitës u konstatua se shërbimi i kontrollit të brendshëm në I EVP “Mine Peza” ishte prezent.

Grupi i inspektimit, inspektoi dhe plotësimin e kushteve materiale dhe të jetesës të të paraburgosurve në këtë institucion, duke u përqendruar kryesisht tek kushtet e banimit, veshjen, mbipopullimin në dhoma, higjienën personale, kushtet sanitare, cilësinë e përgatitjes dhe shpërndarjes në kohë të ushqimit, ndriçimi, ventilimi, ngrohja, ambientet e takimit me familjarët, komunikimi telefonik, dhe monitorimi me kamera i ambienteve të përcaktuara sipas skemës së sigurisë.

Nga inspektimi i ambienteve rezultoi se :Mjedisi i takimit me familjarët (4 bokse të ndara me zgarë hekuri, të pajisur me tavolinë druri, stola plastikë e mbajtur pastër). Dhomat për për takimet me avokatin ishin 2 të pajisura secila me orendi: 2 tavolina, karrige, e mbajtur pastër dhe lyer, dhomat kishin ndriçim artificial dhe natyral. Dhomë këshillimi 1(një) e pajisur me orendi, tavolinë, karrige, raft me libra, piktura të varura në mur, e mbajtur pastër dhe e lyer, me ndriçim artificial dhe natyral. Në katin e parë kishte 1(një) dhomë veçimi dhe 1(një) observimi të pajisura me orenditë e nevojshme. Dushet e përbashkëta për të burgosurit që qëndrojnë në observim (4 bokse për larje me një bolier, 1 wc, mjedisi i shtruar me pllaka dhe i ndriçuar. Në katin e parë ka 11 dhoma, secila me dush brenda dhomave, bolierët janë vendosur jashtë dhomës. Në korridor janë afishuar të drejtat e të burgosurve si dhe numrat e Avokatit të Popullit, Komitetit Shqiptar të Helsinkit, Qendrës Shqiptare të Rehabilitimit të Traumës dhe Torturës, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Institutit Europian të Tiranës, Anti Korrupsioni. Janë të afishuara në mur, norma e sapunit, detergjenteve, norma e ushqimit, organika e punës të dt.02.12.2019, lista e artikujve që shiten në njësinë tregtare me çmimet e dt.22.11.2019, grafiku i ajrimit dhe dusheve të dt.02.12.2019. Në korridor është vendosur një makineri për kafënë. Ajrimi bëhet në 6 bokse, të mbuluara pjesërisht me strehë dhe ku në secilin janë vendosur dy kartofona. Në katin e dytë ka 21 dhoma. Dushet ishin të përbashkët, me 4 bokse për larje dhe 4 bolierë. Mjedisi është i shtruar me pllaka, tavani ka lagështirë të theksuar lagështie. Ndriçimi artificial është i bollshëm, ndriçimi natyral sigurohet nga një dritare e mbyllur me zgarë hekuri. Ne katin e dytë ka dy anekse me tre dhoma, të cilat kanë bolier dhe wc më vete. Te gjitha dhomat, përveç atyre të anekseve, mbyllen si me derë ashtu edhe me zgarë hekuri. Zgara e hekurit siguron ajrosje në ditët e verës, kur dera lihet e hapur. Edhe kur të burgosurit dalin në ajrim, dyert e hekurit hapen dhe zgara mbahet e mbyllur për të qarkulluar ajrin. Në çdo kat janë vendosur edhe dy ventilator. Në katin e tretë ka 17 dhoma si dhe një mjedisi të përbashkët, biblioteka, të pajisura me ambient të përbashkët të dusheve me 4 bokse dhe 4 bolierë. Ambienti i dusheve kishte prezencë të theksuar lagështie. Në I EVP Mine Peza gatuajnë 4 kuzhinierë (2 paradite, 2 mbasdite) Mjedisi ishte i lyer dhe mbahej pastër. Në mur ishin afishuar: norma ushqimore, menuja javore, librezja e shëndetësisë e punonjësve, lista e të sëmurëve kronik (36)

dhe lista e diabetikëve (8). Dhoma e mjekut ishte e pajisur me shtrat dhe medikamente, në mur ishte afishuar lista e medikamenteve të urgjencës (27 gjithsej). Kabineti i stomatologut ishte i ri i siguruar nga Drejtoria e përgjithshme e Burgjeve. Sistemi i monitorimit me kamera funksiononte në të gjitha ambientet. Lavanderia ishte e pajisur me 5(pesë) lavatriçe dhe 1(një) tharëse rrobash, të gjitha ishin në gjendje pune, por këto shërbenin vetëm për larjen e çarçafëve dhe batanijeve pasi të dënuarit rrobat për larje i dërgonin në familje. Nga komunikimi me të paraburgosurit në IEVP Mine Peza rezultoi se kishte ankesa mbi: Ankesa vinin për kushtet e ambienteve të përbashkëta të vuajtjes së dënimit, dhe veçanërisht të ambienteve të ajrimit¹¹, të cilat sipas tyre ishin shumë të kufizuara dhe kjo u konstatua edhe nga ekspertët e MKPT-së. Ankesa kishte edhe për numrin e kufizuar të aktiviteteve rekreative në IEVP “*Mine Peza*” Tiranë. Ankesa kishte dhe për ilaçet të cilat për efekt shpejtësie në disa raste duhej t’i siguronin nga familjarët. Një problematikë e pretenduar nga të intervistuarit ishte edhe vonesa në kryerjen e ekzaminimeve, analizave laboratorike e konsultave në qendrat e specializuara mjekësore. Megjithatë, nga intervistat rezultoi se kishte disa ankesa që ishin të lidhura kryesisht me kushtet e përgjithshme të jetesës në institucion. Të paraburgosurit plotësonin një formular kërkesë/ankese dhe ia dorëzonin më pas punonjësit të sektorit psiko-social. Punonjësi i dërgonte në sekretarinë e institucionit, ku protokolloheshin dhe pastaj i kalonin drejtorit të institucionit, i cili kthente përgjigje me shkrim apo takonte vetë të paraburgosurit. Sa i takon objektit të këtyre kërkesave, rezultoi se ato konsistonin në kërkimin më së shumti për leje shpërblyese, takime me familjarë, kërkesë për dinamikën e vuajtjes së dënimit, kërkesë për takim me avokatë, vizitat në spital, transferim, punësim ose kërkesë për blerjen e pajisjeve si TV ose frigorifer. Sistemi i monitorimit me kamera vëzhgimi ishte funksional. Institucioni ishte i pajisur tërësisht me kamera vëzhgimi. Në IEVP, “*Mine Peza*” Tiranë kamerat monitoronin të gjitha mjediset për 24 orë, ndërkohë që të dhënat ruheshin në server për një periudhë 30 ditore. Cilësia e pamjeve të kamerave ishte mjaft e mirë. Telefonat punonin në çdo kohë dhe të paraburgosurit e intervistuar, pohuan se mund të flisnin sa herë të dëshironin me të afërmit e tyre nëpërmjet telefonave me kartë që ndodheshin në mjedisin e regjimit. Në IEVP, “*Mine Peza*” Tiranë kishte 15 të paraburgosur që punonin kryesisht si pastrues, sanitarë, shpërndarës ushqimi etj. Nga takimi i grupit inspektues më të paraburgosurit dhe dënuarit që punonin brenda institucionit këta të fundit nuk kishin pretendime për kushtet e punës. Të paraburgosurit që punonin, përfitonin nga ulja e dënimit me 3.9 ditë në muaj. Kjo procedurë ndiqej pasi ende nuk janë miratuar aktet nënligjore të nevojshme për të garantuar të drejtën për punësim dhe për shpërbllim të drejtë të punës, për të burgosurit, sipas standardeve ligjore në fuqi. Në mjediset e korridoreve të tre kateve vërehej mungesa e sistemit të ajrosjes e cila shkaktonte një mjedis të rënduar ajrimi megjithëse në to ishin vendosur nga 2 ventilator. Kushtet materiale ishin në përmirësim, por mbetej problematike sipërfaqja e dhomave 2X5 m apo 10 m², në të cilën qëndronin 4-5 pesë të paraburgosur. Në katin e parë të ndërtesës ndodhej sektori i dhomave të veçimit dhe dhomave të tranzitit. Këto dhoma ndryshe nga një vit më parë ishin pajisur me batanije, çarçafë dhe karrige dhe me dollap të vegjël për mbajtjen e

¹¹ CPT/Inf(2019)Fq,7Burgu Nr. 302, kushtet mbetën të njëjta në shumë dhoma, të tilla si lagështia, ajrosja etj

sendeve personale. Konstatimet lidhur me ambientet përveç problemeve të degradimit strukturor të ndërtesës, ngrenë edhe shqetësimin e institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut në një vend demokratik.¹² Avokati i Popullit vlerëson se vendosja e personave në kushtet e një hapësire jetike prej më pak se 4m² dhe larg standardeve minimale të Rregullores së përgjithshme të Burgjeve, neni 22, pika 1, “*Në strehimin e të burgosurve mbahen parasysh kushtet dhe mundësitë konkrete të çdo IEVP-je, por në çdo rast duke iu siguruar kubatura jo më pak se 9 m³ dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4 m² për çdo të burgosur,...*” përbën trajtim degradues dhe jo human dhe shkelje të nenit 3 të KDNJ. Për sa më lartë, Avokati i Popullit kërkon ndërhyrje urgjente nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për të bërë të mundur ndryshimin e shpejtë të situatës në sektorë dhe garantimin e respektimit të normave të hapësirës jetike për çdo të paraburgosur. Gjatë inspektimit të ambienteve të brendshme të regjimit, në IEVP 302 Mine Peza, kishte një mjedis për takimet me familjarët, me 4 sportele të ndara me zgarë hekurash, që monitorohej me kamera vëzhgimi dhe dy dhoma për takimin me avokatët të pajisur me pajisjet e nevojshme tavolinë, karrige. Grupi i inspektimit konstatoi se biblioteka përdorej si një mjedis shumë-funksional, për aktivitete fetare, social-kulturore, për ditë të veçanta festash etj. Kuzhina, ishte një mjedis në hyrje të regjimit, e pastër dhe e pajisur me mjetet e nevojshme për gatim. Gjithashtu kampionët mbaheshin në kushte frigoriferike dhe të kyçura. Grupi i inspektimit konstatoi se për personat diabetikë kishte të njëjtin ushqim, por të gatuar sipas dietës përkatëse. Menyja e përditshme ishte e afishuar. Në hyrje të mjedisit të ajrimit ndodhej dhe dyqani i institucionit. Dyqani ishte i vogël dhe nuk ofronte shumë larmi artikujsh. Lista e çmimeve të produkteve ndodhej e afishuar. Të paraburgosurit shfaqën ankesa lidhur me çmimet e larta të artikujve ushqimorë. Gjatë inspektimit u vu re se zhvilloheshin aktivitete të përbashkëta nga të cilat mund të përfitonin të paraburgosurit të cilat ishin kryesisht ndjekja e programeve të televizorit, lojërat e tavolinës siç janë lojëra me letra dhe domino. Në lidhje me ajrimin u konstatua se ajrimi ditor zgjaste mbi 3 (tre) orë sipas rregullores dhe ky orar ishte edhe më i gjatë në periudhën e verës. Shumë prej të intervistuarve nëpër dhoma të pyetur për aktivitetet apo programet që ata marrin pjesë **kërkuan të kenë më shumë aktivitete të përbashkëta edukative ose sportive.** Problematikë në institucion ngelet mungesa e ambienteve sportive. Është për tu theksuar se një ndër qëllimet e institucioneve të mbyllura penitenciare është riintegrimi në shoqëri i personave, në momentin kur do të lënë burgun. Rregullorja Evropiane e Burgjeve parashikon se “*regjimi i ofruar për të gjithë të burgosurit përfshin një program të balancuar veprimtarish. Ky regjim u lejon të gjithë të burgosurve të kalojnë sa më shumë orë në ditë jashtë qelive të tyre, sipas nevojës për një nivel të përshtatshëm të ndërveprimit njerëzor dhe shoqëror*”¹³. E drejta për të mbajtur kontakte me familjarët dhe miqtë zbatohet përgjithësisht sipas rregullores. Takimet realizoheshin mesatarisht rreth 4 herë në muaj, në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve. Takimi me familjarët zgjaste rreth 20 minuta. Orari i veprimtarive ishte i njëjtë për të gjithë sektorët pavarësisht nga siguria që ata kishin

¹² Një çështje e tillë është gjykuar nga Gjykata e të Drejtave të Njeriut të Këshillit të Evropës në rastin Sulejmanovic kundër Italisë. Gjykatësit e Strasburgut në vendimin e tyre kanë cilësuar se kufizimi i hapësirës jetike ndaj të dënuarve dhe të paraburgosurve përtej standardeve ligjore të shteteve palë dhe ato të Konventave Ndërkombëtare përbëjnë shkelje të nenit 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

¹³Rregullorja e Evropiane e Burgjeve Pika 25.1 dhe 25.2; <http://www.coe.int/t/DGHL/STANDARDSETTING/PRISONS/EPR/EPR-Albanian.pdf>

dhe aktivitetet e zhvilluara. Aktivitetet gjithashtu konsistonin edhe në festa me rastin e datave të rëndësishme ose festive fetare. Nga intervistat e realizuara me të paraburgosurit aktivitetet në bibliotekë zhvilloheshin çdo të premte , ndërkohë që aktivitetet e besimit dhe riteve fetare zhvilloheshin çdo të mërkurë dhe te premte. Ky ambient përdorej si për këshillime individuale. Një mjedis tjetër, që përdorej edhe për këshillime individuale, ndodhej në katin e parë. Kjo klasë ishte e pajisur me një tavolinë të gjatë, gjashtë karrige, një dollap me disa revista dhe disa piktura të varura në mur. Aktualisht në institucion nuk zhvilloheshin kurse profesionale. Dhoma e prinderimit tashme ishte funksionale e pajisur me lodra fëmijësh ne te cilën zhvilloheshin takimi me fëmijët e mitur të dënuarve. Ne dosjet psiko-edukative nuk mungonin programe individuale të trajtimit si dhe pasqyrimi i organizimit të aktivitete të përbashkëta në ta, kryesisht diskutime në grup për tema sociale dhe aktiviteteve sportive. Dosjet psiko-sociale ishin të plotësuara mirë, me përmbledhjet nga takimet e fundit me të paraburgosurit, me programet individuale dhe në grup, me vlerësimet e tre mujoreve dhe gjithë dokumentet e tjera mbështetëse. Nga takimi me punonjësin e sektorit të kujdesit social, si edhe nga intervistat e kryera me të paraburgosurit, grupi i inspektimit vuri re një komunikim dhe ndërveprim shumë të mirë, të ndërsjelltë ndërmjet punonjësit të sektorit të kujdesit social dhe të paraburgosurve. Veçojmë faktin se sektori i çështjeve shoqërore ju kushton një përparësi të veçantë personave që janë kategori 18-21 vjeçare duke ju ofruar një trajtim specific psiko-social dhe një përkujdesje të veçantë. Në institucion në ditën e inspektimit ishin 2(dy) të paraburgosur kategori 18-21 vjeçare që trajtohen me programe të veçanta PIT (Programi i individualizuar trajtimi).Gjatë vizitës në IEVP, “*Mine Peza*” Tiranë si dhe nga intervistat me të paraburgosurit, problematika u konstatuan kryesisht në mungesat e medikamenteve, të cilat shpesh mbuloheshin edhe me kontributet e sjelljes nga familja. Skema e rimbursimit të ilaçeve kishte disa vështirësi për të paraburgosurit, të cilët për shkak të vonesave në plotësimin e dokumentacionit të dosjeve personale e kishin më të vështirë sigurimin e ilaçeve. Të paraburgosurit ishin të pajisur me librezë shëndetësore. Skema e furnizimit Furnizimi me ilaçe për personat me probleme akute funksiononte normalisht në farmacinë e institucionit ndodheshin 27 medikamente të urgjencës, ndërsa furnizimi me ilaçe për personat e sëmurë kronikë kishte probleme. Lidhur me këtë problematikë blerja dhe sigurimi i ilaçeve sigurohej nga tre burime dhe konkretisht nga depo farmaceutike, furnizim me blerjet e drejtpërdrejta nga fondi i siguruar nga D.P.Burgjeve dhe furnizim nga fondi i vetë institucionit. Personeli i kujdesit mjekësor në IEVP, “*Mine Peza*”, Tiranë sipas organikës përbëhej nga 1(një) mjek, 1(një) farmacist, 1(një) stomatolog dhe 4 (katër) ndihmës mjekë. Mjekja aktuale ishte me leje lindje dhe për nevoja të institucionit sa herë ishte e nevojshme ndihma mjekësore, ishte caktuar një mjek nga D.P.B e burgjeve me kohë të pjesshme. Në të njëjtën kohë, fakti që mjeku nuk është i pranishëm në këtë institucion gjatë ditës dhe më pas, vetëm në kushte të domosdoshmërisë thirret ndihma urgjente mjekësore¹⁴, shkakton në mënyrë të drejtpërdrejtë shkeljen e së drejtës për qasje deri te mjeku nga ana e personave të dënuar apo të paraburgosur, gjë që interpretuar dhe në qëndrimet e KPT¹⁵ parashikon që: “*Derisa qëndrojnë në burg, personave të dënuar duhet tu mundësohet qasja deri te mjeku në çdo kohë, pa marrë parasysh faktin e regjimit të burgosjes së tyre*” dhe se “*shërbimi shëndetësor duhet të organizohet në atë mënyrë, që do të mundësojë që*

¹⁴ Rregullorja Evropiane e Burgjeve, pika 39, 40.1, 40.5;

¹⁵ CPT, Komiteti për Parandalimin e Torturës, *Derisa qëndrojnë në burg, personave të dënuar duhet tu mundësohet qasja deri te mjeku në çdo kohë, pa marrë parasysh faktin e regjimit të burgosjes së tyre*”

kërkesat për konsultime mjekësore të ofrohen pa zgjatje të pa nevojshme". Në IEVP, "Mine Peza" Tiranë në katin e parë ne hyrje të regjimit ndodhej godina një- katëshe më vete, ku ishin të vendosura, dhoma e stomatologut, dhoma e vizitave të mjekut, si dhe kishte 1(një) farmaci për institucionin. Dhoma e stomatologut ishte e pajisur me karrige dhe sterilizues, uniti dentar ishte i rri dhe mjeku stomatolog ishte i pranishëm. Dhoma e mjekut në dhe farmacia ishin të lyera dhe ishin në gjendje të mirë me kushte të mira higjieno-sanitare. Në IEVP, "Mine Peza" Tiranë u vu re se, sërisht mungonte ambulanca për të shoqëruar personat në spitalet përkatëse të vendit. Është për tu theksuar se Rregullorja Evropiane e Burgjeve shprehet se: "Autoritetet e burgut ruajnë shëndetin e të gjithë të burgosurve që janë në kujdesin e tyre. Shërbimet mjekësore në burg organizohen në bashkëpunim të ngushtë me administrimin shëndetësor të komunitetit ose të shtetit. Të burgosurit i ofrohen shërbimet mjekësore, kirurgjike dhe psikiatrike, duke përfshirë dhe ato shërbime që janë të disponueshme në komunitet". Në institucion të paraburgosur me probleme të shëndetit mendor ishin 16. Në institucion gjendeshin 6 (gjashtë) persona që kishin qenë përdorues të lëndëve narkotike të cilët merrnin mjekimin me metadon. Të sëmurë, kronik me probleme organike ishin 24. Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor, e në veçanti atij të mjekut, u konstatua se kartelat klinike mbaheshin në dollap në dhomën e mjekut. Gjithashtu u këqyren regjistri i vizitave të mjekut, regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve, të cilat ishin mbajtur me rregull. Ndërkohë që një pjesë, që sapo ishin akomoduar në këtë institucion, prisnin plotësimin e dokumenteve përkatëse për vazhdimin e procedurës së pajisjes me librezë shëndetësore.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës, nenit 21, germa "b" të ligjit Nr. 8454 datë. 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", si dhe nenit 12, nenit 74/1 pika "b" të ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim", i ndryshuar

Rekomanduar: Marrjen e masave të menjëhershme për të garantuar akomodimin e të paraburgosurve në IEVP "Mine Peza" Tiranë në mjedise të përshtatshme banimi duke respektuar për të gjithë normat minimum të hapësirës për person, në institucione të tilla, që janë 6m² për dhomat për një person dhe 4m² për person kur në to sistemohen më shumë banorë; marrjen e masave për punësimin e një mjeku me kohë të plotë në institucion; marrjen e masave për pajisjen e IEVP "Mine Peza" Tiranë me ambulancë për të shoqëruar personat në spitalet përkatëse të vendit në përputhje me nevojat shëndetësore të të dënuarve dhe të paraburgosurve; marrjen e masave për të zhvilluar kurse të arsimit dhe ato profesionale në favor të personave të paraburgosur në IEVP, "Mine Peza" Tiranë; marrjen e masave lidhur me kushtet higjieno-sanitare dhe lagështirën në tualete dhe dushe, gjithashtu pajisjen me produkte higjieno-sanitare për çdo të paraburgosur; marrjen e masave për pajisjen me sistem ajrimi të ambienteve të IEVP-së.

5.4. IEVP FIER

Mekanizmi Kombëtar¹⁶, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, kreu një inspektim në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Fier, më datë 11.04.2019, sipas një Plani Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit.

Ky institucion ka një kapacitet maksimal prej 860 personash. Në ditën e inspektimit, në mjediset e institucionit ishin 813 persona, nga të cilët 123 të paraburgosur dhe 684 të dënuar ndërkohë që 5 të dënuar të tjerë ishin të shtruar në spital në Tiranë. Në këtë IEVP gjendeshin edhe 13 të sëmurë mendor të cilët trajtoheshin në një Sektor të Kujdesit të Veçantë. Organika e institucionit të IEVP Fier përbëhej nga 399 punonjës nga të cilët 341 ishin punonjës të policisë së burgjeve dhe 58 punonjës civil.

Në bazë të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë Nr. 8927/1, datë 27.09.2018, “Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”, i ndryshuar, IEVP Fier është kategorizuar si “burg me një seksion paraburgimi dhe një seksion burgu të sigurisë së zakonshme”. Sipas të dhënave që u morën gjatë kësaj vizite, informacioneve të marra nëpërmjet intervistave konfidenciale me personat e privuar nga liria, si dhe bisedat me stafin e institucionit, rezultoi se: Ishte plotësuar pjesërisht rekomandimi për pajisjen e të gjithë të dënuarve dhe paraburgosurve me librezë shëndetësore dhe numrat respektiv të sigurimit shëndetësor, gjithashtu ishte realizuar vënia në zbatim e skemës tre palëshe e rimbursimit të ilaçeve për të sëmurët. Ishte plotësuar rekomandimi lidhur me sigurimin e furnizimit me ujë të pijshëm në të gjitha dhomat duke hapur puse dhe garantuar një furnizim alternativ dhe të sigurtë me furnizim me ujë 24 orë. Ishte plotësuar rekomandimi për marrjen e masave për të eliminuar mbipopullimin. Ishte plotësuar rekomandimi për ndërprerjen e përdorimit të ambienteve të observim/veçimit jashtë funksionit të tyre ligjor. Ishte zbatuar rekomandimi për plotësimin e vendit vakant të psikologut dhe stomatologut gjithashtu dhe mjekut me kohë të plotë sipas parashikimeve në organiken e institucionit.

Ishte zbatuar rekomandimi për të siguruar që të gjithë të dënuarit të jenë të pajisur me sasinë e nevojshme të produkteve bazë të higjienës personale si edhe me materialet e nevojshme për të pastruar dhomat e tyre. Ishte plotësuar rekomandimi lidhur me pajisjen me regjistrin e evidentimit të rasteve të dhunës në këtë institucion. Të dënuarit dhe të paraburgosurit e konsideronin jo në nivelin e duhur, shërbimin e sektorit psiko-social në IEVP Fier. Gjithashtu sipas të dënuarve shërbimi juridik dhe mjekësor në këtë institucion nuk ishte i rregullt dhe nuk ofrohej në kohë dhe në cilësi. Ankesa kishte lidhur me vizitat mjekësore të specializuara dhe ilaçet specifike të cilat për efekt shpejtësie duhej t'i siguronin nga familjarët, sikurse edhe për shërbimin stomatologjik i cili së fundmi funksiononte normalisht si rezultat i sigurimit të unitit të ri. Spitali kishte 11 dhoma dhe në momentin e inspektimit ishin 10 të sëmurë. Dhoma e mjekut dhe e dentistit ishin të kompletuara. Në strukturën e IEVP Fier kishte dy mjekë ku njëri me kohë të plotë dhe një me kohë të pjesshme, dhjetë infermierë, një farmacist dhe një dentist. Ankesa gjithashtu kishte lidhur me çmimet e larta në njësinë tregtare, brenda IEVP, Fier, gjë kjo që shkaktonte vështirësi tek të dënuarit/paraburgosurit për sigurimin e produkteve bazë të domosdoshme personale. Ankesa kishte edhe për mungesën e aktiviteteve rekreative në IEVP, Fier. Gjithashtu të dënuarit dhe të paraburgosurit në IEVP, Fier konfirmonin faktin se ekzistonin ambiente të veçanta dhe komode për ushtrimin e rriteve fetare. Tek biblioteka ishin përshtatur një ambient kishe,

¹⁶ Neni 74/1 i ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar.

një ambient kulti për myslimanet, një ambient për bibliotekë fetare dhe një ambient për bibliotekë artistike.

Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacioneve lidhur me sistemin e kërkesë/ankesave rezultoi se çdo gjë regjistrohej në regjistrin përkatës dhe protokollohej¹⁷. Regjistrat mbaheshin nga sekretaria e institucionit.

Të paraburgosurit/ dënuarit plotësonin një formular kërkesë/ankese dhe ia dorëzonin më pas punonjësit të sektorit psike-social. Punonjësi i dërgonte në sekretarinë e institucionit ku protokollo eshin dhe pastaj i kalonin drejtorit të institucionit, i cili kthente përgjigje me shkrim apo i takonte vetë të dënuarit. Sa i takon objektit të këtyre kërkesave na rezultoi se konsistonin në kërkimin për leje shpërblyese, takime me familjarë, kërkesë për dinamikën e vuajtjes së dënimit, kërkesë për takim me avokatë, vizitë në spital, transferim, punësim ose kërkesë për blerjen e pajisjeve si TV ose frigorifer. Sistemi i monitorimit me kamera vëzhgimi ishte funksional. Në IEVP, Fier kamerat monitoronin pjesën më të madhe të mjediseve për 24 orë, ndërkohë që të dhënat ruheshin në server për një periudhë rreth dy javore. Observimi si sektor i rëndësishëm për mbajtjen, kujdesin e veçante të paraburgosurve të cilët akomodohen rishtazi në IEVP Fier funksiononte, dhe në momentin e inspektimit gjendeshin 14 dhoma të mirë pajisura në pritje të personave të sapo ardhur në institucion.

Telefonat punonin në çdo kohë dhe të dënuarit apo të paraburgosurit e intervistuar, pohuan se mund të flisnin sa herë të dëshironin me të afërmit e tyre nëpërmjet telefonave me kartë që ndodheshin në mjedisin e regjimit të brendshëm. Gjithashtu ishin vënë në funksionim edhe aparatet telefonik në ambientet e ajrimit. Në IEVP Fier ishte krijuar një mjedis i veçantë për të paraburgosur/dënuar që kishin fëmijë të vegjël lidhur me ushtrimin e të drejtës së pri nderimit në distancë, me të cilët mund të takoheshin pa barriera apo kufizime fizike. Gjithashtu në oborrin e brendshëm ishte krijuar dhe një ambient takimesh me familjarët në formën e një lokali të hapur i cili shërbente për takime të veçanta të të dënuarve me prindër apo familjarë të moshuar. Kjo është një praktikë e mirë e cila duhet inkurajuar në frymën e rritjes së kontakteve të burgosurve me familjarët dhe botën e jashtme.

Në IEVP Fier kishte 85 të dënuar që punonin kryesisht si pastrues, sanitarë, shpërndarës ushqimi etj. Të dënuarit që punonin përfitonin nga ulja e dënimit me 3.9 ditë në muaj dhe dhënia e përfitimit monetar, në masë minimale, që depozitohej në llogarinë bankare të personit.

Kjo procedurë ndiqej pasi ende nuk janë miratuar aktet nënligjore të nevojshme për të garantuar të drejtën për punësim dhe për shpërbllim të drejtë të punës, për të burgosurit, sipas standardeve ligjore në fuqi. Grupi i monitorimit, në fokus të vizitës së tij pati edhe monitorimin e kushteve materiale, të rëndësishme për respektimin e standardeve normale të jetesës. IEVP, Fier është një institucion i ri. Infrastruktura e godinës përbëhej nga 4 godina, një për të paraburgosurit dhe 3 për të dënuarit me ambiente ajrimi të jashtëm. Çdo godinë ishte e përbërë nga tre kate me nga dy sektorë për çdo kat. Ambientet ishin bashkëkohore përsa i përket klasave, dhomave të takimeve, dhomës së prindërimit, 5 klasave ku zhvilloheshin mësimi dhe kurset. Kishte dhomë këshillimi me psikologun, edukimi,

¹⁷ Neni 49 i ligjit Nr. 8328 dt. 16.04.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i ndryshuar.

bibliotekë, ambiente të ndara kulti, një kishë dhe një xhami. Biblioteka nuk ishte shumë e pasur me libra. Ne dhomat e inspektuara nga grupi i ekspertëve monitorues u vu re se dhomat ishin me banjë brenda dhe rrinin 2 ose 3 veta në dhomë. Baza materiale përgjithësisht ishte e plotësuar. Çarçafët dhe batanijet e të dënuarve dhe të paraburgosurve për të gjithë sektorët ishin sjellë nga familjarët, pasi institucioni nuk u vendoste në dispozicion çarçafë, por vetëm batanije të cilat rezultojnë të vjetërsuara. Larja e tyre mundësohej në lavanderi, ku gjendeshin lavatriçe të institucionit dhe të sjella nga vetë të dënuarit. Dushet ndodheshin në çdo seksion, dhe gjendja e tyre ishte përmirësuar si rezultat i riparimeve dhe zëvendësimit të pajisjeve hidrosanitare me defekte.

Problemet lidhur me furnizimin me ujë ishin zgjidhur mbas hapjes dhe vënies në funksion të puseve gjithashtu dhe përmirësimit të furnizimit me detergjente të higjienës personale dhe materiale sanitare për pastrim të dhomave dhe tualeteve. Në të gjithë sektorët u pohua se dushi realizohej një herë në ditë dhe se nuk kishte mungesë të ujit të pijshëm apo të ngrohtë. Në çdo sektor kishte nga një dhomë të posaçme që shërbente si palestër, por mjetet e stërvitjes mungonin dhe të dënuarit i sajnin ato vetë me bidona uji (5-8 l). Në korridoret e përbashkëta kishte disa tavolina dhe karrige ku zhvilloheshin lojëra tavoline, si shah, domino dhe lojëra me letra. Në këtë I EVP ekzistonte një pavijon, i cili shërbente si qendër ambulatorie brenda institucionit me shërbim me shtretër, me personel shëndetësor. Spitali i këtij institucioni kishte 11 dhoma shtrimi, ku gjendeshin 10 vetë gjatë inspektimit. Dhoma e stomatologut kishte sterilizues, karrige dhe unit funksional. Sektori i Kujdesit të Veçantë kishte 13 dhoma dhe tualetet gjendeshin brenda në dhoma. Dhoma e vizitave të mjekut si dhe farmacia ishin në kushte të mira. Autoambulance nuk kishte, por institucioni kishte bashkëpunim me spitalin Rajonal Fier, duke qenë se ndodhej afër I EVP-së. Në I EVP Fier kishte një njësi tregtare për ofrimin e produkteve të ndryshme për të paraburgosurit dhe të dënuarit dhe ishte e afishuar lista e produkteve të ofruara. Pati ankesa lidhur me çmimin e lartë të produkteve ushqimore në këtë njësi tregtare. Kuzhina funksiononte në kushte normale pasi pajisjet e gatimit dhe sistemi i aspirimit ishin të standardeve industriale duke qenë se ishin vendosur së fundmi. Në I EVP Fier punonin 4 (katër) kuzhinierë dhe 10 të dënuar. Në kuzhinë ndodhej regjistri i normativave ushqimore dhe menyuja ditore ishte e afishuar. Regjistrat e kontrollit të ushqimit dhe të menisë së gatimit ishin të sekretuar dhe të protokolluar.

Kampionët e ushqimeve mbaheshin në kushte frigoriferike dhe të etiketuar sipas vakteve përkatëse, por ishin të hapur. Gjithashtu u konstatuan edhe racionet përkatëse më vete për të sëmurët diabetikë në këtë institucion, të cilët ishin 42 persona. Përgjithësisht, kushtet e përgatitjes së ushqimit në ambientet e kuzhinës të institucionit, rezultuan në gjendje të mirë. Megjithatë të dënuarit dhe të paraburgosurit shfaqën ankesa lidhur me cilësinë e ushqimit i cili nuk kishte larmishmëri. U evidentua se një masë e madhe e të burgosurve në I EVP Fier nuk e konsumojnë ushqimin e përgatitur në institucion, duke shpërdoruar një pjesë të konsiderueshme të tij. Mjaft të dënuar kanë pohuar se e merrnin ushqimin nga të afërmit e tyre dhe se nuk e konsumonin ushqimin e institucionit, për shkak se nuk e pëlqenin atë. Gjatë inspektimit u vu re se zhvilloheshin shumë pak aktivitete të përbashkëta. Në lidhje me ajrimin u konstatuan se ajrimi ditor zgjaste mbi 3 (tre) orë sipas rregullores dhe ky orar ishte edhe më i gjatë në periudhën e verës. Shumë prej të intervistuarve nëpër dhoma të pyetur për aktivitetet apo programet që ata marrin pjesë, kërkuan të kenë aktivitete të përbashkëta edukative ose sportive, dhe më shumë mjete dhe pajisje sportive. Është për tu theksuar se një ndër qëllimet e institucioneve të mbyllura penitenciare është riintegrimi në shoqëri i personave, në momentin kur do

të lënë burgun. Rregullorja Evropiane e Burgjeve parashikon se *“regjimi i ofruar për të gjithë të burgosurit përfshin një program të balancuar veprimtarish. Ky regjim u lejon të gjithë të burgosurve të kalojnë sa më shumë orë në ditë jashtë qelive të tyre, sipas nevojës për një nivel të përshtatshëm të ndërveprimit njerëzor dhe shoqëror”*¹⁸.

E drejta për të mbajtur kontakte me familjarët dhe miqtë zbatohet përgjithësisht sipas rregullores. Takimet realizoheshin mesatarisht rreth 4 herë në muaj, në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve. Takimi me familjarët zgjaste rreth 20 minuta. Trajnime profesionale në IEVP Fier kishte dhe ofroheshin për hidraulik, instalim panelesh diellore dhe anglisht në dy nivele.

Për sa i përket mbështetjes psiko-sociale që merrnin të burgosurit, gjatë takimit me stafin e sektorit të kujdesit psiko-social, u konstatua se aktivitetet që ofroheshin ishin të pakta dhe përbëheshin kryesisht nga diskutimet në grup për tema sociale, këshillime në ambientet e ajrimit, ose në dhomën e improvizuar të takimeve me avokatin kur ajo ishte e lirë, si dhe nga aktivitetet sportive. Gjatë vizitës në IEVP Fier si dhe nga intervistat me të dënuarit, problematikat u konstatuan lidhur me shërbimin shëndetësor. Ankesat konsistonin kryesisht në mungesat e medikamenteve, të cilat shpesh mbuloheshin me kontributet e sjelljes nga familja. Skema e furnizimit me ilaçe funksiononte vetëm për të sëmurët kronikë. Ndërsa për sa i përket shërbimit stomatologjik, ai kishte filluar të funksiononte së fundmi si rezultat i plotësimit të bazës materiale. Personeli i kujdesit mjekësor në IEVP Fier përbëhej nga 2(dy) mjekë, 1(një) farmacist, 1(një) stomatolog dhe 10(dhjetë) infermierë.

Një nga mjekët punonte me kohë të plotë dhe tjetri me kohë të pjesshme dhe si rezultat ishin shtuar numri i vizitave mjekësore si në IEVP Fier ashtu dhe ato të specializuara pranë Spitalit të Burgjeve dhe Spitalit Rajonal të Fierit. Gjithashtu dhe trajtimi akut i personave me probleme të shëndetit mendor bëhej në Spitalin e Burgjeve.

Dhoma e mjekut, farmacistit, apo infermierisë ishin të kompletuara. Dhoma e infermierisë ishte e vogël me kushte të mira higjiëno-sanitare dhe aty mbaheshin edhe një sasi e vogël ilaçesh për urgjencën. Në këtë institucion u vu re se mungonte ambulanca për të shoqëruar personat në spitalet përkatëse të vendit. Është për tu theksuar se Rregullorja Evropiane e Burgjeve shprehet se: *“Autoritetet e burgut ruajnë shëndetin e të gjithë të burgosurve që janë në kujdesin e tyre. Shërbimet mjekësore në burg organizohen në bashkëpunim të ngushtë me administrimin shëndetësor të komunitetit ose të shtetit. Të burgosurit i ofrohen shërbimet mjekësore, kirurgjike dhe psikiatrike, duke përfshirë dhe ato shërbime që janë të disponueshme në komunitet”*¹⁹. Në IEVP Fier u evidentua edhe 13(trembëdhjetë) të dënuar që vuanin nga probleme të shëndetit mendor dhe për rrjedhojë u konstatua se organet kompetente duhet të marrin të gjitha masat që shërbimi i kujdesit mjekësor ndaj tyre të përmbushë standardet e të jetë sa më eficient në funksion të shëndetit. Personat të cilët vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor, për shkak të sëmundjes së tyre, kanë nevojë për një vëmendje të veçantë, veçanërisht nga ekipi multidisiplinar i institucionit.

Në IEVP Fier kishte Sektor të Kujdesit të Veçantë në një kohë që për të dënuarit me probleme të shëndetit mendor duhet të tregohet kujdes i veçantë sa i takon përzgjedhjes së standardeve të dhomave ku do të qëndrojnë, ndaj higjiënës vetjake të tyre, si dhe të mjedisit që i rrethon. Të paraburgosurit dhe

¹⁸ Rregullorja e Evropiane e Burgjeve Pika25.1 dhe 25.2; <http://www.coe.int/t/DGHL/STANDARDSETTING/PRISONS/EPR/EPR-Albanian.pdf>

¹⁹ Rregullorja Evropiane e Burgjeve, pika 39, 40.1, 40.5;

të dënuarit ishin të pajisur me libreza shëndetësore. Skema e furnizimit dhe rimbursimit të ilaçeve në IEVP Fier sipas kontratës tre palëshe ISKSH, depo farmaceutike funksiononte vetëm për të sëmurët kronikë. Lidhur me këtë problematikë të sëmurëve akut blerja dhe sigurimi i ilaçeve sigurohej përkohësisht nga blerjet e drejtpërdrejta nga fondi i siguruar nga D.P.Burgjeve. Gjithashtu dhe blerjet e medikamenteve të urgjencës siguroheshin nga ky fond.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës, nenit 21, germa “b” të ligjit Nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, si dhe nenit 12, nenit 74/1 pika “b” të ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar

Rekomanduar: Marrjen e masave të menjëhershme për vënien në zbatim të skemës së furnizimit dhe rimbursimit të ilaçeve në IEVP Fier sipas kontratës tre palëshe ISKSH, depo farmaceutike edhe për të sëmurët akut; marrjen e masave për plotësimin e pozicionit të mjekut të dytë me kohë të plotë sipas parashikimeve në organikën e institucionit; marrjen e masave për shtimin e aktiviteteve dhe takimeve me të dënuarit dhe të paraburgosurit për qëllime rehabilitimi, këshillimi, ri-integrimi, si edhe aktivitete edukative e social-kulturore-sportive; marrjen e masave për shtimin e kurseve profesionale dhe të aktiviteteve mësimore dhe edukative në institucion; marrjen e masave për kontrollin e çmimeve dhe vendosjes së çmimeve të arsyeshme në njësi tregtare për ofrimin e produkteve të ndryshme për të paraburgosurit dhe të dënuarit; marrjen e masave për të përmirësuar cilësinë dhe larmishmërinë e ushqimit në IEVP Fier në shërbim të të dënuarve dhe të paraburgosurve duke shmangur shpërdorimin e tij në vijim; marrjen e masave për pajisjen e IEVP Fier me ambulancë për të shoqëruar personat në spitalet përkatëse të vendit.

5.5. IEVP KAVAJË

Inspektimi i ekspertëve të Mekanizmit Kombëtar në Institutin e të Miturve Kavajë për vitin 2019 u krye në përputhje me procedurën e monitorimit të Mekanizmit më datë 21.03.2019. Objektivi kryesor i këtij inspektimi ishte vlerësimi i kushteve të jetesës në këtë institucion dhe mënyrës së trajtimit të të paraburgosurve dhe të dënuarve që ndodhen në këtë institucion.

Instituti i të Miturve Kavajë funksionon që prej vitit 2009 si qendër rehabilitimi, këshillimi dhe shkolle për të miturit e moshës 14-18 vjeçare. Kapaciteti i institucionit është 40 persona, institucioni ishte i ndarë në 4 sektorë nga të cilët 3 sektorë shërbenin për të paraburgosurit dhe një sektor për të dënuarit. Në ditën e monitorimit 21.03.2019 në këtë institucion ndodheshin 32 persona, prej të cilëve 29 të paraburgosur dhe 3 të dënuar. Katër nga të paraburgosurit ishin me prapambetje të lehtë mendore, por pa terapi. Struktura organike e institucionit është e përbërë nga një numër prej 79 punonjësish.

Konkretisht, të ndarë 32 punonjës civil dhe 47 punonjës në Sektorin e Policisë.

Aktualisht ka 3 (tre) vende vakante: një punonjës civil në sektorin e çështjeve shoqërore dhe 2 (dy) punonjës policie të rolit bazë, aktualisht janë 76 punonjës. Gjatë vizitës monitoruese grupi i ekspertëve vizitoi dhe kontaktoi me të paraburgosurit dhe të dënuarit në të gjitha ambientet e institucionit. Në lidhje me respektimin e të drejtave të tyre, si ajrimi, takimi me familjarët, telefonatat, servirja e ushqimit, të paraburgosurit dhe të dënuarit nuk paraqitën ankesa.

Institucioni ishte pajisur me një njësi kompjuterike, në ambientin e komisionit të pritjes në regjim të brendshëm i cili ju mundësonte të miturve të kryenin video-konferencë prej 1 (një) ore me skype me familjen, kjo risi nga ana e institucionit ishte pritur shume mirë nga të dënuarit e mitur pasi ju mundësonte të komunikonin me familjet që ishin larg dhe nuk kishin mundësi financiare ti vizitonin ata për çdo javë.

Gjithashtu një nga qëllimet e inspektimit ishte edhe identifikimi i rasteve të ushtrimit të torturës, të dhunës fizike ose psikologjike, apo të përdorimit të forcës fizike tej kufijve të parashikuar nga aktet normative në fuqi ndaj kësaj kategorie personash, si edhe të rasteve të marrjes së masave disiplinore ndaj tyre. Nga informacioni i marrë gjatë bisedave konfidenciale dhe intervistave të bëra me të dënuarit/paraburgosurit rezultoi se nuk kishte raste torture, të dhunimit fizik ose psikologjik apo të përdorimit të tepruar të forcës fizike ndaj tyre nga personeli i sigurisë dhe ai civil që shërben në këtë institucion.

Në Institutin e të Miturve në datën e inspektimit kishte 10 persona të punësuar të moshës 16-18 vjeç. Përkatesisht, funksionet janë 3 (tre) pastrues, 2 (dy) punonjës workshop-i, 2 (dy) lulishtarë, 1 (një) punonjës biblioteke, 1 (një) disenjator, 1 (një) berber. Me të punësuarit nuk ishin lidhur kontrata pune nga administrata e institucionit dhe ata nuk ishin të siguar dhe nuk shpërbleheshin për punën që bënin. Ky problem vazhdon të ngelet një shqetësim në këtë institucion sikurse edhe në të gjitha IEVP-të në shkallë vendi. Të dënuarit e punësuar përfitonin ulje dënimi në masën 3.9 ditë në muaj. Ky veprim bëhej nga administrata e institucionit dhe bazohej në Dekretin e Presidiumit të Kuvendit Popullor të Republikës Socialiste të Shqipërisë nr. 7298, datë 08.04.1989. Të paraburgosurit realizonin ajrimin dhe aktivitete të tjera të përbashkëta, të paraburgosur dhe të dënuar.

Grupi monitorues konstatoi se procedura e pranimit në institucion zbatohet në mënyrë korrekte. Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacionit rezultoi se veprimet regjistroheshin në regjistrin përkatës dhe protokolloheshin. Regjistrat mbaheshin nga Sektori i Edukimit.

Regjistri i kërkesë/ankesave i mbajtur nga stafi i edukimit ishte i rregullt dhe me informacionin e duhur. Të paraburgosurit dhe të dënuarit në këtë institut, plotësonin një formular kërkesë/ankese dhe ia dorëzonin më pas edukatorit në zarf ose jo. Ky i fundit i dërgonte në protokollin e institucionit. Pas protokollimit ia kalonin drejtorit të institucionit, i cili kthente përgjigje me shkrim, apo i takonte të miturit, sipas legjislacionit në fuqi.

Telefonat e vendosur në ambientet e regjimit funksiononin dhe të dënuarit/paraburgosurit e intervistuar, pohuan se mund të flisnin me të afërmit e tyre sa herë të dëshironin nëpërmjet telefonave të vendosur nga institucioni me shpenzimet e institutit.

Kontakti me botën e jashtme ishte i garantuar. Të miturit mund të takoheshin me familjarët e tyre sipas rregullores në fuqi dhe me kërkesën e të miturve miratoheshin edhe takime shtesë. Takimet me familjarët zhvilloheshin në dy ambiente takimi, si dhe në një dhomë prindërimi në distancë. Takimi bëhej duke pasur mundësinë e kontaktit fizik me njëri-tjetrin dhe të ulur rreth një tavoline. Këto ambiente krijonin një atmosferë miqësore, e cila është shumë e nevojshme për këtë kategori personash. Ambientet e institucionit monitoroheshin me kamera për 24 orë dhe filmimi ruhej për 20 ditë. Nga inspektimi u konstatua se mbulimi me kamera nuk ishte i plotë, sepse kishte ambiente që nuk ishin vendosur kamera apo ato nuk i mbulonin në mënyrë të plotë hapësirat e tyre, sikurse mund të

përmendim, ambienti i kurseve profesionale të punës me dru dhe korridori, kuzhina, korridori i hyrjes në regjimin e brendshëm dhe shkallët për në katin e dytë, ndërsa holli i madh i regjimit të brendshëm kishte vetëm dy kamera të cilat nuk e mbulonin plotësisht hapësirën e tij. Kjo e konstatuar nga Inspektimi i një viti më parë nga Institucionit të Avokatit të Popullit, ku rekomandohet pajisja e të gjitha ambienteve me monitorim me kamera. Të paraburgosurve dhe të dënuarve ju ofrohej asistencë ligjore nga personeli i institucionit lidhur me kërkesat e tyre drejtuar organeve të gjykatës, etj.

Nga inspektimi i bërë në të gjitha ambientet e këtij institucioni u konstatua se dhomat e banimit kishin hapësirën e nevojshme dhe dritare që lejonin futjen e dritës natyrale dhe ajrosjen e mirë të tyre. Ato ishin të pajisura me orenditë e nevojshme, si krevate, dyshekë, mbulesa, tavolina karrige e dollap për rrobat. Ndryshe nga një vit më parë ku dyshekët ishin të amortizuar ata ishin zëvendësuar nga institucioni me dyshekë të rinj dhe batanije të reja. Tualetet ishin të vendosura brenda dhomave, por ato nuk kishin aspiratorë për ajrosje, sepse nuk ishin vendosur nga subjekti ndërtues. Holli i regjimit të brendshëm dhe dhoma ishin të lyra të pastra dhe të rregullta. Godina ishte e pajisur me sistem për ngrohje qendrore me kaldajë, por në ditët e ftohta institucioni kishte siguruar ngrohëse shtesë për ngrohjen e dhomave të dënimit. Dushet ishin të përbashkëta dhe çdo sektor ishte i pajisur me tre poste, në 4 ambientet e dusheve, 12 dushe ishin funksionale. Muret e këtyre ambienteve ishin lyera dhe pa praninë e lagështirës ndryshe nga një vit më parë kur Institucioni i Avokatit të Popullit rekomandonte, eliminimin e lagështirës në ambientet e dusheve dhe vënien në funksion të lavamanëve. Lavamanët ishin të pastër dhe në funksion ndryshe nga një vit më parë kur këta lavamanë ishin jashtë funksionit. Në këtë institucion kishte 4 ambiente ajrimi dhe një palestër të pajisur me veglat e nevojshme për tu ushtruar dhe dy tavolina pingpongu. Në regjimin e brendshëm ishte edhe një fushë futbollit, e cila ishte e shtruar me beton. Për shkak të amortizimit të betonit zhvillimi i aktiviteteve në këtë fushë ishte me rrezik, sepse të miturit mund të dëmtoheshin në rast rrëzimi.

Mësimi zhvillohej në 4 klasa kolektive të cilat ishin të pajisura me tavolina, karrige, stola, dërrasë të zezë, harta dhe kompjutera. Biblioteka ishte e pasur me libra e literaturë, si dhe kishte kartela anëtarësie. Në ambientet e jashtme si edhe të brendshme të institutit ishin afishuar të drejtat dhe detyrimet e të dënuarve, numrat e institucionit të Avokatit të Popullit dhe shoqatave për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Në institucion ishin dy ambiente kulti fetar ku të miturit mund të zhvillonin ritet fetare. Nga vizita në kuzhinën e institucionit u konstatua se ajo ishte e pastër dhe e pajisur me orenditë e nevojshme. Në kuzhinë ishin punësuar 3 punonjës, të cilët ishin të pajisur me librezë shëndetësore dhe kishin veshur kapuçë dhe doreza. Menyja e përditshme dhe gramaturat ishin afishuar konform rregullave, kampionët e ushqimit ruheshin në kushte frigoriferike për 24 orë, por u konstatua që ato nuk ishin të emërtuara sipas vakteve të ushqimit. Nga prova që u bë ushqimit u konstatua se ai ishte i një cilësie të kënaqshme. Të dënuarit dhe të paraburgosurit informuan se e konsumonin ushqimin e përgatitur aty, por disa prej tyre, si dhe punonjësit e institucionit u shprehën se sasia e ushqimit nuk ishte e mjaftueshme dhe se ajo duhej shtuar. Për këtë Institucioni i është drejtuar me një shkresë drejtorisë së përgjithshme të burgjeve me Nr1010 Prot dt.26.11.2018 ku kërkohet të merret parasysht kërkesa e të paraburgosurve/dënuarve për shtimin e normatives ushqimore ditore me gjysmë racioni më shumë të çdo produkti ushqimor ,për çdo të burgosur të mitur. Lavanderia ishte e pajisur me makinë larëse dhe ambient tharjeje. Megjithatë u konstatua se disa prej tyre rrobat personale i dërgonin për larje në familje. Dezinfektimi i ambienteve të institucionit ishte bërë në vitin 2018 dhe

nuk u konstatua prania e insekteve. Të paraburgosurve dhe të dënuarve iu jepeshin detergjentët e nevojshëm sipas normës të paracaktuar për çdo muaj. Uji i rrjedhshëm sigurohej 24 orë nga pusi, institucioni ishte pajisur me një filtrues uji gjë që e bënte atë të pastër dhe të pijshëm kjo e vërtetuar edhe nga analizat për kontrollin e cilësisë së ujit. Ndryshe nga një vit më parë ku uji ishte i papijshëm dhe të miturit detyroheshin ta blinin atë. Ne këtë institucion nuk funksiononte njësi tregtare sepse subjektet private nuk paraqisnin interes për shkak të numrin të vogël të personave që trajtohen në të. Në Institucionin e të Miturve ofroheshin disa aktivitete, si arsimit i detyrueshëm 9-vjeçar nga klasa e parë deri në klasën e nëntë. Mësuesit vinin nga Shkolla 9-vjeçare “Rilindja” e qytetit Kavajë, sipas marrëveshjes të lidhur ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Drejtësisë. Provimet e lirimit nxënësit i jepnin në Shkollë Publike në qytetin e Kavajës. Ndërsa arsimit i mesëm nuk zhvillohej. Në këtë institucion zhvilloheshin 4 kurse profesionale për elektrikistë, hidraulikë, saldatorë dhe të punës me dru, të organizuara në bashkëpunim me Qendrën e Formimit Profesional Durrës. Në përfundim të kurseve profesionale jepeshin certifikata.

Ajrimi i të miturve të paraburgosur dhe të dënuar bëhej konform rregullave në katër ambientet e ajrimit të institucionit. Ata nuk paraqitën ankesa lidhur me oraret e ajrimit, të cilat ishin konform standardeve dhe rregullores së institucionit. Stafi i kujdesit social ishte i paplotësuar në përbërje të tij kishte punonjës socialë dhe një psikolog i komanduar. Theksojmë se nevoja për psikolog me kohë të plotë në këtë institut është një emergjencë pasi institucioni i të miturve për vet nga natyra e trajtimit të moshës 14-18 vjeç ka problematika psikosociale. Ambientet e mbyllura apo “izolimi” i tyre në një vend, kur pjesën më të madhe të kohës duhet ta zenë programet e ndryshme mësimore, sociale e psikologjike për ti ardhur në ndihme mino rënëve dhe veçanërisht të mos përsërisin ato vepra penale për të cilat duhet të vuajnë dënimin. Punonjësit e këtij sektori kryenin aktivitetet sipas programit të miratuar më parë me një plan 1 mujor. Për sa i përket aktiviteteve edukuese e rehabilituese në këtë institucion, nga ana e ekspertëve të Mekanizmit Kombëtar u konstatua se ato ishin të larmishme nga të cilat mund të përfitonin të dënuarit/paraburgosurit, si ndjekja e TV në dhomat e banimit ose në holle, lojërat e tavolinës, ushtrime në palestër, luanin pingpong, futboll, etj. Gjithashtu kishte edhe një ambient pikture për ushtrimin e atyre personave që kishin prirje në këtë fushë. Në këtë institucion zhvilloheshin aktivitete dhe rite fetare. Drejtuesit e institucionit bashkëpunonin me organizata dhe shoqata të ndryshme, të cilat vinin për predikim dhe zhvillonin aktivitete të ndryshme fetare.

Organika e stafit të këtij sektori përbëhej nga 1 mjek, përgjatë inspektimit konstatuam se në institut kishte vetëm një mjek me kohë të pjesshme, 1 stomatolog, 4 ndihmësmjekë dhe 1 ndihmësmjek/farmacist.

Dhoma e vizitave mjekësore ishte e pajisur me orenditë e domosdoshme dhe ishte me kushte fizike të mira. Dhoma e stomatologut kishte disa probleme, si mungonte autoklava, ndërsa poltroni i dentistit nuk ishte në funksion të plotë. Stomatologu kryente disa shërbime si vizita, mjekime dhe mbushje. Farmacia ishte e rregullt dhe furnizimi me medikamente bëhej nga DPB dhe Drejtoria e ISKSH sipas marrëveshjes tre palëshe të lidhur ndërmjet ISKSH-së, IEVP-ve dhe Depos Farmaceutike, si dhe nga fondi i veçantë për ilaçet që nuk vinin nga dy burimet e para. Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor e në veçanti të dokumentacionit të mjekut rezultoi se regjistrat përkatës mbaheshin dhe

plotësoheshin konform rregullave. Gjithashtu edhe kartelat mjekësore ishin të plotësuara dhe mbaheshin të mbyllura në dollap me dry.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës, nenit 21, germa “b” të ligjit Nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, si dhe nenit 12, nenit 74/1 pika “b” të ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar

Rekomanduum: Marrjen e masave për aktivizimin e bashkëpunimit me DAR Kavajë për sigurimin e funksionimit të shkollës së nivelit të mesëm për vitin mësimor 2018-2019, për të miturit që kanë mbaruar shkollën 9-vjeçare; marrjen e masave të nevojshme për riparimin e fushës së futbollit duke e bërë atë funksionale; marrjen e masave për pajisjen e dhomës së stomatologut me autoklavë dhe riparimin e poltronit; marrjen e masave të nevojshme për të siguruar monitorimin e plotë me kamera të ambienteve të këtij institucioni të cilat nuk monitorohen aktualisht; marrjen e masave për futjen në organike të një Mjeku me kohë të plotë; marrjen e masave për futjen në organikë të një psikologu me kohë të plotë si një emergjencë duke marrë parasysht natyrën e institucionit i cili shërben si qendër rehabilitimi, këshillimi dhe shkolle për të miturit e moshës 14-18 vjeçare; marrjen e masave të nevojshme për rritjen e gramaturës së ushqimit për të paraburgosurit dhe të dënuarit që trajtohen në këtë institucion; marrjen e masave për plotësimin e organikes së punonjësve të policisë të rolit bazë’ marrjen e masave për Kampionët e ushqimit që ruhen në kushte frigoriferike, të emërtohen sipas vakteve të ushqimit duke plotësuar standardet e parashikuara në rregullore; marrjen e masave të nevojshme për riparimin e ashensorit në regjimin e brendshëm.

5.6. IEVP KORÇË

Gjatë vizitës në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Korçë 23.09.2019, sipas një Plani Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit.. Ky institucion ka një kapacitet maksimal të miratuar **prej 382 personash**. Në ditën e inspektimit, në mjediset e institucionit ishin 375 persona, nga të cilët 124 të paraburgosur dhe 244 të dënuar. Në seksionin e sigurisë së lartë ndodheshin 54 persona ndërsa në seksionin e sigurisë së zakonshme gjendeshin 190 persona. Ndërkohë 5 (pesë) persona ndodheshin me masë mbikëqyrjeje të veçantë si dhe 2 (dy) persona ishin në kujdesin spitalor jashtë institucionit. Seksioni i sigurisë së lartë kishte 4 (katër) sektorë me një total prej 34 dhomash dhe 68 shtretër si dhe 4 klasa dhe 4 magazina. Seksioni i paraburgimit kishte 4 (katër) sektorë me një total prej 34 dhomash dhe 164 shtretër si dhe 4 klasa dhe 4 magazina. Seksioni i sigurisë së zakonshme kishte një total prej 44 dhomash dhe 257 shtretër si dhe 4 klasa dhe 4 magazina. Sektori i observimit kishte 6 dhoma dhe 12 shtretër. Sektori i izolimit kishte 10 dhoma dhe 10 shtretër. Në total IEVP Korçë dispononte 531 shtretër. Në institucion nuk kishte asnjë person që kishte shtrat të improvizuar në tokë. Struktura dhe organika e “IEVP” Korçë, ishte e miratuar me Urdhrin Nr.58 datë 24.04.2017 të Kryeministrit, “*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe institucioneve të varësisë së saj*” dhe përbëhej nga 273 punonjës nga të cilët 41 ishin punonjës të administratës civile dhe 232 ishin punonjës të policisë së burgjeve. Aktualisht organika e punonjësve të policisë të rolit bazë ishte e paplotësuar pasi mungonin 10 punonjës dhe organika e punonjësve të policisë së rolit

drejtues ishte e plotësuar. Gjithashtu nuk ishte i plotësuar pozicioni i mjekut me kohë të plotë dhe funksiononte me 2 mjekë me kohë të pjesshme nga të cilët njëri ishte mjek psikiatër dhe tjetri mjek i përgjithshëm. Gjatë takimit me Shefin e Policisë së “IEVP” Korçë, Z. Agim Tafaj grupi inspektues, kërkoi fillimisht informacion në lidhje me të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve/paraburgosurve, mënyrën e trajtimit nga ana e institucionit të problematikave të ndeshura në inspektimin e mëparshëm, si dhe verifikimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të bëra nga Institucioni i Avokatit të Popullit një vit më parë. Nga ana e Shefit të Policisë së “IEVP” Korçë, Z. Agim Tafaj, ekspertëve iu bë me dije se në bazë të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë Nr. 329, datë 15.01.2009, “Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”, i ndryshuar, IEVP Korçë është kategorizuar si burg i sigurisë së lartë, i cili është parashikuar edhe me një seksion sigurie të zakonshme, një seksion paraburgimi dhe një seksion paraburgimi për të mitur. Sipas të dhënave që u morën gjatë kësaj vizite, informacioneve të marra nëpërmjet intervistave konfidenciale me personat e privuar nga liria, si dhe bisedat me stafin e institucionit, rezultoi se: Ishte plotësuar rekomandimi për marrjen e masave të menjëhershme për reduktimin e mbipopullimit në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Korçë. Ishte plotësuar pjesërisht rekomandimi për marrjen e masave të menjëhershme për riparime, mirëmbajtje, eliminim lagështire dhe lyerjen e dhomave të paraburgimit në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Korçë. Ishte plotësuar rekomandimi për marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të pjesshme. Ishte plotësuar rekomandimi për marrjen e masave të menjëhershme për vënien në zbatim të skemës së furnizimit dhe rimbursimit të ilaçeve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Korçë sipas kontratës tre palëshe ISKSH, depo farmaceutike. Ishte plotësuar rekomandimi për marrjen e masave të menjëhershme për furnizimin me materialet e nevojshme dentare për ofrimin e një shërbimi të plotë dhe adekuat stomatologjik. Ishte plotësuar rekomandimi për marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen e sektorit shëndetësor me regjistrin për evidentimin e rasteve të dhunës. Ishte plotësuar rekomandimi për marrjen e masave për plotësimin e organikës së punonjësve të policisë të rolit drejtues. Ishte plotësuar pjesërisht rekomandimi për marrjen e masave për riparimet e nevojshme të ambienteve të dusheve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Korçë.

Ndërkohë që një pjesë e rekomandimeve të paraqitura nga Avokati i Popullit një vit më parë nuk kishin gjetur zbatim dhe nuk ishin plotësuar. Më konkretisht: Nuk ishte plotësuar rekomandimi për marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin me ngrohje të përshtatshme të dhomave të të dënuarve dhe të paraburgosurve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Korçë për t’iu përshtatur kushteve klimaterike. Nuk ishte plotësuar rekomandimi për marrjen e masave për pajisjen e IEVP Korçë me ambulancë për të shoqëruar personat në spitalet përkatëse të vendit. Nuk ishte plotësuar rekomandimi për marrjen e masave për punësimin e mjekut me kohë të plotë sipas parashikimeve në organikën e institucionit. Nuk ishte plotësuar rekomandimi për marrjen e masave për shtimin e aktiviteteve dhe takimeve me të dënuarit për qëllime rehabilitimi, këshillimi, ri-integrimi, si edhe aktivitete edukative e social-kulturore-sportive. Nuk ishte plotësuar rekomandimi për marrjen e masave për plotësimin e organikës së punonjësve të policisë të rolit bazë. Grupi i monitorimit pati për objektiv të punës së tij mbledhjen e informacionit lidhur me trajtimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve, identifikimin e rasteve të përdorimit të forcës fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative apo të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie, si edhe të rasteve të marrjes së masave

disiplinore. Ankesa kishte edhe për numrin e kufizuar të aktiviteteve rekreative në “IEVP” Korçë. Të dënuarit dhe të paraburgosurit e konsideronin shërbimi mjekësor në këtë institucion jo në nivelin e duhur dhe nuk ofrohej në kohë dhe në cilësi. Në ditën e monitorimit në ambientet e izolimit ndodheshin 5 (pesë) persona me masë disiplinore, në përputhje me procedurat mbi zbatueshmërinë e ekzekutimit të tyre. Gjatë intervistimit të tyre të dënuarit nuk shfaqën asnjë pretendim lidhur me ushtrim dhune. Gjendja e tyre shëndetësore ishte konfirmuar nga mjeku i institucionit. Institucioni kishte 10 ambiente izolimi. Lidhur me kushtet në këto ambiente ishin bërë disa ndryshime duke filluar nga lyerja e tyre dhe deri tek pajisja e të dënuarve me mjetet për mbajtjen e higjienës vetjake. Të paraburgosurit/dënuarit plotësonin një formular kërkesë/ankese dhe ia dorëzonin më pas punonjësit të sektorit psiko-social. Punonjësi i dërgonte në sekretarinë e institucionit ku protokolloheshin dhe pastaj i kalonin drejtorit të institucionit, i cili kthente përgjigje me shkrim apo i takonte vetë të dënuarit ose punonjësit e institucionit zhvillonin takimet sipas rasteve. Brenda në regjim kishte kuti postare ku mund të hidheshin ankesat/kërkesat. Sa i takon objektit të këtyre kërkesave na rezultoi se konsistonin në kërkimin për leje shpërblyese, takime me familjarë, kërkesë për dinamikën e vuajtjes së dënimit, kërkesë për takim me avokatë, vizitë në spital, transferim, punësim ose kërkesë për blerjen e pajisjeve si TV ose frigorifer. Të paraburgosurit ishin në seksion më vete nga të dënuarit. Ata realizonin ajrimin dhe aktivitetet e tjera të përbashkëta veçmas nga të dënuarit. Përsa i përket të miturve, u konstatua se nuk kishte të tillë.

Sistemi i monitorimit me kamera vëzhgimi ishte funksional. Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Korçë kamerat monitoronin pjesën më të madhe të mjediseve për 24 orë, ndërkohë që të dhënat ruheshin në server për një periudhë 40 ditore. Theksojmë se mbikëqyrja me kamera e të gjitha mjediseve në IEVP, përveç atyre mjediseve ku cenohet privatësia, është vlerësuar nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit në vitin 2019 si një proces thelbësor për tre arsye:

Nga monitorimi u konstatua se telefonat punonin në çdo kohë dhe të dënuarit apo të paraburgosurit e intervistuar, pohuan se mund të flisnin sa herë të dëshironin me të afërmit e tyre nëpërmjet telefonave me kartë që ndodheshin në mjedisin e regjimit. Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Korçë ishte krijuar një mjedis i veçantë për të paraburgosurit/dënuarit që kishin fëmijë të vegjël lidhur me ushtrimin e të drejtës së prindërimit në distancë. Gjithashtu këtu ata takoheshin pa barriera apo kufizime fizike. Kjo dhomë ishte e pajisur me tavolinë dhe karrige, ku të dënuarit/paraburgosurit qëndronin ulur, duke patur kontakt fizik me fëmijët e tyre. Gjatë takimeve respektohej privatësia. Gjithashtu në këtë institucion kishte edhe 2 dhoma për takime speciale të të dënuarve me bashkëshortet apo bashkëjetueset e tyre. Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Korçë kishte disa të dënuar që punonin kryesisht si pastrues, sanitarë, shpërndarës ushqimi etj. Nga takimi i grupit inspektues më të dënuarit që punonin brenda institucionit këta të fundit u shprehën të kënaqur për kushtet e trajtimit dhe e konsideronin me rëndësi faktin që e kalonin një pjesë të mirë të kohës duke shërbyer dhe duke patur një dinamikë të ndryshme nga qëndrimi në dhomë. Grupi i monitorimit, në fokus të vizitës së tij pati edhe monitorimin e kushteve materiale, të rëndësishme për respektimin e standardeve normale të jetesës. IEVP Korçë është një institucion i vënë në funksion gjatë vitit 2008. Infrastruktura e përgjithshme e institucionit ishte e mirë me ndarje të rregullta të godinave dhe ofronte funksionalitet në lëvizje dhe në elementë të sigurisë. Nisur nga situata e disa prej dhomave edhe hapësira në disa raste, ishte e kufizuar. Për sa i përket dritës dhe ajrit,

megjithëse shumica e dhomave ishin të vogla në kubaturë, por nuk mungonte ajri dhe drita natyrale. Ndërkohë edhe çështja e ngrohjes së ambienteve për shkak të kushteve klimaterike kishte problematikë lidhur me oraret që aplikoheshin paçka se akoma nuk kishte filluar stina e ftohtë në mënyrë që të evidentoheshin konkretisht situata. Fakti që nga inspektimi i vitit 2018 kjo situatë ishte evidentuar si problematike dhe nisur dhe nga mungesa e investimit të dukshëm në këtë drejtim në vitin 2019 konstatohet se çështja e ngrohjes do të jetë serish një moment delikat për nevojë ndërhyrjeje me qëllimin e krijimit të kushteve sa më të favorshme në shërbim të të dënuarve dhe të paraburgosurve. Cilësia e ujit në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Korçë nuk ishte e mirë dhe furnizimi me ujë kishte probleme. Furnizimi me ujë nuk kryhej 24 orë në ditë por kryhej me orar përmes dy puseve, pasi nuk ekzistonte lidhja me rrjetin. Në disa dhoma ishin vendosur aparatura shtesë për ngrohjen e ujit në lavamanët e brendshëm pasi uji përgjithësisht vinte i ftohtë. Shumica e të intervistuarve pohuan se e blinin ujin e pijshëm, pasi uji prej rubinetit ishte jo i pastër dhe nuk mund të pihesh, veçanërisht në ditët me shi. Takimet me familjarët në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Korçë zhvilloheshin rregullisht. Në ambientet e takimeve, gjendeshin 7 sportele xhami të mirëmbajtura, ku familjarët zhvillonin biseda me të dënuarit/paraburgosurit. Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Korçë ekzistonte një godinë e cila shërbente si spitali i këtij institucioni. Në katin e parë të tij gjendej dhoma e stomatologut, dhoma e vizitave të mjekut, si dhe farmacia. Dhoma e stomatologut ishte e pajisur me karrige dhe sterilizues. Në këtë institucion punonte një stomatolog. Dhoma e mjekut dhe farmacia ishin të lyera dhe të mirëmbajtura. Ndërsa në katin e dytë ishin 8 dhoma me shtretër, ku në dy prej tyre ishin shpërndarë të miturit dhe në dhomat e tjera ishin vendosur të sëmurët me sëmundje të rënda. Në spital ndodheshin banjat me dy tualete dhe një post dushi. Seksioni i sigurisë së zakonshme ishte i vendosur në godinën B. Kjo godinë ishte e përbërë nga dy kate me nga katër sektorë për çdo kat. Në dhoma ishin akomoduar 3-4 persona, në maksimum të kapacitetit. Ky rast përbën shkelje të standardit ligjor lidhur me sipërfaqen dhe kubaturën e banimit për një person²⁰, si dhe është në kundërshtim me rekomandimet e bëra nga CPT për Shqipërinë.²¹ Seksioni i sigurisë së lartë në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Korçë ishte i vendosur në sektorin A. Ky seksion ishte i ndarë në 4 sektorë për të dënuar me siguri të lartë, dhe 4 sektorë për të paraburgosur siguri e lartë. Kryesisht kati i parë i sektorit të të dënuarve kishte një shpërndarje nëpër dhoma me nga një të dënuar. Dhomat ishin të pajisura me tualete brenda. Sektori i observimit në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Korçë kishte 6 dhoma dhe 12 shtretër. Në këtë sektor gjendeshin 2(dy) tualete të përbashkëta për të gjitha dhomat. Problematike ishte çështja e kryerjes së dusheve jashtë kësaj godine, dhe se nuk kishte hapësirë për ajrosje. Në sektorin e izolimit kishte 10 dhoma të pajisura me tualete brenda. Ky seksion kishte ambient ajrimi. Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Korçë kishte palestra,

²⁰ Shiko nenin 30 pika 1 e VKM nr. 437, datë 20.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve".

²¹ Albania: Visit 1997 [par.127] Komiteti për Parandalimin e Torturës (CPT) pranë Këshillit të Europës me rastin e vizitës në Shqipëri, në vitin 1997, i ka rekomanduar autoriteteve Shqiptare:

"Të dënuarit/paraburgosurit të akomodohen në dhoma jo me pak se 22 m² në rastet kur vendosen 6 veta në dhomë dhe 10 m² në rastet kur vendosen 2 veta në dhomë. Gjithashtu, dhomat më të vogla se 6 m² nuk plotësojnë standardet minimale për një dhomë burgu dhe duhet të nxirren jashtë shërbimi.

klasa dhe dhoma këshillimi. Kishte një sallë kompjuterësh dhe të gjithë kompjuterët ishin në gjendje funksionale. Palestirat ishin pajisur me mjete të sjella nga vetë të dënuarit. Aktivitetet sportive konsistonin kryesisht në futboll, volejboll dhe lojëra tavoline siç janë lojëra me letra dhe domino. Ambienti i kultit ishte i bollshëm, i ndriçuar dhe i mirëpajisur.

Kuzhina e institucionit ishte e madhe dhe moderne, me higjienë të mirë. Kishte edhe 2(dy) paradhoma ku njëra shërbente si magazinë për ushqimet dhe një tjetër për larjen e enëve. Kuzhina funksiononte në kushte normale pasi pajisjet e gatimit dhe sistemi i aspirimit ishin të standardeve industriale. Në kuzhinë ndodhej regjistri i normativave ushqimore dhe menyuja ditore ishte e afishuar.

Kampionët e ushqimeve mbaheshin në kushte frigoriferike dhe të etiketuar sipas vakteve përkatëse. Gjithashtu u konstatuan edhe racionet përkatëse për të sëmurët diabetikë në këtë institucion. Përgjithësisht, kushtet e përgatitjes së ushqimit në ambientet e kuzhinës të institucionit, rezultuan në gjendje të mirë. Megjithatë të dënuarit dhe të paraburgosurit shfaqën ankesa lidhur me cilësinë e ushqimit i cili nuk kishte larmishmëri. U evidentua se një masë e madhe e të burgosurve dhe të paraburgosurve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Korçë nuk konsumonin ushqimin e përgatitur në institucion, duke shpërdoruar një pjesë të konsiderueshme të tij. Mjaft të dënuar kanë pohuar se e merrnin ushqimin nga të afërmit e tyre dhe se nuk konsumonin ushqimin e institucionit, për shkak se nuk e pëlqenin atë. Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Korçë larja në dushe zhvillohej mesatarisht një deri në dy herë në javë. Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Korçë kishte lavanderi, ku gjendeshin dy lavatriçe por për shkak të fluksit të madh dhe kërkesës për këtë shërbim nuk arrihej të plotësoheshin nevojat e të gjithë të dënuarve dhe të paraburgosurve. Për përvoja të përket larjes së rrobave të fjetjes ato vazhdonin të laheshin nga familjarët në pjesën më të madhe të rasteve ose nga vetë të dënuarit brenda ambienteve të tyre. Në lidhje me ajrimin u konstatuan se ajrimi ditor zgjaste mbi 3 (tre) orë sipas rregullores dhe ky orar ishte edhe më i gjatë në periudhën e verës. Shumë prej të intervistuarve nëpër dhoma të pyetur për aktivitetet apo programet që ata marrin pjesë kërkuan të kenë më shumë aktivitete të përbashkëta edukative ose sportive, dhe më shumë mjete dhe pajisje sportive.

Trajnime profesionale në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Korçë nuk zhvilloheshin megjithëse në këtë njësi administrative kishte shërbime të tilla të ofruara nga Qendra Rajonale e Formimit Profesional në Korçë.

Librat që gjendeshin në inventarin e bibliotekës vireshin në dispozicion të paraburgosurve apo të dënuarve për lexim sipas kërkesave. Të paraburgosurit dhe të dënuarit e regjistruar kishin nga një kartelë personale dhe nëpërmjet saj tërhiqnin dhe dorëzonin librat.

Salla e kompjuterëve përdorej për organizimin e temave ndryshme nga sektori psiko-social. Në këtë institucion kishte 2 mësues të cilët mbulonin procesin arsimor çdo ditë të javës. Në këtë institucion ofrohej edhe mësimi nga mësues të shkollës tetë vjeçare dhe në këtë kurs merrnin pjesë 36 persona.

Sa i takon veprimtarive rikrijuese, u vërejt se në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Korçë ato që zhvilloheshin më së shumti ishin lojërat e tavolinës, pasi personat mund të luajnë edhe në dhomën e tyre, ose edhe në ambientet e ajrimit (*lojëra me letra, domino dhe shah*).

Skema e rimbursimit të ilaçeve funksiononte për të dënuarit, dhe për të paraburgosurit, si rrjedhojë e plotësimit të dokumentacionit të dosjeve personale për të bërë të mundur sigurimin e ilaçeve.

Ndërsa për sa i përket shërbimit stomatologjik, ai funksiononte si rrjedhojë e pasjes së bazës materiale dhe gjithashtu uniti dentar punonte normalisht.

Personeli i kujdesit mjekësor në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Korçë përbëhej nga 2 (dy) mjekë, me kohë të pjesshme (1 mjek psikiatër dhe 1 mjek i përgjithshëm) 1(një) farmacist, 1(një) stomatolog dhe 6 (gjashtë) ndihmës mjekë.

Mjekët aktualë punonin me kohë të pjesshme në këtë institucion dhe vizitat mjekësore kryheshin si në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Korçë ashtu dhe ato të specializuara pranë Spitalit të Burgjeve dhe Spitalit Rajonal të Korçës.

Dhoma e mjekut, farmacistit, apo infermierisë ishin përgjithësisht në gjendje të mirë. Dhoma e infermierisë, farmacia dhe dhoma e stomatologut ishin me kushte të mira higjiëno-sanitare. Në një institucion u vu re se mungonte ambulanca për të shoqëruar personat në spitalet përkatëse të vendit. Të paraburgosurit dhe të dënuarit ishin të pajisur me librezë shëndetësore. Skema e furnizimit dhe rimbursimit të ilaçeve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Korçë sipas kontratës tre paleshe ISKSH, depo farmaceutike funksiononte. Blerja dhe sigurimi i ilaçeve sigurohej edhe nga blerjet e drejtpërdrejta nga fondi i siguruar nga D.P.Burgjeve. Gjithashtu dhe blerjet e medikamenteve të urgjencës siguroheshin nga ky fond.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës, nenit 21, germa “b” të ligjit Nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, si dhe nenit 12, nenit 74/1 pika “b” të ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar

Rekomanduum: Marrjen e masave të menjëhershme për riparime, mirëmbajtje, eliminim lagështire dhe lyerjen e dhomave të paraburgimit në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Korçë; marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin me ngrohje të përshtatshme të dhomave të të dënuarve dhe të paraburgosurve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Korçë për t’iu përshtatur kushteve klimaterike; marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e ambienteve të përbashkëta të jetesës duke kryer sa më parë riparimet e nevojshme të tualeteve të përbashkëta në sektorë, riparimin e tubacioneve dhe pajisjeve hidrosanitare të prishura, ndriçuesve dhe lidhjeve elektrike sipas standardeve të sigurimit teknik; marrjen e masave të menjëhershme për furnizimin në 24 orë në ditë dhe përmirësimin e cilësisë së ujit të pijshëm në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Korçë; marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen e plotë të dhomave të të dënuarve dhe të paraburgosurve me orendi dhe dollapë për vendosjen e rrobave dhe sendeve të tjera personale; marrjen e masave të menjëhershme për zhvillimin e kurseve profesionale në (IEVP), Korçë në bashkëpunim me Qendrën Rajonale të Formimit Profesional në Korçë në favor të të dënuarve dhe të paraburgosurve të akomoduar në këtë institucion; marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të plotë sipas parashikimeve në organikën e institucionit; marrjen e masave për pajisjen e IEVP Korçë me ambulancë për të garantuar ofrimin e shërbimit në kohë dhe në cilësi për të dënuarit dhe të paraburgosurit dhe për të shoqëruar personat me problem shëndetësore në spitalet përkatëse të vendit. Marrjen e masave për të përmirësuar cilësinë dhe larmishmërinë e ushqimit në IEVP Korçë në shërbim të të dënuarve dhe të paraburgosurve duke shmangur shpërdorimin e tij në vijim; marrjen e masave për shtimin e

aktiviteteve dhe takimeve me të dënuarit për qëllime rehabilitimi, këshillimi, ri-integrimi, si edhe aktivitete edukative e social-kulturore-sportive; marrjen e masave për mbikëqyrjen e vazhdueshme të veprimtarisë të njësisë tregtare në IEVP, Korçë për ofrimin e produkteve të ndryshme për të paraburgosurit dhe të dënuarit; marrjen e masave për rikonstruksionin e ambienteve të palestrës dhe plotësimin e saj me bazë materiale në ambientet e Institucionit të IEVP, Korçë; marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e higjienës në tualetet e dhomave të banimit të paraburgosurve/dënuarve; marrjen e masave për ofrimin e plotë të shërbimit të lavanterisë nga institucioni për larjen veshjeve për të paraburgosurit/dënuarit; marrjen e masave për plotësimin e organikës së punonjësve të policisë të rolit bazë.

5.7. IEVP KRUIJË

Mekanizmi Kombëtar **inspektoi IEVP Krujë, më datë 20.06.2019**, sipas Planit të Inspektimit për vitin 2019 të miratuar më parë. **Gjatë takimit, grupi inspektues kërkoi fillimisht informacion në lidhje me mënyrën e trajtimit të të paraburgosurve dhe të dënuarve, respektimin e të drejtave ligjore të tyre, si dhe me problematikat e ndeshura gjatë punës.** Kjo ishte vizita periodike monitoruese e MKPT-së në Institucionin e Ekzekutimeve të Veprave Penale Krujë për vitin 2019. Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi inspektues zhvilloi takimin paraprak dhe mori një informacion të përgjithshëm nga ana e drejtuesit të institucionit Z.Ervis Zika. Më tej, grupi i inspektimit vizitoi ambientet e këtij institucioni. Nga inspektimi në vend, kontakti me stafin dhe pacientët, të dënuarit dhe të paraburgosurit, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, objekteve, pajisjeve dhe mjediseve, grupi inspektues grumbulloi informacion në lidhje me të drejtat, kushtet dhe trajtimin e pacientëve, respektimin e të drejtave të tyre, si dhe me problematikat e ndeshura gjatë punës. **Struktura dhe organika e institucionit** ishte e përbërë nga 149 punonjës, prej të cilëve 101 punonjës të sigurisë dhe rolit bazë dhe 48 punonjës civilë. **Organika e sektorit të shëndetësisë** përbëhej nga 5 mjek nga të cilët 2 mjek psikiatër, 11 infermier, 1 stomatolog, 1 farmacist, 4 kujdestarë. Organika e sektorit psiko-social përbëhej nga 2 psikologë dhe 2 punonjës social. Në momentin e inspektimit, në institucion ndodheshin 290 të dënuar, nga të cilët 60 pacientë me shtrim të përkohshëm dhe 183 me mjekim të detyruar. Institucioni ishte i ndarë në dy sektorë A dhe B të ndarë në të dënuarit dhe pacientët të ndarë më vete. Seksioni me të dënuar, një seksion me të sëmurë kronikë dhe persona me aftësi të kufizuar prej të cilëve 36 me moshë mbi 65 vjeç dhe 5 paraplegjikë. Në dhoma të veçanta ndodheshin edhe 2 persona në moshë të mitur të cilët ishin me masë shtrim i përkohshëm. Sistemi i ankimit funksionon edhe në rastin e kërkesave/ankesave për vitin 2018 në institucion janë regjistruar 234 kërkesë – ankesa .Ky proces administrohej nga stafi psikosocial i cili kishte kontakte më të shpeshta me të dënuarit. Konkretisht situata paraqitej si më poshtë: Nga informacioni, rezultoi se kishin gjetur zbatim rekomandimet e Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm: Ishin plotësuar vendet vakante në stafin mjekësor. Tashmë në institucion kishte 2 mjek psikiatër të cilët kishin rritur cilësinë e shërbimit në institucion dhe përkujdesjen shëndetësore. Ishin plotësuar vendet vakante në sektorin psiko-social me psikolog dhe punonjës social. Ishte plotësuar rekomandimi për sigurimin e ujit të pijshëm. Nga biseda paraprake, inspektimi në vend, kontakti me stafin, bisedat më

vete me të paraburgosurit/dënuarit, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacioneve, u konstatua se rekomandimet e bëra ndër vite nga Avokati i Popullit nuk kishin gjetur zbatim.

IEVP Krujë është kategorizuar si Institut i Veçantë i sigurisë së lartë e të zakonshme, me një seksion me të dënuar mbi 65 vjeç, një seksion me të sëmurë kronikë dhe persona me aftësi të kufizuar, një seksion me persona me çrregullime të shëndetit mendor dhe një seksion paraburgimi. *IEVP Krujë mbetet një institucion i cili nuk plotëson asnjë kriter apo standard për të funksionuar si Institut i Veçantë dhe as si Institucion i ekzekutimit të Vendimeve Penale.* I pozicionuar 4 km në juglindje të qytetit, në kushtet e një rruge tejet të amortizuar e të rrezikshme malore, që nuk mundëson as shkëmbimin e makinave në pjesën më të madhe të saj, e që bëhet vështirësisht e kalueshme e madje bllokohet me ditë në raste moti të rënduar, IEVP Krujë jo vetëm që nuk mund të garantojë lëvizjet e pacientëve drejt spitaleve, apo të të paraburgosurve/dënuarve drejt gjykatave etj., por as transportin e sigurt të stafit, duke vështirësuar tej mase edhe kontaktet e familjarëve me personat që mbahen e trajtohen në të. Infrastruktura e amortizuar, prania e theksuar e lagështirës, problemet me hidroizolimim, mungesa e ngrohjes, mungesa/amortizimi i pajisjeve nëpër dhoma, etj., e bëjnë tepër të vështirë jetesën në këtë institucion. Ajo çka është dhe më shqetësuese është mbajtja në të tilla kushte çnjerëzore e degraduese e personave me probleme të shëndetit mendor, në pamundësi për t'u ofruar shërbim shëndetësor të përshtatshëm e dinjitoz. Kapacitetet maksimale të ofruara janë për 190 persona. Në ditën e inspektimit problematika e përhershme e mbipopullimit u ri konstatua me 100 persona mbi kapacitet, për të cilët ishte mundësuar shtimi i krevateve në dhoma që edhe më herët nuk i respektonin standardet e hapësirës. Të 290 të dënuarit e këtij institucioni ishin të ndarë në dy sektorë. Në sektorin A, në kundërshtim me standardet ndërkombëtare dhe në shkelje flagrante të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, ndodheshin 183 persona me probleme të shëndetit mendor, për 141 prej tyre gjykatat kanë marrë vendim për “mjekim të detyruar në një institucion mjekësor” në bazë të nenit 46/2 të Kodit Penal, ndërsa për 60 persona gjykatat kanë caktuar masën shtrënguese “shtrim të përkohshëm në një institucion psikiatrik” në bazë të neneve 46, 232/e dhe 239 të Kodit të Procedurës Penale. Ndërsa sektori B kishte pjesën tjetër të dënuarve, të sëmurë kronikë dhe mbi 65 vjeç (36 të dënuar). Nga të gjithë të personat që vuanin dënimin në këtë institucion, 243 ishin të sëmurë kronik, nga të cilët 5 paraplegjikë, 2 me HIV AIDS, 14 diabetikë dhe pjesa tjetër me patologji të tjera ku përfshiheshin edhe problemet e shëndetit mendor dhe abuzuesit me substanca narkotike. Personat paraplegjikë për shkak të gjendjes fizike hasnin vështirësi në kryerjen e nevojave të tyre, veçanërisht në tualete e dushe, si pasojë e pamjaftueshmërisë së kujdestarëve në këtë institucion dhe mungesës së rampeve në to. Krevati i fiksimit i amortizuar si dhe mungesa e mjeteve të kufizimit fizik (rripa lëkure, këmisha force) të domosdoshme për realizimin e imobilizimit sipas nenit 27 të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, mbeteshin problematika të pazgjidhura në këtë institucion. Ambulanca e institucionit vazhdonte të ishte tejet e amortizuar. Nevojat për blerje të artikujve të ndryshëm nga ana e të paraburgosurve dhe të dënuarve kishin mbetur të pa plotësuara, në mungesë të dyqanit dhe të arkës në institucion. Punonjësit e shërbimit psiko-social e kishin të pamundur organizimin e aktiviteteve rehabilituese si pasojë e mungesës së ambienteve të përshtatshme për to. Aktiviteti i këtyre punonjësve kufizohej vetëm në disa këshillime individuale apo biseda për tema të lira në ambientet e ajrosjes. Theksojmë se IEVP Krujë, nuk është një institucion i posaçëm mjekësor për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor që kanë kryer vepra penale për të cilat gjykatat kanë marrë vendim

për “mjekim të detyruar në një institucion mjekësor” apo kanë caktuar masën shtrënguese “shtrim të përkohshëm në një institucion psikiatrik”. Ju sjellim në vëmendje se në ligjin nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, në nenin 28, pika 1 përcaktohet se: *“Institucionet mjekësore të posaçme janë institucione që shërbejnë për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor që kanë kryer vepra penale për të cilat gjykata kompetente ka vendosur mjekimin e detyruar në një institucion mjekësor, të të paraburgosurve apo të dënuarve që shfaqin çrregullime të shëndetit mendor gjatë vuajtjes së dënimit, si dhe për trajtimin e personave për të cilët gjykata ka vendosur shtrimin e përkohshëm në një institucion të posaçëm në bazë të nenit 239 të Kodit Procedurës Penale”*. Theksojmë se ligji nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, i cili ka hyrë në fuqi në datën 01.06.2012, nuk e kushtëzon zbatimin e dispozitave të tij me ndërtimin apo krijimin e institucioneve mjekësore të posaçme nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale.

Ndërkohë duke iu referuar dokumentit “Mbi Rregullat Evropiane të Burgut”, miratuar nga Këshilli i Evropës dhe deleguar për zbatim me rekomandimin Nr.87/3, të Këshillit të Ministrave, të vendeve anëtare, ndërmjet shumë rregullave të këtij dokumenti, kemi veçuar pikën 100.1, që përcakton se: *“Personat që konstatohen me probleme të shëndetit mendor nuk duhet të mbahen në burg, por duhet të dërgohen sa më shpejtë që të jetë e mundur nga burgjet në vende të përshtatshme për këtë kategori personash”*.

Avokati i Popullit vlerëson se I EVP Krujë nuk është institucion mjekësor i posaçëm sikurse parashikohet në aktet e cituara më sipër, por është institucion i ekzekutimit të vendimeve penale. Mbatja e këtyre personave në I EVP Krujë përbën shkelje të të drejtave kushtetuese dhe ligjore të tyre pasi vjen në kundërshtim me: Nenin 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, pasi të sëmuret mendor nuk mund të diskriminohen për shkak të statusit të tyre si persona me probleme të shëndetit mendor. Nenin 15 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se: 1. *“Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. 2. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre”*. Nenin 28, pika 1 të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”.

I EVP Krujë është kategorizuar si Institut i Veçantë me një seksion me të dënuar mbi 65 vjeç, një seksion me të sëmurë kronikë dhe persona me aftësi të kufizuar, një seksion me persona me çrregullime të shëndetit mendor dhe një seksion paraburgimi. Kapacitetet maksimale të ofruara janë për 190 persona. Nga vizita në institucion rezultoi se ambientet si rrjedhje e mungesës së investimeve, ishin të amortizuara dhe në gjendje jo të mirë teknike, të gjitha orenditë të dëmtuara dhe të amortizuara. Dhomat dhe tualetet kishin një prani të theksuar lagështie, dushet ishin të ndryshkur dhe të dëmtuar. Mjediset e brendshme kishin mungesë të sistemit të ajrosjes dhe për këtë shkak, ambienti dhe ajri brenda sektorëve ishte i rëndë dhe shqetësues, megjithëse konstatuam se dhomat e pacientëve dhe të dënuarve lejoheshin nga stafi i institucionit të qëndronin të hapura përgjatë gjithë ditës. Kuzhina e institucionit ishte e pastër por punohej në kushte të vështira për mungesë të orendive. Përgjatë inspektimit konstatuam se tenxheret ishin të vendosura në dysheme dhe pa asnjë kusht elementar higjienë. Autoambulanca ishte e vjetër dhe e amortizuar. Dyqani në institucion mungonte, kjo sillte dhe vështirësi në plotësimin e kërkesave emergjente të dënuarve. Në ambiente si sektori i shëndetësisë dhe në korridore ndarëse në institucion mungonin kamerat e monitorimit. Nga sa më sipër vlerësohet

se: Ka neglizhencë të pajustificuar nga ana e autoriteteve përgjegjëse për ngritjen e institucionit të posaçëm mjekësor për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor që kanë kryer vepra penale për të cilat gjykatat kanë marrë vendim për “mjekim të detyruar në një institucion mjekësor” apo kanë caktuar masën shtrënguese “shtrim të përkohshëm në një institucion psikiatrik”, ndonëse për këtë problematikë Institucioni i Avokatit të Popullit u është drejtuar në mënyrë të përsëritur me rekomandime ministrave të drejtësisë dhe shëndetësisë. Gjithashtu kjo çështje ka zënë vend të rëndësishëm edhe në raportet vjetore të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe në raportet e veçanta të Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, të cilat i janë dërguar edhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Ka neglizhencë të pajustificuar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Ministrisë së Drejtësisë për të përmbushur detyrimet ligjore në krijimin e kushteve të përshtatshme infrastrukturore dhe në sigurimin e bazës materiale të nevojshme për të garantuar respektimin e të drejtave ligjore ndaj të paraburgosurve dhe të dënuarve që trajtohen në këtë institucion. Prej vitesh, kushtet në të cilat trajtohen të dënuarit/ të paraburgosurit në IEVP Krujë janë degraduese, jo humane, dhe në kundërshtim me legjislacionin në fuqi e standardet ndërkombëtare.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës, nenit 21, germa “b” të ligjit Nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, si dhe nenit 12, nenit 74/1 pika “b” të ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar

Rekomanduar: Mbylljen e menjëhershme të IEVP Krujë, pasi kushtet në të cilat trajtohen të dënuarit/ të paraburgosurit janë tejet degraduese, jo humane, dhe në kundërshtim me legjislacionin në fuqi e standardet ndërkombëtare; marrjen e masave të menjëhershme nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për sistemimin e personave me probleme të shëndetit mendor, që trajtohen në IEVP Krujë në kundërshtim me ligjin, në pavijone psikiatrike që administrohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, deri në ngritjen e institucioneve të posaçme mjekësore sipas përcaktimit të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”; marrjen e masave të menjëhershme nga Ministria e Drejtësisë për dërgimin e një letër - porosie të gjitha gjykatave në shkallë vendi ku t’u sillet në vëmendje detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 46, paragrafi i parafundit i Kodit Penal, për të shqyrtuar kryesisht të gjitha vendimet e dhëna për “mjekim të detyruar në një institucion mjekësor” dhe dërgimin e vendimeve në institucionet ku trajtohen personat përkatës. Avokati i Popullit konstatoi se me gjithë rekomandimet e përsëritura ndër vite, situata në IEVP Krujë jo vetëm që nuk përmirësohet, por vazhdon të degradohet, ndaj kërkohet vëmendja juaj e veçantë për ndërhyrje të menjëhershme në zgjidhjen e problematikave. Avokati i Popullit do të përdorë të gjitha mjetet që i njeh Kushtetuta dhe ligji për të nxitur autoritetet përgjegjëse në marrjen e vendimeve dhe dhënien zgjidhje të problematikave të ngritura, bazuar në legjislacionin përkatës në fuqi.

5.8. IEVP KUKËS

MKPT kreu inspektim në Institucioni e Ekzekutimeve të Vendimeve Penale (IEVP) Kukës me datë 22.07.2019, sipas një plani inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. IEVP Kukës është

kategorizuar si institucion paraburgimi me urdhrin nr. 329, datë 15/01/2009 të Ministrit të Drejtësisë, “Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”, si dhe rikategorizuar me urdhrin Nr.8927/1 të Ministrit të Drejtësisë.

Gjatë vizitës së inspektimit, në këtë institucion ndodheshin 12 persona të paraburgosur dhe 1 person i dënuar me vendim të formës së prerë në pritje të transferimit. Ndërkohë, që kapaciteti maksimal i këtij institucioni është për mbajtjen dhe trajtimin e 36 personave të paraburgosur. Organika e punonjësve të policisë së burgjeve ishte e plotësuar dhe nuk kishte mungesa, ndërsa organika e punonjësve civilë kishte disa mungesa. Më konkretisht, nuk ishte plotësuar pozicioni i mjekut me kohë të plotë dhe aktualisht kishte një mjek që punonte me kohë të pjesshme, i cili për vetë kapacitetin e të paraburgosurve, mbulonte plotësimin në kohë të kërkesave për vizita mjekësore pranë Spitalit Rajonal Kukës. Gjatë takimit, grupi inspektues, kërkoi fillimisht informacion në lidhje me të drejtat dhe trajtimin e të paraburgosurve, mënyrën e trajtimit nga ana e institucionit të problematikave të ndeshura në inspektimin e mëparshëm pranë këtij institucioni, si dhe verifikimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të parashtruara nga Institucioni i Avokatit të Popullit pas inspektimit të vitit 2018.

Sipas të dhënave që u morën gjatë kësaj vizite, evidentimit të gjendjes së zbatimit të rekomandimeve të bëra më parë nga institucioni i Avokatit të Popullit, informacioneve të marra nëpërmjet intervistave konfidenciale me personat e privuar nga liria, si dhe bisedat me stafin e institucionit, rezultoi se: Ishte zbatuar rekomandimi për marrjen e masave për kalimin në një dhomë të veçantë të të dënuarve me vendim gjyqësor të formës së prerë, në datën që në institucion vjen vendimi i gjykatës dhe urdhri i prokurorit për ekzekutimin e tij, si dhe garantimin e të drejtave të tyre të njohura me ligj. Ishte zbatuar rekomandimi për marrjen e masave për mundësimin brenda skemës së sigurisë të hapjes së dyerve për të lehtësuar ajrosjen. Ishte zbatuar rekomandimi për marrjen e masave për mbajtjen në raft të veçantë dhe të mbyllur me çelës të kartelave mjekësore nga ana e sektorit shëndetësor. Ndërkohe që një pjesë e rekomandimeve të mëparshme të paraqitura nga Avokati i Popullit nuk kishin gjetur zbatim dhe nuk ishin plotësuar. Më konkretisht: Nuk ishte zbatuar rekomandimi për marrjen e masave për hapjen e dyqanit dhe mbajtjen e arkës në institucion, për të mundësuar blerjet nga ana e të paraburgosurve. Nuk ishte zbatuar rekomandimi për marrjen e masave për krijimin e kushteve për ofrimin e kurseve arsimore e atyre të formimit profesional, si dhe për mundësimin e aktiviteteve të tjera kulturore. Nga intervistat me të paraburgosurit dhe të dënuarit, në dhoma dhe më vete, pa praninë e punonjësve të institucionit nuk rezultoi që ndaj tyre të ishte ushtruar dhunë fizike apo psikologjike.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se, kishte një rast të përdorimit të masës disiplinore ndaj një të paraburgosuri (F.H) për të cilin ishte aplikuar masa e përjashtimit nga veprimtaritë e përbashkëta për 10 ditë në përputhje me nenin 118, pika 1, germa (a) të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve. Disa nga ankesat e parashtruara nga personat e paraburgosur gjatë inspektimit, kishin të bënin kryesisht me mungesën e ambientit për ajrim, kushteve për arsimim, për zhvillimin e aktivitete fetare e sportive, etj. Nga të intervistuarit, u ngritën ankesa që lidheshin me faktin se, sjellja e ushqimeve nga familjarët konsiderohej si takim, pavarësisht dhe rastit kur takimi nuk realizohej faktikisht. Ankesa të tjera kishte mbi pa mundësinë e blerjeve të produkteve ushqimore apo produkteve të tjera të lejuara. Në kushtet kur në institucion nuk lejohej më njësia tregtare, personat e paraburgosur e kishin të vështirë të mbulonin nevojat e tyre për blerje, nëse nuk kishin mbështetjen familjare apo nga të

paraburgosurit e tjerë. Veçanërisht pamundësia e blerjeve ndikonte më së shumti tek shtetasit e huaj që vuanin dënimin në këtë institucion dhe ata të paraburgosur të braktisur nga familja. Në momentin e inspektimit në këtë institucion ndodheshin 3 shtetas me origjinë nga Kosova dhe 1 shtetas me origjinë nga Libia. Të paraburgosurit plotësonin një formular kërkesë/ankese dhe ia dorëzonin më pas punonjësit të sektorit psiko-social. Punonjësi i dërgonte në sekretarinë e institucionit ku protokolloheshin dhe pastaj i kalonin drejtorit të institucionit, i cili kthente përgjigje me shkrim apo i takonte vetë. Sa i takon objektit të këtyre kërkesave rezultoi se, ato konsistonin në kërkimin për leje shpërblyese, takime me familjarë, kërkesë për dinamikën e vuajtjes së dënimit, kërkesë për takim me avokatë, vizitë në spital, transferim, punësim ose kërkesë për blerjen e pajisjeve si TV ose frigorifer. Sistemi i monitorimit me kamera vëzhgimi ishte funksional. Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Kukës, kamerat monitoronin në mënyrë të plotë mjediset për 24 orë, ndërkohë që të dhënat ruheshin në server për një periudhë rreth tre mujore.

Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacioneve të tjera u konstatua se çdo veprim regjistrohej në regjistrin përkatës dhe protokollohej. Secili sektor mbante dosjet përkatëse. Komisioni i pritjes funksiononte në rregull. Telefonat punonin në çdo kohë dhe të dënuarit apo të paraburgosurit e intervistuar, pohuan se mund të flisnin me të afërmit e tyre 2 herë në javë, nëpërmjet telefonave me kartë që ndodheshin në mjedisin e regjimit të brendshëm. Nuk kishte ankesa lidhur me ofrimin e shërbimit telefonik. Por kishte ankesa lidhur me minutazhin e ulët që ofronin kartat e telefonit për komunikim me njerëzit e tyre të afërm apo avokatët. Nuk pati ankesa nga të dënuarit/paraburgosurit për mosrespektim të numrit të takimeve me familjet, por u konstatuan ankesa për mënyrën e kryerjes së kontrollit të ushqimeve nga stafi i institucionit. Evidentohet se në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Kukës kishte nevojë për instalimin e një skaneri urë për të bërë të mundur kontrollin me efikasitet të ushqimeve. Ambienti i kultit ishte funksional dhe përdorej kryesisht nga besimtarët myslimanë. Punësimi i të paraburgosurve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Kukës shpërblehej me ditë ulje dënimi në momentet kur të paraburgosurit merrnin vendim të formës së prerë nga gjykata. Në ditën e inspektimit nuk u gjetën të punësuar dhe nuk kishte të tillë. Kjo problematikë ndeshet në të gjithë sistemin penitenciar, që nuk ka gjetur ende zgjidhje. Gjendja materiale e institucionit u konstatua të kishte disa përmirësime, por sërish nevojitej ndërhyrje për të mundësuar kushte sa më optimale. Kapaciteti i ulët i të paraburgosurve në këtë institucion, kishte krijuar mundësinë e akomodimit të këtyre personave në dhoma me kushte dhe hapësirë të bollshme për jetesë. Dhomat e banimit ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjieno-sanitare. Por, nga inspektimi rezultoi se, në dhoma mungonin orendi të nevojshme si dollapë apo komodina, për vendosjen e rrobave dhe sendeve të tjera personale. Dhoma e takimeve ishte e rregullt, e pastër dhe e lyer, me kablllo të vendosura në kanalina. Duke qenë se ajo përdorej edhe për takimet me avokat, prokuror, dhe oficerë të policisë gjyqësore, ajo ishte e pa monitoruar me kamera. Kjo dhomë ishte e pajisur me tavolinë, karrige e stol. Në dhoma kishte ndriçim të kufizuar natyror, pasi dritaret ishin të përmasave 80x60 cm dhe ishin të përforcuara me skarë të parë, skarë mbrojtëse hekuri dhe kornizë. Problem mbetet lagështira, pasi godina e paraburgimit ndodhet pjesërisht nën nivelin e tokës. Lagështira ishte më e madhe në dhomën e cila gjendej pranë tualetit. Dhoma e observimit, si dhe ajo e veçimit, me nga një shtrat, kishin të njëjtat kushte me dhomat e tjera. Ambientet e brendshme dhe të jashtme të Institucionit ishin të dezinfektuara dhe nuk u evidentua prania e insekteve. Për larjen e materialeve të fjetjes, ishte

funkionale një lavatriçe dhe një tharëse. Ndërsa, rrobat e trupit laheshin nga vetë të paraburgosurit ose dërgoheshin pranë familjarëve të tyre. Kjo, për shkak dhe të mungesës të ambienteve për hapjen dhe tharjen e rrobave. Furnizimi me ujë të rrjedhshëm mundësohej nga rrjeti, tre herë në ditë me intervale 2-3 orë, megjithëse një depozitë e madhe mbulonte nevojat në 24 orë. Energjia elektrike në rastet e ndërprerjeve të furnizimit me energji nga rrjeti, mundësohej me gjenerator. Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Kukës Kukës, mungojnë mjediset e jashtme të cilat mund të përdoren për aktivitete sportive si futboll, basketboll etj. I vetmi mjedis ishte ai i ajrimit i cili ishte i kufizuar në hapësirë dhe nuk ofronte asnjë mundësi argëtimi me aktivitete sportive, përveç lojërave të tavolinës. Kuzhina e institucionit ishte e vogël, por mbahej pastër nga personeli i kuzhinierëve. Gatimi kryhej me sobë me energji elektrike, por mungonte aspirimi. Ushqimi i përgatitur ishte i cilësisë së kënaqshme. Në rastet kur kishte të sëmurë me diabet, ushqimi gatuhej më vete. Në kuzhinë ishte afishuar menya javore, kuotat ditore dhe vlerat kalorike, të cilat rezultuan brenda standardeve. Po aty ishin vendosur të afishuara dhe librezat shëndetësore të punonjësve të cilat rezultuan të rregullta. Gjatë inspektimit u konstatua se kampionët e ushqimeve ruheshin në kushte frigoriferike. Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Kukës, nuk ofrohej mundësia për arsimim apo për formim profesional pasi Drejtoria Arsimore Kukës dhe Zyra e Formimit Profesional, nuk i ishin përgjigjur kërkesave të institucionit për të dërguar mësues apo instruktor. Të vetmet aktivitete që ofroheshin nga specialistja e shërbimit psiko-social ishin temat dhe recensionet e librave të cilat konsideroheshin si aktivitete informuese dhe edukative, ndërkohë që mungonin aktivitetet social- kulturore, përveç rasteve të festave fetare për të cilat bizneset private shtronin dreka për të paraburgosurit.

Organika e sektorit të shëndetësisë përbëhej nga 1 mjek me kohë të pjesshme (katër orë në ditë) dhe 3 ndihmësmjekë. Nga verifikimi i dokumentacionit të stafit mjekësor e në veçanti ai i mjekut, u konstatua se regjistrat e terapisë ditore, marrjes dhe dorëzimit të shërbimit, kartelave dhe ngjarjeve të rënda ishin të plotësuar dhe të mbajtur në mënyrë të rregullt. Kartelat mbaheshin me çelës në zyrën e nd/mjekut, që shërbente njëkohësisht edhe si zyrë për financën dhe logjistikën. Dhoma e mjekut, infermierisë dhe farmacia ishin të rregullta dhe të mirëmbajtura, megjithëse me infrastrukturë të vjetër e të varfra në pajisje. Furnizimi me medikamente për pacientët kronikë kryhej me kërkesë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Furnizimi me mjekime të urgjencës kryhej përmes blerjeve me prokurim të vogël nga vetë institucioni. Mjekimet, përfshirë ato personale të sjella nga familjarët, administroheshin nga ndihmësmjekët e turnit. Të gjithë të paraburgosurit ishin të pajisur me librezat shëndetësore. Asgjësimi i ilaçeve të skaduara bëhej me komision dhe regjistrohej në mënyrë filmike. Autoambulanca në këtë institucion mungonte prej kohësh.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës, nenit 21, germa “b” të ligjit Nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, si dhe nenit 12, nenit 74/1 pika “b” të ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar

Rekomanduar: Marrjen e masave të menjëhershme lidhur me rikonstrukcionin e godinës së banimit të të paraburgosurve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Kukës, për të siguruar ambiente të përshtatshme dhe dinjitoze; marrjen e masave të menjëhershme për rikonstrukcione, riparime, mirëmbajtje, eliminim lagështire dhe lyerjen e dhomave të të dënuarve dhe të

paraburgosurve; marrjen e masave të menjëhershme për furnizimin me ujë të pijshëm dhe 24 orë në ditë në ambientet e këtij institucioni; marrjen e masave të menjëhershme për shtimin e aktiviteteve dhe takimeve me të dënuarit dhe të paraburgosurit për qëllime rehabilitimi, këshillimi, ri-integrimi, si edhe aktivitete edukative e social-kulturore-sportive; marrjen e masave të nevojshme për instalimin e një skaneri urë në ambientet e institucionit, për të bërë të mundur kontrollin me efikasitet të ushqimeve për të dënuarit dhe të paraburgosurit; marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të plotë, sipas parashikimeve në organikën e IEVP Kukës; marrjen e masave të menjëhershme për rikonstruksionin e dhomës së mjekut dhe infermierisë në këtë institucion, e cila duhet të jetë e ndarë nga ambientet e tjera të shërbimeve; marrjen e masave për pajisjen e këtij institucioni me ambulance, për të garantuar ofrimin e shërbimit në kohë dhe në cilësi për të dënuarit dhe të paraburgosurit, si dhe për të shoqëruar personat me probleme shëndetësore në spitalet përkatëse të vendit; marrjen e masave të menjëhershme për ngritjen dhe funksionimin e skemës tre paleshe midis IEVP, Kukës, Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Depos Farmaceutike për plotësimin e nevojave të të paraburgosurve dhe të dënuarve me medikamentet e nevojshme; marrjen e masave të nevojshme për përmirësimin e shërbimit të sektorit psiko-social në raport me të dënuarit dhe të paraburgosurit në këtë institucion; marrjen e masave të menjëhershme për krijimin e kushteve për ofrimin e kurseve arsimore e atyre të formimit profesional si dhe për mundësimin e aktiviteteve të tjera kulturore; marrjen e masave të menjëhershme për hapjen e dyqanit dhe mbajtjen e arkës në institucion për të mundësuar blerjet nga ana e të paraburgosurve; marrjen e masave për evidentimin e situatës dhe ngritjen e këtij shqetësimi pranë strukturës përgjegjëse në DPB, në lidhje me ankesat e të paraburgosurave, për minutazhin e ulët që ofronin kartat e telefonit që përdoren për komunikimin me njerëzit e tyre të afërm apo avokatët; marrjen e masave të menjëhershme për pasurimin e fondit dhe titujve të librave në institucion, që janë në shërbim të të dënuarve apo të paraburgosurve; marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e përshtatshëm me ngrohje të dhomave të të dënuarve dhe të paraburgosurve, që vuajnë dënimin në këtë institucion, për t'iu përshtatur kushteve klimaterike; marrjen e masave të menjëhershme, për pajisjen e plotë të dhomave të të dënuarve dhe të paraburgosurve me orendi dhe dollapë për vendosjen e rrobave dhe sendeve të tjera personale.

5.9. IEVP LUSHNJË

MKPT kreu inspektim në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Lushnjë, më datë 10.04.2019, sipas një Plani Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. mëparshme. Vizita në këtë institucion u zhvillua në një frymë të mirë bashkëpunimi. Kjo ishte vizita periodike monitoruese e MKPT-së në IEVP, Kosovë, Lushnjë, për vitin 2019 dhe inspektimi i mëparshëm ishte realizuar në vitin 2016. Ky institucion ka një kapacitet maksimal prej 182 personash. Në ditën e inspektimit, në mjediset e institucionit ishin 179 persona, ndërkohë që 2 të dënuar të tjerë ishin me leje. Institucioni nuk kishte Sektor të Kujdesit të Veçantë (SKV). Midis personave që vuanin dënimin në këtë institucion kishte 7 (shtatë) përdorues të lëndëve narkotike, 3 (tre) depresivë kronikë dhe 2 (dy) të dënuar diabetikë ndërkohë që nuk kishte të dënuar mbartës të virusit HIV-AIDS. Të dënuar të kategorisë 18-21 vjeçarë nuk kishte. Organika e punonjësve të policisë së burgjeve ishte e plotësuar dhe nuk kishte

mungesa ndërsa organika e punonjësve civilë kishte disa mungesa. Më konkretisht nuk ishte plotësuar pozicioni i mjekut me kohë të plotë dhe aktualisht kishte një mjek që punonte me kohë të pjesshme. Gjithashtu nuk ishte i plotësuar vendi i punës për pozicionin e farmacistit.

Gjatë takimit me Shefin e Policisë të IEVP, Kosovë, Lushnjë Z. Zoi Rrushi, grupi inspektues, kërkoi fillimisht informacion në lidhje me të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve/paraburgosurve, mënyrën e trajtimit nga ana e institucionit të problematikave të ndeshura në inspektimin e mëparshëm, si dhe verifikimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të bëra nga Institucioni i Avokatit të Popullit më parë. Në bazë të Urdhrit të Ministrisë të Drejtësisë Nr.8927/1, datë 27.09.2018, “*Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale*”, i ndryshuar, IEVP Kosovë, Lushnjë është kategorizuar si burg i sigurisë së zakonshme.

Nga informacioni i marrë, nga bisedimi në grup dhe në privatësi me të paraburgosurit, dhe të dënuarit, grupi monitorues nuk evidentoi pretendime për tejkallim të forcës fizike nga ana e punonjësve të policisë së burgjeve. Megjithatë, nga intervistat rezultoi një numër i madh ankesash që ishin të lidhura kryesisht me kushtet e përgjithshme të jetesës në institucion si dhe me punën që duhej bërë nga sektori psiko-social dhe ai i shëndetësor. Të dënuarit dhe të paraburgosurit e konsideronin jo në nivelin e duhur, shërbimin e sektorit psiko-social në IEVP, Kosovë Lushnjë. Gjithashtu sipas të dënuarve shërbimi mjekësor në këtë institucion nuk ishte në nivelin e kërkuar dhe nuk ofrohej në cilësi. Ankesa kishte dhe për vizitat mjekësore dhe ilaçet të cilat për efekt shpejtësie duhej t’i siguronin nga familjarët, sikurse edhe për shërbimin stomatologjik i cili nuk funksiononte normalisht si rezultat i mungesës së materialeve dhe medikamenteve. Shërbimi stomatologjik si rrjedhojë e mungesës së kushteve dhe materialeve ofronte përgjithësisht procesin e ekstraksioneve dhe të mjekimeve por nuk kishte mundësi për të vijuar me shërbime të tjera. Ankesa kishte për furnizimin me ngrohje në IEVP, Kosovë, Lushnjë për t’iu përshtatur kushteve klimaterike. Ankesa të shumta vinin për kushtet e ambienteve të vuajtjes së dënimit, të cilat jo vetëm që ishin me lagështirë të theksuar, por kishin mungesa në orendi dhe në dollapë për vendosjen e rrobave dhe sendeve të tjera personale. Brenda IEVP, Kosovë, Lushnjë kishte njësi tregtarë, për të dënuarit/paraburgosurit për sigurimin e produkteve bazë të domosdoshme personale. Të dënuarit shfaqën pretendime se më parë njësi tregtarë kishte raste që ndryshonte çmimet e produkteve. Nga ana e grupit inspektues u verifikua lista e çmimeve si dhe cilësia e ofrimit të shërbimit nga kjo njësi. Lista e çmimeve ishte e afishuar dhe e aksesueshme dhe shërbimi ofrohej normalisht.

Ankesa nga të dënuarit dhe të paraburgosurit kishte edhe për mungesën e aktiviteteve rekreative në IEVP, Kosovë-Lushnjë të cilët sipas tyre ishin të pakta nisur edhe nga kushtet e pafavorshme të ambienteve.

Të paraburgosurit/ dënuarit plotësonin një formular kërkesë/ankese dhe ia dorëzonin më pas punonjësit të sektorit psiko-social. Punonjësi i dërgonte në sekretarinë e institucionit ku protokolloheshin dhe pastaj i kalonin drejtorit të institucionit, i cili kthente përgjigje me shkrim apo i takonte vetë të dënuarit. Sa i takon objektit të këtyre kërkesave na rezultoi se konsistonin në kërkimin për leje shpërblyese, takime me familjarë, kërkesë për dinamikën e vuajtjes së dënimit, kërkesë për takim me avokatë, vizitë në spital, transferim, punësim ose kërkesë për blerjen e pajisjeve si TV ose frigorifer. Sistemi i monitorimit me kamera vëzhgimi ishte funksional. Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Kosovë-Lushnjë kamerat monitoronin në mënyrë të plotë rreth 60% të

mjediseve për 24 orë, ndërkohë që të dhënat ruheshin në server për një periudhë rreth tre javore. Nga informacioni që morëm shihej si e nevojshme që të shtohesh numri i kamerave të vëzhgimit me të paktën rreth 20 copë të tjera në ambientet e brendshme. U konstatua se kishte nevojë për të paktën 2(dy) kamera në kat në një kohë që gjendja aktuale tregonte se kishte vetëm nga 1(një) kamera që monitoronte këto ambiente.

Observimi si sektor i rëndësishëm për mbajtjen dhe kujdesin e veçante të paraburgosurve të cilët akomodohen rishtazi në IEVP, Kosovë, Lushnjë, ishte funksional dhe në momentin e inspektimit nuk gjendeshin persona. U konstatua se kishte 1(*një*) dhomë observimi. Dhoma kishte mangësi në orendi dhe pajisje dhe kishte nevojë për rikonstruksion dhe lysterje. Telefonat punonin në çdo kohë dhe të dënuarit apo të paraburgosurit e intervistuar, pohuan se mund të flisnin sa herë të dëshironin me të afërmit e tyre nëpërmjet telefonave me kartë që ndodheshin në mjedisin e regjimit të brendshëm. Nuk kishte ankesa lidhur me ofrimin e shërbimit telefonik. Por kishte ankesa lidhur me minutazhin e ulët që ofronin kartat e telefonit për komunikim me njerëzit e tyre të afërm apo avokatët.

Në IEVP, Kosovë-Lushnjë, kishte 33 të dënuar që punonin kryesisht si pastrues, sanitarë, shpërndarës ushqimi etj. Të dënuarit që punonin përfitonin nga ulja e dënimit me 3.9 ditë në muaj. Të punësuarit ishin të gjithë me kontrata pune dhe çdo muaj mblidhej komisioni i institucionit që parashikonte nevojat për shtimin e numrit të personave që mund të punonin në përputhje me organikën e lejuar të punësimit. IEVP Kosovë-Lushnjë është një institucion i vjetër i trashëguar nga sistemi komunist. Infrastruktura e institucionit përbëhej nga dy godina tre katëshe. Në total ishin 44 dhoma. Banjat ishin kolektive në çdo kat të godinave dhe konstatohej qartësisht amortizimi i tyre. Kishte nga një ambient ajrimi në pjesën e jashtme të secilës godinë dhe zakonisht procesi i ajrimit realizohej në mënyrë të ndarë. Orari i ajrimit ishte rreth 6 (*gjashtë*) orë në ditë. Ajrimi për katet brenda godinave kryhej në ambiente të veçanta të ndara nga njëra-tjetra. Dhomat nuk kishin tualete brenda. Përgjithësisht tualetet e përbashkëta ishin të amortizuara dhe të dënuarit shfaqën ankesa për mungesën e investimeve në to nga ana e institucionit. Në dhomat e inspektuara nga grupi i ekspertëve, u vu re se baza materiale nuk ishte e plotësuar si duhej, dhe kishte mungesë pajisjesh ose kishte orendi të amortizuara. Shtrojat ishin vendosur në krevatet e dhomave dhe nuk u konstatua asnjë rast që ndonjë nga të paraburgosurit/dënuarit të flinte në tokë, kjo edhe për faktin se nuk kishte mbipopullim. Megjithatë u konstatua se hapësira brenda dhomave, ishte e kufizuar. Të dënuarit dhe të paraburgosurit gjithashtu shfaqën ankesa se institucioni nuk ofronte shërbim për ngrohje të dhomave gjatë stinëve të ftohta të vitit. Kishte shumë pak bazë materiale në ambientet e përbashkëta, pasi aktualisht në IEVP, Kosovë-Lushnjë nuk ishin realizuar investime në këtë drejtim. Në këtë institucion kishte edhe një palestër e cila ishte tejet e amortizuar dhe me shumë pak pajisje të cilat ishin të dëmtuara dhe jofunksionale. Ambientet e takimit me familjarët gjendeshin në 2 (*dy*) bokse për të dy sektorët. Në këto ambiente të takimeve gjendeshin sportele të ndara me kangjella hekuri. Një dhomë e vogël prej gati 5-6 m² sipërfaqe që gjendej në hyrje të godinës, përdorej si ambient për takime me avokatët ose oficerët e policisë gjyqësore por gjithashtu ajo përdorej si ambient për prindërimin në distancë. Kjo dhomë kishte tavolina dhe karrige dhe ishte e vetmja mundësi e parë si zgjidhje nga ana e institucionit për shkak të mungesës së ambienteve shtesë. Gjithashtu kishte 4 (katër) ambiente për takime speciale ndërmjet bashkëshortëve por sërish ato kishin nevojë për rikonstruksion dhe për tu pajisur me bazë materiale sipas standardeve. Në institucion kishte dy terrene sportive nga një për secilën godinë si dhe ekzistonte

një ambient shtesë që përdorej rrallë. Institucioni kishte një ambient që përdorej si xhami që frekuentohej nga rreth 15 persona por nuk kishte një ambient që mund të përdorej si kishë. Probleme kishte me higjienën e mjediseve nisur nga fakti që institucioni në tërësinë e tij ishte i amortizuar. Nga intervistat e bëra nëpër dhoma nga të parburgosurit apo të dënuarit pati shumë ankesa për mungesën e investimeve në IEVP, Kosovë-Lushnjë për të garantuar cilësinë e higjienës në institucion. Cilësia e ujit nuk ishte e mirë dhe furnizimi i institucionit ishte 2-3 orë në ditë. Të dënuarit shfaqën ankesa që ky shërbim kishte probleme dhe nuk plotësoheshin nevojat e tyre. Ky problem u konstatua edhe gjatë inspektimit. Në IEVP, Kosovë-Lushnjë, larja në dushe zhvillohej mesatarisht dy herë në javë por u konstatua se bokset e dusheve ishin tejet të amortizuara. Në ambientin e dusheve kishte lagështirë të theksuar, tavani ishte shumë i dëmtuar, kokat e dusheve ishin gjithashtu të dëmtuara dhe kishte amortizim të theksuar të pllakave dhe tubacioneve. Të dënuarit në pjesën më të madhe të rasteve pohuan se realizonin dush me ujë të ftohtë sepse përgjithësisht edhe uji ishte me orare shumë të kufizuara. Përsa i përket larjes së rrobave të fjetjes ato vazhdonin të laheshin nga familjarët ose nga vetë të dënuarit brenda ambienteve të tyre, pasi lavanteria nuk funksiononte normalisht por vetëm në pak raste nisur edhe nga fluksi i madh i nevojave për larje dhe ende nuk ishte mundësuar një shërbim i tillë në formën e duhur nga institucioni. Kuzhina funksiononte në kushte normale pasi pajisjet e gatimit dhe sistemi i aspirimit ishin të standardeve industriale. Kuzhina ishte e lyster dhe përgjithësisht nuk u evidentuan papastërti. Në IEVP, Kosovë-Lushnjë punonin 4 (katër) kuzhinierë. Në kuzhinë ndodhej regjistri i normativave ushqimore dhe menyuja ditore ishte e afishuar. Regjistrat e kontrollit të ushqimit dhe të menisë së gatimit ishin të sekretuar dhe të protokolluar. Kampionët e ushqimeve mbaheshin në kushte frigoriferike dhe të etiketuar sipas vakteve përkatëse. Gjithashtu u konstatuan edhe racionet përkatëse për të sëmurët diabetikë në këtë institucion. Përgjithësisht, kushtet e përgatitjes së ushqimit në ambientet e kuzhinës të institucionit, rezultuan në gjendje të mirë. Megjithatë të dënuarit dhe të parburgosurit shfaqën ankesa lidhur me cilësinë e ushqimit i cili nuk kishte larmishmëri. U evidentua se një masë e madhe e të burgosurve në IEVP, Kosovë-Lushnjë nuk e konsumonin ushqimin e përgatitur në institucion, duke shpërdoruar një pjesë të konsiderueshme të tij. Mjaft të dënuar kanë pohuar se e merrnin ushqimin nga të afërmit e tyre dhe se nuk e konsumonin ushqimin e institucionit, për shkak se nuk e pëlqenin atë. Sa i takon veprimtarive rikrijuese, u vërejt se në IEVP, Kosovë-Lushnjë ato që zhvilloheshin më së shumti ishin lojërat e tavolinës, pasi personat mund të luajnë edhe në dhomën e tyre, ose edhe në ambientet e ajrimit (lojra me letra, domino dhe shah) dhe paralelisht zhvilloheshin dhe lojra futbollit jashtë secilës prej godinave. E drejta për të mbajtur kontakte me familjarët dhe miqtë zbatoheshin përgjithësisht sipas rregullores. Takimet realizoheshin mesatarisht rreth 4 herë në muaj, në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve. Takimi me familjarët zgjaste rreth 20 minuta. Trajnime profesionale në IEVP, Kosovë-Lushnjë kishte pasi në këtë njësi administrative kishte edhe shërbime të tilla të ofruara nga Qendra Rajonale e Formimit Profesional dhe konkretisht ofroheshin kurse për hidraulik dhe elektrikist. Për sa i përket mbështetjes psiko-sociale që merrnin të burgosurit, gjatë takimit me stafin e sektorit të kujdesit psiko-social, u konstatua se aktivitetet që ofroheshin ishin të pakta dhe përbëheshin kryesisht nga diskutimet në grup për tema sociale, këshillime në ambientet e ajrimit, ose në dhomën e improvizuar të takimeve me avokatin kur ajo ishte e lirë, si dhe nga aktivitetet sportive. Dosjet psiko-sociale ishin të plotësuara mirë, me përmbledhjet nga takimet e fundit me të dënuarit, me vlerësimet e tre mujoreve

dhe gjithë dokumentet e tjera mbështetëse. Pengesë për kryerjen e punës nga stafi i edukimit dhe nga ai psiko-social ishin mungesa e ambienteve të përbashkëta dhe e dhomave të këshillimit. Në institucion, nuk kishte një ambient të mirëfilltë biblioteke. U evidentua se shpërndarë nëpër zyra, gjendej dhe një numër i vogël me tituj librash që konsideroheshin si të bibliotekës. Ata viheshin në dispozicion të paraburgosurve /dënuarve për lexim sipas kërkesave. Të paraburgosurit dhe të dënuarit e regjistruar kishin nga një kartelë personale dhe nëpërmjet saj tërhiqnin dhe dorëzonin librat sipas kërkesave. Nga shqyrtimi i dosjeve psiko-sociale dhe dokumentacioneve të tjera të mbajtura nga ky sektor, u vu re se ato ishin të plotësuara relativisht mirë me shënime periodike mbi takimet dhe aktivitetet ku të paraburgosurit merrnin pjesë. Në dosjet ishin përfshirë si programet individuale të trajtimit ashtu dhe vlerësimet periodike të cilët ishin të plotësuara mirë. Ankesat e të dënuarave vijonin dhe konsistonin kryesisht në mungesat e medikamenteve, të cilat shpesh mbulohehin me kontributet e sjella nga familja. Skema e furnizimit me ilaçe funksiononte përgjithësisht për të sëmurët kronikë. Ndërsa për sa i përket shërbimit stomatologjik, ai kishte probleme për shkak të mungesës së bazës materiale. Shërbimi stomatologjik si rrjedhojë e mungesës së kushteve dhe materialeve ofronte përgjithësisht shërbimin e ekstraksioneve dhe të mjekimeve por nuk kishte mundësi për të vijuar me shërbime të tjera. Personeli i kujdesit mjekësor në IEVP, Kosovë-Lushnjë përbëhej nga 1(një) mjek, 1(një) stomatolog dhe 4(katër) infermierë. Ndërkohë që pozicioni i mjekut me kohë të plotë dhe 1(një) pozicion farmacist ishin të paplotësuar. Pra evidentohet mungesa e personelit mjekësor në përputhje me organikën e institucionit. Mjeku aktual punonte me kohë të pjesshme në këtë institucion pasi mjeku i mëparshëm kishte 6 muaj që kishte dhënë dorëheqjen në Institutin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Kosovë-Lushnjë. Nga biseda me personelin mjekësor u konstatua se trajtimi akut i personave me probleme të shëndetit mendor bëhej në Spitalin e Burgjeve.

Mjeku që punonte me kohë të pjesshme është i pranishëm në këtë institucion vetëm pjesërisht gjatë ditës dhe më pas, vetëm në kushte të domosdoshmërisë thirrret ndihma urgjente mjekësore, shkakton në mënyrë të drejtpërdrejtë shkeljen e së drejtës për qasje deri te mjeku nga ana e personave të dënuar apo të paraburgosur, gjë që interpretuar dhe në qëndrimet e KPT parashikon që: *“Derisa qëndrojnë në burg, personave të dënuar duhet tu mundësohet qasja deri te mjeku në çdo kohë, pa marrë parasysh faktin e regjimit të burgosjes së tyre” dhe se “shërbimi shëndetësor duhet të organizohet në atë mënyrë, që do të mundësojë që kërkesat për konsultime mjekësore të ofrohen pa zgjatje të pa nevojshme”*. Dhoma e mjekut, farmacistit, apo infermierisë ishin tejet të amortizuara, si të gjithë ambientet e këtij institucioni, dhe kishin nevojë për investime. Dhoma e infermierisë ishte e vogël me kushte të mira higjieno-sanitare dhe aty mbaheshin edhe një sasi e vogël ilaçesh për urgjencën. Në këtë institucion u vu re se mungonte ambulanca për të shoqëruar personat në spitalet përkatëse të vendit. Institucioni përdorte për transport një automjet tip autoveturë i cili ishte totalisht jashtë çdo standardi dhe nuk dispononte as dokumentacionin e nevojshëm teknik për të qarkulluar si i tillë. Në IEVP, Kosovë-Lushnjë, nuk kishte Sektor të Kujdesit të Veçantë por nisur nga fakti që në këtë institucion kishte të dënuar me probleme të depresionit, është i rëndësishëm që të tregohet kujdes i veçantë sa i takon përzgjedhjes së standardeve të dhomave ku do të qëndrojnë, ndaj higjienës vetjake të tyre, si dhe të mjedisit që i rrethon. Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor, e në veçanti atij të mjekut, u konstatua se kartelat klinike mbaheshin në dollap të mbyllura me çelës në dhomën e mjekut. Gjithashtu u këqyren regjistri i vizitave të mjekut, regjistrat e informacionit 24 orësh të

infirmierëve, të cilat ishin mbajtur me rregull, regjistri i evidentimit të rasteve të dhunës fizike si dhe formatet e kontrollit mjekësor sipas Protokollit të Stambollit lidhur me evidentimin dhe raportimin e rasteve të dhunës.

Të paraburgosurit dhe të dënuarit ishin të pajisur me libreza shëndetësore. Blerja dhe sigurimi i ilaçeve sigurohej edhe blerjet e drejtpërdrejta nga fondi i siguruar nga D.P.Burgjeve. Gjithashtu dhe një pjesë e blerjeve të medikamenteve të urgjencës siguroheshin nga ky fond. Megjithëqë rezultoi se sërish medikamentet ishin të pamjaftueshme për të përmbushur nevojat e të dënuarve.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës, nenit 21, germa “b” të ligjit Nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, si dhe nenit 12, nenit 74/1 pika “b” të ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar

Rekomanduar: Marrjen e masave të menjëhershme lidhur rikonstruksionin e godinave banimit të të dënuarve dhe të paraburgosurve në IEVP Kosovë/Lushnjë për të siguruar ambiente të përshtatshme dhe dinjitoze; marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e përshtatshëm me ngrohje të dhomave të të dënuarve dhe të paraburgosurve në IEVP Kosovë, Lushnjë për t’iu përshtatur kushteve klimaterike; marrjen e masave të menjëhershme për rikonstruksione, riparime, mirëmbajtje, eliminim lagështire dhe lyerjen e dhomave të të dënuarve dhe të paraburgosurve; marrjen e masave të menjëhershme për furnizimin me ujë të pijshëm dhe 24 orë në ditë në ambientet e IEVP Kosovë, Lushnjë; marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e ambienteve të përbashkëta të jetesës duke kryer sa më parë riparimet e nevojshme të tualeteve të përbashkëta në sektorë, riparimin e tubacioneve dhe pajisjeve hidrosanitare të prishura, ndriçuesve dhe lidhjeve elektrike sipas standardeve të sigurimit teknik; marrjen e masave të menjëhershme lidhur me kushtet higjieno-sanitare të të gjitha mjediseve të regjimit, veçanërisht në lidhje me lagështirën dhe me kanalizimet e ujërave të zeza; marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen e plotë të dhomave të të dënuarve dhe të paraburgosurve me orëndi dhe dollapë për vendosjen e rrobave dhe sendeve të tjera personale; marrjen e masave të menjëhershme për të realizuar mbulimin me kamera në mënyrë të plotë në korridoret pranë dhomave të veçim/observimit dhe në tërësi për ambientet e tjera të institucionit; marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen, përshtatjen dhe krijimin e kushteve të jetesës sipas standardeve të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve të dhomës të observim/veçimit; marrjen e masave për rikonstruksionin dhe pajisjen me bazë materiale sipas standardeve të dhomave të takimeve të veçanta në IEVP, Kosovë, Lushnje; marrjen e masave të menjëhershme për të sjellë në përputhje me standardet dhomat e prindërimit me distancë realizuar dhe pajisjen e tyre me bazë materiale për të mundësuar realizimin e takimeve mes të dënuarve dhe fëmijëve të mitur të tyre në kuadrin e garantimit të prindërimit në distancë; marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e nevojave të të dënuarve me medikamentet e nevojshme në IEVP, Kosovë, Lushnje; marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e higjienës në dhomat e banimit të të paraburgosurve/dënuarve, gjithashtu dhe në ambientet e përbashkëta në institucion; marrjen e masave të nevojshme për përmirësimin e shërbimit të sektorit psiko-social në raport me të dënuarit dhe të paraburgosurit në IEVP, Kosovë Lushnje; marrjen e masave të menjëhershme për krijimin dhe vënien në funksion të dhomave të këshillimit psiko-social në godinat e IEVP, Kosovë, Lushnje; marrjen e masave të menjëhershme lidhur me

dezinfektimin e mjediseve të jashtme të IEVP, Kosovë, Lushnjë; marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të plotë sipas parashikimeve në organikën e IEVP, Kosovë, Lushnje ose në mënyrë alternative me dy mjekë me kohë të pjesshme; marrjen e masave për plotësimin e pozicionit të farmacistit sipas parashikimeve në organikën e institucionit; marrjen e masave për pajisjen e IEVP, Kosovë, Lushnje me ambulancë për të garantuar ofrimin e shërbimit në kohë dhe në cilësi për të dënuarit dhe të paraburgosurit dhe për të shoqëruar personat me problem shëndetësore në spitalet përkatëse të vendit; marrjen e masave të menjëhershme për furnizimin me materialet e nevojshme dentare për ofrimin e një shërbimi të plotë dhe adekuat stomatologjik; marrjen e masave për rikonstruksionin e dhomës së mjekut, farmacistit, dhe infermierisë në IEVP, Kosovë, Lushnje; marrjen e masave për krijimin e një Sektori të Kujdesit të Veçantë në IEVP, Kosovë, Lushnje për të dënuarit dhe të paraburgosurit me probleme të shëndetësore; marrjen e masave të menjëhershme për të garantuar akomodimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve në mjedise të përshtatshme banimi duke respektuar normat minimum të hapësirës për person, në institucione të tilla, që janë 6m² për dhomat për një person dhe 4m² për person kur në to sistemohen më shumë banorë; marrjen e masave për vendosjen e një tende në ambientet e ajrimit me qëllim që të mund të përdoren edhe gjatë reshjeve apo ditëve të ngrohta me diell; marrjen e masave për vënien në funksionim të ambienteve për ushtrimin e rriteve fetare të fesë së krishterë; marrjen e masave për përmirësimin e mjedisit të ajrimit për t'iu përshtatur kushteve klimaterike edhe nevojës për gjelbërim; marrjen e masave për rikonstruksionin e ambienteve të palestrës dhe plotësimin e saj me bazë materiale në ambientet e Institucionit të IEVP, Kosovë, Lushnjë; marrjen e masave për shtimin e aktiviteteve dhe takimeve me të dënuarit dhe të paraburgosurit për qëllime rehabilitimi, këshillimi, ri-integrimi, si edhe aktivitete edukative e social-kulturore-sportive; marrjen e masave për krijimin e një ambienti të përshtatshëm biblioteke dhe pasurimin e fondit dhe titujve të librave në IEVP, Kosovë, Lushnje në shërbim të të dënuarve apo të paraburgosurve; marrjen e masave për mbikqyrjen e vazhdueshme të veprimtarisë të njësisë tregtare në IEVP, Kosovë, Lushnje për ofrimin e produkteve të ndryshme për të paraburgosurit dhe të dënuarit; marrjen e masave për të përmirësuar cilësinë dhe larmishmërinë e ushqimit në IEVP Kosovë, Lushnje në shërbim të të dënuarve dhe të paraburgosurve duke shmangur shpërdorimin e tij në vijim; marrjen e masave të nevojshme për instalimin e një skaneri urë në ambientet e IEVP, Kosovë, Lushnje për të bërë të mundur kontrollin me efikasitet të ushqimeve për të dënuarit dhe të paraburgosurit si dhe të një skaneri për kontrollin e personave që hyjnë në këto ambiente; marrjen e masave të nevojshme për rikonstruksionin dhe vënien në funksionim në normalitet të ambienteve të dusheve në Institucionin e IEVP Kosovë, Lushnje; marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin me bazë materiale dhe orendi të dhomës së observim/veçimit; marrjen e masave për ofrimin e shërbimit të lvanterisë nga institucioni për larjen veshjeve për të paraburgosurit/dënuarit.

5.10. IEVP PEQIN

MKPT kreu një inspektim në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Peqin më datë 05.04.2019, sipas një Plani Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Kjo ishte vizitë periodike monitoruese e Avokatit të Popullit në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Peqin për vitin 2019. IEVP Peqin është kategorizuar si burg i sigurisë së lartë, me një seksion sigurie të zakonshme

dhe një seksion paraburgimi. Struktura dhe organika e IEVP Peqin përbëhej nga 361 punonjës nga të cilët 50 ishin punonjës të administratës civile dhe 311 ishin punonjës të policisë së burgjeve. Aktualisht organika e institucionit ishte në tërësi e plotësuar, por shqetësuese ishte mungesa e 3 mjekëve të shërbimit shëndetësor, të cilët ishin të punësuar, por me kontrata pune me kohë jo të plotë. Po ashtu, ndihej dhe mungesa efektive e mjekut stomatolog, i cili për shkak të kryerjes të veprës penale ndodhej me masën e sigurisë “arrest shtëpie” dhe nuk ishte zëvendësuar me tjetër. Kjo situatë vijonte e tillë nga muaji Tetor i viti 2018. Nga informacioni i grumbulluar, në ditën e inspektimit numri i personave që vuanin dënimin në këtë institucion ishte 548 të dënuar/paraburgosur nga 550 persona që ishte kapaciteti fizik i tij. IEVP Peqin është i përbërë nga 4 seksione dhe konkretisht seksioni i sigurisë së lartë me 197 të dënuar, seksioni i sigurisë së zakonshme me 341 të dënuar, seksioni i të paraburgosurve me 10 persona, si dhe seksioni i kujdesit të veçantë (SKV) për akomodimin e personave me probleme të shëndetit mendor. Nga vizita inspektuese u konstatua se të dënuar të moshës 18-21 vjeçare ishin 5 persona, të cilët mbaheshin në dhoma më vete sipas seksioneve. Gjithashtu, në këtë institucion ishin 35 persona me probleme të shëndetit mendor, të cilët trajtoheshin në 2 sektorët e kujdesit të veçantë (SKV) të krijuar njëri në seksionin e sigurisë të lartë dhe tjetri në SKV e seksionit të sigurisë të zakonshme.

Grupi i inspektimit, inspektoi dhe plotësimin e kushteve materiale dhe të jetesës të të dënuarve/paraburgosurve në këtë institucion, duke u përqendruar kryesisht te kushtet e banimit, veshjen, mbipopullimin në dhoma, higjienën personale, kushtet sanitare, cilësinë e përgatitjes dhe shpërndarjes në kohë të ushqimit, ndriçimi, ventilimi, ngrohja, ambientet e takimit me familjarët, komunikimi telefonik, dhe monitorimi me kamera i ambienteve të përcaktuara sipas skemës së sigurisë, etj. Nga këqyrja e këtyre ambienteve dhe nga intervistat me personat e privuar nga liria, u konstatuan një sërë problematikash dhe ankesash që kishin të bënin me plotësimin e kushteve të përgjithshme të jetesës në institucion, sipas detyrimeve ligjore të përcaktuara në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve dhe standardeve ndërkombëtare. Një numër i konsiderueshëm i ankesave u ngritën për ambientet e përbashkëta të dusheve, të cilat ishin pothuajse jashtë funksionit. Përveç faktit që një dush ishte planifikuar mesatarisht për 20 të dënuar, kokat e dushit ishin të dëmtuara dhe gjendja teknike e mureve dhe pllakave në këto ambiente, ishin të amortizuara. Në këto kushte, pajisjet e dusheve si bolierët dhe kokat e dusheve, ishin siguruar nga vetë të dënuarit/paraburgosurit. Ndërkohë që dhe kushtet higjieno-sanitare të këtyre ambienteve nuk ishin të pastra. Ato nuk ishin të lyera dhe të dizinfektuara. Kushtet e ambienteve të vuajtjes së dënimit ishin relativisht të mira. Por në disa dhoma, veçanërisht në ambientet e paraburgimit dhe seksionin e sigurisë së zakonshme, kishin nevojë për riparime pasi kishin lagështirë dhe tualetet brenda dhomave kërkonin riparime për të garantuar higjienën e nevojshme. Gjithashtu, ankesa kishte dhe për mosfunksionimin e sistemit qendror ngrohje/ftohje të ambienteve të banimit në këtë institucion, për t’iu përshtatur kushteve klimaterike. Në mungesë të tij, ngrohja/ftohja në dhoma kryhej me pajisje të siguruara nga vetë të dënuarit/paraburgosurit. Ankesa kishte edhe për numrin e kufizuar të aktiviteteve rekreative në institucion, kryesisht nga të dënuarit e seksionit të sigurisë së lartë. Ata ngritën si shqetësim mungesën e aktiviteteve edukuese, por dhe të aktiviteteve kulturore dhe sportive. Ata ndjeheshin pothuajse të izoluar dhe i vetmi aktivitet për këtë kategori ishte orari i ajrimit. Të dënuarit dhe të paraburgosurit e konsideronin shërbimi mjekësor në këtë institucion jo në nivelin e duhur dhe nuk ofrohej në kohë dhe

në cilësi. Kjo situatë, kishte ardhur për shkak të mungesës së mjekëve, të cilët duhet të punonin me kohë të plotë. Një grup tjetër ankesash kishin të bënin për moszbatimin e skemës së furnizimit me ilaçe, pasi të dënuarit e sëmurë nuk e merrnin këtë shërbim në kohën e duhur dhe për efekt shpejtësie ata i siguronin ilaçet nga familjarët e tyre. Në ditën e monitorimit në ambientet e izolimit ndodheshin 5 (pesë) persona me masë disiplinore, në përputhje me procedurat mbi zbatueshmërinë e ekzekutimit të tyre. Gjatë intervistimit të tyre të dënuarit nuk shfaqën asnjë pretendim lidhur me ushtrim dhune, por 2 prej të dënuarve me masë disiplinore mbaheshin në këto ambiente, përtej afateve të përcaktuara nga Komisioni Disiplinor i këtij institucioni. Gjendja e tyre shëndetësore ishte konfirmuar nga mjeku i institucionit. Institucioni Ekzekutimit të Vendimeve Penale Peqin kishte 1 dhomë veçimi me kapacitet për 2 persona, 4 dhoma observimi me kapacitet për 4 persona dhe 10 dhoma izolimi për personat e dënuar me masë disiplinore. Lidhur me kushtet në këto ambiente, grupi i inspektimit konstatoi se, ishin bërë disa ndryshime duke filluar nga lyerja e tyre dhe deri tek pajisja e të dënuarve me mjetet për mbajtjen e higjienës vetjake.

Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacioneve lidhur me sistemin e kërkesë/ankesave rezultoi se çdo gjë regjistrohej në regjistrin përkatës dhe protokollohej²². Regjistrat mbaheshin nga sekretaria e institucionit. Të dënuarit/paraburgosurit plotësonin një formular kërkesë/ankese dhe ia dorëzonin më pas punonjësit të sektorit të kujdesit dhe shërbimit social. Punonjësi i dërgonte ato brenda ditës në sekretarinë e institucionit ku protokolloheshin dhe pastaj i kalonin drejtorit të institucionit, i cili kthente përgjigje me shkrim apo i takonte vetë të dënuarit ose punonjësit e institucionit zhvillonin takimet sipas rasteve. Brenda në regjim kishte kuti postare ku mund të hidheshin ankesat/kërkesat nga të dënuarit/paraburgosurit drejtuar familjarëve të tyre apo institucioneve të tjera shtetërore. Përsa i takon objektit të këtyre kërkesave, rezultoi se ato konsistonin në kërkimin për leje shpërblyese, takime me familjarë, kërkesë për dinamikën e vuajtjes së dënimit, kërkesë për takim me avokatët, vizitë në spital, transferim, punësim ose kërkesë për blerjen e pajisjeve si TV, frigorifer etj.

Në këtë institucion, sistemi i monitorimit të ambienteve me kamera ishte funksional, por për shkak të infrastrukturës të ndërtimit të godinave paraqiste probleme. Nga inspektimi u konstatua se, hapësira e shkallëve zbritëse të katit të dytë të sektorëve të sigurisë së lartë dhe sigurisë së zakonshme për në ambientet e ajrimit, nuk ishte e monitoruar me kamera. Gjithashtu në ambientin e infermierisë ku mbahen personat e shtruar dhe në korridorin e dhomave të pacientëve, nuk kishte monitorim me kamera. Sipas informacionit të drejtuesit të institucionit, brenda tremujorit të parë të vitit 2019, ishte planifikuar kryerja e një investimi nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për instalimin e një sistemi të ri të kamerave për këtë institucion. Për sa i përket ambienteve të tjera në regjim, veç ambientit të dhomave të banimit, klasave, dhomave të edukimit, palestrave, ambienteve të përbashkëta për zhvillimin e aktiviteteve institucioni kishte 8 dhoma observimi/veçimi, për akomodimin e të dënuarve me konflikte në regjim të cilët nuk kishin gjetur ende përshtatshmëri. Nga intervistimi i të dënuarve/paraburgosurve u kërkua prezenca më e madhe e punonjësve të sektorit juridik në lidhje me kërkesat për dhënie të konsulencave juridike, pasi një pjesë e tyre nuk kishin mundësi financiare për marrjen e avokatëve private. Ndaj ata kërkonin prezencë me të shpeshtë të punonjësve të sektorit

²² Neni 49 i ligjit Nr. 8328 dt. 16.04.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i ndryshuar.

juridik për të përmbushur brenda afateve ligjore kërkesat apo apelimet gjyqësore. Takimet me familjarët në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Peqin zhvilloheshin rregullisht me 2 takime në javë. Në ambientin e takimeve të sigurisë së lartë dhe atij të sigurisë së zakonshme, për të dënuarit dhe familjarët e tyre, ishin krijuar dhoma për takime me nga 3 sportele për secilën, dhoma për takimet speciale të të dënuarve me bashkëshortet apo bashkëjetueset e tyre, si dhe dhoma për prindërimin në distancë. Dhoma për prindërimin në distancë ishte e pajisur me tavolinë dhe karrige, ku të dënuarit/paraburgosurit qëndronin ulur, duke patur kontakte të drejtpërdrejta me fëmijët e tyre. Gjatë takimeve respektohej privatësia dhe takimet zhvilloheshin pa barriera apo kufizime fizike. Në këtë institucion kishte 75 persona të privuar nga liria në marrëdhënie pune. Këto shtetas kompensoheshin sipas skemës 3.9 ditë (heqje nga vuajtja e dënimit) pasi nuk aplikoheshin dhënia e një pagese konkrete në përputhje dhe në varësi të punës së kryer me kompensim në vlerë monetare. Gjithashtu asnjë nga personat e punësuar nuk rezultonte i siguruar nga instancat përkatëse në (ISSH), pasi mungonin aktet nënligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës të dënuarve/paraburgosurve në institucionet penitenciare. Në seksionet e sigurisë së lartë, sigurisë së zakonshme, si dhe në seksionin e paraburgimit baza materiale ishte e plotësuar. Dhomat ishin të kompletuar me shtretër, pajisje dhe orenditë e nevojshme për jetesë. Dhomat e banimit kishin tualete brenda, por në disa dhoma u konstatua mungesa e dymëve në këto ambiente. Për sa i përket dritës dhe ajrit, megjithëse shumica e dhomave ishin të vogla në kubaturë, nuk mungonte ajri dhe drita natyrale. Në ambientet e banimit mjetet akomoduese si tavolinë dhe karrige, paraqiteshin në gjendje të mirë. Por, shtrojet ishin të vjetërsuara, ndërsa batanijet dhe çarçafët një pjesë e konsideruar e të dënuarve ua siguronin familjarët e tyre. Dhomat kishin nevojë për lyerje dhe të dënuarit shfaqën ankesa lidhur me pajisjen e tyre me produkte higjieno-sanitare dhe mjete pastrimi (kova, shtupa pastrimi, kosha plehrash etj). Ata pohuan se nga institucioni jepej normativë mujore vetëm test larës dhe sapunë, dhe për pasojë ambientet e dhomave të dënuarve/paraburgosurve nuk ishin të pastra. Në ambientin e paraburgimit në momentin e inspektimit, u konstatuan dhoma që mungonin pajisje si dollapë për rroba. Në kushtet e mungesës së tyre të paraburgosurit i mbanin teshat në qese plastike ose në thes, kryesisht poshtë shtretërve. Edhe në këtë sektor gjendja e çarçafëve, jastëkëve, shtrojave dhe shtretërve, linte për të dëshiruar. Prezenca e insekteve (furrtareve) ishte një problem në të gjithë institucionin. Korridoret në tërësi ishin të pastra, por qelitë ishin të palyera. Të paraburgosurit shfaqën kryesisht të njëjtat ankesa për mos furnizimin në sasi të mjaftueshme me produkte të higjienës së përbashkët dhe personale. Ndrërimi artificial në dhoma realizohej me dritë llapma neoni. Kjo, përbënte shqetësim për të dënuarit në periudhën e gjumit, pasi ndrërimi ishte i fortë dhe gjatë natës drita për arsye sigurie duhet të qëndrojë e hapur. Lidhur me këtë shqetësim, rekomanduam që dritat e neonit të zëvendësohen me drita më të zbehta që siguria mos të cenohet, por dhe periudha e gjumit është një element i rëndësishëm për shëndetin e këtyre personave. Godina e banimit të dënuarve të seksionit të sigurisë së lartë dhe seksionit të sigurisë së zakonshme përbëhej nga 4 sektorë. Në dhomat e banimit ishin akomoduar deri në 2, 4 dhe 6 persona, në maksimumin e kapacitetit të tyre. Ky rast përbën shkelje të standardit ligjor lidhur me sipërfaqen dhe kubaturën e banimit për një person²³, si dhe është në kundërshtim me rekomandimet e bëra nga CPT

²³ Shiko nenin 30 pika 1 e VKM nr. 437, datë 20.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”.

për Shqipërinë.²⁴ Dushet ishin të përbashkëta për çdo seksion. Në shumicën e rasteve të dënuarit larjen e trupit e kryenin në dhoma duke ngrohur ujin me pajisjet e siguruara nga vetë ata. Në ambientet e dusheve kishte lavamanë me katër ose pesë dushe, por funksional ishin një ose dy prej tyre. Në këto ambiente, vihej re prania e lagështirës, amortizimi i pllakave, si dhe mungesa të kokave të dusheve. Nga intervistat e kryera me të dënuarit në të gjitha sektorët u pohua se dushi realizohej përgjithësisht një herë në javë. Furnizimi me ujë dhe energji elektrike e ambienteve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Peqin, ngelet një problem serioz. Furnizimi me ujë të rrjedhshëm, sikurse u informuam, në këtë institucion vazhdonte të ishte me orar të reduktuar (dy orë, tre herë në ditë). Ndërsa furnizimi me energji elektrike kishte problem me linjën kryesore të furnizimit pasi ishte e dëmtuar. Ankesa kishte edhe në lidhje me mungesën e ujit të ngrohtë në dushet e përbashkëta, ku si rezultat i ngarkesës (mesatarisht 1 dush për 20 persona) mundësia e përdorimit të tyre nga të dënuarit dhe të paraburgosurit ishte e pamjaftueshme, megjithëse ishin marrë masa që të realizohej dushi sipas një grafiku 2 herë në javë. Ngrohja në dhoma në periudhën e dimrit realizohej më pajisjet e siguruara nga të dënuarit, pasi mungonte një sistem qendror për ngrohje me kaldajë. Në ambientet e klasave dhe dhomat ku zhvilloheshin aktivitetet e përbashkëta, ngrohja mungonte. Sektori i veçimit/observimit në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Peqin kishte 6 dhoma dhe 12 shtretër. Në sektorin e veçimit/observimit në ditën e inspektimit nuk gjendej asnjë person. Ndërsa në dhomat e izolimit ndodheshin 5 persona me masë disiplinore. Në sektorin e izolimit kishte 10 dhoma të pajisura me tualete brenda. Ky seksion kishte ambient ajrimi. Sikundër e theksuam, 2 nga këta persona qëndronin në këto ambiente jashtë çdo kriteri ligjor. Nga informacioni i drejtuesit e institucionit, këta persona qëndronin aty me dëshirën e tyre, për arsye të mospërshtatjes me ambientet dhe personat e tjerë të dënuar në regjim. Në sektorin e sigurisë të lartë dhe të sigurisë të zakonshme kishte palestra, klasa dhe dhoma këshillimi. Kishte një sallë kompjuterësh dhe të gjithë kompjuterët ishin në gjendje funksionale. Palestrat ishin pajisur me mjete të sjella nga vetë të dënuarit. Aktivitetet sportive që zhvilloheshin në ambientet e ajrimit konsistonin kryesisht në futboll, volejboll dhe lojëra tavoline, sipas programit të miratuar nga sektori i edukimit. E drejta për ushtrimin e riteve fetare, zbatohej rregullisht. Në këtë institucion ishin krijuar 2 ambiente kulturi, xhamia për besimtarët mysliman dhe kisha për besimtarët e krishterë. Këto ambiente ishin me hapësirë të bollshme, kishin ndriçim dhe ishin të pajisur me materialet e nevojshme. Këto rite kryheshin rregullisht sipas grafikut të miratuar nga drejtuesit e institucionit në bashkëpunim me përfaqësuesit e komuniteteve fetare të zonës. Cilësia e ushqimit në institucion dhe shërbimi i vakteve gjatë ditës, ishte një nga aspektet që u monitorua gjatë vizitës inspektuese. Nga intervistat me të dënuarit/paraburgosurit kishte pretendime për cilësinë e keqe të ushqimit dhe mungesën e larmisë, por nga vizita në kuzhinën e institucionit rezultoi se ushqimi i përgatitur për vaktin e drekës ishte i cilësisë së kënaqshme dhe mjedisi ishte i lyster dhe i pastër. Normat e ushqimit dhe menyuja ishin të afishuara në mur. Personeli i kuzhinës ishte i pajisur me uniformë dhe doreza pune, si dhe me librezë shëndetësore. Kampionet e ushqimit ndodheshin sipas vakteve në

²⁴ Albania: Visit 1997 [par.127] Komiteti për Parandalimin e Torturës (CPT) pranë Këshillit të Europës me rastin e vizitës në Shqipëri, në vitin 1997, i ka rekomanduar autoritetet Shqiptare:

“Të dënuarit/paraburgosurit të akomodohen në dhoma jo me pak se 22 m² në rastet kur vendosen 6 veta në dhomë dhe 10 m² në rastet kur vendosen 2 veta në dhomë. Gjithashtu, dhomat më të vogla se 6 m² nuk plotësojnë standardet minimale për një dhomë burgu dhe duhet të nxirren jashtë shërbimi.

frigorifer, të mbyllur me çelës. Të sëmurët diabetik trajtoheshin me gatim të diferencuar, por grupi i inspektimit nuk konstatoi ruajtjen e kampioneve të ushqimit për këtë kategori. Kuzhina ishte e pajisur me aspiratorë, por nuk ishte në gjendje pune të plotë, për shkak të defekti teknik. Një problematikë tjetër, ishte dhe mungesa e ujit të ngrohtë në çezma, e nevojshme për larjen e enëve të kuzhinës, pasi bolieri që i furnizonte ishte djegur dhe nuk punonte. Përgjithësisht, kushtet e përgatitjes së ushqimit në ambientet e kuzhinës së institucionit, rezultuan në gjendje të mirë. Në këtë institucion, funksiononte një lavanderi e cila dhe përdorej për të plotësuar nevojat e institucionit për larjen e teshave personale dhe kryesisht çarçafët dhe batanijet për të dënuarit/paraburgosurit. Nga 4 lavatriçe që ndodheshin në këtë ambient, vetëm 2 ishin në gjendje pune. Larja e teshave kryhej nga të dënuar të punësuar, pasi personeli ishte shkurtuar pas miratimit të organikës së re. Në lidhje me orarin e ajrimit u konstatuan se ajrimi ditor zgjaste deri 3 (tre) orë dhe ky orar ishte edhe më i gjatë në periudhën e verës. Shumë prej të intervistuarve nëpër dhoma, të pyetur për aktivitetet apo programet që ata merrnin pjesë, kërkuan që aktivitetet e përbashkëta edukative ose sportive të jenë të larmishme, të kenë më shumë mjete dhe pajisje sportive në dispozicion të tyre, si dhe më shumë orë qëndrimi në ambientin e ajrimit. Në lidhje me trajnimet profesionale në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Peqin, për periudhën e inspektimit, konstatoam se nuk ishte ofruar asnjë kurs profesional nga Qendra Rajonale e Formimit Profesional në Elbasan. Librat që gjendeshin në inventarin e bibliotekës vihehin në dispozicion të të paraburgosurve apo të dënuarve për lexim sipas kërkesave. Një pjesë e të paraburgosurve dhe të dënuarve ishin regjistruar dhe kishin hapur kartelë personale nëpërmjet të cilës ata tërhiqnin dhe dorëzonin librat. Gjatë vizitës në regjim grupi inspektues u shoqërua nga stafi i sektorit të kujdesit dhe shërbimit social i cili përbëhej nga 8 punonjës social, ndër ta 2 psikologë. Për sa i përket mbështetjes psiko-sociale që merrnin të burgosurit, u konstatua se aktivitetet që ofroheshin ishin të pakta në raport me numrin e personave dhe përbëheshin kryesisht nga diskutimet në grup për tema sociale dhe këshillime në klasa. Sipas stafit të institucionit, të paraburgosurit dhe të dënuarit regjistroheshin në disa aktivitete, por jo gjithmonë i frekuentonin ato. Aktivitetet kulturore të organizuara nga vetë institucioni në bashkëpunim me Qendra Kulturore Rajonale, ishte pothuajse inekzistente. Dosjet psiko-sociale të të paraburgosurve/dënuarve të moshës 18-21 vjeç ishin të gjitha të plotësuar dhe të freskuara me përmbledhjet nga takimet e fundit me to. Një problem që ishte evident për sektorin e kujdesit social ishte mungesa materialeve dhe mjeteve të veçanta brenda në seksione për punën individuale dhe në grup me të dënuarit/paraburgosurit, mungesë që ndikon në mënyrë të veçantë impaktin e punës së stafit psikosocial me të dënuarit. Gjatë vizitës në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Peqin, si dhe nga intervistat me të dënuarit, u konstatuan problematika lidhur me shërbimin shëndetësor. Ankesat konsistonin kryesisht në mungesën e mjekut me kohë të plotë, vonesat në përgjigjen për kryerjen e vizitave mjekësore, si dhe disa mungesa në medikamente të cilat shpesh mbuloheshin me kontributet e sjelljes nga familjet e tyre. Skema e rimbursimit të ilaçeve nuk funksiononte njësoj për të gjithë personat që vuanin dënimin në këtë institucion. Të dënuarit ishin të pajisur me librezat shëndetësore, ndërsa të paraburgosurit kishin vështirësi për zbatimin e kësaj skeme, për shkak të vonesave në plotësimin e dokumentacionit të dosjeve personale.

Organika e sektorit shëndetësor përbëhej nga 10 punonjës, prej të cilëve 3(tre) mjekë, 1 (një) stomatolog, 1(një) ndihmës mjek/farmacist, 1(një) laborant dhe 4 ndihmësmjekë. Nga intervistat me të dënuarit problematika më shqetësuese ishte mungesa e mjekut me kohë të plotë, pasi të 3 mjekët që

kryenin këtë detyrë ishin me kontrata me kohë të pjesshme. Ata kryenin vizitat, sipas orareve të parashikuar në kontratat me institucionin, por nuk ishin prezent kur kishte shqetësime për shëndetin nga të dënuarit. Mungesa e mjekut me kohë të plotë, kishte sjellë për pasojë vonesa të përgjigjeve ndaj kërkesave për vizita mjekësore, si dhe për konsultat jashtë institucionit me mjekë specialiste në spitalin e rrethit. Mungesa e mjekut me kohë të plotë ka një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë dhe mbulimin e shërbimit shëndetësor dhe për shmangien e situatave të tilla, duhen marrë masa të menjëhershme për plotësimin e stafit pasi mund të ketë raste urgjente të cilat personeli i mesëm shëndetësor nuk mund t'i përballojë. Në të njëjtën kohë, fakti që mjeku është i pranishëm në këtë institucion vetëm pjesërisht gjatë ditës dhe më pas, vetëm në kushte të domosdoshmërisë njoftohet ndihma urgjente mjekësore, shkakton në mënyrë të drejtpërdrejtë shkeljen e të drejtës për qasje deri te mjeku nga ana e personave të dënuar apo të paraburgosur. Shërbimin stomatologjik gjithashtu ishte pothuajse inekzistent, për mungesë të mjekut stomatolog, i cili siç e kemi lartpërmendur, për shkak të kryerjes së veprës penale, ishte dhënë masa e sigurisë “arrest në shtëpi”, prej 7 muajsh. Për çdo nevojë të dënuarit/paraburgosurit dërgoheshin jashtë institucionit në klinika private. Kjo situatë ishte shqetësuese edhe për drejtuesit e institucionit, pasi shërbimi stomatologjik jo vetëm nuk sigurohej në kohë për të dënuarit/paraburgosurit, por sipas nevojave të të dënuarve, institucioni ishte i detyruar ti dërgonte të sëmurët në klinika private të zonës.

Po ashtu, institucioni kishte 2 seksione të kujdesit të veçantë (SKV), një ishte në seksionin e sigurisë të lartë dhe një në seksionin e sigurisë të zakonshme. Kushte e përgjithshme në këto ambiente ishin të mira. Dhomat e pacientëve mbaheshin të pastra e me rregull nga personeli sanitar i stafit shëndetësor. Institucioni ishte i pajisur me një Ambulance. Të sëmurët në seksionin e kujdesit të veçantë (SKV) të sigurisë të zakonshme ngrinin shqetësimin se në këto ambiente qëndronin persona që nuk ishin pajisur me kartela dhe pa rekomandimin e mjekut. Kapaciteti i Seksionit të Kujdesit të Veçantë ishte për 20 të sëmurë ku 9 prej tyre (sipas ankesave) ishin pa asnjë rekomandim të mjekut, por ishin me dijeninë e personelit të shërbimit të policisë të regjimit të brendshëm. Dhoma e mjekut, dhoma e stomatologut dhe farmacisë ishin të rregullta dhe të mirëmbajtura. Dhoma e stomatologut ishte e pajisur me unit, autoklavë, të cilat funksiononin mirë, por mungonin materialet dhe instrumentet dentare dhe kryesisht materialet për riparime. Skema e medikamenteve të rimbursueshme funksiononte konform Marrëveshjes Trepalëshe (Drejtor i IEVP – DRSKSH - Depo Farmaceutike). Lidhur me medikamentet të cilat nuk janë pjesë e Skemës së Rimbursueshme, institucioni e kryente blerjen e tyre përmes fondit të posaçëm për rastet në fjalë. Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor, në veçanti ai i mjekut, u konstatua ekzistenca e një regjistri vizitash themeltar, regjistri i të sëmurëve kronike, si dhe regjistri për konsultat që mbahen jashtë institucionit. Të gjithë formatet e kontrollit mjekësor ishin të mbajtura me rregull, po ashtu edhe regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve. Por mungonte formulari tip konform Protokollit të Stambollit me të dhënat specifike (shenja dhune, fraktura faciale, fraktura gjymtyrësh, shputa duarsh dhe këmbësh) për rastet kur Komisioni i Pritjes dhe kryesisht mjeku konstaton shenja dhune të dukshme apo të deklaruara nga vetë i paraburgosuri/dënuari.

Gjithashtu ky institucion referuar numrit të lartë të personave me probleme të shëndetit mendor, e vuan prezencën e një mjeku psikiatër për vizita periodike. Duke marrë shkas nga numri i lartë i të sëmurëve, specifika institucionale dhe dinamika e lartë e problematikave tek të paraburgosurit/dënuarit lidhur me gjendjen e tyre emocionale apo problemet e mbartura gjatë vuajtjes së dënimit në një kohe relativisht

të gjatë, prezenca e psikiatrit ishte e domosdoshme pasi mund të ndihmojë në parandalimin e agravimit të gjendjes të shëndetit të tyre mendor. KY shërbim mundësohet vetëm në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve (IVSHB) Tiranë, ndërkohë që Spitali Psikiatrik Elbasan, si spitali më i afërt, mund ta mundësojë këtë shërbim përmes një marrëveshjeje ndërinstytucionale.

Në fund të vizitës, grupi i inspektimit zhvilloi një takim përmbyllës me drejtorin e IEVP Peqin, me të cilin u biseduan të gjitha problematikat e hasura gjatë inspektimit, për të cilat drejtuesi i këtij institucioni i vlerësoi dhe u angazhua se, në bashkëpunim me stafin do të ndërmerrenin masat e menjëhershme për t'i zgjidhur çështjet që i përkisnin detyrave dhe përgjegjësiive të tij institucionale të ngarkuar me ligj.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës, nenit 21, gërma “b” të ligjit Nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, si dhe nenit 12, nenit 74/1 pika “b” të ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar

Rekomanduum: Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e organikës të institucionit me 3 mjekë të përgjithshëm dhe mjek stomatolog me kohë të plotë, për t’ju përgjigjur nevojave dhe kërkesave të të dënuarve/paraburgosurve për vizita mjekësore dhe ofrimin e një shërbimi shëndetësor sa më cilësor; marrjen e masave të menjëhershme për nënshkrimin e një marrëveshjeje të Institucionit me Spitalin Psikiatrik Elbasan, për prezencën e një mjeku psikiatër të paktën një herë në muaj, me qëllim trajtimin mjekësor të personave me probleme të shëndetit mendor kundrejt specifikave mjekësore, si dhe për parandalimin në kohë të ecurisë së sëmundjeve të shëndetit mendor; marrjen e masave të nevojshme për vënien në zbatim të plotë të skemës tre-paleshe të rimbursimit të ilaçeve për të gjithë të dënuarit/paraburgosurit; marrjen e masave të menjëhershme për riparimin e kokave të dusheve në ambientet e përbashkëta, zëvendësimin e bolierëve të prishur, si dhe ndërrimin e pllakave të amortizuara; marrjen e masave të menjëhershme për transferimin në sektorë të personave të dënuar që qëndronin të akomoduar në ambientet e izolimit përtej afateve ligjore, çka përbën në vetvete trajtim çnjerëzor dhe degradues të këtyre personave; marrjen e masave të menjëhershme për të plotësuar mjediset e punës të punonjësve të sektorit të kujdesit dhe shërbimit social, kryesisht klasat e edukimit brenda në seksionet e institucionit, me materiale dhe orendi të nevojshme, që ti shërbejnë riedukimit të të dënuarve/paraburgosurve; marrjen e masave për mundësimin e kurseve profesionale në bashkëpunim me Qendrën e Formimit Profesional, me qëllim rehabilitimin dhe riintegrimin e të paraburgosurve/dënuarve në jetën sociale; marrjen e masave të menjëhershme për përfshirjen në programet vjetore të punës së sektorit të kujdesit dhe shërbimit social, rritja e larmisë të aktiviteteve kulturore dhe sportive me qendra kulturore rajonale; marrjen e masave për zëvendësimin në dhomat e banimit të të dënuarve të dritave të neonit me drita më të zbehta, për të garantuar gjatë natës elementët e sigurisë, por dhe gjumin si një element i rëndësishëm për shëndetin e këtyre personave; marrjen e masave për rregullimin e situatës së shpërblimit për punën e kryer të të dënuarve/paraburgosurve, sipas dispozitave të nenit 34 dhe 35 të Ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar.

5.11. IEVP TEPELENË

MKPT kreu inspektim ne Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Tepelenë, më datë 11.12.2019, sipas një Plani Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit Kjo ishte vizita periodike monitoruese e Avokatit të Popullit në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Tepelenë, për vitin 2019. Ky institucion ka një kapacitet maksimal prej 75 personash. Në ditën e inspektimit, në mjediset e institucionit ishin 90 persona, nga të cilët 70 të paraburgosur dhe 20 të dënuar. Rrjedhimisht, mbipopullimi ishte një problematikë e qenësishme, duke pasur parasysh edhe infrastrukturën e këtij institucioni e cila është një ndërtesë e ndërtuar prej vitit 1970 dhe ka një amortizim të përgjithshëm të ndërtesës. Theksojmë se në gjashtëmujorin e fundit të dhënave e mbipopullimit janë si më poshtë: Organika e IEVP Tepelenë përbëhet nga 107 punonjës nga të cilët 78 ishin punonjës të policisë së burgjeve dhe 29 punonjës civilë. Përgjatë inspektimit grupi i punës konstatoi se kishte, prej disa muajsh mungesë stafi të punonjësve civil, nga të cilat pozicione të rëndësishme për shërbimet e ofruara ndaj të dënuarve/paraburgosurve. Juristi në institucion është vakant prej datës 11.10.2019Psikologia në institucion mungon prej datës 18.03.2019Aktivitetet psiko-sociale zhvillohen të mangëta për arsye të mungesës së personelit dhe faktit që edukatorja nuk mund të ofrojë asistencën psikologjike për këta të dënuar. Sipas të dhënave që u morën gjatë kësaj vizite, informacioneve të marra nëpërmjet intervistave konfidenciale me personat e privuar nga liria, si dhe bisedat me stafin e institucionit, rezultoi se: Të dënuarit dhe të paraburgosurit e konsideronin jo në nivelin e duhur, shërbimin e sektorit psiko-social në IEVP Tepelenë. Gjithashtu sipas të dënuarve shërbimi mjekësor në këtë institucion nuk ishte i rregullt dhe nuk ofrohej në kohë dhe në cilësi. Ankesa kishte për mungesën e juristit në institucion, për të dënuarit dhe paraburgosurit ishte kthyer në shqetësim pasi për ta, është i nevojshme për plotësimin e kërkesave që kanë të bëjnë me dinamikën e vuajtjes së dënimit dhe përfaqësimit të tyre në gjykatë për kërkesat e ndryshme që ata kanë. Gjithashtu, disa shprehën shqetësimin se nuk mund të përfitonin lejet shpërblyese për shkak të mungesës së juristit që të plotësonin dokumentacionin përkatës. Ankesa kishte për mungesën e ambulancës, sipas tyre në rast të paraqitjes së një komplikacioni shëndetësor të të dënuarit, makina e shoqërimit shërben si mjet për transportimin e tyre në spitalin rajonal, ose në spitalin e Gjirokastrës. Për drejtorin e institucionit mungesa e ambulancës është shqetësuese pasi në rastin kur ka lindur nevoja për transportimin e të dënuarve për mjekim në Tiranë, është e pamundur pasi për distancë të largët nuk mund të vihet në dispozicion makina e sigurisë. Ankesa kishte dhe për vizitat mjekësore dhe ilaçet të cilat për efekt shpejtësie duhej t'i siguronin nga familjarët, sikurse edhe për shërbimin stomatologjik i cili nuk funksiononte normalisht si rezultat i mungesës së materialeve. Ankesa kishte për mungesën e kurseve të gjuhës së huaj bazuar në kërkesat dhe nevojat e të dënuarve me qëllim edukimin vazhdues të të dënuarve dhe përshtatjen e tyre pas vuajtjes së dënimit.

Ankesa kishte për furnizimin me ngrohje në IEVP Tepelenë për t'iu përshtatur kushteve klimaterike. Ankesa të shumta vinin për kushtet e ambienteve të vuajtjes së dënimit, të cilat jo vetëm që ishin me lagështirë të theksuar, por kishin mungesa në orendi dhe dollapë për vendosjen e rrobave dhe sendeve të tjera personale. Ankesa gjithashtu kishte lidhur me mungesën e njësisë tregtare, brenda IEVP Tepelenë, gjë kjo që kishte shkaktuar vështirësi tek të dënuarit/paraburgosurit për sigurimin e produkteve bazë të domosdoshme personale. Ankesa kishte edhe për mungesën e aktiviteteve rekreative në IEVP Tepelenë. Gjithashtu të dënuarit dhe të paraburgosurit në IEVP, Tepelenë

konfirmonin faktin se nuk ekzistonin ambiente për ushtrimin e rriteve fetare. Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacioneve lidhur me sistemin e kërkesë/ankesave rezultoi se çdo gjë regjistrohej në regjistrin përkatës dhe protokollohej²⁵. Regjistrat mbaheshin nga sekretaria e institucionit. Të paraburgosurit/ dënuarit plotësonin një formular kërkesë/ankese dhe ia dorëzonin më pas punonjësit të sektorit psiko-social. Punonjësi i dërgonte në sekretarinë e institucionit ku protokolloheshin dhe pastaj i kalonin drejtorit të institucionit, i cili kthente përgjigje me shkrim apo i takonte vetë të dënuarit. Sa i takon objektit të këtyre kërkesave na rezultoi se konsistonin në kërkimin për leje shpërblyese, takime me familjarë, kërkesë për dinamikën e vuajtjes së dënimit, kërkesë për takim me avokatë, vizitë në spital, transferim, punësim ose kërkesë për blerjen e pajisjeve si TV ose frigorifer. Sistemi i monitorimit me kamera vëzhgimi ishte funksional. Në I EVP Tepelenë kamerat monitoronin pjesën më të madhe të mjediseve për 24 orë, ndërkohë që të dhënat ruheshin në server për një periudhë rreth dy javore. Observimi si sektor i rëndësishëm për mbajtjen, kujdesin e veçante të paraburgosurve të cilët akomodohen rishtazi në I EVP Tepelenë, funksiononte dhe ishte i pajisur me orendi. Telefonat punonin në çdo kohë dhe të dënuarit apo të paraburgosurit e intervistuar, pohuan se mund të flisnin sa herë të dëshironin me të afërmit e tyre nëpërmjet telefonave me kartë që ndodheshin në mjedisin e regjimit të brendshëm dhe në mjedisin e ajrimit. Nuk pati ankesa nga të dënuarit/paraburgosurit për mosrespektim të numrit të takimeve me familjet. Në I EVP Tepelenë ishte krijuar një mjedis i veçantë për të paraburgosur/dënuar që kishin fëmijë të vegjël lidhur me ushtrimin e të drejtës së prindërimit në distancë, me të cilët mund të takoheshin pa barriera apo kufizime fizike por ky ambient kishte nevojë për investime dhe orendi për të qenë sa më i përshtatshëm. Në I EVP Tepelenë kishte disa të dënuar që punonin kryesisht si pastrues, sanitarë, shpërndarës ushqimi etj. Seksioni i paraburgimit ka një dhomë veçimi e cila ka dritë natyrale dhe dritë artificiale, gjithashtu është e pajisur me 2 shtretër me sfungjer.

Një dhomë ishte e posaçme për personat e paraburgosur të moshës 18-21 vjeç, ku ishin akomoduar 7 veta. Nga takimi me të paraburgosurit u shprehën se punonjësit e sigurisë ishin të gjithë të sjellshëm nuk referuan raste dhune. Kubatura e dhomës ishte e vogël dhe e pamjaftueshme për kapacitetin me 7 të dënuar. Nga vëzhgimi i dhomave konstatohet se në ato që ka mbi 5 të paraburgosur janë të vogla dhe nuk u sigurojnë hapësirën e nevojshme të parashikuar nga rregulloret. Ndërkohë që kishte dhoma të cilat ishin akuzuar vetëm 3 ose 4 të dënuar. Lidhur me kushtet në regjimin e burgut u vërejtën: Dhoma të gjitha kanë ndriçim natyral dhe artificial, gjithashtu sigurohet dhe ajrimi. Dhomat janë të pajisur me tualete. Shtretërit kanë të gjithë dyshekë (sfungjer). Të dënuarve u është lejuar mbajtja e televizorit dhe frigoriferit. Pothuajse të gjitha dhomat kishin tualete brenda. Ajrimi për katet kryhej në ambiente të veçanta të ndara nga njëra-tjetra. Në hyrje të godinës gjendej një ambient ajrimi i cili përdorej për personat me probleme të shëndetit mendor, izolim/veçimin, si edhe 18-21 vjetarët (aktualisht ishin 7 të paraburgosur në moshën 18-21 vjeçare). Gjithashtu ky ambient i veçantë përdorej për kryerjen e ajrimit edhe për personat e tjerë kur konstatohesh se ata kishin konflikte dhe mosmarrëveshje me njëri-tjetrin. Në dhomat e inspektuara nga grupi i ekspertëve, u vu re se baza materiale nuk ishte e plotësuar si duhej, dhe kishte mungesë pajisjesh ose orendi të amortizuara. Nisur

²⁵ Neni 49 i ligjit Nr. 8328 dt.16.04.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i ndryshuar.

nga situata e mbipopullimit edhe hapësira brenda disa dhomave, ishte e kufizuar. Nuk kishte bazë materiale në ambientet e përbashkëta, pasi aktualisht në IEVP Tepelenë nuk kishte të tilla përveç ambienteve të ajrimeve. Ambientet e takimit me familjarët gjendeshin në një dhomë të përbashkët për të dy sektorët. Në këtë ambient të takimeve gjendeshin 3 sportele të ndara me kangjella hekuri. Një dhomë e vogël prej gati 2-3 m² sipërfaqe që gjendej në hyrje të godinës, përdorej si ambient për prindërimin në distancë por kjo dhomë nuk kishte orenditë e duhura për t'u konsideruar si ambient takimi, megjithëse kjo ishte e vetmja mundësi e parë si zgjidhje nga ana e institucionit për shkak të mbipopullimit dhe mungesës së ambienteve shtesë. Gjithashtu kishte një ambient për takime speciale ndërmjet bashkëshortëve të pajisur me bazë materiale sipas standardeve por që kishte nevojë për rikonstrukcion. Problem kishte me higjienën e mjediseve nisur nga fakti që institucioni në tërësinë e tij ishte i amortizuar. Nga intervistat e bëra nëpër dhoma nga të paraburgosurit apo të dënuarit pati shumë ankesa për mungesën e investimeve në IEVP Tepelenë për të garantuar cilësinë e higjienës brenda në institucion. Cilësia e ujit ishte e mirë dhe furnizimi në një pjesë të institucionit ishte 24 orë në ditë. Në IEVP Tepelenë larja në dushe zhvillohej mesatarisht dy herë në javë Duset ishin të instaluar nga 2 në çdo regjim përkatësisht 2 në paraburgim dhe 2 në burgim, në ambientin e dusheve lagështirë e theksuar, tavani ishte shumë i dëmtuar, kokat e dusheve ishin të dëmtuara, kishte amortizim të theksuar të pllakave dhe tubacioneve. Në IEVP Tepelenë nuk kishte një njësi tregtare për ofrimin e produkteve të ndryshme për të paraburgosurit dhe të dënuarit.

Kuzhina funksiononte në kushte normale pasi pajisjet e gatimit dhe sistemi i aspirimit ishin të standardeve industriale duke qenë se ishin vendosur së fundmi. Në IEVP Tepelenë punonin 3 (tre) kuzhinierë. Në kuzhinë ndodhej regjistri i normativave ushqimore dhe menyuja ditore ishte e afishuar. Regjistrat e kontrollit të ushqimit dhe të menusë së gatimit ishin të sekretuar dhe të protokolluar. Ushqimi ofrohet rregullisht tre vakte dhe përsa i takon cilësisë ë tij titullari i institucionit kishte mbajtur një procesverbal konstatimi që garantonte se cilësia ishte në nivelin e mirë. Kampionët e ushqimeve mbaheshin në kushte frigoriferike dhe të etiketuar sipas vakteve përkatëse. Gjithashtu u konstatuan edhe racionet përkatëse për të sëmurët diabetikë në këtë institucion. Përgjithësisht, kushtet e përgatitjes së ushqimit në ambientet e kuzhinës të institucionit, rezultuan në gjendje të mirë. Megjithatë të dënuarit dhe të paraburgosurit shfaqën ankesa lidhur me cilësinë e ushqimit i cili nuk kishte larmishmëri u evidentua se një masë e madhe e të burgosurve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Tepelenë nuk e konsumojnë ushqimin e përgatitur në institucion, duke shpërdoruar një pjesë të konsiderueshme të tij. Mjaft të dënuar kanë pohuar se e merrnin ushqimin nga të afërmit e tyre dhe se nuk e konsumonin ushqimin e institucionit, për shkak se nuk e pëlqenin atë. Trajnime profesionale në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Tepelenë nuk kishte pasi në këtë njësi administrative nuk kishte shërbime të tilla të ofruara nga Qendra Rajonale e Formimit Profesional apo organizata të ndryshme. Për sa i përket mbështetjes psiko-sociale që merrnin të burgosurit, gjatë takimit me stafin e sektorit të kujdesit psiko-social, u konstatua se aktivitetet që ofroheshin ishin të pakta dhe përbëheshin kryesisht nga diskutimet në grup për tema sociale, këshillime në ambientet e ajrimit, ose në dhomën e improvizuar të takimeve me avokatin kur ajo ishte e lirë, si dhe nga aktivitetet sportive. Në sektorin e edukimit ka vetëm një edukator punonjës social dhe organika nuk është e plotë. Aktivitetet psiko-sociale zhvillohen të mangëta për arsye të mungesës së personalit dhe faktit që edukatorja nuk mund të ofrojë asistencën psikologjike për këta të dënuar.

Dosjet psiko-sociale ishin të plotësuara mirë, me përmbledhjet nga takimet e fundit me të dënuarit, me vlerësimet e tre mujoreve dhe gjithë dokumentet e tjera mbështetëse. Pengesë për kryerjen e punës nga stafi i edukimit dhe nga ai psiko-social ishin mungesa e ambienteve të përbashkëta dhe e dhomave të këshillimit. Gjatë vizitës në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Tepelenë si dhe nga intervistat me të dënuarit, problematikat u konstatuan lidhur me shërbimin shëndetësor. Ankesat konsistonin kryesisht në mungesat e medikamenteve, të cilat shpesh mbuloreshin me kontributet e sjelljes nga familja. Skema e furnizimit me ilaçe funksiononte vetëm për të sëmurët kronikë. Ndërsa për sa i përket shërbimit stomatologjik, ai kishte probleme për shkak të mungesës së bazës materiale. Personeli i kujdesit mjekësor në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Tepelenë përbëhej nga 1(një) mjek, 1(një) farmacist, 1(një) stomatolog dhe 4(katër) infermierë. Mjeku aktual punonte me kohë të pjesshme, mungesa e mjekut me kohë të plotë ka një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë dhe mbulimin e shërbimit shëndetësor dhe për shmangien e situatave të tilla, duhen marrë masa të menjëhershme për plotësimin e stafit pasi mund të ketë raste urgjente të cilat personeli shëndetësor nuk mund t'i përballojë dhe pasojat mund të jenë të rënda. Në të njëjtën kohë, fakti që mjeku është i pranishëm në këtë institucion vetëm pjesërisht gjatë ditës dhe më pas, vetëm në kushte të domosdoshmërisë thirret ndihma urgjente mjekësore, shkakton në mënyrë të drejtpërdrejtë shkeljen e së drejtës për qasje deri te mjeku nga ana e personave të dënuar apo të paraburgosur Dhoma e mjekut, farmacistit, apo infermierisë ishin të amortizuara, si të gjithë ambientet e këtij institucioni, dhe kishin nevojë për investime. Dhoma e infermierisë ishte e vogël me kushte të mira higjieno-sanitare dhe aty mbaheshin edhe një sasi e vogël ilaçesh për urgjencën. Në këtë institucion u vu re se mungonte ambulanca për të shoqëruar personat në spitalet përkatëse të vendit. Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Tepelenë u evidentua edhe kishte të dënuar probleme të shëndetit mendor dhe për rrjedhojë u konstatua se organet kompetente duhet të marrin të gjitha masat që shërbimi i kujdesit mjekësor ndaj tyre të përmbushë standardet e të jetë sa më eficient në funksion të shëndetit, persona me probleme të shëndetit mendor kanë nevojë për tu dërguar në një institucion të posaçëm shëndetësor pasi ambienti i burgut nuk ju ofronte shërbimet e nevojshme shëndetësore duke marrë parasysh diagnozat e tyre të cilat janë (Psikoza Skizofrenike dhe Suspect Skizofrenie).

Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Tepelenë nuk kishte Sektor të Kujdesit të Veçantë në një kohë që për të dënuarit me probleme të shëndetit mendor duhet të tregohet kujdes i veçantë sa i takon përzgjedhjes së standardeve të dhomave ku do të qëndrojnë, ndaj higjienës vetjake të tyre, si dhe të mjedisit që i rrethon. Në institucion janë 8(shtatë) të dënuar që kanë referuar se janë ish përdorues të lëndëve narkotike por vetëm njëri prej tyre trajtohej me methadone. Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor, e në veçanti atij të mjekut, u konstatua se kartelat klinike mbaheshin në dollap të mbyllura me çelës në dhomën e mjekut. Gjithashtu u këqyren regjistri i vizitave të mjekut, regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve, të cilat ishin mbajtur me rregull, por mungonte regjistri i evidentimit të rasteve të dhunës fizike si dhe formatet e kontrollit mjekësor sipas Protokollit të Stambollit lidhur me evidentimin dhe raportimin e rasteve të dhunës. Të paraburgosurit dhe të dënuarit ishin të pajisur me librezë shëndetësore. Skema e furnizimit dhe rimbursimit të ilaçeve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Tepelenë sipas kontratës tre paleshe ISKSH, depo farmaceutike nuk funksiononte. Lidhur me këtë problematikë blerja dhe sigurimi i

ilաճեւե սիցւրոհեյ քըրկոհըսիտ նգա քերյեթ ե ճրեյքըրճրեյտա նգա քոնդիս ի սիցւրուար նգա D.P.Burgjeve. Gjithashtu dhe blerjet e medikamenteve të urgjencës siguroheshin nga ky fond.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës, nenit 21, germa “b” të ligjit Nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, si dhe nenit 12, nenit 74/1 pika “b” të ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar

Rekomanduum: Marrjen e masave të menjëhershme për reduktimin e mbipopullimit në I EVP Tepelenë; marrjen e masave për plotësimin e vendit vakant të juristit, me qëllim që personave të dënuar/paraburgosur t’ju garantohen të drejtat procedural; marrjen e masave për plotësimin e vendit vakant të psikologut, mungesa e specialistit psikolog ka sjellë për të dënuarit e I EVP Bëncë, mosrealizimin e plotë të aktiviteteve psiko-sociale dhe ndihmën e nevojshme, për përmirësimin dhe rehabilitimin e tyre; marrjen e masave për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të plotë sipas parashikimeve në organikën e institucionit; marrjen e masave të menjëhershme për reduktimin e mbipopullimit në I EVP Tepelenë; marrjen e masave të menjëhershme për riparime, mirëmbajtje, eliminim lagështire dhe lyerjen e dhomave të të dënuarve dhe të paraburgosurve; marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e ambienteve të përbashkëta të jetesës duke kryer sa më parë riparimet e nevojshme të tualeteve të përbashkëta në sektorë, riparimin e tubacioneve dhe pajisjeve hidrosanitare të prishura, ndriçuesve dhe lidhjeve elektrike sipas standardeve të sigurimit teknik; marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e përshtatshëm me ngrohje të dhomave të të dënuarve dhe të paraburgosurve në I EVP Tepelenë për t’iu përshtatur kushteve klimaterike; marrjen e masave të menjëhershme për vënien në zbatim të skemës së furnizimit dhe rimbursimit të ilaճeւe në I EVP Tepelenë sipas kontratës tre paleshe ISKSH, depo farmaceutike; marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e higjienës në dhomat e banimit të të paraburgosurve/dënuarve, gjithashtu dhe në ambientet e përbashkëta në institucion; marrjen e masave për pajisjen e I EVP Tepelenë me ambulancë për të shoqëruar personat në spitalet përkatëse të vendit; marrjen e masave të menjëhershme për furnizimin me materialet e nevojshme dentare për ofrimin e një shërbimi të plotë dhe adekuat stomatologjik; marrjen e masave për rikonstruksionin e dhomës së mjekut, farmacistit, dhe infermierisë në I EVP Tepelenë; marrjen e masave për krijimin e një Sektori të Kujdesit të Veçantë në I EVP Tepelenë për të dënuarit dhe të paraburgosurit me probleme të shëndetësore; marrjen e masave për rikonstruksion dhe plotësimin me materiale dhe orendi të dhomës së veçantë për ta bërë sa më të përshtatshme për takime të të dënuarve dhe të paraburgosurve me fëmijë të mitur në kuadrin e prindërimit në distancë; marrjen e masave për vënien në funksionim të ambjenteve për ushtrimin e riteve fetare; marrjen e masave për realizimin e kurseve të gjuhës së huaj bazuar në kërkesat dhe nevojat e të dënuarve me qëllim edukimin vazhdues të të dënuarve dhe përshtatjen e tyre pas vuajtjes së dënimit; marrjen e masave për përmirësimin e mjedisit të ajrimit për t’iu përshtatur kushteve klimaterike edhe nevojës për gjelbërim; marrjen e masave për shtimin e aktiviteteve dhe takimeve me të dënuarit dhe të paraburgosurit për qëllime rehabilitimi, këshillimi, ri-integrimi, si edhe aktivitete edukative e social-kulturore-sportive; marrjen e masave për hapjen e një njësie tregtare për ofrimin e produkteve të ndryshme për të paraburgosurit dhe të dënuarit; marrjen e masave për të përmirësuar cilësinë dhe larmishmërinë e ushqimit në I EVP Tepelenë në shërbim të të dënuarve dhe të

paraburgosurve duke shmangur shpërdorimin e tij në vijim; marrjen e masave të nevojshme për rikonstruksionin e ambienteve të dusheve në IEVP Tepelenë.

5.12. IEVP “JORDAN MISJA” TIRANË

MKPT kreu inspektim në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) “Jordan Misja” Tiranë, më datë 04.09.2019. IEVP “Jordan Misja”, Tiranë është kategorizuar si institucion paraburgimi me një seksion për personat që klasifikohen si “bashkëpunëtorë të drejtësisë” sipas kritereve të Ligjit Nr.10461 datë 13.09.2011 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë” si edhe me një seksion të posaçëm për instalimin e masave të reja të regjimit të sigurisë së lartë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale (i ashtuquajturit 41-bis) në kuadrin e ndryshimeve të Nenit 13/1 të Ligjit Nr. 8328 dt. 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar²⁶. IEVP “Jordan Misja” Tiranë duke marrë parasysh marrjen në dorëzim të godinave të reja në fillimin e vitit 2019 ka një kapacitet maksimal të miratuar prej 482 personash. Në ditën e inspektimit, në mjediset e institucionit ishin 486 persona, nga të cilët 452 të paraburgosur (ndërkohë që 8 të paraburgosur ishin të moshave 18-21 vjeçare) dhe rreth 34 të dënuar me vendim të formës së prerë por që ishin në pritje të ardhjes në rrugë institucionale të vendimeve të zbardhura nga gjykatat kompetente. Ky numër i lartë të paraburgosurish dhe të dënuarish ishte rrjedhojë e transferimit të personave pranë IEVP, “Jordan Misja” duke qenë se IEVP “Vaqarr” është në proces rikonstruksioni. Paralelisht me transferimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve me Urdhërin Nr.3499 datë 17.04.2019 “Për komandimin në detyrë të punonjësve civilë”, ishte transferuar edhe personeli i shërbimit të policisë së burgjeve dhe administrata e IEVP “Vaqarr” pranë IEVP, “Jordan Misja”. Në sektorin e observimit aktualisht ndodheshin 15 persona dhe IEVP, “Jordan Misja” Tiranë kishte një Sektor të Kujdesit të Veçante (SKV) të ndarë në dy godina ku konkretisht në godinën “A” gjendeshin 29 persona në ditën e inspektimit dhe në godinën “B” të përbërë nga 7 (shtatë) dhoma ndodheshin 25 persona. Aktualisht funksiononte edhe një seksion sigurie për të paraburgosurit të cilët janë dëshmitarë të drejtësisë (konkretisht gjendeshin 6 persona), sipas kritereve të Ligjit Nr.10461 datë 13.09.2011 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë”. Në IEVP, “Jordan Misja” Tiranë ishte ndërtuar edhe një ambjent i ri konkretisht Godina “B” me një kapacitet prej 264 personash që ishte marrë në dorëzim në fillimin e vitit 2019. Në këtë godinë ishin transferuar të paraburgosurit dhe të dënuarit e IEVP “Vaqarr”. Në IEVP, “Jordan Misja” Tiranë ishte ndërtuar edhe një ambjent i ri izolimi i posaçëm Godina “C” me një kapacitet midis 20-40 personash për instalimin e masave të reja të regjimit të sigurisë së lartë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale (i ashtuquajturit 41-bis) në kuadrin e ndryshimeve të Nenit 13/1 të Ligjit Nr. 8328 dt. 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar²⁷. Kjo godinë aktualisht ishte e pabanuar dhe po plotësohej me disa detaje të vogla që lidheshin me vendosjen e citofonave në ambjentet e takimit mes të dënuarve dhe familjarëve të tyre. Gjatë takimit me drejtorin

²⁶ Neni 13/1 i ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar.

²⁷ Neni 13/1 i ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar.

e komanduar të IEVP, “Jordan Misja” ekspertët e MKPT-së u informuan se: “Një nga tre godinat ku strehohen të paraburgosurit, godina “C”, do të shërbejë për të vendosur të paraburgosurit që do të nënshtrohen regjimit të posaçëm të sigurisë. Kjo godinë ishte e përfunduar.” Ajrimi i të paraburgosurve në regjimin e posaçëm do të kryhej në gjysmën e sheshit që rrethohet nga tre godinat e të paraburgosurve dhe nga godina e administratës. Gjysma e sheshit për këtë kategori ishte e ndarë në katër bokse ajrimi. Ndërkohë, Ministri i Drejtësisë kishte miratuar Rregulloren e Regjimit të Posaçëm me Urdhërin Nr.380, dt. 19.07.2019. Struktura dhe organika e IEVP, “Jordan Misja”, Tiranë ishte e miratuar me Urdhërin Nr.58 datë 24.04.2017 të Kryeministrit të RSH “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithëshme të Burgjeve dhe institucioneve të varësisë së saj”, dhe ajo përbëhej nga 210 punonjës dhe 1 (një) drejtues, plus 2 (dy) punonjës së SHKBB nga të cilët 35 ishin punonjës të administratës civile dhe pjesa tjetër ishin punonjës të policisë së burgjeve. Aktualisht ishin të paplotësuar vetëm 2 (dy) pozicione për punonjës të nivelit n/inspektor të regjimit të brendëshëm.

Aktualisht organika e IEVP, “Jordan Misja”, Tiranë ishte e përbërë nga sektori i burimeve njerëzore, sektori juridik, sektori financiar, sektori i logjistikës, sektori shëndetësor (me një mjek, një stomatolog, një farmacist, 5 ndihmësmjekë), sektori i çështjeve shoqërore (i përbërë nga 8 persona ku mes të cilëve dy psikologë ushtrojnë shërbim të mirëfilltë psikologjik dhe nga punonjës socialë dhe edukatorë) dhe sektori i policisë. Infrastruktura e regjimit të brendëshëm të IEVP, “Jordan Misja”, Tiranë është e përbërë nga 3 (tre) godina përkatësisht A, B dhe C.

Sipas të dhënave që u morën gjatë kësaj vizite, informacioneve të marra nëpërmjet intervistave konfidenciale me personat e privuar nga liria, si dhe bisedat me stafin e institucionit, rezultoi se: Ishin realizuar investime për përmirësimin e kushteve të jetesës në 2 (dy) godina të reja (Godina “B” dhe Godina “C”) me dhoma të reja të paraburgosurve/dënuarve dhe dhomave të observim/veçimit, dhe ambiente të reja për veprimtari, ajrim dhe ambiente të posaçme. Ishin marrë masat e nevojshme për instalimin e një skaneri urë në ambientet e IEVP, “Jordan Misja” për të bërë të mundur kontrollin me efikasitet të ushqimeve për të dënuarit dhe të paraburgosurit si dhe të një skaneri për kontrollin e personave që hyjnë në këto ambjente. Ishin marrë masa për pasurimin e inventarit të bibliotekës në (IEVP), “Jordan Misja” Tiranë, në dispozicion të paraburgosurve apo të dënuarve për lexim. Ishin marrë masa për shtimin e aktiviteteve dhe takimeve me të paraburgosurit/dënuarit dhe në veçanti për 18-21 vjeçarët për qëllime rehabilitimi, këshillimi, ri-integrimi, si edhe aktivitete edukative e social-kulturore. Kishte përmirësim të cilësisë së shërbimeve të ofruara nga stafi psiko-social, për shtimin e kontakteve por kishte nevojë sërish për shtimin e aktiviteteve riintegruese dhe social-kulturore në përgjithësi. Aktivitetet dhe veprimtaritë me karakter sportiv nuk zhvilloheshin për shkak të mungesës së ambienteve përveç ushtrimit në palestër e cila kishte shumë pak bazë materiale. Të dënuarit dhe të paraburgosurit ishin plotësuar me libra shëndetësore dhe numrat respektive të sigurimit shëndetësor.

Ndërkohë që në krahasim me inspektimin e realizuar një vit më parë nga Avokati i Popullit disa rekomandime nuk kishin gjetur zbatim dhe nuk ishin plotësuar. IEVP, “Jordan Misja” Tiranë kishte problematikë në Godinën “A” në funksionimin në normalitet të sistemit të ngrohjes për t’iu përshtatur kushteve klimaterike në një orar më të gjatë si rezultat i rrjetit elektrik të amortizuar. IEVP “Jordan

Misja” Tiranë nuk kishte autoambulancë. Nuk funksiononte normalisht skema tre-paleshe e rimbursimit të ilaçeve për të gjithë të dënuarit/paraburgosurit. Aktivitetet sportive nuk zhvilloheshin për shkak të mungesës së ambienteve. Vijonte problematika e bashkëjetesës së të paraburgosurve me të dënuarit, në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), “*Jordan Misja*” Tiranë, duke bërë të mundur nevojën për transferimin e shpejtë të personave që ishin dënuar me vendim të formës së prerë drejt institucioneve të tjera të vuajtjes së dënimit. Gjithashtu si në çdo institucion vijonte problemi i cilësisë dhe larmishmërisë së ushqimit në (IEVP), “*Jordan Misja*” Tiranë në shërbim të të dënuarve dhe të paraburgosurve. Nuk zhvilloheshin kurse të arsimit dhe ato profesionale në favor të personave të paraburgosur/dënuar në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), “*Jordan Misja*” Tiranë, megjithëse ishin bërë përpjekje për të mundësuar këtë veprimtari nga ana e administratës së institucionit. Nga informacioni i marrë, nga bisedimi në grup dhe në privatësi me të paraburgosurit, dhe të dënuarit, grupi monitorues nuk evidentoi pretendime për tejkalim të forcës fizike nga ana e punonjësve të policisë së burgjeve. Megjithatë, nga intervistat rezultoi se kishte disa ankesa që ishin të lidhura kryesisht me kushtet e përgjithshme të jetesës në institucion. Sikurse u përshkrua edhe më sipër, në ditën e inspektimit në IEVP, “*Jordan Misja*”, Tiranë numri i personave të paraburgosur ose të dënuar ishte i përafërt me kapacitetin e institucionit çka tregon që nuk kishte mbipopullim. Ankesa vinin për kushtet e ambienteve të përbashkëta të vuajtjes së dënimit, dhe veçanërisht të ambienteve të ajrimit sidomos për pjesën e Godinës “A” të cilat sipas tyre ishin shumë të kufizuara dhe kjo u konstatua edhe nga ekspertet e MKPT-së.

Gjithashtu ankesa kishte për sigurimin e përshtatshëm me ngrohje në IEVP, “*Jordan Misja*” Tiranë për pjesën e Godinës “A” për t’iu përshtatur kushteve klimaterike.

Ankesa kishte edhe për numrin e kufizuar të aktiviteteve rekreative në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), “*Jordan Misja*” Tiranë. Ankesa kishte dhe për ilaçet të cilat për efekt shpejtësie në disa raste duhej t’i siguronin nga familjarët. Lidhur me kushtet në këto ambiente ishin bërë disa ndryshime pozitive sidomos lidhur me Godinën “B” e cila ishte e re dhe me standarde e higjienizuar dhe funksiononte në normalitet. Konstatohet rregullsi në ambientet e dusheve dhe mbajtja pastër e ambienteve të përbashkëta. Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacioneve lidhur me sistemin e kërkesë/ankesave rezultoi se çdo gjë regjistrohej në regjistrin përkatës dhe protokollohej²⁸. Regjistrat mbaheshin nga sekretaria e institucionit. Sa i takon objektit të këtyre kërkesave na rezultoi se konsistonin në kërkimin për leje shpërblyese, takime me familjarë, kërkesë për takim me avokatë, vizita në spital, punësim ose kërkesë për blerjen e pajisjeve si TV ose frigorifer.

Ekspertët morën informacion në lidhje me pritjen e të paraburgosurve në institucion dhe funksionimin e Komisionit të Pritjes, si dhe në lidhje me plotësimin e regjistrave e dosjeve personale të tyre. Nga biseda me punonjësit e institucionit dhe verifikimeve në dosjet përkatëse, grupi monitorues konstatoi se procedura e pranimit në institucion zbatohet në mënyrë korrekte. Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacionit rezultoi se veprimet regjistroheshin në regjistrin përkatës dhe protokolloheshin.

²⁸ Neni 49 i ligjit Nr. 8328 dt. 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar.

Sistemi i monitorimit me kamera vëzhgimi ishte funksional. Institucioni ishte i pajisur tërësisht me kamera vëzhgimi. Në IEVP, “*Jordan Misja*” Tiranë kamerat monitoronin të gjitha mjediset për 24 orë, ndërkohë që të dhënat ruheshin në server për një periudhë 30 ditore. Cilësia e pamjeve të kamerave ishte mjaft e mirë. Telefonat punonin në çdo kohë dhe të dënuarit apo të paraburgosurit e intervistuar, pohuan se mund të flisnin sa herë të dëshironin me të afërmit e tyre nëpërmjet telefonave me kartë që ndodheshin në mjedisin e regjimit. Konkretisht zhvilloheshin 4(katër) takime për çdo të paraburgosur plus takime shtesë sipas kërkesave të ligjit. Në IEVP, “*Jordan Misja*”, Tiranë ishte krijuar nga një mjedis i veçantë si në Godinën “A” ashtu edhe në Godinën “B” për të paraburgosurit që kishin fëmijë të vegjël lidhur me ushtrimin e të drejtës së prindërimit në distancë, me të cilët mund të takoheshin pa barriera apo kufizime fizike. Këto dhoma ishte e pajisur me tavolinë dhe karrige, ku të paraburgosurit qëndronin ulur, duke patur kontakt fizik me fëmijët e tyre. Në IEVP, “*Jordan Misja*” Tiranë kishte 5 (pesë) të paraburgosur/dënuar që punonin kryesisht si pastrues, sanitarë, shpërndarës ushqimi etj. Nga takimi i grupit inspektues më të paraburgosurit dhe dënuarit që punonin brenda institucionit këta të fundit nuk kishin pretendime për kushtet e punës. Të dënuarit që punonin përfitonin nga ulja e dënimit me 3.9 ditë në muaj. Kjo procedure ndiqej pasi ende nuk janë miratuar aktet nënligjore të nevojshme për të garantuar të drejtën për punësim dhe për shpërblim të drejtë të punës, për të burgosurit, sipas standardeve ligjore në fuqi. Punësimi i të paraburgosurve/dënuarve rregullohej sipas neneve 34,35, të Ligjit Nr. 8328 dt. 16.04.1998, “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*”, i ndryshuar. Në nenin 34 të ligjit të cituar më sipër ndërmjet të tjerave parashikohet se: “*Puna nuk ka karakter dënimi dhe shpërblehet sipas kriterëve të përcaktuara me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.*” Megjithëse në nenin 76 të këtij ligji parashikohet miratimi nga Këshilli i Ministrave i akteve nënligjore në zbatim të tij brenda tre muajve nga hyrja në fuqi, deri më tani nuk është nxjerrë e miratuar VKM-ja lidhur me kriteret për shpërblimin e punës së të dënuarve dhe të paraburgosurve. Avokati i Popullit thekson se puna dhe kriteret e shpërblimit duhet të parashikohen dhe rregullohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, vendim i cili edhe pse tej çdo afati ligjor²⁹, ka shumë vite që nuk është miratuar.

Ekspertët e MKPT-së gjatë inspektimit i kushtuan një vëmendje të veçantë edhe masave të reja të regjimit të sigurisë së lartë në IEVP, “*Jordan Misja*”, Tiranë (i ashtuquajturit 41-bis) në kuadrin e ndryshimeve të Nenit 13/1 të Ligjit Nr. 8328 dt. 16.04.1998, “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*”, i ndryshuar. Konkretisht ky regjim i posaçëm ishte instaluar në Godinën “C” të IEVP, “*Jordan Misja*”, Tiranë që kishte 5 (pesë) kate. Në katin 0 ofroheshin shërbimet dhe aty ndodhej mjedisi i takimit me familjarët, pesë vende takimi të ndara me xham (citofonia nuk ishte vendosur ende); një dhomë e takimit me avokatin/prokurorin/opgj; një dhomë këshillimi, e vetmja për të gjithë godinën; mjedisi i tualeteve dhe dusheve, i ndarë në bokse, tre dushe dhe tre ëc allaturka (nuk është e qartë kush do ti përdorë dushet në katin e shërbimeve, pasi çdo kat ka dushe më vete). Në katër katet e tjera, një ndër të cilët është ndërtuar nëntokë, ndodheshin dhomat e të paraburgosurve dhe dushet e përbashkëta. Në çdo kat kishte 5(pesë) dhoma. Dhomat kishin nga dy

²⁹ Nenet 76 dhe 77 të ligjit nr. 8328 dt. 16.04.1998, “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*”, i ndryshuar.

shtretër të fiksuar në dysHEME, një tavolinë të vogël të fiksuar në dysHEME në një nga këndet e dhomës, një kalorifer për ngrohje, një tualet me WC allaturka, me një lavaman dhe një pasqyrë alumini të fiksuar në murë me vida. Dritarja ishte e mbyllur me dy kanate me xham dhe e siguruar me zgarë hekuri dhe me grilë hekuri të fiksuar në mur. Dushet e përbashkëta kishin 6 (*gjashhtë*) bokse për tu larë. Kokat e dusheve ndodheshin në lartësinë jo më shumë se dy metra nga dysHEMEJA, të fiksuara në murin ndarës të bokseve. Në korridor ishin vendosur dy kartofona të dy kompanive të ndryshme. Qëllimi i regjimit të posaçëm është për të parandaluar: kontakte me organizatën kriminale ku i burgosuri bën pjesë; konflikte me element të organizatave kundërshtare; ndërveprim me të burgosurit e tjerë që i përkasin të njëjtës organizatë ose organizatave të tjerë bashkëpunuese; komunikimin apo shkëmbimin e sendeve ndërmjet të burgosurve që i përkasin grupimeve të ndryshme. Kjo nuk do të thotë që këta të burgosur të privohen nga aktivitetet sportive, kulturore, krijuese, shërbimi bibliotekarë, veprimtari që i shërbejnë edhe rehabilitimit/riintegrit të të burgosurit. Përkundrazi, aktivitetet në këtë regjim janë edhe më të domosdoshme për të zbutur rreptësinë e kufizimeve. Nga monitorimi në Godinën “C” u konstatua se kishte vetëm një dhomë këshillimi për të gjithë të paraburgosurit dhe asgjë tjetër. Edhe pajisjet e dhomës ishin shumë të kufizuara dhe nuk justifikohen me qëllimin e regjimit. Tavolina brenda secilës dhomë ishte tepër e vogël për të ngrënë dhe lexuar qoftë edhe për një të burgosur të vetëm. Ndërsa dhoma ishte menduar për të strehuar 2(dy) të paraburgosur. Këndi ku ishte vendosur tavolina nuk i mundëson të paraburgosurit ndriçim gjatë ngrënies apo leximit, sepse drita artificiale dhe natyrale ndodhen në shpinë të tij kur të ulet. Grila e hekurit që siguron dritaren nuk mundëson ndriçim natyral të bollshëm dhe ajrosje të dhomës ku ta paraburgosurit mund të qëndrojnë deri 23 orë të mbyllur. Neni 8/2 i Rregullores së Regjimit të Posaçëm parashikon se, ndriçimi, drita artificiale, ngrohja do të jenë sipas kërkesave të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve. Neni 30/1 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve përcakton se: *“Dritarja duhet të mundësojë ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral normal për të lexuar e punuar. Kokat e dusheve të fiksuara në lartësinë jo më shumë se dy metra nga dysHEMEJA i krijojnë lehtësi të paraburgosurit për të kryer vetëvrasje”*. Është për tu theksuar se institucioni i Avokatit të Popullit e ka marrë në shqyrtim edhe me parë projektligjin për regjimin e posaçëm, për të vlerësuar përputhshmërinë e tij me Kushtetutën, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga RSH, me vendimet e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe me ligjin Italian për të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve. Në përfundim të analizës rezultoi se, regjimi i posaçëm i parashikuar në projektligj, në thelb, nuk vinte në kundërshtim me aktet ligjore të lartpërmendura dhe me vendimet e GJEDNJ. Disa nga komentet dhe propozimet e realizuara nga institucioni i Avokatit të Popullit janë pasqyruar në ndryshimet e bëra të Nenit 13/1 të Ligjit Nr. 8328 dt. 16.04.1998, *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*, i ndryshuar.

Shqetësimi i MKPT-së mbetet, nëse I EVP, *“Jordan Misja”* Tiranë ka llogjistikën e duhur për ta bërë të zbatueshëm regjimin e posaçëm duke ruajtur një ekuilibër midis sigurisë dhe dinjitetit të të burgosurve. Është për tu theksuar se, në zbatim të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese, Ministria e Drejtësisë Italiane i ka dërguar një qarkore drejtorive të burgjeve lidhur me organizimin e seksioneve ku mbahen të burgosurit subjekt të regjimit të posaçëm. Në këtë qarkore, ndër të tjera, urdhërohet që: *“ushtrimi në mjedise të hapura të zgjatet deri në 4 orë në ditë; fusha e ajrimit në dy burgje duhet të*

ketë pajisjet e nevojshme për aktivitet fizik dhe sportiv; në sektorët ku mbahen të burgosur subjekte të regjimit të posaçëm duhet të shtohet një ose më shumë dhoma për aktivitetet sociale, kulturore dhe krijuese; takimet me fëmijët nën 16 vjeç duhet të zhvillohen pa ndarjen me xham³⁰”. Lidhur me këtë shqetësim institucioni i Avokatit të Popullit i ka kërkuar shpjegime Ministrisë së Drejtësisë nëse ishte bërë ndonjë analizë para se të propozohej projektligji. Shkresa drejtuar Ministrisë së Drejtësisë i është nisur për dijeni edhe Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvend. Ministria e Drejtësisë ka kthyer një përgjigje lidhur me llogjistikën duke u shprehur se, është bërë një vlerësim paraprak për kapacitetet infrastrukture. Avokatit i Popullit si një institucion kushtetues i kushton një vëmendje të veçantë çështjes së respektimit të të drejtave të të dënuarve dhe të paraburgosurve që ndodhen në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) në Republikën e Shqipërisë dhe në mënyrë periodike kryen monitorime pranë tyre si dhe paraqet rekomandime për problematikat apo gjetjet që mund të evidentohen gjatë këtij procesi. Për rrjedhojë edhe implementimi i ndryshimeve me Ligjin Nr.108/2018, “Për një shtesë në Ligjin Nr.8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” i ndryshuar, si një çështje mjaft delikate që lidhet me të drejtat e njeriut kërkon një kujdes të veçantë dhe do të jetë pjesë e procesit të inspektimit vazhdues nga ana e Avokatit të Popullit. Është shumë me rëndësi që Ligji Nr.108/2018, “Për një shtesë në Ligjin Nr.8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” i ndryshuar, është i një natyre të posaçme, që synon të sanksionojë privimin e disa të drejtave dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve, por në vetvete një vend i veçantë në tërësinë e tij i kushtohet edhe pjesës që i takon trajtimit human të tyre, pasi ka të drejta themelore që i përkasin të gjithëve - madje edhe personave që qëndrojnë në burg. Është për tu theksuar se regjimi “41-bis” synon që masat e posaçme të sigurimit dhe të sigurisë merren vetëm në raste përjashtimore. Gjithashtu në rast aplikimi të masave të tilla ka procedura të qarta ku natyra, kohëzgjatja dhe kushtet në të cilat zbatohet ato përcaktohen nga legjislacioni kombëtar. Infrastruktura e përgjithshme e institucionit me marrjen në dorëzim të godinave të reja ishte e mirë me ndarje të rregullta të godinave dhe ofronte funksionalitet në lëvizje dhe në elementë të sigurisë përveç Godinës “A” e cila ishte e amortizuar dhe kishte problematikë në këtë drejtim. Në Institucion baza materiale ishte e plotësuar. Ishte siguruar kompletimi me shtretër dhe gjithashtu kishte edhe gjendje në magazinë dhe nuk kishte asnjë person që flinte në tokë. Edhe në dhomat e inspektuara nga grupi i ekspertëve, u vu re se baza materiale përgjithësisht ishte e plotësuar si duhej. Për sa i përket dritës dhe ajrit, megjithëse shumica e dhomave ishin të vogla në kubaturë, nuk mungonte ajri dhe drita natyrale. Dhomat përgjithësisht ishin të pajisura me orenditë e nevojshme si tavolinë, karrige dhe dollapë. Në dhoma ishin akomoduar 1-4 persona. Problematikë ishte çështja e furnizimit me detergjente dhe materiale pastrimi e të paraburgosurve. Theksojmë se Komiteti për Parandalimin e Torturës shprehet se norma minimum e hapësirës për person, në institucione të tilla, është 6m² për dhomat për një person dhe 4m² kur në to sistemohen më shumë persona. Në këtë normë nuk mbahet parasysh sipërfaqja e tualetit, që mund të ndodhet brenda dhomës. Gjithashtu, sipas standardit të Komitetit për Parandalimin e Torturës, duhet respektuar dhe distanca ndërmjet mureve të dhomave, që duhet të jetë jo më pak se

³⁰ Case of Enea v. Italy, fq.12, pika 38

2m distancë ndërmjet mureve të dhomës dhe jo më pak se 2.5m distancë nga dyshemeja me tavanin e dhomës.³¹ Nisur nga fakti që në institucion nuk kishte mbipopullim u evidentua se në dhomat e Godinës “B”, ky standard respektohej por kishte një numër të madh dhomash në Godinën “A”, ku ky standard nuk respektohej si rrjedhojë e faktit që kjo e fundit ishte godinë e vjetër dhe e trashëguar nga më parë. Nga ana tjetër është për tu theksuar se në këtë institucion funksiononte dhe përdorej për banim edhe 1(një) ndërtesë (Godina A) e cila ishte trashëguar nga kohë më parë dhe për rrjedhojë edhe parashikimi i hapësirave të kërkuara është i kushtëzuar nga numri i personave që gjenden të paraburgosur për të garantuar respektimin e hapësirës jetike. Ndërkohë edhe çështja e ngrohjes së ambienteve për shkak të kushteve klimaterike kishte problematikë lidhur me oraret që aplikoheshin si dhe me faktin që rrjeti elektrik në Godinën “A”, aktuale ishte i amortizuar. Por nga ana e IEVP, “*Jordan Misja*”, Tiranë ishin marrë disa masa edhe më parë për të lejuar futjen e ngrohësave të lëvizëshëm brenda dhomave gjatë stinëve të ftohta. Vendosija e ngrohësave sërish krijonte ngarkesë në rrjet dhe defekte elektrike. Dushet ishin të mirëmbajtura dhe në kushte të mira higjene. Nga intervistat që u bënë në të gjitha sektorët dhe në të 2(dy) godinat e banimit u pohua se dushi realizohej përgjithësisht 2 (dy) herë në javë. Cilësia e ujit në IEVP, “*Jordan Misja*” Tiranë ishte e mirë dhe furnizimi me ujë nuk kishte probleme. Takimet me familjarët në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), “*Jordan Misja*” Tiranë zhvilloheshin rregullisht. Në ambientet e takimeve, gjendeshin sportele të mirëmbajtura, në të 2 (dy) godinat e banimit ku familjarët zhvillonin biseda me të dënuarit/paraburgosurit. Ambienti i takimit ishte i vendosur në katin e parë të dy godinave (A-B) të institucionit dhe ishte i ndarë. Të paraburgosurit/dënuarit mund të komunikonin lirshëm me familjarët e tyre, ulur në stola, gjithmonë nën vëzhgimin në distancë të punonjësit të policisë. Respektohej privatësia. Sektori i observimit në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), “*Jordan Misja*” Tiranë funksiononte normalisht. Në sektorin e obeservimit ditën e inspektimit gjendeshin 15 persona. Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), “*Jordan Misja*” Tiranë kishte palestër, klasa dhe dhoma këshillimi. Palestrat ishin pajisur me mjete nga institucioni si dhe me mjete të sjella nga vetë të paraburgosurit/dënuarit. Aktivitetet sportive konsistonin kryesisht në lojëra tavoline siç janë lojëra me letra dhe domino dhe nuk zhvilloheshin lojëra futbollit pasi nuk kishte ambiente. Ambienti i kultit ishte i bollshëm, i ndriçuar dhe i mirëpajisur. Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), “*Jordan Misja*” Tiranë kishte 12 (dymbëdhjetë) ambiente ajrimi nga të cilat 4 (katër) ndodheshin në katin e tretë të Godinës ‘A’ dhe 8 (tetë) ndodheshin në katin e parë. Këto ambiente ishin të pastra dhe të mirëmbajtura. Në këto ambiente ndodheshin gjithashtu edhe telefona ku të paraburgosurit/dënuarit i shfrytëzonin për të kontaktuar me familjarët. Telefonat ishin funksionalë në të gjitha ambientet e ajrimit. Kuzhina e institucionit ishte e madhe dhe moderne, me higjienë të mirë. Muret e kuzhinës ishin të lyera. Kishte edhe magazinë për ushqimet. Kuzhina funksiononte në kushte normale pasi pajisjet e gatimit dhe sistemi i aspirimit ishin të standardeve industriale. Në kuzhinë ndodhej regjistri i normativave ushqimore dhe menyuja ditore ishte

³¹ Vendimi Nr.437, datë 20.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”, Neni 30 parashikon se: “Në vendosjen e të paraburgosurve apo të të dënuarve mbahen parasysh kushtet dhe mundësitë konkrete të çdo IEVP-je, por në çdo rast duke iu siguruar kubatura jo më pak se 9m3 dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4m2 për çdo person të paraburgosur apo të dënuar, dritare që mundësojnë ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral normal për të lexuar e punuar”.

e afishuar. Regjistrat e kontrollit të ushqimit dhe të menusë së gatimit ishin të sekretuar dhe të protokolluar. Stafi i kuzhinës ishte i kompletuar.

Kampionët e ushqimeve mbaheshin në kushte frigoriferike dhe të etiketuar sipas vakteve përkatëse. Gjithashtu u konstatuan edhe racionet përkatëse për të sëmurët diabetikë në këtë institucion. Përgjithësisht, kushtet e përgatitjes së ushqimit në ambientet e kuzhinës të institucionit, rezultuan në gjendje të mirë. Megjithatë të dënuarit dhe të paraburgosurit shfaqën disa ankesa lidhur me cilësinë e ushqimit i cili nuk kishte larmishmëri.

Gjatë inspektimit u vu re se zhvilloheshin aktivitete të përbashkëta nga të cilat mund të përfitonin të dënuarit/paraburgosurit të cilat ishin kryesisht ndjekja e programeve të televizorit, lojërat e tavolinës siç janë lojëra me letra dhe domino. Në lidhje me ajrimin u konstatua se ajrimi ditor zgjaste mbi 3 (tre) orë sipas rregullores dhe ky orar ishte edhe më i gjatë në periudhën e verës. Shumë prej të intervistuarve nëpër dhoma të pyetur për aktivitetet apo programet që ata marrin pjesë kërkuan të kenë më shumë aktivitete të përbashkëta edukative ose sportive. E drejta për të mbajtur kontakte me familjarët dhe miqtë zbatohet përgjithësisht sipas rregullores. Takimet realizoheshin mesatarisht rreth 4 herë në muaj, në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve. Takimi me familjarët zgjaste rreth 20 minuta. Për sa i përket mbështetjes psiko-sociale që merrnin të burgosurit, gjatë takimit me stafin e sektorit të kujdesit psiko-social, u konstatua se aktivitetet që ofroheshin përbëheshin kryesisht nga diskutimet në grup për tema sociale dhe këshillime në klasa. Sipas stafit të institucionit të paraburgosurit dhe të dënuarit regjistroheshin në disa aktivitete, por jo gjithmonë i frekuentonin ato. Sa i takon veprimtarive rikrijuese, u vërejt se në IEVP, “*Jordan Misja*” Tiranë ato që zhvilloheshin më së shumti ishin lojërat e tavolinës, pasi personat mund të luajnë edhe në dhomën e tyre, ose edhe në ambientet e ajrimit (lojra me letra, domino dhe shah).

Gjatë vizitës në IEVP, “*Jordan Misja*” Tiranë si dhe nga intervistat me të dënuarit, problematika u konstatuan kryesisht në mungesat e medikamenteve, të cilat shpesh mbuloheshin edhe me kontributet e sjelljes nga familja. Skema e rimbursimit të ilaçeve kishte disa vështirësi për të paraburgosurit, të cilët për shkak të vonesave në plotësimin e dokumentacionit të dosjeve personale e kishin më të vështirë sigurimin e ilaçeve. Të paraburgosurit dhe të dënuarit ishin të pajisur me librezë shëndetësore. Skema e furnizimit dhe rimbursimit të ilaçeve në IEVP, “*Jordan Misja*” Tiranë sipas kontratës tre palese ISKSH, depo farmaceutike nuk funksiononte pasi nuk ishte futur akoma receta elektronike. Furnizimi me ilaçe për personat me probleme akute funksiononte normalisht ndërsa furnizimi me ilaçe për personat e sëmurë kronikë kishte probleme. Lidhur me këtë problematikë blerja dhe sigurimi i ilaçeve sigurohet nga tre burime dhe konkretisht nga Depoja farmaceutike “*FloriFarma*”, furnizim me blerjet e drejtpërdrejta nga fondi i siguruar nga D.P.Burgjeve dhe furnizim nga fondi i vetë institucionit. Theksojmë se institucioni i Avokatit të Popullit në mënyrë të përsëritur ka rekomanduar marrjen e masave për vënien në funksion të skemës së furnizimit me ilace në IEVP, “*Jordan Misja*” Tiranë. Personeli i kujdesit mjekësor në IEVP, “*Jordan Misja*”, Tiranë sipas organikës përbëhet nga 1(një) mjek, 1(një) farmacist, 1(një) stomatolog dhe 5 (pesë) ndihmës mjekë. Mjeku aktual punonte me kohë të plotë në këtë institucion. Ndërkohë si rrjedhojë e transferimit të punonjësve dhe të të paraburgosurve dhe të dënuarve nga IEVP “*Vaqarr*” pranë IEVP, “*Jordan Misja*”, stafi mjekësor ishte

dyfishuar dhe aktualisht kishte 2 (dy mjekë), 2 (dy) stomatologë, 1(një) farmacist dhe 10 (dhjetë) nd/mjekë. Stafi ishte i plotë dhe nuk kishte asnjë mungesë.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës, nenit 21, gërma “b” të ligjit Nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, si dhe nenit 12, nenit 74/1 pika “b” të ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar

Rekomanduar: Marrjen e masave të menjëhershme për shmangur bashkëjetesën e të paraburgosurve me të dënuarit, në IEVP “*Jordan Misja*” Tiranë, duke bërë të mundur transferimin e shpejtë të personave që ishin dënuar me vendim të formës së prerë drejt institucioneve të tjera të vuajtjes së dënimit; marrjen e masave të menjëhershme për të garantuar akomodimin e të paraburgosurve në IEVP “*Jordan Misja*” Tiranë në mjedise të përshtatshme banimi duke respektuar për të gjithë normat minimum të hapësirës për person, në institucione të tilla, që janë 6m² për dhomat për një person dhe 4m² për person kur në to sistemohen më shumë banorë; marrjen e masave të menjëhershme lidhur rikonstruksionin e Godinës “A” të banimit të të paraburgosurve në IEVP “*Jordan Misja*” Tiranë, për të siguruar ambiente të përshtatshme dhe dinjitoze; marrjen e masave të menjëhershme për ndërtimin e dhomave të Godinës “A” sipas standardit të Komitetit për Parandalimin e Torturës, duhet respektuar hapësirën e nevojshme për të paraburgosurit distancat ndërmjet mureve të dhomave, që duhet të jetë jo më pak se 2m distancë ndërmjet mureve të dhomës dhe jo më pak se 2.5m distancë nga dyshemeja me tavanin e dhomës³²; marrjen e masave të menjëhershme për riparimin e rrjetit elektrik dhe sigurimin e përshtatshëm me ngrohje të dhomave të të paraburgosurve dhe të dënuarve në Godinën “A” në IEVP, “*Jordan Misja*” Tiranë sipas kushteve klimaterike; marrjen e masave të menjëhershme për vënien në zbatim të skemës së furnizimit dhe rimbursimit të ilaçeve në IEVP, “*Jordan Misja*” Tiranë sipas kontratës tre palese ISKSH, depo farmaceutike; marrjen e masave për pajisjen e IEVP “*Jordan Misja*” Tiranë me ambulancë për të shoqëruar personat në spitalet përkatëse të vendit në përputhje me nevojat shëndetësore të të dënuarve dhe të paraburgosurve; marrjen e masave për të përmirësuar cilësinë dhe larmishmërinë e ushqimit në IEVP, “*Jordan Misja*” Tiranë në shërbim të të dënuarve dhe të paraburgosurve; marrjen e masave për të zhvilluar kurse të arsimit dhe ato profesionale në favor të personave të paraburgosur/dënuar në IEVP, “*Jordan Misja*” Tiranë; marrjen e masave për shtimin e aktiviteteve dhe takimeve me të paraburgosurit për qëllime rehabilitimi, këshillimi, ri-integrimi, si edhe aktivitete edukative e social-kulturore-sportive; marrjen e masave për shtimin e aktiviteteve dhe takimeve me të paraburgosurit/dënuarit dhe në veçanti për 18-21 vjeçarët për qëllime rehabilitimi, këshillimi, ri-integrimi, si edhe aktivitete edukative e social-kulturore-sportive; marrjen e masave për krijimin dhe vënien në funksionim të ambienteve për ushtrimin e riteve fetare të fesë së krishterë në ambientet e godinës “B”; marrjen e masave për plotësimin e ambienteve të palestrave me bazë materiale në ambientet e Institucionit të IEVP, “*Jordan Misja*” Tiranë; marrjen

³² Vendimi Nr.437, datë 20.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”, Neni 30 parashikon se: “Në vendosjen e të paraburgosurve apo të të dënuarve mbahen parasysh kushtet dhe mundësitë konkrete të çdo IEVP-je, por në çdo rast duke iu siguruar kubatura jo më pak se 9m³ dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4m² për çdo person të paraburgosur apo të dënuar, dritare që mundësojnë ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral normal për të lexuar e punuar”.

e masave për furnizimit me detergjente dhe materiale pastrimi e të paraburgosurve në IEVP, “Jordan Misja” Tiranë; marrjen e masave për plotësimin e 2 (dy) vendeve vakante për punonjës të nivelit n/inspektor të regjimit të brendshëm; marrjen e masave për mbikëqyrjen e vazhdueshme të veprimtarisë të njësisë tregtare në IEVP, “Jordan Misja” Tiranë, për ofrimin e produkteve të ndryshme për të paraburgosurit dhe të dënuarit; marrjen e masave për krijimin e kushteve në seksionin e posaçëm të regjimit të sigurisë së lartë në IEVP, “Jordan Misja” Tiranë, (i ashtuquajtur 41-bis) në kuadrin e ndryshimeve të Nenit 13/1 të Ligjit Nr. 8328 dt. 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar³³, në mënyrë që të paraburgosurit që do të akomodohen në këto ambiente të mos privohen nga aktivitetet sportive, kulturore, krijuese, shërbimi bibliotekar, veprimtari që i shërbejnë edhe rehabilitimit/riintegritet të të burgosurit; marrjen e masave në seksionin e posaçëm të regjimit të sigurisë së lartë në IEVP, “Jordan Misja” Tiranë për ta bërë të zbatueshëm regjimin e posaçëm duke ruajtur një ekuilibër midis sigurisë dhe dinjitetit të të paraburgosurve; marrjen e masave në seksionin e posaçëm të regjimit të sigurisë së lartë në IEVP “Jordan Misja” Tiranë, (i ashtuquajtur 41-bis) në kuadrin e ndryshimeve të Nenit 13/1 të Ligjit Nr. 8328 dt. 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar, për të garantuar shëndetin dhe jetën e të paraburgosurve që do të akomodohen në këto ambiente duke parandaluar trajtimin jo-human nga infrastruktura e krijuar në godinën “C” të këtij institucioni

5.13. IEVP DURRËS

MKPT kreu një inspektim në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Durrës në datën 29.05.2019, në përbërje të grupit inspektues ishin ndihmës komisionerët e Mekanizmit Kombëtar, vëzhgues z.Patrizio Gonella, Dr. Petur Hauksson dhe z. Markus Jaeger, në cilësinë e përfaqësuesve të Këshillit të Europës në kuadër të Observatorit të Mekanizmave Kombëtarë për Parandalimin e Torturës (NPM OBS).

Organika e institucionit përbëhej nga **202** punonjës, prej të cilëve **50** punonjës ishin staf civil dhe **152** ishin punonjës sigurie të shërbimit të policisë. Nga informacioni, organika në tërësi ishte e plotësuar, por kishte mungesa në stafin mjekësor me **1** mjek dhe **1** infermier, ndërsa në organikën e punonjësve të policisë kishte mungesa të **2** punonjësve, një punonjës i rolit bazë (PRB) dhe një punonjës i rolit të mesëm (PRM). Por, pavarësisht këtyre mungesave, ato nuk e cenonin punën dhe funksionimin e sektorëve kryesorë që ofrojnë shërbimet bazë në atë të ruajtjes dhe sigurisë të institucionit, në sektorin juridik, sektorin psiko-social, shërbimin mjekësor dhe në personelin e guzhinës. IEVP Durrës, kishte një kapacitet maksimal për 300 persona, të ndarë në 6 sektorë, mesatarisht 14 dhoma për çdo sektorë. Në datën e inspektimit, në këtë institucion vuanin dënimin 261 persona, nga të cilët 91 persona të dënuar dhe 170 persona të paraburgosur. Institucioni kishte gjithashtu edhe një seksion të kujdesit të veçantë (SKV) ku trajtoheshin 81 persona të dënuar/paraburgosur me probleme të shëndetit mendor. Grupi i inspektimit, vizitoi ambientet në regjimin e brendshëm si dhomat e banimit, ambientet e

³³ Neni 13/1 i ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar.

përbashkëta të Institucionit, si dhe zhvilloi intervista me personat e dënuar/paraburgosur në lidhje me trajtimin dhe respektimin e të drejtave të këtyre personave, të parashikuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Nga informacioni dhe në intervistat konfidenciale të zhvilluara me të paraburgosurit dhe të dënuarit rezultoi se, nuk kishte raste torture, të dhunimit fizik ose psikologjik apo përdorimit të tepruar të forcës fizike ndaj këtyre personave nga personeli i sigurisë të shërbimit të policisë apo punonjësit e stafit civil që shërbejnë në këtë institucion. Por, gjatë intervistave të dënuarit/paraburgosurit ngritën ankesa që kishin të bënin me hapësirën e vogël të dhomave të banimit, duke patur parasysh faktin që në dhoma ishin akomoduar 3-4 persona. Hapësirat dhe sipërfaqet e dhomave nuk i përgjigjeshin standardit për normativën që ato duhet të plotësonin për një person, ashtu siç është e sanksionuar në aktet ligjore e nënligjore dhe në aktet ndërkombëtare, për këtë qëllim. Të intervistuarit paraqitën ankesa për mungesën e kushteve materiale në dhomat e banimit, kryesisht për mungesën e pajisjeve dhe orendive të nevojshme për jetesë. Nga intervistat u evidentua gjithashtu si shqetësim, mosdhënia e normativave mujore të detergjenteve dhe sapunëve për larje, gjë e cila reflektohej në mungesën e pastërtisë dhe kushteve higjieno-sanitare në dhoma. Një shqetësim tjetër i ngritur nga të dënuarit/paraburgosurit edhe në inspektimet e mëparshme, ishte dhe problemi i furnizimit me ujë të rrjedhshëm që përdorej për larjen e trupit dhe për pastërtinë higjieno-sanitare të ambienteve. Furnizimi me ujë bëhej nga rrjeti i ujës-jellësit të qytetit të Durrësit, 3 herë në ditë sipas orareve që furnizohej edhe popullata përreth institucionit. Por, koha e furnizimit me ujë ishte e reduktuar në 1-2 orë dhe kjo nuk i përgjigjej kërkesave të të dënuarve, njëkohësisht për larjen e trupit dhe mbajtjen pastër të ambienteve të banimit. Kësaj shtate i shtohet dhe cilësia e keqe e ujit, pasi ai vinte i turbullt nga tubacionet dhe nuk mund të përdorej për tu pirë, por as për të larë trupin dhe mbajtjen e higjienës personale. Institucioni i Avokatit të Popullit, e konsideron plotësimin e kushteve të jetesës për personat e dënuar/paraburgosur, si pajisjen e dhomave të banimit me orenditë e nevojshme, dhënie e normativave mujore të detergjenteve dhe furnizimin me ujë të rrjedhshëm, si kushte minimale dhe të domosdoshme në kuadër të të drejtave që duhet të gëzojnë këta persona. Ndërkohë, plotësimi i tyre nga ana e institucionit që ju drejtoni, nuk kërkon investime apo planifikime të mëdha të fondeve buxhetore. Ndaj, drejtuesit e I EVP Durrës, duhet të marrin masa të menjëhershme për ndryshimin e kësaj shtate, si dhe të nxjerrin përgjegjësitë konkrete dhe të marrin masa administrative ndaj punonjësve të stafit që shkelin të drejtat minimale për jetesë të këtyre personave.

Në intervistat konfidenciale me personat e dënuar/paraburgosur, u ngritën disa ankesa që kishin të bënin me nevojën e një prezence më të madhe të juristit dhe të stafit psiko-social të institucionit në takimet periodike që zhvillojnë në çdo seksion, për dhënie e këshillimeve ligjore dhe sqarimeve të nevojshme në lidhje me të drejtat që iu jep ligji në rastin e kërkesave për transferime dhe lejeve shpërblyese, si dhe nevojën e respektimit të këtyre të drejtave nga ana e stafit dhe punonjësit e policisë të institucionit. Nga inspektimi i ambienteve dhe intervistat me të paraburgosurit, doli si problematikë shqetësuese niveli i lartë i lagështirës në disa nga ambientet e banimit dhe kryesisht në ambientet e tualeteve dhe të dusheve të përbashkëta. Sipas informacionit të drejtuesve të institucionit, kjo shtatë ishte krijuar për shkak të mungesës së hidroizolimit të plotë të tarracës së godinave të banimit, por dhe vendodhjes të institucionit në një zonë të njohur si kënetë, e cila përmbajtej sa herë që kishte shira të rrëmbyeshëm. Grupi monitorues inspektoi shtatën e trajtimit, kushteve materiale dhe ato higjienike të

paraburgosurve/dënuarve në ambientet e observim/veçimit. Ky ambient përbëhej nga 2 dhoma observimi dhe 3 dhoma veçimi. Në ditën e inspektimit në ambientin e observimit u konstatua se, njëra nga dhomat ishte kthyer në dhomë banimi ku ishin akomoduar dy persona, të cilët sipas informacionit të punonjësve të policisë, ishin vendosur aty përkohësisht për arsye sigurie. Ndërsa në ambientin e veçimit ndodhej vetëm një person, në pritje të zhvillimit të mbledhjes së komisionit të disiplinës të institucionit, për dhënie të masës disiplinore. Ambienti në tërësi ishte i lyster, por nuk ishte i pastër nga ana higjieno-sanitare. Në dhomat e veçimit mungonin pajisjet e domosdoshme për të përmbushur nevojat kryesore të jetesës, si tavolina, stola, komodina dhe u konstatuan xhama të thyer të dritareve dhe mungesa të kanatave të dritareve. Problematike në këto ambiente ishte gjithashtu dhe mungesa e dushit për larjen e trupit të personave, pasi në mungesë të tij, larja e trupit duhet të bëhej në ambientet dusheve të përbashkëta sipas sektorëve. Personat e dënuar që ndodheshin përkohësisht në ambientin e observimit, u ankuan dhe për hapësirën e vogël të bokseve të ajrimit dhe kërkonin që ajrosjen ta kryenin njësoj me të dënuarit e tjerë në ambientet tjera të ajrimit që ndodheshin jashtë godinës të regjimit të brendshëm. Dhomat e banimit të dënuarve/paraburgosurve, kishin tualete dhe lavamanë brenda në dhoma. Veç tyre, në çdo sektorë kishte ambiente të përbashkëta që shërbenin si tualete dhe dushe për larjen e trupit. Marrëdhëniet dhe sjelljet e personelit të Institucionit me personat e paraburgosur dhe të dënuar, ishin korrekte dhe nuk pati ankesa nga këta të fundit. Nga inspektimi dhe verifikimi i dokumentacioneve lidhur me sistemin e kërkesë/ankesave rezultoi se çdo ankesë regjistrohej në regjistrin përkatës dhe protokollohej³⁴. Regjistrat mbaheshin nga sekretaria e institucionit. Të paraburgosurit plotësonin një formular kërkesë/ankese dhe ia dorëzonin punonjësit të sektorit psiko-social. Përsa i takon objektit të kërkesë/ankesave, nga verifikimi i tyre rezultoi se, në shumicën e tyre konsistonin në kërkesa për leje shpërblyese, takime me familjarët, kërkesë për dinamikën e vuajtjes së dënimit, kërkesë për takim me avokatë, vizitë në spitalin rajonal, transferim, punësim ose kërkesë për blerjen e pajisjeve si TV ose frigorifer. Sistemi i monitorimit me kamera vëzhgimi ishte funksional. Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Durrës kamerat monitoronin pjesën më të madhe të mjediseve për 24 orë, ndërkohë që të dhënat ruheshin në server për një periudhë një mujore. Por, sipas informacionit, sistemi aktual ishte i amortizuar dhe kishte nevojë për riparime të herë pas hershme. Në këtë aspekt, Drejtori i institucionit ishte drejtuar me shkresë zyrtare Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve³⁵, në lidhje me sigurimin e instalimit të një sistemi të ri të kamerave.

Lagështia në disa ambiente, nuk ishte e shkaktuar vetëm nga kënetat që rrethon Institucioni, por edhe nga mungesa e hidroizolimit të plotë të tarracës. Lagështia ishte e pranishme në disa prej dhomave të banimit, në ambientin e takimit me familjarët, në kolonën kryesore të tualeteve të dhomave, në ambientet e dusheve të përbashkëta, si dhe në disa nga dhomat e shërbimeve në katin e parë të godinës. Nga inspektimi, dhomat e banimit në përgjithësi ishin të lyera, të pastra dhe të pajisura me orenditë e nevojshme. Por theksojmë se, grupi i inspektimit konstatoi se kishte diferencime midis dhomave të banimit. Nëse disa dhoma ishin plotësuar me orenditë për jetesë, në disa dhoma u gjetën mungesa të

³⁴ Neni 49 i ligjit Nr. 8328 dt. 16.04.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i ndryshuar.

³⁵ Shkresa nr.83/1 prot., datë 04.02.2019.

paisjeve dhe orendive bazike si dollapë për vendosjen e sendeve personale, tavolina e karrige. Diferencime u vërejtën dhe në lyerjen e dhomave. Kjo situatë, ishte më evidente në një nga sektorët e të paraburgosurve që ndodhej në katin e 2 të godinës së banimit, ku disa prej dhomave nuk ishin të lyera dhe nuk ishin të plotësuara me orenditë e nevojshme për jetesë. Kubatura dhe sipërfaqet e dhomave të banimit nuk ishin në raport të drejtë me numrin e personave të vendosur brenda tyre. Numri i personave të akomodur në dhoma ishte 3–4 persona dhe nuk e plotësonin normën minimale të hapësirës për person. Theksojmë se Komiteti për Parandalimin e Torturës shprehet se norma minimale e hapësirës për person, në institucione të tilla është 6 m² për dhomat për një person dhe 4 m² kur në to sistemohen më shumë persona. Në këtë normë nuk mbahet parasysh sipërfaqja e tualetit, që mund të ndodhet brenda dhomës. Gjithashtu, sipas standardit të Komitetit për Parandalimin e Torturës, duhet respektuar dhe distanca ndërmjet mureve të dhomave, që duhet të jetë jo më pak se 2 m distancë ndërmjet mureve të dhomës dhe jo më pak se 2.5 m distancë nga dyshemeja me tavanin e dhomës,³⁶ sikurse përcaktohet dhe në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve. Dritaret mundësonin ndriçim natyral të bollshëm. Në dhoma sigurohej energji elektrike për ndriçim dhe nevoja të përditshmërisë. Çdo dhomë banimi kishte tualet më vete. Por, mungesa e ujit dhe e detergjenteve për larje, përbënin arsye që në dhomat e banimit të mungonte pastërtia higjieno-sanitare. Ambientet e përbashkëta të dusheve për larjen e trupit ishin funksionale për çdo sektorë. Larja e trupit kryhej sipas grafikut të miratuar nga drejtuesit e institucionit 2 herë në javë. Bolieri për ngrohjen e ujit ishin në gjendje pune, ndërsa kokat e dusheve të dëmtuara ishin zëvendësuar. Pavarësisht kësaj, të dënuarit deklarorin se në shumicën e rasteve larja e trupit kryhej në dhoma, duke ngrohur ujë me mjetet ngrohëse personale. Kjo për arsye se, koha e furnizimit me ujë ishte e shkurtër dhe sasia e ujit të ngrohtë nuk ishte e mjaftueshme, për të përbashkuar larjen e trupit të personave të burgosur që ndodheshin në një sektorë. Theksojmë se, një sektorë kishte 14 dhoma dhe një boks të dusheve me 3-4 poste. Siç e përmendëm më lart, cilësia e ujit nuk ishte e mirë, pasi ishte shumë i ndotur, veçanërisht në ditët me shi. Shumica e të intervistuarve pohuan se e blinin ujin e pijshëm, pasi nuk mund të pihej. Institucioni nuk kishte sistem qendror ngrohje/ftohje. Në periudhën e dimrit ngrohja në dhoma realizohej me pajisje elektrike të siguruara nga familjarët e personave të burgosur, ndërsa në periudhën e verës ata shprehnin shqetësime për vapën e madhe, si dhe për prezencën e madhe të mushkonjave. Institucioni nga ana e tij kishte bërë dezinfektimin e ambienteve të brendshme në mënyrë periodike, por kjo ishte shqetësim për gjithë zonën e kënetës përreth tij. Sektori i kujdesit të veçantë (SKV), ndodhej si godinë më vete. Godina ishte në gjendje të mirë teknike. Ambienti i tualeteve ndodhej brenda çdo dhome dhe për arsye sigurie dyert kishin një dritare të vogël që lejonte vëzhgimin dhe kontrollin e të burgosurit nga personeli policor. Bolierët e dusheve të përbashkëta të sektorit të kujdesit të veçantë ndodheshin jashtë këtij ambienti dhe komandoheshin nga personeli i burgut. Kjo zgjidhje, ishte në funksion të elementëve të sigurisë, veçanërisht për personat e burgosur që kanë probleme të shëndetit mendor.

³⁶ Vendimi Nr.437, datë 20.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve", Neni 30 parashikon se: "Në vendosjen e të paraburgosurve apo të të dënuarve mbahen parasysh kushtet dhe mundësitë konkrete të çdo IEVP-je, por në çdo rast duke iu siguruar kubatura jo më pak se 9m³ dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4m² për çdo person të paraburgosur apo të dënuar, dritare që mundësojnë ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral normal për të lexuar e punuar".

Dhomat e veçimit, ku personat e dënuar shlyenin masat disiplinore, duhet që të plotësojnë të njëjtat kushte dinjitoze për jetesë, ashtu si edhe dhomat e banimit. Ato duhet të jenë të pajisura me krevat, komodina, tavolinë dhe karrige të fiksuara në dysheme, të jenë të mirëmbajtura dhe të mundësojnë ndriçim artificial. Por, siç përmendëm dhe më lart, nga tre dhoma veçimi që ka ky institucion, ishin në përdorim vetëm dy dhoma, pasi njëra nga dhomat ishte me shumë lagështirë. Këto dhoma ishin të pajisura vetëm me një shtrat hekuri të fiksuar në dyshemenë e shtruar me beton, ndërsa dritaret e siguruara me zgarë hekuri ishin pa kanate ose me kanate pa xhama, që sipas shpjegimit të punonjësve të policisë ato ishin dëmtuar nga të burgosurit. Në tualetin e ndërtuar brenda dhomës së veçimit mungonte uji i rrjedhshëm, si dhe pajisjet e materialet për tu kujdesur për higjienën personale. Tualeti ishte i vendosur ngjitur me dhomat e veçimit dhe ishte i përbashkët me të burgosurit që ndodheshin në ambientin e observimit. Dhomat kishin ajrim dhe ndriçim natyral, si dhe ishin të pajisura me ndriçimi artificial. Kuzhina e institucionit u gjet e pastër dhe e rregullt. Ajo funksiononte në kushte normale, pasi pajisjet e gatimit dhe sistemi i aspirimit ishin të standardeve industriale. Në kuzhinë ndodhej regjistri i normativave ushqimore dhe menyja ditore ishte e afishuar. Personeli i guzhinierëve ishte pajisur me kartelat shëndetësore. Menuja javore dhe norma ushqimore ishin të afishuara. Kampionët ushqimorë ruheshin në kushte frigoriferike, të etiketuar sipas vakteve përkatëse. Gjithashtu u konstatuan edhe racionet përkatëse për të sëmurët diabetikë në këtë institucion. Përgjithësisht, kushtet e përgatitjes së ushqimit në ambientet e kuzhinës së institucionit, rezultuan në gjendje të mirë. Megjithatë të dënuarit dhe të paraburgosurit shfaqën ankesa lidhur me cilësinë e ushqimit i cili nuk kishte larmishmëri. U evidentua se, një pjesë e personave të dënuar dhe të paraburgosurve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Durrës, nuk e konsumonin ushqimin e përgatitur në institucion, duke shpërdoruar një pjesë të konsiderueshme të tij. Mjaft të dënuar kanë pohuar se e merrnin ushqimin nga të afërmit e tyre dhe se nuk konsumonin ushqimin e institucionit, për shkak se nuk e pëlqenin atë. Nga shqyrtimi i dosjeve psiko-sociale dhe dokumentacionet e tjera të mbajtura nga ky sektor, u vu re se ato ishin të plotësuara relativisht mirë me shënime periodike mbi takimet dhe aktivitetet ku të dënuarit/paraburgosurit merrnin pjesë. Në dosje ishin përfshirë si programet individuale të trajtimit ashtu dhe vlerësimet periodike të cilat ishin të plotësuara mirë. Në këtë institucion gjenden disa ambiente që i shërbejnë qëllimit të riintegritimit të të burgosurve, si biblioteka, dy dhoma ku ushtrohen rite fetare të besimtarëve myslyman dhe atyre të krishterë, klasa që shërbenin si dhoma për psikologun, palestra etj. Biblioteka ishte një mjedis i vogël, e cila ishte e lyer dhe e pastër. Ky mjedis ishte pajisur me televizor, stola dhe një raft jo shumë të pasur me libra. Të paraburgosurit dhe të dënuarit e regjistruar kishin nga një kartelë personale dhe nëpërmjet saj tërhiqnin dhe dorëzonin librat. Por, sipas personit përgjegjës që mbikqyrte bibliotekën, të burgosurit nuk tregonin shumë interes për të lexuar libra. Në katin e parë të godinës të regjimit të brendshëm, ndodheshin dy dhoma për praktikimin e fesë. Ato ishin të ndara më vetë për besimtarët myslimanë dhe për besimtarët e krishterë. Këto ambiente ishin të lyera dhe të pastra dhe ishin të pajisura me orëndi sipas riteve të secilit besim. Orari i veprimtarive ishte i njëjtë për të gjithë sektorët pavarësisht nga siguria që ata kishin dhe aktivitetet e zhvilluara. Në ambientin e kultit të fesë myslimanë nga ora 12:00-13:00, mblidheshin besimtarët dhe praktikonin ritet e tyre fetare. Ndërsa të martën, të enjten dhe të shtunën mblidheshin praktikuesit e fesë ortodokse dhe asaj katolike nën drejtimin e dërguarëve nga kishat

respective të Durrësit. Gjithashtu në ambientin e kultit praktikonin ritet e tyre edhe besimtarët e tjerë protestantë. Referuar dokumentacionit të administruar, gjatë muajit Maj dhe Qershor 2019, në këtë institucion ishin parashikuar të zhvilloheshin disa aktivitete ku mund të merrnin pjesë të burgosurit si shërbesa të drejtuara nga përfaqësues të fesë myslimane, por dhe të fesë krishtere, shtrim i iftarit të përbashkët për të burgosurit gjatë gjithë Muajit të Ramazanit, mini spartakiada midis sektorëve, etj. Në lidhje me ajrimin u konstatua se, ajrimi ditor zgjaste 2.5 - 3 orë sipas rregullores dhe ky orar zgjatej në periudhën e verës. Shumë prej personave të burgosur të intervistuarve, kërkonin të kishte më shumë aktivitete të përbashkëta edukative dhe sportive në grup, si dhe më shumë mjete dhe pajisje sportive. Në këtë drejtim, është për tu theksuar se, një ndër qëllimet e institucioneve të mbyllura penitenciare është riintegrimi në shoqëri i këtyre personave, i cili do të vlejë në momentin kur ata do të lënë burgun. Ndaj, larmia e aktiviteteve që zhvillohen brenda institucionit duhet të jetë e shumëllojtë, ku në to të përfshihen një masë sa më e madhe e të burgosurve. Për këtë qëllim, Rregullorja Evropiane e Burgjeve parashikon se: *“regjimi i ofruar për të gjithë të burgosurit përfshin një program të balancuar veprimtarish. Ky regjim u lejon të gjithë të burgosurve të kalojnë sa më shumë orë në ditë jashtë qelive të tyre, sipas nevojës për një nivel të përshtatshëm të ndërveprimit njerëzor dhe shoqëror”*³⁷. Në Institucionin e Ekzekutimeve të Vendimeve Penale Durrës, grupi i inspektimit konstatoi se, mungonin gjithashtu dhe trajnimet profesionale. Në lidhje me këtë konstatim, institucioni duhet të mundësojë menjëherë një marrëveshje me Qendrën e Formimit Profesional Durrës, për zhvillimin e kurseve profesionale, sipas nevojave dhe kërkesave të të dënuarve. Për sa i përket mbështetjes psiko-sociale që merrnin të burgosurit, gjatë takimit me stafin e sektorit të kujdesit psiko-social, u konstatua se aktivitetet që ofroheshin ishin të pakta në raport me numrin e personave të burgosur dhe përbëheshin kryesisht nga diskutimet në grup për tema sociale dhe këshillime në klasa. Sipas stafit të institucionit të paraburgosurit dhe të dënuarit regjistroheshin në disa aktivitete, por jo gjithmonë i frekuentonin ato. Në momentin e inspektimit, u konstatua se në këtë institucion, vuanin dënimin si të paraburgosur 7 shtetas të huaj, 2 me origjinë nga Kosova, 2 me origjinë nga Jordania, 1 origjinë nga Rusia, 1 origjinë nga Turqia dhe 1 me origjinë nga Kanadaja. Grupi i inspektimit mori takim me disa nga të paraburgosurit me kombësi të huaj, të cilët kërkonin tu krijohej më shumë mundësia nga ana e institucionit, për të kryer biseda telefonike me familjarët, pasi nuk kishin mundësi financiare për të blerë karta telefoni. Në lidhje me këtë konstatim, legjislacioni parashikon se, IEVP-ja i siguron një herë në muaj bisedë telefonike të burgosurve që nuk kanë mjete financiare (neni 44/2 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve). *“Shtetasve të huaj, që nuk kanë përfaqësi diplomatike ose konsullore në vend, refugjatëve ose personave pa shtetësi u mundësohet komunikimi me familjet dhe përfaqësitë diplomatike të shtetit që mbron interesat e tyre ose me autoritetin kombëtar ose ndërkombëtar, sa herë që ata e shikojnë të nevojshme, detyra e të cilit është mbrojtja e interesave të këtyre personave”*³⁸. Organika e stafit mjekësor të IEVP Durrës, është miratuar për 18 punonjës, nga të cilët 1 mjek psikiatër,

³⁷ Rregullorja e Evropiane e Burgjeve Pika 25.1 dhe 25.2; <http://www.coe.int/t/DGHL/STANDARDSETTING/PRISONS/EPR/EPR-Albanian.pdf>

³⁸ Neni 30, paragrafi i katërt i Ligjit Nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, nenet 45/2 dhe 96 të VKM Nr.437, datë 20.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”.

4 mjek të përgjithshëm, 1 farmacist, 1 stomatolog, 1 kryeinfermier dhe 10 infermierë. Referuar informacionit të marrë nga drejtuesi i institucionit, organika e stafit mjekësor nuk ishte e plotësuar me një mjek të përgjithshëm dhe një infermier. IEVP Durrës, kishte një sektor të kujdesit të veçantë (SKV) të vendosur në një godinë më vete, për trajtimin dhe diagnostikimin e personave të dënuar/paraburgosur me probleme të shëndetit mendor. Në momentin e inspektimit në këtë sektor, rezultuan të ishin shtruar me rekomandim të mjekut të institucionit 81 persona të dënuar/paraburgosur, nga të cilët 51 persona me probleme të shëndetit mendor, 9 persona përdorues të drogave të ndryshme që trajtoheshin me metadon, si dhe 21 persona me probleme të tjera të shëndetit. Nga inspektimi u konstatua se, punonjësit në këtë qendër zhvillojnë aktivitete të ndryshme si lojëra tavoline, aktivitete në bibliotekë, si dhe lojëra me top në oborrin e këtij institucioni. Por, mungonin zhvillimi i aktiviteteve apo terapive në grup nga ana e stafit psiko-social në ambientet e përbashkëta, pasi nuk kishte ambiente të nevojshme apo kushte për ti zhvilluar ato. Dhoma e mjekut dhe e infermierit u gjetën në kushte të mira higjieno-sanitare si dhe të pajisura me orënditë e nevojshme për punë si shtrat, tavolinë pune, karrige dhe raft për mbajtjen e medikamenteve. Siç e përmendëm edhe më lart, në këto mjedise vihej re prania e lagështirës e shkaktuar nga përmbytjet dhe nga hidroizolimi jo i plotë i tarracës. Megjithatë, dhomat ku shërbehej ndihma mjekësore ishin të mirëmbajtura. Shërbimi stomatologjik ishte i plotësuar me autoklavën dhe turbinën dhe ishte në funksion të plotë për kryerjen e këtij shërbimi nga ana e stomatologut. Dhoma e infermierisë, farmacia dhe dhoma e stomatologut ishin me kushte të mira higjieno-sanitare. Personeli mjekësor në këtë institucion, ngritën si shqetësim mungesën e autoambulancës për të shoqëruar personat e sëmurë në rastet e emergjencave në Spitalin Rajonal Durrës. Deri tani, rastet e emergjencave përballtoheshin nga shërbimi spitalor i qytetit të Durrësit. Skema e rimbursimit të ilaçeve funksiononte më mirë për të dënuarit, ndërkohë që më i vështirë bëhej zbatimi i kësaj skeme për të paraburgosurit, të cilët për shkak të vonesave në plotësimin e dokumentacionit të dosjeve personale e kishin më të vështirë sigurimin e ilaçeve me anë të skemës së rimbursimit të ilaçeve. Por, nga të intervistuarit u ngritën ankesa në lidhje me mungesën e medikamenteve në institucion, të cilat shpesh mbuloheshin me kontributet e sjelljes nga familja. Megjithatë organika e personelit mjekësor ishte e plotësuar, me përjashtim të një mjeku të përgjithshëm dhe një infermieri, personat që vuanin dënimin në këtë institucion, ngritën si shqetësim vonesat në kryerjen e vizitave mjekësore dhe dërgimin e tyre për vizitë të mjekëve specialist në Spitalin Rajonal të Durrësit. Lidhur me këtë konstatim, bëjmë me dije se, Komiteti për Parandalimin e Torturës parashikon që: *“Derisa qëndrojnë në burg, personave të dënuar duhet tu mundësohet qasja deri te mjeku në çdo kohë, pa marrë parasysh faktin e regjimit të burgosjes së tyre”* dhe se *“shërbimi shëndetësor duhet të organizohet në atë mënyrë, që do të mundësojë që kërkesat për konsultime mjekësore të ofrohen pa zgjatje të pa nevojshme”*. Po ashtu, është për tu theksuar edhe Rregullorja Evropiane e Burgjeve, e cila shprehet qartë për rolin e drejtuesve të IEVP-ve në plotësimin e kërkesave të personave të burgosur, konkretisht se: *“Autoritetet e burgut ruajnë shëndetin e të gjithë të burgosurve që janë në kujdesin e tyre. Shërbimet mjekësore në burg organizohen në bashkëpunim të ngushtë me administrimin shëndetësor të komunitetit ose të shtetit. Të burgosurit i ofrohen shërbimet mjekësore, kirurgjike dhe psikiatrike, duke përfshirë dhe ato shërbime që janë të disponueshme në*

komunitet”³⁹. Për shkak të specifikës që ka seksioni i kujdesit të veçantë (SKV) në këtë institucion, ku trajtohen personat që kanë probleme të shëndetit mendor, pajisja e IEVP-së me mjete të veçanta të kufizimit fizik është e domosdoshme, në përballimin e rasteve të veçanta të gjendjes shëndetësore të agravuar të këtyre personave, për periudhë kohore shumë të shkurtër. Mund të ndodhë që këta të burgosur të kryejnë veprime për të dëmtuar veten, të tjerët ose pronën dhe lind nevoja për ti kufizuar fizikisht. Aktualisht, këto raste përballohen me mjete nga stafi mjekësor mbështetur nga shërbimi policor i këtij institucioni. Nga këqyrja e dokumentacionit të personeli shëndetësor u konstatua ekzistenca e regjistrave të vizitave mjekësore, të cilët ishin plotësuar në mënyrë korrekte. Ndërsa në dosje të veçanta ndodheshin kartelat mjekësore të çdo personi të dënuar/paraburgosur që vuante dënimin në momentin e inspektimit. Telefonat me kartë ndodheshin në mjedisin e regjimit të brendshëm në çdo sektorë. Ata ishin në gjendje pune dhe të dënuarit/paraburgosurit e intervistuar, pohuan se flisnin dy herë në javë me të afërmit e tyre nëpërmjet këtyre telefonave. Ndërkohë, ata kishin kërkesa për komunikime më të shpeshta me familjarët e tyre dhe ngritën si shqetësim kufizimin e numrit të telefonatave. Ata kërkonin që tu jepej mundësia e komunikimit më shpesh brenda mundësive të institucionit, pasi kushtet familjare të secili prej tyre nuk ishin të mira.

Takimet e të dënuarve/paraburgosurve me familjarët zhvilloheshin në mjedise të veçanta. Ato kryheshin normalisht sipas rregullores një herë në javë, mesatarisht rreth 4 takime në muaj, në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve. Takimi me familjarët zgjaste rreth 20 minuta. Institucioni mundësonte për personat e dënuar/paraburgosur familjarë dhe prindërimin në distance në një ambient më vete. Në këtë mjedis nuk kishte ndarje ndërmjet të burgosurit dhe familjarit, duke e bërë atmosferën e takimit më miqësore sidomos për fëmijët e mitur. Ky ambient, ishte i lyster, i pastër nga ana higjieno-sanitare dhe ishte i pajisur me orendi si stola dhe tavolinë plastike. Muret e një prej dhomave ishin të pikturuara me figura kartonash. Por, ky mjedis kishte nevojë të pajiset me më shumë mjete didaktike dhe lodrave për fëmijët. Në momentin e inspektimit, në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Durrës, nga 21 persona në organikë të punësuar faktikisht ishin të punësuar 18 persona të dënuar/paraburgosur, kryesisht në kuzhinë, pastrim, gjelbërim, shpërndarje ushqimi, bibliotekë dhe magazinë. Sipas informacionit të drejtuesit të Institucionit, me të paraburgosurit e punësuar nuk ishin lidhur kontrata pune që rregullojnë marrëdhëniet e punës, midis punëdhënësit dhe punëmarrësit. Institucionit të Avokatit të Popullit, në rekomandimet e tij të mëparshme, ka theksuar qartë se, mungesa e lidhjes të kontratës të punës me të dënuarit/paraburgosurit e punësuar është shkelje e një të drejte të sanksionuar në aktet ligjore dhe nënligjore, kryesisht në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, ku përcaktohet se: *“Te paraburgosurit apo të dënuarit kanë të drejtë të punojnë në përputhje me aftësitë fizike, shëndetësore dhe psikologjike.....Aktet ligjore dhe nënligjore që shërbejnë për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë, mirëqenies sociale dhe kohëzgjatjen e punës, si dhe ato që rregullojnë marrëdhëniet e punës, me përjashtim të ushtrimit të së drejtës për grevë dhe pjesëmarrje në sindikata, zbatohen njëjloj edhe për të paraburgosurit e të dënuarit”*⁴⁰. Nisur nga ky konstatim, sjellim në mënyrë të përsëritur në vëmendjen e drejtuesve të institucioneve tuaja se,

³⁹ Rregullorja Evropiane e Burgjeve, pika 39, 40.1, 40.5;

⁴⁰ Neni 54, Kreu XII, Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve.

punësimi i të paraburgosurve/dënuarve rregullohet sipas neneve 34, 35 të ligjit nr. 8328 dt. 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar⁴¹ dhe Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve⁴². Avokati i Popullit, duke vlerësuar punësimin e të paraburgosurve/dënuarve si një e drejtë e ligjshme, i ka rekomanduar Ministrin të Drejtësisë, miratimin sa më parë të akteve nënligjore që rregullojnë të drejtën e punësimit në këto institucione. Rekomandimet e Avokatit të Popullit janë vlerësuar të drejta, por kanë kaluar më shumë se 10 vite dhe ato ende nuk janë miratuar tej çdo afati ligjor. Në përfundim të inspektimit u zhvillua sërish një takim me drejtuesin e institucionit, ku në mënyrë të përmbledhur iu bënë me dije gjetjet dhe problematikat e evidentuara.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës, nenit 21, germa “b” të ligjit Nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, si dhe nenit 12, nenit 74/1 pika “b” të ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar.

Rekomanduar: Marrjen e masve të menjëhershme për hidroizolimimin e plotë të tarracës së godinës në regjimin e brendshëm të institucionit, për eliminimin e lagështirës në ambientet e brendshme të banimit; marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin me orenditë e nevojshme për jetesë në dhomat e banimit të të dënuarve/paraburgosurve si tavolina, karrige dhe dollapë për mbajtjen e sendeve personale; marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin u kushteve dinjitoze për jetesë në dhomat e veçimit dhe pajisen e tyre me tavolina, komodina, kanate për dritaret dhe zëvendësimin e xhamave të thyer; marrjen e masave të menjëhershme për verifikimin e rasteve, nxjerrjen e përgjegjësive dhe plotësimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve sipas normativave mujore me detergjente dhe materiale të tjera për pastrimin dhe mbajtjen e higjienës personale dhe të ambientit në dhomat e banimit; marrjen e masave për plotësimin e organikës të stafit mjekësor me një mjek të përgjithshëm dhe një infermier; marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e plotë dhe furnizimin me medikamente, për rastet e të sëmurëve akutë dhe rastet e emergjencave. marrjen e masave të menjëhershme për rritjen e larmisë të aktiviteteve kulturore, sportive dhe sociale nga sektori psiko-social, me pjesëmarrjen e gjerë të personave të burgosur, që të ndikojnë në formimin dhe riintegrimin e këtyre personave; marrjen e masave të menjëhershme për dezinfektimin dhe përmirësimin e cilësisë të ujit të rrjedhshëm, që furnizohet nga tubacioni i ujësjellësit; marrjen e masave të menjëhershme për pajisen e seksionit të kujdesit të veçantë, me mjetet e veçanta të kufizimit fizik dhe me të paktën një shtrat dhe një karrige kufizuese, për shkak të trajtimit mjekësor të personave me probleme të shëndetit mendor; marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e cilësië së ushqimit dhe larminë e tij sipas produkteve të stinës, si dhe ushtrimin e kontrolleve të vazhdueshme nga drejtuesit e institucionit, për këtë problematikë; marrjen e masave për instalimin e një sistemi qendror për ngrohje/ftohje të ambienteve të brendshme të dhomave të banimit të të dënuarve/paraburgosurve dhe për heqjen e pajisjeve ngrohëse elektrike, të cilat përbëjnë rrezik për

⁴¹ Nenet 76 dhe 77 të ligjit nr. 8328 dt. 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar.

⁴² Nenet 54/3 dhe 54/4/a të Rregullores të Përgjithshme të Burgjeve, miratuar me VKM nr. 437, datë 20.05.2015

jetën e këtyre personave; marrjen e masave të menjëhershme për rritjen e pranisë të punonjësve të sektorit juridik dhe sektorit psiko-social në kontakte të përditshme me personat që vuajnë dënimin në këtë institucion, për dhënien e këshillimeve ligjore dhe sqarimet për zgjidhjen e kërkesave dhe ankesave që ata mund të paraqesin; marrjen e masave të menjëhershme, brenda hapësirave ligjore për krijimin e mundësisë që të burgosurit me shtetësi të huaj të bisedojnë më shpesh në telefon me familjarët e tyre me shpenzimet e institucionit; marrjen e masave të menjëhershme, në bashkëpunim me institucionet e tjera të shëndetit parësor të qytetit të Durrësit, për dezinfektimin e zonës përreth kufirit të jashtëm të këtij institucionit, për eliminimin e insekteve dhe agjentëve infektivë; arrijnë e masave të nevojshme në bashkëpunim me Qendrën e Formimit Profesional Durrës, për ofrimin e kurseve dhe zhvillimin e aktiviteteve të formimit profesional me të dënuarit/paraburgosurit në këtë institucion; marrjen e masave për pajisjen e Institucionit me një autoambulancë për rastet emergjente të të sëmurëve dhe shoqërimin në Spitalin Rajonal Durrës apo Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë.

5.14. SPITALI PSIKIATRIK SHKODËR

MKPT- inspektoi Shërbimin e Shëndetit Mendor me shtretër, Shkodër, më datë 28.05.2019, sipas Planit të Inspektimit për vitin 2019 të miratuar më parë. Në përbërje të grupit inspektues ishin Znj. Ermonela Xhafa me detyrë Komisionere e Mekanizmit Kombëtar, znj. Nertila Qafzezi Nd/komisionere, dr. Petur Hauksson përfaqësues i NPM OBS, si dhe dr. Alma Alibali mjek psikiatre eksperte e jashtme. Kjo ishte vizita periodike monitoruese e paparalajmëruar e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës në Shërbimit e Shëndetit Mendor me Shtretër Shkodër për vitin 2019. Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi inspektues takoi fillimisht shërbimin e këtij shërbimi Znj.Valdet Hoxha për ta informuar mbi qëllimin e inspektimit. Kapaciteti maksimal i këtij shërbimi spitalor është 35 (tridhjetë e pesë) persona. Në ditën e inspektimit në këtë shërbim me shtretër të shtruar ishin 34 (tridhjetë e katër) persona, prej të cilëve 9(nëntë) me mjekim të detyruar me vendim gjykate. Organika e institucionit përbëhej nga 1 mjek psikiatër, 1 kryeinfermier, 16 ndihmësmjek, 15 kujdestar, 4 psikolog, 1 punonjës social, 1 farmacist, 1 jurist. Pacientët në përgjithësi sillen në këtë shërbim nga familjarët ose policia. Por ka dhe raste kur shtrohen pacientët me vendim gjykate. Nga kontakti me stafin, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacioneve, objekteve, pajisjeve dhe mjediseve, u konstatua se një pjesë e rëndësishme e rekomandimeve të bëra nga Avokati i Popullit në inspektimin paraardhës, kishin gjetur zbatim pjesërisht. Shërbimi i shëndetit mendor në Shqipëri rregullohet me ligjin Nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor” dt 12.04.2012 (i pari, miratuar me 1996)⁴³; ligji Nr.10 107, Datë 30.3.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”. Aktet e miratuara në zbatim të Ligjit Nr. 44/2012 “ Për Shëndetin Mendor” janë : VKM Nr. 456, datë 22.5.2013 “ Për funksionimin e Komitetit Kombëtar për Shëndetin Mendor”, Rregullorja e Shërbimeve të Shëndetit Mendor, Standardet e Kufizimit Fizik në Shërbimet e Shëndetit Mendor të Specializuar me Shtretër dhe Regjistri përkatës, Plani i Veprimit për Shëndetin Mendor 2013-2021. Në konceptin gjithëpërfshirës, kuadri ligjor dhe institucional ofron mundësinë e një sistemi të integruar të shërbimeve të shëndetit

⁴³ Ligji Nr 8092.dt 21.03.1996 për Shëndetin Mendor

mendor, i cili nënkupton një rrjet shërbimesh në nivel rajonal. Në ditën e inspektimit në këtë shërbim me shtretër me kapacitet zyrtar prej 35 personash, respektohej hapësira jetike, kusht ky i domosdoshëm për trajtimin njerëzor të pacientëve në institucione psikiatrike. Në ditën e vizitës monitoruese trajtoheshin 34(tridhjetë e katër) pacientë. Nga të cilët 9 (nëntë) persona janë me mjekim të detyruar. Diktuar nga një numër në rritje i sëmundjeve/çrregullimeve mendore, i tipologjive, i grupmohave, i shtrirjes gjeografike, çrregullimeve për shkak të përdorimit të substancave narkotike, etj, lind domosdoshmëri ndryshimi dhe përmirësimi i mbrojtjes dhe kujdesit të pacientëve në kushte të tilla komplekse, të vështira. U evidentuan mangësi në lidhje me nevojën për mbështetje me investime, kushte me të mira materiale për një shërbim cilësor, nevojë për një numër në rritje të stafëve mjekësore dhe mbështetëse, adresimin e psikiatrisë ligjore ambulatorie apo trajtimin dhe monitorimin e kushteve për personat me çrregullime mendore që kanë kryer vepra penale (personat që vuajnë dënimin me burg apo që janë me masa mjekësore, mjekim i detyruar). Nga inspektimi në vend, u konstatua se vështirësi paraqiste mirëmbajtja e institucionit, si pasojë e amortizimit është e nevojshme, ndërhyrja për rregullimin për shkak të kategorisë së personave që trajtohen aty, ambientet kanë nevojë për investime si: Lagështira ishte problem i përgjithshëm, por në mensën e grave ishte shqetësues, riparime në banjën e grave (riparime hidraulike e suvatime), magazina e infermierisë kërkon zgjerim e ambient me të përshtatshëm, pajisja e lavanderisë me pajisje te reja, pasi ekzistueset ishin të amortizuara (dhurata nga kisha ose persona të ndryshëm). Në kundërshtim me nenin 28 të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, vazhdonin të sillleshin në këtë institucion në bazë të vendimeve gjyqësore, persona me çrregullime të shëndetit mendor që kanë kryer vepra penale për të cilat gjykatat kanë marrë vendim “mjekim të detyruar në një institucion mjekësor”. Theksojmë se Shërbimi i Shëndetit Mendor me shtretër, Shkodër, nuk është një institucion i posaçëm mjekësor për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor që kanë kryer vepra penale për të cilat gjykatat kanë marrë vendim për “mjekim të detyruar në një institucion mjekësor”. Sjellim në vëmendje se në ligjin nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, në nenin 28, pika 1 përcaktohet se: *“Institucionet mjekësore të posaçme janë institucione që shërbejnë për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor që kanë kryer vepra penale për të cilat gjykata kompetente ka vendosur mjekimin e detyruar në një institucion mjekësor, të të paraburgosurve apo të dënuarve që shfaqin çrregullime të shëndetit mendor gjatë vuajtjes së dënimit, si dhe për trajtimin e personave për të cilët gjykata ka vendosur shtrimin e përkohshëm në një institucion të posaçëm në bazë të nenit 239 të Kodit Procedurës Penale”*. Theksojmë se ligji nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, i cili ka hyrë në fuqi në datën 01.06.2012, nuk e kushtëzon zbatimin e dispozitave të tij me ndërtimin apo krijimin e institucioneve mjekësore të posaçme nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale. Për këta persona nga ana e shefes së këtij shërbimi ishin bërë kërkesa të vazhdueshme, jo vetëm për të sqaruar situatën e shtrimeve në institucion, por edhe për rivlerësim e masave nga ana e gjykatave. Personat me “mjekim të detyruar”, bëhen pengesë për shtrimet e reja, është e nevojshme ndërhyrja e menjëhershme për transferimin urgjent të këtyre personave. Këta pacient duhet të trajnohen me një institucion të posaçëm. (shkresa me nr prot.38 me datë 07.05.2019, e cila i drejtohet Njësisë vendore të kujdesit shëndetësor Shkodër. E megjithatë, për shkak të vonësive në përgjigje, ata vazhdonin të trajtoheshin për një kohë relativisht të gjatë në institucion, çka jo vetëm që e vështirësonte punën e stafit, por edhe nuk ofronte kushtet e përshtatshme të sigurisë. Grupi inspektues bëri takime private, pa praninë e

personelit të shërbimit me personat me masë mjekësore “mjekim i detyruar”. Ata për momentin ishin nën kujdesin intensiv të stafit mjekësor, nga biseda private me të sëmurët ata shprehën pozitivitet dhe nuk kishin ankesa për keqtrajtim fizik apo ushtrim dhune nga personeli i këtij shërbimi.

Problematika e dërgimit të personave abuzues me substancat narkotike dhe alkoolin pranë këtij shërbimi, ashtu si dhe në të gjithë institucionet e tjera psikiatrike në vend, mbetet e pazgjidhur dhe shqetësuese për stafin e institucionit, pasi ky i fundit nuk ka kapacitetet infrastrukturore dhe as burimet njerëzore për hospitalizimin apo ofrimin e një shërbimi të specializuar për personat abuzues me substancat të cilët si rregull duhet të trajtohen në repart toksikologjie. Institucioni nuk ishte pajisur ende me aparat EKG, si dhe me aparat për matjen e glicemisë. Këto aparate ishin në plan për t’u siguruar nga shoqata humanitare dhe OJF, pasi nuk kishte fonde të akorduara për këtë qëllim nga organet kompetente. Vazhdonte të mungonte dhoma e izolimit, si dhe mjetet e parashikuara të kufizimit fizik (rripat e këmishat e forcës), ndaj dhe mënyra e vetme për të realizuar atë ishte nëpërmjet kufizimit kimik. Shërbimi mjekësor mbetet me mungesa dhe nevojë të përhershme për kushte më të mira materiale, mbështetje me staf sigurie, për shkak të kushteve minimale të sigurisë, mjekët dhe stafi mbështetës janë gjithmonë të rrezikuar. Ndërkohë furnizimi me komplete të përshtatshme fjetjeje, veshmbathje, produkte higjieno-sanitare, dhe pajisje të tjera individuale ishte në sasi të mjaftueshme, në sajë të mbështetjes së vazhdueshme që institucioni kishte siguruar nga shoqatat humanitare. Furnizimi me ujë të rrjedhshëm ishte siguruar pa ndërprerje, duke u mundësuar personave nën trajtim plotësimin normal të nevojave të tyre. Institucioni kishte një sistem qendror ngrohje, i cili siguronte ngrohje në periudhën e dimrit dhe ajër të kondicionuar gjatë verës. Tualetet dhe dushet ishin të amortizuara, me lagështirë dhe në kushte jo të mira higjieno-sanitare. Pacientët zakonisht bënin dush 2 herë në javë. Përsa i përket ushqimit, sigurohej nga kuzhina e vetë këtij institucioni. Kuzhina ishte e pastër. Sistemi i aspirimit ishte funksional. Kuzhinierët dhe punonjësit që shpërndanin ushqimin, ishin të pajisur me librezën shëndetësore të higjienës. Kampionet ushqimore ruheshin rregullisht në kushte frigoriferike. Ushqimi ishte i mjaftueshëm. Ushqimi shërbehej 5 pesë herë në ditë (3 vaktet kryesore dhe 2 të ndërmjetme), mëngjesi, vakti para dreke, dreka, vakti i mbas ditës, darka. Vetëm një prej pacientëve E.V i cili vuante nga çrregullimi i përndjekjes dhe ishte i hospitalizuar me vendim gjykate, mjekim i detyruar shfaqti ankesë ndaj ushqimit të ofruar në spital për një cilësi më të mirë të ushqimit. Furnizimi me medikamente nuk kishte paraqitur probleme për këtë institucion, farmacia ishte e kompletuar me larmishmëri antipsikotikësh, antidepressivësh, ansiolitikësh, hipnosedativësh, si dhe stabilizues të humorit. Nuk kishte mungësi në medikamente edhe për sëmundjet e tjera kronike, kardiale, endokrinologjike, neurologjike, dermatologjike, etj kjo e ndihmuar edhe nga shoqatat humanitare. Shtrimet e pavullnetshme kryheshin në përputhje me nenin 20 të ligjit Nr. 44/ 2012, “Për Shëndetin Mendor”, procedurat ndiqeshin në mënyrë rigorozë, dhe plotësimi i dokumentacionit përkatës nga stafi i mjekëve të këtij spitali kryhej me rregull në të gjitha hallkat e tij. Organika e këtij institucioni ishte e plotësuar me mjekë, infermierë dhe kujdestarë, prej të cilëve 16 infermier , 15 kujdestarë . Roli i infermiereve në spital ishte mëse i rëndësishëm pasi ofronin dhe promovonin kujdes me qasje ndaj shërimit të sëmundjeve mendore, vlerësonin situatën dhe bisedonin me pacientët rreth problemeve që ata kanë dhe diskuton me ta për planin individual të trajtimit dhe mënyrën më të mirë që ky trajtim mund të jepet. Organika e shërbimit psiko-social ishte e plotësuar, e përbërë nga 4 (katër) psikologë dhe 1 (një) punonjëse sociale. Puna e tyre ndahej sipas pavijoneve, në planet individuale të

trajtimin për çdo pacient, si të atyre që shtroheshin në pavijonin e pranimit, ashtu edhe për ata të cilët trajtoheshin në dy pavijonet e tjera. Psikologu kryente vlerësimin e funksionimit psikologjik dhe mendor, si pjesë e vlerësimit multidisiplinar që i bëhet pacientit pas kontaktit të parë në shërbim. Vlerësimi mund të bëhet në bazë të intervistës së strukturuar klinike, ose duke përdorur teste të standardizuara të aftësive mendore dhe ose psikologjike. Stafit psiko-social pasi bënte një vlerësim psikologjik fillestar, të cilin e pasqyronte në kartelën mjekësore të pacientit bënte ndjekjen e ecurisë së tij paralelisht me trajtimin terapeutik okupacional. Ky i fundit dokumentohej dhe i bashkëlidhej kartelës mjekësore të pacienti. Raportet për pacientët e shtruar në spital i përcilleshin sektorit psiko-social të Drejtorisë Rajonale Shëndetësorë Shkodër, i cili mbikëqyrte mbarëvajtjen e punës në këtë spital. Nga ana e stafit psiko-social, pacientët në këtë institucion trajtoheshin me seanca këshillimore individuale apo në grup, psiko-edukim dhe mbështetje emocionale. Punonjësi social ofronte menaxhimin e rastit që përfshin krijimin dhe nxitjen e bashkëpunimit midis profesionisteve të ekipit multidisiplinar të një shërbimi dhe midis shërbimeve të ndryshme në funksion të përmirësimit të situatës psiko-sociale apo zgjidhjes së problematikave të një pacienti ose grupi pacientësh, gjetjen dhe vënien në lëvizje të burimeve të nevojshme për realizimin e planit të kujdesit për pacientin ose grupin e pacienteve. Nga bisedat me pacientët në përgjithësi kushtet dhe trajtimi vlerësoheshin pozitivisht nga ta. Stafit zhvillonte aktivitete të ndryshme në sallën e ergoterapisë si lojëra tavoline, punime dore me grep për gratë, si dhe ndonjë herë dhe lojëra me top për burrat, në oborrin e këtij institucioni. Kishte një tip biblioteke të vogël. Ambientet e përbashkëta, për zhvillimin e aktiviteteve apo terapive në grup nga ana e stafit psiko-social, ishin të bollshme, të rregullta dhe të mirëmbajtura.

Pacientët mund të lëviznin nëpër ambientet e spitalit dhe brenda rrethimit të tij. Ata kishin uniforma dhe higjienë të pranueshme. Lejoheshin takimet e herë pas hershme me familjarët.

Shefja e Shërbimit luante një rol shumë aktiv për përmirësimin e marrëdhënieve mes pacientëve dhe familjarëve, në disa nga rastet që ne konstatuam. Regjistrat e të gjithë pavijoneve dhe procedurave të shtrimeve që kryhen në spital ishin të sekretuar dhe të mbajtur me rregull. Të mbajtura me rregull dhe të pasqyruara saktë ishin regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve. Sistemi i kërkesë-ankesave funksiononte normalisht, në institucion ndodhej një kuti e veçantë ku mblidheshin të gjitha ankesat e të sëmurëve dhe të familjarëve. Nuk kishin patur asnjë ankesë për 2018-2019. Sistemi monitorues i kamerave të vëzhgimi në të gjithë ambientet e këtij institucioni ishin funksionale, si një ndër aspektet më të rëndësishme të parandalimit të veprave të dhunshme apo sjelljeve degraduese/çnjerëzore. Në përfundim të inspektimit u zhvillua sërish një takim me shefen e shërbimit, ku në mënyrë të përmbledhur iu bënë me dije gjetjet dhe problematikave të evidentuara.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës, nenit 21, germa “b” të ligjit Nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, si dhe nenit 12, nenit 74/1 pika “b” të ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar

Rekomanduar: Marrjen e masave të menjëhershme për vënien në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor” nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për ngritjen e institucioneve të posaçme mjekësore dhe për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor, që kanë kryer një veprë penale, për të cilët gjykata kompetente

ka vendosur mjekimin e detyruar në një institucion mjekësor, të të paraburgosurve apo të të dënuarve që shfaqin çrregullime të shëndetit mendor gjatë vuajtjes së dënimit, si dhe për trajtimin e personave, për të cilët gjykata ka vendosur shtrimin e përkohshëm në një institucion mjekësor të posaçëm, sipas nenit 239 të Kodit të Procedurës Penale, i ndryshuar; marrjen e masave të menjëhershme nga Ministria e Drejtësisë për gjetjen e një zgjidhjeje të shpejtë, efektive dhe të qëndrueshme, për shqyrtimin kryesisht brenda afateve ligjore nga gjykatat të të gjitha vendimeve të dhëna për “mjekim të detyruar në një institucion mjekësor”, si dhe për dërgimin e vendimeve në institucionet ku trajtohen personat përkatës. Në kushtet aktuale kjo mund të realizohet përmes dërgimit të një letër - porosie të gjitha gjykatave në shkallë vendi, ku t’u sillet në vëmendje detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 46, paragrafi i parafundit i Kodit Penal. Në perspektivë të vlerësohet mundësia e ngritjes së një sistemi elektronik qendror që t’u sjellë në kujtesë gjykatave shqyrtimin brenda afateve ligjore të vendimeve gjyqësore të dhëna për këtë kategori personash; marrjen e masave për ofrimin e shërbimit të specializuar me hospitalizim pranë spitaleve rajonale të personave abuzues me substancat narkotike apo/dhe alkoolin. Kjo do të zgjidhte problemin e trajtimit të papërshtatshëm të këtyre personave jo vetëm në Shërbimin e Shëndetit Mendor me Shtretër Shkodër, por edhe në spitalet psikiatrike të Elbasanit dhe Vlorës; marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e një dhome të izolimit në Shërbimin e Shëndetit Mendor me shtretër Shkodër në përputhje me nenin 27 të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”; marrjen e masave për furnizimin e Shërbimit të Shëndetit Mendor me Shtretër Shkodër me mjete të kufizimit fizik konform standardeve evropiane, ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor” dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë dhe për zbatim të tij; marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen me aparatën e EKG-së dhe aparat për matjen e glicemisë; marrjen e masave për riparimin e menjëhershëm të dusheve.

5.15. SPITALI PSIKIATRIK ELBASAN

MKPT-inspektoi Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinçi” Elbasan më datë 29.05.2019, sipas Planit të Inspektimit për vitin 2019 të miratuar më parë. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Ermonela Xhafa Komisionere e Mekanizmit Kombëtar, Nd/komisionerët Znj. Nertila Qafzezi, Besnik Deda, dr. Petur Hauksson përfaqësues i NPM OBS, si dhe dr. Alma Alibali mjekë psikiatre, eksperte e jashtme. Mbledhjen e informacionit lidhur me kushtet dhe trajtimin e pacientëve, si dhe identifikimin e rasteve të mundshme të përdorimit ndaj kësaj kategorie të presionit psikologjik dhe përdorimin e forcës fizike tej kufijve në tejkallim të standardeve . Në ditën e inspektimit në këtë shërbim me shtretër të shtruar ishin 326 (treqind e njëzet e gjashtë) persona nga ku evidentohet një mbipopullim prej 16 personash. Pacientët në përgjithësi sillen në këtë shërbim nga familjarët ose policia. Por ka dhe raste kur shtrohen pacientët me vendim gjykate. Nga kontakti me stafin, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacioneve, objekteve, pajisjeve dhe mjediseve, u konstatua se një pjesë e rëndësishme e rekomandimeve të bëra nga Avokati i Popullit në inspektimin paraardhës, kishin gjetur zbatim pjesërisht. Shërbimi i shëndetit mendor në Shqipëri rregullohet me ligjin Nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor” dt, 12.04.2012 (i pari, miratuar me 1996)⁴⁴; ligji Nr.10 107, Datë 30.3.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e

⁴⁴ Ligji Nr 8092.dt 21.03.1996 për Shëndetin Mendor

Shqipërisë”. Aktet e miratuara në zbatim të Ligjit Nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor” janë : VKM Nr. 456, datë 22.5.2013 “Për funksionimin e Komitetit Kombëtar për Shëndetin Mendor”, Rregullorja e Shërbimeve të Shëndetit Mendor, Standardet e Kufizimit Fizik në Shërbimet e Shëndetit Mendor të Specializuar me Shtretër dhe Regjistri përkatës, Plani i Veprimit për Shëndetin Mendor 2013-2021. Në konceptin e gjithpërfshirjes, kuadri ligjor dhe institucional ofron mundësinë e një sistemi të integruar të shërbimeve të shëndetit mendor, i cili nënkupton një rrjet shërbimesh në nivel rajonal. U evidentua nevojë në investime, kushte me të mira materiale për një shërbim cilësor, nevojë për një numër në rritje të stafëve mjekësore dhe mbështetëse. Nga inspektimi në vend, u konstatua se mirëmbajtja e institucionit nga ana infrastrukturore paraqiste vështirësi, si pasojë e amortizimit është e nevojshme ndërhyrja për rregullimin e ambienteve për shkak të kategorisë së personave që trajtohen aty, ambientet kanë nevojë për investime është emergjente. Diktuar nga një numër në rritje i sëmundjeve/çrregullimeve mendore, i tipologjive, i grupmoshave, i shtrirjes gjeografike, çrregullimeve për shkak të përdorimit të substancave narkotike, lind domosdoshmëri ndryshimi dhe përmirësimi i mbrojtjes dhe kujdesit të pacientëve në kushte të tilla komplekse, të vështira. Nga drejtori i spitalit u bë me dije se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kishte miratuar fondin për rikonstruksionin e plotë të spitalit, por ky fond do të lëvrohej në vitin 2020, kur do të fillojnë dhe punimet për rikonstruksionin. I kërkuam drejtorit që të na mbajë të informuar për këtë çështje.

Mbipopullimi në këtë spital ishte me 16 persona mbi kapacitet. Kapaciteti zyrtar është 310 persona. Duke qenë se numri i shtretërve në institucion ishte shtuar, nuk u gjetën pacientë që flinin përtokë, por shqetësues është mosrespektimi i hapësirës së tyre jetike. Vazhdonin të trajtoheshin si të shtruar në këtë spital 56 persona me aftësi të kufizuara intelektuale, për të cilët nuk ishte mundësuar akomodimi në komunitet, në shtëpi sociale, jashtë një shërbimi spitalor. Problematika e dërgimit të personave abuzues me substancat narkotike dhe alkoolin pranë këtij spitali mbetet e pazgjidhur dhe mjaft shqetësuese për stafin, pasi spitali nuk ka kapacitet infrastrukturor dhe as burimet njerëzore për hospitalizimin apo ofrimin e një shërbimi të specializuar për këtë kategori personash. Dy pavione vazhdonin të ishin problematikë, pasi si rrjedhojë e mbipopullimit, në to trajtoheshin pacientët akutë së bashku me ata të kthyer në rezidentë prej vitesh, çka e vështirëson ofrimin e shërbimit të përshtatshëm mjekësor. Laboratori klinik bio-kimik si dhe EKG-ja nuk ishin funksionale, ndonëse ata konsiderohen të domosdoshëm për shërbimin që duhet të ofrojë spitali. Ndërkohë furnizimi me komplete të përshtatshme fjetjeje, veshmbathje, produkte higjieno-sanitare, dhe pajisje të tjera individuale ishte në sasi të mjaftueshme. Tualetet dhe dushet ishin të amortizuara, me lagështirë dhe në kushte jo të mira higjieno-sanitare. Pacientët zakonisht bënin dush 1 herë në javë. Furnizimi me ujë të rrjedhshëm ishte i sigurt, kurse sistemi qendror i ngrohjes/ftohjes vazhdonte të kishte probleme dhe dilte shpesh jashtë funksionit. Ambulanca, megjithëse në funksion, mbetet e amortizuar. Përsa i përket ushqimit, sigurohej nga kontraktimi i një kompanie private, e cila përdorte kuzhinën e institucionit për gatim. Kuzhinierët dhe punonjësit që shpërndanin ushqimin, ishin të pajisur me librezën shëndetësore të higjienës. Kampionët ushqimorë ruheshin sipas rregullave. Kuzhina ndodhej në një ambient më vetë spitalit. Ushqimi ishte në cilësi të kënaqshme, i mjaftueshëm dhe nuk kishte raste të refuzimit të tij, por konstatoam se duhej të shërbehet në kushte të përshtatshme. Punonjësit që kujdeseshin për shpërndarjen e ushqimit, e transportonin ushqimin në pjata nga ambientet jashtë kuzhinës, tek godina

ku ndodheshin të sëmuret. Ushqimi shërbehej 5 (pesë) herë në ditë. (3 vaktet kryesore dhe 2 të ndërmjetme). Ambientet e përbashkëta, për zhvillimin e aktiviteteve apo terapive në grup nga ana e stafit psiko-social, ishin të bollshme, të rregullta dhe të mirëmbajtura. Stafi psiko-social kryente monitorimin e vazhdueshëm të pacientëve gjatë procesit të socializimit e të rehabilitimit në qendrat ditore, në punimet e dorës, në vizatime, piktura, gatime, në lojëra inteligjence e sportive dhe në higjienën e ambienteve të jashtme e të brendshme të qendrave ditore. Organika e institucionit, ndonëse e plotësuar, nuk përmbushte nevojat si për sa i përket mjekëve ashtu dhe infermierëve dhe kujdestarëve, numri i të cilëve mbetet i pakët në raport me numrin e pacientëve për pavijon. (një psikiatër dhe një infermier për 60 pacientë). Organika e këtij shërbimi psiko-social ishte e plotësuar me psikologë dhe punonjës social, puna e të cilëve ndahej sipas pavijoneve dhe fokusohej kryesisht në punën në grup si dhe atë individuale me pacientët, përgatitjen e dosjeve për secilin prej tyre, plotësimin në kartelat klinike si për pacientët që shtroheshin për herë të parë, ashtu edhe për ata rezidentë prej vitesh në institucion. Psikologu kryente vlerësimin e funksionimit psikologjik dhe mendor, si pjesë e vlerësimit multidisiplinar që i bëhet pacientit pas kontaktit të parë në shërbim. Vlerësimi mund të bëhet në bazë të intervistës së strukturuar klinike, ose duke përdorur teste të standardizuara të aftësive mendore dhe osepsikologjike. Stafi psiko-social pasi bënte një vlerësim psikologjik fillestar, të cilin e pasqyronte në kartelën mjekësore të pacientit bënte ndjekjen e ecurisë së tij paralelisht me trajtimin terapeutik okupacional. Ky i fundit dokumentohej dhe i bashkëlidhej kartelës mjekësore të pacienti. Punonjësi social ofronte menaxhimin e rastit që përfshin krijimin dhe nxitjen e bashkëpunimit midis profesionisteve të ekipit multidisiplinar të një shërbimi dhe midis shërbimeve të ndryshme në funksion të përmirësimit të situatës psiko-sociale apo zgjidhjes së problematikave të një pacienti ose grupi pacientësh, gjetjen dhe vënien në lëvizje të burimeve të nevojshme për realizimin e planit të kujdesit për pacientin ose grupin e pacientëve. Personeli i spitalit ishte i përkushtuar, komunikues dhe bashkëpunues me pacientët në spital. Nuk kishte asnjë pretendim për keqtrajtim apo dhune kundër pacientëve nga stafi, nuk kishte as raste dhune ndërmjet vetë pacientëve. Dhoma e izolimit megjithëse e ndërtuar rishtazi, nuk ishte përputhje me pikën 4.4.6 të “Standardeve të Kufizimit Fizik në Shërbimet e Shëndetit mendor të Specializuar me Shtretër”, në zbatim të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”. Nuk ishin siguruar mjetet shtrënguese (këmisha force dhe rripa lëkure) të domosdoshme për realizimin e imobilizimit sipas nenit 27 të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, për rastet e veçanta të trajtimit (axhitimit psiko-motor, tentativa suicidale apo homicidale). Mënyra përmes të cilës mundësohej imobilizimi ishte kufizimi kimik. Ende nuk ka asnjë regjistër qendror mbi përdorimin e mjeteve të kufizimit (si mbajtja fizike e një pacienti të dhunshëm dhe kufizimi kimik). Sistemi i kërkesë-ankesave funksiononte normalisht, në institucion ndodhej një kuti e veçantë ku mblidheshin të gjitha ankesat e të pacientëve dhe të familjarëve, e cila ishte e vendosur në hyrjen e institucionit. Me urdhërin e drejtorit Nr. 609/1 dt. 01.11.2018 ishte ngritur Komisioni për menaxhimin dhe administrimin e ankesave, në mbështetje të ligjit nr.9106 datë 17.07.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, “Kodi i procedurave Administrative”, “Rregullores së Brendshme të Spitalit Psikiatrik si dhe në mbështetje të ligjit nr.9492 datë 13.03.2006 “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit”.

Për vitin 2018-2019 nuk kishte patur asnjë ankesë. Grupi inspektues bëri takime private me personat me masë mjekësore “mjekim i detyruar”. Ata për momentin ishin nën kujdesin intensiv nga stafi

mjekësor, gjatë bisedës me të sëmurët ata u shprehën pozitivisht për stafin mjekësor. Nuk kishin ankesa për trajtimin dhe ushqimin. Furnizimi me medikamente nuk paraqiste probleme për këtë institucion, përveç mungesës së kohëve të fundit të Prometazinës. Regjistrat e të gjithë pavijoneve (regjistri i pranimit, i konsultave, i shtrimeve të pavullnetshme dhe regjistri i informacionit 24 orësh të infermierëve) ishin të sekretuar dhe të mbajtur me rregull. Për sa i përket dokumentacionit, stafi mbante një regjistër të ndërhyrjeve për pavijonin e pranimit dhe atë sub-akut, si dhe një regjistër për aktivitet që zhvilloheshin në institucion dhe jashtë tij. Kabineti stomatologjik ishte pajisur me instrumente dhe materiale dentare. Shtrimet e pavullnetshme kryheshin në përputhje me nenet 20 të ligjit Nr. 44/ 2012, “Për Shëndetin Mendor” dhe procedurat ndiqeshin në mënyrë rigoroze nga stafi i mjekëve të këtij spitali në të gjitha hallkat e tij. Në Spitalin Psikiatrik të Elbasanit, shumica e pacientëve të cilët formalisht janë të klasifikuar si “vullnetarë”, nuk lejohen të largohen nga spitali vetë dhe prandaj janë de facto të privuar nga liria pa përfituar nga ndonjë mbrojtje procedurale. Procedurat e vendosjes së pavullnetshme nuk përbëjnë mbrojtje efektive, pasi kjo kategori pacientësh zakonisht nuk janë të përfshirë në procedurën gjyqësore. Këta persona qëndrojnë në spital prej vitesh për shumë arsye si, braktisja nga familja, mungesa e institucioneve rehabilituese etj. Nga kontakti i marrë me pacientët, pa praninë e stafit, nuk rezultoi që ndaj tyre të ishte ushtruar presion psikologjik apo forcë fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative. Pacientët mund të lëviznin nëpër ambientet e spitalit dhe brenda rrethimit të tij. Ata kishin uniforma dhe higjienë të pranueshme. Lejoheshin takimet e herë pas hershme me familjarët. Mungonte sistemi monitorues i kamerave të vëzhgimi në të gjithë ambientet e këtij institucioni, si një ndër aspektet më të rëndësishme të parandalimit të veprave të dhunshme apo sjelljeve degraduese/çnjerëzore. Në përfundim të inspektimit u zhvillua sërish një takim me drejtuesin e institucionit, ku në mënyrë të përmbledhur iu bënë me dije gjetjet dhe problematikat e evidentuara.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës, nenit 21, germa “b” të ligjit Nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, si dhe nenit 12, nenit 74/1 pika “b” të ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar **Rekomanduar:** Marrjen e masave të menjëhershme për uljen e mbipopullimit në Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinçi” Elbasan, duke i dhënë zgjidhje problemit të trajtimit si rezidentë të personave me aftësi të kufizuar intelektuale në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, si dhe duke mundësuar trajtimin e personave abuzues me substancat narkotike apo/dhe alkoolin në një repart toksikologjie të përshtatshëm për këtë qëllim; marrjen e masave që dhoma e kufizimit fizik të ndërtohet dhe pajiset në përputhje me pikën 4.4.6 të “Standardeve të Kufizimit Fizik në Shërbimet e Shëndetit mendor të Specializuar me Shtretër”, në zbatim të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”; marrjen e masave të vendosjes së një sistemi monitorues kamerash vëzhgimi në të gjithë ambientet e këtij institucioni, si një ndër aspektet më të rëndësishme të parandalimit të veprave të dhunshme ndaj shtetasve dhe anasjelltas, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut; marrjen e masave të menjëhershme që të sigurohen mjetet shtrënguese (këmisha force dhe rripa lëkure) të domosdoshme për realizimin e imobilizimit sipas nenit 27 të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”; marrjen e masave për shtimin në organikën e këtij institucioni të numrit të infermierëve, kujdestarëve, berberit dhe një punonjësi për mirëmbajtjen, në përputhje me nevojat për trajtim të pacientëve në shërbim të shëndetit mendor me

shtretër; marrjen e masave për mundësimin e riorganizimit të pavijoneve të pacienteve akutë më vete; marrjen e masave për ofrimin e shërbimit të specializuar me hospitalizim pranë spitaleve rajonale të personave abuzues me substancat narkotike apo/dhe alkoolin. Kjo do të zgjidhte problemin e trajtimit të papërshtatshëm të këtyre personave në spitalet psikiatrike të Elbasanit dhe Vlorës si dhe Shërbimin e Shëndetit Mendor me shtretër, Shkodër; marrjen e masave për përmirësimin e kushteve në pavijone, dushe dhe tualete në mënyrë që të ofrohet një shërbim sa më dinjitoz të personave që trajtohen në këtë spital; marrjen e masave të menjëhershme në vënien në funksion të Laboratorit klinik bio-kimik si dhe të aparatit të EKG-së; marrjen e masave për vënien në funksion të plotë të sistemit qendror të ngrohjes/ftohjes.

5.16. SPITALI PSIKIATRIK VLORË

MKPT-inspektoi Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë më datë 24.04.2019, sipas Planit të Inspektimit për vitin 2019 të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin zj. Ermonela Xhafa, me detyrë Komisionere e Mekanizmit Kombëtar, zj. Lindita Xhillari, z. Genci Tërpo, z. Besnik Deda dhe z. Alfred Kocobashi me detyrë ndihmës komisionerë të institucionit të Avokatit të Popullit.

Grupi i inspektimit vizitoi ambientet e këtij spitali. Nga inspektimi në vend, kontakti me stafin dhe pacientët, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, objekteve, pajisjeve dhe mjediseve, grupi inspektues grumbulloi informacion në lidhje me të drejtat, kushtet dhe trajtimin e pacientëve në këtë spital, respektimin e të drejtave të tyre, si dhe me problematikat e ndeshura gjatë punës. Struktura dhe organika e institucionit ishte e përbërë nga 128 punonjës, prej të cilëve 91 punonjës në përbërje të ekipit multidisiplinar, (mjek psikiatër 5, psikolog 5, punonjës social 8, infermier 42, kujdestar 31) të ndarë sipas pavijoneve, Shtëpive të Mbështetura Nr.1-2-3 dhe Q.K.SH.M, si dhe 37 punonjës ishin staf mbështetës. Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë përbëhej nga 4 pavijone dhe shtëpitë e mbështetura nr.1-2-3, me kapacitet zyrtar prej 188 pacientësh. Më konkretisht, Pavioni i Pranim-Urgjencës me 9 shtretër, Pavioni Akut –Sub-Akut (burra-Gra) me 34 shtretër, Pavioni Kronik-Gra me 60 shtretër, Pavioni kronik Burra me 51 shtretër dhe Shtëpitë e Mbështetura nr.1-2-3 me 34 shtretër. Në momentin e inspektimit, në spital ndodheshin 144 pacientë të shtruar, nga të cilët 141 pacientë ndodheshin të ndarë sipas pavijoneve dhe 3 pacientë ndodheshin në ambientin e observacionit. Infrastruktura e re e spitalit mundësonte kushte dinjitoze, trajtimi për çdo person me probleme të shëndetit mendor që paraqitej në urgjencën e spitalit dhe vizitat mjekësore kryheshin konform ligjit 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”. Ambientet, kushtet materiale, hapësira jetike për pacient, si dhe shërbimi që ofrohej në pavijonin e pranim, urgjencës dhe ato akut dhe subakut për gra dhe burra ishin në përputhje me standardet. Sistemi i ankimit funksionon edhe në rastin e kërkesave/ankesave nga grupe interesi si psh, shoqata apo grupime të tjera vullnetare të pacientëve, familjarëve ose personave të interesuar për mbrojtjen e interesave të personave me çrregullime të shëndetit mendor. Nga sa më lartë u konstatua se rekomandimet e bëra nga Avokati i Popullit, sa i përket përmirësimit të kushteve të jetesës në pavijonet ku mbaheshin të sëmurët kronikë, nuk kishin gjetur zbatim, për mungesë të akordimit të fondeve për këtë qëllim nga autoritetet përkatëse. Konkretisht situata paraqitej si më poshtë: Ligji për shëndetin mendor, në nenin 31 të tij, përcakton procedurat e monitorimit të jashtëm të shërbimit të

shëndetit mendor nga Avokati i Popullit, nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin Torturës, Trajtimin Çnjerëzor dhe Poshtëruës, që vepron si strukturë e veçantë nën autoritetin e tij, vëzhgon rregullisht, me anë të inspektimeve periodike, respektimin e të drejtave dhe të standardeve që u ofrohen personave me çrregullime të shëndetit mendor në mjediset e shërbimit të shëndetit mendor të specializuar me shtretër, si dhe paraqet rekomandime në organet përkatëse, me qëllim përmirësimin e trajtimit dhe kushteve të pacientëve dhe sigurimin e respektimit të plotë të të drejtave të njeriut në institucionet e kujdesit të shëndetit mendor. Shërbimi i shëndetit mendor në Shqipëri rregullohet me ligjin “Për shëndetin mendor” i 12 prillit 2012 (i pari, miratuar me 1996); një ligj i veçantë përveç ligjit “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”. Pas miratimit të tij, sfida mbetej në përshtatjen dhe zbatimin faktik të tij në Shqipëri. Ky ligj solli nevojën e reformave në lidhje me ngritjen dhe zhvillimin në shkallë kombëtare të kujdesit komunitar të shëndetit mendor si e vetmja mënyrë për të arritur shërbime komunitare të shëndetit mendor për të gjithë (përfshi deinstitutionalizimin të personave që vuajnë sëmundje të shëndetit mendor; monitorimin e të drejtave dhe lirive themelore nga mekanizma të jashtëm, pjesëmarrjen aktive të aktorëve të shoqërisë civile, etj). Në konceptin e gjithëpërfshirjes, kuadri ligjor dhe institucional ofron mundësinë e një sistemi të integruar të shërbimeve të shëndetit mendor, i cili nënkupton një rrjet shërbimesh në nivel rajonal. Godina e spitalit të ri ishte ndërtuar në vitin 2015, me gjithë infrastrukturën e brendshme të rikonstrktuar. Gjithashtu, ishte instaluar sistem i ri i monitorimit me kamera, si dhe sistemi qendror i ngrohjes/ftohjes, i cili ishte në funksion të plotë. Ndërkohë, në pavijonet e kronikëve si rrjedhojë e mungesës së investimeve, godinat ishin të amortizuara dhe në gjendje jo të mirë teknike. Nga ana e Drejtorisë të institucionit ishte realizuar projekti i rikonstruksionit për të dyja godinat e pavioneve të kronikëve burra dhe gra, i cili është paraqitur pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresë datë 26.07.2018, për tu përfshirë në projekt buxhetin e vitit 2019. Por, në momentin e inspektimit, institucioni ende nuk kishte një përgjigje nga ana e Ministrisë, por ishin në pritje të investimit për rikonstruksion të këtyre godinave. Gjendja në 2 pavijonet e pacientëve kronikë të vendosur si rezidentë në këtë institucion, nuk paraqitej e mirë. Në këto godina, nuk respektohej hapësira jetike dhe kishte lagështirë. Këto salla vazhdonin të mbanin deri në 15 pacientë. Dhomat ku ishin vendosur këta pacientë kishin dritare të mëdha që siguronin ndriçim natyral, por ngrohja për ta ishte e pamjaftueshme. Materialet e buta (dyshekët, çarçafët, batanijet, jastëk, veshmbathjet, kostumet e pacientëve) ishin të siguruar nga operatori ekonomik privat “AGS” (*Avance Global Service*), sipas nevojave dhe kërkesave të institucionit të përshtatshme për çdo stinë të vitit. Tualetet e dushet, duke patur parasysh gjendjen e godinave janë të kompletuara me pajisje hidrosanitare, të cilat zëvendësohen me fondet e institucionit sipas nevojave. Në spital janë duke u trajtuar 25 persona me aftësi të kufizuar intelektuale, 12 paciente gra dhe 13 pacientë burra. Aktualisht janë edhe 3 pacientë në shtëpitë e mbrojtura. Ekipi multidisiplinar është duke punuar rast pas rasti për të realizuar daljet e pacientëve kronik aty ku ka një bërthamë familjare, në bashkëpunim dhe me institucionet e shërbimeve sociale dhe bashkitë përkatëse. Shtrimet e pavullnetshme kryheshin në përputhje me nenin 20 të ligjit Nr. 44/2012, “Për Shëndetin Mendor”. Procedurat ndiqeshin në mënyrë rigorozë nga stafi i mjekëve të këtij spitali në të gjitha hallkat e tij, dhe plotësimi i dokumentacionit përkatës bëhej në kohë dhe me rregull. Dhoma e izolimit megjithëse e ndërtuar rishtazi, kishte nevoja për rregullime për shkak të dëmtimeve që kishte pësuar nga të sëmurët e axhituar. Institucioni duke përdorur fondin 20% të

mirëmbajtjes së vitit 2018 është duke sistemuar të dyja dhomat e izolimit, atë të pavionit të pranimit dhe atë të pavionit kronik.(aktualisht në rikonstruksion). Në këtë institucion spitalor mungonin mjetet e parashikuara të kufizimit fizik (rripat e lëkurës), ndërkohë që ky spital ishte i pajisur me një këmishë force, e cila në momentin e inspektimit ishte jashtë përdorimi. (ishte grisur nga pacientë të dhunshëm).

Ushqimi sigurohej me katering nga shërbimi privat i kuzhinës. Kuzhinierët dhe punonjësit që shpërndanin ushqimin, ishin të pajisur me librezën shëndetësore të higjienës. Kampionët ushqimorë ruheshin sipas rregullave në frigorifer konstatuar kjo në momentin e inspektimit. Ushqimi ishte cilësor dhe nuk kishte raste të refuzimit të tij. Furnizimi me ujë ishte pa probleme dhe plotësonte nevojat e përditshme. Problematika e dërgimit të personave abuzues me substancat narkotike dhe alkoolin pranë këtij spitali mbetej e pazgjidhur dhe mjaft shqetësuese për stafin, pasi spitali nuk ka kapacitet infrastrukturor dhe as burimet njerëzore për hospitalizimin apo ofrimin e një shërbimi të specializuar për këtë kategori personash, por nisur nga kompleksiteti i problemeve edhe të shëndetit mendor të këtyre personave ata kanë marrë shërbimin e duhur nga stafi i spitalit. Autoambulanca ishte në funksion të plotë dhe në ndihmë të stafit kishte edhe një furgon, i cili shërbente për aktivitetet që zhvillonte stafi psiko-social me pacientët jashtë institucionit. Organika e shërbimi psiko-social ishte e plotësuar. Kishte një mirë organizim dhe ndarje të punës ndërmjet punonjësve, si dhe një bashkëpunim e bashkërendim të mirë me stafin mjekësor.(kjo e konstatuar nga intervistat e kryera me disa prej këtyre punonjësve). Ambientet e përbashkëta, për zhvillimin e aktiviteteve apo terapive në grup nga ana e stafit psiko-social, ishin të bollshme, të rregullta dhe të mirëmbajtura. Punonjësit e shërbimit psiko-social punonin mbi bazën e një plani fillestar që në shtrim dhe më pas pacientët ndiqeshin me këshillime individuale e në grup, psiko-edukim dhe në fund kishte një plan daljeje për secilin prej tyre. Ndërsa sa i përket pacientëve kronikë shërbimi i këtij stafi përqendrohej në rehabilitimin e tyre, duke punuar me plane individuale si dhe bëheshin përpjekje për t'i përgatitur që të transferoheshin në shtëpizat e mbështetura e në raste shumë të rralla në shtëpi. Kjo procedurë kryhej me vendimmarrje të mjekut kurues dhe shefit të pavijonit.(verifikuar nga dosjet dhe intervistat me personat përgjegjës). Kabineti stomatologjik ishte i rregullt dhe i pajisur me instrumente dhe materiale dentare. Nga verifikimi i bërë rezultoi se regjistrat e të gjithë pavijoneve dhe procedurave të shtrimeve që kryhen në këtë spital ishin të sekretuar dhe të mbajtur me rregull, regjistri i pranimit, i konsultave, dhe ai i shtrimeve të pavullnetshme. Të mbajtura me rregull dhe të pasqyruara saktë ishin edhe regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve. Nga kontakti i marrë me disa pacientë, pa praninë e stafit, nuk rezultoi që ndaj tyre të ishte ushtruar presion psikologjik apo forcë fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative. Ky spital kishte të ngritur sistemin elektronik për çdo pacient dhe diagnozat e tyre si dhe zyrën e informacionit me personel të mjaftueshëm. Diktuar nga një numër në rritje i sëmundjeve/çrregullimeve mendore, i tipologjive, i grupmoshave, i shtrirjes gjeografike, çrregullimeve për shkak të përdorimit të substancave narkotike, etj., lind domosdoshmëri ndryshimi dhe përmirësimi i mbrojtjes dhe kujdesit të pacientëve në kushte të tilla komplekse/ të vështira. Praktika botërore i mëshon politikave lehtësuese dhe mbështetëse për shërbimet e shëndetit mendor, duke vendosur prioritetet strategjike që lidhen me trajtimin, ndjekjen, trajtimin spitalor të këtyre pacientëve (shërbimet e shëndetit mendor) në krahasim me shërbimet e kujdesit shëndetësor në tërësi. Për këtë ndërhyrje të rëndësishme, strukturat qeverisëse duhet të krijojnë hapësira për zgjerimin e

mbështetjes dhe garantimit të prioriteteve ndaj këtij shërbimi mjekësor për të garantuar mirëfunksionimin e çdo strukture apo specialiteti

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës, nenit 21, germa “b” të ligjit Nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, si dhe nenit 12, nenit 74/1 pika “b” të ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar *liria dhe të parandalohet tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor dhe poshtëruar*”,

Rekomanduar: Marrjen e masave të menjëhershme për t’i dhënë zgjidhje problemit të trajtimit si rezidentë të personave me aftësi të kufizuar intelektuale në kundërshtim me legjislacionin në fuqi; marrjen e masave për ofrimin e shërbimit të specializuar me hospitalizim pranë spitaleve rajonale të personave abuzues me substancat narkotike apo/dhe alkoolin, si dhe duke krijuar ambient të veçantë brenda kapaciteteve ekzistuese në spitalin psikiatrik Ali Mihali, Vlorë; marrjen e masave të menjëhershme lidhur me rikonstruksionin për përmirësimin e kushteve të jetesës në godinën e vjetër, eliminimin e lagështirës në dhoma, dhe zëvendësimin e pajisjeve hidrosanitare dushe e tualete, në mënyrë që të ofrohet një trajtim sa më dinjitoz të personave që trajtohen në këtë spital; marrjen e masave nga autoritetet përgjegjëse për sigurimin e të gjithë medikamenteve të domosdoshme për ofrimin e një shërbimi cilësor në këtë spital; marrjen e masave për pajisjen e spitalit me rripa të kufizimit fizik dhe këmisha force si një domosdoshmëri për trajtimin me dinjitet të pacientëve; marrjen e masave për trajnimin e stafeve mbështetëse për përdorimin e mjeteve fizik konform standardeve të parashikuara në Paketën e Akteve Nënligjore të ligjit Nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, dhjetor 2013 pika 1.1. si dhe përmirësimin e kushteve aktuale për izolimin e pacientëve me kriza akute.

5.17. QENDRA KOMBËTARE PRITËSE E AZILKËRKUESVE BABRRU

MKPT kreu inspektim në Qendrën Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve. Inspektimi u krye në datën 16.04.2019, sipas një Plani-Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit.

Qendra e Azilkërkuesve, është një institucion në varësi të Ministrisë së Brendshme, që funksionon në mbështetje të ligjit nr.121/2014 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë” dhe në bazë të Vendimit nr.332, datë 04.05.2016 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit”, me qëllim strehimin e të huajve që kërkojnë azil në Republikën e Shqipërisë. Qendra Kombëtare Pritëse është e vetmja në territorin e Republikës së Shqipërisë ku akomodohen dhe trajtohen shtetas të huaj që kërkojnë mbrojtje në Shqipëri. Në këtë qendër strehohen azilkërkuesit pas paraqitjes së kërkesës për azil, si dhe personat të cilëve iu është refuzuar aplikimi për azil, derisa të mbarojnë procedurat e ankimit apo afatet për ushtrimin e tyre. Pranimi i azilkërkuesve dhe personave të tjerë që gëzojnë mbrojtje në bazë të legjislacionit ndërkombëtar dhe kombëtar, bëhet me akt-pranimi (akt dorëzimi) të nënshkruar nga personi i autorizuar i drejtorisë vendore për kufirin dhe migracionin ose policisë së shtetit dhe një prej specialistëve të qendrës. Një kopje e akt-pranimit (akt dorëzimit) rruhet në zyrën e protokoll-arkivës. Pas pranimit të azilkërkuesit, sektori i mbështetjes së azilantëve në bashkëpunim me sektorin e financës dhe mbështetjes me shërbime, harton plan-

masash për akomodimin dhe përgatitjen e ambienteve ku do të strehohen azilkërkuesit. Kjo qendër ofron strehimin e azilkërkuesve, kujdesin për shërbimin shëndetësor, sigurinë e tyre, ushqimin, veshmbathjen dhe plotësimin e të gjithë nevojave jetike të tyre. Nga informacioni i grumbulluar në vend, nga kontakti me stafin e institucionit, këqyrja e dokumentacionit, i objekteve dhe mjediseve, rezultoi se rekomandimet e dërguara pas inspektimit të bërë në vitin 2017, ndonëse janë pranuar në parim, vetëm një pjesë e tyre janë zbatuar, sikurse përmendim:

Kapaciteti zyrtar i kësaj qendre është 180 persona, sipas pajisjes me shtretër. Në mjediset e institucionit në kohën e inspektimit ndodheshin 164 persona nga këta: meshkuj të rritur 89, meshkuj minorene 31, femra të rritura 25, femra minorene 19.

Ndërkohë pritej ardhja e 29 azilkërkuesve nga Drejtoria e Kufirit Korçë. Në rastet kur numri i azilkërkuesve e tejkalon kapacitetin, institucioni i ka akomoduar në ambiente të tjera si, salla e pritjes, e lojërave dhe argëtimit.

Pasi mori informacionin e nevojshëm lidhur me inspektimin, grupi i punës inspektoi ambientet e kësaj qendre. Nga këqyrja në vend gjatë inspektimit, rezultoi se gjendja faktike e ambienteve ishte përmirësuar ndjeshëm me përfundimin e godinës së re, 4-katëshe për akomodimin e azilkërkuesve. Megjithëse gjatë monitorimit konstatuam dëmtime të shumta në infrastrukturën e brendshme kjo për shkak të fluksit në rritje të azilkërkuesve prej vitit 2017. Gjatë vizitës monitoruese, grupi inspektues pati si objekt të punës së tij mbledhjen informacionit lidhur me trajtimin e azilkërkuesve të strehuar në këtë qendër të hapur, si dhe identifikimin e rasteve të përdorimit të presionit psikologjik, të dhunës fizike, apo të ushtrimit të forcës tej kufijve të parashikuar nga aktet normative në fuqi ndaj kësaj kategorie. Grupi inspektues mori kontakt me pjesën më të madhe të azilkërkuesve që gjendeshin në qendër dhe bisedoi me ta në mënyrë konfidenciale. Nga bisedat e kryera nuk rezultoi që ndaj tyre të ishte ushtruar dhunë fizike apo psikologjike nga personeli i qendrës. Azilkërkuesit të cilët dyshohet se mund të kenë qenë viktima të torturës deri në momentin e ardhjes në institucion apo akteve të tjera të rënda të dhunës, qoftë kjo seksuale, fizike apo psikologjike, i krijohen mundësitë për këshillim dhe/ose trajtim të veçantë mjekësor dhe psikologjik. Për çdo rast vlerësohet gjendja e tyre nga punonjësit e Sektorit të Mbështetjes së Azilantëve, e më pas shihet mundësia që rasti të trajtohet brenda ambienteve të QKPA së apo të referohet në instanca më të specializuara kur vlerësohet si e nevojshme. Trajtimi me ushqim i azilkërkuesve bëhej mbështetur në një kuotë të ulët, rreth 330 (treqind e tridhjetë) lekë/në ditë, e cila paraqiste vështirësi për përmbushjen e nevojave. Qendra nuk ofronte një ndihmë ekonomike kjo bazuar në Ligjin për Azilin në Republikën e Shqipërisë nr. 121/2014, neni 56, pika 3, thuhet se *"Refugjati për sa kohë trajtohet në Qendrën e pritjes për azilkërkuesit ose në ato të strehimit të përkohshëm, nuk përfiton ndihmë ekonomike"*. Personat e akomoduar në Qendrën Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve që u intervistuan nga grupi i inspektimit, pohuan se mund të dilnin nga institucioni dhe se mund të zhvillonin aktivitetet e tyre personale pa probleme, duke gjetur mbështetje nga stafi i qendrës. Një problematikë e pazgjidhur ndër vite, e cila edhe përgjatë këtij inspektimi ishte qëndrimi afatgjatë i personave në këtë qendër. Koha e qëndrimit varioonte nga dy javë deri në disa vite, duke e bërë edhe me të vështirë akomodimin në periudhën kur ka fluks emigrantesh, si dhe integrimin e tyre në shoqëri. Kjo e pasqyruar edhe në numrin e personave

të rikthyer nga drejtoria e kufirit të cilët nga periudha Janar-Mars 2019 janë 271 (dyqind e shtatëdhjetë e një) azilante. Sa i përket çështjes së sigurisë, në mesin e re të Qendrës Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve ishte instaluar sistemi i monitorimit me kamera në mjediset e përbashkëta, jo në ato të banimit. Siguria e ambienteve të qendrës bëhej ndërmjet një kompanie të shërbimit privat të sigurisë fizike. Sistemi i kamerave monitorohej nga punonjësi i sigurisë. Struktura e kësaj qendre përbëhej nga: Ndërtesa 4 (katër) katëshe e ndërtuar nga donatori UNHCR me fonde të BE-së, e cila kryen disa funksione : Në katin e parë është kuzhina bashkë me ambientin e mensës dhe dy tualete, lavanderia, infermiera, dhoma e personave me aftësi të kufizuara, salla e kamerave të sigurisë. Në katin e dytë janë vendosur salla e internetit, biblioteka, dhoma e fëmijëve për orët argëtuese dhe edukative, gjithashtu, po në këtë kat ndodhet dhe dhoma akomodimi për azilkërkuesit. Kati i tretë dhe i katërt është i gjithi për akomodime për azilkërkuesit të pajisura me tualete për të gjitha ambientet, me sistem ngrohjeje dhe ftohjeje, ujë të ngrohtë 24 orë. Godina njëkatëshe janë 5(pesë) 3(tre) godina janë ambiente akomoduese dhe me tualetet përkatëse, me sistem ngrohjeje dhe ftohjeje, me ujë të ngrohtë njëzet e katër orë. 1 (një sallë) pritjeje dhe intervistimi në momentin e pritjes së azilkërkuesve. 2 (dy) godina të tjera, janë zyra për administratën dhe ambiente ndihmëse për administrimin e qendrës (magazina).

Lavanderia ishte në kushte shumë të mira, me 5 lavatriçe të reja, si dhe pranë saj shërbente sanitaria e qendrës. Ambienti i bibliotekës ishte i bollshëm dhe i ndriçuar, i pasur me libra. Qendra mbahej me fondet e buxhetit të shtetit, ndërsa pajisjet ishin mbuluar nga UNCHR. Në katin e dytë të godinës së re ishte dhoma e fëmijëve, e pajisur edhe me kamera. Ajo ishte rreth 40 m², e ndriçuar dhe e mobiluar duke filluar nga tavolinat dhe karriget deri te lojërat e ndryshme dhe për të vazhduar më tej me pikturat shumëngjyrëshe që gjendeshin nëpër mure, duke krijuar kështu një ambient të veçantë për fëmijët që strehohen në qendër. Kuzhina ishte e pastër, kishte mjaftueshëm tavolina dhe karrige për azilkërkuesit. Punonjëset e saj ishin të pajisura me librezë dhe kushtet higjienike ishin të mira. Menyja e përditshme ishte e afishuar. Për të rriturit ofroheshin 3 vakte në ditë dhe për fëmijët 4. Kampionët ushqimorë ruheshin në një ambient frigoriferik. Ashtu sikurse u konstatua në vend nga grupi i inspektimit, edhe nga intervistat e bëra me azilantët e akomoduar në qendër, ushqimi ishte i një cilësie të mirë. Në momentin e inspektimit nuk kishte kërkesa të posaçme lidhur me dietën ushqimore, pavarësisht se stafi ishte i përgatitur edhe për këtë çështje. Në ambientet e qendrës kishte gjithashtu edhe Wi-Fi. Në katet e sipërme të godinës së re, mjediset e banimit ishin të strukturuar në dhoma të mëdha, të pajisura me tualete dhe me dush brenda. Në përgjithësi, dhomat e banuara kishin dritë natyrale dhe artificiale dhe ishin të pajisura me orenditë e nevojshme të reja. Nuk u konstatua prani e insekteve apo e brejtësve. Sistemi i ngrohjes së qendrës kryhej përmes paneleve diellore.

Në përgjithësi, në të gjitha intervistat e kryera, grupi i inspektimit konstatoi se nuk kishte mungesa në furnizimin e azilkërkuesve me shtroje, mjete të tjera të higjienës personale dhe asaj të përbashkët. Furnizimi me ujë të rrjedhshëm ishte pa kufizim oraresh dhe nuk u konstatuan probleme as me energjinë elektrike. Për këtë të fundit kishte edhe një gjenerator në raste ndërprerjeje të energjisë. Grupi i monitorimit konstatoi se në oborrin e qendrës kishte një mjedis të jashtëm të rrethuar, i cili përdorej për basketboll dhe kalçeto, por ishte i shtruar me beton dhe ishte i papërshtatshëm për aktivitete sportive, mungonte një kënd lojërash i jashtëm për fëmijët. Nisur nga fakti se qendra ishte e hapur, personat e strehuar në të ishin të lirë të punonin, të dilnin nga qendra, apo edhe të kryenin

aktivitete të tjera personale. Pavarësisht kësaj, stafi i kësaj qendre, i përbërë prej 15 vetash, organizonte herë pas here aktivitete të përbashkëta, të tilla si ditëlindje, gjatë verës vajtje në pishina, ndeshje futbollit dhe basketbollit, etj. Ambiente kulturi nuk kishte. Kjo qendër kishte nënshkruar një marrëveshje me Ministrinë e Arsimit lidhur me arsimimin 9-vjeçar të fëmijëve të strehuar në këtë qendër. Nga intervistat me vetë fëmijët, grupi i inspektimit u bë me dije se aktualisht ata ndiqnin shkollën rregullisht. Biblioteka funksiononte dhe kishte një numër të konsiderueshëm titujsh. Tërheqja dhe kthimi i librave bëhej duke shënuar të dhënat përkatëse në një kartelë personale.

Kurset profesionale ofroheshin në bashkëpunim me RMSA-në dhe përmendim ato për mekanikë, gjuhë të huaja, parukeri, kompjuter, leje drejtimi etj.

Gjithashtu, kishte edhe një ambient të përbashkët për ndjekjen e programeve televizive.

Gjatë këqyrjes së dokumentacionit, grupi i inspektimit vuri re se stafi i qendrës mbante regjistrin elektronik themeltar për të gjithë personat e strehuar në qendër, si dhe regjistrin themeltar të sekretuar. Secili prej tyre kishte një dosje specifike me të gjithë dokumentacionin e duhur dhe zhvilloheshin takime të veçanta nga stafi psiko-social me ta. Organika e qendrës kishte mungesa në mjek me kohë të plotë, infermier dhe stomatolog, këto shërbime vijnë të mos ofrohen nga qendra, por në bashkëpunim me RMSA ("Organizata Shërbimet Shqipëtare për Refugjatët") dhe UNHCR është mbuluar pozicioni i një infermieri për një periudhë 6-mujore. Me rikonstrukcionin e mjedisëve të qendrës, ishte parashikuar një dhomë e veçantë për mjekun me të gjitha pajisjet e duhura. Nuk kishte mungesa në furnizimin me medikamente. Institucioni nuk kishte një autoambulancë. Por në raste emergjente, përdoreshin makinat e qendrës për transportimin e azilkërkuesve pranë qendrave spitalore. Gjithashtu ishin të hapura Librezat Shëndetësore për të gjithë azilkërkuesit e akomoduar në qendër, dhe skema e rimbursimit të ilaçeve ishte në funksion të plotë. Medikamentet mjekësore të rimbursueshme përfitoheshin me të njëjtën praktikë si shtetasit e tjerë të Republikës së Shqipërisë, në rastin konkret nga fondet e qendrës. Ndërsa medikamentet mjekësore të parimbursueshme bliheshin sipas procedurave të prokurimit publik.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës, nenit 21, gërma "b" të ligjit Nr. 8454 datë. 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", si dhe nenit 12, nenit 74/1 pika "b" të ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim", i ndryshuar

Rekomanduar: Marrjen e masave për rritjen e kuotës ditore të trajtimit me ushqim të azilkërkuesve, duke marrë parasysh rritjen e çmimeve të ushqimeve në vite; marrjen e masave të nevojshme për shtimin në organikë të kësaj qendre minimalisht me mjek të përgjithshëm, infermier, punonjës social, kujdestar nate, përkthyes, mirëmbajtës; marrjen e masave për pajisjen e institucionit me një autoambulancë; marrjen e masave për krijimin e një këndi lojërash për fëmijët dhe një fushë sportive të përshtatshme për kryerjen e aktiviteteve sportive.

5.18. QENDRA PRITËSE E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT LINZË

MKPT-më datë 19.04.2019 **kreu një inspektim në Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikut Linzë**, sipas një Plani Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikut është pjesë përbërëse e rrjetit të institucioneve të përkujdesit shoqëror të administruara nga shërbimi social shtetëror. Kjo qendër ka si mision përmirësimin e statusit social të viktimave të mundshme të trafikimit, ndërgjegjësimi dhe aftësimi i tyre për jetesë të pavarur në komunitet, nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm të procesit të vetëvlerësimit, të luftës ndaj stigmës dhe diskriminimit që kanë efekt të drejtpërdrejtë në riintegrimin e plotë. Qëllimi i kësaj qendre është rehabilitimi i grave, vajzave të trafikuar ose të identifikuar si potencial trafikimi. Qendra Kombëtare e Viktimave të Trafikut u ofron përfituesve një vendqëndrim të përkohshëm, të sigurt, jashtë rrezikut, duke ofruar në të njëjtën kohë ndihmë të specializuar për riaftësimin dhe rikthimin në jetën normale. “Viktimë” do të nënkuptojë çdo person fizik që është objekt i trafikimit të qenieve njerëzore, siç përcaktohet nën/5 “Parandalimi i trafikimit të qenieve njerëzore”. Konventa e Këshillit të Europës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”. Kapaciteti zyrtar i kësaj qendre është prej 80 shtretëri, por aktualisht funksional janë 50. Në momentin e inspektimit, në mjediset e institucionit ndodheshin 7 (shtatë) viktima të mundshme të trafikimit të moshës nga 14-18 vjeç ku njëra prej përfitueseve vuante nga probleme të shëndetit mendor. Organika e qendrës përbëhej nga 17 punonjës ku numrin më të madh të punonjësve e zenë punonjësit social. Kjo ishte vizita periodike monitoruese e Avokatit të Popullit në Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikut për vitin 2019. Qëllimi i vizitës ishte grumbullimi i informacionit në lidhje me të drejtat, kushtet dhe trajtimin e viktimave të mundshme të trafikimit në këtë institucion, si dhe verifikimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve të bëra nga Avokati i Popullit.

Numri i personelit në këtë qendër është 17 punonjës, nga të cilët 5 punonjës social, 1 mjek, 1 psikolog dhe 1 kujdestare. Asistenca psiko-sociale realizohet dhe përmbushet përmes shërbimit dhe raporteve psiko-sociale nga personeli i specializuar. Punonjësit social të cilët kanë edhe rolin më të madh në këtë qendër kryenin vlerësimin e nevojave të identifikuar dhe hartojnë programe të ndërhyrjes, këshillimin individual dhe në grup për mbrojtjen e interesave individuale të përfitueseve.

Asistenca mjekësore përmbushet nga mjekja e qendrës e cila realizon vlerësimin e nevojave mjekësore të përfitueseve në momentin e akomodimit në qendër. Në bashkëpunim me shërbimet shëndetësore rajonale plotëson dosjen mjekësore të përfitueseve dhe hap kartelat shëndetësore për to. Ilaçet sigurohen përmes blerjeve të vogla, sipas nevojave specifike të personave që trajtohen në këtë qendër. Në rastet emergjente shëndetësore mjeku ndjek dhe shoqëron trajtimin e tyre në spital apo tek specialisti.

Gjatë inspektimit në Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikut, nuk u paraqitën ankesa lidhur me trajtimin, ushqimin apo për probleme dhe shqetësime të tjera. Koha e qëndrimit të personave në këtë qendër varionte nga 3 muaj deri në një vit. Sipas procedurës, grupi ndërdisiplinor trajton çdo rast specifik deri në përfundimin e gjyqimit dhe riintegrimin të viktimës së mundshme të trafikimit. Nga intervistimet e bëra nga grupi i inspektimit rezultoi se të gjithë personat e akomoduar në Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikut ndodheshin aty si viktima të mundshme të trafikimit.

Për të garantuar sigurinë e jetës së banorëve që trajtoheshin në Qendrën Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikut ishte instaluar dhe funksiononte një sistem monitorimi me kamera si për ambientet e jashtme ashtu dhe për ato të brendshme. Ruajtja e sigurisë së qendrës kryhej nga stafi i sigurisë së Ministrisë së Rendit Publik në bazë të Akt-Marrëveshjes së firmosur më datën 15.06.2004. Mbrojtja e përfituesve mbështetej në evidentimin dhe plotësimin e nevojave të veçanta, bazuar në vlerësimin e gjithë jetës së përfituesve, aspekteve emocionale, fizike, arsimore, sociale, gjinore, etj. Sistemi i ankesë/kërkesave funksiononte konform akteve normative në fuqi. Ankesat e banoreve depozitoheshin në një kuti të posaçme, e cila hapej një herë në muaj nga punonjësit e Shërbimit Social Shtetëror. Në rastet kur ankesat kishin karakter urgjent, ankueset takoheshin drejtpërdrejtë me drejtuesin e institucionit. Vizitat me të afërmit realizohen dhe monitorohen tek Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për siguri të lartë të përfituesve në qendër. Punonjësi që kishte në ndjekje rastin mbante kontaktet me të afërmit e viktimës së mundshme të trafikimit. Në kuadër të ndërtimit të një sistemi për monitorimin e standardeve, grupi inspektues u informua se pas daljes nga qendra, personat e akomoduar në të, ktheheshin në familjet e tyre ose në strehëzat e ngritura nga OJF të ndryshme, të cilat merren me riintegrimin e tyre dhe sistemimin në jetën e përditshme. Gjatë monitorimit në të dy godinat, grupi i inspektimit konstatoi se ishin afishuar postera, jo vetëm për të drejtat e përfituesve, por edhe të drejtat dhe detyrimet e personelit të punësuar pranë qendrës, pjesë kjo e rregullores së brendshme të qendrës. Në këtë qendër e cila është e përbërë nga dy godina, ndonëse ishin bërë rikonstruksione të pjesshme të ambienteve të jashtme dhe të brendshme të saj, mbeteshin problematike lagështira dhe amortizimi i ndërtesave. Gjatë vizitës inspektuese drejtuesja e këtij institucioni e informoi grupin inspektues se ishte parashikuar rikonstruksioni i plotë dhe për këtë ishte përgatitur një projekt i detajuar dhe siguruar fondet e nevojshme nga implementimi i një projekti me Ambasadën Amerikane brenda vitit 2019. Në mesin e parë, e cila kryesisht shërbente për zyrat e administratës, si edhe mjedise të tjera të përbashkëta për përfitueset e kësaj qendre, ishin kryer punime ristrukturimi dhe situata e mjediseve të brendshme ishte e mirë. Në mesin e dytë, ndodheshin dhomat e përfituesve, me krevate, të pajisur me shtroje dhe orendi. Mjedisi i përbashkët (atelieja), ishte në një gjendje më të mirë se nga inspektimi i mëparshëm dhe të gjithë kompjuterët ishin vënë në funksion të plotë. Tualetet ishin përgjithësisht të mirëmbajtura, me kushte të mira higjieno-sanitare dhe në sajë të sigurimit të paneleve diellore kishin ujë të ngrohtë për larje gjatë gjithë kohës. Produktet higjieno-sanitare dhe veshmbathjet e përshtatshme për përfitueset e të gjitha moshave dhe masave ishin siguruar. Ndërkohë ishin në funksion makinat larëse dhe shërbimet e tjera sanitare. Furnizimi me ujë të pijshëm bëhej 24 orë në 24, si dhe ishte zgjidhur çështja e ndërprerjeve të herë pas herë me tërësi elektrike pasi institucioni ishte pajisur me gjenerator. Ishte siguruar riparimi dhe sistemi qendror i ngrohjes. Ngrohja sigurohej rregullisht sipas parashikimeve të rregullores së brendshme të institucionit. Kuzhina, megjithëse e pajisur me mjetet e domosdoshme, vazhdonte të kishte probleme lagështire si rezultat i amortizimit të ndërtesës. Ushqimi ishte i larmishëm dhe i bollshëm, por grupi i punës konstatoi se kampionet ushqimore nuk emërtoheshin sipas vakteve ditore ushqimore megjithëse ato ruheshin në kushte frigoriferike. Mensa ishte një mjedis tjetër brenda kësaj godine me rreth 8 tavolina ngrënieje në kushte të mira higjienike. Dhoma e mjekes ishte e rregullt dhe e pajisur me një krevat vizitash, një dollap për mbajtjen e medikamenteve dhe një tjetër për mbajtjen e kartelave mjekësore për secilën përfituese. Grupi i monitorimit konstatoi se ishte bërë një rikonstruktim i këndit

të lodrave për fëmijë. Stafi i sektorit psiko-social ishte i përbërë nga 5 punonjës social dhe një psikologe. Ky staf, përveç aktiviteteve rehabilituese, planeve ndihmëse dhe konsultave individuale sipas rasteve, plotësonte dosjet me të dhënat personale të përfituesve dhe i administron ato. Punonjësit socialë mbi bazën e vlerësimit të nevojave hartonin programe të ndryshme për të bërë të mundur integrimin e përfituesve në jetën sociale, nëpërmjet organizimit të aktiviteteve dhe sinkronizimit të ndërhyrjeve. Reabilitimi për përfitueset kryej me programe shërbim/ këshillimi, individual ose në grup. Punonjësit socialë shoqëronin përfitueset në takimet me familjarët dhe kurset profesionale. Psikologjia në qendër hartonte skeda psikologjike lidhur me llojin e terapisë që përdorej, lojëra dhe aktivitete për zhvillimin psikologjik. Në bazë të nevojave individuale psikologu i shoqëronte përfitueset në seancat gjyqësore. Qendra kishte edhe një bashkëpunim të mirë organizuar me qendrat; “Të ndryshëm dhe të barabartë”, Tiranë; “Tjetër Vizion”, Elbasan dhe “Vatra” në Vlorë, të cilat së bashku përbënin koalicionin kombëtar antitrafik. Kurset e formimit profesional në QKPVT ofroheshin nga Qendra e Formimit Profesional nr. 4, Tiranë, ku disa përfitueseve i ofrohej mundësia për kurse parukerie, kuzhine, rrobaqepësi, etj. Për këtë qëllim ishte vënë në dispozicion edhe baza materiale. Sa i përket arsimimit 9-vjeçar për viktimat që strehoheshin në këtë qendër, grupi i inspektimit u informua se për shkak të sigurisë së lartë që ka kjo qendër, si dhe pamundësisë së përfituesve për të lëvizur jashtë saj, ky shërbim nuk ofrohej. Dokumentacioni i këtij stafi ishte i plotësuar rregullisht dhe me rigorozitet, që nga vlerësimi i nevojave të përfitueseve, planet ndihmëse, konsultat individuale, e deri në ri integrimin e tyre me mbështetjen edhe të shoqatave apo qendrave që trajtojnë këtë kategori personash. Organika e qendrës ishte e plotësuar me një mjekë me kohë të plotë ndryshe nga inspektimi i mëparshëm ku mjeku ishte në mungesë. Mjeku në momentin e mbërritjes së përfitueseve në qendër kryente vlerësimin e nevojave mjekësore. Në bashkëpunim me shërbimet shëndetësore rajonale, kryente plotësimin e dosjes personale mjekësore të përfitueseve dhe hapte kartelat shëndetësore. Mjeku organizonte emulacionin shëndetësor në institucion, kontrollonte menynë ditore duke insistuar në respektimin e sasisë, cilësisë e shumëllojshmërisë së ushqimit. Vizitat kryheshin në dhomën e mjekes dhe medikamentet, përfshirë këtu edhe ato të urgjencës, ndodheshin në një dollap të posaçëm. Për sa i përket rasteve për të cilat nevojitej konsultë e specializuar, shërbimi ofrohej pa vonesa nga mjekë specialistë të QSU “Nënë Tereza” Tiranë. Herë pas here në këtë institucion nevojitej edhe një vlerësim i specializuar i psikiatrit për shkak të specifikave dhe problemeve që mund të manifestoheshin nga përfitueset gjatë trajtimit në këtë qendër. Ky shërbim mund të ofrohej nga Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor, e cila i përket zonës së mbulimit të këtij institucioni. Medikamentet siguroheshin nëpërmjet një buxhetit të veçantë të qendrës. Shërbimi stomatologjik kryhej rregullisht nga një subjekt privat, bazuar në marrëveshjen që kjo qendër kishte lidhur me klinikën përkatëse. Institucioni nuk kishte një autoambulancë, por në raste emergjente, përdoreshin makinat e qendrës për transportimin e viktimave pranë qendrave spitalore. Nga këqyrja e dokumentacionit që administronte mjekja e këtij institucioni, u konstatua se ekzistonte një regjistër vizitash, si dhe kartelat për secilën përfituese të cilat ishin të plotësuara me rregull.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës, nenit 21, gërma “b” të ligjit Nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, si dhe nenit 12, nenit 74/1 pika “b” të ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar

Rekomanduam: Marrjen e masave për ndryshimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 589, datë 28.08.2003 “Për ngritjen dhe vënien në funksionim të Qendrës Pritëse të Viktimave të Trafikut”, bazuar në ligjin nr. 90/2012, datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, për të parashikuar detyrat funksionale të këtij institucioni, shërbimet që ofrohen në të, si edhe përcaktimin e përfitueseve sipas Procedurave Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave/Viktimave të Mundshme të Trafikimit; marrjen e masave për garantimin e procesit mësimor për arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar; marrjen e masave për emërtimin e vakteve ushqimorë, në kampionët ushqimorë të konservimit 24 orësh; marrjen e masave për pajisjen e qendrës me ambulancë.

5.19. Q.S.U.T SPITALI PSIKIATRIK “XHAVIT XHARRA”

MKPT- më datën 05.04.2019 sipas Planit të Inspektimit për vitin 2019 të miratuar nga Avokati i Popullit. Kjo ishte vizita e parë periodike monitoruese e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës në Shërbimin e Psikiatrisë QSU “Nënë Tereza” Tiranë për vitin 2019. Shërbimi i shëndetit mendor në Shqipëri rregullohet me ligjin “Për shëndetin mendor” i 12 prillit 2012 (i pari, miratuar me 1996)⁴⁵; një ligj i veçantë përveç ligjit “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”. Pas miratimit të tij, sfida mbetej në përshtatjen dhe zbatimin faktik të tij në Shqipëri. Ky ligj solli nevojën e reformave në lidhje me ngritjen dhe zhvillimin në shkallë kombëtare të kujdesit komunitar të shëndetit mendor si e vetmja mënyrë për të arritur shërbime komunitare për të gjithë (përfshi deinstitutionalizimin të personave që vuajnë sëmundje të shëndetit mendor, monitorimin e të drejtave dhe lirive themelore nga mekanizma të jashtëm, pjesëmarrjen aktive të aktorëve të shoqërisë civile, etj.). Në konceptin e gjithëpërfshirjes, kuadri ligjor dhe institucional ofron mundësinë e një sistemi të integruar të shërbimeve të shëndetit mendor, i cili nënkupton një rrjet shërbimesh në nivel rajonal. Në praktikë, mangësi u evidentuan në lidhje me nevojën për mbështetje me investime, kushte me të mira materiale dhe një shërbim cilësor, nevojë për një numër në rritje të stafëve mjekësorë dhe mbështetëse, adresimin e psikiatrisë ligjore ambulatorë apo trajtimin dhe monitorimin e kushteve për personat me çrregullime mendore që kanë kryer vepër penale (personat që vuajnë dënimin me burg apo që janë me masa mjekësore, mjekim i detyruar). Të tjera mangësi, si psh roli i mjekut të familjes në identifikimin, referimin apo ndjekjen e pacientëve që shfaqin sëmundje të shëndetit mendor, krijimi dhe garantimi i trajtimit të urgjencave mjekësore pranë familjeve, procedurat e ndalimit dhe transportit të urgjencave psikiatrike, etj. Bashkëpunimi dhe mbështetja që strukturat e policisë duhet t’i ofrojnë shërbimit në rastet kur vihet në rrezik jeta dhe shëndeti i mjekëve dhe stafit spitalor. Më konkretisht: Komponenti siguri ishte i mangët, si për stafin mjekësor, psiko-social e ndihmës, ashtu edhe për studentët specializantë dhe familjarët e pacientëve. Trajtimi i pacientëve në përgjithësi, dhe veçanërisht i atyre me emergjencë psikiatrike të kombinuara me abuzim dogrash dhe axhitim psiko-motor, ishte vështirësuar nga incidentet e agresionit me pasojë dëmtime serioze që kishin bërë të nevojshme

⁴⁵ Ligji Nr 8092.dt 21.03.1996 për Shëndetin Mendor

ndërhyrjet me shpeshtësi të konsiderueshme të policisë së komisarariatit të zonës. Që prej ndryshimeve ligjore të vitit 2012, shërbimi i shëndetit mendor ende nuk ka vendosur mekanizma apo rregullime ligjore e administrative që të adresojnë procedurat e “ndalimit” apo “transportit” të të sëmurëve mendorë në rast a) krizash psikiatrike; b) kryerje të një vepre penale; c) cenim të sigurisë publike. Pajisja e ambienteve të përbashkëta të spitalit me kamera vëzhguese nuk ishte realizuar ende. Dhoma e izolimit ishte jashtë funksionit, pasi nuk ishte ndërtuar dhe pajisur në përputhje me standardet. EKG-ja vazhdonte ishte jashtë funksionit, prej më shumë se dy vitesh. Ky shërbim, sikurse dhe ai stomatologjik, laboratorik klinik-biokimik dhe ekzaminimet imazherike, apo konsultat me specialistë të klinikave apo shërbimeve të tjera, ofroheshin pjesërisht nga shërbimi i neurologjisë dhe nga shërbime të specialiteteve përkatëse në Q.S.U.T. Sistemi qendror i ngrohjes vazhdonte të ishte problematik dhe shpesh herë jashtë funksionit. Kishte mangësi në furnizimin me mjete të hotelerisë, si dhe të produkteve higjieno sanitare dhe veshmbathje për pacientët e shtruar në spital. Disa prej ambienteve të brendshme (dyert e dhomave, dushet, tualetet, etj.) kërkonin ndërhyrje të menjëhershme rikonstruksioni e riparimesh. Mungonin ambientet e përbashkëta, për zhvillimin e aktiviteteve apo terapive në grup nga ana e stafit psiko-social. Kati i nëndheshëm i kësaj godine vazhdonte të ishte bosh, në mungesë të investimeve të cilat do të krijonin ambiente të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve rehabilituese nga ana e stafit psiko-social. Sistemi i brendshëm i ankimit është një çështje e pazgjidhur nga ana e mekanizmave të shërbimeve të shëndetit mendor. Mungesa e këtij sistemi në thelb cenon parimin e transparencës dhe llogaridhënies për rastet individuale që mund të trajtohen brenda sistemit të shërbimit të shëndetit mendor. Ligji për shëndetin mendor në nenin 31 të tij përshkruan procedurat e monitorimit të jashtëm të shërbimit të shëndetit mendor nga Avokati i Popullit, nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit çnjerëzor dhe poshtëruës, që vepron si strukturë e veçantë nën autoritetin e tij. Avokati i Popullit vëzhgon rregullisht, me anë të inspektimeve periodike, respektimin e të drejtave dhe të standardeve që u ofrohen personave me çrregullime të shëndetit mendor në mjediset e shërbimit të shëndetit mendor të specializuar me shtretër, si dhe paraqet rekomandime në organet përkatëse, me qëllim përmirësimin e trajtimit dhe kushteve të pacientëve dhe sigurimin e respektimit të plotë të të drejtave të njeriut në institucionet e kujdesit të shëndetit mendor. Sistemi i ankimit funksionon edhe në rastin e kërkesave/ankesave nga grupe interesi si psh, shoqata apo grupime të tjera vullnetare të pacientëve, familjarëve ose personave të interesuar për mbrojtjen e interesave të personave me çrregullime të shëndetit mendor. Roli i mjekut të familjes dhe garantimi i trajtimit të urgjencave spitalore afër familjeve (nëpërmjet seksioneve të urgjencave psikiatrike pranë spitaleve rajonale) mbeten të pa adresuara. Që prej vitit 2009, Shëndeti Mendor është pjesë e Paketës Bazë të Shërbimeve që ofrohen nga Mjekët e Familjes (MF). Qëllimi i shërbimeve të shëndetit mendor në këtë nivel përkufizohet si: *“Ky shërbim asiston individë me probleme të shëndetit mendor dhe ndihmon në përmirësimin e gjendjes shoqërore, që është përcaktuese e shëndetit jo të mirë mendor të pacientëve dhe familjeve të tyre”*. Në shërbimin e shëndetit mendor mungojnë protokollet e trajtimit për patologjitë e rënda. Vështirësitë praktike lidhen me nevojën për trajnime të vazhdueshme, të profilizuara dhe të avancuara mbi metodat e trajtimit, format dhe modelet më të mira botërore të rehabilitimit, decentralizimit dhe deinstitutionalizimit të trajtimit të pacientëve të sëmurë mendorë. Numri në rritje i pacientëve me probleme kronike shëndetësore identifikon nevojën e punës së koordinuar, në mjedise me teknologji bashkëkohore për

adresimin e nevojave mjekësore. Pavarësisht koncepteve bashkëkohore për deinstitutionalizimin e pacientëve, puna dhe angazhimi i plotë në trajtimin spitalor të pacientëve të sëmurë mendorë kronikë kufizon miratimin dhe zbatimin e shërbimit të integruar. Sistemi ynë shëndetësor mbetet larg shfrytëzimit të teknologjive të reja të informacionit për të rritur kapacitetin e burimeve njerëzore dhe profesionale ekzistuese shëndetësore; për të përmirësuar produktivitetin dhe efektivitetin e burimeve njerëzore, për garantimin e një shërbimi mjekësor cilësor, efektiv. Integrimi i teknologjisë në mbledhjen, procesimin, përdorimin për punë kërkimore shkencore dhe vlerësime koherente të gjendjes së shërbimit shëndetësor do të ndihmonte praktikisht në identifikimin e shkallës së përhapjes së sëmundjeve mendore, në evidentimin e tipologjive të sëmundjeve, të kostove individuale dhe kostove shtetërore për çdo pacient (qoftë të hospitalizuar apo të trajtuar me mjekim). Mbajtja e regjistrave me shkrim, shumëllojshmëria e tyre, dhe vështirësitë praktike të mjekëve dhe infermierëve në plotësimin e tyre “me shkrim”, konsumon kohë të vyer në ndihmë të pacientëve, vështirëson ndjekjen dinamike të ecurisë së sëmundjeve të pacientëve; paralizon plotësisht sistemin e referimit apo ndjekjes së urgjencave psikiatrike që mund të identifikohen nga mjeku i familjes. Spitali i Psikiatrisë për Fëmijë dhe Adoleshentë është rehabilituar tërësisht, me kushte dhe standarde bashkëkohore për trajtimin e fëmijëve që vuajnë nga problemet e shëndetit mendor. Klinika e Psikiatrisë së Fëmijëve e Adoleshentëve është një njësi specifike brenda shërbimit të Psikiatrisë. Është e vetmja strukturë me shtretër për këtë profil në vend, si ofruesja e shërbimeve terciare në psikiatrinë e moshave nën 18 vjeç. Kjo klinikë ofron shërbime ambulatorë, shërbime të Spitalit Ditor dhe shtrimet tipike afatshkurtra e afatmesme për rreth 1500 fëmijë e adoleshentë në vit. Çrregullimet e zhvillimi, psikozat e hershme, çrregullimet afektive, çrregullimet e ankthit, anoreksitë dhe çrregullimet e tjera të ushqyerjes përbëjnë diagnozat më të shpeshta. Investimi në Psikiatrinë për Fëmijë nuk është thjesht investim në infrastrukturë, por ka një vlerë terapeutike për fëmijët me probleme të shëndetit mendor, që përballen edhe me vështirësitë e qëndrimit larg shtëpisë, në përpjekjen për të luftuar me sëmundjen.

Shërbimi psikiatrik për të rritur vuan nga mungesa sistematike që lidhen me përmirësimin e kushteve materiale. Kjo vërehet që në momentin e hyrjes në institucion në mungesat e një recepsioni funksional, në mosfunksionimin e sistemit të mbikëqyrjes e më pas në amortizimin e tejskajshëm të ambienteve të përbashkëta të higjienës, mungesës së sistemit të ngrohjes e ftohjes në pavijone, nevojës për ambiente të përshtatshme rehabilitimi. Këto problematika të përsëritura kthehen në kushte të papërshtatshme për pacientët dhe për stafin mjekësor dhe stafin mbështetës, të cilët duhet të përballojnë çdo ditë dinamika komplekse të të sëmurëve kronike dhe akutë. Procedura e ndjekur për shtrimet e pavullnetshme, në këtë shërbim dokumentohej në kartelën mjekësore të pacientit bazuar në nenin 22 pika 4. Shërbimi ka plotësuar rekomandimet e mëparshme në lidhje me dokumentimin në regjistra të veçantë (shtrimi i vullnetshëm, kufizimi fizik, konsultat ambulatorë etj.), por sot është domosdoshmëri që shërbimit t'i ofrohet një sistem qendror i kompjuterizuar për të ndihmuar në procesin e planifikimit dhe menaxhimit efektiv të nevojave gjithnjë në rritje për këtë shërbim. Shërbimit i janë vënë në dispozicion mjete të kufizimit fizik (këmisha force), por numri i tyre mbetet mjaft i kufizuar dhe nevoja për mbështetje mbetet prezent për të gjitha institucionet me shtretër në rang kombëtar. Grupi i inspektimit u njoftua se ishte kryer vënia e një këmishe force, për shkak të një urgjence psikiatrike. Në hapësirat e përbashkëta, brenda në pavijon, korridore apo ambiente të tjera të

këtij institucioni mungon informacioni për familjarët në lidhje me oraret e vizitave, takimet, ambientet e përbashkëta të vizitave për pacientet. Shërbimi mjekësor mbetet me mungesa dhe nevojë të përhershme për kushte më të mira materiale, për shkak të kushteve minimale të sigurisë, mjekët dhe stafi mbështetës janë gjithmonë të rrezikuar. Pavarësisht ngritjes së një task force të posaçme, në parim ky problem nuk duhej të ekzistonte, por gjatë bisedave me disa prej anëtareve të kësaj task force, mungesa e trajtimit financiar dhe e profilizimit të tyre, bën që mjekët në disa raste të ndihen të pambrojtur dhe në kërcënim për jetën e tyre. Gjatë inspektimit, nga drejtuesi i Shërbimit u ngrit si shqetësim marrëdhënia institucionale që duhet krijuar me punonjësit e policisë së shtetit në raste specifike kur kërcënohet jeta dhe integriteti i mjekut apo stafit mbështetës. Shkak për këtë shqetësim ishte bërë një rast ku një paciente e shtruar në pavijonin e grave kishte mbyllur mjekët në zyrën e tyre dhe ishte larguar nga ambientet e spitalit, duke u bërë kërcënim për veten e saj (pacientja) dhe për popullatën. Shërbimi social, pavarësisht shkresave të përsëritura dhe argumentimit për nevojën e shtimit të tyre mbetet i pakët në numër dhe praktikisht jo funksional për rehabilitimin efektiv të pacientëve të shtruar. Sikundër u përmend më lart, mungesa e ambienteve rehabilituese, kushteve fizike dhe materiale e vështirësojnë punën individuale për çdo pacient. Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit psiko-social u konstatua, se ekzistonin dosje personale për të gjithë personat që trajtoheshin në këtë institucion të cilat ishin të mbajtura dhe të plotësuara me rregull me plane individuale trajtimi, psikologët dhe punonjësit social, me gjithë gatishmërinë e tyre për rol sa më aktiv, mbeten të mënjanuar për shkak të mungesave urgjente për hapësire dhe kushte materiale. Shërbimet e tjera për institucionin, si shërbimi stomatologjik, ai laboratorik klinik-biokimik dhe ekzaminimet imazherike, EKG, apo konsultat me specialistë të fushave të tjera të kujdesit shëndetësor, ofroheshin pjesërisht nga shërbimi i neurologjisë dhe nga shërbime të specialiteteve përkatëse në QSUT. Stafi i Shërbimit vuri në dispozicion të grupit të inspektimit shkresa të përsëritura për nevoja emergjente drejtuar stafit të lartë drejtues të QSUT. Trajtimi me dinjitet, pa diskriminim, në kushte të barabarta si për pacientët e tjerë, kërkon analiza të thelluara, në kushtet kur shërbimi psikiatrik do të duhet të gëzojë mbështetje dhe vullnetin e plotë të strukturave qeverisëse për ndryshimin dhe përmirësimin e gjendjes aktuale. Qasja e pamjaftueshme ndaj shërbimeve alternative që lidhen me deinstitutionalizmin, vështirësitë praktike në ofrimin e programeve rehabilituese dhe decentralizimi i shërbimit të shëndetit mendor, mbeten sfida të tjera të rëndësishme që duhen marrë në konsideratë për t'u plotësuar përpara përfundimit të Planit të Veprimit dhe Strategjisë për shëndetin mendor 2013-2022. Diktuar nga një numër në rritje i sëmundjeve/çrregullimeve mendore, i tipologjive, i grup moshave, i shtrirjes gjeografike, çrregullimeve për shkak të përdorimit të substancave narkotike, etj., lind domosdoshmëri ndryshimi dhe përmirësimi i mbrojtjes dhe kujdesit të pacientëve në kushte të tilla komplekse, të vështira. Praktika botërore i mëshon politikave lehtësuese dhe mbështetëse për shërbimet e shëndetit mendor, duke vendosur prioritete strategjike që lidhen me trajtimin, ndjekjen, trajtimin spitalor të këtyre pacientëve (shërbimet e shëndetit mendor) në krahasim me shërbimet e kujdesit shëndetësor në tërësi. Për këtë ndërhyrje të rëndësishme, strukturat qeverisëse duhet të krijojnë hapësira për zgjerimin e mbështetjes dhe garantimit të prioriteteve ndaj këtij shërbimi mjekësor për të garantuar mirëfunksionimin e çdo strukture apo specialiteti.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës, nenit 21, germa “b” të ligjit Nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, si dhe nenit 12, nenit 74/1 pika “b” të ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar

Rekomanduam: Marrjen e masave të menjëhershme për përgatitjen e matricës së rekomandime dhe ngritjes së një grupi pune të përbashkët për rishikimin dhe vlerësimin e Strategjisë Kombëtare dhe planit të veprimit për ndryshime rrënjësore që duhen ofruar për këtë shërbim; marrjen e masave për përmirësimin e kushteve të pritjes, të shoqërimit dhe shtrimit të pacientëve, si dhe garantimin e ambienteve pritëse për familjarët (për shkak të specifikave të trajtimit dhe mbulimi gjeografik të ofron ky institucion në Tiranë); marrjen e masave për mbështetje me staf shtesë, pajisje mjekësore dhe medikamente, në përmbushje të kërkesave të përsëritura të këtij Shërbimi nga QSUT; marrjen e masave nga ana e QSU “Nënë Tereza” Tiranë për krijimin e një zyre informacioni në këtë shërbim, si dhe vendosjen e tabelave orientuese në ambientet e brendshme të tij; marrjen e masave për vendosjen e një sistemi monitorues me kamera vëzhgimi në ambientet e përbashkëta të këtij institucioni, ku nuk cenohet privatësia e pacienteve, si masë parandaluese e trajtimit çnjerëzor dhe degradues të pacientëve si dhe me qëllim ofrimin e një shërbimi cilësor në nivel sigurie në marrëdhëniet personel mjekësor-pacient, për vetë specifikën që ky institucion ka; marrjen e masave për vënien në funksion të plotë të sistemit qendror të ngrohjes; marrjen e masave për shtimin në organikën e këtij institucioni të numrit të infermierëve, berberit dhe një punonjësi për mirëmbajtjen, duke pasur parasysh specifikën e këtij shërbimi të shëndetit mendor me shtretër; marrjen e masave për vënien në funksionim dhe trajtimin financiar për grupin e posaçëm task force, i cili aktualisht është jofunksional; rikonstruksionin efektiv dhe pajisjen me dyer dhe dritare të reja për secilin pavijon të të rriturve (burrat dhe gratë); marrjen e masave për trajnimin e stafeve mbështetëse për përdorimin e mjeteve të kufizimit fizik konform standardeve të parashikuara në Paketën e Akteve Nënligjore të ligjit Nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, Dhjetor 2013 pika 1.1. si dhe përmirësimin e kushteve aktuale për izolimin e pacientëve me kriza akute; përgatitjen e politikave të shkruara brenda pavijoneve me shtretër për komunikimin me median dhe përcaktimin e rregulloreve përkatëse për qëndrimet zyrtare të institucionit (sidomos për rastet e kërcënimeve të familjarëve për kamerat e fshehta); marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e regjistrave të sekretuar nga ana e drejtorisë juridike pranë QSUT-së; nevojën urgjente për investime në ngritjen e një sistemi qendror elektronik për çdo pacient dhe diagnozat e tyre; marrjen e masave për krijimin e një pavijoni të posaçëm për persona abuzues me substanca narkotike, të cilët manifestojnë çrregullime të sjelljes apo/dhe psikotike.

6. Rekomandimet e dërguara në bazë të Inspektimeve të kryera gjatë vitit 2018 në Drejtoritë e Policisë së Vendore dhe në Komisaritet e varësisë e DPV- ve

6.1. KOMISARIATI I POLICISË LUSHNJË

Inspektimi u krye në datën 13.09.2019, sipas një Plani Inspektimi të miratuar më parë nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin Z. Alfred Koçobashi dhe Z. Genci Tërpo me detyrë Nd/Komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në Ligjin Nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, në “Rregullat dhe Procedurat Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhrin Nr.925, datë 18.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, dhe në “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.306, datë 31.03.2016, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme. Grupi inspektues, pasi mori informacionin e nevojshëm lidhur me qëllimin e inspektimit, vijoi kryerjen e inspektimit me punonjës të punonjësit të dhomave të shoqërimit. Grupi i punës në vijim inspektoi ambientet e shoqërimit, disa zyra të punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar. **Gjatë inspektimit u konstatua se nuk ishin zbatuar rekomandimet** e Institucionit të Avokatit të Popullit pas inspektimit të bërë në vitin 2018 në këtë komisariat dhe konkretisht: **Nuk ishte realizuar ndërtimi i ambienteve të reja të shoqërimit**, sipas kërkesave të ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, procedurës standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.306, datë 31.03.2016, për të pasur tre dhoma shoqërimi të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit, duke krijuar mjedise të përshtatshme dhe dinjitoze, të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrim dhe të monitoruara me kamera. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi për ndërtimin e ambienteve të reja të sigurisë** sipas kërkesave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe procedurës standarde: “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.1102, datë 07.11.2017. **Gjithashtu nuk ishte zbatuar rekomandimi** për marrjen e masave të nevojshme për krijimin e dhomave (zyrave) të punës në këtë komisariat ku merren në pyetje personat e shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera.

Ndërkohë nga verifikimet e bëra u konstatua se për personat e shoqëruar në komisariat zbatohet detyrimi ligjor për dhënien e kopjes së “Procesverbalit të shoqërimit”. Në përfundim të inspektimit grupi monitorues konstatoi se, në ambientet aktuale në Komisaratin e Policisë Lushnje, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika dhe konkretisht: Në Komisaratin e Policisë Lushnje nuk kishte dhoma shoqërimi të ndërtuara sipas parashikimeve të bëra në ligjin Nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe në procedurën standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.306, dt. 31.03.2016, me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit. Ambienti i shoqërimit që përdorej aktualisht ndodhej në një godinë më vete, brenda territorit të këtij organi. Ambienti kishte hyrje direkte pa korridor dhe nuk ishte i monitoruar me kamera. Ambienti i shoqërimit përbëhej nga 1 (një) dhomë me përmasa 8m x 7m dhe përdorej vetëm për shoqërimin e meshkujve madhorë, ndërsa për shoqërimin e femrave dhe për të miturit përdorej ambienti i pritjes së qytetarëve dhe zyrat e punonjësve të policisë. Ambienti që përdorej për shoqërimin e meshkujve madhorë, kishte një dritare të madhe e cila lejonte ajrimin dhe ndriçimin natyral, si dhe kishte ndriçim funksional nga

rrjeti elektrik. Gjithashtu realizohej edhe furnizimi me energji elektrike me anë të gjeneratorit në rast defektsh elektrik. Dritarja ishte pa hekura dhe ambienti nuk kishte derë. Dhoma që përdorej për shoqërim ishte e pastër, por ishte e pa lyster dhe ishte pajisur me orenditë e nevojshme, si tavolinë e stola të gjatë për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar. Pranë ambientit të shoqërimit që përdorej për meshkujt madhorë kishte dy tualete të cilët ishin të pastër dhe kishin ujë të rrjedhshëm. Në momentin e inspektimit nuk kishte shtetas të shoqëruar. Në ambientin e shoqërimit ishin vendosur postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar. U konstatua se në këtë komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të Ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse. Ndërkohë një kopje e këtij procesverbali ruhej në sekretarinë e institucionit. Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisaratin e Policisë Lushnje, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform me procedurën standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar. Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se: Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë⁴⁶. Në këtë komisariat mbahej regjistri për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë, nisur nga momenti, çasti, kur privoheshin nga liria. Ndërkohë u konstatua se në këtë komisariat kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë. Gjithashtu posterat e vendosur në institucion, pasqyronin edhe të drejtën e personave të ndaluar/arrestuar për të bërë ankese nëse kishin të tilla. Në Komisaratin e Policisë Lushnje nuk kishte ambiente të sigurisë pasi ato ishin mbyllur në përputhje me rekomandimin e bërë dy vite më parë nga institucioni i Avokatit të Popullit dhe personat e arrestuar/ndaluar dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Fier. Në godinën aktuale në Komisaratin e Policisë Lushnje oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e punës së tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta intervistimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore. Lidhur me këto shqetësime, Avokati i Popullit, nisur edhe nga inspektimet e mëparshme ka rekomanduar marrjen e masave për krijimin e zyrave të dedikuara ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të

⁴⁶ Kreu VII, Procedura standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit

monitorimit me kamera në këto zyra, por ende ky rekomandim nuk është zbatuar⁴⁷. Procesi i monitorimit filmik gjatë marrjes në pyetje të personave të shoqëruar është një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit. Gjithashtu, Komisariati i Policisë Lushnje në kushtet aktuale nuk posedon hapësirë të posaçme për komunikimin apo intervistim me persona të mitur, MKPT e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se bisedat me fëmijët dhe pyetja e tyre duhet të realizohen në një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i përshtatur në mënyrë të posaçme për zhvillimin e intervistimeve me fëmijët, pasi nga intervistimi i tyre në kushtet aktuale mund të shkaktohet pasoja të rënda deri në trauma tek të miturit që janë në konflikt me ligjin. Nga monitorimi që u bë në disa prej zyrave të punonjësve të policisë në godinën aktuale të Komisarariatit të Policisë Lushnje, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Në këtë komisarariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të Ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse. Gjatë inspektimit, u konstatua se detyrimi ligjor për të njoftuar personat e ndaluar/arrestuar madhor që në mungesë të mundësive financiare për të pajtuar një avokat privat, kërkon ndihmë juridike, atij i ofrohej një avokat kryesisht dhe iu ishte krijuar mundësia për të kontaktuar me të. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, e cila ishte e afishuar në zyrën e përgjegjës të zyrës së informacionit. Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut që ofrohej menjëherë nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier.

Në Komisarariat e Policisë Lushnje nuk kishte ndonjë zyrë të monitoruar me kamera për marrjen në pyetje të shtetasve të shoqëruar dhe ndaluar/arrestuar nga punonjësit e policisë. Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e godinës, si dhe në dhomën që përdorej për shoqërim të këtij komisaritati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar.

Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime: Marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin dhe vënien në funksionim të ambienteve të shoqërimit në Komisarariat e Policisë Lushnje sipas kriterëve të parashikuara në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe në procedurën standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit, duke krijuar mjedise të përshtatshme dhe dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim, tavolina, karrige dhe

⁴⁷ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkësë të bërë nga i ndaluarit gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

ambiente të pastra dhe të monitoruara me kamera. Marrjen e masave të menjëhershme për ndërtimin dhe vënien në funksionim të ambienteve të reja të sigurisë sipas kriterëve të parashikuara në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe në procedurën standarde: “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.1102, datë 07.11.2017. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e dhomave (zyrave) të punës në këtë komisariat ku merren në pyetje personat e ndaluar/arrestuar dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera. Marrjen e masave të nevojshme për lyerjen e dhomës së shoqërimit.

6.2. KOMISARIATI I DREJTORISË KUFITARE VLORË

MKPT- kreu Inspektim në datën 25.04.2019, sipas një Plani Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Sipas informacionit, Drejtoria Vendore e Policisë Kufitare dhe Emigracionit Vlorë kishte në varësinë e saj 8 Stacione të Policisë Kufitare, konkretisht në Hoxharë, Vlorë, Triport, Himarë, Borsh, Livadhja, Sarandë dhe Qafë Botë. Nga 8 stacione të policisë kufitare, 5 prej tyre janë Pika të Kalimit të Kufirit si në Portin e Vlorës, në Himarë, në Sarandë, në Livadhja dhe në Qafë Botë.

Gjatë kryerjes së inspektimit në pikën e kalimit të kufirit në Portin e Vlorës, rezultoi se aktualisht nuk kishte ambiente për shoqërimin, mbajtjen dhe trajtimin e personave në mjediset e policisë, por ato ishin në ndërtim e sipër. Drejtuesi i institucionit na informoi se, në momentin që punonjësit e policisë kufitare konstatojnë persona në konflikt me ligjin, në mungesë të ambienteve të shoqërimit, këta persona shoqërohen menjëherë në ambientet e Komisarariatit të Policisë Vlorë për kryerjen e veprimeve të mëtejshme. Ndërkohë, grupi i inspektimit u informua dhe vizitoi ambientet e reja të Stacionit të policisë kufitare në Portin e Vlorës, të cilat ishin krejtësisht të reja dhe ndodheshin brenda ambientit të Terminalit të ri të Udhëtarëve të sapo përfunduar. Mjedisi i shoqërimit dhe ambientet e punës të punonjësve të policisë ishin të ndërtuara sipas standardeve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore, për këtë qëllim. Për grupin e inspektimit të Mekanizmit Kombëtar, kjo ishte vizita e parë inspektuese që zhvillonte në Stacionin e policisë kufitare Vlorë dhe konstatoi se ishin të pranishme disa problematika. Siç e përmendëm edhe më lart, ambienti i shoqërimit në Stacionin e Policisë Kufitare në Portin e Vlorës ishte ndërtuar krejtësisht i ri, sipas parashikimeve në procedurat standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në polici*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 306 datë 31.03.2016. Ky mjedis ndodhej brenda Terminalit të Udhëtarëve, përbri me ambientin ku do të kryhen procedurat e kontrollit fizik dhe me skaner të udhëtarëve dhe bagazheve të tyre. Këto dy ambiente ndaheshin njëri nga tjetri me strukturë xhami. Mjedisi i shoqërimit përbëhej nga zyra e punonjësit të shërbimit të informacionit, tre dhoma shoqërimi të ndara më vete për personat e shoqëruar të rritur, femra dhe të miturit, si dhe një dhomë për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të shoqëruar. Dhomat e shoqërimit kishin sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrimin e këtyre personave. Dritaret e dhomave të shoqërimit ishin me përmasa të tilla që krijonin mundësinë për realizimin e ajrimit e ndriçimit të plotë natyral. Gjithashtu, ishte instaluar dhe sistemi i ndriçimit që furnizohej nga rrjeti elektrik. Dritaret ishin me xham, por në pjesën e jashtme ato kishin nevojë të siguroheshin dhe me skarë hekuri, me qëllim parandalimin e ndonjë mundësie largimi apo arratisje të

personave të shoqëruar në këto mjedise. Skara e hekurit duhet të vendoset në mënyrë të tillë që ajo të mos pengojë hyrjen e plotë të ajrit dhe ndriçimit natyral. Ky lloj kufizimi përcaktohet dhe në rregullat teknike të shoqërimit në polici, ku thuhet se: *“Dritaret e këtyre mjediseve të jenë të siguruara me qëllim parandalimin e largimit apo arratisjes së personave të shoqëruar nga këto mjedise”*⁴⁸. Në momentin e inspektimit, mjedisi i shoqërimit nuk ishte i pajisur me orenditë e nevojshme si tavolina, stola dhe karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar. Kjo për faktin se, kompletimi i këtyre ambienteve me orenditë e punës, do të kryhej njëkohësisht me kompletimin me këto materiale të Terminalit të Udhëtarëve. Projekti parashikonte pajisjen me orendi pune, por nga informacioni, për dhomën ku pyetet i shoqëruari nga specialistët e ndihmës specialistët e policisë, ato nuk ishin planifikuar të ishin të fiksuara në dysheme, sikurse përcaktohet në procedurat standarde mbi rregullat teknike të shoqërimit në polici. Gjithashtu, gjatë inspektimit rezultoi se, dyert e dhomave të shoqërimit ishin me strukturë alumini dhe xhami. Dyert ishin të pajisura me bravë të rregullt dhe me çelës. Rregullat teknike dhe standardet që kanë të bëjnë me shoqërimin, mbajtjen dhe trajtimin e personave në mjediset e policisë, parashikojnë marrjen e masave ndaj personave të shoqëruar që duhet t’u krijohen kushte të nevojshme të përshtatshme të ndryshme nga ato të dhomave të sigurisë. Por, mbi të gjitha ambienti dhe kushtet materiale në dhomat e shoqërimit, duhet të jenë të tilla garantojnë sigurinë dhe trajtimin njerëzor të këtyre personave. Në vlerësimin e grupit të inspektimit, struktura e dyerve të dhomave të shoqërimit sipas projektit me xham, paraqet shqetësim i cili duhet të merret në konsideratë nga strukturat e policisë, pasi për shkak të veprimeve të qëllimshme apo të pa qëllimshme që mund të kryhen nga persona të veçantë në ambientin e shoqërimit, copat e xhamit mund të shërbejnë si mjete që cenojnë sigurinë e personave të shoqëruar dhe personave të tjerë që mund të jenë në këto dhoma. Po ashtu, ato mund të shërbejnë dhe si mjete kundërveprimi ndaj punonjësve të policisë që kryejnë shërbimin në këto ambiente. Në këto rrethana, me qëllim parandalimin e situatave që cenojnë sigurinë dhe trajtimin e personave të shoqëruar, dyert e dhomave të shoqërimit sugjerojmë se duhet të zëvendësohen domosdoshmërisht me dyer me veshje druri. Pajisja e dhomave të shoqërimit me dyer me veshje druri, do të bënte të mundur gjithashtu që personat e shoqëruar që mbahen në këto ambiente, të mos jenë të reklamuar nga ana vizuale edhe nga pjesa tjetër e udhëtarëve që kryejnë veprimet në terminalin e udhëtarëve, i cili ndodhet ngjitur me mjedisin e shoqërimit. Lidhur me çështjen e sigurisë të këtyre personave, në procedurën standarde mbi rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e policisë, thuhet shprehimisht se: *“Në të gjitha mjediset (shoqërimit) të mos mbahen sende apo mjete të tilla që mund të shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve apo për kundërveprim ndaj punonjësit të policisë”*⁴⁹. Në vijim të inspektimit, grupi monitorues konstatoi se, në mjedisin e shoqërimit kishte tualete për personat e shoqëruar meshkuj dhe femra, por ato nuk ndodheshin brenda apo ngjitur këtij ambienti. Ato ishin ndërtuar sipas projektit të terminalit, jashtë këtij ambienti në zonën e ku lëvizin udhëtarët. Shoqërimi i personave nga punonjësit e policisë për nevojat personale të shoqëruarve, do të duhet të kryhet duke lëvizur nëpërmjet zonës të udhëtarëve, që mund të ndodhet ngjitur me ambientin e shoqërimit. Kjo do kërkonte nga ana e punonjësve të policisë që kryejnë shërbimin në këto ambiente,

⁴⁸ Kreu VI, pika g, “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 306 datë 31.03.2016.

⁴⁹ Kreu VI, pika f, “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 306 datë 31.03.2016.

që paraprakisht të vlerësojnë rrezikshmërinë që paraqet personi konkret, vendin/largësinë ku gjendet tualeti, kushtet e sigurisë që plotëson ky ambient dhe marrjen e masave të forta për shoqërimin e këtyre personave. Ndaj, ne mendojmë se, është e nevojshme krijimi i një ambienti për tualete brenda ose ngjitur me mjedisin e shoqërimit, me qëllim që ato të jetë lehtësisht i aksesueshëm për punonjësit e policisë dhe personat e shoqëruar. Mjedisi i shoqërimit dhe ambientet e tjera ishin të lyera dhe shumë të pastra nga ana higjieno-sanitare. Në ambientet e shoqërimit të Pikës së Kalimit të Kufirit në Vlorë, ishte instaluar një sistem i plotë monitorimi me kamera me qëllim mbajtjen në vëzhgim të terminalit të udhëtarëve, por edhe ambientit të shoqërimit. Avokati i Popullit e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor si një standard ndërkombëtarë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit ndaj tyre.⁵⁰ Në zyrën e punonjësit të informacionit, kishte libër për evidentimin e personave të shoqëruar me shënimet përkatëse. Libri ishte i sekretuar dhe ishte i plotësuar sipas rubrikave. Procedurat e evidentimit të veprimeve që janë kryer me personat e shoqëruar ishin kryer nga punonjësi i policisë që ka punuar dhe sqaruar çështjen, ndërsa hedhja e të dhënave në regjistër dhe në sistemin elektronik të të dhënave ishte kryer nga punonjësi i policisë të shërbimit të informacionit në pikën e kalimit të kufirit. Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte asnjë person të shoqëruar. Ambientet e qëndrimit të shtetasve të riadhesuar. Në Pikën e Kalimit të Kufirit Vlorë, riadhesohen në mënyrë periodike nga policitë e vendeve të tjera shtetas shqiptarë, por fluksi i tyre ishte shumë i vogël, në raport me njësitë e tjera të pikave të kalimit të kufirit. Gjatë vitit 2018 numri total i shtetasve shqiptarë të riadhesuar ishte 35 vetë. Akomodimi i këtyre personave deri në momentin e identifikimit dhe verifikimit të dokumentacionit, kryhej në ambientet e Drejtorisë të Kufirit dhe Emigracionit Vlorë, ambientet e të cilës ishin të pajisura me sistem monitorimi me kamera. Personat e riadhesuar regjistroheshin në librin përkatës dhe intervistoheshin të gjithë nga punonjësit e policisë të këtij komisarati. Ndërkohë ndaj tyre bëheshin edhe verifikime nëpërmjet organeve të policisë sipas vendbanimit përkatës. Sipas punonjësve të policisë, koha e qëndrimit në komisarati e këtyre personave shkonte nga 2 – 4 orë. Në momentin e inspektimit nuk konstatoam persona të riadhesuar në ambientet e këtij institucioni, ndaj grupi i inspektimit nuk mundi të zhvillojë intervista në lidhje me problematikat që ata i shqetësojnë. Por, lidhur me këtë çështje, Institucioni i Avokatit të Popullit sjell në vëmendje kërkesat e nenit 109/1/f të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, në cilin parashikohet e drejta e punonjësit të policisë që të shoqërojë personat në ambientet e Policisë, për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, si dhe në rastet e dëbimit ose ekstradimit. Në pikën 5 të po këtij neni, thuhet shprehimisht se: *“Punonjësi i policisë, dokumenton në proces-verbal veprimet e kryera me personin e shoqëruar. Procesverbali nënshkruhet në fund të çdo flete nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe personi i shoqëruar. Një kopje e procesverbalit i vihet në dispozicion personit të shoqëruar.”*

⁵⁰ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohen në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluar gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

Gjatë kohës së inspektimit në Drejtorinë e Kufirit dhe Emigracionit Vlorë u monitorua edhe sjellja e punonjësve të policisë në komunikimin me qytetarët e ndryshëm, kryesisht me qytetarët shtetas shqiptar dhe të huaj që hynin e dilnin në atë moment në Pikën e Kalimit të Kufirit Vlorë. Nga monitorimi dhe pyetja e disa prej qytetarëve që hynin dhe dilnin nga Porti Vlorë, u konstatua se punonjësit e policisë komunikonin në mënyrë korrekte dhe me etikë me ta duke i trajtuar me respekt e dinjitet. Ne gjykojmë se kjo mënyrë sjelljeje e punonjësve të policisë rrit imazhin dhe prestigjin e organit të Policisë së Shtetit Shqiptar në publik. Ndërkohë ajo rrit edhe besimin e qytetarëve vendas e të huaj ndaj këtij organi të administratës publike. Në përfundim të inspektimit, u konstatua se ambientet e punës aktuale të punonjësve të policisë në pikën e kalimit të kufirit Vlorë ishin të kufizuara dhe jo komode për të kryer me performancë detyrat ligjore, por ato ishin të përkohshme deri në kalimin në ambientet e reja që ishin krijuar në Terminalin e Udhëtarëve të Portit Vlorë.

Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime:

Marrjen e masave të nevojshme për sigurimin e dyerve të dhomave të shoqërimit me dyer druri, me qëllim sigurimin e jetës të personave të shoqëruar dhe personave të tjerë që punojnë në këto ambiente. Marrjen e masave të menjëhershme për vendosjen e skarave prej hekuri në pjesën e jashtme të dritareve në dhomat e shoqërimit, me qëllim parandalimin e largimit apo arratisjes së personave të shoqëruar nga këto mjedise. Marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin e tualeteve për femra dhe meshkuj, brenda ose ngjitur me mjedisin ku mbahen dhe trajtohen personat e shoqëruar. Marrjen e masave për garantimin e dhënies të dokumenteve dhe regjistrimin e të dhënave të shtetasve të riatdhesuar në pikën e kalimit të kufirit.

6.3. KOMISARIATI I POLICISË MAT

MKPT kreu inspektim në datën 06.11.2019, sipas planit të inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në vijim, grupi i punës inspektoi dhomat e shoqërimit dhe ato të sigurisë, zyrat e punës të punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar. Nga informacioni dhe verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit, nga inspektimi i vitit të kaluar rezultoi se:

Ishte plotësuar rekomandimi në lidhje me përmirësimin e kushteve të higjienës dhe pastërtisë në ambientin e sigurisë si meremetimi, lysterja me bojë dhe dizifektimi i dhomave të sigurisë. Gjithashtu, ishin përmirësuar kushtet e qëndrimit dhe të fjetjes në këto dhoma duke bërë zëvendësimin e materialeve të fjetjes të vjetërsuara me materiale në gjendje të mirë përdorimi.

Ndërkohë, grupi i inspektimit konstatoi se, nuk kishin gjetur zbatim rekomandimet e mëposhtme: Nuk ishte plotësuar rekomandimi për mbylljen e ambientit ekzistues të sigurisë në këtë komisariat, për shkak të mosplotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore, njëkohësisht dhe ndërtimi i dhomave të reja të sigurisë; Nuk ishte plotësuar rekomandimi për ndërtimin e dhomave të shoqërimit sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, të ndara më vete për personat e rritur meshkuj, femra dhe të mitur. Në përgjigje të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë inspektimit të kryer në vitin

2018, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit me shkresën nr.3340/1 prot., datë 22.05.2019 drejtuar Institucionit tonë, thekson se, i pranon si të drejta këto rekomandime, por janë të pazbatueshme për arsye objektive, pasi: *“Nuk disponojmë ambiente të tjera me kushte të përshtatshme për mbajtjen dhe trajtimin e personave të ndaluar/arrestuar, të Komisarariatit të Policisë Mat. Nuk disponohen fondet e nevojshme financiare për ndërtimin dhe funksionimin e ambienteve me kushte të përshtatshme për mbajtjen dhe trajtimin e personave të arrestuar/ndaluar dhe ato për të shoqëruarit”*. Sipas informacionit të drejtuesve të policisë, kërkesat për kryerjen e investimeve në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë kanë qenë të përvitshme, kryesisht gjatë fazës të planifikimit të buxhetit, por ende dhe sot, fondet për këto investime nuk janë siguruara. Në përfundim të inspektimit, grupi monitorues konstatoi se, në ambientet aktuale të shoqërimit dhe të sigurisë në Komisarariatit të Policisë Mat, të ishin të pranishme disa problematika, si më poshtë vijon: Në Komisarariatit të Policisë Mat, ambienti i shoqërimit në tërësi nuk ishte i ndërtuar sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014, *“Për Policinë e Shtetit”* dhe Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.306, datë 31.03.2016, për miratimin e procedurës standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në polici”*, ku theksohet se, *“mjediset/ambientet të jenë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim....si dhe të ndara më vete për personat e rritur, femra dhe të mitur”*.⁵¹ Ambienti i shoqërimit ndodhej në katin e parë të godinës të komisarariatit dhe përbëhej nga 2(dy) dhoma, të ndara me vete për personat e rritur dhe për femra. Për personat e shoqëruar të mitur, sipas informacionit, mbaheshin në zyrat e punonjësve të policisë në prani të kujdestarit ligjor, avokatit mbrojtës dhe psikologut. Dhomat e shoqërimit ishin në tërësi me hapësirë dhe sipërfaqe të bollshme. Dritaret e dhomave ishin me përmasa të tilla që lejonin hyrjen e ajrit dhe dritës natyrale. Ato ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjiëno-sanitare. Por, ato nuk ishin të pajisura me orenditë e nevojshme si tavolina dhe karrige/stola për të mundësuar qëndrimin ulur të personave të shoqëruar⁵². Në këtë ambient, ngjitur me dhomat e shoqërimit ndodhej një tualet, i cili ishte i përbashkët dhe jo i ndarë më vete për meshkuj dhe femra⁵³. Dyert e dhomave të shoqërimit mbylleshin me çelës, me bravë të rregullt. Në mjedisin e shoqërimit, nuk u gjetën sende apo mjete të tilla që mund të shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve apo për kundërveprim ndaj punonjësit të policisë. Për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të shoqëruar të rritur, femra dhe të mitur, përdorehin zyrat e oficerëve të policisë gjyqësore, të cilat ndodheshin në katin e dytë të godinës. Në mjediset e komisarariatit nuk ishte instaluar sistemi i monitorimit me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe ambientit të shoqërimit. Në dhomat e shoqërimit nuk kishte sistem ngrohje apo paisje të tjera elektrike, për sigurimin e ngrohjes të ambientit kryesisht në periudhën e dimrit. Në Komisarariatit të Policisë Mat ambienti i sigurisë nuk ishte i ndërtuar sipas kërkesave të ligjit nr. 108/2014 *“Për Policinë e Shtetit”* dhe Urdhërën e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde *“Trajtimi dhe Sigurimi i Personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*. Ambienti i sigurisë ndodhej në një godinë më vete, ngjitur me godinën kryesore të këtij komisarariatit. Ky ambient kishte në total 12 dhoma sigurie, nga të cilat ishin në përdorim vetëm 4(katër)

⁵¹ Kreu VI, pika 3/b,c e procedurës standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në polici”*.

⁵² Kreu VI, pika 3/d e procedurës standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në polici”*.

⁵³ Kreu VI, pika 3/e e procedurës standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në polici”*.

prej tyre, të ndara në 2(dy) dhoma për akomodimin e personave të rritur meshkuj, 1(një) për femra dhe 1(një) për të mitur. Ndërsa dhomat e tjera ishin të mbyllura dhe të vulosura, për shkak se ishin nxjerrë jashtë funksionit. Kapaciteti i dhomave të sigurisë ishte për akomodimin e 6(gjashtë) personave të arrestuar/ndaluar, por kjo në varësi dhe të situatave. Dhomat e sigurisë nuk plotësonin normat dhe parametrat teknikë jetësorë, për një person të ndaluar/arrestuar, pasi sipërfaqja e përgjithshme ishte më pak se 10 metra katrorë dhe e ndarë në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m² dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m².⁵⁴ Dritaret e dhomave ishin të vogla dhe nuk mundësonin futjen e sasisë së mjaftueshme të ajrit dhe dritës natyrale. Dhomat kishin dritë elektrike, që furnizoheshin nga rrjeti elektrik. Por, komisariati kishte dhe gjenerator si burim rezervë energjie, për të vënë në përdorim pajisjet elektrike dhe ndriçuar ambientin. Në dhomat e sigurisë nuk kishte kravatë dhe personat e ndaluar/arrestuar flinin në dyshekë që vendoseshin mbi dyshe-menë prej dërrase. Materialet e fjetjes si dyshekë, batanije dhe jastëk, ishin zëvendësuar me materiale që ishin në gjendje të mirë përdorimi. Ambienti i sigurisë vazhdonte të kishte shumë lagështirë dhe ishte i amortizuar në tërësi. Qëndrimi i shtetasve të arrestuar/ndaluar në këto kushte përbën trajtim degradues, ndaj Institucioni i Avokatit të Popullit rekomandon në mbylljen sa më parë të këtyre ambienteve dhe krijimin e nja ambienti sigurie sipas standardeve të përcaktuara në kriteret për ndërtimin e tyre. Të ndaluarit/arrestuarit kishin akses për larje dhe pastrim vetjak në tualetet, që ndodheshin në korridorin e ambientit të sigurisë, ndërsa për larjen e trupit kishte ambient të posaçëm (dushe me ujë të ngrohtë). Në ambientin e sigurisë nuk kishte sistem ngrohjeje me kaldajë për dimër apo pasije të tjera për ngrohje, sikurse parashikohet në procedurën standarde⁵⁵. Mungesa e këtyre elementëve për ngrohje, ndikon në jetën dhe shëndetin e personave të arrestuar/ndaluar për kohën e qëndrimit në këto ambiente. Në korridorin e ambientit të sigurisë nuk kishte aparat telefonik fiks dhe citofon për t'u përdoruar nga punonjësit e shërbimit në rastet e tentativave apo ngjarjeve të rënda me të ndaluarit/arrestuarit, për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje të shpejtë. Sikurse, brenda në dhomat e sigurisë mungonte butoni me zile, për njoftimin e punonjësve të shërbimit nga ana e personave të arrestuar/ndaluar në rast nevojë. Brenda në ambientin e sigurisë kishte një dhomë për kryerjen e vizitave mjekësore, e cila ishte e pajisur me krevat, tavolinë dhe karrige. Kjo dhomë nuk përmbushte standardet, pasi ishte e pandriçuar mirë, e ftohtë dhe e papërshtatshme për kryerjen e vizitave mjekësore. Gjithashtu kishte edhe një dhomë për takimin e të ndaluarve/arrestuarve me avokatët dhe pyetjen e tyre nga oficerët e policisë gjyqësore. Kjo dhomë ishte e pajisur me tavolinë pune dhe karrige për qëndrimin ulur të personave. Hyrja kryesore e ambientit të sigurisë, korridori i tij dhe hyrjet në dhomat e sigurisë nuk monitoroheshin me sistemin e kamerave për 24 orë. Në momentin e inspektimit, nuk kishte asnjë person të arrestuar/ndaluar në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Mat. Nga informacioni i shefit të komisarariatit rezultoi se, ende dhe këtë vit nuk është bërë i mundur sigurimi i fondeve financiare nga buxheti i shtetit, për realizimin e një projekti me qëllim ndërtimin e ambienteve të reja të dhomave të sigurisë, sipas të gjitha parametrave dhe kërkesave të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore. Në Komisariatin e Policisë Mat “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr.1”

⁵⁴ Kreu VIII, pika 3.3 e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.

⁵⁵ Kreu VIII, pika 3.2/c e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”

konform procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë kryheshin sipas dispozitave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” duke i regjistruar në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, të gjitha rubrikat e tij ishin plotësuar me korrektesë dhe përgjegjësi nga punonjësit e zyrës së informacionit. Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Ndërsa të ndaluarit/arrestuarit që trajtoheshin e siguroheshin në ambientet e sigurisë në këtë Komisarariat evidentoheshin në regjistrin e personave të ndaluar/arrestuar, i cili ishte i sekretuar. Ky regjistër ishte i plotësuar me korrektësi në të gjitha rubrikat e tij. Në zyrën e përgjegjësit të dhomave të sigurisë, grupi i inspektimit u njoh dhe administroi kopje të regjistrave të tjerë që evidentonin gjithë aktivitetin 24 orësh, që zhvillohej me personat e arrestuar/ndaluar, të cilët ishin plotësuar sipas rubrikave dhe ishin të sekretuar. Në kohën e inspektimit në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë në Komisariatin e Policisë Mat, nuk kishte asnjë person të shoqëruar apo të ndaluar/arrestuar. Grupi i inspektimit u informua nga punonjësit e policisë se personat e arrestuar/ndaluar, trajtohen në mënyrë korrekte gjatë kohës së marrjes në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore dhe qëndrimit në ambientin e sigurisë. Shtetasit e intervistuar vihen në dijeni për identitetin e punonjësit të policisë me të cilin marrin kontakt dhe kryejnë veprimet procedurale. Ata shpjeguan se, gjatë shoqërimit dhe arrestimit, punonjësit e policisë identifikohen përpara tyre duke u prezantuar me gjeneralitetet dhe detyrën që kryenin. Nga informacioni i dhënë nga punonjësit e policisë që shërbenin në dhomat e sigurisë rezultoi se, të ndaluarit/arrestuarit trajtoheshin me ushqim tre herë në ditë sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në urdhrin e përbashkët nr. 432, datë 10.03.2008 të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë. Ushqimi gatuhet në kuzhinën e IEVP Burrel dhe shërbehet nga punonjësit e shërbimit të policisë. Të ndaluarve/arrestuarve iu jepeshin produkte për ruajtjen e higjienës vetjake dhe të ambientit si sapun, detergjente, letra higjienike dhe letra për fshirjen e duarve dhe të fytyrës. Në ambientet e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Mat kishte një dhomë për marrjen në pyetje të shtetasve të ndaluar/arrestuar nga përfaqësuesit e akuzës dhe për takim me avokatët, e cila nuk ishte e monitoruar me sistemin e kamerave. Gjithashtu, marrja në pyetje/intervistimi i shtetasve të ndaluar/arrestuar para se të ndaloheshin apo arrestoheshin dhe të futeshin në ambientet e sigurisë, kryhet nga oficerët e policisë gjyqësore në zyrat e tyre të punës. Këto zyra nuk ishin të monitoruara me sistemin audio-viziv të kamerave. Grupi i inspektimit, konstatoi gjithashtu se, në këtë komisarariat nuk kishte asnjë ambient të veçantë hetimi edhe për të miturit, i cili të ishte i monitoruar me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore. Avokati i Popullit e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit ndaj tyre⁵⁶. Nga monitorimi që u bë zyrave të oficerëve të policisë

⁵⁶ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të

gjqësore, nuk u gjetën sende prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Në këtë Komisariat ishte krijuar një dhomë më vete për administrimin dhe ruajtjen e provave materiale. Gjatë inspektimit u konstatua se në korridorin e ambienteve të sigurisë dhe të shoqërimit në Komisaratin e Policisë Mat, ishin të afishuara disa postera me të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar, si dhe atyre të shoqëruar. Ndërsa për shtetasit e ndaluar/arrestuar të huaj ishin përgatitur formularët me të drejtat e të ndaluarve/arrestuarve në 9-të gjuhë të huaja, si anglisht, frëngjisht, italisht, greqisht, gjermanisht, maqedonisht, serbisht, sllovenisht dhe rome. Sipas punonjësve të policisë, të ndaluarit/arrestuarit dhe të shoqëruarit njiheshin me të drejtën për të pasur një avokat mbrojtës gjatë marrjes në pyetje, dhe ata që e kishin kërkuar u ishte krijuar mundësia reale për të kontaktuar me të. Gjithashtu nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se, në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat të caktuar kryesisht.

Ndërsa në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të kujdestarit ligjor, avokatit mbrojtës dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve e dërguar nga organi i prokurorisë. Përgjegjësi i dhomave të sigurisë kishte listën e avokatëve dhe numrat e telefonave të tyre. Ndërsa psikologu sigurohej nga bashkia dhe shkolla e mesme e qytetit të Burrelit. Të ndaluarve dhe arrestuarve iu jepeshin nga oficerët e policisë gjyqësore kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit, të kontrollit personal dhe të letrës me të drejtat e tyre.

Grupi i ekspertëve konstatoi se vizitat mjekësore të personave të arrestuar/ndaluar bëheshin nga ana e mjekut të IEVP Burrel, brenda afatit 12 orësh nga momenti i vendosjes së këtyre personave në këtë ambient, sikurse përcaktohet në procedurën standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.⁵⁷ Mjeku apo ndihmësmjeku pasqyronte konstatimet, rekomandimet dhe mjekimet e dhëna gjatë vizitave mjekësore për të ndaluarit/arrestuarit, në regjistrin e vizitave mjekësore. Po ashtu, ai hapte kartelat mjekësore (kartelat ditore) të tyre dhe i vendoste në fashikullin përkatës për çdo të ndaluar/arrestuar. Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisariat zbatoheshin detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse. Gjithashtu në këtë Komisariat kishte edhe regjistër për evidentimin e ankesave dhe kërkesave të personave të ndaluar/arrestuar dhe të shoqëruar. Nga verifikimi tij rezultoi se nuk ishte regjistruar asnjë ankesë apo kërkesë nga personat e ndaluar/arrestuar dhe të shoqëruar.

Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime: Marrjen e masave të menjëhershme për mbylljen e ambienteve ekzistuese të sigurisë në Komisaratin e Policisë Mat, si dhe ndërtimin e ambienteve të reja sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe procedurës standarde “*Trajtimi dhe Sigurimi i*

regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluarit gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

⁵⁷ *Kreu II, pika 7 e procedurës standarde*

Personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre". Marrjen e masave të menjëhershme për rikonstruksionin e ambientit ekzistues të sigurisë, kryesisht në plotësimin e dhomave të sigurisë me krevat për fjetje, eliminimin e lagështirës dhe zgjerimin e dritareve për hyrjen e ajrit dhe ndriçimit të plotë natyral. Marrjen e masave të menjëhershme për ndërtimin e ambientit të shoqërimit në Komisarlatin e Policisë Mat, sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar dhe procedurës standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në polici", të ndara më vete për personat e rritur, femra dhe të mitur, duke krijuar mjedise të përshtatshme dhe dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim dhe të monitoruara me kamera. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e dhomës (zyrës) të intervistimit/ marrjes në pyetje të personave të ndaluar/arrestuar të rritur dhe të mitur në këtë komisarlat, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera. Marrjen e masave të nevojshme për instalimin e sistemit të kamerave në këtë Komisarlat, për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe hyrjet e dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë. Marrjen e masave të nevojshme për instalimin e sistemit të ngrohjes në ambientin e sigurisë dhe atë të shoqërimit, për shkak të kushteve të rënduara atmosferike të kësaj zone.

6.4. KOMISARIATI I POLICISË DEVOLL

MKPT kreu inspektim në datën 25.09.2019, sipas një Plani Inspektimi të miratuar më parë nga Avokati i Popullit. Nga informacioni i grumbulluar në vend gjatë kryerjes së inspektimit, rezultoi se gjendja faktike lidhur me ambientin e shoqërimit ishte si një vit më parë. Në përfundim të inspektimit grupi monitorues konstatoi se, megjithëse në Komisarlatin e Policisë Devoll ishin marrë disa masa për përmirësimin e standardeve lidhur me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe të personave të arrestuar/ndaluar, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika dhe më konkretisht: Por nga ana tjetër u konstatua se institucioni i Komisarlatit të Policisë Devoll nuk ishte njësi shpenzuese direkt më vete dhe detyrohej që veprimet financiare ti kryente vetëm përmes Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë. Në këto kushte nga ana e Komisarlatit të Policisë Devoll ishin bërë përpjekjet e nevojshme duke ju drejtuar organeve eprore me kërkesa për të mundësuar realizimin e investimeve në këtë institucion në kuadrin e përmirësimit të mëtejshëm të ambienteve të shoqërimit për të garantuar respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar por sërish nuk kishte asnjë ndryshim në kuadrin e çeljes së fondeve të dedikuara për këtë institucion. Grupi i inspektimit u njoh gjithashtu edhe me veprimtarinë administrative edhe kërkesat e këtij institucioni drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë, lidhur me krijimin e kushteve sipas standardeve për vënien në funksion të ambienteve të shoqërimit në Komisarlatin e Policisë Kolonjë, sipas kërkesave të Ligjit Nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit", dhe Aktit të procedurave standarde: "Rregullat teknike të shoqërimit në polici", miratuar me Urdhrin Nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit, duke krijuar mjedise të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim dhe të monitoruara me kamera. Në përfundim të inspektimit grupi monitorues konstatoi se, megjithëse në Komisarlatin e Policisë Devoll ishin marrë disa masa në kuadrin e mirëmbajtjes së ambienteve për përmirësimin e standardeve lidhur me të drejtat

ligjore të personave të shoqëruar dhe të personave të arrestuar/ndaluar, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika dhe më konkretisht: Në Komisariatin e Policisë Devoll nuk kishte ambiente shoqërimi të ndërtuara sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe në procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 306, dt. 31.03.2016, me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit.⁵⁸ Ndonëse Avokati i Popullit në shkresën K-4/175-2 të dt.13.12.2017 u ka rekomanduar autoriteteve përkatëse ndërtimin e ambienteve të shoqërimit konfirmo akteve normative në fuqi, me qëllim për të krijuar kushtet për trajtim dinjitar të të shoqëruarve, ato nuk ishin ndërtuar ende. Në këtë komisarjat nuk kishte asnjë dhomë shoqërimi për qëndrimin e shtetasve të shoqëruar. Në rastet kur nga punonjësit e policisë shoqëroheshin persona të ndryshëm, ata mbaheshin në zyrat e punës deri sa mbaronin procedurat e verifikimit dhe të pyetjes së tyre. Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar. Në Komisariatin e Policisë Devoll nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisarjatisë të Policisë Korçë.

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar si dhe trajtimi i të shoqëruarve, ndaluarve/arrestuarve gjatë veprimeve që kryen policia. Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisarjatin e Policisë Devoll, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform me procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar. Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjister nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se: Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 4 orë. Rubrikat e regjistrimit ishin plotësuar me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë. Konkretisht, në rubrikën “Adresa e vendbanimit” të personave të shoqëruar ishte pasqyruar rruga, lagjja apo numri i banesës. Në rubrikën “Të dhëna për njoftimin e familjarëve/afërmeve”, ishin pasqyruar gjeneralitetet e të njoftuarit, numri i telefonit dhe ora e njoftimit të tyre.⁵⁹ Në këtë komisarjat ishte i pranishëm regjistri për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë. Gjithashtu u konstatua se ishte vendosur regjistri për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar. Në Komisarjatin e Policisë Devoll, oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet proceduralë me shtetasit në zyrat e punës së tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta intervistimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve proceduralë nga oficerët e policisë gjyqësore. Lidhur me këto fakte Avokati i Popullit nisur edhe nga inspektimi i mëparëshëm ka rekomanduar marrjen e masave për krijimin e zyrave të dedikuara ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve

⁵⁸ Kreu VI, pika 3 e procedurave standarde.

⁵⁹ Kreu VII, pika a.1.4.k e Procedurave standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.

proceduralë nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra por është konstatuar se sërish ky i fundit nuk është plotësuar⁶⁰. Procesi i monitorimit filmik gjatë marrjes në pyetje të personave të shoqëruar është një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit. Nga monitorimi që u bë të gjitha zyrave të punonjësve të policisë, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime proceduriale. Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat sipas një liste që disponohej në institucion. Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet proceduriale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë. Ndërsa psikologu sigurohej në bashkëpunim me shkollën e mesme të qytetit dhe Bashkinë Devoll. Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e godinës, si dhe në dhomat e shoqërimit të këtij komisariati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar. U konstatua se në këtë komisariat zbatohej detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit të çështjes përkatëse. U evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme ku në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë në Komisaratin e Policisë Devoll, mbaheshin procesverbalet përkatëse ku një kopje e të cilit firmosej dhe i jepej personit të shoqëruar. **Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime:** Marrjen e masave të nevojshme dhe gjetjen e fondeve përkatëse për të mundësuar rikonstruksionin e përgjithshëm të godinës dhe realizimin e investimeve në Komisaratin e Policisë Devoll për të garantuar kushte të përshtatshme pune për punonjësit e policisë së këtij institucioni ashtu edhe për të krijuar ambiente cilësore për ofrimin e shërbimeve për qytetarët e interesuar. Marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin dhe vënien në funksion të ambienteve të shoqërimit në Komisaratin e Policisë Devoll sipas kërkesave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, dhe procedurave standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit, duke krijuar mjedise të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrim dhe të monitoruara me kamera. Marrjen e masave të nevojshme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në korridorin dhe ambientet e

⁶⁰ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluarit gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.”

CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

Komisariatit e Policisë Devoll. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve proceduriale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave të posaçme për intervistim me persona të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.

6.5. KOMISARIATI I POLICISË BERAT

MKPT- kreu inspektim në datën 03.07.2019, sipas një Plani Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Grupi inspektues, pasi mori informacionin e nevojshëm lidhur me qëllimin e inspektimit, vijoi takimin me përgjegjësën e dhomave të sigurisë dhe punonjësën e informacionit të dhomave të shoqërimit, për inspektimin e kushteve të këtyre ambienteve në Komisariatit e Policisë Berat. Në vijim, grupi i punës inspektoi dhomat e shoqërimit, dhomat e sigurisë, vizitoi disa zyra të punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm rezultoi se: Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për krijimin e ambientit të shoqërimit në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore, për tu garantuar kushte dinjitoze personave të shoqëruar, duke krijuar dhoma të ndara më vete për të rriturit, femrat dhe të miturit. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për krijimin e ambientit të sigurisë brenda godinës apo ambientit të Komisariatit të Policisë Berat, në përputhje me standardet e parashikuara në legjislacionin në fuqi. Dhomat e sigurisë vazhdonin të ishin të ndarë në dy ambiente të ndryshme. Ambienti i sigurisë me 2 (dy) dhoma për shtetasit e arrestuar/ndaluar të rritur dhe të mitur, ndodhej brenda në godinën e IEVP Berat, ndërsa ambienti tjetër me 1 (një) dhomë sigurie për femrat, ndodhej në godinën e Spitalit Rajonal Berat. Nisur nga informacioni por edhe nga verifikimi i dokumentacionit për personat e shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar rezultoi gjithashtu se: Ishte zbatuar rekomandimi, për plotësimin e regjistrave për evidentimin e personave të shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar, sipas të gjitha rubrikave në mënyrë korrekte. Ishte plotësuar rekomandimi, për zbatimin me rigorozitet të Urdhrit nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Policisë së Shtetit “Procedura standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, për pajisjen e personave të shoqëruar me procesverbalin e veprimeve të kryera nga punonjësi i policisë me personin e shoqëruar. Përsa i takon mungesës të investimeve të kryera dhe atyre të pritshme në Komisariatit e Policisë Berat, për ndërtimin dhe krijimin e ambienteve të përshtatshme të shoqërimit dhe të ndalim/arrestimit brenda ambienteve të komisariatit, sipas kërkesave të përcaktuara në procedurat standarde të rregullave të shoqërimit dhe për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar, nga informacioni i drejtuesve të këtij komisariatit, rezultoi se, interesimi dhe kërkesat kanë qenë të vazhdueshme, por ende nuk ishin siguruar fondet e nevojshme nga Drejtoria e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për ndërtimin e tyre. Në përfundim të inspektimit grupi monitorues konstatoi se, në ambientet aktuale në Komisariatit e Policisë Berat, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika dhe konkretisht: Në Komisariatit e Policisë Berat, ambienti i shoqërimit ndodhej jashtë godinës të komisariatit, në një ndërtesë më vete. Ky mjedis përbëhej nga zyra e shërbimit të punonjësit të informacionit dhe nga 2

(dy) dhoma shoqërimi, një dhomë për të rritur dhe një dhomë për shoqërimin e femrave dhe të miturit. Dhomat e shoqërimit ishin të përmasave rreth 2x3m dhe 3x3m, të pajisura me nga një tavolinë dhe tre-katër karrige secila, me dritare pa skarë apo rrjetë hekuri, të cilat lejonin ajrimin dhe ndriçimin e nevojshëm natyral. Po ashtu, dhomat e shoqërimit kishin të siguruar ndriçimin nga rrjeti elektrik. Në mjedisin e shoqërimit ishin afishuar posterat me të drejtat e personave të shoqëruar. Dyert ishin me bravë të rregullt dhe mbylleshin me çelës. Tualetet nuk gjendeshin pranë dhomave të shoqërimit, por brenda në godinën e komisariatit. Në muret e brëndshme të dhomave të shoqërimit ishte e dukshme lagështira, por ato ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjieno-sanitare. Ndërkohë, gjatë inspektimit rezultoi se, mjedisi nuk kishte sistem monitorimi me kamera për vëzhgimin e korridorit në dhomat e shoqërimit. Sistemi i kamerave monitoronte vetëm ambientet e jashtme të komisariatit. Në momentin e inspektimit nuk kishte asnjë shtetas të shoqëruar në këto ambiente. Nga këqyrja e dokumentacionit, u konstatua se në këtë komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse. Kjo u evidentuan gjatë verifikimit të disa praktikave të njëpasnjëshme ku në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë në Komisariatin e Policisë Berat mbaheshin procesverbalet përkatëse, një kopje e të cilit pasi firmosej i jepej personit të shoqëruar. Në Komisariatin e Policisë Berat, ambienti i sigurisë nuk ishte në përputhje me procedurat standarde miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1102, datë 07.11.2017 “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”. Bazuar në marrëveshjeje midis institucioneve të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim mbajtjen dhe trajtimin e përkohshëm të arrestuarve/ndaluarve, në kushtet e mungesës të ambienteve në disa komisariate vendore të policisë, nga Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, janë vënë në dispozicion dhoma që shërbejnë si ambient sigurie për këto komisariate.

Një praktikë e tillë zbatohet edhe në Komisariatin e Policisë Berat, mbi bazën e të cilës, I EVP Berat ka vënë në dispozicion të këtij komisariati 2 (dy) dhoma që ndodhen në godinën e regjimit të brendshëm të këtij institucioni. Këto dhoma, shërbejnë si ambient sigurie për Drejtorinë/komisariatet vendore të policisë të Qarkut Berat, me qëllim mbajtjen, trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar dhe ndaluarve me vendim të formës së prerë. Kapaciteti i këtyre dhomave ishte për akomodimin e 10 personave. Dhomat e sigurisë ishin të ndara më vete, 1 (një) dhomë për shtetasit e arrestuar/ndaluar të rritur me kapacitet për 8 (tetë) persona dhe 1 (një) dhomë për të miturit me kapacitet për 2 (dy) persona. Dhoma e sigurisë e cila përdorej për personat e ndaluar/arrestuar të rritur, ishte e pajisur me 8 (tetë) shtretër të vendosur në krevatë marinari. Materialet e tjera për jetesë ndodheshin në magazinën e I EVP-së, pasi në momentin e inspektimit nuk kishte asnjë person të ndaluar/arrestuar. Hapësira dhe sipërfaqe e dhomës të sigurisë për personat e rritur ishte e vogël dhe nuk ishte e përshtatshme për qëndrim dhe jetesë normale për 8 (tetë) persona, pasi nuk plotësohej kubatura e nevojshme sipas normave të lejuara për jetesë normale. Dritarja e dhomës kishte përmasa e lejuara teknike për ajrimin dhe ndriçimin e plotë natyral. Ndërkohë, dhoma ishte e siguruar me

ndriçim me llapmë, që furnizohej nga sistemi elektrik i këtij institucioni. Mungesa e hapsirës dhe sipërfaqes të dhomës së sigurisë, është një problematikë e cila kërkon zgjidhje të menjëhershme. Dhomat e sigurisë duhet të plotësojnë normat dhe parametrat teknikë jetësorë, për një person të arrestuar apo ndaluar, ku sipërfaqja e përgjithshme duhet të jetë jo më pak se 10 metra katrorë, e ndarë në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m² dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m².⁶¹ Ndërkohë, dhoma e sigurisë që përdorej për mbajtjen dhe qëndrimin e personave të mitur, kishte një kapacitet për 2 (dy) persona. Ajo ishte me sipërfaqe dhe hapsirë të bollshme, si dhe kishte dritare për lejimin e ajrimit dhe dritës natyrale. Kushtet higjieno-sanitare ishin të mira. Në dhomë nuk kishte asnjë person të mitur në pritje të caktimit apo vlerësimit të masës së arrestit nga gjykata. Tualeti dhe plotësimi i nevojave të tjera jetike të këtyre personave, si dhe larja e trupit, kryheshin në ambientet e përbashkëta të dusheve të sektorit në katin e 2-të të godinës së IEVP-së Berat. Orari i veprimeve ishte i miratuar nga drejtuesit e dy institucioneve, komisariatit të policisë Berat dhe IEVP-së Berat. Ambienti i sigurisë ruhej nga personeli i shërbimit të Komisarariatit të Policisë Berat dhe vëzhgohej nga sistemi i kamerave të IEVP-së Berat. Dhomat e sigurisë kishin nevojë për lyerje, pasi muret e tyre ishin të gërvishtura dhe nuk ishin të pastra. Kushtet e tjera higjieno-sanitare në dhoma ishin të pastra. Në rastin e arrestimit/ndalimit të femrave në konflikt me ligjin, sipas informacionit të drejtuesve të komisarariatit, ato akomodoheshin në një “dhomë sigurie” që ndodhej në ambientin e godinës të Spitalit Rajonal Berat. Qëllimi i krijimit të kësaj dhome ishte në bazë të një marrëveshje midis dy institucioneve, Komisarariatit të Policisë Berat dhe Spitalit Rajonal Berat, për shtrimin e personave të arrestuar/ndaluar në rastet e urgjencave dhe që paraqisnin probleme shëndetësore. Kjo dhomë ishte e pajisur me të gjitha orëditë e nevojshme për jetesë si krevatë, karrige, tavolinë dhe komodinë për mbajtjen e sendeve personale. Dritarja e dhomës lejonte ajrimin dhe hyrjen e dritës natyrale. Në pjesën e jashtme ajo ishte e siguruar me skarë hekuri. Tualeti ndodhej brenda dhomës dhe kishte ujë të rrjedhshëm. Kjo dhomë ruhej nga forcat e Komisarariatit të Policisë Berat. Në vlerësimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, ambienti i sigurisë në Komisariatin e Policisë Berat i organizuar në këtë mënyrë, është në shkelje të kërkesave dhe parashikimeve të përcaktuara në ligj dhe aktet ndërkombëtare. Ky mjedis duhet të ndërtohet detyrimisht brenda godinës apo ambientit të Komisarariatit të Policisë Berat, me kushte e standarde që mundësojnë garantimin e lirive dhe të drejtave ligjore të ndaluarve/arrestuarve. Një praktikë e tillë, bie ndesh dhe me pikat e Marrëveshjes të Bashkëpunimit të vitit 2019 midis institucioneve të Drejtorisë të Përgjithshme të Burgjeve dhe Drejtorisë të Përgjithshme të Policisë të Shtetit⁶², sipas të cilës parashikohet që, IEVP-të nuk do të administrojnë/akomodojnë persona të ndaluar për të cilët nuk ka një masë arresti nga gjykata. Në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale dhe në zbatim të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, punonjësit e policisë së shtetit bëjnë arrestimin/ndalimin e personit, duke i trajtuar këta persona në ambientet e posaçme të sigurisë të ngritura pranë komisariateve për këtë qëllim. Ndërkohë, që subjekt i ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, të ndryshuar

⁶¹“Rregullat dhe Procedurat Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Nr.1102, datë 07.11.2017, “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.

⁶² Marrëveshje Bashkëpunimi nr.23194 prot., datë 05.03.2019 për DPB dhe nr.897/3 prot., datë 04.03.2019 për DPPSH.

dhe i organeve të Ministrisë së Drejtësisë janë të paraburgosurit dhe të dënuarit me burgim me vendim të formës së prerë të gjykatave shqiptare dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare edhe të gjykatave të huaja, duke respektuar kërkesat procedurale përkatëse, sikurse dhe të gjithë të paraburgosurit dhe të dënuarit me vendim të formës së prerë, shtetas shqiptarë, të huaj dhe personat pa shtetësi. Personat e ndaluar/arrestuar nga punonjësit e policisë në raport me personat e paraburgosur apo të dënuar me vendim të formës së prerë, kanë të drejta të ndryshme të parashikuara shprehimisht në legjislacionin e përmendur më sipër. Në ditën e inspektimit, grupi i punës nuk mundi të kontaktonte apo të intervistonte persona të arrestuar/ndaluar, pasi nuk kishte asnjë person në këto ambiente. Shërbimi roje për të ndaluarit/arrestuarit kryhej me punonjës të policisë të këtij komisariati. Të ndaluarit/arrestuarit nuk dilnin në ajrim. Ata trajtoheshin me ushqim nga ushqimi që gatuhej në guzhinën e I EVP Berat, tre herë në ditë. Ndërsa, në rastin e personave të arrestuar/ndaluar femra që ndodheshin në “dhomën e sigurisë” pranë spitalit rajonal, ushqimi sigurohej me catering nga Komisarati i Policisë Berat. Personat e arrestuar/ndaluar furnizoheshin rregullisht me sapunë dhe detergjente, sipas normave të parashikuara në procedurat standarde. Në zbatim të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe në procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.306, dt. 31.03.2016, çdo njësi policore që ka dhoma shoqërimi dhe sigurie, duhet të jetë e pajisur ndër të tjera edhe me regjistrat përkatës. Regjistrat ishin të mbajtur në rregull dhe të plotësuar sipas rubrikave. Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisaratin e Policisë Berat, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform me procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar. Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se: Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrat ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë⁶³. Në këtë komisarati ishte vendosur regjistri për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë. Ndërkohë u konstatua se në këtë komisarati kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë. Në godinën e Komisarati të Policisë Berat specialistët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit e shoqëruar në zyrat e punës së tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta intervistimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga specialistët e policisë gjyqësore. Ndërkohë në ambientin e sigurisë që ndodhej në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Berat, kishte një dhomë për marrjen në

⁶³ Kreu VII, *Procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit*

pyetje të shtetasve të ndaluar/arrestuar nga përfaqësuesit e akuzës dhe për takim me avokatët, e cila monitorohej me kamera. Lidhur me këto fakte Avokati i Popullit nisur edhe nga inspektimet e mëparshme ka rekomanduar marrjen e masave për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera të zyrave të dedikuara ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore, por konstatohet se sërish ky rekomandim nuk është plotësuar⁶⁴. Procesi i monitorimit filmik gjatë marrjes në pyetje të personave të shoqëruar dhe të ndaluar është një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit. Gjithashtu, Komisariati i Policisë Berat në kushtet aktuale nuk disponon dhomë (zyrë) të posaçme për marrjen në pyetje apo intervistave me persona të mitur. MKPT e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se intervistat me fëmijët duhet të realizohen në një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e tyre, pasi nga intervistimi i tyre në kushtet aktuale mund të shkaktohet traumatizim plotësues i fëmijëve. Nga monitorimi që u krye në zyrat e punonjësve të policisë në godinën aktuale të Komisarariatit të Policisë Berat, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Gjatë inspektimit, u konstatua se detyrimi ligjor për të njoftuar personat e ndaluar/arrestuar madhor që në mungesë të mundësive financiare për të pajtuar një avokat privat, kërkon ndihmë juridike, atij i ofrohej një avokat kryesisht dhe iu ishte krijuar mundësia për të kontaktuar me të. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, e cila ishte e afishuar në zyrën e përgjegjësit të ambientit të sigurisë. Në ambientin e shoqërimit dhe atë të sigurisë kishte postera me të drejtat e personave të shoqëruar dhe të ndaluarve/arrestuarve, në gjuhë shqipe dhe disa gjuhë të huaja si anglisht, italisht, greqisht, gjermanisht, etj. Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet proceduralë kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut që ishte në organikë të Drejtorisë Vendore të Policisë Berat. Grupi i ekspertëve konstatoi se vizitat mjekësore nga ana e personelit mjekësor kryheshin brenda afatit 12 orësh nga momenti i vendosjes së këtyre personave në këtë ambient, sikurse përcaktohet në “Rregullat dhe Procedurat Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Nr.1102, datë 07.11.2017, “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”. Mjeku ishte i pranishëm sipas nevojave dhe thirrej të kryente procedurat përkatëse në kohë. Vizitat mjekësore ndaj të ndaluarve/arrestuarve, konstatimet, rekomandimet dhe mjekimet e dhëna pasqyroheshin në regjistrin e vizitave mjekësore. Ndërkohë hapeshin edhe kartelat mjekësore (kartelat ditore) të tyre, të cilat vendoseshin në fashikullin përkatës për çdo të ndaluar/arrestuar. Gjatë inspektimit u konstatua se

⁶⁴ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluar gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.”

CPT' reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

në korridoret e godinës të këtij komisariati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar. Nga informacionet e grumbulluara gjatë vizitës nuk rezultoi asnjë rast i përdorimit të mjeteve të forcës dhe shtrëngimit fizik, si dhe asnjë rast i përdorimit të armëve të zjarrit nga ana e policisë ndaj shtetasve të shoqëruar/ndaluar/ arrestuar, me qëllim përmbushjen e një synimi të ligjshëm sipas dispozitave ligjore në fuqi. **Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime:** Marrjen e masave të menjëhershme për krijimin e ambienteve të reja të sigurisë brenda ambientit të Komisarariatit të Policisë Berat, në përputhje me standardet e parashikuara në legjislacionin në fuqi dhe mbylljen e menjëhershme të dhomave aktuale të sigurisë. Marrjen e masave të menjëhershme për krijimin e ambienteve të përshtatshme të shoqërimit, duke siguruar kushte dinjitoze dhe të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrimin e shtetasve të ndara më vete, për personat e rritur, për femra dhe për të miturit. Marrjen e masave për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi, në ambientet e këtyre mjediseve dhe kryesisht në dhomat e intervistimit/marrjes në pyetje të shtetasve, kryesisht të të miturve, pasi sistemi i monitorimit audio-viziv përbën një ndër aspektet më të rëndësishme sa i përket parandalimit të veprave të dhunshme ndaj shtetasve dhe anasjelltas, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime: Marrjen e masave të menjëhershme për krijimin e ambienteve të reja të sigurisë brenda ambientit të Komisarariatit të Policisë Berat, në përputhje me standardet e parashikuara në legjislacionin në fuqi dhe mbylljen e menjëhershme të dhomave aktuale të sigurisë. Marrjen e masave të menjëhershme për krijimin e ambienteve të përshtatshme të shoqërimit, duke siguruar kushte dinjitoze dhe të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrimin e shtetasve të ndara më vete, për personat e rritur, për femra dhe për të miturit. Marrjen e masave për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi, në ambientet e këtyre mjediseve dhe kryesisht në dhomat e intervistimit/marrjes në pyetje të shtetasve, kryesisht të të miturve, pasi sistemi i monitorimit audio-viziv përbën një ndër aspektet më të rëndësishme sa i përket parandalimit të veprave të dhunshme ndaj shtetasve dhe anasjelltas, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

6.6. KOMISARIATI I POLICISË ELBASAN

MKPT- kreu inspektim në datën 12.03.2019, sipas një Plani Inspektimi të miratuar më parë nga Avokati i Popullit. Grupi i punës në vijim inspektoi ambientet e shoqërimit, disa zyra të punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar. Gjatë inspektimit u konstatua se nuk ishte plotësuar rekomandimi i bërë nga institucioni i Avokatit të Popullit në vitin 2017, për marrjen e masave të menjëhershme për nxjerrjen jashtë funksioni dhe ndërtimin e një ambienti ndalim/arrestimit në Komisariatin e Policisë Elbasan sipas kërkesave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, dhe Manualit “Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011. Ishte plotësuar pjesërisht rekomandimi për marrjen e masave për ndërtimin e

dhomave të shoqërimit për femra si dhe ndërtimin e një tualeti në funksion të personave të shoqëruar në Komisaratin e Policisë Elbasan, por ato sërisht nuk ishin sipas kriterëve të parashikuara në Kreun VI, pika 3 të procedurave standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në polici*”, miratuar me Urdhrin nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Nuk ishte plotësuar rekomandimi për marrjen e masave të nevojshme për krijimin e dhomave (zyrave) të punës në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan ku merren në pyetje personat e ndaluar/arrestuar para se të dërgohen në ambientet e sigurisë dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera. Ishte plotësuar rekomandimi për marrjen e masave të nevojshme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në Komisaratin e Policisë Elbasan dhe kryesisht mbajtjen nën vëzhgim të ambienteve të shoqërimit dhe ambientet e ndalim/arrestimit. Ishte plotësuar rekomandimi për marrjen e masave të nevojshme me qëllim plotësimin me përgjegjësi e saktësi të të gjitha rubrikave të “*Regjistrin të evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar*” në Komisaratin e Policisë Elbasan. Në përfundim të inspektimit grupi monitorues konstatoi se, në ambientet aktuale në Komisaratin e Policisë Elbasan, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika dhe konkretisht: Në Komisaratin e Policisë Elbasan, ambienti i shoqërimit ishte në katin e parë të godinës me dalje direkte në pjesën e pasme në oborrin e institucionit dhe përbëhej nga 2(dy) dhoma shoqërimi, 1(një) për meshkujt madhorë dhe 1(një) për femrat ndërkohë që nuk kishte dhomë për shoqërimin e të miturve. Për shoqërimin e të miturve përdorej ambienti i pritjes në hyrje të këtij komisarati në mungesë të një dhome të përshtatëshme. Konkretisht në Komisaratin e Policisë Elbasan ishte krijuar edhe një ambient për shoqërimin e femrave si dhe ishte krijuar edhe një tualet që përdorej por sërisht ato nuk ishte në përputhje me “*Rregullat dhe Procedurat Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Nr.1102, datë 07.11.2017, “*Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”, dhe në “*Rregullat teknike të shoqërimit në polici*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.306, datë 31.03.2016. Pra të dy dhomat e shoqërimit megjithëse funksiononin nuk ishin ndërtuar sipas kriterëve të parashikuara në procedurat standarde: “*Rregullat teknike të shoqërimit në polici*”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit⁶⁵. Dy dhomat e shoqërimit që përdorreshin ishin me sipërfaqe dhe hapësirë të mjaftueshme për qëndrim. Ato kishin dritare me skarë dhe rrjetë hekuri për sigurimin e ajrimit dhe të ndriçimit të plotë natyral, ishin të lyera rishtazi dhe të pastra, dhe ishin të pajisura me orenditë e nevojshme, tavolina dhe karrige për të qëndruar ulur të shoqëruarit sipas pikës 3 të Kreut IV të “*Rregullave teknike të shoqërimit në polici*”, të cituar më sipër. Njëra prej dhomave të shoqërimit (*dhoma që përdorej për shoqërimin e femrave*) kishte tualet pranë saj dhe ishte e pastër dhe me ujë të rrjedhshëm. Ndërkohë të shoqëruarit meshkuj mund të përdornin një tualet që ishte jashtë ambientit të shoqërimit i cili ishte i pastër dhe me ujë të rrjedhshëm. Dhomat nuk kishin korridor dhe hyrje-dalja nga këto ambiente ishte direkt në pjesën e pasme në oborrin e institucionit që monitorohej me kamera. Në momentin e inspektimit nuk kishte shtetas të shoqëruar. Në ambientin e

⁶⁵ “*Rregullat teknike të shoqërimit në polici*”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

shoqërimin ishin vendosur postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar. U konstatua se në këtë komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse. U evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme ku në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë në Komisarlatin e Policisë Elbasan mbaheshin procesverbalet përkatëse ku një kopje e të cilit firmosej dhe i jepej personit të shoqëruar, regjistrat ishin të mbajtur në rregull. Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisarlatin e Policisë, Elbasan, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform me procedurat standarde: “*Rregullat teknike të shoqërimin në polici*”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar. Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se: Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrin ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë⁶⁶. Në këtë komisariat ishte vendosur regjistri për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimin të tyre në organin e policisë. Ndërkohë u konstatua se në këtë komisariat kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë. Gjithashtu në Komisarlatin e Policisë Elbasan kishte edhe regjistër për takimet me avokatin ose prokurorin, regjistër të vizitave mjekësore, regjistër të shoqërimin të personave në ndaluar në gjykatë apo në institucione të tjera, regjistër të marrjes në pyetje dhe informacion në gjuhën shqipe dhe në disa gjuhë të huaja për të drejtat e personave të ndaluar ose të arrestuar. Në Komisarlatin e Policisë Elbasan në ambientin e sigurisë kishte aktualisht 7 (shtatë) dhoma me nga 2 (dy) krevate për secilën prej tyre. Ato ishin të ndara në 5 (pesë) dhoma për meshkuj madhorë, 1 (një) dhomë për femra dhe 1 (një) dhomë për të mitur. Dhomat nuk ishin të ndërtuara sipas kërkesave të parashikuara në “*Rregullat dhe Procedurat Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Nr.1102, datë 07.11.2017, “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”. Dhomat e sigurisë ishin me përmasa 3m X 2m, të cilat ndodheshin në një godinë të veçuar dhe ishin tejet të amortizuara dhe nuk plotësonin normat dhe parametrat teknike jetësorë, pasi sipërfaqja e përgjithshme ishte më pak se 10 metra katrorë, dhe nuk ishin të ndara në ambient qëndrimi (*dhomë*) dhe paradhomë.⁶⁷ Dritaret aktuale të dhomave në

⁶⁶ Kreu VII, Procedurat standarde: “*Rregullat teknike të shoqërimin në polici*”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit

⁶⁷ “*Rregullat dhe Procedurat Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Nr.1102, datë 07.11.2017, “Për trajtimin

përdorim në kushtet aktuale mundësonin futjen e sasisë së mjaftueshme të ajrit por jo të dritës natyrale sepse nuk plotësonin standardet. Këto ambiente ishin të pajisura me orenditë e nevojshme për jetesë, si krevat, dyshek, batanije dhe jastëk, por ato ishin të vjetra dhe të amortizuara. Të ndaluarit/arrestuarit kishin akses dhe mund të shkonin në tualet për larje e pastrim të vazhdueshëm ndërsa për larjen e trupit kishte një ambient të posaçëm (*dushi me ujë të ngrohtë*), i cili gjithashtu ndodhej në korridor. Në ambientet e sigurisë nuk kishte sistem ngrohjeje me kaldajë për dimër, sikurse parashikohet në “*Rregullat dhe Procedurat Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Nr.1102, datë 07.11.2017, “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.

Dhomat e ndalimit nuk kishin zile të emergjencës, që të mundësonte komunikimin me shërbimin e policisë në një moment nevojë të ngutshme. Në korridorin e ambientit të sigurisë kishte aparat telefonik fiks për t’u përdoruar nga punonjësit e shërbimit në rastet e tentativave apo ngjarjeve të rënda me të ndaluarit/arrestuarit, për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje të shpejtë. Dhomat kishin edhe burim rezervë energjie me gjenerator. Brenda ambienteve të sigurisë kishte dhomë për kryerjen e vizitave nga ndihmës mjeku. Hyrja kryesore ambientit të sigurisë, korridori i tij dhe hyrjet në dhomat e sigurisë monitoroheshin me kamera 24 orë. Nga informacioni i dhënë nga punonjësit e policisë që shërbenin në dhomat e sigurisë dhe personat e arrestuar rezultoi se të ndaluarit/arrestuarit trajtoheshin me ushqim 3 (tre) herë në ditë sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në Vendimin Nr. 189, datë 15.03.2017 “Për trajtimin me ushqim të punonjësve, të studentëve dhe të kursantëve në institucionet arsimore të Policisë së Shtetit, si dhe të shtetasve të ndaluar dhe arrestuar deri në sqarimin e pozitës së tyre”. Ushqimi përgatitej nga një subjekt privat në bazë të kontratës së lidhur me të. Ndonëse në ambientet e sigurisë nuk kishte ambiente kulti, të ndaluarve/arrestuarve që dëshironin u lejohej ushtrimi i riteve fetare brenda dhomave të sigurisë. Nga informacioni i dhënë nga punonjësit e policisë dhe personat e arrestuar rezultoi se të ndaluarve/arrestuarve u jepeshin produkte për ruajtjen e higjienës vetjake dhe të ambientit, si sapun, detergjente, letra higjienike dhe letra për fshirjen e duarve dhe të fytyrës. Në Komisarriatin e Policisë Elbasan kishte një dhomë për takimin e të ndaluarve/arrestuarve me avokatët dhe pyetjen e tyre nga oficerët e policisë gjyqësore. Kjo dhomë ishte e pajisur me tavolinë dhe karrige.

Në ambientin e sigurisë kishte 6 (*gjashhtë*) persona të arrestuar gjatë kohës së inspektimit ku 5 (*pesë*) prej të cilëve ndodheshin në këto ambiente ndërsa 1(*një*) prej tyre ishte shoqëruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan për vlerësim të masës së sigurisë. Grupi i monitorimit intervistoi personat e arrestuar, të cilët konfirmuan se ishin trajtuar në mënyrë korrekte gjatë kohës së qëndrimit të tyre në ambientet e sigurisë dhe marrjes në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore. Të intervistuarit nuk patën pretendime për trajtim denigrues, jo human apo për ushtrim dhune fizike e psikologjike. Gjendja psikologjike e të intervistuarve ishte e qetë dhe nuk dëshmonte për pasoja të shkaktuara nga

dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.

keqtrajtimi. Shtetasit e intervistuar kishin dijeni për identitetin e punonjësve të policisë me të cilët kishin marrë kontakte dhe kishin kryer veprimet proceduriale. Ata shpjeguan se, gjatë ndalimit/arrestimit edhe punonjësit e tjerë të policisë që kishin kontaktuar me ta, ishin identifikuar përpara tyre duke u prezantuar me gjeneralitetet dhe detyrën që kryenin. Personave të ndaluar/arrestuar ju ishin dhënë nga oficerët e policisë gjyqësore kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit, të kontrollit personal dhe të letrës me të drejtat e tyre. Ata kishte kontaktuar edhe me avokat dhe ishte në pritje të procedurave gjyqësore lidhur me caktimin e masës së sigurisë dhe vlerësimit të arrestit. Gjithashtu të ndaluarit konfirmuan se ishin trajtuar me urrejtje dhe nuk kishin asnjë pretendim lidhur me këtë çështje. Nga informacionet e grumbulluara gjatë vizitës nuk rezultoi asnjë rast i përdorimit të mjeteve të forcës dhe shtrëngimit fizik, si dhe asnjë rast i përdorimit të armëve të zjarrit nga ana e policisë ndaj shtetasve të ndaluar/ arrestuar me qëllim përmbushjen e një synimi të ligjshëm sipas dispozitave ligjore në fuqi. Në mesin aktual në Komisaratin e Policisë Elbasan oficerët e policisë gjyqësore për shkak të veprimtarisë së ngjeshur të punës dhe mungesës së kushteve të kryenit veprimet proceduriale me shtetasit përgjithësisht në zyrat e punës së tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara me kamera dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte një ambient të veçantë intervistimi. Lidhur me këtë fakt Avokati i Popullit nisur edhe nga inspektimet e mëparshme ka rekomanduar marrjen e masave për ndërtimin e zyrave të dedikuara ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve proceduriale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera pranë tyre, por është konstatuar se sërish ky i fundit nuk është plotësuar⁶⁸. Procesi i monitorimit filmik gjatë marrjes në pyetje të personave të shoqëruar dhe të ndaluar është një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit. Gjithashtu, Komisarati i Policisë Elbasan në kushtet aktuale nuk posedon hapësirë të posaçme për biseda apo intervistim me persona të mitur. MKPT e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se bisedat me fëmijët duhet të realizohen në një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët, pasi nga intervistimi i tyre në kushtet aktuale mund të shkaktohet traumatizim plotësues i fëmijëve. Nga monitorimi që u bë në disa prej zyrave të punonjësve të policisë në mesin aktual të Komisarimit të Policisë Elbasan, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime proceduriale. Në këtë komisarati zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse. Edhe në nenet 34/b. pika 2 dhe 251 të K.Pr.Penale parashikohet se të

⁶⁸ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkësë të bërë nga i ndaluarit gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.”

CPT' reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

ndaluarit/arrestuarit duhet t'i jepet dhe të mbajë me vete një kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit. Rezultoi se ndaj personave të shoqëruar nga punonjësi i policisë mbahej një procesverbal tip i emërtuar “*Formulari i raportit të Shoqërimit ose Ndalimit/Arrestimit*”. Gjatë inspektimit, u konstatua se detyrimi ligjor për të njoftuar personat e ndaluar/arrestuar madhor që në mungesë të mundësive financiare për të pajtuar një avokat privat, kërkon ndihmë juridike, atij i ofrohej një avokat kryesisht dhe iu ishte krijuar mundësia për të kontaktuar me të. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, e cila ishte e afishuar në zyrën e përgjegjës të ambientit të sigurisë. Ndërsa për shtetasit e ndaluar/arrestuar të huaj ishin përgatitur postera me të drejtat e të ndaluarve/arrestuarve në disa gjuhë të huaja dhe këto material gjendeshin edhe në gjuhën shqipe. Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut i cili sigurohej në kohë nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan dhe qëndronte i pranishëm derisa përfundonte procedura përkatëse. Grupi i ekspertëve konstatoi se vizitat mjekësore nga ana e ndihmës mjekut kryheshin brenda afatit 12 orësh nga momenti i vendosjes së këtyre personave në këtë ambient, sikurse përcaktohet në “*Rregullat dhe Procedurat Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Nr.1102, datë 07.11.2017, “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”. Ndihmës mjeku ishte i pranishëm dhe punonte me kohë të pjesshme në institucion por sipas nevojave mund të thirrej edhe jashtë orarit me qëllim që të kryente procedurat përkatëse në kohë. Ndërkohë në këtë institucion ekzistonte pozicioni vakant i mjekut i cili ishte i paplotësuar. Vizitat mjekësore ndaj të ndaluarve/arrestuarve, konstatimet, rekomandimet dhe mjekimet e dhëna pasqyroheshin në regjistrin e vizitave mjekësore. Gjithashtu hapeshin edhe kartelat mjekësore (kartelat ditore) të tyre, të cilat vendoseshin në fashikullin përkatës për çdo të ndaluar/arrestuar. Gjatë inspektimit u konstatua se edhe në korridoret e godinës të këtij komisariati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar.

Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime: Marrjen e masave për nxjerrjen jashtë funksioni dhe ndërtimin e ambienteve të ndalim/arrestimit në Komisaratin e Policisë Elbasan sipas kërkesave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, “*Rregullat dhe Procedurat Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Nr.1102, datë 07.11.2017, “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, pasi qëndrimi i shtetasve në ambientet ekzistuese nuk plotëson kushtet për të garantuar një trajtim dinjitoz. Marrjen e masave për ndërtimin e dhomave të shoqërimit në Komisaratin e Policisë Elbasan, sipas kriterëve të parashikuara në Kreun VI, pika 3 të procedurave standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në polici*”, miratuar me Urdhrin nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit duke përfshirë në të dhe ndërtimin e një dhome shoqërimi për të miturit. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave në Komisaratin e Policisë Elbasan ku merren në pyetje personat e ndaluar/arrestuar para se të dërgohen në ambientet e sigurisë dhe

instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto ambiente. Marrjen e masave për plotësimin e personelit të Komisarariatit të Policisë Elbasan për pozicionin e mjekut me kohë të plotë.

6.7. KOMISARIATI I POLICISË FIER

MKP-kreu në datën 12.09.2019, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit.

Grupi i inspektimit pasi mori informacionin e nevojshëm, vijoi me inspektimin e ambientit të shoqërimit dhe atij të sigurisë, për evidentimin e kushteve në të cilën janë ndërtuar dhomat e shoqërimit dhe dhomat e sigurisë, plotësimi i kriterëve për ndërtimin e dhomave dhe rregullat që zbatohen nga personeli i shërbimit policor për respektimin dhe garantimin e të drejtave kushtetuese dhe ligjore të personave të privuar nga liria. Gjithashtu, grupi i inspektimit vizitoi edhe zyrat e specialistëve e ndihmës specialistëve të policisë që kryejnë veprime procedurale me personat e shoqëruar dhe personat e ndaluar/arrestuar, si dhe kontrolloi e administroi dokumentacionin përkatës ku pasqyrohen veprimet e kryera me këta persona. Gjatë ushtrimit të detyrës për inspektimin e ambienteve ku mbahen dhe trajtohen personat e privuar nga liria, grupi inspektues ishte i shoqëruar nga shefi i rendit të Komisarariatit të Policisë Fier dhe punonjësit e policisë që kryejnë shërbimin në këto ambiente. Nga informacioni dhe verifikimi i rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit të dërguara në përfundim të inspektimit të kryer në vitin 2018, grupi i inspektimit konstatoi se, nuk ishte zbatuar asnjë pre rekomandimeve. Konkretisht: **Nuk ishte plotësuar rekomandimi** për krijimin e zyrave ku merren në pyetje personat e ndaluar/arrestuar para se të dërgohen në ambientet e sigurisë dhe instalimi i sistemit të monitorimit me kamera. **Nuk ishte plotësuar rekomandimi** për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në dhomën që ndodhet brenda në ambientet e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Fier, e cila shërben për marrjen në pyetje të të ndaluarve/arrestuarve nga oficerët e policisë gjyqësore dhe prokurorët. Në përfundim të inspektimit grupi inspektues konstatoi se, në mjedisin e shoqërimit dhe atë të sigurisë në Komisariatin e Policisë Fier, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika, të cilat po i parashtrijmë si më poshtë vijon: Ambienti i shoqërimit ndodhej në godinë më vete, brenda territorit të komisarariatit dhe përbëhej nga tre dhoma shoqërimi të ndërtuara për persona të rritur, femra dhe për të miturit. Dhomat e shoqërimit ishin me sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme për qëndrim. Ato kishin dritare për sigurimin e ajrimit dhe kishin ndriçim të plotë natyral. Dhomat ishin të lyera rishtas dhe të pastra nga ana higjienike. Dritaret e dhomave ishin me përmasa të tilla që të krijonin mundësi për realizimin e ajrimit e ndriçimit të plotë natyral. Dhomat e shoqërimit kishin ndriçim nga rrjeti elektrik dhe ishin të pajisura me karrige për qëndrimin ulur të të shoqëruarëve. Në korridorin e këtij ambienti, pranë dhomave të shoqërimit kishte tualete të cilët ishin të pastra dhe kishin ujë të rrjedhshëm. Korridori i këtij ambienti ishte i monitoruar me kamera. Në ambientin e shoqërimit ishin vendosur postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar. Gjithashtu në posterat përkatës ishte pasqyruar edhe e drejta ligjore e personave të shoqëruar për të paraqitur ankesa. Në momentin e inspektimit nuk kishte asnjë shtetas në dhomat e shoqërimit. Nga inspektimi i ambientit të shoqërimit u konstatua se, mungonte dhoma më vete për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të shoqëruar, e cila duhet të jetë e pajisur me tavolina, karrige dhe stola për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, si dhe me orenditë e nevojshme si karrige dhe tavolina pune për specialistët e ndihmës specialistët e

policisë⁶⁹. Por, sipas informacionit të shefit të rendit, të shoqëruarit merren në pyetje në zyrat e punës të punonjësve të policisë. Gjithashtu, gjatë kontrollit të dokumentacionit në zyrën e informacionit të Komisarariatit të Policisë Fier, grupi i inspektimit konstatoi se, nuk zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse. Grupi i inspektimit kontrolloi disa praktika me fashikuj ku ndodheshin formularët e raportit të shërbimit dhe kopje të procesverbaleve me veprimet e kryera me personat e shoqëruar nga punonjësit e policisë, të cilat ishin në zyrën e informacionit. Ato ishin të plotësuar në rregull sipas rubrikave, por nga punonjësit e policisë që kryejnë shërbim në ambientin e shoqërimit u informuam se, procesverbali pasi firmosej nuk i jepej një kopje personit të shoqëruar, por ata mjaftoheshin vetëm me firmën që i shoqëruari nënshkruante në regjistrin e evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar, në rubrikën “Pretendime dhe nënshkrimi i personit të shoqëruar”. Nga verifikimi i Regjistrit të marrjes dhe dorëzimit të personit të shoqëruar dhe kopje të procesverbalit të veprimeve të kryera nga punonjësi i policisë me personin e shoqëruar, në rubrikën me shënimet në lidhje me ankesat/kërkesat e të shoqëruarve rezultoi se, për vitin 2019 nuk kishte asnjë ankesë të regjistruar. Dhomat e sigurisë në Komisarariatit të Policisë Fier ishin të ndërtuara sipas kërkesave të parashikuara në Procedurën standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019.

Ambienti i sigurisë kishte 6 (gjashtë) dhoma sigurie, të ndara më vete 4 (katër) dhoma për personat e rritur, 1 (një) dhomë për femra dhe 1 (një) dhomë për të miturit. Kapaciteti i dhomave të sigurisë ishte për 8 (tetë) persona, të pajisura me shtretër dhe krevat. Dhomat e sigurisë plotësonin normat dhe parametrat teknike jetësorë, për një person të arrestuar apo ndaluar, pasi sipërfaqja e përgjithshme ishte jo më pak se 10 metra katrorë, e ndarë në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m² dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m².⁷⁰ Dritaret e dhomave mundësonin futjen e sasisë së mjaftueshme të ajrit dhe dritës natyrale. Këto ambiente ishin të pajisura me tualete brenda, si dhe orenditë e nevojshme për jetesë, si krevat, dyshek, batanije dhe jastëk, të cilët ishin në gjendje të mirë dhe të pastra. Të ndaluarit/arrestuarit kishin akses për larje e pastrim të vazhdueshëm në paradhomë, ndërsa për larjen e trupit kishte një ambient të posaçëm (dushi me ujë të ngrohtë), i cili ndodhej në korridor. Gjithashtu në ambientet e sigurisë kishte sistem ngrohjeje me kaldajë për dimër, sikurse parashikohet edhe në procedurat standarde për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar. Në çdo dhomë

⁶⁹ Kreu VI, Pika 3/d procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, datw 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

⁷⁰ Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe Sigurimi i Personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.

kishte zile të emergjencës, e cila mundësonte komunikimin me shërbimin e policisë në një moment nevojë apo emergjence. Në korridorin e ambientit të sigurisë kishte aparat telefonik fiks dhe citofon për t'u përdoruar nga punonjësit e shërbimit në rastet e tentativave apo ngjarjeve të rënda me të ndaluarit/arrestuarit, për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje të shpejtë. Ambienti i sigurisë kishte burim rezervë energjie me gjenerator më vete. Brenda ambienteve të sigurisë kishte edhe një dhomë për kryerjen e vizitave mjekësore nga mjeku, e cila ishte e pajisur me krevat, tavolinë dhe karrige. Gjithashtu kishte edhe një dhomë për takimin e të ndaluarve/arrestuarve me avokatët dhe pyetjen e tyre nga oficerët e policisë gjyqësore, e cila nuk ishte e monitoruar me sistemin e kamerave. Kjo dhomë ishte e pajisur me tavolinë dhe karrige të fiksuara në dysheme. Hyrja kryesore ambientit të sigurisë, korridori i tij dhe hyrjet në dhomat e sigurisë monitoroheshin me kamera për 24 orë. Nga informacioni i dhënë nga punonjësit e policisë që shërbenin në dhomat e sigurisë dhe personat e arrestuar rezultoi se, të ndaluarit/arrestuarit trajtoheshin me ushqim 3 (tre) herë në ditë sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në vendimin nr. 189, datë 15.03.2017 “Për trajtimin me ushqim të punonjësve, të studentëve dhe të kursantëve në institucionet arsimore të Policisë së Shtetit, si dhe të shtetasve të ndaluar dhe arrestuar deri në sqarimin e pozitës së tyre”. Ushqimi përgatitej nga një subjekt privat në bazë të kontratës së lidhur me të dhe ofrohej me shërbim catering. Ndonëse në ambientet e sigurisë nuk kishte ambiente kulti, të ndaluarve/arrestuarve që dëshironin u lejohej ushtrimi i riteve fetare brenda dhomave të sigurisë. Nga informacioni i dhënë nga punonjësit e policisë dhe personat e arrestuar rezultoi se të ndaluarve/arrestuarve u jepeshin produkte për ruajtjen e higjienës vetjake dhe të ambientit, si sapun, detergjente, letra higjienike dhe letra për fshirjen e duarve dhe të fytyrës. Në momentin e inspektimit, në dhomat e sigurisë gjendeshin 10 persona të arrestuar, nga të cilët 3 prej tyre flinin me dyshekë të shtruar në dysheme. Grupi i inspektimit intervistoi personat e arrestuar, të cilët konfirmuan se ishin trajtuar në mënyrë korrekte gjatë kohës së marrjes në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore dhe qëndrimit në ambientin e sigurisë. Por, evidente ishte mbipopullimi në dhomat e sigurisë, pasi të gjithë personat e arrestuar ishin në moshë madhore dhe personeli i shërbimit i kishte akomoduar në 4 dhomat e destinuar për këtë kategori. Nga të intervistuarit nuk pati pretendime të tjera për trajtim denigrues, jo human apo për ushtrim dhune fizike e psikologjike. Gjendja psikologjike e të intervistuarve ishte e qetë dhe nuk dëshmonte për pasoja të shkaktuara nga keqtrajtimi. Shtetasit e intervistuar kishin dijeni për identitetin e punonjësit të policisë me të cilin kishin marrë kontakt dhe kishin kryer veprimet proceduriale. Ata shpjeguan se, gjatë ndalimit/arrestimit punonjësit e policisë ishin identifikuar përpara tyre duke u prezantuar me gjeneralitetet dhe detyrën që kryenin. Personave të ndaluar/arrestuarve iu ishin dhënë nga oficerët e policisë gjyqësore kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit, të kontrollit personal dhe kartën me të drejtat e tyre. Nga informacionet e grumbulluara gjatë inspektimit, nuk rezultoi asnjë rast i përdorimit të mjeteve të forcës dhe shtrëngimit fizik, si dhe asnjë rast i përdorimit të armëve të zjarrit nga ana e policisë ndaj shtetasve të ndaluar/arrestuar me qëllim përmbushjen e një synimi të ligjshëm sipas dispozitave ligjore në fuqi. Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisariatit të Policisë, Fier, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform me procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar. Të gjithë personat e shoqëruar në organin e

policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se: Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrimit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë⁷¹. Edhe regjistri për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, ishte i sekretuar dhe mbahej në zyrën e punonjësit përgjegjës të dhomave të ndalimit brenda këtyre ambjenteve. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit në proces-verbalin e arrestimit apo ndalimit, përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë. Ndërkohë u konstatua se në këtë komisariat kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por për vitin 2019 nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë. Gjithashtu posterat e vendosur në institucion, pasqyronin edhe të drejtën e personave të ndaluar/arrestuar për të bërë ankesa apo kërkesa të natyrave të ndryshme. Në Komisarlatin e Policisë Fier oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e punës së tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara me sistemin e kamerave, ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta intervistimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore. Lidhur me këto fakte Avokati i Popullit nisur edhe nga inspektimet e mëparshme ka rekomanduar marrjen e masave për krijimin e zyrave të dedikuara ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra por është konstatuar se sërish ky i fundit nuk është plotësuar⁷². Procesi i monitorimit filmik gjatë marrjes në pyetje të personave të shoqëruar është një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit. Gjithashtu, Komisarlati i Policisë Fier në kushtet aktuale nuk posedon hapësirë të posaçme për biseda apo intervistim me persona të mitur, sikurse është e parashikuar në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur dhe në procedurat standarde⁷³. MKPT e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se bisedat me fëmijët duhet të realizohen në një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me të miturit, pasi nga intervistimi i tyre në kushtet aktuale mund të shkaktohet traumatizim plotësues i fëmijëve.

⁷¹ Kreu VII, procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhërin Nr.306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

⁷² “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluar gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste”. CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

⁷³ Kreu VI, pika 2.16 procedura standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019.

Nga monitorimi që u bë zyrave të punonjësve të policisë në mesin aktual të Komisarariatit të Policisë Fier, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Sikurse e përmendëm edhe më lart, në këtë komisarariat nuk zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, për plotësimin dhe dhënien e kopje të procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse. Nga inspektimi rezultoi se, për personat e shoqëruar punonjësit e policisë plotësonin “Formulari i raportit të Shoqërimit ose Ndalimit/Arrestimit”, si dhe mbahej një procesverbal tip për veprimet e kryera me këta persona. Por, në përfundim të veprimeve procedurale, punonjësit e policisë nuk jepnin një kopje e këtij procesverbali me arsyen e shoqërimit, por mjaftoheshin me firmën që këta persona hidhnin në regjistrin me të dhënat e tyre. Ndërsa personat e arrestuar/ndaluar ishin të pajisur me një kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit dhe me letrën e të drejtave të tyre, sikurse është e përcaktuar në nenin 34/b, pika 2 dhe 251 të Kodin e Procedurës Penale. Gjatë inspektimit u konstatua gjithashtu se, personat e ndaluar/arrestuar ishin njoftuar që në mungesë të mundësive financiare për të pajtuar një avokat privat, mundet të kërkonin ndihmë juridike, duke ju ofruar një avokat kryesisht dhe duke ju krijuar mundësinë për të kontaktuar me të. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, e cila ishte e afishuar në zyrën e përgjegjës të ambientit të sigurisë. Për shtetasit e ndaluar/arrestuar të huaj, zbatohet detyrimi ligjor për njoftimin e përfaqësive diplomatike të shteteve respektive, ju sigurohej një avokat për të komunikuar në gjuhën e tyre, si dhe ishin përgatitur postera me të drejtat e të ndaluarve/arrestuarve në disa gjuhë të huaja, si anglisht, frëngjisht, italisht, greqisht, gjermanisht, maqedonisht, serbisht, dhe gjuhën rome.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht, përfaqësuesit ligjor dhe të psikologut që ofrohej menjëherë nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier. Grupi i ekspertëve, kontrolloi regjistrin e vizitave mjekësore dhe kartelat mjekësore për secilin person të arrestuar/ndaluar me shënimet e mbajtura nga ana e personelit mjekësor. Nga intervista me personat e arrestuar rezultoi se, vizitat mjekësore kryheshin brenda afatit 12 orësh nga momenti i vendosjes së këtyre personave në këtë ambient, sikurse përcaktohet në procedurat standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019. Vizitat mjekësore ndaj të ndaluarve/arrestuarve, konstatimet, rekomandimet dhe mjekimet e dhëna pasqyroheshin në regjistrin e vizitave mjekësore. Ndërkohë ishin hapur edhe kartelat mjekësore (kartelat ditore) të tyre, të cilat ishin vendosur në fashikullin përkatës për çdo të ndaluar/arrestuar. Por, grupi inspektimit konstatoi se, në asnjë nga këto dokumente mjeku nuk kishte shënuar orën e saktë të vizitës mjekësore, e cila duhet të kryhet brenda 12 orëve nga momenti i hyrjes në ambientin e dhomave të sigurisë. Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e mesin të këtij komisarariat ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar.

Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime: Marrjen e masave të menjëhershme për zbatimin nga punonjësit e policisë të Komisarariatit të Policisë Fier, detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr.

108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, për plotësimin dhe dhënien e kopjes të procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë të ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse. Marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e shtretërve me krevat për fjetjen e personave të ndaluar/arrestuar e akomoduar në dhomat e sigurisë dhe jo me dyshek në tokë, pasi kjo përbën trajtim çnjerëzor dhe degradues të këtyre personave. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave ku merren në pyetje personat e ndaluar/arrestuar para se të dërgohen në ambientet e sigurisë dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera. Marrjen e masave të nevojshme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në dhomën që ndodhet në ambientet e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Fier, e cila shërben për marrjen në pyetje të të ndaluarve/arrestuarve nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore. Marrjen e masave të menjëhershme për shënimin në regjistrin e vizitave mjekësore dhe kartelat mjekësore të personave të arrestuar/ndaluar, të orës të vizitës mjekësore nga ana e personelit mjekësor, brenda 12 orëve të vendosjes të këtyre personave në ambientin e sigurisë.

6.8. KOMISARIATI I POLICISË GJIROKASTËR

MKPT- kreu inspektim në datën **19.07.2019**, sipas një Plani Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Grupi i punës në vijim inspektoi ambientet e shoqërimit, zyrat e punës të punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar. Nga informacioni dhe verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit të vitit të kaluar, rezultoi se: Nuk ishte plotësuar rekomandimi për krijimin e zyrave të intervistimit në këtë komisarariat ku merren në pyetje personat e ndaluar/arrestuar para se të dërgohen në ambientet e sigurisë dhe pajisjen e tyre me sistem të monitorimit me kamera. Nuk ishte plotësuar rekomandimi për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në dhomën që ndodhet në ambientet e sigurisë të këtij komisarariat dhe që shërben aktualisht për marrjen në pyetje të të ndaluarve/arrestuarve nga oficerët e policisë gjyqësore. Ndërkohë, kishte gjetur zbatuar rekomandimi për plotësimin e organikës së personelit me mjek në Drejtorinë/Komisariatit të Policisë Gjirokastrë, i cili punonte me kohë të plotë. Në përfundim të inspektimit grupi monitorues konstatoi se, në mjediset aktuale në Komisarariatit të Policisë Gjirokastrë, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika dhe konkretisht: Në Komisarariatit të Policisë Gjirokastrë, ambienti i shoqërimit ishte në katin e parë të godinës dhe përbëhej nga tre dhoma shoqërimi, 1 (një) për meshkujt madhorë, 1 (një) për femrat dhe 1 (një) për të miturit. Ato ishin ndërtuar sipas kriterëve të parashikuara në procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Dhomat e shoqërimit ishin me sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme për qëndrim. Ato kishin dritare për sigurimin e ajrimit dhe të ndriçimit të plotë natyral, ishin të pastra nga ana higjieno-sanitare dhe të lyera rishtas, si dhe të pajisura me orenditë e nevojshme, tavolina dhe karrige për të qëndruar ulur të shoqëruarit, sipas pikës 3 të Kreut IV të “Rregullave teknike të shoqërimit në polici”. Në korridorin e këtij ambienti, pranë dhomave të shoqërimit kishte tualete të cilët ishin të pastra dhe kishin ujë të rrjedhshëm. Korridori i këtij ambienti ishte i monitoruar me kamera. Në momentin e inspektimit nuk kishte shtetas

të shoqëruar. Në ambientin e shoqërimit ishin vendosur postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në gjuhën shqipe dhe në disa nga gjuhët e huaja. Nga verifikimi i dokumentacionit, u konstatua se, në këtë komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit të çështjes përkatëse, pasi një kopje e formularit mbahej nga punonjësi i policisë në zyrën e informacionit. Gjithashtu, u evidentuan edhe disa praktika të njëpasnjëshme ku rezultoi se, në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë në Komisaratin e Policisë Gjirokastër, mbaheshin procesverbalet përkatëse, një kopje e të cilave firmosej dhe i jepej personit të shoqëruar. Në Komisaratin e Policisë Gjirokastër ambienti i sigurisë ishte i ndërtuar sipas kërkesave të parashikuara në rregullat dhe procedurat standarde miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Nr.1102, datë 07.11.2017, “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”. Ambienti i sigurisë kishte 8 (tetë) dhoma me kapacitet për 9 (nëntë) persona, të ndara më vete 6 (gjashtë) dhoma për personat në moshë madhore, 1 (një) dhomë për femrat dhe 1 (një) dhomë për të miturit. Dhomat e sigurisë plotësonin normat dhe parametrat teknikë jetësorë, për një person të arrestuar apo ndaluar, pasi sipërfaqja e përgjithshme ishte jo më pak se 10 metra katrorë, e ndarë në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m² dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m².⁷⁴ Dritaret e dhomave mundësonin depërtimin e sasisë së mjaftueshme të ajrit dhe dritës natyrale. Këto ambiente ishin të pajisura me tualete brenda, si dhe orenditë e nevojshme për jetesë si krevat të fiksuar në dysheme, dyshek, batanije dhe jastëk, të cilët ishin në gjendje të mirë dhe të pastra. Dhomat ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjieno-sanitare. Në çdo dhomë kishte zile të emergjencës, e cila mundësonte komunikimin me shërbimin e policisë në një moment nevoje të ngutshme. Në korridorin e ambientit të sigurisë kishte aparat telefonik fiks dhe citofon, për t’u përdoruar nga punonjësit e shërbimit në rastet e tentativave apo ngjarjeve të rënda me të ndaluarit/arrestuarit, për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje të shpejtë. Dhomat kishin edhe burim rezervë energjie me gjenerator. Në fund të korridorit ndodhej një dhomë dushi me ujë të ngrohtë, ku nga intervistat rezultoi se, të ndaluarit/arrestuarit kishin akses për larjen e trupit. Ndërsa për larje e pastrim për nevoja të përditshme, në çdo paradhomë kishte çezma me ujë të rrjedhshëm. Në ambientin e sigurisë kishte sistem ngrohje me kaldajë për dimër, sikurse parashikohet në “Rregullat dhe Procedurat Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Nr.1102, datë 07.11.2017, “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”. Brenda ambienteve të sigurisë kishte edhe një dhomë për kryerjen e vizitave nga mjeku, e cila

⁷⁴“Rregullat dhe Procedurat Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Nr.1102, datë 07.11.2017, “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.

ishite e pajisur me krevat, tavolinë dhe karrige. Dhoma e mjekut kishte dollap për mbajtjen e ilaçeve por mungonte frigoriferi për ruajtjen e medikamenteve mjekësore. Gjithashtu brenda këtij ambienti, kishte edhe një dhomë për takimin e të ndaluarve/arrestuarve me avokatët dhe pyetjen e tyre nga oficerët e policisë gjyqësore e cila nuk ishte e monitoruar nga kamerat. Kjo dhomë ishte e pajisur me tavolinë dhe karrige. Hyrja kryesore e ambientit të sigurisë, korridori i tij dhe hyrjet në dhomat e sigurisë monitoroheshin me kamera përgjatë 24 orëve. Nga informacioni i dhënë nga punonjësit e policisë që shërbenin në dhomat e sigurisë dhe nga intervistat me personat e arrestuar/ndaluar rezultoi se, ata trajtoheshin me ushqim 3 (tre) herë në ditë sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në Vendimin Nr.189, datë 15.03.2017 “Për trajtimin me ushqim të punonjësve, të studentëve dhe të kursantëve në institucionet arsimore të Policisë së Shtetit, si dhe të shtetasve të ndaluar dhe arrestuar deri në sqarimin e pozitës së tyre”. Ushqimi përgatitej nga një subjekt privat në bazë të kontratës së lidhur me të dhe ofrohej me shërbim katering. Ndonëse në ambientet e sigurisë nuk kishte ambiente kulti, të ndaluarve/arrestuarve që dëshironin u lejohej ushtrimi i riteve fetare brenda dhomave të sigurisë. Nga informacioni i dhënë nga punonjësit e policisë dhe personat e arrestuar rezultoi se të ndaluarve/arrestuarve u jepeshin produkte për ruajtjen e higjienës vetjake dhe të ambientit si sapun, detergjente, letra higjienike dhe letra për fshirjen e duarve dhe të fytyrës. Në momentin e inspektimit, në seksionin e sigurisë ishin 7 (shtatë) persona të arrestuar/ndaluar, nga të cilët 6 (gjashtë) persona të arrestuar dhe 1 (një) person i ndaluar. Midis tyre ishin dhe 2 femra, të cilat ishin në pritje të vlerësimit të masës së arrestit nga gjykata. Personat e arrestuar/ndaluar ishin të gjithë në moshë madhore. Grupi i monitorimit intervistoi personat e arrestuar/ndaluar, të cilët konfirmuan se ishin trajtuar në mënyrë korrekte gjatë kohës së marrjes në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore dhe qëndrimit në ambientin e sigurisë. Të intervistuarit nuk patën pretendime për trajtim denigrues, jo human apo për ushtrim dhune fizike e psikologjike. Gjendja psikologjike e të intervistuarve ishte e qetë dhe nuk dëshmonte për ndonjë shenjë keqtrajtimi. Gjithashtu, shtetasit e intervistuar kishin dijeni për identitetin e punonjësit të policisë me të cilin kishin marrë kontakt dhe kishin kryer veprimet proceduriale. Ata shpjegonin se, gjatë ndalimit/arrestimit edhe punonjësit e tjerë të policisë që kishin kontaktuar me ta, ishin identifikuar përpara tyre duke u prezantuar me gjeneralitetet dhe detyrën që kryenin. Nga intervistimi rezultoi se, këtyre personave ju ishin dhënë nga oficerët e policisë gjyqësore kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit, të kontrollit personal dhe të njohjes me të drejtat e tij. Ata kishin kontaktuar edhe më një avokat dhe ishin në pritje të procedurave gjyqësore lidhur me caktimin e masës së sigurisë dhe vlerësimit të arrestit. Nga informacionet e grumbulluara gjatë vizitës nuk rezultoi asnjë rast i përdorimit të mjeteve të forcës dhe shtrëngimit fizik, si dhe asnjë rast i përdorimit të armëve të zjarrit nga ana e policisë ndaj shtetasve të ndaluar/ arrestuar, me qëllim përmbushjen e një synimi të ligjshëm sipas dispozitave ligjore në fuqi. Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisariatin e Policisë, Gjirokastër, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform me procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar. Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se: Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi

dhe saktësi nga punonjësit e policisë⁷⁵. Në këtë komisariat ishte vendosur regjistri për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë. Ndërkohë u konstatua se në këtë komisariat kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë.

Në godinën aktuale në Komisaratin e Policisë Gjirokastër specialistët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e punës së tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta intervistimi të monitoruara me kamera, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore. Gjithashtu, në ambientet e sigurisë të Komisarimit të Policisë Gjirokastër kishte një dhomë për marrjen në pyetje të shtetasve të ndaluar/arrestuar nga përfaqësuesit e akuzës dhe për takim me avokatët, e cila dhe ajo nuk monitorohej me kamera. Lidhur me këto fakte Avokati i Popullit nisur edhe nga inspektimet e mëparshme ka rekomanduar marrjen e masave për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera të zyrave të dedikuara ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore, por rezultoi se ky rekomandim nuk është plotësuar⁷⁶. Procesi i monitorimit filmik gjatë marrjes në pyetje të personave të shoqëruar dhe të ndaluar është një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit. Gjithashtu, Komisarati i Policisë Gjirokastër në kushtet aktuale nuk disponon hapësirë të posaçme për biseda apo intervistim me persona të mitur, MKPT e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se bisedat me fëmijët duhet të realizohen në një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët, pasi nga intervistimi i tyre në kushtet aktuale mund të shkaktohet traumatizim plotësues i fëmijëve. Nga monitorimi që u bë në disa prej zyrave të punonjësve të policisë në godinën aktuale të Komisarimit të Policisë Gjirokastër, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Në këtë komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse. Edhe në nenet 34/b. pika 2 dhe 251 të K.Pr.P parashikohet se të

⁷⁵ *Kreu VII, Proçedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit*

⁷⁶ *“Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.”*

CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

ndaluarit/arrestuarit duhet t'i jepet dhe të mbajë me vete një kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit. Rezultoi se ndaj personave të shoqëruar nga punonjësi i policisë mbahej një procesverbal tip i emërtuar "Formulari i raportit të Shoqërimit ose Ndalimit/Arrestimit". Gjatë inspektimit, u konstatua se detyrimi ligjor për të njoftuar personat e ndaluar/arrestuar madhor që në mungesë të mundësive financiare për të pajtuar një avokat privat, kërkon ndihmë juridike, atij i ofrohej një avokat kryesisht dhe iu ishte krijuar mundësia për të kontaktuar me të. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, e cila ishte e afishuar në zyrën e përgjegjës të ambientit të sigurisë. Ndërsa për shtetasit e ndaluar/arrestuar të huaj ishin përgatitur fletëpalosje me të drejtat e të ndaluarve/arrestuarve në disa gjuhë të huaja, si anglisht, spanjisht, frëngjisht, italisht, greqisht, gjermanisht, maqedonisht, serbisht, sllovenisht dhe gjuhën rome. Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat. Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut që ofrohej nga Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastrë, por dhe në bashkëpunim me shkollat e mesme të qytetit të Gjirokastrës. Grupi i ekspertëve konstatoi se vizitat mjekësore nga ana e personelit mjekësor kryheshin brenda afatit 12 orësh nga momenti i vendosjes së këtyre personave në këtë ambient, sikurse përcaktohet në "Rregullat dhe Procedurat Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Nr.1102, datë 07.11.2017, "Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre". Mjeku ishte i pranishëm sipas nevojave dhe njoftohej të kryente procedurat përkatëse në kohë. Vizitat mjekësore ndaj të ndaluarve/arrestuarve, konstatimet, rekomandimet dhe mjekimet e dhëna pasqyroheshin në regjistrin e vizitave mjekësore. Ndërkohë hapeshin edhe kartelat mjekësore (kartelat ditore) të tyre, të cilat vendoseshin në fashikullin përkatës për çdo të ndaluar/arrestuar. Gjatë inspektimit u konstatua se në korridorët e godinës të këtij komisariati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar. **Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime:** Marrjen e masave të nevojshme për instalimin e sistemit të kamerave në dhomën që shërben për marrjen në pyetje të të ndaluarve/arrestuarve nga oficerët e policisë gjyqësore në ambientin e sigurisë, me qëllim monitorimin e veprimeve që kryhen me këta persona. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave ku merren në pyetje personat e ndaluar/arrestuar, kryesisht për fëmijët e mitur, para se të dërgohen në ambientet e sigurisë dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera.

6.9. KOMISARIATI I POLICISË GRAMSH

MKPT- kreu inspektim në datën 06.03.2019, sipas një Plani Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në Komisarlatin e Policisë Gramsh, ambienti i shoqërimit ishte i ndërtuar sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit" dhe procedurës standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në polici", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.306, datë 31.03.2016. Grupi i inspektimit konstatoi se, në ambientin e shoqërimit

ndodheshin 3 (tre) dhoma shoqërimi, nga të cilat 1 (një) dhomë për shoqërimin, mbajtjen dhe trajtimin e personave në mjediset e komisariatit të policisë për personat e rritur, 1 (një) për femrat dhe 1 (një) për të miturit. Ambienti i dhomave të shoqërimit ishte me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrimin dhe trajtimin e të shoqëruarve, duke krijuar kushte për trajtim dinjitoz dhe garantimin e të drejtave që ju njeh ligji këtyre personave. Dhomat e shoqërimit kishin dritare të cilat lejonin ajrimin dhe ndriçimin natyral, si dhe kishin ndriçim nga rrjeti elektrik. Ato ishin të lyera, të pastra nga ana higjienike dhe ishin të pajisura me orënditë e nevojshme, si tavolinë dhe karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar. Në korridorin e ambientin të shoqërimit ndodhej tualeti në të cilin kishte ujë të rrjedhshëm në mënyrë të vazhdueshme dhe pa ndërprerje. Nga inspektimi rezultoi gjithashtu se, në këtë Komisariat mungonte dhoma për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar. Gjithashtu u konstatua se nuk kishte sistem monitorimi me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe ambientit të shoqërimit. Sipas informacionit të specialistit për hetimin e krimeve, pyetja e personave të shoqëruar kryhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë të Komisarariatit. Mungesa e sistemit të monitorimit dhe e dhomës për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar, mund të përbëjë shkak për përdorimin e mjeteve dhe metodave jo të përshtatshme për shoqërimin, mbajtjen dhe trajtimin e personave në mjediset e policisë, si dhe për respektimin dhe garantimin e të drejtave që ju njeh ligji këtyre personave. Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar dhe për rrjedhojë nuk u realizuan intervistime lidhur me trajtimin që u bëhet personave nga ana e punonjësve të policisë. Në Komisarariatin e Policisë Gramsh nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Elbasan. Gjatë inspektimit u konstatua se, në Komisarariatin e Policisë Gramsh, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar”, ishte i tipit “Model nr.1”, konform procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar. Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrimit nuk ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë⁷⁷, sepse rubrikat për “Arsyet ligjore të shoqërimit” dhe “Njoftimi i familjarëve të të shoqëruarve” nuk ishin plotësuar me korrektesë sipas ligjit. Konkretisht, nuk ishte pasqyruar baza ligjore e shoqërimit, si dhe gjeneralitetet dhe numri i telefonit të personit të njoftuar.

Në këtë Komisariat kishte regjistër për personat e arrestuar/ndaluar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë. Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisariat kishte regjistër për evidentimin e kërkesës/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por nuk ishte evidentuar asnjë ankesë apo kërkesë. Në Komisarariatin e Policisë Gramsh oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e tyre të

⁷⁷ *Kreu VII, Procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.*

punës. Këto ambiente nuk ishin të monitoruara me kamera për vëzhgimin gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore. Lidhur me këtë fakt, Avokati i Popullit nisur edhe nga inspektimi i mëparshëm ka rekomanduar marrjen e masave për krijimin e zyrave të veçanta ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, por është konstatuar se sërish ky rekomandim nuk është plotësuar. Avokati i Popullit, duke iu referuar standardeve ndërkombëtare⁷⁸, e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit. Nga monitorimi që u bë në disa prej zyrave të punonjësve të policisë, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të marrë avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat. Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, ata shoqëroheshin për në ambientet e sigurisë të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, për kryerjen e veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore të seksionit për të miturit dhe në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë Elbasan, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale. Ndërsa psikologu sigurohej në bashkëpunim me Shkollat e Mesme të qyteteve Gramsh dhe Elbasan. Gjatë inspektimit u konstatua se, në korridorin e godinës dhe ambientit të shoqërimit, si dhe në dhomat e shoqërimit të këtij komisarati, ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar. Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisarariat zbatoheshin detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse. **Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime:** Marrjen e masave të menjëhershme për ndërtimin e dhomës për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar dhe të dhomave të intervistimit të personave të arrestuar/ndaluar nga oficerët e policisë gjyqësore. Marrjen e masave të nevojshme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në korridorin e ambientit të shoqërimit dhe në dhomat e marrjes në pyetje/intervistimit të shtetasve të shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar. Marrjen e masave të menjëhershme për trajnimin e punonjësve të policisë të zyrës së informacionit me qëllim plotësimin e plotë dhe me korrektesë të të gjithave rubrikave të regjistrit të shoqërimit.

⁷⁸ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkësë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

6.10. KOMISARIATI HAS

Inspektimi u krye në datën 25.07.2019, sipas një Plani Inspektimi të miratuar më parë nga Avokati i Popullit. Grupi i inspektimit, pasi mori informacionin e nevojshëm lidhur me qëllimin e inspektimit, inspektoi ambientet e shoqërimit, zyrat e punës të punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar. Nga informacioni dhe inspektimi i kryer në ambientet e shoqërimit në Komisaratin e Policisë Has, lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i vitit të kaluar 2018, rezultoi se: Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për krijimin e dhomave të shoqërimit të ndara më vete për personat e shoqëruar të rritur, për femrat dhe të miturit, sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr.306, dt.31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për krijimin e ambienteve të punës ku merren në pyetje/intervistohen shtetasit e shoqëruar në mjediset e policisë, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga punonjësit e policisë, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera brenda këtyre ambienteve. Ndërkohë, nga verifikimi i dokumentacioneve dhe regjistrit që ndodheshin në zyrën e punonjësit të policisë të informacionit, grupi i inspektimit konstatoi se: Ishte zbatuar rekomandimi për plotësimin me përgjegjësi dhe saktësi të të gjitha rubrikave të “Regjistrit të evidentimit të të dhënave të personave të shoqëruar”, si dhe dokumenteve të tjera të parashikuara në aktet ligjore e nënligjore, që kanë të bëjnë me procedurën standarde të shoqërimit në mjediset e policisë. Në përfundim të inspektimit grupi monitorues konstatoi se, megjithëse në Komisaratin e Policisë Has ishin marrë masa për përmirësimin e standardeve të dhomave të shoqërimit, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika dhe më konkretisht: Ambienti i shoqërimit në Komisaratin e Policisë Has ishte ndërtuar i ri dhe përshtatur sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr.306, dt.31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Grupi i punës, pasi mori informacionin e nevojshëm, inspektoi nga afër ambientin e shoqërimit. Ky ambient ndodhej në katin e parë të ndërtesës të këtij komisarati. Në hyrje të godinës ndodhej zyra e punonjësit të policisë të informacionit dhe përmbri saj, ndodheshin 2 (dy) dhoma shoqërimi, të ndara më vete një për persona të rritur dhe një dhomë për femra/të mitur, pasi dhe fluksi i personave të shoqëruar në mjedisin e policisë ishte shumë i ulët. Por, referuar procedurës standarde për rregullat teknike të shoqërimit, ambienti i shoqërimit duhet të kishte 3 (tre) dhoma shoqërimi të ndara ndara më vete për persona të rritur, femra dhe të mitur⁷⁹. Dhomat e shoqërimit ishin me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, ato kishin dritare të cilat lejonin ajrimin dhe ndriçimin natyral, si dhe kishin ndriçim nga rrjeti elektrik. Dhomat e shoqërimit ishin të pastra nga ana higjieno-sanitare, ishin të lyera dhe të pajisura me orenditë e nevojshme, si tavolinë dhe karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar. Në korridorin e ambientit të shoqërimit ndodhej një tualet, i cili ishte i pastër dhe kishte çezmë me ujë të rrjedhshëm.

⁷⁹ Kreu VI, pika 3 e Procedurave standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.

Ambienti i shoqërimit në këtë komisarariat nuk kishte sistem monitorimi me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe dhomave të shoqërimit. Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte asnjë person të shoqëruar dhe për rrjedhojë grupi i inspektimit nuk mundi të realizoi intervista me këta persona, në lidhje me trajtimin që u bëhet në mjediset e policisë.

Në Komisarariat e Policisë Has, nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar pasi regjistroheshin në regjistër, dërgoheshin menjëherë në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Kukës. Regjistri për evidentimin e personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar si dhe trajtimi i të shoqëruarve, ndaluarve/arrestuarve gjatë veprimeve që kryen policia. Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisarariat e Policisë Has, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr.1” konform kërkesave të procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar. Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë⁸⁰. Në këtë komisarariat kishte regjistër për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë. Ndërkohë u konstatua se në këtë komisarariat kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por gjatë vitit 2019 nuk ishte evidentuar asnjë ankesë apo kërkesë. Në Komisarariat e Policisë Has specialistët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit e shoqëruar në zyrat e punës së tyre, pasi nuk kishte një ambient të veçantë për kryerjen e veprimeve hetimore. Gjithashtu, Komisarariat i Policisë Has nuk posedon hapësirë të posaçme për intervistimin e fëmijëve të mitur. Mekanizmi Kombëtar e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se bisedat me fëmijët duhet të realizohen në një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave, pasi nga intervistimi i tyre në zyrat e punës të specialistëve të policisë, mund të shkaktohet traumatizim i mëtejshëm i të miturve. Lidhur me këto fakte Institucioni i Avokatit të Popullit nisur edhe nga inspektimi i mëparshëm ka rekomanduar marrjen e masave për krijimin e zyrave të dedikuara ku merren në pyetje shtetasit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore, madje dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, por konstatohet se sërish ky rekomandim nuk është plotësuar⁸¹

⁸⁰ *Kreu VII, Procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit*

⁸¹ *“Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluar gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.”*

Avokati i Popullit, duke iu referuar standardeve ndërkombëtare, e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit. Nga monitorimi që u bë në disa prej zyrave të punonjësve të policisë, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime proceduriale. Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat. Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet proceduriale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë. Ndërsa psikologu sigurohej në bashkëpunim me shkollën e mesme të qytetit Krumë. Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e ambientit të shoqërimit dhe në dhomat e shoqërimit të këtij komisariati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar. Ndërkohë u konstatua se në këtë komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në Nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarte për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse. Rezultoi se ndaj personave të shoqëruar nga punonjësi i policisë mbahej një procesverbal tip i emërtuar “Formulari i Raportit të Shoqërimit ose Ndalimit/Arrestimit”. Gjatë inspektimit, u evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme ku në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë, mbahej procesverbali përkatëse i cili pasi firmosej, një kopje i jepej personit të shoqëruar dhe një kopje mbahej nga punonjësi i zyrës të informacionit. **Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime:** Marrjen e masave të menjëhershme për ndërtimin e ambientit të shoqërimit me dhoma të ndara më vete për personat e rritur, femrat dhe të miturit në Komisaritet e Policisë Has, sipas kërkesave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr.306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e ambienteve të punës ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve proceduriale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera.

6.11. KOMISARIATI KAPSHICË KORÇË

MKPT-kreu një inspektim në Stacionin e Policisë Kufitare dhe Emigracionit në Kapshticë, Korçë. Inspektimi u krye në datën 25.09.2019, sipas një Plani Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Ky stacion i Policisë Kufitare është pjesë dhe vartësi e Drejtorisë të Policisë Kufitare të Qarkut Korçë. Stacioni vepron me struktura dhe logjistikes pranë pikës së kalimit kufitar Kapshticë dhe Stacionit të Policisë Kufitare Kapshticë, 2 km larg pikës së kalimit kufitar të vendosur në një godinë në vete. Pranë pikës së kalimit kufitar përveç kioskave të kontrollit të pasaportave dhe personelit përgjegjës për këtë

funksion, në godinën kryesore të kësaj pike kalimi gjendeshin dy zyra të pajisura me teknologjinë e informacionit (sistemi TIMS) dhe personelin e specializuar për të identifikuar dhe proceduar lidhur me rastet e paraqitura problematike në momentin e hyrjes në territorin Shqiptarë pranë Kioskave të kontrollit. Lidhur me rastet e identifikuar dhe konsultuara në sistemin TIMS nga ana e personelit të Policisë Kufitare për personat me probleme dokumentacioni, persona të shpallur në kërkim policor, persona të cilët kishin kaluar kufirin ilegalisht, të depërtuar apo të larguar nga vendet e luftës në kërkim të statusit të refugjatit, merreshin masat e transportimit të tyre për veprime të mëtejshme pranë Stacionit të Policisë Kufitare të sipërpërmendur. Në këtë stacion policie kishte 2 dhoma intervistimi të pajisura me teknologjinë e informacionit (sistemi TIMS) dhe personelin e specializuar intervistues. Gjithashtu kishte dhe dy dhoma shoqërimi (njëra për meshkuj dhe tjetra për gra). Dhomat e shoqërimit ishin të pajisura me orenditë minimale për një qëndrim deri në 10 orë sipas ligjit. Përgjithësisht brenda kësaj kohe kryheshin të gjitha veprimet e duhura dhe personat liheshin të lirë apo shoqëroheshin pranë komisariateve apo institucioneve përkatëse. Në momentin e inspektimit nuk kishte persona të depërtuar nga shteti Grek. Në dhomat dhe korridoret e Stacionit të Policisë nuk mungonin posterat me të drejtat e personave të shoqëruar apo informacion informues lidhur me të drejtën për të kërkuar statusin e azilkërkuesit/ refugjatit. Megjithatë personeli intervistues kishte formularë për kërkimin e statusit të refugjatit dhe sipas tyre i viheshin në dispozicion së bashku me sqarimet e duhura të gjithë të interesuarve. Grupit inspektues iu bë me dije se ditët e fundit nuk kishte pasur raste të personave jo Shqiptarë të cilët të kishin kaluar kufirin shtetëror pranë kësaj pike kufitare në kërkim të këtij statusi.

Grupi monitorues u njoh me punën e bërë dhe praktikat e ndjekura në këtë pikë në raste të problemeve me kategori të ndryshme. Një nga kategoritë më shqetësuese ishte ajo e personave të deklaruar si të papranuar apo të papranueshëm në territorin grek për shkak të pamjaftueshmërisë së mjeteve financiare, pamjaftueshmëri që konstatohet nga pala greke mbi arsyetimin e diskutueshëm se personi, sipas rregullave të zonës Schengen, duhet të ketë me vete apo të disponueshme një shumë specifike për kalimin e kufirit. Mjediset e shoqërimit dhe ambientet e punës të punonjësve të policisë ishin të ndërtaura sipas standardeve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore, për këtë qëllim. Siç e përmendëm edhe më lart, ambienti i shoqërimit në Stacionin e Policisë Kufitare në Kapshticë ishte ndërtaur sipas parashikimeve në procedurat standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në polici”*, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 306 datë 31.03.2016. Lidhur me rastet e identifikuar dhe konsultuara në sistemin TIMS nga ana e personelit të Policisë Kufitare për personat me probleme dokumentacioni, persona të shpallur në kërkim policor, persona të cilët kishin kaluar kufirin ilegalisht, të depërtuar apo persona të ikur nga vendet e luftës në kërkim të statusit të refugjatit, ata dërgoheshin në mjedisin e pritjes të përmendur më lart. Në këtë mjedis apo qendër të vogël pritje kishte 2 dhoma intervistimi të pajisura me teknologjinë e informacionit (sistemi TIMS) dhe personelin e specializuar intervistues. Gjithashtu kishte dhe 2 dhoma shoqërimi (njëra për meshkuj dhe tjetra për gra dhe të mitur). Grupi monitorues u njoh edhe me 2 mjediset që përdorreshin për izolimin e personave të ndaluar apo me personat që shkaktonin probleme gjatë qëndrimit në këtë mjedis pritje. Dritaret e dhomave të shoqërimit ishin me përmasa të tilla që krijonin mundësinë për realizimin e ajrimit e ndriçimit të plotë natyral. Gjithashtu, ishte instaluar dhe sistemi i ndriçimit që furnizohej nga rrjeti elektrik. Dritaret ishin me xham, por në pjesën e jashtme të siguruara dhe me

skarë hekuri, me qëllim parandalimin e ndonjë mundësie largimi apo arratisje të personave të shoqëruar në këto mjedise. Skara e hekurit ishte vendosur në mënyrë të tillë që ajo të mos pengojë hyrjen e plotë të ajrit dhe ndriçimit natyral. Ky lloj standardi përcaktohet dhe në rregullat teknike të shoqërimit në polici, ku thuhet se: *“Dritaret e këtyre mjediseve të jenë të siguruara me qëllim parandalimin e largimit apo arratisjes së personave të shoqëruar nga këto mjedise”*⁸². Në momentin e inspektimit, mjedisi i shoqërimit ishte i pajisur me orenditë e nevojshme si tavolina, stola dhe karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar. Gjithashtu, gjatë inspektimit rezultoi se, dyert e dhomave të shoqërimit ishin me strukturë të rregullt. Dyert ishin të pajisura me bravë të rregullt dhe me çelës. Rregullat teknike dhe standardet që kanë të bëjnë me shoqërimit, mbajtjen dhe trajtimin e personave në mjediset e policisë, parashikojnë marrjen e masave ndaj personave të shoqëruar që duhet t’u krijohen kushte të nevojshme të përshtatshme të ndryshme nga ato të dhomave të sigurisë. Por, mbi të gjitha ambienti dhe kushtet materiale në dhomat e shoqërimit, duhet të jenë të tilla garantojnë sigurinë dhe trajtimin njerëzor të këtyre personave. Lidhur me çështjen e sigurisë të këtyre personave, në procedurën standarde mbi rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e policisë, thuhet shprehimisht se: *“Në të gjitha mjediset (shoqërimit) të mos mbahen sende apo mjete të tilla që mund të shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve apo për kundërveprim ndaj punonjësit të policisë”*⁸³. Mjedisi i shoqërimit dhe ambientet e tjera ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjieno-sanitare. Në ambientet e shoqërimit të Pikës së Kalimit të Kufirit në Kapshticë ishte instaluar një sistem i pjesshëm i monitorimi me kamera me qëllim mbajtjen në vëzhgim të ambienteve hyrëse të godinës, por mungonte vëzhgimi në korridorin e ambienteve të shoqërimit. Avokati i Popullit e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor si një standard ndërkombëtarë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit ndaj tyre.⁸⁴ Në zyrën e punonjësit të informacionit, kishte libër për evidentimin e personave të shoqëruar me shënimet përkatëse. Libri ishte i sekretuar dhe ishte i plotësuar sipas rubrikave. Procedurat e evidentimit të veprimeve që janë kryer me personat e shoqëruar ishin kryer nga punonjësi i policisë që ka punuar dhe sqaruar çështjen, ndërsa hedhja e të dhënave në regjistër dhe në sistemin elektronik të të dhënave ishte kryer nga punonjësi i policisë të shërbimit të informacionit në pikën e kalimit të kufirit. Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte asnjë person të shoqëruar. Në Pikën e Kalimit të Kufirit Kapshticë, riatdhesohen në mënyrë periodike nga policia e vendeve të tjera (Greqia) shtetas shqiptarë. Personat e riatdhesuar regjistroheshin në librin përkatës dhe intervistoheshin të gjithë nga punonjësit e policisë të këtij stacioni. Ndërkohë ndaj tyre bëheshin edhe verifikime nëpërmjet organeve të policisë sipas

⁸² Kreu VI, pika g, “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 306 datë 31.03.2016.

⁸³ Kreu VI, pika f, “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 306 datë 31.03.2016.

⁸⁴ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohen në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkësë të bërë nga i ndaluar gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

vendbanimit përkatës. Sipas punonjësve të policisë, koha e qëndrimit në komisariat e këtyre personave shkonte nga 2 – 4 orë. Në dhomat dhe korridoret e stacionit të policisë në vendkalimin kufitar ishin posterat me informacion informues lidhur me të drejtën për të kërkuar statusin e refugjatit. Gjithashtu personeli intervistues kishte formularë për kërkimin e statusit të refugjatit dhe sipas tyre i viheshin në dispozicion së bashku me sqarimet e duhura të gjithë të interesuarve. Këta formularë plotësoheshin si pjesë e procedurës së përzgjedhjes e cila synon kategorizimin e personave jo shtetas shqiptarë që ndalohen nga policia, në emigrantë ekonomikë të cilët pranojnë të kthehen vullnetarisht në vendin e tyre e kërkojnë për këtë ndihmën e IOM, në persona të trafikuar apo në rrezik trafikimi dhe në azilkërkues. Në rastin e konstatimit në pikën kufitare apo në kufirin e gjelbër të personave jo shtetas shqiptarë të cilët nuk plotësonin kushtet për hyrje apo qëndrim në territorin shqiptar, ata intervistoheshin edhe nga specialistët e Drejtorisë Rajonale në Korçë dhe pastaj dërgoheshin ose në Qendrën e Pritjes së Azilkërkuesve në Babrru, Tiranë, ose në Qendrën e Mbyllur për të Huajt e Parregullt në Karreç, Durrës. Lidhur me parapërgatitjet për një fluks të shtuar migratorë në këtë pike kalimit kufitare ishin duke u marrë masa për instalimin e ambienteve shtese të akomodimit në kontejnerë pranë këtij Stacioni të Policisë. Në momentin e inspektimit nuk konstatuam persona të riatdhesuar në ambientet e këtij institucioni, ndaj grupi i inspektimit nuk mundi të zhvillojë intervista në lidhje me problematikën që ata i shqetësojnë. Por, lidhur me këtë çështje, Institucioni i Avokatit të Popullit sjell në vëmendje kërkesat e nenit 109/1/f të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, në cilin parashikohet e drejta e punonjësit të policisë që të shoqërojë personat në ambientet e Policisë, për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, si dhe në rastet e dëbimit ose ekstradimit. Në pikën 5 të po këtij neni, thuhet shprehimisht se: *“Punonjësi i policisë, dokumenton në proces-verbal veprimet e kryera me personin e shoqëruar. Procesverbali nënshkruhet në fund të çdo flete nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe personi i shoqëruar. Një kopje e procesverbalit i vihet në dispozicion personit të shoqëruar.* “Marrjen e masave të nevojshme për realizimin e dhomës së tretë për shoqërimin e të miturve në Pikën e Kalimit të Kufirit Kapshticë sipas standardeve. Marrjen e masave të menjëhershme për mbajtjen dhe përditësimin e një liste përkthyesish për gjuhët kryesore nga vijnë të huajt e parregullt në çdo pikë kalimi kufitar. Marrjen e masave për garantimin e dhënies të dokumenteve dhe regjistrimin e të dhënave të shtetasve të riatdhesuar në pikën e kalimit të kufirit. Marrjen e masave për monitorimin e plotë me kamera të të gjitha ambienteve ku mbahen persona të privuar nga liria në Stacionin e Policisë Kufitare Kapshticë.

6.12. KOMISARIATI KRUJË

MKPT- kreu inspektim në datën 13.06.2019, sipas një Plani Inspektimi të miratuar më parë nga Avokati i Popullit. Nga informacioni i grumbulluar në vend gjatë kryerjes së inspektimit, rezultoi se gjendja faktike e ambientit të shoqërimit kishte disa ndryshime në krahasim me një vit më parë, duke zbatuar pjesërisht në disa pika rekomandimin e Avokatit të Popullit dërguar pas inspektimit të bërë në vitin 2018. Konkretisht: Ishte plotësuar rekomandimi për marrjen e masave të nevojshme për kompletimin e dhomave të shoqërimit me orenditë e nevojshme për qëndrim, duke zëvendësuar ato ekzistuese. Ishte plotësuar rekomandimi për marrjen e masave të nevojshme për instalimin e një sistemi cilësor të monitorimit me kamera në dhomat e shoqërimit si dhe në korridoret, oborrin dhe

ambientet e tjera të institucionit. Ishte plotësuar rekomandimi për marrjen e masave të nevojshme për plotësimin me saktësi dhe përgjegjësi të “Regjistrin të evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” në rubrikën “shkaqet, arsyet e shoqërimit”, duke e saktësuar dhe orën për çdo rast shoqërimi. Gjithashtu nga ana e Komisarariatit të Policisë Krujë ishin bërë përpjekjet duke ju drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës me shkresën Nr.795/1 Prot, datë 23.04.2019 për të kërkuar plotësimin e të gjitha rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit dërguar me shkresën Nr. Ku/69-3 datë 12.02.2019, Lënda “ *Rekomandime mbi inspektimin e bërë në Komisariatin e Policisë Krujë* ”. Në përfundim të inspektimit grupi monitorues konstatoi se, megjithëse në Komisariatin e Policisë Krujë ishin marrë disa masa për përmirësimin e standardeve lidhur me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe të personave të arrestuar/ndaluar, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika të cilat do paraqiten konkretisht më poshtë: Në Komisariatin e Policisë Krujë ambientet e shoqërimit nuk ishin realizuar plotësisht sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe në Procedurën Standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 306, dt. 31.03.2016, ku specifikohet se “*ato duhet të jenë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit*”.⁸⁵ Në këtë Komisariat kishte vetëm 2 (dy) dhoma shoqërimi, 1 (një) për meshkujt madhorë dhe tjetra e përbashkët për femrat dhe të miturit. Dhomat kishin nga një dritare, e cila lejonte ajrimin dhe ndriçimin natyral, si dhe kishin ndriçim nga rrjeti elektrik. Ato ishin të pastra, të lyera dhe ishin të pajisura plotësisht me orenditë e nevojshme, si tavolinë e karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar. Dhomat e shoqërimit nuk ishin të pajisura me tualete brenda apo ngjitur me to. Të shoqëruarit përdornin tualetin, i cili përdorej edhe nga punonjësit e policisë të këtij komisariati. Në korridorin dhe në dhomat e ambienteve të shoqërimit ishte instaluar sistem monitorimi me kamera për vëzhgimin e veprimeve që kryheshin nga punonjësit e policisë me të shoqëruarit. Gjithashtu në dhomat e shoqërimit nuk kishte sende apo mjete të tilla që shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve apo për kundërveprim ndaj punonjësve të policisë. Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar. Në Komisariatin e Policisë Krujë nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Durrës. Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar si dhe trajtimi i të shoqëruarve, ndaluarve/arrestuarve gjatë veprimeve që kryen policia. Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisariatin e Policisë Krujë, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform

me Procedurën Standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr.306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar. Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se: Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrin ishin plotësuar me saktësi nga punonjësit e policisë të këtij institucioni. Punonjësit e policisë sqaruan se si orar shoqërimi fillestar në çdo rast përdoret momenti i hyrjes së personave në Komisariatin e Policisë Krujë dhe ky orar shërben edhe në procedurat që ndiqen

⁸⁵ Kreu VI, pika 3 e procedurave standarde.

lidhur me arrestimin e personave kur ekzistojnë kushtet që urdhërohet arrestimi i tyre. Në këtë komisariat ishte vendosur regjistri për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga verifikimi i këtij regjistri, rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë.

Ndërkohë u konstatua se në këtë komisariat kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë. Sipas punonjësve të policisë nuk ka pasur ankesa apo kërkesa që të evidentoheshin në regjistrin e mësipërm. Në Komisarlatin e Policisë Krujë oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e punës së tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta hetimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore. Institucioni i Avokatit të Popullit, duke iu referuar standardeve ndërkombëtare, e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit⁸⁶. Nga monitorimi që u bë zyrave të punonjësve të policisë, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë, kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat. Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë. Ndërsa psikologu sigurohej në bashkëpunim me shkollën e mesme të qytetit. Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e godinës dhe të ambientit të shoqërimit si dhe në dhomat e shoqërimit të këtij komisariati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të arrestuar/ndaluar.

Ndërkohë u konstatua se në këtë komisariat zbatoheshin detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të Procedurës Standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse. U evidentuan rast pas rasti procedurat e ndjekura lidhur me dhënien e procesverbalit të shoqërimit për personat e shoqëruar në Komisarlatin e Policisë Krujë. **Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime:**

Marrjen e masave të nevojshme dhe gjetjen e fondeve përkatëse për të mundësuar rikonstruksionin e përgjithshëm të godinës së Komisarlatit të Policisë Krujë me qëllim për ta kthyer atë në një institucion

⁸⁶ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohen në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluarit gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

me standarde bashkëkohore dhe dinjtoze, si për personat e shoqëruar, arrestuar/ndaluar, ashtu edhe për punonjësit e policisë. Marrjen e masave e menjëhershme për ndërtimin dhe vënien në funksionim të dhomës së tretë të shoqërimit në Komisaratin e Policisë Krujë sipas kërkesave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, dhe Procedurës Standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit, duke krijuar një mjedis të përshtatshëm dhe dinjtoz për të shoqëruarit. Marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin e tualeteve për personat e shoqëruar brenda apo ngjitur me ambientin e shoqërimit. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave ku merren në pyetje shtetasit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave të posaçme për intervistoma me persona të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët. Marrjen e masave të nevojshme për instalimin e një sistemi cilësor të monitorimit me kamera në ambientet dhe mjediset në të cilat do të merren në pyetje shtetasit e shoqëruar.

6.13. KOMISARIATI I POLICISË KUÇOVË

MkPT- kreu inspektim në datën 03.07.2019, sipas një Plani Inspektimi të miratuar më parë nga Avokati i Popullit. Grupi inspektues, pasi mori informacionin e nevojshëm lidhur me qëllimin e inspektimit, vijoi kryerjen e inspektimit me shefin e rendit dhe punonjësin përgjegjës të dhomave të shoqërimit. Grupi i punës në vijim inspektoi ambientet e shoqërimit, disa zyra të punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar. Gjatë inspektimit u konstatua se rekomandimet e Institucionit të Avokatit të Popullit të dërguara në vitin 2018 pas inspektimit të bërë në vitin 2017 në këtë komisarariat ishin zbatuar në mënyrë të pjesëshme dhe konkretisht: Ishte zbatuar rekomandimi për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimitin e çështjes përkatëse, i cili është një detyrim ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të Ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurës standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me urdhrin nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Policisë së Shtetit. Nga verifikimet e bëra u konstatua se për personat e shoqëruar në komisarariat aplikohet detyrimi ligjor për dhënien e kopjes së “Procesverbalit të shoqërimit” dhe mbajtjen e kopjes tjetër në sekretarinë e institucionit. Ndërsa rekomandimi për marrjen e masave të menjëhershme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi në korridorin e ambientit të shoqërimit dhe në zyrat e intervistimit të personave të shoqëruar dhe atyre të arrestuar/ndaluar, nuk ishte zbatuar ende për shkak të mungesës së fondeve financiare. Në përfundim të inspektimit grupi monitorues konstatoi se, në ambjentet aktuale në Komisaratin e Policisë Kuçovë, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika dhe konkretisht: Në Komisaratin e Policisë Kuçovë nuk kishte dhoma shoqërimi të ndërtuara sipas parashikimeve të bëra në ligjin Nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe në procedurën standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.306,

dt. 31.03.2016, me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit. Në këtë komisariat, brenda mjediseve të tij, kishte dy dhoma shoqërimi funksionale të ndara një për të rritur, dhe tjetra për femra dhe të mitur. Dhomat e shoqërimit ishin të lyera, të pastra dhe të mirëmbajtura. Dhomat e shoqërimit ishin të pajisura me tavolinë dhe karrige, kishin dritare me përmasa që siguronin ndriçim të nevojshëm natyral, si dhe ndriçim artificial nga rrjeti elektrik. Në korridorin e godinës pranë ambientit të shoqërimit kishte një tualet, i cili ishte funksional, i pastër dhe kishte ujë të rrjedhshëm. Në ambientin e shoqërimit ishin vendosur postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar. Në momentin e inspektimit nuk kishte shtetas të shoqëruar. Në zbatim të Ligjit Nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe në procedurën standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.306, dt. 31.03.2016, çdo njësi policore duhet të jetë e pajisur, ndër të tjera, edhe me regjistrat përkatës. Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisaratin e Policisë Kuçovë, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform me procedurën standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar. Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se: Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë⁸⁷. Në këtë komisariat mbahej regjistri për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij institucioni, i cili ishte i sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë, nisur nga momenti, çasti, kur privoheshin nga liria. Ndërkohë u konstatua se në këtë komisariat kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë. Gjithashtu në këtë institucion ishin afishuar posterat me të drejtat e personave të shoqëruar dhe personave të ndaluar/arrestuar, ku parashikohej edhe e drejta e tyre për të bërë ankesa, nëse kishin të tilla. Në Komisaratin e Policisë Kuçovë nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Berat. Në godinën e Komisarariatit të Policisë Kuçovë oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e punës së tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta intervistimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore. Lidhur me këto shqetësime, Avokati i Popullit, nisur edhe nga inspektimet e mëparshme të bërë në këtë komisariat ka rekomanduar marrjen e masave për krijimin e zyrave të veçanta ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, por

⁸⁷ Kreu VII, Procedura standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit

sikurse u parashtrua edhe më sipër ky rekomandim nuk është zbatuar ende⁸⁸. Procesi i monitorimit filmik gjatë marrjes në pyetje të personave të shoqëruar është një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit. Gjithashtu, Komisariati i Policisë Kuçovë në kushtet aktuale nuk posedon ambient të posaçëm për komunikim apo intervistim me persona të mitur. MKPT e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se bisedat me fëmijët dhe pyetja e tyre duhet të realizohen në një ambient më vehte që duhet të jetë i përshtatur në mënyrë të posaçme për zhvillimin e intervistave me këtë kategori personash, pasi nga intervistimi në kushtet aktuale mund të shkaktohet pasoja të rënda deri në trauma tek të miturit që janë në konflikt me ligjin. Nga monitorimi që u bë në disa prej zyrave të punonjësve të policisë në godinën aktuale të Komisarariatit të Policisë Kuçovë, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime proceduriale. Në këtë komisarariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të Ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit të çështjes përkatëse. Gjatë inspektimit, u konstatua se detyrimi ligjor për të njoftuar personat e ndaluar/arrestuar madhor që në mungesë të mundësive financiare për të pajtuar një avokat privat, kërkojnë ndihmë juridike, atyre u ofrohej një avokat kryesisht dhe iu ishte krijuar mundësia për të kontaktuar me të. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, e cila ishte e afishuar në zyrën e përgjegjës të zyrës së informacionit. Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet proceduriale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut që ofrohej menjëherë nga Drejtoria Vendore e Policisë Berat. Në Komisarariatin e Policisë Kuçovë nuk kishte ndonjë zyrë të monitoruar me kamera për marrjen në pyetje të shtetasve të shoqëruar dhe ndaluar/arrestuar nga punonjësit e policisë. Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e godinës, si dhe në dhomën që përdorej për shoqërim të këtij komisaritati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar. **Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime:** Marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin dhe vënien në funksionim të ambienteve të shoqërimit në Komisarariatin e Policisë Kuçovë sipas kritereve të parashikuara në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe në procedurën standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke pasur edhe një dhomë tjetër të tretë më vehte për të shoqëruarit e mitur, i cili duhet të jetë një mjedis i përshtatshëm dhe dinjitoz, i pajisur me orënditë e nevojshme për qëndrimin e kësaj kategorie personash. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e dhomave (zyrave) të punës në këtë komisarariat ku merren në pyetje

⁸⁸ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkësë të bërë nga i ndaluarit gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

apo intervistohen personat e ndaluar/arrestuar dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera. Marrjen e masave të nevojshme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në korridorin e ambientit të shoqërimit të këtij komisariati.

6.14. KOMISARIATI I POLICISË KUFITARE DIBËR

MKPT kreu Inspektimi u krye në datën 08.11.2019, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Institucioni i Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit të inspektimit, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrijë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon: Gjatë inspektimit të këtyre ambienteve, grupi monitorues vuri theksin në përshtatjen e ambienteve sipas standardeve teknike të ndërtimit të dhomave të shoqërimit dhe dhomave të sigurisë, parashikuar në aktet ligjore dhe nënligjore për këtë qëllim, si dhe për garantimin e respektimit të drejtave të personave të privuar nga liria, qofshin këta shtetas shqiptarë apo shtetas të huaj sipas standardeve të përcaktuara edhe në Konventat Ndërkombëtare. Grupi i punës gjithashtu, inspektoi dhe ambientet e zyrave të punonjësve të policisë që kryejnë veprime procedurale me personat e shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar, si dhe kërkoi të njihet me dokumentacionin përkatës ku pasqyrohen veprimet e kryera me këta persona. Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit, rezultoi se, vitet e fundit nuk ishte zhvilluar inspektim nga ana e institucionit tonë në këtë Komisarjat. Në përfundim të inspektimit, grupi monitorues konstatoi se, në Stacionin e Policisë dhe Pikën e Kalimit të Kufirit të Bllatës, krahas masave të marra për përmirësimin e kushteve në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë apo dhe në vend qëndrimin e personave të riatdhesuar, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika, të cilat po i referojmë si më poshtë vijon: Në Komisarjatin e Policisë Kufitare dhe Migracionit Dibër, ambientet e shoqërimit ishin të ndërtuara në tërësi sipas kërkesave të përcaktuara në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.306, datë 31.03.2016, për miratimin e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”. Por, grupi i inspektimit, inspektoi në vend ambientet e shoqërimit dhe u njoh me dokumentacionin që mbahej nga punonjësit e policisë në Stacionin Policisë dhe Pikën e Kalimit të Kufirit në Bllatë. Në Stacionin e Policisë Kufitare Bllatë, ambienti i shoqërimit ishte i përbërë nga 3(tre) dhoma i përshtatur në dy ambiente. Një prej dhomave përdorej nga punonjësit e policisë kufitare për kryerjen e intervistave me shtetasit shqiptarë të deportuar, ndërsa 2(dy) dhomat e tjera shërbenin për qëndrimin e shtetasve të deportuar deri në përfundimin e procedurave. Në një nga dhomat qëndronin femra dhe të mitur të deportuar dhe dhomën tjetër qëndronin personat e rritur. Shtetasit shqiptarë të deportuar ktheheshin nga shtete të ndryshme, por numrin më të madh të tyre e përbënin personat e depërtuar nga shteti i Maqedonisë të Veriut. Kryesisht, ata ishin banorë të zonës së Dibrës, Bulqizës dhe Burrelit, të cilët shkojnë në këto vende për të kryer punë sezonale, por policitë e vendeve i kthejnë ata, për arsye të shkeljes të afatit 3 mujor të qëndrimit. Gjatë vitit 2019 numri i shqiptarëve të deportuar në Stacionin e Policisë Kufitare Bllatë, ka qenë rreth 87 persona. Dhoma e intervistimit dhe dhomat e qëndrimit të shtetasve të deportuar, ishin me hapsirë dhe sipërfaqe të bollshme, të pajisura me orënditë e nevojshme si tavolina për nevoja pune, si dhe karrige dhe stola për qëndrimin ulur të këtyre shtetasve. Ambientet ishin të pastra nga ana higjiëno-sanitare, si dhe të lyera. Dhomat e shoqërimit kishin ajrim dhe dritë natyrale, si dhe ndriçim artificial. Ngjitur me këto dhoma

ndodhej dhe një tualet për kryerjen e nevojave personale. Në momentin e inspektimit, grupi i inspektimit nuk u gjet asnjë shtetas i deportuar në këto ambiente, por sipas informacionit të punonjësve të policisë kufitare, rezultoi se, këta shtetas pasi intervistohen lihen të lirë, ndaj dhe koha e qëndrimit të tyre në këto ambiente ishte shumë e vogël, nga 1-2 orë. Ambienti i Stacionit të Policisë dhe Pikës së Kalimit të Kufirit në Bllatë, ruhej me sistemin e kamerave. Në periudhën e dimrit, ngrohja e brendshme e këtyre ambienteve sigurohej me pajisje elektrike dhe me dru, duke krijuar kushte të përshtatshme dhe dinjitoze për trajtimin e këtyre shtetasve. Pika e Kalimit të Kufirit Bllatë, ndodhej në godinë më vete nga stacioni i policisë, në njërën prej ambienteve të lëshuara me qira nga Drejtoria e Doganës në Bllatë. Ajo ishte një godinë prej druri dhe në funksion të policisë kufitare ishin lëshuar vetëm 2 dhoma. Njëra nga dhomat ishte zyra e punës të përgjegjësit të turnit të policisë dhe ngjitur me të ndodhej një ambient që shërbente si dhomë shoqërimi. Në këtë dhomë shoqërimi qëndronin personat që konstatohen nga punonjësit e policisë kufitare, si persona në konflikt me ligjin, të cilët pasi verifikoheshin dhe evidentoheshin në rregjistrat përkatës, i dërgonin menjëherë për në ambientet e sigurisë të Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër. Dhoma e shoqërimit kishte një dritare shumë të vogël dhe ishte e pajisur me stola për qëndrimin ulur të personave të shoqëruar. Ajo kishte ndriçim artificial. Për shkak të mungesës të infrastrukturës së një godine, në Pikën e Kalimit të Kufirit Bllatë, mungonin ambientet e tjera funksionale, kryesisht dhoma për intervistimin e personave të shoqëruar dhe dhomat e shoqërimit të ndara më vete për personat e rritur, femra dhe të mitur, sikurse përcaktohen në procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, *“mjedise me sipërfaqe dhe hapsirë të bollshme, si dhe me dritare që të lejojë ajrimin dhe dritën e plotë natyrale”*⁸⁹. Në ambientin e shoqërimit, nuk kishte asnjë person të shoqëruar për të zhvilluar intervista në lidhje me kushtet dhe trajtimin e tyre nga punonjësit e policisë të këtij komisariati. Gjatë kohës së inspektimit në Stacionin e policisë dhe Pikën e kalimit të kufirit Bllatë, u monitorua edhe sjellja e punonjësve të policisë gjatë komunikimit me qytetarët e ndryshëm, shtetas shqiptarë dhe të huaj që hynin e dilnin në pikën e kalimit të kufirit. Nga monitorimi dhe pyetja e disa prej qytetarëve që hynin dhe dilnin në pikën e kalimit të kufirit u konstatua se, punonjësit e policisë komunikonin në mënyrë korrekte dhe me etikë me ta, duke i trajtuar me respekt e dinjitet. Nga intervistimi i punonjësve të policisë të këtij Komisarati, grupi inspektues konstatoi se, për shtetasit e depërtuar në momentin e dorëzimit të pasaportës u jepej dhe një kopje e proces-verbalit të mbajtur nga punonjësi i policisë për secilin person të rikthyer. Aty pasqyroheshin shkaqet e kthimit dhe kohëzgjatja e penaliteteve si rezultat i shkeljeve të rregullave Shengen nga personi i kthyer, konform nenit 109/1/f dhe 109/5 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”⁹⁰. Në Komisaratin e Policisë Kufitare dhe Migracionit Dibër, stacionet e policisë dhe pikat e kalimit të kufirit në varësi të tij, nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar, pasi evidentoheshin në rregjistër përkatës, në mungesë të ambienteve dërgoheshin menjëherë në dhomat

⁸⁹ Kreu VI, pika 3 e procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.

⁹⁰ Neni 109/1/f “Punonjësi i policisë bën shoqërimin e personave në ambientet e Policisë ose institucionin urdhërdhënës në kushtet dhe rastet e mëposhtme: f) për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, si dhe në rastet e dëbimit ose ekstradimit.

Neni 109/5 “Punonjësi i policisë, dokumenton në proces-verbal veprimet e kryera me personin e shoqëruar. Procesverbali nënshkruhet në fund të çdo flete nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe personi i shoqëruar. Një kopje e procesverbalit i vihet në dispozicion personit të shoqëruar.”

e sigurisë të Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër. Në Stacionin e Policisë dhe Pikën e Kalimit të Kufirit Bllatë kishte regjistër të personave të shoqëruar me shënimet përkatëse, sipas Modelit nr.1 të procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306 datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Regjistrimi i tyre në regjister bëhej nga punonjësi i zyrës së informacionit, sipas dispozitave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”. Grupi inspektimit konstatoi gjithashtu se zbatoheshin detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë, që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit të çështjes përkatëse. **Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime:** Marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin e ambientit të shoqërimit në Pikën e Kalimit të Kufirit Bllatë, sipas standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, të miratuar me Urdhër Nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke shtuar dy dhoma të tjera shoqërimi, të pajisura me orëditë e nevojshme si tavolina dhe karrige dhe të ndara më vete për personat e rritur, femra dhe të mitur. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e dhomës (zyrës) së intervistimit të personave të shoqëruar nga punonjësit e policisë në Pikën e Kalimit të Kufirit Bllatë.

6.15. KOMISARIATI I POLICISË KUKËS

MKPT- kreu inspektim në datën 24.07.2019, sipas një Plani Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Grupi i punës në vijim inspektoi ambientet e shoqërimit, disa zyra të punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar. Nga informacioni i grumbulluar në vend gjatë kryerjes së inspektimit, rezultoi se gjendja faktike e ambientit të shoqërimit ishte e njëjtë si në inspektimin pararendës, ballafaquar me standardet e parashikuara në aktet normative dhe dokumentet ndërkombëtare, për respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar brenda këtyre ambienteve. Nga informacioni i dhënë dhe nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të bëra nga Institucioni i Avokatit të Popullit nga inspektimi i kryer në vitin 2018, grupi i inspektimit konstatoi se: Nuk ishte zbatuar rekomandimi për krijimin e dhomës së shoqërimit për femra, si dhe ai për krijimin e dhomës për marrjen në pyetje të të shoqëruarve para se të dërgohen në ambientet e sigurisë, sipas kritereve të parashikuara në procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr.306, dt.31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për instalimin e sistemit të monitorimit në dhomën që ndodhet në ambientet e sigurisë së këtij komisariati dhe që shërben për marrjen në pyetje të të ndaluarve/arrestuarve nga oficerët e policisë gjyqësore. Ndërkohë, nga kontrolli i dokumentacionit dhe regjistrave që plotësohen nga punonjësit e policisë në zyrën e informacionit dhe të shërbimit në dhomat e sigurisë, grupi i inspektimit konstatoi se, ishte zbatuar rekomandimi për plotësimin në kohë, në mënyrë të saktë, korrekte dhe pa gabime të regjistrave të shoqërimit dhe të arrestimit/ndalimit të shtetasve, si dhe aplikimin e procedurave korrekte ndaj personave të shoqëruar dhe personave të arrestuar/ndaluar gjatë

qëndrimit dhe mbajtjes së tyre në mjediset e policisë. Në përfundim të inspektimit grupi monitorues konstatoi se, në Komisarlatin e Policisë Kukës ishin marrë disa masa për përmirësimin e standardeve lidhur me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe të personave të arrestuar/ndaluar, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika dhe më konkretisht: Në Komisarlatin e Policisë Kukës, mjediset e shoqërimit janë ndërtuar të reja, sipas kërkesave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Mjedisi për shoqërimin e personave, ndodhet në një godinë më vete brenda territorit të këtij institucioni dhe përbëhen nga 2 (dy) dhoma shoqërimi, një për shoqërimin e personave të rritur dhe dhoma tjetër përdorej për qëndrimin e personave të shoqëruar femra dhe të mitur. Dhomat e shoqërimit ishin me sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme për qëndrimin e shtetasve të shoqëruar. Ato kishin dritare për sigurimin e ajrimit dhe ndriçimit të plotë natyral, ishin të lyera dhe të pastra, si dhe të pajisura me orenditë e nevojshme, tavolina dhe karrige për të qëndruar ulur të shoqëruarit sipas pikës 3 të kreut IV të “Rregullave teknike të shoqërimit në polici”. Gjithashtu në korridorin e këtij ambienti, pranë dhomave të shoqërimit kishte një tualet, i cili ishte i pastër dhe kishte ujë të rrjedhshëm. Korridori i këtij ambienti ishte i monitoruar me kamera. Në ambientin e shoqërimit kishte edhe dhoma të tjera të cilat nuk përdorreshin dhe ishin jashtë funksionit, ndërkohë që njëra prej tyre mund të përshtatej si dhomë për shoqërimin e shtetasve, pasi 2 (dy) dhomat ekzistuese janë të pamjaftueshme, referuar standardeve ligjore. Gjithashtu, një nga dhomat mund të shërbente edhe si dhomë për intervistimin/marrjen në pyetje të këtyre personave dhe jo sikundër bëhen aktualisht në zyrat e punonjësve të policisë. Avokati i Popullit sugjeron që këto ambiente duhet të shfrytëzohen duke i përshtatur dhe pajisur me orenditë e nevojshme⁹¹, sipas kritereve të parashikuara në procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, për të krijuar dhomën e shoqërimit, me qëllim që femrat dhe të miturit të qëndrojnë në dhoma më vete,⁹² ashtu si edhe për dhomën ku merren në pyetje të shoqëruarit. Në Komisarlatin e Policisë Kukës, dhomat e sigurisë ishin të ndërtuara sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, si dhe Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1102, datë 07.11.2017, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”. Ambienti i sigurisë përbëhej nga 6 (gjashtë) dhoma sigurie, dhoma e përgjegjësit të dhomave të sigurisë, dhoma për intervistimin/marrjen në pyetje dhe takimeve me avokatin të ndaluarve/arrestuarve, si dhe dhoma për mjekun për kryerjen e vizitave mjeksore. Dhomat e sigurisë ishin të ndara më vete, 4 (katër) për meshkuj madhorë, 1 (një) për femra dhe 1 (një) për të mitur. Kapaciteti fizik i dhomave të sigurisë ishte për mbajtjen dhe trajtimin e 12 (dymbëdhjetë) personave të ndaluar/arrestuar. Dhomat e sigurisë plotësonin normat dhe parametrat teknikë jetësorë, për një person të arrestuar apo ndaluar, pasi sipërfaqja e përgjithshme ishte jo më pak se 10 metra katrorë, e ndarë në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m² dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m².⁹³ Dritaret e dhomave mundësonin futjen e sasisë së mjaftueshme të ajrit

⁹¹ Kreu VI, pika 3.d të Procedurave standarde.

⁹² Kreu VI, pika 3.b e Procedurave standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

⁹³ Kreu V, pika 3.3 e Procedurave standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

dhe dritës natyrale. Këto ambiente ishin të pajisura me tualete brenda dhe orenditë e nevojshme për jetesë, si krevat, dyshekë, batanije, çarçaf dhe jastëk në gjendje të mirë dhe të pastra. Ambienti i sigurisë ishte i lyster dhe ishte i pastër nga ana higjieno-sanitare. Të ndaluarit/arrestuarit kishin akses për larje e pastrim të vazhdueshëm në paradhomë, ndërsa për larjen e trupit kishte ambient të posaçëm (dushe me ujë të ngrohtë), i cili ndodhej në fund të korridorit, sikurse parashikohet në pikën 9 të Kreut V të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1102, datë 07.11.2017, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit. Gjithashtu në ambientet e sigurisë kishte sistem ngrohjeje për dimër, sikurse parashikohet në pikën 3 të Kreut V të Aktit të procedurës standarde “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit. Në çdo dhomë kishte zile të emergjencës për të komunikuar me shërbimin e policisë në një moment nevojë të ngutshme, të cilat ishin funksionale. Në korridorin e ambientit të sigurisë kishte aparat telefonik fiks për t’u përdoruar nga punonjësit e shërbimit në rastet e tentativave apo ngjarjeve të rënda me të ndaluarit/arrestuarit, për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje të shpejtë. Brenda ambienteve të sigurisë kishte edhe një dhomë për kryerjen e vizitave nga ndihmësmjeku, e cila ishte e pajisur me krevat, tavolinë dhe karrige. Gjithashtu, ambienti kishte edhe një dhomë për takimin e të ndaluarve/arrestuarve me avokatët dhe pyetjen e tyre nga oficerët e policisë gjyqësore. Kjo dhomë ishte e pajisur me tavolinë dhe karrige. Hyrja kryesore e ambientit të sigurisë, korridori i tij dhe hyrjet në dhomat e sigurisë monitoroheshin me kamera për 24 orë. Në momentin e inspektimit nuk ndodhej asnjë person në këto ambiente. Në Komisaratin e Policisë Kukës “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr.1”, konform procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr.306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar. Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, ishte zbatuar rekomandimi i Institucionit të Avokatit të Popullit, nisur nga mangësitë e konstatuara nga inspektimi i kryer në vitin 2018, në lidhje me mospërputhjen e orareve të shoqërimit me atë të arrestimit/ndalimit. Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë⁹⁴.

Shoqërimi i shtetasve në organin e policisë bëhet në bazë të nenit 111, të Ligjit “Për Policinë e Shtetit” ku parashikohet se, punonjësi i Policisë bën arrestimin dhe ndalimin e personit, sipas përcaktimeve në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Ndërsa në nenin 112/2/e, të po këtij ligji parashikohet se, në rastet e arrestimit/ndalimit, policia evidenton për çdo person të dhënat për orën, datën dhe vendin e arrestimit, apo të ndalimit. Pra, sapo personi kapet dhe prangoset nga punonjësi i policisë që ka bërë kapjen në flagrancë apo ora kur bëhet ekzekutimi i urdhrit të ndalimit. Në këtë përfundim arrihet duke iu referuar neneve 144 dhe 250, të Kodit të Procedurës Penale. Sipas këtyre dispozitave, shënimi në

⁹⁴ Kreu VII, *Procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.*

procesverbal i çastit (orës) së arrestimit në flagrante, ose të ndalimit është një element i rëndësishëm, mbi bazën e të cilit fillojnë të llogariten efektet e paraburgimit. Ndërsa në bazë të nenit 258, të Kodit të Procedurës Penale, nga çasti (ora) e arrestimit ose ndalimit fillon afati i 48-të orëve, brenda të cilit prokurori kërkon vleftësimin e masës së sigurimit në gjykatën e vendit ku është kryer arrestimi, ose ndalimi. Sa më sipër, Institucioni i Avokatit të Popullit ka rekomanduar në vijimësi nisur nga rastet e ankesave të trajtuara ashtu edhe nga inspektimet e bëra në organet e Policisë së Shtetit duke kërkuar që, në rastet kur për personat e shoqëruar në organet e policisë vendoset arrestimi apo ndalimi, në procesverbalin e arrestimit në flagrante ose të ndalimit, duhet vihet ora e shoqërimit të tyre dhe jo ora kur përpilohet procesverbali i arrestimit/ndalimit. Rekomandimet e Avokatit të Popullit janë bazuar jo vetëm në parimet universale të së drejtës dhe në parimet e përgjithshme të së drejtës tonë penale, por edhe në dispozitat konkrete të Kodit të Procedurës Penale respektivisht nenet 144, 250 dhe 259 të tij. Gjithashtu, u konstatua se në këtë komisariat kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të shtetasve të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë nga ana e tyre. Në momentin e inspektimit në ambientet e shoqërimit dhe në ambientin e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Kukës nuk kishte asnjë person të shoqëruar apo të ndaluar/arrestuar. Nga informacioni i dhënë nga punonjësit e policisë që shërbenin në dhomat e sigurisë rezultoi se të ndaluarit/arrestuarit trajtoheshin me ushqim tre herë në ditë sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në urdhrin e përbashkët nr.432, datë 10.03.2008 të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë. Ushqimi përgatitej në kuzhinën e I EVP Kukës, brenda të njëjtës godinë ku ndodheshin ambientet e sigurisë të këtij komisariati. Kuzhinierja ishte e pajisur me librezën shëndetësore të vendosur në stendën ku paraqitej menyuja javore. Ndonëse në ambientet e sigurisë nuk kishte ambiente kulti, të ndaluarve/arrestuarve që dëshironin u lejohej të predikonin ritet fetare brenda dhomave të sigurisë. Të ndaluarve/arrestuarve iu jepeshin produkte për ruajtjen e higjienës vetjake dhe të ambientit, si sapun, detergjente, letra higjienike dhe letra për fshirjen e duarve dhe të fytyrës. Në ambientet e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Kukës, kishte një dhomë për marrjen në pyetje të shtetasve të ndaluar/arrestuar nga përfaqësuesit e akuzës dhe për takim me avokatët, e cila ishte e pajisur me orenditë e nevojshme si karrige dhe tavolinë, por nuk monitorohej me sistemin e kamerave. Sipas punonjësve të policisë që kryenin shërbim në dhomat e sigurisë, pyetja e personave të ndaluar/arrestuar nga oficerët e policisë gjyqësore bëhej në dhomën e destinuar për këtë qëllim, por më shpesh ata merren në pyetje/intervistohen dhe në zyrat e punës së këtyre të fundit, të cilat gjithashtu nuk janë të monitoruara me kamera. Avokati i Popullit e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit ndaj tyre. Lidhur me këto fakte Avokati i Popullit nisur edhe nga inspektimet e mëparshme ka rekomanduar vazhdimisht marrjen e masave për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera të zyrave të dedikuara ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore, por rezultoi se ky rekomandim ende nuk

është plotësuar⁹⁵ nga Drejtoria/Komisariatet Vendore të Policisë Kukës. Nga monitorimi që u krye në zyrat e oficerëve të policisë gjyqësore në këtë komisariat, nuk u gjetën sende prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Në këtë komisariat ishte krijuar një dhomë (magazinë) për administrimin dhe ruajtjen e provave materiale. Gjatë inspektimit u konstatua se në korridorin e ambienteve të sigurisë dhe të shoqërimit në Komisaratin e Policisë Kukës ishin të afishuara postaret me të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar, si dhe atyre të shoqëruar. Ndërsa për shtetasit e ndaluar/arrestuar të huaj ishin përgatitur postaret me të drejtat e të ndaluarve/arrestuarve në disa gjuhë të huaja, si anglisht, frëngjisht, italisht, greqisht, gjermanisht, maqedonisht, serbisht dhe sllovenisht. Sipas punonjësve të policisë, të ndaluarit/arrestuarit dhe të shoqëruarit njiheshin me të drejtën për të pasur një avokat mbrojtës gjatë marrjes në pyetje, dhe ata që e kishin kërkuar u ishte krijuar mundësia reale për të kontaktuar me të. Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat kryesisht. Ndërsa në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve e dërguar nga organi i prokurorisë. Përgjegjësi i dhomave të sigurisë kishte listën e avokatëve dhe numrat e telefonave të tyre. Ndërsa psikologjia sigurohej nga Qendra e Strehimit të Grave dhe të Miturve të Dhunuar pranë Bashkisë Kukës, si dhe nga Organizata Jo Fitimprurëse (OJF) me seli në këtë qytet. Personave të ndaluar dhe arrestuar iu jepeshin nga oficerët e policisë gjyqësore kopje të proces-verbalit të ndalimit/arrestimit, të kontrollit personal dhe të letrës me të drejtat e tyre. Ndërsa, personave të shoqëruar në mjediset e policisë, në përfundim të kohës të qëndrimit iu jepeshin kopje të proces-verbalit me arsyet e shoqërimit. Grupi i punës konstatoi se vizitat mjekësore nga ana e ndihmësmjekut kryheshin brenda afatit 12 orësh nga momenti i vendosjes së këtyre personave në këtë ambient, sikurse përcaktohet në procedurën standarde “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin Nr.1102, datë 07.11.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.⁹⁶ Ndihmësmjeku ishte i punësuar në këtë organ me kohë të plotë. Ai i pasqyrore konstatimet, rekomandimet dhe mjekimet e dhëna gjatë vizitave mjekësore për të ndaluarit/arrestuarit, në regjistrin e vizitave mjekësore. Po ashtu, ai hapte kartelat mjekësore (kartelat ditore) të tyre, të cilat i vendoste në fashikullin përkatës për çdo të ndaluar/arrestuar. Por, në rastin e vdekjes të shtetasit M.GJ më datë 03.01.2019, si person i arrestuar që ndodhej në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Kukës, pas një hetimi të pavarur që zhvilloi Institucioni i Avokatit të Popullit, rezultoi se, punonjësit e policisë

⁹⁵ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluarit gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.”

CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

⁹⁶ Kreu II, pika 7, e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1102, datë 07.11.2017.

që kryenin shërbimin në dhomat e sigurisë ditën e ngjarjes, ishin punonjës të patrullës të përgjithshme të policisë, dhe jo të dhomave të sigurisë. Në librat e shërbimit ata figuronin që ishin instruktuar, por nga përgjigjet e pyetjeve rezultonte se, ata nuk ishin të trajnuar dhe të instruktuar specifikash për mënyrën se si duhet të veprojnë dhe procedurat që duhet të ndjekin në parandalimin e rasteve të vrasjeve apo vetëvrasjeve të shtetasve kur ata ndodhen në mjediset e policisë. Ndaj, organi i prokurorisë duke marrë në konsideratë konkluzionet e aktit të ekspertimit mjeko-ligjor dhe shënimet e bëra në kartelën ditore nr.127 viti 2019 të Shërbimit Spitalor Kukës për shtetasin M.GJ, ka regjistruar emrin e personit që i atribuohet vepra penale për dy punonjës policie të cilët kanë qenë të planizuar në shërbim tek dhomat e sigurisë në Komisariatin e Policisë Kukës, shtetasve F.O dhe E.D, si persona të dyshuar për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar në neni 248 i K.Penal dhe “Veprimeve që pengojnë zbulimin e së vërtetës”, parashikuar në neni 301 i K.Penal. Ndërkohë, Institucioni i Avokatit të Popullit në zbatim të kërkesave të nenit 14 të ligjit 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, pasi është njohur me faktin se çështja është në shqyrtim nga prokuroria për veprat penale të sipërcituara ndaj punonjësve të policisë të shërbimit në dhomat e sigurisë të Komisariatit të Policisë Kukës, ka ndërprerë procedurat e mëtejshme të hetimit administrativ. Gjithashtu, në ambientin e shoqërimit dhe atë të sigurisë, kishte regjistër për evidentimin e ankesave dhe kërkesave të personave të shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar. Nga verifikimi tyre rezultoi se, nuk ishte asnjë ankesë/kërkesë të regjistruar nga shtetasit për vitin 2019. **Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime:** Marrjen e masave të menjëhershme për trajnimin dhe instruktimin e vazhdueshëm të trupës së policisë që kryejnë shërbim në ambientin e shoqërimit dhe atë të sigurisë për zbatimin e kërkesave të procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1102, datë 07.11.2017, në rastin e parandalimit të vrasjeve apo vetëvrasjes të shtetasve kur ata ndodhen në mjediset e policisë, si dhe evidentimin e këtyre masave në një libër të veçantë. Marrjen e masave të menjëhershme për krijimin e dhomës të shoqërimit të ndara më vete për femra dhe për të mitur, sipas kriterëve të parashikuara në procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306, dt.31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Marrjen e masave të menjëhershme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera të dhomës që ndodhet në ambientet e sigurisë të këtij komisarati, e cila shërben për marrjen në pyetje të të ndaluarve/arrestuarve nga oficerët e policisë gjyqësore. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e dhomave (zyrave) të punës në këtë komisarati ku merren në pyetje personat e ndaluar/arrestuar para se të dërgohen në ambientet e sigurisë dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera.

6.16. KOMISARIATI I POLICISË LIBRAZHD

MKPT- kreu inspektim në datën 06.03.2019, sipas një Plani Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Më tej, grupi inspektues vijoi inspektimin në ambientet e komisariatit, vizitoi zyrat e punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar. Nga informacioni i grumbulluar në vend gjatë

kryerjes së inspektimit dhe këqyrjes së ambienteve, Grupi i inspektimit konstatoi se ishte zbatuar rekomandimi i Institucionit të Avokatit të Popullit lidhur me marrjen e masave për lëvrimin e fondeve sipas parashikimeve të bëra në Ligjin nr. 108/2014, “*Për Policinë e Shtetit*”, i ndryshuar, dhe në procedurat standarde: “*Rregullat teknike të shoqërimit në polici*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 306 datë 31.03.2016, me qëllim krijimin e dhomave të shoqërimit për kategoritë e parashikuar në ligj (femra, të mitur dhe madhorë) me kushte normale dhe trajtimin dinjitoz ndaj shtetasve të shoqëruar, krijimin e zyrave të intervistimit ku merren në pyetje personat e ndaluar/arrestuar, si edhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto ambiente.

Në përfundim të inspektimit Grupi inspektues konstatoi se, megjithëse në Komisaratin e Policisë Librazhd, ishin marrë masa serioze për përmirësimin e standardeve lidhur me kushtet materiale dhe të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika dhe më konkretisht: Në Komisaratin e Policisë Librazhd, ambientet e shoqërimit ishte në ndërtim e sipër sipas parashikimeve të bëra në Ligjin nr. 108/2014 “*Për Policinë e Shtetit*”, i ndryshuar, dhe procedurës standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në polici*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 306 datë 31.03.2016. Grupi i inspektimit konstatoi se, ambientet e shoqërimit sipas planit arkitektonik të punimeve do të përbëheshin nga 3 (tre) dhoma shoqërimi, nga të cilat 1 (një) dhomë për shoqërimin, mbajtjen dhe trajtimin e personave në mjediset e Komisaratis të Policisë për personat e rritur, 1 (një) për femrat dhe 1 (një) për të miturit. Ambientet e dhomave të shoqërimit në ndërtim e sipër ishin me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrimin dhe trajtimin e të shoqëruarve, duke krijuar kushte për trajtim dinjitoz dhe garantimin e të drejtave që ligji iu njehtë këtyre personave. Gjithashtu sipas planimetrisë dhe planit të punimeve në këto ambiente ishin parashikuar edhe dhoma për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar dhe instalimi i sistemit të monitorimit me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridoreve dhe ambienteve të shoqërimit. Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar dhe për rrjedhojë nuk u realizuan intervistime lidhur me trajtimin që iu bëhet personave nga ana e punonjësve të policisë. Në Komisaratin e Policisë Librazhd nuk kishte dhe nuk do ketë ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisaratis të Policisë Elbasan. Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisaratin e Policisë Librazhd, “*Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar*” nuk ishte i tipit “*Model nr.1*”, konform procedurave standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në polici*”, miratuar me Urdhrin nr. 306 datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, por ishte i sekretuar. Avokati i Popullit ka rekomanduar edhe më përpara përshtatjen dhe hartimin e Regjistrimit të personave të shoqëruar sipas modelit të sipërcituar, por ende nuk është arritur ky standard, dhe kjo në gjykimin tone përbën një mangësi të madhe procedurale, duke marrë parasysh edhe faktin se Rregullorja respektive, e sipërcituar, ka hyrë në fuqi prej tre vitesh tashmë. Të gjithë personat e shoqëruar në strukturën e policisë sipas dispozitave të Ligjit nr.108/2014 “*Për Policinë e Shtetit*”, i ndryshuar, regjistroheshin në një regjister të vjetër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrimit nuk ishin

plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë⁹⁷, sepse rubrikat për “Arsyet ligjore të shoqërimit” dhe “Njoftimi i familjarëve të të shoqëruarve” nuk ishin plotësuar me korrektesë sipas ligjit. Konkretisht, nuk ishte pasqyruar baza ligjore e shoqërimit, si dhe gjeneralitetet dhe numri i telefonit të personit të njoftuar. Në këtë Komisariat kishte regjistër për personat e arrestuar/ndaluar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë. Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisariat kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por nuk ishte evidentuar dhe pasqyruar asnjë ankesë apo kërkesë. Oficerët e Policisë Gjyqësore në Komisaratin e Policisë Librazhd, aktualisht deri në përfundimin e punimeve për dorëzimin e ambienteve të reja, i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e tyre të punës. Këto ambiente nuk ishin të monitoruara me kamera për vëzhgimin gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore. Lidhur me këtë fakt, Avokati i Popullit nisur edhe nga inspektimi i mëparshëm ka rekomanduar marrjen e masave për krijimin e zyrave të veçanta ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, por është konstatuar se sërish ky rekomandim nuk është plotësuar. Avokati i Popullit, duke iu referuar standardeve ndërkombëtare⁹⁸, e konsideron procesin e monitorimit filmik si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e Policisë së Shtetit. Nga monitorimi i disa prej zyrave të punonjësve të policisë, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Nga pyetja e punonjësve të policies, rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë, të cilët nuk kishin mundësi financiare për të marrë avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, iu sigurohej mbrojtja me avokat. Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, ata shoqëroheshin për në ambientet e sigurisë të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, për kryerjen e veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore të seksionit për të miturit dhe në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë Elbasan, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale. Ndërsa psikologu sigurohej në bashkëpunim me Shkollat e Mesme të qyteteve Librazhd dhe Elbasan. Gjatë inspektimit u konstatua se, në korridorin e godinës ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar në organin e policisë. Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisariat zbatoheshin detyrimi ligjor i parashikuar në nenin

⁹⁷ Kreu VII, Procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.

⁹⁸ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

109/5 dhe 122/5 të ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse. **Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime:** Marrjen e masave të nevojshme për përfundimin sa më të shpejtë të punimeve për ndërtimin e ambienteve të reja të shoqërimit dhe dhomës për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar dhe të dhomave të intervistimit të personave të arrestuar/ndaluar nga oficerët e policisë gjyqësore. Marrjen e masave të nevojshme për pajisjen dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera të këtyre ambienteve të shoqërimit dhe të dhomave të marrjes në pyetje/intervistimit të shtetasve të shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar. Marrjen e masave të menjëhershme për zvendësimin e regjistrit të vjetër të evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar me atë të tipit “Model nr.1”, konform procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhërin nr. 306 datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Fillimin e procedimit administrativ dhe propozimin e masave disiplinore ndaj punonjësve të Komisarariatit të Policisë Librazhd të cilët nuk kanë zbatuar dhe nuk kanë respektuar në vijimësi rekomandimet e Avokatit të Popullit lidhur me zvendësimin e regjistrave dhe plotësimin korrekt të tyre. Marrjen e masave të menjëhershme për trajnimin e punonjësve të policisë të zyrës së informacionit me qëllim plotësimin e plotë dhe me korrektesë të të gjithave rubrikave të regjistrit të shoqërimit.

6.17. KOMISARIATI I POLICISË NR. 3 TIRANË

MKPT- kreu inspektim në datën 04.12.2019, sipas një Plani Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Grupi i inspektimit, pasi mori informacionin e nevojshëm inspektoi ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë, zyrat e punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar. Theksojmë se, drejtuesit e komisarariatit dhe punonjësit e policisë u treguan bashkëpunues dhe transparentë, gjatë inspektimit që zhvilloi grupi inspektues në ambientet e këtij Komisaritati. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, rezultoi se: Ishte plotësuar rekomandimi, për plotësimin në kohë dhe në mënyrë korrekte sipas të gjitha rubrikave të regjistrave të shoqërimit dhe të ndalimit/arrestimit të shtetasve. Ndërkohë, grupi i inspektimit konstatoi se nuk kishin gjetur zbatim rekomandimet e mëposhtme: Nuk ishte plotësuar rekomandimi, për ndërtimin e ambientit të shoqërimit sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhërin Nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për të rritur, femra dhe të mitur. Nuk ishte plotësuar rekomandimi, për ndërtimin e ambientit të sigurisë sipas procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019. Nuk ishte plotësuar rekomandimi, për krijimin e zyrave të përshtatshme ku merren në pyetje/intervistohen shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera. Nuk ishte plotësuar rekomandimi, për

plotësimin me shtretër të dhomave të sigurisë, me qëllim sigurimin e kushteve të përshtatshme për jetesë të shtetasve të arrestuar/ndaluar. Në përfundim, grupi i inspektimit konstatoi se, në Komisariatin e Policisë nr.3 Tiranë ishin marrë disa masa të rëndësishme për përmirësimin e standardeve lidhur me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe të personave të arrestuar/ndaluar, por nisur nga kushtet aktuale vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika, si më poshtë vijon: Në Komisariatin e Policisë nr.3 Tiranë, mjedisi i shoqërimit nuk është i ndërtuara sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.306, datë 31.03.2016, për miratimin e procedurës standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në polici*”, në ambiente me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit.⁹⁹ Ambienti i shoqërimit ndodhej në katin e parë të godinës të komisarariatit. Ai kishte 2(dy) dhoma shoqërimi me dimensione 4 x 3m. Njëra nga dhomat përdorej për personat e shoqëruar në moshë madhore, ndërsa dhoma tjetër përdorej për personat e shoqëruar femra dhe të mitur. Dritarja e dhomës ku qëndronin shtetasit e shoqëruar në moshë madhore, ishte me përmasa të vogla dhe nuk krijonte mundësi për ajrim dhe ndriçim të plotë natyral. Ndërsa dhoma tjetër ku qëndronin shtetasit e shoqëruar femra dhe të mitur, ishte me dritare me përmasa normale që lejonte ajrimin dhe futjen e dritës natyrale. Ato kishin ndriçim nga rrjeti elektrik. Në pjesën e jashtme, dritaret ishin të siguruara me rrjetë të hollë hekuri. Dhomat e shoqërimit ishin të pajisura me karrige për të mundësuar qëndrimin ulur të shtetasve që qëndrojnë në këto ambiente. Ato ishin të pastra nga ana higjieno-sanitare, por kishin nevojë për lysterje dhe dezinfektim të herë pas hershëm të tyre. Dhomat ishin të pajisura me dyer druri të veshura me llamarinë dhe mbylleshin nga jashtë me shul dhe çelës. Mjedisi i shoqërimit dhe ambientet e tjera të komisarariatit nuk kishin sistem ngrohjeje qendror. Në korridorin afër ambientit të shoqërimit, kishte një tualet, i cili kishte ujë të rrjedhshëm dhe përdorej nga të shoqëruarit. Në këtë Komisariat ishte instaluar sistemi i monitorimit me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe të dhomave në mjedisin e shoqërimit. Në dhomat e shoqërimit nuk u konstatuan sende apo mjete të tilla që mund të shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve apo për kundërveprim ndaj punonjësve të policisë.

Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte asnjë person të shoqëruar në ambientet e këtij komisaritati. Në Komisariatin e Policisë nr.3, ambienti i sigurisë në tërësi nuk ishte i ndërtuar sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe siguri i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”. Ambienti i sigurisë ndodhej në katin e parë të ndërtesës të komisarariatit dhe kishte 3(tre) dhoma sigurie. Në zbatim të rekomandimeve të inspektimit të kryer nga CPT dhe Avokati i Popullit në vitin 2018, dy prej dhomave që nuk plotësonin parametrat teknikë dhe jetësor, nuk përdorreshin dhe ishin të mbyllura e të vulosura. Në funksion ishte vetëm një dhomë sigurie, që kishte kapacitet për mbajtjen dhe sigurimin e 2(dy) personave të ndaluar/arrestuar në moshë madhore. Ndërsa në rastin e ndalimit/arrestimit të personave femra dhe të mitur, në përfundim të veprimeve procedurale, ata dërgoheshin menjëherë në ambientin e sigurisë në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë. Pavarësisht masave për rikonstruksionin e këtij ambienti, dhomat e sigurisë nuk

⁹⁹ *Kreu VI, pika 3 e procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.*

plotësonin normat dhe parametrat teknikë dhe jetësorë për një person të arrestuar/ndaluar, pasi sipërfaqja e përgjithshme ishte më pak se 10 metra katrorë dhe jo e ndarë në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m² dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m².¹⁰⁰ Dritaret e dhomave ishin të vogla dhe nuk mundësonin futjen e sasisë së mjaftueshme të ajrit dhe dritës natyrale. Ndërkohë, ndriçimi sigurohej nga rrjeti elektrik në mënyrë të vazhdueshme. Dhoma e sigurisë që ishte në përdorim, ishte e pastër nga ana higjieno-sanitare, por kishte nevojë për lysterje dhe dezinfektim të vazhdueshëm. Pajisjet e dhomave të sigurisë me orenditë e nevojshme si krevatë, tavolina dhe karrige (stola), pothuajse mungonin fare. Në dhomën e sigurisë ndodhej vetëm një krevat dhe nëse kishte persona të tjerë, ata flinin me dyshekë të vendosur për tokë mbi një zagare druri. Furnizimi me materiale për fjetje, si batanie, jastek bëhej rregullisht dhe ishin në gjendje të mirë përdorimi. Gjate inspektimit, u konstatua se, në dhomat e sigurisë nuk kishte sende që shkaktojnë/eksponojnë dhunë psikologjike tek të ndaluarit/arrestuarit, apo që mund të përdoren si mjete për dhunimin fizik të këtyre personave. Në korridorin e ambientit të sigurisë ndodhej një tualet dhe të ndaluarit/arrestuarit kishin akses për larje e pastrim vetjak dhe ambjentit të dhomave. Ndërsa për larjen e trupit, në tualet ishte instaluar një dush me ujë të ngrohtë. Ambienti i sigurisë nuk kishte sistem ngrohje me kaldajë për dimër, por institucioni kishte siguruar pajisje elektrike për ngrohje. Në korridorin e ambientit të sigurisë nuk kishte aparat telefonik fiks për t'u përdoruar nga punonjësit e shërbimit në rastet e tentativave apo ngjarjeve të rënda me të ndaluarit/arrestuarit, për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje të shpejtë. Sikurse në dhoma, mungonte butoni me zile/sinjali, që personat e ndaluar/arrestuar të njoftojnë punonjësit e shërbimit në rast nevoje. Dhoma për kryerjen e vizitave nga mjeku ishte e përbashkët me dhomën për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të ndaluar/arrestuar nga prokurorët. Gjithashtu kjo dhomë përdorej edhe për takimin e të ndaluarve/arrestuarve me avokatët. Kjo dhomë ishte e pajisur me tavolinë dhe karrige, por mungonte krevati për kryerjen e vizitave mjekësore, si dhe rafti për ruajtjen e paketave të ilaçeve për rastet e emergjencave. Këto ambiente, nisur nga funksioni që ato kanë, duhet të jenë të ndara më vete, sikurse përcaktohet edhe në procedurat standarde. Komisariati kishte burim rezervë të energjisë, në rast ndërprerje të energjisë elektrike në ambientin e sigurisë dhe të shoqërimit.

Hyrja kryesore ambienteve të sigurisë, korridori i tij dhe hyrjet në dhomat e sigurisë monitoroheshin me sistemin e kamerave për 24 orë. Në Komisarlatin e Policisë nr. 3 Tiranë “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.306, datë 31.03.2016, për miratimin e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”. Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga kqyrja e këtij regjistri rezultoi se të gjitha rubrikat e tij ishin plotësuar me korrektesë dhe përgjegjësi nga punonjësit e zyrës së informacionit dhe ishte I sekretuar. Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Ndërsa të ndaluarit/arrestuarit që trajtoheshin e siguroheshin në ambientet e sigurisë në këtë komisarlat, të dhënat e tyre evidentoheshin në regjistrin e personave të ndaluar/arrestuar, i cili ishte i

¹⁰⁰ *Kreu V, pika 3.3 e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.*

sekretuar. Ky regjistër ishte i plotësuar me korrektësi në të gjitha rubrikat e tij. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë. Nga këqyrja e librave të evidentimit të personave të ndaluar/ arrestuar dhe procesverbaleve, nuk kishte mospërputhje mes kohës (orës) kur ishin ndaluar apo arrestuar, me orën e shënuar në procesverbalet e arrestimit në flagrancë. Ndërkohe, komisariati kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por për vitin 2019 nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë nga ana e këtyre personave. Në ambientin e sigurisë, mbaheshin edhe regjistrat dhe librat e tjerë sikurse janë të parashikuara në procedurën standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, të cilët ishin të plotësuar sipas rubrikave dhe ishin të sekretuar. Në kohën e inspektimit në ambientin e shoqërimit në Komisarlatin e Policisë nr. 3 Tiranë nuk kishte asnjë person të shoqëruar. Ndërsa në ambientin e sigurisë ndodhej vetëm një person i ndaluar, si person në kërkim. Grupi i monitorimit intervistoi personin ndaluar, i cili konfirmoi se ishte trajtuar në mënyrë korrekte gjatë kohës së marrjes në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore dhe qëndrimit në ambientin e sigurisë. Shtetasi i intervistuar kishte dijeni për identitetin e punonjësit të policisë me të cilin kishte marrë kontakt dhe kishte kryer veprimet procedurale. Ai deklaroi se, gjatë shoqërimit dhe ndalimit nga punonjësit e policisë, ata ishin identifikuar duke u prezantuar me gjeneralitetet dhe detyrën që kryenin. Nga i intervistuari nuk pati pretendime për trajtim denigrues, jo human apo për ushtrim dhune fizike e psikologjike. Gjendja psikologjike ishte e qetë dhe nuk dëshmonte për pasoja të shkaktuara nga keqtrajtimi. Koha e qëndrimit të personit të shoqëruar dhe i ndaluar në ambientin e sigurisë ishte brenda afatit ligjor të parashikuar në Kodin e Procedurës Penale. Nga informacioni i dhënë nga punonjësit e policisë që shërbenin në dhomat e sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar rezultoi se të ndaluarit/arrestuarit trajtoheshin me ushqim tre herë në ditë me shërbim katering, sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në urdhrin e përbashkët nr. 432, datë 10.03.2008 të Ministrisë të Brendshme dhe Ministrisë të Shëndetësisë. Ndonëse në ambientin e sigurisë nuk kishte ambiente kulturi, të ndaluarve/arrestuarve që dëshironin u lejohej ushtrimi i riteve fetare brenda dhomave të sigurisë ose në ambientin e ajrimit. Të ndaluarve/arrestuarve iu jepeshin produkte për mbajtjen e higjienës vetjake dhe të ambientit dhomave si sapun, detergjente, letra higjienike dhe letra për fshirjen e duarve dhe të fytyrës. Në ambientin e sigurisë të Komisarlatit të Policisë nr. 3 Tiranë kishte një dhomë që shërbente për marrjen në pyetje të shtetasve të ndaluar/arrestuar nga përfaqësuesit e organit të prokurorisë, njëkohësisht dhe për takime me avokatët. Dhoma ishte e pajisur me tavolinë dhe karrige me këmbë të fiksuara në dysheme, dritarja ishte e siguruar me rrjetë hekuri, por që nuk monitorohej me sistemin audio-viziv të kamerave. Ndërsa shtetasit e shoqëruar në mjediset e policisë, para se tu komunikohesh masa e sigurisë dhe të kalonin në ambientet e sigurisë, intervistoheshin nga oficerët e policisë gjyqësore në zyrat e punës së tyre. Zyrat e punonjësve të policisë, në mungesë të ambienteve të veçanta të hetimit, nuk ishin të monitoruara me sisteme e kamerave gjatë kryerjes së veprimeve procedural nga ana e tyre. Avokati i Popullit e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e

të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit ndaj tyre, por konstatohet se ky rekomandim nuk është plotësuar¹⁰¹. Nga monitorimi që u bë zyrave të oficerëve të policisë gjyqësore, nuk u gjetën sende prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Në këtë Komisarariat ishte krijuar një magazinë për administrimin dhe ruajtjen e provave materiale. Në Komisarariat e Policisë nr.3, zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse. Nga inspektimi, rezultoi gjithashtu se, ndaj personave të shoqëruar nga punonjësi i policisë mbahej një procesverbal tip i emërtuar “Formulari i raportit të Shoqërimit ose Ndalimit/Arrestimit”. Njëkohësisht u konstatua se, zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenet 34/b, pika 2 dhe 251 të K.Pr.P, që personit të ndaluar/arrestuar duhet t’i jepet dhe të mbajë me vete një kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit. Gjatë inspektimit u konstatua se, personat e ndaluar/arrestuar madhor ishin të njoftuar që në mungesë të mundësive financiare për të pajtuar një avokat privat, të kërkonin ndihmë juridike për t’ju ofruar një avokat kryesisht. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, e cila ishte e afishuar në ambientin e punës të përgjegjësit të dhomave të sigurisë. Gjatë inspektimit u konstatua se, në korridorin e ambienteve të sigurisë dhe të shoqërimit në Komisarariat e Policisë nr. 3 Tiranë ishin të afishuara postera me të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar, si dhe atyre të shoqëruar. Ndërsa për shtetasit e huaj të ndaluar/arrestuar, ishin përgatitur deklaratat me të drejtat e të ndaluarve/arrestuarve në 9-të gjuhë të huaja, si anglisht, frëngjisht, italisht, greqisht, gjermanisht, maqedonisht, serbisht, sllovenisht dhe rome. Ndërsa në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës, kujdestarit ligjor dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve e dërguar nga organi i prokurorisë, e cila ishte e afishuar në ambientin e sigurisë, lista e avokatëve dhe numrat e telefonave të tyre. Ndërsa psikologu ofrohej nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë. Personave të ndaluar/arrestuar iu jepeshin nga oficerët e policisë gjyqësore kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit, të kontrollit personal dhe të letrës me të drejtat e tyre. Informacioni i dhënë nga punonjësit e policisë u konfirmua edhe nga intervista me personin që ndodhej në ambientin e sigurisë gjatë kryerjes së inspektimit. Grupi i inspektimit konstatoi gjithashtu se, vizitat mjekësore të personave të arrestuar/ndaluar bëheshin nga ana e mjeku/ndihmësmjeku i Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë brenda afatit 12 orësh nga momenti i vendosjes së këtyre personave në këtë ambient, sikurse përcaktohet në procedurën standarde për trajtimin e personave të ndaluar/arrestuar.¹⁰²

¹⁰¹ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

¹⁰² Kreu V, pika 7.2 e procedurës standarde për trajtimin e personave të ndaluar/arrestuar.

Mjeku ishte i punësuar pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë me kohë të plotë. Ai i pasqyronte konstatimet, rekomandimet dhe mjekimet e dhëna gjatë vizitave mjekësore për të ndaluar/arrestuarit, në regjistrin e vizitave mjekësore. Po ashtu, ai hapte kartelat mjekësore (kartelat ditore) të tyre, të cilat i vendoste në fashikullin përkatës për çdo të ndaluar/arrestuar. Gjithashtu në këtë Komisarariat kishte edhe regjistër për evidentimin e ankesave dhe kërkesave të personave të ndaluar/arrestuar dhe të shoqëruar. Nga verifikimi tij rezultoi se, për vitin 2019 nuk ishte regjistruar asnjë ankesë apo kërkesë nga personat e ndaluar/arrestuar dhe të shoqëruar. **Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime:** Marrjen e masave të nevojshme në Komisarariat e Policisë nr.3 Tiranë, deri në ndërtimin e godinës/bllokut më vete të dhomave të sigurisë për strukturat e DVP Tiranë, për sigurimin e kushteve të përshtatshme për qëndrim dhe jetesë normale të shtetasve të arrestuar/ndaluar, duke i pajisur me krevat më vete personat e ndaluar/arrestuar, si dhe lyerjen e dezinfektimin e vazhdueshëm të ambientit të sigurisë. Marrjen e masave të nevojshme, për ndërtimin të ambienteve të shoqërimit sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, të ndara më vete për të rritur, femra dhe të mitur. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave të përshtatshme ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra. Marrjen e masave për krijimin e zyrës të posaçme për intervistim e personave të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm dhe plotësuar me atë me pajisjet e nevojshme, për zhvillimin e bisedave/intervistave me fëmijët në konflikt me ligjin.

6.18. KOMISARIATI I POLICISË NR.4 TIRANË

MKPT, kreu një inspektim në Komisarariat e Policisë Nr.4, Tiranë në datën 06.12.2019. Avokati i Popullit vitin e kaluar, lidhur me përmirësimin e kushteve sipas procedurave standarde të ambienteve të shoqërimit të këtij komisarati. Drejtuesi i Komisarariatit gjithashtu angazhoi punonjësit e këtij institucioni që ishin prezent për të bashkëpunuar dhe për të shërbyer në vijim të procesit të inspektimit. Nga informacioni i grumbulluar në vend gjatë kryerjes së inspektimit, rezultoi se: Gjendja e ambienteve të shoqërimit për të rritur, nuk kishte ndryshuar nga inspektimet e mëparshme që ka zhvilluar institucioni i Avokatit të Popullit. Ishte zbatuar pjesërisht rekomandimi për krijimin e dhomave të shoqërimit për femra dhe të mitur, por këto ambiente ishin të përshtatura dhe jo dhoma të ndërtuara sipas standardeve të përcaktuara dhe urdhrin të drejtorit të përgjithshëm të policisë. *Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, dhe në “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.306, datë 31.03.2016 . Grupi i punës në vijim inspektoi ambientet e shoqërimit, zyra e punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar. Gjithashtu u verifikua nëse për personat e shoqëruar aplikoheshin pajisja e tyre me “Procesverbalin e Shoqërimit”, ku rezultoi se ky standard ligjor realizohej për të gjithë shtetasit e shoqëruar. Gjatë inspektimit u konstatua se, në komisarariat e policisë nr.4 kishte 1(një) dhomë shoqërimi për persona të rritur, 1(një) ambient i përshtatur në katin e parë për të mitur dhe 1(një) të*

përshtatur për femra. Në këtë komisariat nuk ka ambiente sigurie për personat e ndaluar/arrestuar në zbatim të Ligjit Nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, në “Rregullat dhe Procedurat Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Nr.925, datë 18.07.2019¹⁰³, “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, dhe në “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.306, datë 31.03.2016, në të cilat specifikohen kushtet e ambienteve dhe procedurat në rastet e shoqërimit dhe ndalim/arrestimit të shtetasve. Në përfundim të inspektimit grupi monitorues konstatoi se, në ambientet aktuale në Komisarlatin e Policisë nr.4 në Tiranë, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika dhe konkretisht: Nga informacioni i grumbulluar në vend gjatë kryerjes së inspektimit, rezultoi se gjendja konkrete e ambienteve të shoqërimit ishte e ngjashme si në inspektimin pararendës, ballafaquar me standardet e parashikuara në aktet normative dhe dokumentet ndërkombëtare, për respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar brenda këtyre ambienteve. Në Komisarlatin e Policisë Nr.4 ambienteve të shoqërimit të tërësi nuk ishin të ndërtuara sipas parashikimeve të bëra në ligjin Nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe në procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.306, dt. 31.03.2016. Nga këto ambiente 1(një) dhomë shoqërimi për persona madhorë meshkuj ishte me hapësirë të bollshme për qëndrim, por theksojmë se ajo ishte me lagështirë i mungonin tavolina dhe karriget, në këtë dhomë kishte vetëm një stol. Dy dhomat e tjera për femra dhe të mitur, ishin të pastra, dhe të lyera rishtas dhe ishin të pajisura me orenditë e nevojshme, si tavolinë dhe karrige për qëndrimin ulur me¹⁰⁴ kushte për trajtim dinjitoz të të shoqëruarve, por ato nuk ishin zyra të ndërtuara sipas standardit të kërkuar pasi nuk kishin hapësirën e duhur. Në këtë komisariat të 3 (tre) dhomat e shoqërimit, të cilat ndodheshin në katin e parë të ndërtesës së këtij komisariati, kishin dritare të cilat lejonin ajrimin dhe ndriçimin natyral, si dhe kishin ndriçim nga rrjeti elektrik, dhomat kishin edhe burim rezervë energjie me gjenerator. Dhoma e shoqërimit nuk kishin tualet brenda, për të shoqëruarit tualetet, ndodheshin në korridorin e ambientit të shoqërimit. Në këtë komisariat kishte sistem monitorimi me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit të ambientit të shoqërimit. Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar. Në Komisarlatin e Policisë Nr.4 nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë. Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisarlatin e Policisë Nr.4, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform me procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar. Të gjithë personat e shoqëruar në

¹⁰³ Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Nr.925, datë 18.07.2019.

¹⁰⁴ CPT rithekson rekomandimin e tij që autoritetet shqiptare të rikujtojnë para të gjithave, oficerëve të policisë detyrimin ligjor për t'iu dhënë një avokat (i cili përfshin të drejtat për të folur me avokatin në mënyrë private dhe për ta prezantuar atë / saj gjatë marrjes në pyetje) që nga fillimi i një privimi të lirisë për personin

organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrimit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë¹⁰⁵. Për rrjedhojë u konstatua se ishte plotësuar standardi për pasqyrimin me saktësi dhe përgjegjësi të rubrikave të librit të shoqërimit nga punonjësit e policisë të zyrës së informacionit. Në këtë komisariat kishte regjistër për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Ky regjistër ishte i plotësuar me korrektesë në të gjitha rubrikat e tij. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë. Ndërkohë u konstatua se në këtë komisariat kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por nuk ishte evidentuar asnjë ankesë apo kërkesë për vitin 2019. Në Komisaratin e Policisë Përmet oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta intervistimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore. Lidhur me këtë fakt Avokati i Popullit nisur edhe nga inspektimi i mëparshëm ka rekomanduar marrjen e masave për krijimin e zyrave të dedikuara ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra por është konstatuar se sërish rekomandimi nuk është plotësuar¹⁰⁶. Avokati i Popullit, duke iu referuar standardeve ndërkombëtare, e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit. Nga monitorimi që u bë në disa prej zyrave të punonjësve të policisë, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat. Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, ndërsa psikologu sigurohej nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Tiranë. Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e godinës dhe të ambientit të shoqërimit ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin

¹⁰⁵ *Kreu VII, Procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt.*

31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit

¹⁰⁶ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohej që të regjistrohen në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluarit gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.”

CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar. Ndërkohë u konstatua se në këtë komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse. Edhe në nenet 34/b. pika 2 dhe 251 të K.Pr.P parashikohet se të ndaluarit/arrestuarit duhet t’i jepet dhe të mbajë me vete një kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit. Rezultoi se ndaj personave të shoqëruar nga punonjësi i policisë mbahej një procesverbal tip i emërtuar “Formulari i raportit të Shoqërimit ose Ndalimit/Arrestimit”. Përfundimisht theksojmë se problematikat e evidentuara gjatë këtij inspektimi janë trajtuar edhe në rekomandimet e mëparshme drejtuar institucionit të Komisarariatit të Policisë Nr.4 dhe për rrjedhojë në vijim do të vazhdojmë të kërkojmë informacion lidhur me plotësimin e tyre. **Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime:** Marrjen e masave të menjëhershme për ndërtimin e ambienteve të shoqërimit, sipas kushteve dhe kritereve të parashikuara në procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur. Marrjen e masave për eliminimin e lagështirës pothuajse në të gjithë ambientet të Komisarariatit. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e ambienteve të përshtatshme ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore. Marrjen e masave të nevojshme për instalimin e një sistemi të monitorimit me kamera në zyrat ku merren në pyetje shtetasit e shoqëruar.

6.19. KOMISARIATI I POLICISË SHIJAK

MKPT kreu inspektim në datën 12.06.2019 sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Grupi i monitorimit, në vijim inspektoi ambientet e shoqërimit, zyrat e punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar. Gjatë kryerjes së inspektimit, rezultoi se gjendja e ambientit të shoqërimit ishte e njëjtë si në inspektimin e mëparshëm, referuar rekomandimeve të lëna nga Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vizitës inspektuese në vitin 2016. Situata e gjendjes të dhomave të shoqërimit paraqitej e mirë dhe ishte në përputhje me rregullat teknike të shoqërimit të personave në mjediset e policisë. Ndërkohë, ngelet si problematikë nga vitet e mëparshme, mungesa e instalimit të sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi të korridorit në dhomat e shoqërimit. Në përfundim të inspektimit grupi monitorues konstatoi se, megjithëse në Komisariatin e Policisë Shijak ishin marrë disa masa për përmirësimin e standardeve lidhur me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe të personave të arrestuar/ndaluar, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika dhe më konkretisht: Në Komisariatin e Policisë Shijak ambientet e shoqërimit ishin të ndërtuara sipas parashikimeve të bëra në Ligjin Nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe në procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.306, dt. 31.03.2016. Në këtë komisariat kishte 3 (tre) dhoma shoqërimi, të cilat ndodheshin në katin e parë të një ndërtesë brenda territorit të këtij organi, në hyrjen e tij. Dhomat e shoqërimit ishin të ndara më

vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të mitur¹⁰⁷, duke krijuar kushte për trajtim të përshtatshëm të shoqëruarve. Këto ambiente ishin me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, kishin dritare të cilat lejonin ajrimin dhe ndriçimin natyral, si dhe kishin ndriçim nga rrjeti elektrik. Ato ishin të pastra, dhe të lyera dhe ishin të pajisura me orenditë e nevojshme, si tavolinë dhe karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar. Në korridorin e ambientit të shoqërimit ndodheshin dy tualete, të pajisura me pajisjet e nevojshme, si dhe çezmë me ujë të rrjedhshëm, të ndara më vete për femra dhe meshkuj. Gjithashtu komisariati kishte gjenerator për furnizimin me energji elektrike në rast defektesh të sistemit elektrik. Në këtë komisariat mungonte sistemi i monitorimit me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe ambientit të shoqërimit. Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar dhe për rrjedhojë nuk u realizuan intervistime lidhur me trajtimin që u bëhet personave nga ana e punonjësve të policisë. Në Komisaratin e Policisë Shijak nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar pasi rregjistroheshin në regjistër, dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisarimit të Policisë Durrës. Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisaratin e Policisë Shijak, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform me parashikimin në procedurat standarte: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar. Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrimit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë¹⁰⁸. Në këtë komisariat kishte regjistër për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë. Ndërkohë u konstatua se në këtë komisariat kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por nuk ishte evidentuar asnjë ankesë apo kërkesë. Në Komisaratin e Policisë Shijak specialistët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e punës së tyre, pasi nuk kishte një ambient të veçantë për kryerjen e veprimeve hetimore. Gjithashtu, Komisarati i Policisë Shijak nuk posedon hapësirë të posaçme për biseda apo intervistoma me fëmijët e mitur. Mekanizmi Kombëtar e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se bisedat me fëmijët duhet të realizohen në një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave, pasi nga intervistimi i tyre në zyrat e punës të specialistëve të policisë, mund të shkaktohet traumatizim plotësues i fëmijëve. Lidhur me këto fakte Institucioni i Avokatit të Popullit nisur edhe nga inspektimi i mëparshëm ka rekomanduar marrjen e masave për krijimin e zyrave të dedikuara ku merren në pyetje shtetasit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore, madje dhe

¹⁰⁷ Kreu VI, pika 3 e procedurave standarde.

¹⁰⁸ Kreu VII, Procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit

instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, por konstatojmë se sërish ky rekomandim nuk është plotësuar¹⁰⁹. Avokati i Popullit, duke iu referuar standardeve ndërkombëtare, e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit. Nga monitorimi që u krye zyra të punës të punonjësve të policisë në këtë komisarariat nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat. Punonjësit e policisë pasqyruar për grupin e inspektimit se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë. Ndërsa psikologu sigurohej nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës por dhe në bashkëpunim me shkollën e mesme të qytetit të Shijak. Gjatë verifikimit të regjistrave të personave të shoqëruar u konstatua se procedura e ndjekur nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Shijak ishte zhvilluar konform ligjit. Gjatë inspektimit u konstatua se në korridorët e godinës dhe të ambientit të shoqërimit si dhe në dhomat e shoqërimit të këtij komisaritati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar. Ndërkohë u konstatua se në këtë komisarariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në Nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit të çështjes përkatëse. Rezultoi se ndaj personave të shoqëruar nga punonjësi i policisë mbahej një procesverbal tip i emërtuar “Formulari i raportit të Shoqërimit ose Ndalimit/Arrestimit”. U evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme ku në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë, mbaheshin procesverbalet përkatëse ku një kopje e të cilit firmosej dhe i jepej personit të shoqëruar. **Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime:** Marrjen e masave të nevojshme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera për vëzhgimin e korridorit në ambientin e shoqërimit. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e një ambienti të përshtatshëm ku intervistohen/merren në pyetje shtetasit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga specialistët dhe punonjësit e policisë.

6.20. KOMISARIATI I POLICISË PEQIN

¹⁰⁹ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkësë të bërë nga i ndaluarit gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.”

CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

MKPT kreu inspektim në datën 08.03.2019, sipas një Plani Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Nga informacioni i grumbulluar në vend gjatë kryerjes së inspektimit rezultoi se, gjendja faktike e ambientit të shoqërimit ishte e njëjtë si në inspektimin e mëparshëm, krahasuar me standardet e parashikuara në aktet normative dhe dokumentet ndërkombëtare, për respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar, arrestuar/ndaluar brenda këtyre ambienteve. Grupi i inspektimit, konstatoi se ishte zbatuar rekomandimi i institucionit të Avokatit të Popullit i bërë pas inspektimit të kryer në këtë Komisarariat në vitin 2017 për afishimin e listës së avokatëve në ambientet ku kanë akses personat e shoqëruar, arrestuar/ndaluar. Ndërkohë konstatoi se nuk ishin zbatuar rekomandimet e bëra për marrjen e masave për lëvizimin e fondeve për investime në këtë komisarariat dhe kryesisht në instalimin e sistemit të monitorimit me kamera audio-vizive, si dhe për krijimin e zyrave të intervistimit ku merren në pyetje personat e arrestuar/ndaluar, para se të dërgohen në ambientet e sigurisë pranë DVP Elbasan dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto ambiente. Sipas Shefit të Komisarariatit këto dy rekomandime nuk ishin zbatuar për shkak të mungesës së fondeve financiare, të cilat administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Në përfundim të inspektimit grupi inspektues konstatoi se, megjithëse në Komisariatin e Policisë Peqin, ishin marrë disa masa për përmirësimin e standardeve lidhur me kushtet materiale dhe të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika dhe më konkretisht: Në Komisariatin e Policisë Peqin, ambienti i shoqërimit ishte i ndërtuar sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.306, datë 31.03.2016. Grupi i inspektimit konstatoi se, në ambientin e shoqërimit ndodheshin 3 (tre) dhoma shoqërimi, nga të cilat 1 (një) dhomë për shoqërimin, mbajtjen dhe trajtimin e personave në mjediset e Komisarariatit të Policisë për personat e rritur, 1 (një) për femrat dhe 1 (një) për të miturit. Ambienti i dhomave të shoqërimit ishte me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrimin dhe trajtimin e të shoqëruarve, duke krijuar kushte për trajtim dinjitoz dhe garantimin e të drejtave që iu njej ligji këtyre personave. Dhomat e shoqërimit kishin dritare të cilat lejonin ajrimin dhe ndriçimin natyral, si dhe kishin ndriçim nga rrjeti elektrik. Ato ishin të lyera, të pastra nga ana higjienike dhe ishin të pajisura me orenditë e nevojshme, si tavolinë dhe karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar. Në korridorin e ambientin të shoqërimit ndodhej tualeti në të cilin kishte ujë të rrjedhshëm në mënyrë të vazhdueshme dhe pa ndërprerje. Nga inspektimi rezultoi gjithashtu se, në këtë Komisarariat mungonte dhoma për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar. Gjithashtu u konstatua se nuk kishte sistem monitorimi me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe ambientit të shoqërimit. Sipas informacionit të Shefit të Komisarariatit, pyetja e personave të shoqëruar kryhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë të këtij komisaritati. Mungesa e sistemit të monitorimit dhe e dhomës për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar, mund të përbëjë shkak për përdorimin e mjeteve dhe metodave jo të përshtatshme për shoqërimin, mbajtjen dhe trajtimin e personave në mjediset e policisë, si dhe për respektimin dhe garantimin e të drejtave që ju njej ligji këtyre personave. Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar dhe për rrjedhojë nuk u mundësua realizimi i intervistimeve lidhur me trajtimin që u bëhet personave nga ana e punonjësve të policisë. Në Komisariatin e Policisë Peqin nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar

dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Elbasan. Gjatë inspektimit u konstatua se, në Komisariatin e Policisë Peqin, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar”, ishte i tipit “Model nr.1”, konform procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar. Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga kqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrimit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë¹¹⁰. Në këtë komisarariat kishte regjistër për personat e arrestuar/ndaluar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e arrestimeve dhe ndalimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë. Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisarariat kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por nuk ishte evidentuar asnjë ankesë apo kërkesë. Në Komisariatin e Policisë Peqin oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e tyre të punës. Këto ambiente nuk ishin të monitoruara me kamera për vëzhgimin gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore. Lidhur me këtë fakt, Avokati i Popullit nisur edhe nga inspektimi i mëparshëm ka rekomanduar marrjen e masave për krijimin e zyrave të veçanta ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, por sikurse u përshkrua edhe më sipër, ky rekomandim nuk është zbatuar ende.

Avokati i Popullit, duke iu referuar standardeve ndërkombëtare¹¹¹, e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit. Nga monitorimi që u bë në disa prej zyrave të punonjësve të policisë, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të arrestuarit/ndaluarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të marrë avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat. Në rastet kur të arrestuarit/ndaluarit ishin të mitur, ata shoqëroheshin për në ambientet e sigurisë të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, për kryerjen e veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore të seksionit

¹¹⁰ Kreu VII, Procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.

¹¹¹ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

për të miturit dhe në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i Prokurorisë Elbasan, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, e cila ishte e afishuar në ambiente të dukshme dhe të aksesueshme. Ndërsa psikologu sigurohej në bashkëpunim me Shkollat e Mesme të qyteteve Peqin dhe Elbasan. Gjatë inspektimit u konstatua se, në korridorin e godinës dhe ambientit të shoqërimit, si dhe në dhomat e shoqërimit të këtij komisariati, ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të arrestuar/ndaluar. Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisarjat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit të çështjes përkatëse.

Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime: Marrjen e masave të menjëhershme për ndërtimin e dhomës për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar dhe të dhomave të intervistimit të personave të arrestuar/ndaluar nga oficerët e policisë gjyqësore. Marrjen e masave të nevojshme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në korridorin e ambientit të shoqërimit dhe në dhomat e marrjes në pyetje/intervistimit të shtetasve të shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar.

6.21. KOMISARIATI I POLICISË PËRMET

MKPT kreu inspektim në datën 18.07.2019, sipas një Plani Inspektimi të miratuar më parë nga Avokati i Popullit. Grupi inspektues, pasi mori informacionin e nevojshëm lidhur me qëllimin e inspektimit, vijoi takimin me përkatësisht me punonjësit e policisë të zyrës së informacionit dhe të dhomave të shoqërimit. Grupi i punës në vijim inspektoi ambientet e shoqërimit, disa zyra të punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar. Nga informacioni i grumbulluar në vend gjatë kryerjes së inspektimit, rezultoi se gjendja faktike e ambientit të shoqërimit kishte disa ndryshime në krahasim me një vit më parë, duke patur parasysh standardet e parashikuara në aktet normative dhe dokumentet ndërkombëtare, për respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar brënda këtyre ambienteve dhe duke zbatuar pjesërisht rekomandimin e Avokatit të Popullit dërguar pas inspektimit të bërë në vitin 2018. Konkretisht: Ishte plotësuar rekomandimi për marrjen e masave të nevojshme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhguese në korridorin e ambientit të shoqërimit. Por nuk ishte plotësuar rekomandimi për marrjen e masave të nevojshme për krijimin e ambienteve të përshtatëshme ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra. Në përfundim të inspektimit grupi monitorues konstatoi se, megjithëse në Komisarjatin e Policisë Përmet ishin marrë disa masa për përmirësimin e standardeve lidhur me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe të personave të arrestuar/ndaluar, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika dhe më konkretisht: Në Komisarjatin e Policisë Përmet ambientet e shoqërimit ishin të ndërtuara sipas parashikimeve të bëra në ligjin Nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe në Aktin për procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm

të Policisë së Shtetit Nr.306, dt. 31.03.2016. Këto ambiente ishin me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të mitur,¹¹² duke krijuar kushte për trajtim dinjitoz të të shoqëruarve. Në këtë komisariat kishte 3 (tre) dhoma shoqërimi, të cilat ndodheshin në katin e parë të ndërtesës së këtij komisariati. Dhomat e shoqërimit kishin dritare të cilat lejonin ajrimin dhe ndriçimin natyral, si dhe kishin ndriçim nga rrjeti elektrik. Ato ishin të pastra, dhe të lyera rishtas dhe ishin të pajisura me orenditë e nevojshme, si tavolinë dhe karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar. Dhomat kishin edhe burim rezervë energjie me gjenerator. Dhoma e shoqërimit të femrave kishte tualet brenda, ndërsa për të shoqëruarit meshkuj kishte një tualet, i cili ndodhej në korridorin e ambientit të shoqërimit. Në këtë komisariat kishte sistem monitorimi me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe ambientit të shoqërimit. Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar. Në Komisarlatin e Policisë Përmet nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisarlatit të Policisë Gjirokastrë. Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisarlatin e Policisë Përmet, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform me procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar. Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se: Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë¹¹³. Për rrjedhojë u konstatua se ishte plotësuar standardi për pasqyrimin me saktësi dhe përgjegjësi të rubrikave të librit të shoqërimit nga punonjësit e policisë të zyrës së informacionit. Në këtë komisariat kishte regjistër për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Ky regjistër ishte i plotësuar me korrektësi në të gjitha rubrikat e tij. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë. Ndërkohë u konstatua se në këtë komisariat kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por nuk ishte evidentuar asnjë ankesë apo kërkesë. Në Komisarlatin e Policisë Përmet oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e punës së tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta intervistimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore. Lidhur me këtë fakt Avokati i Popullit nisur edhe nga inspektimi i mëparshëm ka rekomanduar marrjen e masave për krijimin e zyrave të dedikuara ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra por

¹¹² Kreu VI, pika 3 e procedurave standarde.

¹¹³ Kreu VII, Procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit

është konstatuar se sërish rekomandimi nuk është plotësuar¹¹⁴. Avokati i Popullit, duke iu referuar standardeve ndërkombëtare, e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit. Nga monitorimi që u bë në disa prej zyrave të punonjësve të policisë, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat. Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë. Ndërsa psikologu sigurohej në bashkëpunim me shkollat e mesme të qytetit të Përmetit. Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e godinës dhe të ambientit të shoqërimit si dhe në dhomat e shoqërimit të këtij komisariati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar. Ndërkohë u konstatua se në këtë komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit e çështjes përkatëse. Edhe në nenet 34/b, pika 2 dhe 251 të K.Pr.P parashikohet se të ndaluarit/arrestuarit duhet t’i jepet dhe të mbajë me vete një kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit. Rezultoi se ndaj personave të shoqëruar nga punonjësi i policisë mbahej një procesverbal tip i emërtuar “Formulari i raportit të Shoqërimit ose Ndalimit/Arrestimit”. Përfundimisht theksojmë se problematikat e evidentuara gjatë këtij inspektimi janë trajtuar edhe në rekomandimet e mëparshme drejtuar institucionit të Komisarariatit të Policisë Përmet dhe për rrjedhojë në vijim do të vazhdojmë të kërkojmë informacion lidhur me plotësimin e tyre. **Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime:** Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e ambienteve të përshtatëshme ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore. Marrjen e masave të nevojshme për instalimin e një sistemi cilësor të monitorimit me kamera në zyrat ku merren në pyetje shtetasit e shoqëruar. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave të posaçme për intervistim me persona të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.

6.22. KOMISARIATI I POLICISË POGRADEC

¹¹⁴ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohej që të regjistrohen në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluarit gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.”

CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

MKPT kreu inspektim në datën 25.09.2019, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Grupi i inspektimit, pasi mori informacionin e nevojshëm vijoi takimin me punonjësit e policisë që shërbenin në zyrën e informacionit dhe në dhomat e shoqërimit. Theksojmë se, drejtuesi i Komisarariatit dhe punonjësit e policisë u treguan bashkëpunues dhe transparentë gjatë komunikimit dhe inspektimit, që zhvilloi grupi inspektues në ambientet e këtij Komisaritati. Grupi i inspektimit, në vijim inspektoi ambientet e shoqërimit, zyrat e punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar. Nga informacioni dhe verifikimi në vend masave të marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit, rezultoi se: Nuk ishte plotësuar rekomandimi për ndërtimin dhe vënien në funksion të ambienteve të shoqërimit në Komisariatin e Policisë Pogradec, sipas kërkesave të parashikuara në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, të ndara më vete për personat e rritur, femrat, dhe të miturit. Gjithashtu, nuk ishte plotësuar rekomandimi për krijimin e zyrave të përshtatshme ku merren në pyetje/intervistohen shtetasit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga specialistët dhe ndihmës specialistët e policisë, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra dhe në korridorin e ambientit të shoqërimit. Drejtuesi i Komisarariatit të Policisë Pogradec, vuri në dispozicion të grupit të inspektimit, projektin me relacionin dhe preventivin e punimeve për “Rikonstruksionin e pjesshëm të godinës dhe ambienteve të shoqërimit të këtij institucioni”, dërguar me shkresë Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë të Shtetit¹¹⁵ prej vitit 2018, por ende dhe sot nuk janë siguruar fondet buxhetore për realizimin e këtij projekti. Në përfundim të inspektimit grupi monitorues konstatoi se, megjithëse në Komisariatin e Policisë Pogradec ishin marrë disa masa për përmirësimin e standardeve lidhur me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe të personave të arrestuar/ndaluar, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika si më poshtë vijon: Në Komisariatin e Policisë Pogradec ambienti i shoqërimit nuk ishte i ndërtuar sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe në procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 306, dt. 31.03.2016, ku thuhet se, “...mjediset/ambientet (e shoqërimit) të jenë të ndara më vehte për persona të rritur, femra dhe të mitur....Mjediset të jenë me sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme për qëndrimin e personave”.¹¹⁶ Në këtë Komisariat kishte vetëm një dhomë shoqërimi, e cila ndodhej në një ndërtesë 1(një) katëshe brenda territorit të këtij organi e ndarë nga godina e Komisarariatit. Dhoma kishte një dritare, e cila lejonte ajrim dhe ndriçim natyral, si dhe kishte ndriçim nga rrjeti elektrik. Dhoma e shoqërimit ishte e pastër dhe e lysterishtë dhe ishte e pajisur me orënditë e nevojshme, si tavolinë dhe karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar. Dhoma e shoqërimit nuk kishte sistem ngohje. Në rastet kur shoqëroheshin femra dhe të mitur, ata mbaheshin në zyrat e punës të punonjësve të policisë, deri në përfundim të procedurave të verifikimit dhe intervistimit e

¹¹⁵ Shkresa, Nr.320,Prot datë 17.01.2018, Lënda “Dërgohen rekomandime pwr inspektimin e bërë në Komisariatin e Policisë Pogradec”. Shkresa Nr.3571,Prot datë 27.07.2018, Lënda “Informacion mbi gjëndjen e dhomave të shoqërimit

¹¹⁶ Kreu VI, pika 3 e procedurave standard “Rregullat teknike tw shoqwrimit nw Polici”..

tyre. Në korridorin e ambientit të shoqërimit ndodhej një tualet, e cila përdorej nga personat e shoqëruar. Komisariati i Policisë, kishte burim rezervë energjie me gjenerator, për rastet e ndërprerjes të energjisë elektrike. Në këtë Komisarjat nuk kishte sistem monitorimi me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe ambientit të shoqërimit. Gjatë kohës së kryerjes së inspektimit, nuk kishte persona të shoqëruar. Në Komisarjatin e Policisë Pogradec nuk kishte ambiente të sigurisë. Personat e arrestuar/ndaluar pasi evidentoheshin në regjistrin përkatës, dërgoheshin menjëherë në dhomat e sigurisë të Komisarjatisë të Policisë Korçë. Në Komisarjatin e Policisë Pogradec u konstatua se, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr.1” konform procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar. Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se: Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë. Në këtë Komisarjat kishte regjistër për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga verifikimi i këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë. Gjithashtu u konstatua se, në këtë Komisarjat kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në Nenin 115 të Ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por për vitin 2019 nuk ishte evidentuar asnjë ankesë apo kërkesë. Në Komisarjatin e Policisë Pogradec, specialistët dhe ndihmës specialistët e policisë i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e punës së tyre, pasi nuk kishte ambiente të veçanta hetimi të monitoruara me sistemin e kamerave. Edhe zyra e specialistëve të policisë, nuk ishin të monitoruara me sistemin e kamerave. Institucioni i Avokatit të Popullit, duke iu referuar standardeve ndërkombëtare, e konsideron procesin e monitorimit filmik, një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.¹¹⁷ Nga monitorimi i zyrave të punonjësve të policisë, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Grupi i inspektimit, në mungesë të personave të shoqëruar, intervistoi punonjësit e policisë, ku rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat. Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht, përfaqësuesit ligjor dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin

¹¹⁷ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohej që të regjistrohen në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluarit gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë. Ndërsa psikologu, sigurohej nga Bashkia Pogradec ose nga shkolla e mesme e qytetit të Pogradecit. Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisarariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në Nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse¹¹⁸. Gjatë inspektimit u konstatua se në korridorët e godinës dhe të ambientit të shoqërimit si dhe në dhomat e shoqërimit të këtij Komisaritati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar.

Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime: Marrjen e masave të nevojshme për realizimin e investimit për ndërtimin dhe vënien në funksion të ambientit të shoqërimit në Komisarlatin e Policisë Pogradec sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe të procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, të ndara më vete për personat e rritur, femrat dhe të miturit, duke krijuar mjedise të përshtatshme dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrimin ulur të personave, si dhe të monitoruara me kamera. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave të përshtatshme për marrjen në pyetje/intervistimin e shtetasve gjatë kryerjes së veprimeve proceduriale nga oficerët e policisë gjyqësore, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në mjediset e brendshme të Komisariatit, kryesisht në korridorin e ambientit të shoqërimit.

6.23. KOMISARIATI I POLICISË SHIJAK

MKPT kreu inspektim në datën 12.06.2019 sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Grupi inspektues, pasi mori informacionin e nevojshëm lidhur me qëllimin e inspektimit, shoqëruar nga drejtuesi i Komisariatit, vijoi takimin me punonjësin e policisë të zyrës së informacionit dhe inspektoi kushtet e dhomave të shoqërimit. Theksojmë se, të gjithë punonjësit e policisë me të cilët kontaktuam u treguan bashkëpunues gjatë komunikimit dhe inspektimit, që zhvilloi grupi inspektues në ambientet e këtij komisaritati. Grupi i monitorimit, në vijim inspektoi ambientet e shoqërimit, zyrat e punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar. Gjatë kryerjes së inspektimit, rezultoi se gjendja e ambientit të shoqërimit ishte e njëjtë si në inspektimin e mëparshëm, referuar rekomandimeve të lëna nga Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vizitës inspektuese në vitin 2016. Situata e gjendjes të dhomave të shoqërimit paraqitej e mirë dhe ishte në përputhje me rregullat teknike të shoqërimit të personave në mjediset e policisë. Ndërkohë, ngelet si problematikë nga vitet e mëparshme, mungesa e instalimit të sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi të korridorit në dhomat e shoqërimit. Në përfundim të inspektimit grupi monitorues konstatoi se, megjithëse në Komisarlatin e Policisë Shijak ishin marrë disa masa për përmirësimin e standardeve lidhur me të

¹¹⁸ Ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”

drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe të personave të arrestuar/ndaluar, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika dhe më konkretisht: Në Komisarlatin e Policisë Shijak ambientet e shoqërimit ishin të ndërtuara sipas parashikimeve të bëra në Ligjin Nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe në procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.306, dt. 31.03.2016. Në këtë komisarlat kishte 3 (tre) dhoma shoqërimi, të cilat ndodheshin në katin e parë të një ndërtesë brenda territorit të këtij organi, në hyrjen e tij. Dhomat e shoqërimit ishin të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të mitur¹¹⁹, duke krijuar kushte për trajtim të përshtatshëm të të shoqëruarve. Këto ambiente ishin me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, kishin dritare të cilat lejonin ajrimin dhe ndriçimin natyral, si dhe kishin ndriçim nga rrjeti elektrik. Ato ishin të pastra, dhe të lyera dhe ishin të pajisura me orenditë e nevojshme, si tavolinë dhe karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar. Në korridorin e ambientit të shoqërimit ndodheshin dy tualete, të pajisura me pajisjet e nevojshme, si dhe çezëm me ujë të rrjedhshëm, të ndara më vete për femra dhe meshkuj. Gjithashtu komisarlati kishte gjenerator për furnizimin me energji elektrike në rast defektesh të sistemit elektrik. Në këtë komisarlat mungonte sistemi i monitorimit me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe ambientit të shoqërimit. Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar dhe për rrjedhojë nuk u realizuan intervistime lidhur me trajtimin që u bëhet personave nga ana e punonjësve të policisë. Në Komisarlatin e Policisë Shijak nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar pasi regjistroheshin në regjistër, dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisarlatit të Policisë Durrës. Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisarlatin e Policisë Shijak, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform me parashikimin në procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar. Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrimit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë¹²⁰. Në këtë komisarlat kishte regjistër për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë. Ndërkohë u konstatua se në këtë komisarlat kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por nuk ishte evidentuar asnjë ankesë apo kërkesë. Në Komisarlatin e Policisë Shijak specialistët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e punës së tyre, pasi nuk kishte një ambient të veçantë për kryerjen e veprimeve hetimore. Gjithashtu, Komisarlati i Policisë Shijak nuk posedon hapësirë të posaçme për biseda apo intervistim me fëmijët

¹¹⁹ Kreu VI, pika 3 e procedurave standarde.

¹²⁰ Kreu VII, Procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit

e mitur. Mekanizmi Kombëtar e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se bisedat me fëmijët duhet të realizohen në një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave, pasi nga intervistimi i tyre në zyrat e punës të specialistëve të policisë, mund të shkaktohet traumatizmi plotësues i fëmijëve. Lidhur me këto fakte Institucioni i Avokatit të Popullit nisur edhe nga inspektimi i mëparshëm ka rekomanduar marrjen e masave për krijimin e zyrave të dedikuara ku merren në pyetje shtetasit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore, madje dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, por konstatojmë se sërish ky rekomandim nuk është plotësuar¹²¹. Avokati i Popullit, duke iu referuar standardeve ndërkombëtare, e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit. Nga monitorimi që u krye zyrave të punës të punonjësve të policisë në këtë komisariat nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat. Punonjësit e policisë pasqyruar për grupin e inspektimit se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë. Ndërsa psikologu sigurohej nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës por dhe në bashkëpunim me shkollën e mesme të qytetit të Shijak. Gjatë verifikimit të regjistrave të personave të shoqëruar u konstatua se procedura e ndjekur nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Shijak ishte zhvilluar konform ligjit. Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e godinës dhe të ambientit të shoqërimit si dhe në dhomat e shoqërimit të këtij komisariati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar. Ndërkohë u konstatua se në këtë komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në Nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse. Rezultoi se ndaj personave të shoqëruar nga punonjësi i policisë mbahej një procesverbal tip i emërtuar “Formulari i raportit të Shoqërimit ose Ndalimit/Arrestimit”. U evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme ku në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë, mbaheshin procesverbalet përkatëse ku një kopje e të cilit firmosej dhe i jepej personit të shoqëruar. **Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime:** Marrjen e masave të nevojshme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera për vëzhgimin e

¹²¹ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluarit gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

korridorit në ambientin e shoqërimit. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e një ambienti të përshtatshëm ku intervistohen/merren në pyetje shtetasit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga specialistët dhe punonjësit e policisë.

6.24. KOMISARIATI I POLICISË SKRAPAR

MKPT- kreu në datën 03.07.2019, sipas një Plani Inspektimi të miratuar më parë nga Avokati i Popullit. Grupi i punës në vijim inspektoi ambientet e shoqërimit, disa zyra të punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar. Gjatë inspektimit u konstatua se nuk ishte plotësuar rekomandimi i bërë nga institucioni i Avokatit të Popullit në vitin 2017, për marrjen e masave për rikonstruksionin/ndërtimin e dhomave të shoqërimit në Komisarlatin e Policisë Skrapar sipas kërkesave të Ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe në zbatim të Urdhrit Nr.925, datë 18.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, dhe në “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhritin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.306, datë 31.03.2016 duke krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze dhe të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur. Nuk ishte plotësuar rekomandimi për marrjen e masave të menjëhershme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi, duke qenë se sistemi i monitorimit audio-viziv të procesit të pyetjes dhe intervistimit përbën një ndër aspektet më të rëndësishme përse i përket parandalimit të veprave të dhunshme ndaj shtetasve dhe anasjelltas, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ishte plotësuar rekomandimi për marrjen e masave për pajisjen me regjistër për personat e ndaluar/arrestuar si dhe për plotësimin me përgjegjësi të plotë të regjistrit të personave të shoqëruar në rubrikat e tij në përputhje me parashikimet e nenit 109 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar. Ishte plotësuar rekomandimi për marrjen e masave për zbatimin me rigorozitet të Urdhrit Nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Policisë së Shtetit “Procedura standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, duke respektuar detyrimin e mbajtjes së dokumentacionit të përcaktuar në këtë urdhër dhe pajisjes së personave të shoqëruar me procesverbalin e veprimeve të kryera nga punonjësi i policisë me personin e shoqëruar. Në përfundim të inspektimit grupi monitorues konstatoi se, në ambientet aktuale në Komisarlatin e Policisë Skrapar, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika dhe konkretisht: Në Komisarlatin e Policisë Skrapar, ambienti i shoqërimit ishte në katin e parë të godinës me dalje direkt në hyrjen e korridorit të institucionit dhe përbëhej nga 1(një) dhomë shoqërimi, e cila përdorej për meshkujt madhorë ndërkohë që nuk kishte dhomë për shoqërimin e femrave dhe të të miturve. Për shoqërimin e femrave dhe të të miturve përdorej ambienti i pritjes në hyrje të këtij komisarlati ose personat qëndronin në një ambient të hapur me stola në oborrin e jashtëm të institucionit në mungesë të dhomave të përshtatshme. Dhoma e vetme e shoqërimit mbahej në kushte të mira higjienike dhe kishte dritare të përmasave sipas standardit, që siguronin dritën e nevojshme natyrale. Dhoma kishte ndriçim artificial nga rrjeti elektrik dhe ishte e pajisur me një tavolinë dhe një karrige në kushte të mira. Dera ishte prej druri sipas standardeve. Tuelaleti ndodhej në

të njëjtin kat me dhomën e shoqërimit dhe ishte i përbashkët pasi përdorej edhe nga punonjësit e institucionit. Dhoma e vetme e shoqërimit nuk ishte e mbuluar në brendësi me sistem monitorimi nga kamerat përveç pjesës së hyrjes së saj në korridor. Pavarësisht kushteve që dispononte kjo dhomë shoqërimi ajo sërish nuk ishte në përputhje me “Rregullat dhe Procedurat Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhrin Nr.925, datë 18.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, dhe në “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, dhe në “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.306, datë 31.03.2016. Komisariati i Policisë Skrapar funksiononte në një godinë të vjetër por të mirëmbajtur dhe dhoma e vetme e shoqërimit ishte e përshtatur brenda këtyre ambienteve, por sërish ajo nuk ishte ndërtuar sipas kriterëve të parashikuara në procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit¹²². Në momentin e inspektimit nuk kishte shtetas të shoqëruar. Në ambientin e shoqërimit u konstatua se ishin vendosur postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar të cilat ishin edhe në gjuhë të huaj dhe konkretisht në anglisht. U konstatua se në këtë komisarjat zbatoheshin detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse. U evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme ku në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë në Komisarjatin e Policisë Skrapar mbaheshin procesverbalet përkatëse ku një kopje e të cilit firmosej dhe i jepej personit të shoqëruar. Në Komisarjatin e Policisë Skrapar, nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Drejtorisë së Policisë Berat të cilat ndodheshin pranë IEVP, Berat. Dhomat e vjetra të sigurisë ishin vulosur dhe nuk përdoreheshin në zbatim të rekomandimit të lënë më parë nga Avokati i Popullit. Në zbatim të Ligjit Nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe në procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.306, dt. 31.03.2016, çdo njësi policore që ka dhoma sigurie, duhet të jetë e pajisur, ndër të tjera, edhe me regjistrat përkatës. Regjistrat ishin të mbajtur në rregull. Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisarjatin e Policisë, Skrapar, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform me procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar. Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se: Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrat ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e

¹²² “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

policisë¹²³. Në këtë komisariat ishte vendosur regjistri për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë. Ndërkohë u konstatua se në këtë komisariat kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë. Gjithashtu në Komisaratin e Policisë Skrapar kishte edhe regjistër për takimet me avokatin ose prokurorin, regjistër të shoqërimit të personave në ndaluar në gjykatë apo në institucione të tjera, regjistër të marrjes në pyetje dhe informacion në gjuhën shqipe dhe në disa gjuhë të huaja për të drejtat e personave të ndaluar ose të arrestuar. Në godinën aktuale në Komisaratin e Policisë Skrapar oficerët e policisë gjyqësore për shkak të veprimtarisë së ngjeshur të punës dhe mungesës së ambienteve dhe kushteve i kryenin veprimet procedurale me shtetasit përgjithësisht në zyrat e punës së tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara me kamera dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte një ambient të veçantë intervistimi. Lidhur me këtë fakt Avokati i Popullit nisur edhe nga inspektimet e mëparshme në komisarate të ndryshme të Republikës së Shqipërisë ka rekomanduar marrjen e masave për ndërtimin e zyrave të dedikuara ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera pranë tyre, dhe për rrjedhojë konstatohet si mjaft e rëndësishme dhe e nevojshme realizimi i këtyre ambienteve edhe në Komisaratin e Policisë Skrapar. Procesi i monitorimit filmik gjatë marrjes në pyetje të personave të shoqëruar dhe të ndaluar është një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit. Komisarati i Policisë Skrapar në kushtet aktuale nuk posedonte hapësirë të posaçme për biseda apo intervistim me persona të mitur. MKPT e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se bisedat me fëmijët duhet të realizohen në një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët, pasi nga intervistimi i tyre në kushtet aktuale mund të shkaktohet traumatizim plotësues i fëmijëve. Nga monitorimi që u bë në disa prej zyrave të punonjësve të policisë në godinën aktuale të Komisaratis të Policisë Skrapar, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Në këtë komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në Nenin 109/5 dhe 122/5 të Ligjit Nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse. Edhe në nenet 34/b. pika 2 dhe 251 të K.Pr.Penale parashikohet se të ndaluarit/arrestuarit duhet t’i jepet dhe të mbajë me vete një kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit. Rezultoi se ndaj personave të shoqëruar nga punonjësi i policisë mbahej një procesverbal tip i emërtuar “*Formulari i raportit të Shoqërimit ose Ndalimit/Arrestimit*”. Gjatë inspektimit, u konstatua se në këtë institucion zbatohet detyrimi ligjor për

¹²³ Kreu VII, Proçedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit

të njoftuar personat e ndaluar/arrestuar madhorë që në mungesë të mjeteve financiare për të pajtuar një avokat privat ti ofrohej një avokat kryesisht dhe iu krijuar mundësia për të kontaktuar me të sipas nevojës. Avokatët nga qyteti i Çorovodës mungonin duke qenë se nuk kishte gjykatë në këtë rreth por ata siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat. Lista e avokatëve ishte e afishuar në zyrën e punonjësit të informacionit të Komisarariatit të Policisë Skrapar. Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut i cili sigurohej në kohë përmes ndihmës nga shkolla e mesme e këtij qyteti ose nga Drejtoria Vendore e Policisë Berat dhe qëndronte i pranishëm derisa përfundonte procedura përkatëse. Gjatë inspektimit u konstatua se edhe në korridoret e godinës të këtij komisariati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar. **Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime:** Marrjen e masave të nevojshme dhe gjetjen e fondeve përkatëse për të mundësuar rikonstruksionin e përgjithshëm të godinës së Komisarariatit të Policisë Skrapar me qëllim për ta kthyer atë në një institucion me standarde bashkëkohore dhe dinjtoze, si për personat e shoqëruar, arrestuar/ndaluar, ashtu edhe për punonjësit e policisë. Marrjen e masave për ndërtimin e dhomave të shoqërimit në Komisariatin e Policisë Skrapar, sipas kriterëve të parashikuara në Kreun VI, pika 3 të procedurave standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në polici”*, miratuar me Urdhrin nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit duke përfshirë në të dhe ndërtimin e një dhome shoqërimi për të miturit dhe të një dhome shoqërimi për femra dhe monitorimin e tyre me kamera. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave në Komisariatin e Policisë Skrapar ku merren në pyetje personat e shoqëruar dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto ambiente. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave të posaçme për intervistim me persona të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët,

6.25. KOMISARIATI I POLICISË TEPELENË

MKPT u kreu një inspektim në datën 17.07.2019, sipas një Plani Inspektimi të miratuar më parë nga Avokati i Popullit. Grupi inspektues, pasi mori informacionin e nevojshëm lidhur me qëllimin e inspektimit, vijoi takimin me punonjësën e policisë të zyrës së informacionit që na u bashkua gjatë evidentimit të kushteve të dhomave të shoqërimit. Theksojmë se, të gjithë punonjësit e policisë me të cilët kontaktuam u treguan bashkëpunues gjatë komunikimit dhe inspektimit, që zhvilloi grupi inspektues në ambientet e këtij komisariati. Grupi i punës në vijim inspektoi ambientet e shoqërimit, zyrat e punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar. Nga informacioni i grumbulluar në vend gjatë kryerjes së inspektimit, rezultoi se gjendja faktike e ambientit të shoqërimit kishte pak ndryshime në krahasim me një vit më parë, duke patur parasysh standardet e parashikuara në aktet normative dhe dokumentet ndërkombëtare, për respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar brenda këtyre ambienteve dhe duke zbatuar pjesërisht rekomandimin e Avokatit të Popullit dërguar pas inspektimit të bërë në vitin 2018. U konstatua se ishte zbatuar rekomandimi për

marrjen e masave të nevojshme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhguese në korridorin e ambientit të shoqërimit. Nuk ishte plotësuar rekomandimi për marrjen e masave të nevojshme për krijimin e ambienteve të përshtatshme ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra. Në kuadrin e informacionit përsa i përket organikës të Komisarariatit të Policisë Tepelenë, kjo e fundit ishte e plotësuar. Në përfundim të inspektimit grupi monitorues konstatoi se, megjithëse në Komisariatin e Policisë Tepelenë ishin marrë disa masa për përmirësimin e standardeve lidhur me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe të personave të arrestuar/ndaluar, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika dhe më konkretisht: Në Komisariatin e Policisë Tepelenë ambientet e shoqërimit ishin të ndërtuara sipas parashikimeve të bëra në Ligjin Nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe në procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.306, dt. 31.03.2016. Këto ambiente ishin me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të mitur¹²⁴, duke krijuar kushte për trajtim dinjitoz të të shoqëruarve. Në këtë komisarariat kishte 3 (tre) dhoma shoqërimi, të cilat ndodheshin në katin e parë të një ndërtesë brenda territorit të këtij organi, në hyrjen e tij. Dhomat e shoqërimit kishin dritare të cilat lejonin ajrimin dhe ndriçimin natyral, si dhe kishin ndriçim nga rrjeti elektrik. Ato ishin të pastra, dhe të lyera dhe ishin të pajisura me orenditë e nevojshme, si tavolinë dhe karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar por kishin nevojë për rikonstrukcion pasi ishin të amortizuara. Në korridorin e ambientin të shoqërimit ishte ndërtuar edhe tualeti në të cilin kishte ujë të rrjedhshëm. Gjithashtu kishte edhe gjenerator funksional për furnizimin me energji në rast defektesh. Ambientet e shoqërimit nuk kishin sistem ngrohjeje. Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar dhe për rrjedhojë nuk u realizuan intervistime lidhur me trajtimin që u bëhet personave nga ana e punonjësve të policisë. Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre. Në Komisariatin e Policisë Tepelenë nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar, dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Gjirokastër. Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar si dhe trajtimi i të shoqëruarve, ndaluarve/arrestuarve gjatë veprimeve që kryen policia. Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisariatin e Policisë Tepelenë, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform me parashikimin në procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar. Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të Ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se: Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrimit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë¹²⁵. Punonjësit e policisë sqaruan se si orar shoqërimi fillestar në çdo rast përdoret momenti i hyrjes së personave në Komisariatin e Policisë Tepelenë. Në rastet e arrestimit të personave si orar shërbente

¹²⁴ Kreu VI, pika 3 e procedurave standarde.

¹²⁵ Kreu VII, Procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit

momenti kur ekzekutohej masa e arrestit në vendin ku ndalohej personi i cili mund të ishte i ndryshëm për shkak të rrethanave ku realizohej ndalimi apo kapja e tij. Punonjësit e policisë sqaruan se në regjistrin e ndalim-arrestimit specifikohet orari faktik i ndalimit paçka se ky mund të ishte i ndryshëm nga orari i hyrjes në ambientet e komisariatit. Në këtë komisariat kishte regjistër për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë. Ndërkohë u konstatua se në këtë komisariat kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por nuk ishte evidentuar asnjë ankesë apo kërkesë. Në Komisaratin e Policisë Tepelenë oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e punës së tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta hetimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore. Gjithashtu Komisarati i Policisë Tepelenë nuk posedon hapësirë të posaçme për biseda apo intervistim me persona të mitur, MKPT e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se bisedat me fëmijët duhet të realizohen në një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët, pasi nga intervistimi i tyre në kushtet aktuale mund të shkaktohet traumatizim plotësues i fëmijëve. Lidhur me këto fakte Avokati i Popullit nisur edhe nga inspektimi i mëparshëm ka rekomanduar marrjen e masave për krijimin e zyrave të dedikuara ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra por është konstatuar se sërish ky i fundit nuk është plotësuar¹²⁶. Avokati i Popullit, duke iu referuar standardeve ndërkombëtare, e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit. Nga monitorimi që u bë të gjitha zyrave të punonjësve të policisë, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat. Punonjësit e policisë pasqyruar për grupin e inspektimit se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë. Ndërsa psikologu sigurohej në bashkëpunim me shkollat e mesme të qytetit të Tepelenës. Gjatë verifikimit të regjistrave të personave

¹²⁶ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluarit gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.”

CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

të shoqëruar u konstatua se procedura e ndjekur nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Tepelenë ishte zhvilluar konform ligjit. Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e godinës dhe të ambientit të shoqërimit si dhe në dhomat e shoqërimit të këtij komisaritati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar. Ndërkohë u konstatua se në këtë komisarariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në Nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse. Rezultoi se ndaj personave të shoqëruar nga punonjësi i policisë mbahej një procesverbal tip i emërtuar “*Formulari i raportit të Shoqërimit ose Ndalimit/Arrestimit*”. U evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme ku në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë, mbaheshin procesverbalet përkatëse ku një kopje e të cilit firmosej dhe i jepej personit të shoqëruar. **Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime:** Marrjen e masave të nevojshme dhe gjetjen e fondeve përkatëse për të mundësuar rikonstruksionin e përgjithshëm të godinës së Komisarariatit të Policisë Tepelenë me qëllim për ta kthyer atë në një institucion me standarde bashkëkohore dhe dinjtoze, si për personat e shoqëruar, arrestuar/ndaluar, ashtu edhe për punonjësit e policisë. Marrjen e masave të menjëhershme për rikonstruksionin e ambienteve të shoqërimit të shtetasve të Komisarariatit të Policisë Tepelenë të cilat ishin të amortizuara. Marrjen e masave të menjëhershme për krijimin e ambienteve të përshtatshme ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave të posaçme për intervistim me persona të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.

6.26. KOMISARIATI I POLICISË VAHU I DEJËS SHKODËR

MKPT kreu inspektim në datën 28.05.2019, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Inspektimi vijoi në ambientet e shoqërimit, në disa nga zyrat e punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar. Në përfundim të inspektimit grupi inspektues konstatoi se, megjithëse në Komisariatin e Policisë Vau Dejës, ishin marrë disa masa për respektimin e standardeve lidhur me kushtet materiale dhe të drejtat ligjore të personave të shoqëruar, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika dhe më konkretisht: Në Komisariatin e Policisë Vau Dejës ambienti i shoqërimit nuk ishte i ndërtuara sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.306, datë 31.03.2016. Grupi i inspektimit, konstatoi se, në ambientin e shoqërimit ndodheshin 2 (dy) dhoma shoqërimi, të cilat shërbenin për shoqërimin, mbajtjen dhe trajtimin në mjediset e komisarariatit të policisë vetëm për personat e rritur. Këto ambiente ishin me sipërfaqe të vogël prej 1.5x2.5m dhe hapësira jo të bollshme për qëndrimin e të shoqëruarve,

duke krijuar minimalisht kushte për trajtim dinjitoz dhe garantimin e të drejtave që ju njeh ligji personave të privuar nga liria. Dhomat e shoqërimit kishin dritare të cilat lejonin ajrimin dhe ndriçimin natyral, por mungonte ndriçimi nga rrjeti elektrik. Ato ishin të pastra nga ana higjienike, të lyera por nuk ishin të pajisura me orenditë e nevojshme, si tavolinë dhe karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar. Sipas personelit këto orendi vendoseshin në këro dhoma vetëm në rastet kur kishte persona të shoqëruar. Në korridorin afër ambientin të shoqërimit ishte ndërtuar edhe tualeti i cili shërbente për të gjithë komisariatit në të cilin kishte ujë të rrjedhshëm. Nga inspektimi i ambientit të shoqërimit rezultoi se, në këtë Komisariat mungonte dhoma e shoqërimit më vete për të mitur¹²⁷. Sipas procedurës standarde për rregullat teknike të shoqërimit në polici, në rastet kur i shoqëruari është i mitur, organi i policisë ka detyrimin ligjor të sigurojë dhomë shoqërimi më vete për të miturit, si dhe të realizojnë menjëherë njoftimin e personit mbikëqyrës të tij (prindërit, kujdestarit ligjor)¹²⁸. Gjithashtu, në ambientin e shoqërimit mungonte sistemi i monitorimit me kamera¹²⁹ për mbajtjen në vëzhgim të veprimeve që kryejnë punonjësit e policisë me personat e shoqëruar dhe dhomave të shoqërimit. Në lidhje me zbatimin e rregullave të sigurisë gjatë kryerjes së veprimeve me personat e shoqëruar, në Komisariatit Vau Dejës, mungonte edhe dhoma(zyra) për marrjen në pyetje/intervistimin e këtyre personave¹³⁰. Mungesa e këtyre elementëve, mund të përbëjë shkak për përdorimin e mjeteve dhe metodave jo të përshtatshme për shoqërimin, mbajtjen dhe trajtimin e personave në mjediset e policisë, si dhe për respektimin dhe garantimin e të drejtave që ju njeh ligji këtyre personave. Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar dhe për rrjedhojë nuk u realizuan intervistime lidhur me trajtimin që u bëhet personave nga ana e punonjësve të policisë. Në Komisariatit e Policisë Vau Dejës nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisariatit të Policisë Shkodër. Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar, si dhe trajtimi i të shoqëruarve, ndaluarve/arrestuarve gjatë veprimeve që kryen policia. Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisariatit e Policisë Vau Dejës, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform me procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar. Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrimit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë¹³¹. Në këtë komisariat kishte regjistër për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë. Ndërkohë u konstatua se në këtë komisariat kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të

¹²⁷ Kreu VI, pika 3/b të procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.

¹²⁸ Kreu VI, pika 2/a të procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.

¹²⁹ Kreu VI, pika 4/ç të procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.

¹³⁰ Kreu VI, pika 4/e të procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.

¹³¹ Kreu VII, procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.

personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por nuk ishte evidentuar asnjë ankesë apo kërkesë.

Në Komisarriatin e Policisë Vau Dejës oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e punës së tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta hetimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore. Në momentin e inspektimit këto zyra ishin të mbyllura me çelës dhe grupi inspektues e pati të pamundur inspektimin në këto dhoma. Lidhur me këtë situatë shefi i rendit mori përsipër nxjerrjen e një urdhëri për depozitim dhe mbajtjen pranë zyrës së specialistit të informacionit mbajtjen e një kopje të këtyre çelësve në çdo kohë. Lidhur me këtë fakt Avokati i Popullit ka rekomanduar marrjen e masave për krijimin e një zyre të veçantë ku të merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin në këtë zyrë të sistemit të monitorimit me kamera. Avokati i Popullit, referuar standardeve ndërkombëtare¹³² e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit. Nga intervistimi i punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat. Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, ata shoqëroheshin për në ambientet e sigurisë të Komisarriatit të Policisë Shkodër, për kryerjen e veprimeve procedurale në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale. Ndërsa psikologu sigurohej në bashkëpunim me shkollat e mesme të qytetit të Shkodrës. Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e godinës dhe të ambientit të shoqërimit, si dhe në dhomat e shoqërimit të këtij komisarriati, nuk ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar. Ndërkohë u konstatua se në këtë komisarriat zbatoheshin detyrimi ligjor i parashikuar në Nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit të çështjes përkatëse. **Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime:** Marrjen e masave të menjëhershme për ndërtimin dhe plotësimin e ambienteve të shoqërimit sipas kriterëve të parashikuara në procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orëditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, meshkuj dhe kryesisht për të miturit.

¹³² “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluarit gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

Marrjen e masave të nevojshme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhguese në korridorin e ambientit të shoqërimit. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrës të intervistimit ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra. Marrjen e masave për krijimin e një sistemi aksesi në çdo kohë në zyrat e oficerëve të policisë gjyqësore nga ana e trupave monitoruese të brendshme dhe të jashtme.

6.27 KOMISARIATI I POLICISË SË KUFIRIT DHE MIGRACIONIT, MURIQAN

MKPT kreu inspektim në datën 28.05.2019, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin gjithashtu Patrizio Gonella, Petur Hauksson dhe Markus Jaeger, në cilësinë e përfaqësuesve të Këshillit të Europës në kuadër të Observatorit të Mekanizmave Kombëtarë për Parandalimin e Torturës (MPM OBS). Grupi i inspektimit vizitoi ambientet e shoqërimit dhe ato të sigurisë, disa nga zyrat e oficerëve të policisë në këtë Stacion, si dhe kërkoi të njihet me gjithë dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar. Gjatë kryerjes së inspektimit, rezultoi se ambienti i shoqërimit të personave në Stacionin e Policisë së Kufirit në Muriqan, aktualisht ndodhej brenda ambientit të godinës së Stacionit, të improvizuara poshtë një shkalle që lidhte katin e parë me katin e dytë të godinës. Këto ambiente ishin përshtatur jashtë standardeve teknike të dhomave të shoqërimit të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore për këtë qëllim. Në brendësi të këtij ambienti me sipërfaqe 2mx1m, i rrethuar me rrjetë hekuri dhe i mbyllur me derë hekuri dhe me shula, u gjetën dhe tre ulëse karrigesh dhe dy batanije, të cilat ishin dhënë për tu përdorur nga ana e personave të shoqëruar apo ndaluar/arrestuar gjatë orëve të qëndrimit në atë ambient. Lidhur me kohën e ndërhyrjes në strukturë dhe përshtatjes së nënshkallës në ambiente sigurie nuk morëm një përgjigje të saktë nga Shefi i Stacionit, z. Leart Sula, pasi ai ishte emëruar në atë detyrë gjatë dy muajve të fundit. Për veprimet me personat e shoqëruar, Shefi i Stacionit na informoi se, pasi ata konstatoheshin nga punonjësit e Policisë Kufitare si persona në konflikt me ligjin, në mungesë të ambienteve, shoqëroheshin menjëherë në ambientet e Komisarariatit të Policisë Shkodër, për kryerjen e veprimeve të mëtejshme. Megjithatë kishte raste kur këta persona ishin banorë të qyteteve të tjera dhe Sherbimeve të Komisariateve respektive i disa orë për të arritur në Muriqan, me qëllim që t'i merrnin në dorëzim dhe të kryenin veprime të mëtejshme. Në këto raste, personat e shoqëruar, ndaluar/arrestuar mbaheshin në këto ambiente sigurie të improvizuara. Plotësimi i kushteve dhe standardeve për mbajtjen dhe trajtimin e personave të shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar në mjediset e policisë, përbën detyrim ligjor për Stacionin e Policisë së Kufirit dhe Migracionit Muriqan, me qëllim garantimin e respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria. Grupi i inspektimit konstatoi se nuk kishin gjetur zbatim detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 109/5 dhe 122/5 të Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë, që ngarkohen me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse. Në përfundim të inspektimit, Grupi Monitorues konstatoi se, në Stacionin e Policisë Kufitare Muriqan duheshin marrë

masa të menjëhershme lidhur me përmirësimin e standardeve dhe të drejtave ligjore të personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar apo personave të riadhesuar. Siç u përmend edhe më lart, ambienti i sigurisë në Stacionin e Policisë Kufitare Muriqan nuk ishte ndërtuar sipas parashikimeve në procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 306 datë 31.03.2016. Mjedisi i shoqërimit dhe punës me shtetasit, ndodhej përbri ambienteve (kioskave) ku kryheshin procedurat e kontrollit të pasaportave dhe kalimit të kufirit të udhëtarëve. Këto ambiente ndaheshin nga njëri-tjeri me xham. Në ambientin e shoqërimit ndodhej zyra e shërbimit të punonjësit të informacionit, dhoma për intervistimin e shtetasve të shoqëruar, por mungonin 3 (tre) dhoma për personat e shoqëruar, të ndara më vete për persona të rritur, femra dhe të miturit. Në këtë Stacion Policie Kufitare ka të instaluar pjesërisht një sistem monitorimi me kamera me qëllim mbajtjen në vëzhgim të ambienteve të brendshme të godinës dhe pikave të kontrollit të pasaportave, por ky sistem nuk është krejtësisht funksional pasi nuk ishte finalizuar duke mbuluar monitorimin e ambienteve ku mbahen personat e privuar nga liria në rastet e shoqërimit dhe ndalim /arrestimit. Avokati i Popullit e konsideron procesin e monitorimit filmik si një element parësor dhe një standard ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e Policisë së Shtetit ndaj tyre.¹³³ Duke vlerësuar në tërësi elementët kryesor të ambientit të sigurisë në këtë Stacion të Policisë të Kufirit dhe Migracionit, për trajtimin dinjitoz të shtetasve të arrestuar dhe të ndaluar, gjykojmë se, dhomat e sigurisë nuk plotësojnë asnjë nga kushtet dhe kriteret ligjore të përcaktuara në aktet normative dhe dokumentet ndërkombëtare. Institucioni i Avokati i Popullit gjykon se, standardet e përcaktuara në rregullat teknike të shoqërimit, janë standarde minimale që duhet të respektohen në mjediset e policisë, ndaj plotësimi i tyre është detyrim ligjor për organet e policisë. Në këtë Stacion Policie mungonte regjistri i personave të shoqëruar me shënimet përkatëse dhe këto persona nuk regjistroheshin në “Regjistrin e evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar”, sipas “Model nr.1 të procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306 datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Regjistrimi i tyre në regjistër bëhej nga punonjësi i zyrës të informacionit, sipas dispozitave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”. Në momentin e inspektimit grupi inspektues u ndesh me informacione jo të sakta dhe kontradiktore lidhur me praktikën e mbajtjes së këtij regjistri nga punonjësit e rolit bazë, përgjegjës për mbajtjen dhe administrimin e tij. Lidhur me verifikimet për ekzistencën e këtij regjistri dhe gjithashtu për verifikimin e Urdhërit për ndërtimin e dhomës së sigurisë dhe inventarizimit të saj, Grupi Inspektues u detyrua të ndryshojë planin e inspektimit dhe të kërkojë takim me drejtues të lartë të Drejtorisë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit Shkodër. Gjatë takimit dhe shkëmbimit të informacionit rezultoi

¹³³ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohej që të regjistrohen në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluar gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.”

CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

se si në rastin e mungesës së regjistrimit të personave të shoqëruar, ashtu dhe me iniciativën për të krijuar ambiente sigurie të pa miratuara, ishin veprime apo mosveprime që ngarkonin me përgjegjësi personelin përgjegjës të Stacionit të Policisë së Kufirit dhe Migracionit Muriqan. Grupi inspektimit konstatoi gjithashtu se nuk zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të Procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë, që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit e çështjes përkatëse. Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar. **Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime:** Marrjen e masave për mbylljen e menjëhershme dhe mospërdorimin e ambientit të sigurisë, ndërtuar pa lejen dhe miratimin e strukturave drejtuese të Policisë Kufirit dhe Migracionit, të cilat nuk plotësojnë kushtet dhe kriteret e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore, që të garantojnë respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria. Marrjen e masave administrative ndaj personave përgjegjës të cilët kanë urdhëruar dhe lejuar përdorimin e këtij ambienti sigurie, i cili përbën trajtim degradues dhe jo njerëzor të personave të privuar nga liria të mbajtur në këto ambiente. Marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin e ambienteve të reja të sigurisë sipas procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1102 datë 07.11. 2017. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e dhomës më vete në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë, për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar në mjediset e policisë. Marrjen e masave të menjëhershme të sigurimit, vënies në funksion dhe plotësimit të regjistrimit të evidentimit të personave të shoqëruar. Marrjen në analizë dhe nxjerrjen e përgjegjësive dhe marrjen e masave administrative lidhur me mosveprimin e personelit përgjegjës në administrimin e këtij regjistri dhe tentativës për të mohuar të vërtetën lidhur me këtë situatë. Marrjen e masave të nevojshme për vendosjen e pajisjeve të sigurisë (sisteme me kamera audio-vizive) për vëzhgimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme të dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë, të dhomës për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar, si dhe për monitorimin e veprimeve të punonjësve të policisë me personat që ndodhen në mjediset e policisë. Marrjen e masave për vënien në funksion dhe shtimin e kamerave të sigurisë për monitorimin e ambienteve ku punohet dhe mbahen personat e privuar nga liria në Stacionin e Policisë Muriqan. Marrjen e masave të menjëhershme lidhur me pajisjen me një kopje të proces-verbalit, të mbajtur nga Punonjësi i Policisë për secilin person të kthyer apo të cilit i pengohet kalimi kufitar, ku të pasqyrohen shkaqet e kthimit apo mos lejimit të kalimit kufitar dhe kohëzgjatjen e panaliteteve si rezultat i shkeljeve të rregullave Shengen nga personat në fjalë.

6.28. REPARTI USHTARAK NR. 6620

MKPT kreu një inspektim periodik në Repartin Ushtarak Nr.6620, Policia Ushtarake Tiranë, më datë 11.09.2019. Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e standardeve të përcaktuara në ligjin nr.173/2014 “Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, ligjin nr.13/2015 “Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, “Rregulloren e jetës së brendshme të

Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, si dhe udhëzimin nr.5, datë 22.04.2015, të Ministrisë të Mbrojtjes “Për procedurën disiplinore në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, që kanë të bëjnë me krijimin e kushteve, trajtimin dhe respektimin e të drejtave dhe detyrimeve të ushtarakëve me masë disiplinore për shkelje të rëndë, “ndalim disiplinor”. Vizita periodike inspektuese për vitin 2019 e ekspertëve të Institucionit të Avokatit të Popullit në Policinë Ushtarake Farkë, Tiranë, u krye në përputhje me metodologjinë e inspektimit të Mekanizmit Kombëtar, bazuar në standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të funksionimit të kësaj strukture.

Grupi i inspektimit kontaktoi fillimisht me Komandantin e këtij Reparti, Kolonel Altin Kurti dhe më tej zhvilloi takimin me shefin e shtabit të Policisë Ushtarake, Major Euklid Janini dhe grupin e ushtarakëve që e shoqëronin, të cilët u informuan në lidhje me qëllimin e këtij inspektimi. Shefi i shtabit të repartit, informoi grupin e inspektimit në lidhje me masat e marra për krijimin e kushteve për trajtimin dhe respektimin e të drejtave të ushtarakëve ndaj të cilëve zbatohet masa disiplinore për shkelje të rëndë disiplinore “ndalim disiplinor” në këtë institucion, kuadri ligjor ku mbështetet veprimtaria e Policisë Ushtarake në lidhje me ekzekutimin e masës disiplinore për kufizimin fizik të ushtarakut, si dhe për zbatueshmërinë e rekomandimeve të bëra nga Institucioni i Avokatit të Popullit në inspektimet e viteve të kaluara. Nga informacioni dhe verifikimi i kushteve në të cilën ndodheshin ambientet e Policisë Ushtarake në Farkë, rezultoi se, për shkak të mungesës të infrastrukturës të godinave ku ishte dislokuar repartit, nuk ishte bërë e mundur krijimi i një ambienti më vete për mbajtjen, qëndrimin dhe trajtimin e ushtarakëve me masë disiplinore “ndalim disiplinor”. Më konkretisht, Policia Ushtarake në muajin Shkurt të vitit 2018 me urdhër të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura ishte transferuar nga ambientet ku ndodhej prej vitesh në Sauk, Tiranë dhe ishte vendosur përkohësisht në ambientet e një repartit ushtarak në zonën e Farkës. Në momentin e inspektimit u informuam gjithashtu se, përsëri me urdhër të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Komanda e Repartit, kishte planifikuar masat që brenda datës 31 Tetor 2019, të lironte ambientet në zonën e Farkës, për tu ridislokuar në ambientet e tjera të ish-Komandës të Forcave Ajrore me vendodhje në Rinas. Kjo situatë prej dy vitesh e qëndrimit të përkohshëm dhe mungesës të godinave në Farkë, kishte bërë të pamundur krijimin e ambienteve të veçanta për mbajtjen e trajtimin e ushtarakëve me masë disiplinore “ndalim disiplinor”. Gjithashtu, sipas informacionit, gjatë periudhës 2 vjeçare nuk ka patur masa disiplinore, për shkelje të rëndë disiplinore “ndalim disiplinor”, duke mos e cenuar të drejtën efektive të ushtarakëve me këtë masë disiplinore. Nisur nga eksperiencia e mëparshme, grupi i inspektimit u informua se, në ambientet e Policisë Ushtarake në Sauk, kanë qenë në funksion të plotë 10 dhoma të ndalimit disiplinor për ushtarakët me masë disiplinore për shkelje të rëndë të disiplinës, të ndërtuara në bazë të procedurave standarde të veprimit. Ato kanë qenë të kompletuar me materiale për fjetje si krevat, dyshek, jastëk dhe batanije, si dhe me orenditë e nevojshme tavolina, komodina dhe karrige. Në organikën e këtij repartit është mjeku, ndihmësmjeku dhe psikologu, për trajtimin shëndetësor dhe psiko-social të ushtarakëve që qëndrojnë në dhomat e “ndalimit disiplinor”. Pranë dhomave të “ndalimit disiplinor” në Sauk nuk mungonte dhe ambienti i takimit të ushtarakut me familjarët, i cili ka qenë i pajisur me orenditë e nevojshme për të realizuar qëllimin e këtyre takimeve. Çdo ushtaraku që akomodohej në këto ambiente i sigurohej një paketë e plotë e produkteve të higjienës personale. Veprimtaria dhe

aktiviteti i ushtarakëve në dhomat e “ndalimit disiplinor”, ishte e drejtuar nga orari ditor i veprimeve, miratuar nga Komandanti i Policisë Ushtarake. Gjithashtu, në ambientet e dhomave të “ndalimit disiplinor” kanë qenë të afishuara posterat me të drejtat dhe detyrimet e ushtarakëve me masë “ndalim disiplinor”, si dhe mbahej e administrohej i gjithë dokumentacioni i nevojshëm nga personeli i shërbimit në këto ambiente. Në përfundim, shefi i shtabit të Policisë Ushtarake, informoi grupin e inspektimit se, pas dislokimit të këtij repartit në rajonin e Rinasit, grupi i punës i ngritur për këtë qëllim nga Shefi i Shtabi i Përgjithshëm i FA, ka përgatitur një projekt-ide sëbashku me relacionin shoqërues, për ndërtimin dhe përshtatjen e ambienteve ekzistuese ku do të vendoset Policia Ushtarake. Ky projekt, përfshin edhe ndërtimi i dhomave të “ndalimit disiplinor”, sipas të gjitha standardeve dhe parametrave të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kjo projekt-ide pritet të zbatohet menjëherë, pas miratimit të buxhetit vjetor të Ministrisë të Mbrojtjes për vitin 2020. Institucioni i Avokatit të Popullit, mbështet zbatimin sa më parë të këtij projekti të Policisë Ushtarake, në lidhje me krijimin e kushteve, trajtimin dhe respektimin e të drejtave të ushtarakëve që ndodhen nën efektin e zbatimit të kësaj mase të rëndë disiplinore, kur kjo përcaktohet në urdhrin e lëshuar nga autoriteti përgjegjës që ka dhënë masën disiplinore¹³⁴. **Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbushnin këtë rekomandim:** *“Marrjen e masave të menjëhershme për ndërtimin dhe krijimin e dhomave të ndalimit disiplinor të Policisë Ushtarake, për akomodimin e ushtarakëve që kanë kryer shkelje të rënda të disiplinës, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe standardet ndërkombëtare”.*

6.29. STACIONI I POLICISË KUFITARE PORTI DURRËS DHE NË DREJTORINË VENDORE PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN DURRËS

MKPT kreu inspektim në datën 12.06.2019, sipas një Plani Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Stacioni i Policisë Kufitare Porti Durrës është pjesë përbërëse e Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Durrës. Në këtë stacion, përveç ambienteve të kontrollit të pasaportave dhe personelit përgjegjës për këtë funksion në godinën kryesore të kësaj Pike Kalimi Kufitar gjendeshin zyra të pajisura me teknologjinë e informacionit (sistemi TIMS) dhe personelin e specializuar për të identifikuar dhe proceduar lidhur me rastet e paraqitura problematike në momentin e hyrjes-daljes në territorin shqiptar, kishte edhe dy ambiente ku qëndronin për pak kohë shtetasit shqiptarë të kthyer nga policitë e vendeve të tjera, shtetasit e huaj që hyjnë me dokumentacion të parregullt në vendin tonë, si dhe shtetasit shqiptarë ndaj të cilëve për arsye ligjore vendosej refuzimi për të dalë jashtë shtetit. Stacioni vepronte me struktura dhe logjistikë pranë Pikës së Kalimit Kufitar Durrës. Grupi monitorues u njoh me punën e bërë dhe praktikën e ndjekura në këtë pikë në raste të problemeve me kategori të ndryshme. Një nga kategoritë më shqetësuese ishte ajo e personave të deklaruar si të papranuar apo të papranueshëm në territorin italian për shkak të pamjaftueshmërisë së mjeteve financiare, pamjaftueshmëri që konstatohet nga pala italiane mbi arsyetimin e diskutueshëm se

¹³⁴ Neni 14/c, ligji nr.173/2014 “Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”; Kreu XII, pika 2/c e udhëzimit nr.5, datë 22.04.2015, të Ministrit të Mbrojtjes “Për procedurën disiplinore në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

personi, sipas rregullave të zonës Schengen, duhet të ketë me vete apo të disponueshme një shumë financiare specifike për kalimin e kufirit. Ambientet e punës të punonjësve të policisë ishin të ndërtuara me kushte komode sipas standardeve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ambienti i shoqërimit në Stacionin e Policisë Kufitare Porti Durrës nuk ishte ndërtuar sipas parashikimeve në procedurat standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në polici*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 306 datë 31.03.2016, sepse nuk kishte tre dhoma shoqërimi dhe të ndara më vehte, respektivisht një për meshkuj madhorë, një për femra dhe një për të mitur. Lidhur me rastet e identifikuar dhe konsultuara në sistemin TIMS nga ana e personelit të Policisë Kufitare për personat me probleme dokumentacioni të cilëve u refuzohet dalja jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, persona të shpallur në kërkim policor, persona të deportuar apo persona të huaj që vijnë në këtë port me dokumentacion të parregullt dërgoheshin në këto dy ambiente dhe intervistoheshin nga punonjësit e policisë. Dy dhomat e intervistimit ishin të pajisura me orenditë e nevojshme, stola për qëndrimin ulur të personave që intervistoheshin, me teknologjinë e informacionit (sistemi TIMS) dhe personelin e specializuar intervistues. Për këtë kategori personash dhe veçanërisht për personat e shoqëruar të dyshuar se kishin probleme penale, në Drejtorinë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Durrës ishin përshtatur dy ambiente qëndrimi. Këto ambiente ishin me hapësira të pamjaftueshme, me ndriçim të kufizuar natyral dhe të pa pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrimin ulur të personave të shoqëruar, si dhe dyert ishin me shula e dryna. Pranë këtyre dhomave, në korridorin e godinës ishte edhe një tualet me kushte normale. Këto ambiente nuk garantonin kushte dinjitoze për qëndrimin e personave të shoqëruar në këto organe të Policisë së Shtetit.

Në ambientet e kësaj drejtorie kishte edhe një apartament të ndërtuar me donacione nga një OJF me të gjitha kushtet e nevojshme, i cili përdorej për akomodimin e përkohshëm të familjarëve të rikthyer, për qëndrim të grupeve vulnerabël, si gra, vajza të trafikuar dhe të mitur. Ky ambient ishte me hapësirë të mjaftueshme, me ndriçim të plotë natyral e artificial dhe kushte normale për qëndrim, i pajisur me një divane dhe dy kolltukë, si dhe një tualet me kushte normale. Mjedisi i shoqërimit dhe ambientet e tjera ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjieno-sanitare. Në ambientet e shoqërimit të Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Durrës nuk ishte instaluar një sistem i monitorimit me kamera me qëllim mbajtjen në vëzhgim të personave të shoqëruar në këtë organ. Avokati i Popullit e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor si një standard ndërkombëtarë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit ndaj tyre.¹³⁵ Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte asnjë person të shoqëruar. Në Pikën e Kalimit të Kufirit Durrës, riatdhesohen në mënyrë periodike nga policitë e vendeve të tjera shtetas shqiptarë. Personat e riatdhesuar dhe të shoqëruar në këto organe regjistroheshin në sistemin

¹³⁵ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohen në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkësë të bërë nga i ndaluar gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

TIMS, si dhe intervistohen të gjithë nga punonjësit e policisë. Ndërkohë ndaj tyre bëheshin edhe verifikime nëpërmjet organeve të policisë sipas vendbanimit përkatës. Sipas, punonjësve të policisë, koha e qëndrimit në këto organe të personave të shoqëruar shkonte deri në 3- 4 orë. Ndërsa në rastet kur ndaj personat e shoqëruar vendosej arrestimi apo ndalimi i tyre, ata dërgoheshin menjëherë në ambientet e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Durrës. Nga punonjësit e policisë u informua se, për komunikimin e tyre me shtetasit e huaj siguroheshin përkthyes dhe kur ishte e nevojshme edhe avokat mbrojtës pa pagesë. Në të dy këto organe nuk kishte regjistra për evidentimin e të dhënave të personave të shoqëruar sipas kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe në procedurën standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 306 datë 31.03.2016. Në ambientet e shoqërimit dhe korridoret e Stacionit të Policisë Kufitare Porti Durrës dhe të Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Durrës ishin vendosur postera me informacionin e nevojshëm lidhur me të drejtat e personave të shoqëruar dhe arrestuar/ndaluar, si dhe drejtën e shtetasve të huaj për të kërkuar statusin e refugjatit. Gjithashtu personeli intervistues kishte formularë për kërkimin e statusit të refugjatit dhe sipas tyre i viheshin në dispozicion së bashku me sqarimet e duhura të gjithë të interesuarve. Këta formularë plotësoheshin si pjesë e procedurës së përzgjedhjes e cila synonte kategorizimin e personave jo shtetas shqiptarë që ndalohen nga policia, në emigrantë ekonomikë të cilët pranojnë të kthehen vullnetarisht në vendin e tyre dhe kërkojnë për këtë ndihmën e IOM, në persona të trafikuar apo në rrezik trafikimi dhe në azilkërkues. Në rastin e konstatimit në Pikën e Kalimit Kufitar të personave jo shtetas shqiptarë të cilët nuk plotësonin kushtet për hyrje apo qëndrim në territorin shqiptar, ata intervistoheshin edhe nga specialistët e Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Durrës dhe pastaj dërgoheshin ose në Qendrën e Pritjes së Azilkërkuesve në Babrru, Tiranë, ose në Qendrën e Mbyllur për të Huajt e Parregullt në Karreç, Durrës. Në momentin e inspektimit nuk konstatuam persona të riadhesuar në ambientet e këtij institucioni, ndaj grupi i inspektimit nuk mundi të zhvillojë intervista në lidhje me problematikat që ata i shqetësonin. Lidhur me këtë çështje, Institucioni i Avokatit të Popullit sjell në vëmendje kërkesat e nenit 109/1/f të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, në cilin parashikohet e drejta e punonjësit të policisë që të shoqërojë personat në ambientet e Policisë, për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, si dhe në rastet e dëbimit ose ekstradimit. Në pikën 5 të po këtij neni, thuhet shprehimisht se: *“Punonjësi i policisë, dokumenton në proces-verbal veprimet e kryera me personin e shoqëruar. Procesverbalin nënshkruhet në fund të çdo flete nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe personin e shoqëruar. Një kopje e procesverbalit i vihet në dispozicion personit të shoqëruar. “Gjatë kohës së inspektimit në Pikën e Kalimit Kufitar Durrës u monitorua edhe sjellja e punonjësve të policisë në komunikimin me qytetarët e ndryshëm, kryesisht me qytetarët shtetas shqiptar dhe të huaj që hynin e dilnin në atë moment në këtë institucion. Nga monitorimi dhe pyetja e disa prej qytetarëve që hynin dhe dilnin nga Pikën e Kalimit Kufitar Durrës, u konstatua se punonjësit e policisë komunikonin në mënyrë korrekte dhe me etikë me ta duke i trajtuar me respekt e dinjitet. Ne gjykojmë se kjo mënyrë sjelljeje e punonjësve të policisë jo vetëm që është një detyrim ligjor, por ndërkohë ajo rrit imazhin dhe prestigjin e organit të Policisë së Shtetit Shqiptar në publik. Ndërkohë ajo rrit edhe besimin e qytetarëve vendas e të huaj ndaj këtij organi të administratës publike. **Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime:***

Marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin e ambienteve të shoqërimit në Stacionin e Policisë Kufitare Porti Durrës dhe në Drejtorinë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Durrës sipas kërkesave të parashikuara në dispozitat e ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe në procedurën standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 306 datë 31.03.2016, duke krijuar tre dhoma shoqërimi më vehte, respektivisht një për të rriturit madhorë, një për femra dhe një për të miturit, të pajisura me orenditë e nevojshme dhe me kushte dinjitoze për qëndrimin e të shoqëruarve. Marrjen e masave të menjëhershme për arredimin e ambientit ekzistues në Drejtorinë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Durrës me orenditë e nevojshme për qëndrim ulur të personave të shoqëruar, deri në momentin e ndërtimit të ambienteve të reja të shoqërimit. Marrjen e masave të menjëhershme për vendosjen në Stacionin e Policisë Kufitare Porti Durrës dhe në Drejtorinë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Durrës të regjistrave për evidentimin e të dhënave të personave të shoqëruar sipas kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe në procedurën standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 306 datë 31.03.2016.

6.30. KOMISARIATI I POLICISË KUÇOVË

MKPT kreu inspektim në datën 03.07.2019, sipas një Plani Inspektimi të miratuar më parë nga Avokati i Popullit. Grupi i punës në vijim inspektoi ambientet e shoqërimit, disa zyra të punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar. Gjatë inspektimit u konstatua se rekomandimet e Institucionit të Avokatit të Popullit të dërguara në vitin 2018 pas inspektimit të bërë në vitin 2017 në këtë komisariat ishin zbatuar në mënyrë të pjesshme dhe konkretisht: Ishte zbatuar rekomandimi për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse, i cili është një detyrim ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të Ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurës standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me urdhrin nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Policisë së Shtetit. Nga verifikimet e bëra u konstatua se për personat e shoqëruar në komisariat aplikohet detyrimi ligjor për dhënien e kopjes së “Procesverbalit të shoqërimit” dhe mbajtjen e kopjes tjetër në sekretarinë e institucionit.

Rekomandimi për marrjen e masave të menjëhershme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi në korridorin e ambientit të shoqërimit dhe në zyrat e intervistimit të personave të shoqëruar dhe atyre të arrestuar/ndaluar, nuk ishte zbatuar ende për shkak të mungesës së fondeve financiare. Në përfundim të inspektimit grupi monitorues konstatoi se, në ambientet aktuale në Komisaratin e Policisë Kuçovë, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika dhe konkretisht: Në Komisaratin e Policisë Kuçovë nuk kishte dhoma shoqërimi të ndërtuara sipas parashikimeve të bëra në ligjin Nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe në procedurën standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.306, dt. 31.03.2016, me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit. Në këtë komisariat, brenda mjediseve të tij, kishte dy dhoma

shoqërimi funksionale të ndara një për të rritur, dhe tjetra për femra dhe të mitur. Dhomat e shoqërimit ishin të lyera, të pastra dhe të mirëmbajtura. Dhomat e shoqërimit ishin të pajisura me tavolinë dhe karrige, kishin dritare me përmasa që siguronin ndriçim të nevojshëm natyral, si dhe ndriçim artificial nga rrjeti elektrik. Në korridorin e godinës pranë ambientit të shoqërimit kishte një tualet, i cili ishte funksional, i pastër dhe kishte ujë të rrjedhshëm. Në ambientin e shoqërimit ishin vendosur postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar. Në momentin e inspektimit nuk kishte shtetas të shoqëruar. Në zbatim të Ligjit Nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe në procedurën standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.306, dt. 31.03.2016, çdo njësi policore duhet të jetë e pajisur, ndër të tjera, edhe me regjistrat përkatës. Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisarlatin e Policisë Kuçovë, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform me procedurën standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar. Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se: Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë¹³⁶. Në këtë komisarlat mbahej regjistri për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij institucioni, i cili ishte i sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë, nisur nga momenti, çasti, kur privoheshin nga liria. Ndërkohë u konstatua se në këtë komisarlat kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë. Gjithashtu në këtë institucion ishin afishuar posterat me të drejtat e personave të shoqëruar dhe personave të ndaluar/arrestuar, ku parashikohej edhe e drejta e tyre për të bërë ankesa, nëse kishin të tilla. Në Komisarlatin e Policisë Kuçovë nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisarlatit të Policisë Berat. Në godinën e Komisarlatit të Policisë Kuçovë oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e punës së tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta intervistimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore. Lidhur me këto shqetësime, Avokati i Popullit, nisur edhe nga inspektimet e mëparshme të bërë në këtë komisarlat ka rekomanduar marrjen e masave për krijimin e zyrave të veçanta ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, por sikurse u parashtrua edhe më sipër ky rekomandim nuk është zbatuar ende¹³⁷. Procesi i monitorimit

¹³⁶ Kreu VII, Procedura standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit

¹³⁷ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse

filmik gjatë marrjes në pyetje të personave të shoqëruar është një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit. Gjithashtu, Komisariati i Policisë Kuçovë në kushtet aktuale nuk posedon ambient të posaçëm për komunikim apo intervistim me persona të mitur. MKPT e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se bisedat me fëmijët dhe pyetja e tyre duhet të realizohen në një ambient më vehte që duhet të jetë i përshtatur në mënyrë të posaçme për zhvillimin e intervistave me këtë kategori personash, pasi nga intervistimi në kushtet aktuale mund të shkaktohet pasoja të rënda deri në trauma tek të miturit që janë në konflikt me ligjin. Nga monitorimi që u bë në disa prej zyrave të punonjësve të policisë në godinën aktuale të Komisarariatit të Policisë Kuçovë, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Në këtë komisarariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të Ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse. Gjatë inspektimit, u konstatua se detyrimi ligjor për të njoftuar personat e ndaluar/arrestuar madhor që në mungesë të mundësive financiare për të pajtuar një avokat privat, kërkojnë ndihmë juridike, atyre u ofrohej një avokat kryesisht dhe iu ishte krijuar mundësia për të kontaktuar me të. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, e cila ishte e afishuar në zyrën e përgjegjës të zyrës së informacionit. Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut që ofrohej menjëherë nga Drejtoria Vendore e Policisë Berat. Në Komisarariatin e Policisë Kuçovë nuk kishte ndonjë zyrë të monitoruar me kamera për marrjen në pyetje të shtetasve të shoqëruar dhe ndaluar/arrestuar nga punonjësit e policisë. Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e godinës, si dhe në dhomën që përdorej për shoqërim të këtij komisaritati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar. **Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime:** Marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin dhe vënien në funksionim të ambienteve të shoqërimit në Komisarariatin e Policisë Kuçovë sipas kriterëve të parashikuara në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe në procedurën standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke pasur edhe një dhomë tjetër të tretë më vehte për të shoqëruarit e mitur, i cili duhet të jetë një mjedis i përshtatshëm dhe dinjitoz, i pajisur me orënditë e nevojshme për qëndrimin e kësaj kategorie personash. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e dhomave (zyrave) të punës në këtë komisarariat ku merren në pyetje apo intervistohen personat e ndaluar/arrestuar dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera. Marrjen e masave të nevojshme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në korridorin e ambientit të shoqërimit të këtij komisaritati.

është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]